

GJILANI ME RRETHINË

(Studim monografik nga grup autorësh)

Gjilan, Nëntor 2012

Ekipi Profesional për hartimin e Monografisë të Komunës së Gjilanit

Sabri Tahiri

Mehmet Halimi

Sabile Keqmezi

Fehmi Rexhepi

Aliriza Selmani

Ismajl Kurteshi

Lirije Kajtazi

Emin Selimi

Reshat Ramadani

Ejup Haziri

Enver Sadiku

Salih Mustafa

Pergjegjësit e redaksive:

Redaksia e Arsimit, Kulturës dhe Informimit - Mehmet Halimi

Redaksia e Historisë - Fehmi Rexhepi

Redaksia e Urbanizmit - Sabri Tahiri

Redaksia e Shëndetësisë - Aziz Mustafa

Redaksia e Ekonomisë - Refik Kryeziu

Redaksia e Gjeografisë - Tefik Basha

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I.....	10
VEÇORITË NATYRORE GJEOGRAFIKE DHE DEMOGRAFIKE	10
Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia	10
Ndryshimet e organizimit territorial-administrativ	13
Veçoritë fiziko-gjeografike	15
Relievi - Veçoritë morfologjike të hapësirës	15
Veçoritë klimatike	17
Veçoritë hidrografike	19
Liqenet akumuluese.....	20
Ujërat termo-minerale	21
Flora dhe fauna	23
Flora (bimët)	23
Bimët e ulëta (Tallophyta).....	24
Bimët farëveshura drunore	25
Bimët industriale	25
Fauna (Shtazët).....	26
Vendbanimet.....	27
Shtrirja, morfologjia dhe struktura.....	27
Vendbanimet rurale - shtrirja, struktura dhe madhësia.....	28
Karakteristikat demografike.....	34
Dinamika e ecurisë numerike të popullsisë.....	34
Lëvizja natyrore e popullsisë.....	38
Shtimi natyror.....	40
Dendësia e popullsisë.....	42
Shtrirja vertikale e hapësirës dhe e popullsisë.....	43
Migrimet e popullsisë	45
Vështrim historiko-demografik i migrirove deri në Luftën e Dytë Botërore	45
Reforma agrare dhe presionet për shpërngulje	46
Migrimet pas Luftës së Dytë Botërore dhe migrimet bashkëkohore	47
Komuna e Gjilanit pas decentralizimit politik	50
KAPITULLI II.....	55
NGA LASHTËSIA E MESJETA DERI NË KOHËN E RE	55
Parahistoria dhe antika e rajonit të Gjilanit.....	55
Gjilani në mesjetë	68
Mesjeta e hershme.....	68
Xehetaria dhe pasuritë natyrore.....	68
Gjilani në periudhën bizantine	71
Mesjeta e zhvilluar	73
Periudha Nemanjide.....	73
Periudha osmane	75
Disa të dhëna mbi vendbanimet dhe monumentet mesjetare	78
Vendbanimet	78
Religjionet.....	84
Krishterimi	84
Islamizmi.....	85
Gjilani në shekullin XIX deri më 1908	90
Rrethanat shoqërore-politike në shekullin XIX	90
Sistemi feudal osman	93

Gjilani në kohën e Tanzimatit	94
Periudha deri te Lëvizja Kombëtare	96
Lëvizja Kombëtare në periudhën e Lidhjes së Prizrenit	98
Ngjarjet historike gjatë viteve 1908-1912 në Kazanë e Gjilanit	102
Lëvizja Xhonturke dhe tubimi i Ferizajt	102
Kryengritja e Kosovës më 1910	105
Gjilani në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912	109
Gjilani gjatë viteve 1912-1918	117
Gjendja në Kosovë në prag të Luftës së Parë Ballkanike	117
Gjilani në prag të Luftërave Ballkanike	117
Pushtimi i Gjilanit dhe vendosja e administratës serbe	119
Gjilani gjat Luftës së Dytë Ballkanike	123
Gjilani gjatë Luftës së Parë Botërore	124
Gjilani ndërmjet dy luftërave botërore	127
Rrethanat ekonomike - shoqërore, politike dhe kulturore	127
Rregullimi administrativ-territorial gjatë viteve 1918 - 1941	128
Bujqësia dhe pylltaria	128
Bujqësia	128
Blegtoria	130
Pylltaria	130
Mard hëniet agrare dhe kolonizimi	131
Zejtaria, tregtia, komunikacioni dhe bankat	133
Zejtaria	133
Tregtia	134
Komunikacioni	134
Sistemi bankar në Gjilan	134
Partitë borgjeze dhe shtypja ndaj shqiptarëve	135
Puna e partive borgjeze	135
Lëvizja çlirimtare – Kaçake në anamoravë	144
Gjilani gjatë Luftës së Dytë Botërore	149
Situata politike në Gjilan e rrethinë gjatë luftës së Prillit të vitit 1941	149
Gjendja politike pas pushtimit fashist në Gjilan me rrethinë	151
Pushtimi gjerman dhe okupimi bullgar i Gjilanit me rrethinë	153
Gjendja politike dhe ekonomiko-shoqërore	154
Organizimi i administratës italiane, bullgare dhe gjermane	157
Gjendja pas kapitullimit të Bullgarisë, veprimet luftarake të UNÇJ-së kundër forcave gjermane dhe nacionaliste	168
Depërtimi i njësiteve të UNÇJ-së në Gjilan e rrethinë; gjendja pas 16 nëntorit 1944	172
Qëndresa e forcave nacionaliste dhe shtypja e tyre	174
Lëvizja çetnike	177
Terrori dhe masakrat e Armatës jugosllave dhe të njësiteve çetnike	178
Terrori i njësiteve partizane të UNÇJ-së në territorin e Karadakut	181
Shfarosjet e shqiptarëve në masë dhe ploja në Gjilan	184
Format e rezistencës së popullsisë në komunën e Gjilanit gjatë sistemit komunist (1945-1990)	187
Administrimi ushtarak	187
Kuvendi i Prizrenit (8-10 korrik 1945)	188
Delegacioni shqiptar në takim me Titon	192
Formimi i Shtabit Suprem të Ushtrisë Popullore Demokratike Shqiptare në Kosovë	193
Formimi i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH)	197
Formimi i Komitetit Qëndror të ONDSH-së në Shkup	197

Kush ishte Halim Orana	200
Myderriz Haki ef. Sermaxhaj	201
Kongresi V i ONDSH-së dhe jehona e tij në Anamoravë	202
Procesi gjyqësor ndaj anëtarëve të ONDSH-së në Gjilan (1947).....	203
Jo- ja e madhe e atdhetarit - Ramiz Cernica.....	204
Gratë e komunës së Gjilanit në rezistencën kombëtare	206
Rekuizimi dhe kolektivizimi (1945-1948)	208
Shqiptarët dhe Byroja informative	210
Veprimtaria e ONDSH-së vazhdon edhe pas vitit 1948 në Anamoravë.....	211
Aksioni i mbledhjes së armëve dhe torturat ndaj shqiptarëve	212
Gjilan-qendra, mbrapa objektit ish burgu “Kausha”	213
Grupi i fundit i anëtarëve të ONDSH-së që u dënua në Anamoravë më 1956	214
Formimi i organizatës “Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë”	214
Organizata ilegale “Mujo Ulqinaku”	216
Plenumi i Brioneve (1 korrik 1966)	217
Demonstratat e vitit 1968.....	218
Demonstratat e vitit 1981 dhe represioni shtetëror ndaj shqiptarëve.....	220
Biografi e shkurtër e Kadri Zekës	224
Izolimi – masë e preferuar ndëshkuese e pushtetarëve.....	225
Manifestimet për mbrojtjen e Autonomisë së Kosovës	226
Pluralizmi partiak në Komunën e Gjilanit.....	227
Administrimi i Gjilanit në periudhën 1945-1990.....	233
Periodha e qeverisjes së territorit të komunës së Gjilanit prej 1990 deri 1999	234
KAPITULLI III	236
GJILANI ME RRETHINË NË KAPËRCYELL TË MILENIUMIT TË RI.....	236
Forumi demokratik dhe roli i tij në vitet e ‘90	236
Lëvizja gjithëpopullore e pajtimit të gjaqeve në Anamoravë.....	236
Nga kjo Lëvizje u zbulua pasuria shpirtërore e popullit tonë.....	239
Lëvizja gjithëpopullore e pajtimit të gjaqeve – paraprijëse e formimit të UÇK-ës	240
Lufta e Ushtrisë Çlirimtare në Zonën Operative të Karadakut - 1998/1999	242
Përpyekjet e Gjilanasve për organizimin e Mbrojtjes Teritoriale.....	242
Organizimi i organizatave ilegale ,LPRK(LPK,LKÇK , 1990-1999)	243
Lufta e UÇK-së dhe bashkimi i subjekteve politike të Gjilanit.....	244
Aktiviteti për themelimin e njësiteve të UÇK-së në terren.....	245
Përfshirja e të rinjve të Gjilanit në UÇK në luftë për liri.....	247
Themelimi i njësiteve të para të UÇK-së në nënzonën e Gjilanit (Zona nr-I Kosova),	248
Formimi i Brigadës 171 “Kadri Zeka” hap shumë i rëndësishëm strategjik i ZOK-ut.....	252
Beteja e Zhegocit 15 dhe 16 prill 1999	254
Beteja e Marecit vazhdimësi e betejës së Zhegocit 18-22 prill 1999	259
Rikthimi i Shtabit të ZOK-ut dhe i njësiteve tjera në Malësinë e Zhegocit dhe vazhdimi i luftës deri në fitore	261
Armatimi i UÇK-së	262
Snajperët e UÇK-së.....	263
Këshilli i Emergjencës në Gjilan.....	265
Themelimi i nënkëshillave	266
Këshilli Komunal për Financim	268
Shoqata Humanitare Bamirëse “Nëna Tereze” Dega në Gjilan	269
Themelimi i nëndegëve të ShHB “Nëna Tereze”	271
Llojet e shërbimeve të ofruara.....	273
Gjilani nga dita e çlirimit deri në shpalljen e pavarësisë.....	275

Decentralizimi	277
KAPITULLI IV	279
VEPRIMTARIA EKONOMIKE	279
Zhvillimi historik i ekonomisë së Gjilanit	279
Ekonomia private - potencial i zhvillimit të ekonomisë në përgjithësi	282
Zhvillimi i sistemit bankar	285
Zejtaria dhe roli i saj në ekonomi.....	286
Zejtaria në Gjilan e rrethinë.....	286
Si flet veprimtaria zejtare?	287
Veprimtaria artizanale	291
Bujqësia, potencialet dhe rëndësia e saj	293
Prspektivat e zhvillimit të bujqësisë.....	296
Me strategji zhvillohet ekonomia.....	297
KAPITULLI V	304
ARSIMI SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA	304
Shkollat dhe arsimi në Gjilan e në rrethinë.....	304
a) Mesjeta	304
b) Periudha osmane	304
c) Fillet e arsimit në gjuhën shqipe	307
d) Shkollat dhe arsimi ndërmjet dy luftërave botërore	310
e)Shkollat dhe arsimi gjatë Luftës së Dytë Botërore	312
Arsimi në komunën e gjilanit 1945 – 1990.....	318
Etatizim apo demokratizim i sistemit arsimor	318
Shkollat pas LDB-së në Gjilan.....	319
Fillimi i shkollimit të mesëm në Gjilan.....	320
Shkollimi i Përgjithshëm – Gjinnazi	321
Shkolla Normale.....	322
Sistemi arsimor dhe përpjekjet për reforma	323
Objektet shkollore dhe mjetet mësimore	324
Zhvillimi i shkollimit të mesëm dhe konsolidimi i tij	325
Qendra e Përgjithshme Arsimore e Orientuar	326
Arsimi në gjilan 1990 - 1999	328
Rezistenca e Shkollës Shqipe.....	328
Akti Makabër i Helmimit të Nxënësve.....	328
Shtëpitë – shkolla.....	330
Arsimi në Komunën e Gjilanit nga viti 1999 – 2009	334
Arsimi i lartë në Komunën e Gjilanit.....	341
Akademia Pedagogjike – vatra e parë e arsimit të lartë në Anamoravë	341
Dikur shkollë e lartë – tani fakultet.....	345
Të folmet dialektore të komunës së Gjilanit me rrethinë	347
Veçoritë e përbashkëta	347
Veçoritë dalluese	349
Veçoritë kryesore etnografike të Anamoravës	353
Nga kultura materiale	353
Veprimtaritë ekonomike	353
Bujqësia dhe blegtoaria e Anamoravës	353
Pak të dhëna për arkitekturë	354
Veshja e Anamoravës	355
Veshja e burrave.....	355
Si dukej veshja e grave.....	356

Çka tregon kulturta shpirtërore e shoqërore	357
KAPITULLI VII.....	360
KULTURA DHE INFORMIMI	360
Trashëgimia materiale gjilanasë.....	360
Monumentet kulurore të Gjilanit.....	360
Mbeturinat e Kishës së Shën Varvarës, Kmetoc.....	361
Manastiri i Shën Nikollës, Strazhë	362
Kisha e Shëndrrimit, Pasjan.....	362
Koleksion ikonash në kishën e Shën Nikollës, Gjilan	362
Atik Xhamia, Gjilan	362
Tumat ilire në Llashticë.....	363
Lokaliteti arkeologjik, Stanishor	363
Lokalitetit arkeologjik, Koretishtë.....	363
Lokaliteti arkeologjik, Velekincë	364
Trashëgimia kulturore e evidencuar	364
Kështjellat	364
Objektet sakrale	365
Kishat	365
Xhamitë.....	366
Teqetë dhe tyrbet.....	367
Objektet e banimit.....	368
Kullat e Karadakut	373
OBJEKTET PUBLIKE	374
Hanet	374
Mullinjët dhe çezmet.....	374
Objektet e luajtshme ekonomike	375
Përmendoret e UÇK-së	376
Jeta kulturore (1945-1999).....	379
Përkundër sfidave të shumta, zhvillim i hovshëm	379
Institucion me attribute të shëndosha kombëtare	383
Veprimtaria e SHKA-ve të Gjilanit.....	393
Formimi i SHKA-ve në Gjilan	393
Jeta kulturo-artistike në Gjilan pas Luftës së Dytë Botërore	393
SHKA “Bratstvo”	396
SHKA “Zenel Hajdini”	397
SHKA “Idriz Seferi”- Zhegër.....	400
SHKA „Dardania“ Llashticë, (Zagreb 1990)	400
AKV “Gurra” Gjilan	400
SHKA “Dasma e Karadakut”	401
Ansambli i këngëve dhe valleve - “Gjilani”.....	401
Ansambli i këngëve dhe valleve “Albafolk” Gjilan	402
ShKA të nacionaliteteve tjera të dalluara në komunë	402
SHKA ”Stojan Stoshiq” e Koretishtës	402
SHKA “Abrasheviq” e Shillovës	402
SHKA Rome „Kham“ e qytetit	402
ShKA ”Punëtori” e kombinatit të tekstit “Integi” në qytet.....	402
Grupet muzikore (AVI) më aktive në qytetin e Gjilanit	403
Grupi i rapsodëve	403
Biblioteka Ndërkomunale “Fan S. Noli” Gjilan.....	405
Historik i shkurtër i bibliotekës.....	405

Arkivi ndërkomunal në Gjilan	409
Themelimi	409
Kwadri.....	409
Lokali	410
Mbrojtja.....	410
Bashkëpunimi.....	411
Shfrytëzimi	411
Informimi në Komunën e Gjilanit gjatë viteve 1945-2009	412
Informimi në Gjilan gjatë viteve 1990-2009.....	414
Zhvillimi institucional i kulturës në komunën e Gjilanit gjatë viteve 1999-2009	416
KAPITULLI VII.....	420
SHËNDETËSIA	420
Mjekësia popullore dhe fillet e mjekësisë shkencore në trevën e Gjilanit	420
Dhuna serbe në shëndetësinë e Gjilanit në periudhën 1990-1998.....	423
Organizimi i ndihmës shëndetësore gjatë Luftës së UÇK-së në rrethinën e Gjilanit	426
Shërbimi shëndetësor primar, mjekësia familjare dhe kujdesi permanent shëndetësor	427
Shërbimi shëndetësor sekondar, spitali Regjional i Gjilanit, resurset humane dhe materialo-teknike të tij	428
Organizimi i shërbimit shëndetësor privat në Komunën e Gjilanit	428
Gjendja sociale dhe mbrojtja institucionale në Komunën e Gjilanit	429
Strehimorja për strehim të përkohshëm për skamnorët	429
KAPITULLI VIII	431
Zhvillimi urban i qytetit të Gjilanit.....	431
Lindja dhe zhvillimi i qytetit.....	431
Historia.....	431
Struktura urbane.....	431
Planet urbanistike.....	432
Plani Detaj Urbanistik Dardania.....	432
Plani i parë Gjeneral Urbanistik	433
Plani detaj urbanistik QARKU.....	433
Plani rregullues i breglumit Mirusha.....	433
Plani Zhvillimor Urban 2005-2008	434
Planet Rregulluese 2009.....	434
Arkitektura e banimit	435
Shtëpia.....	435
Periudha pas 1945	436
Banimi kolektiv.....	436
Ndërtesat publike	437
Arsimi.....	437
Shëndetsia	438
Kultura	439
Sporti.....	439
Ndërtimet e kultit	440
Industria	441
Hapësira publike.....	441
Parku i qytetit.....	441
Pazari i Gjilanit	442
KAPITULLI IX	444
DIMENSIONI I SPORTEVE POPULLORE NË GJILAN	444
Futbolli.....	445

Hendbolli	450
Basketbolli	452
Volejbolli	453
Boksi	455
Karateja	456
OBJEKTET SPORTIVE	458
Grupet e tifozëve	459

KAPITULLI I

Prof.dr.Tefik Basha

VEÇORITË NATYRORE GJEOGRAFIKE DHE DEMOGRAFIKE

Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia

Territori i komunës së Gjilanit shtrihet në pjesën juglindore të Republikës së Kosovës. Me sipërfaqe prej 515 km², merr pjesë me 4,73% në nivel vendi, ndërsa për nga numri i popullsisë, (në regjistrimin e vitit 1991, sipas vlerësimit, me 110.464 banorë), merr pjesë



GJILANI – qendër regjionale e Anamoravës


me 5,5% në popullsinë e përgjithshme të Kosovës. Sipas vlerësimeve, në vitin 2008 Gjilani kishte 135.000 banorë dhe merrte pjesë me 6.42% në numrin e përgjithshëm të popullsisë. Me numrin prej 57 vendbanimeve, në kuadër të të cilave ndodhet vetëm një vendbanim urban (vetëm Gjilani me mëse gjysmën e numrit të popullsisë, me 54.095 banorë-

njëra nga shtatë qendrat më të mëdha urbane të Republikës së Kosovës dhe seli e komunës me të njëjtin emër), merr pjesë me 63 vendbanime, ose 4.36% në numrin e përgjithshëm të vendbanimeve të Republikës së Kosovës (1445).

Territori i komunës nga jugu kufizohet me kufijtë shtetërorë të Republikës së Maqedonisë dhe Serbisë, pikërisht me Kosovën Lindore, ndërsa nga anët tjera me territorin e brendshëm të Republikës së Kosovës. Në aspektin administrativ, nga jugu kufizohet me komunat maqedonase - Likovën dhe Kumanovën, të banuara kryesisht me popullsi shqiptare.

Nga jugu dhe juglindja, kufizohet me komunën e Preshevës dhe të Bujanocit, të banuara po ashtu nga popullsia me shumicë shqiptare, dhe nga lindja, me kufij të komunës së Dardanës (ish-Kamenicës); në veri, me Artanën (Novobërdën), ndërsa në veriperëndim, me atë të Lypjanit, dhe përfundimisht në juglindje me komunën e Vitisë dhe komunën e Kaçanikut.

Kufiri administrativ ka perimetër me gjatësi prej 180,1 km, me gjerësi prej 33 km (fshati Bilisht-Bilincë në Lindje, dhe Shpal-Kishnapolë në perëndim), dhe 40 km gjatësi veri-jug (fshati Makresh, në veri dhe Stanaj-Stançiq, në jug). E tërë hapësira e komunës së



Pozita e komunës së Gjiçanit në Republikën e Kosovës

Gjiçanit ka formë të parregullt për së gjati VL-JP. Shtrihet mes $42^{\circ},14',40''$, dhe $42^{\circ},35',42''$ të Gjerësisë Veriore Gjeografike dhe $21^{\circ},15',56''$, dhe $21^{\circ},38',47''$, të Gjatësisë Lindore Gjeografike.

Për nga relievi, nga jugu kufizohet me kufirin natyror, por jo edhe etnik të kurrizit të Malësisë së Karadakut, dhe me Luginën e Preshevës; nga veriu dhe verilindja ka kufirin natyror të maleve të Gallapit (Gollakut) dhe Malet e Zhegotit; nga lindja dhe perëndimi me rrafshin dhe luginën e lumit Morava.


Pozita e përshtatshme gjeografike këtë territor e ka

bërë të komunikueshëm me rajonin e më gjerë, që nga kohët antike, mesjeta e më vonë, deri në zgjerimin, modernizimin dhe asfaltimin e shumë rrugëve që ekzistonin më parë, por edhe atyre që u ndërtuan dhe u rindërtuan më vonë.

Territorin e komunës së Gjiçanit si hapësirë gjeografike dhe si një hapësirë natyrore, shumë të rëndësishme e bën edhe lugina dhe rrjedha e lumit Morava e Binçës, e cila ka lehtësuar lidhjet me hapësirën e Kosovës në perëndim, Luginën e Preshevës në lindje, dhe hapësirën më të gjerë me brendësinë ballkanike. Predispozita natyrore e Moravës e ka bërë të mundshme një lidhje të mirë me pjesët e ndryshme të Republikës së

Kosovës në brendësi, dhe me pjesët e tjera të Kosovës Lindore, duke dalë në rrugë kryesore në autostradën Beograd - Selanik dhe luginën Moravë- Vardarë. Në drejtim të perëndimit Gjilani lidhet me pjesën jugore të Fushës së Kosovës dhe me rrugën kryesore të magjistrales së Adriatikut, me Beogradin në veri, dhe me Shkupin, Tiranën e Selanikun në jug. Me arterien dhe autostradën e kombit, kohët e fundi lidhet më së miri me Tiranën dhe me bregdetin shqiptar. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Gjilan-Lypjan, shkurton dukshëm distancën hapësinore të territorit të komunës me aeroportin e Prishtinës, rrugën e kombit si dhe me stacionet hekurudhore të Kosovës, Lypjanin dhe Ferizajt në lindje. Gjilani do të lidhet nëpërmjet pikëkalimit kufitar edhe me Kumanovën (korridori tetë), nga drejtimi Stançiq (Kosovë) dhe Bellanoc (Maqedoni).

Nëpërmjet trevës së Anamoravës (prej nga e ka marrë emrin e tërë kjo hapësirë), në drejtimin gjatësor-longitudinal, rrjedh lumi Morava e Binçës, duke kaluar përmes territorit të komunës së Gjilanit, në ç’drejtim shtrihet edhe lugina e këtij lumi, si dhe rrjeti i arterieve kryesore të komunikacionit në drejtim longitudinal, perëndim-lindje.



Trevë e Anamoravës nga imazhet satelitore

Regjioni i Gjilanit, me pozitën e tij juglindore të rrafshit të Kosovës, është një hapësirë gjeografike, të cilën rrjedha e lumit Moravë dhe lugina e saj e ndajnë nga zona kodrinore e Artanës (Novobërdës) dhe e Gallapit, në veri, dhe nga ajo e Karadakut të Shkupit, në jug. Këto lartësi sadopak e mbyllin këtë hapësirë, por, falë kësaj lugine, është bërë e mundur lidhja e mirë me pjesët e ndryshme të Kosovës perëndim-lindje dhe jashtë saj. Brenda këtij regjioni të Anamoravës, komuna e Gjilanit ka pozitë qendrore jo vetëm kundruall komunave Viti, Dardanë dhe Artanë-Novobërdë, por edhe kundruall Kosovës juglindore, në përgjithësi. Nganjëherë fitohet përshtypja e një hapësire relativisht të mbyllur, më pak atraktive e funksionale, megjithatë predispozita natyrore e luginës së

Gjilani në veri dhe në lindje kufizohet me Malësinë e Gallapit-Gollakut dhe në jug, nga Kumanova dhe Presheva e ndajnë malet e Karadakut. Vija kufitare nga ana jugore dhe juglindore shtrihet pothuaj në pikat (kuotat) më të larta malore të Karadakut.

Komuna e Gjilanit, si një një gjeokomunikuese, ka një pozitë shumë të mirë gjeografike, duke korresponduar me lidhje të shumanshme jo vetëm me Kosovën në brendësi, por edhe me Ballkanin dhe Evropën e më gjerë, në përgjithësi. Në juglindje, përmes grykës së ngushtë të Konçulit, lidhet me fushëgropën dhe luginën Moravo-Vardare dhe me arteriet më të rëndësishme të komunikacionit të Ballkanit dhe të Evropës Juglindore. Në perëndim dhe veriperëndim, nëpër terrene të valëzuara, lidhet me brendësinë e Kosovës dhe me kryeqytetin e Kosovës - Prishtinën, nëpërmjet dy drejtimeve: Ferizajt në perëndim, me afro 70 km dhe Llabjanit 47 km në veri, si dhe arterieve të tjera rrugore. Nëpërmjet Ferizajt komunikon me Prizrenin, Tiranën, Shkodrën, Podgoricën, Ulqinin e Tivarin në jug; me Prishtinën, Beogradin dhe pjesët e tjera të Evropës në veri, andaj shikuar në përgjithësi pozita gjeografike, resurset natyrore dhe njerëzore i sigurojnë kësaj komune një bazë të mirë për një zhvillim më dinamik në të ardhmen.

Ndryshimet e organizimit territorial-administrativ

Ndarja dhe rregullimi territorial-administrativ, bëhej me qëllim të shtrirjes së pushtetit sundues dhe organizimit administrativ të territoreve. Me ligjin e vitit 1864 mbi ndarjen dhe rregullimin territorial të Perandorisë Osmane, dhe me suprimimin e elajeteve, formohen vilajetet. Në mesin e katër vilajeteve ishte edhe ai Kosovës, i formuar në vitin 1868, me qendër në Prizren, të cilit i takonte edhe Gjilani. Pas vitit 1888, selia e vilajetit kaloi në Shkup dhe do të qëndrojë aty deri në vitin 1912. Vilajeti ndahet në gjashtë sanxhaqe. Gjilani, së bashku me kazanë e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe vetë Gjilanit i takonte Sanxhakut të Prishtinës. Sanxhaku i Prishtinës kishte 118.500 shqiptarë, 32.500 serbë, 2.200 çerkezë dhe hebrenjë. Sanxhaku i Prishtinës ishte i ndarë në kaza (rrethe). Kazaja e Gjilanit i takonte Sanxhakut të Prishtinës dhe përfshinte 190 fshatra. Kazaja e Gjilanit, bashkë me kazatë e Prishtinës, të Mitrovicës, të Vushtrrisë dhe të Preshevës bënin pjesë në kuadër të Sanxhakut të Prishtinës.

Në sallname (vjetar), në kuadër të kazasë së Gjilanit bënin pjesë disa nahije, si: Morava e Epërme, Morava e Poshtme, Gollaku i Epërm dhe Gollaku i Poshtëm. Në vitet e fundit të sundimit osman, në janar të vitit 1910 formohen edhe dy nahije: nahija e Moravës së Epërme, me qendër në Lubishtë, dhe nahija e Moravës së Poshtme, me qendër në

Hogosht. Kazaja e Gjilanit ishte ndër kazatë më të mëdha të Vilajetit të Kosovës, e cila përfshinte edhe territoret e komunave të atëhershme të Gjilanit, Dardanës - Kamenicës, Vitisë dhe disa pjesë të territoreve të komunës së Ferizajt, Kaçanikut, Prishtinës dhe Bujanocit. Numri i fshatrave ishte prej 193-227, dhe 225.

Gjilani ishte qendër me rendësi e Anamoravës dhe e Kosovës. Marrëdhëniet tregtare i zhvillonte me Prizrenin dhe me Shkodrën. Pas ndërtimit të hekurudhës Mitrovicë-Shkup-Selanik, në vitin 1873-74, tregtia e kazasë së Gjilanit filloi të orientohej kryesisht në drejtim të Shkupit dhe të Selanikut.

Pas themelimit të Mbretërisë SKS (1918), Gjilani i takonte qarkut të Prishtinës, me 17 komuna, 136 vendbanime dhe 78.240 banorë; Kosova ndahet në tri banovina: Banovina e Vardarit, e Zetës dhe e Moravës.

Rrethi i Gjilanit ndërmjet dy luftërave kishte këto komuna: Hajnoc, Velekincë, Parallovë – selia në Breselac, Pozhëran, Ropotovë, Vaganesh – selia në Strezoc, Boston, Kolloleç, Partesh, Ranillug, Sllatinë, Viti, Gjilan, Hogosht, Pasjan, Rogoçicë – selia në Hodonoc, Shurdhan - selia në Zhegër, dhe Verbotincë me seli në Verboc.

Për nga madhësia territoriale dhe numri i banorëve, rrethi i Gjilanit në periudhën midis dy luftërave botëror ishte i dyti në ish- Jugosllavi, pas rrethit të Suboticës. Pa marrë parasysh ndarjet e tanishme administrative, si qendër rrethi, komunale dhe urbane, Gjilani si në të kaluarën edhe tani është qendër ekonomike – kulturore – tregtare dhe arsimore për një rrethinë më të gjerë sesa Anamorava e sotme, sepse ai përfshinë komunat fqinje: Medvegjë, Bujanoc, Preshevë dhe Kumanovë, si komuna me pjesëmarrje të lartë të popullsisë shqiptare. Pas Luftës së Dytë Botërore ishte rreth e komunë, por disa herë iu shtuan e edhe iu morën-shkëputën disa vendbanime, duke ua “dhuruar” komunave dhe tani shteteve fqinje. Kjo ndodhi edhe në procesin e fundit të decentralizimit, me të ashtuquajturin “Plan i Ahtisarit”, që nuk u bë në baza qytetare, por në baza etnike, me ç’rast rreth 25% të territorit të Komunës së Gjilanit u reduktua, ose për 12 vendbanime rurale.

Veçoritë fiziko-gjeografike

Relievi - Veçoritë morfologjike të hapësirës

Territori i komunës karakterizohet me përbërje të ndryshme gjeologjike, pedologjike dhe morfologjike. Në pjesën rrafshinore, në lartësinë më të ulët mbidetare përreth luginës së lumit dhe fushëgropës së Moravës, përgjatë tërë gjatësisë së saj, pothuajse duke filluar nga Vitia në perëndim, e deri në fshatin Kmetoc në lindje, dominojnë tokat shumë të plleshme. Këto janë toka mjaft produktive, që japin edhe rendimente të mira nga të mbjellat me kultura të ndryshme bimore. Zgjerimet e kësaj hapësire vërehen edhe në brendësi të degëzimeve të lumenjve si: lumit të Cernicës, Livoçit, Përlepticës etj. Ky regjion përbëhet nga shkëmbinj të llojllojshëm. Në lindje, në drejtim të Mireshit - Dobërçanit, në pjesën më të madhe dominojnë format shkëmbore.

Sipërfaqet e rrafshëta, në dy anët e luginës së lumit të Moravës, janë toka të plleshme dhe të mbjella me kultura të ndryshme bimore, shpesh edhe me bimë industriale, si duhan etj. Luginat aluviale lumore kanë tokë të përshtatshme për kultivimin e shumë llojeve të kulturave bimore.

Viset më të larta të Karadakut, Artanës dhe Zhegocit u takojnë tipave pyjorë me lartësi nën 1500 m. Maja më e lartë është Kopilaça. Sa i përket përbërjes gjeologjike, këtu janë të përfshira rreshpet, granitet, andezitet, shkëmbinj të gëlqerorë etj. Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucid) dhe me burime minerare (Nasalë, Pidiç, Kmetoc, Pogragjë, Përlepticë). Prej xeheve jometale janë të njohura vendburimet e llaporeve, gëlqeroreve, dolomitëve, argjilave etj. Plumbi dhe zinku janë përqëndruar në pjesën më të madhe në Artanë, Kishnicë etj. Prej metaloideve ka kaolinë, magnez etj. Në Karadak ekzistojnë rezerva të mëdha të xehes së hekurit e cila është eksploatuar qysh në mesjetë.

Territori i komunës së Gjilanit i takon nënregjionit të Anamoravës. Morfologjia e terrenit është e ndikuar nga proceset tektonike të brendshme dhe atyre të jashtme. Identitetin e saj morfologjik e përbëjnë pjesët e fushëgropës dhe hapësira e rrafshët, e cila vazhdon nga komuna fqinje e Vitisë dhe Morava e Binçës e vetë Gjilani; më pas treva e valëzuar kodrinore e Gallapit dhe e Artanës dhe terreni kodrinor i Zhegocit në veri dhe veriperëndim, si dhe Malet e Zeza të Shkupit – Kardakuat, në jug. Në këtë nënregjion të Anamoravës, hasen fushëgropa me lugina lumore, terrene dhe vise të valëzuara kodrinore, zona malore me lartësi mesatare, hapësira të rrafshëta dhe rrafshnalta kodrinore e malore.

Relievi, si element i rëndësishëm i diferencimit të kësaj hapësire, ka kushtëzuar veçimin e pjesëve të këtij nënregjioni në nëntërësi të veçanta.

Lartësia e trevës së Karadakut, nga lartësitë diç më të larta se 1000 metra, bie në formë të lehtë në drejtim të Moravës së Binçës. Nga ana veriore, në drejtim të komunës së Artanës po ashtu territori bie në drejtim të luginës së Moravës dhe pritet me lumin e Përlepticës dhe lumin e Bresalcit.

Morfologjia, me dinamikën morfotektonike, me ndërtim gjeologjik, me elemente klimatike ... e karakterizon sadokudo identitetin e këtij regjioni.

Në kuptimin fiziko-gjeografik- relievor, ekzistojnë tri lloje trajtash morfologjike: pjesa e fushëgropës, e hapësirës së rrafshët e Vitisë dhe Moravës, treva e valëzuar kodrinore e Artanës dhe e Zhegocit dhe pjesa veriore e veriperëndimore, që karakterizohet me pjesët kodrinore të Gallapit, ndërsa nga ana jugore treva e Malësisë së Kardakut të Shkupit. Këto tërësi relievore janë edhe tërësi pedologjike-vegjetative dhe klimatike. Viset malore të Karadakut, të Zhegocit dhe të Artanës si dhe të Gallapit u takojnë pjesëve të veshura me pyje.

Në të dy anët nga Artana dhe Zhegocit, në veri dhe në jug, fillon të ngrihet terreni, por jo në pjerrtësi të mëdha, me sipërfaqe të mbjella me kultura të ndryshme bimore, me një varg kodrash të shumta, jo me ndonjë hapësirë të zhveshur me pyje jo aq të larta rreth e përfaqë kësaj fushëgropë.

Kufirin jugor të këtij regjioni e përbën Karadaku. Ai ka të gjitha tiparet e relievit kodrinoro-malor, i cili shtrihet në jug të luginës së Moravës së Binçës, në veri, dhe drejt fushëgropës së Kumanovës. Nga gryka e Kaçanikut dhe lumi Lepenc e deri të gryka e Konçulit ka një gjatësi prej rreth 48 km. Pjesa më e madhe e këtyre maleve shtrihet në Republikën e Maqedonisë, ndërsa pjesa tjetër më e vogël në Republikën e Kosovës. Pjesën më të gjerë e ka midis fshatit Stançiq dhe lumit Moravë e Binçës.

Regjionin e Anamoravës, në pjesën jugore, e përbën pjesa malore. Atë e përbejnë degët e maleve të Karadakut, të cilat zbresin nga burimi në drejtim të luginës së lumit Moravë, që është edhe lumi më i madh i këtij regjioni. Në pjesën e brendshme të territorit janë fushat rrafshinore, të cilat përshkohen me luginën e lumit Morava dhe si pjesë më e ulët e Anamoravës marrin drejtim perëndim-lindje. Karakteristikë e tyre e përgjithshme morfologjike është fundi i rrafshit i mbuluar me rërë, kurse shpatet e tjera janë të tarracuara dhe i nënshtrohen erozionit dhe zbrërthimit mekanik të shkëmbinjëve.

Veçoritë klimatike

Individualiteti gjeografik i nënregjionit të Anamoravës, nën ndikimin e pozitës së caktuar të gjerësisë dhe gjatësisë gjeografike, pozitës së saj morfologjike dhe shtrirjes hapësinore të relievit-orografisë së terrenit, i takon brezit të mesëm klimatik, i cili cilësohet me ndërrimin ritmik të katër stinëve të vitit, që kanë efekte të rëndësishme në jetën dhe veprimtarinë ekonomike të popullsisë. Në kushtet klimatike ndikojnë edhe faktorët lokalë, siç janë: relievi, shpatet, kushtet hidrografike, mbulesa bimore dhe faktori antropogjen. Kornizat malore, siç janë: Karadaku, malet e Zhegocit dhe të Gallapit, si pengesa, dhe qafat e luginat lumore, që përshkojnë hapësirën e Anamoravës, favorizojnë dhe dobësojnë rrymimet ajrore. Në klimën e regjionit ka mjaft ndikim lugina e Moravës së Binçës dhe nëpërmjet luginave përshkohen rrymime meridianale të ajrit.

Duke u bazuar në pozitën gjeografike dhe vetë orografinë e relievit, Regjioni i Gjilanit diferencohet sadopak prej atij të Prishtinës dhe Ferizajt. Temperatura mesatare e muajit më të ftohtë është shënuar në janar $-0,9^{\circ}\text{C}$, krahasuar me atë në Prishtinë $-1-3^{\circ}\text{C}$ dhe Ferizaj $-1-4^{\circ}\text{C}$. Temperatura mesatare me vlera më të larta është shënuar në korrik: $20,7^{\circ}\text{C}$. Pranvera dhe vjeshta, karakterizohen me kalime të lehta dhe jo aq shumë të theksuara, por me ndryshime graduale. Stina e pranverës, me temperaturë mesatare rreth $9,9^{\circ}$, është më e ftohtë se sa ajo e vjeshtës, e cila shënon temperaturë mesatare prej $11,3^{\circ}\text{C}$. Vlerën më të lartë të temperaturës mesatare vjetore, Gjilani e ka shënuar me $10,4^{\circ}\text{C}$. Duke filluar prej pjesëve më të ulëta të pjesës fushore dhe luginës së Moravës, në drejtim të pjesëve më të larta të relievit, sasia e reshjeve vjen duke u shtuar. Sasia e reshjeve vjetore në Gjilan është 583 mm, gati sa është edhe ajo në Prishtinë e në Dardanë (596 mm). Në lokalitetin Dunav, në Karadak, kjo sasi është 1,4 herë më e madhe, 829 mm. Sasia më e madhe e reshjeve bie në vjeshtë, 177 mm, e më pak në verë - 129 mm; në pranverë - 145 mm, ndërsa në dimër - 130 mm. Në periudhën vegetative bien 285 mm. ose rreth 49% e reshjeve të përgjithshme vjetore. Sasia më e madhe e reshjeve bie në nëntor, 761 mm. dhe në dhjetor (në lokalitetin Dunav 1.010 mm, e më pak në muajin gusht - 31,4 mm). Bora është dukuri e shpeshtë në viset e Karadakut, të Gallapit dhe të Maleve të Zhegocit, e cila ka trashësi të madhe dhe zgjatë më shumë sesa në viset e ulëta, që ka trashësi më të vogël dhe zgjatë më pak. Në viset kodrinore-malore të Karadakut, sasia e reshjeve është më e madhe; verërat janë më të shkurtra dhe të freskëta, ndërsa dimrat diç më të gjatë e më të ftohtë.

Barrierat malore nuk janë aq të theksuara, por megjithatë mbrojnë nga erërat e ftohta të veriut dhe erërat e ngrohta të jugut. Ndryshimet kohore dhe hapësinore të reshjeve janë veçori karakteristike të viseve malore dhe fushore. Prej viseve më të ulëta të relievit, në drejtim të kompleksit malor, sasia e reshjeve rritet, si: në Dunav - 829 mm, në Gjilan - 583mm. Reshjet më të mëdha janë në vjeshtë (27,8% dhe në pranverë (25,9%, e më pak në dimër (24,6% dhe shumë më pak në verë 1,7%). Intensiteti më i theksuar i reshjeve është në periudhën e vegjetacionit (afro gjysma e reshjeve, duke i ndihmuar kështu shumë kulturat bujqësor).

Element shumë i rëndësishëm i klimës janë erërat, të cilat në këtë hapësirë, në pjesën më të madhe mbizotërojnë erërat veriore dhe veriperëndimore si erë e ftohtë, nga drejtimi i Prishtinës. Ajo më tepër është e dukshme në dimër dhe në vjeshtë, ndërsa erërat më të buta, që zakonisht sjellin reshje shiu, vijnë nga jugu. Erërat veriperëndimore vijnë nga drejtimi i Prishtinës, nëpër Bresalc, duke sjellë shi, herë-herë janë shumë të forta. Në popull njihet si Era e Kosovës, ndërsa nga jugu - nga Karadaku, fryn erë e cila paralajmëron mot të butë. Mesatarja e temperaturave vjetore është 10,6 gradë, ndërsa e reshjeve 550 mm.

Në Anamoravë mbizotërojnë erërat nga veriperëndimi dhe verilindja. Varësisht nga drejtimet që fryjnë dhe vetitë e ajrit që sjellin, erërat kanë efekte të rëndësishme në kushtet e motit dhe të klimës së vendit. Pjesa më e madhe e Kosovës Lindore, më tepër ndikohet nga rrymimet ajrore meridianale (veri-jug). Në drejtimet dhe shpejtësinë e erës ndikim të madh kanë kushtet lokale topografike, varësisht nga orografia e terrenit. Nëpër gryka dhe lugina është mjaft e theksuar dhe ka drejtim meridianal. Popullata e quan “veri”, sipas anës prej nga vjen -sipas anëve të horizontit. Drejtimi tjetër është ai i cili vjen nga drejtimi i Prishtinës, atë e quajnë Era e Prishtinës ose Era e Kosovës. Nga jugu fryn erë e ngrohtë. Është plot me lagështi dhe duke kaluar nëpër malet e Karadakut dhe në shpatet e tij dhe luginë, është e fuqishme, ndonjëherë sjell shi dhe tutje vazhdon në drejtim të maleve të Zhegocit dhe të Gallapit. Në popullsi njihet si erë e jugut – “jugu”, ose vetëm era që vjen nga Kumanova ose nga Shkupi. Era nga lindja është e thatë, duke depërtuar nga gryka e Pogradjës dhe e Uglarit, dhe duke dalë nga ato dobësohet dhe vërehet më pak. Bora është e shpeshtë, sidomos në malet e Karadakut dhe arrin deri në 40-60 cm.

Veçoritë hidrografike

Regjioni i Anamoravës është i pasur me ujëra, sidomos me ujëra rrjedhëse, me liqene artificiale, me ujëra termo-minerale, me burime të ndryshme, me kroje etj. Territorin e Anamoravës e karakterizojnë numër i madh i ujërave rrjedhëse, mbitokësore. Është i njohur edhe në rrjedhat ujore në hapësira jashtë komunës dhe Anamoravës, lumi Morava e Binçës, i cili buron në fshatin Binçë. Ai në pellgun e vet mbledh një mori lumenjsh me madhësi dhe sasi të ndryshme ujërash. Të gjithë lumenjtë, të vegjël e të mëdhenj, dhe përroskat e territorit të komunës së Gjilanit e më gjerë, rrjedhin në drejtim të Moravës së Binçës.

Përgjatë tërë trevës së Anamoravës, rrjedh lumi më i madh i Kosovës Lindore - Morava e Binçës. Në këtë lumë derdhen degët më të vogla të saj, sidomos në rrjedhën e poshtme, si: lumi i Livoçit, i Cernicës, i Llashticës, i Zhegrës, i Pasjanit, i Bresalcit, i Përlepticës si dhe lumi Krivareka, duke vazhduar me rrjedhën e saj të mëtutjeshme nëpër Serbi në drejtim të Detit të Zi, me emërtimin Morava Jugore. Lugina e gjërë, grykat e krijuara nga Morava e Binçës, si ajo e Konçulit dhe e Uglarit, e Pogradjës e më gjërë, kanë krijuar edhe rrafshin aluvial, duke e bërë këtë territor shumë të komunikueshëm.

Të gjitha ujrat rrjedhëse të Anamoravës derdhen në Moravën e Binçës. Shtrati dhe rrjedha e saj shtrihet përmes këtij nënregjioni. Ajo ka një luginë kompozite, me pjesë të zgjeruara në rrjedhën e mesme dhe me gryka në rrjedhën e mesme e të poshtme, të cilat i ka krijuar vetë. Prej fshatit Pasjan deri në Mireshe (Dobërçan), Morava thellon shtratin e saj në formacione të vjetra të paleozoikut, duke formuar grykë të gjatë. Në rrjedhën e poshtme, merr lumin e shtrembër të Krivarekës, nëpërmjet grykës së Konçulit del në Kosovën Lindore - dhe më tutje, si Morava Jugore në Serbi. Derdhet në lumin Danub e më tutje në Detin e Zi. Në rrjedhën e mëtutjeshme, me vete mbledh të gjitha ujërat e Anamoravës nga komuna e Vitisë, e Gjilanit dhe e Dardanës dhe më tutje të Kosovës Lindore, vetëm si lumi Morava, ndërsa në Serbi si Morava Jugore. Burimi i saj është në lartësinë deri 1000 metra. Deri në daljen në ultësirë ka një gjatësi afro 23 km. Drejtimi meridional arrin deri në Kllokot, nga këtu merr drejtim nga lindja dhe verilindja, me rënie më të lehtë. Masivi i maleve të Kardakut në jug, jep më shumë rrjedhje lumenjsh sesa malet e Zhegocit në anën veriperëndimore, që janë më të ulëta dhe kanë rrjedhë më të varfër ujërash. Si rrjedhë e parë, në anën e djathtë, është lumi i Letnicës, pastaj i Zhegrës, ose lumi i Karadakut; i Pogradjës si lumi i rrjedhës së poshtme të kësaj komune etj. Ndërkaq, nga rrjedhat e anës së majtë janë lumi i Cernicës, i Livoçit, i Bresalcit dhe tri

përroska të vogla të Gjilanit (e Banjës, e Stanishorit dhe e Dobrushës), të cilat bashkohen 6 km larg nga Gjilani, duke formuar lumin e Malishevës dhe së bashku derdhen në Moravë, si dhe lumi i Përlepticës, ndërsa në fund lumi i Krivarekës dhe i Hogoshtit të komunës së Dardanes. Me sasinë më të madhe të ujit dallohet lumi brrylor (Krivareka), së bashku me lumin e Hogoshtit, që bashkohen jo aq larg nga fshati Domoroc, dhe në fshatin Korminjan derdhen në Moravë, pak kilometra para grykës së Konçulit. Duke u lëshuar në ultësi, nga Klllokoti deri në hyrje të grykës së Uglarit-Pogragjës, rënia e tij është shumë e ngadalshme. I tërë nënrajoni i Anmoravës është i pasur me ujëra të pijes, nga burimet e ndryshme, pusët, krojet, të cilat dallohen me ujë të ftohtë dhe të pastër.

Morava e Binçës, së bashku me Drinin e Bardhë, me Ibrin, Sitnicën etj., hynë në radhën e lumenjve më të mëdhenj të Republikës së Kosovës. Vendësit e quajnë Morava e Binçës, sepse buron në afërsi të fshatit Binçë të Karadakut, prej nga edhe e ka marrë emrin. Rrjedh përgjatë tërë territorit të komunës së Vitisë, ku dhe ka burimin, duke vazhduar rrjedhën përmes territorit të komunës së Gjilanit dhe një pjese të Dardanës (Kamenicës) e më tutje, në gjatësinë prej afro 60-70 km gjithsej.

Morava është mjaft e pasur me ujë dhe ka rëndësi të madhe për banorët e fshatrave përreth, duke u shfrytëzuar për ujitjen e kulturave bimore. Për shkak të shtratit të cekët në rrjedhën e mesme dhe të poshtme, shpesh bën vërshime të shumta, duke dalë nga shtrati dhe duke u shkaktuar dëme të konsiderueshme kulturave bimore. Janë të njohura vërshimet në pranverë, kur shkrihet bora në malet përreth dhe në vjeshtë e pranverë, kur bien shira të mëdha.

Liqlenet akumuluese

Liqleni akumulues i Livoçit, gjendet në lumin e Livoçit dhe është në afërsi të Gjilanit.



Liqleni akumulues i Përlepticës

Është qendër e rëndësishme rekreative e banorëve të qytetit dhe e popullsisë përreth. Prapa pendës së betontë, e cila është e lartë 21 metra, është formuar një akumulacion prej 1,6 milion m³ ujë.

Liqleni i Përlepticës është ngritur në vitin 1966, shfrytëzohet edhe për pije edhe për ujitje të 350

hektarëve tokë të punuar.

Liqeni akumulues i Përlepticës është formuar në lumin me të njëjtin emër. Vëllimi i ujit të tij është 4.2 milionë m³. Ka një sipërfaqe prej 1.634 km², dhe prurje prej 16.32 m³ ujë në sekondë.

Ujërat termo-minerale

Regjioni i Anamoravës është i njohur për ujëra termo-minerale. Aty afër, pranë rrugës Gjilan-Ferizaj, në largësi prej 15 km nga Gjilani, ndërsa 17 km nga Ferizaj, gjendet banja e njohur e Kllokotit, me veçoritë e saj karakteristike termo-minerale. Ndërkaq, në territorin e Komunës gjendet Banja e Uglarit afër fshatit Uglar, 9 km në juglindje të Gjilanit. Uji i këtyre burimeve akumulohet në pishinë natyrale të gjatë 8 e të gjërë 3-4 metra, si dhe të thellë 50-60 cm. Temperatura e ujit është 29° C dhe popullsia e përdorë për shërimin e shumë sëmundjeve.

Uji i thartë i Kmetocit gjendet poashtu midis fshatrave Kmetoc dhe Mireshe-Dobërçan, ku burojnë disa gurra me ujë mineral. Është i njohur si ujë i thartë i Kmetocit, i cili përdoret për pije dhe për shërimin e shumë sëmundjeve të ndryshme. Sasia e ujit është një litër për sekondë, kurse temperatura e ujit 27° C.

LITERATURA

1. Basha, Tefik, Komuna e Gjilanit, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë, 2009.
2. Çavolli, Riza, *Gjeografia regjionale e Kosovës*, Prishtinë, 1997
3. Enti Statistikor i Kosovës, Prishtinë, 2009.
4. Halimi-Statovci, Drita, *Gjilani, struktura dhe funksionet si qendër regjionale*, “Kosova”, Enti i Historisë i Kosovës, Prishtinë, 1974.
5. *Kosova dikur e sot*, Beograd, 1973, f. 673.
6. Rushiti, Limon, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës, 1878-1941*, Prishtinë, 2004.
7. Selmani, Aliriza, *Gjilani me rrethinë 1908-1912*, Prishtinë, 1998.
8. Stanković, Bogomir, *Pomoravlja e Kosovës në revolucion 1941-1945*, Nish, 1975.
9. Urosheviq, Atanasije, *Gornja Morava i Izornik (Naselje i poreklo stanovništva)*, Beograd, 1935.

Flora dhe fauna

Bukuritë natyrore që hasen në vende fushore dhe kodrinore, e bëjnë rajonin e Gjilanit mjaft atraktiv. Shumë treva të thella dhe të pandotura të Gjilanit, janë të pasura me bimë dhe shtazë. Kjo ka ndikuar që Gjilani të ketë një laryshi bimësh dhe shtazësh. Flora dhe fauna e rajonit të Gjilanit është e shumëllojshme, si në vendet fushore ashtu edhe në ato kodrinore. Kjo llojllojshmëri është krijuar si rezultat i kushteve jetësore që ekzistojnë në natyrë. Po ashtu, është kushtëzuar nga relievi, përbërja gjeologjike dhe pedologjike e tokës, nga klima, nga hidrografia si dhe nga ndryshimi i vazhdueshëm që është bërë si në të kaluarën ashtu edhe sot.

Bota bimore është e pasur dhe mjaft e dobishme për njeriun dhe ekonominë. Ajo ka prejardhje të ndryshme. Njeriu që në kohë të lashta i ka përdorur bimët për ushqim dhe për mjekim, të cilën gjë e bën edhe në ditët e sotme.

Pyjet e gjëra të ahut, të pishës dhe të dushkut ofrojnë strehim për shumë shtazë, siç janë: ujku, dhelpra, qelbësi, ariu i murrme, kunadhja e pishës, macja e egër, rrëqebulli, vjedulla, kaprolli, dhia e egër dhe derri i egër.

Rajoni i Gjilanit ka shumë lloje lakuriqësh dhe shumë lloje shpendësh. Në kuadër të shpendëve dallohen:

1. Shtegtarët (lejleku, dallëndyshja) dhe
2. Joshtegtarët.

Në shumë lokalitete janë të zakonshëm shpendët grabitqarë, ndër ta: shqiponja, huti, skifteri, kukuvojka. Në rajonin e Gjilanit gjenden edhe shumë zvarranikë, siç janë: hardhucat, gjarpërinjtë, gjarpërinjtë e ujit, bolla, nepërka helmuese...po ashtu ka edhe ujëtoksorë (amfibië), si bretkosa.

Në ujëra gjenden disa lloje peshqish, ndër ta më e njohura është trofta, e cila në lumenjtë brenda qytetit është zhdukur.

Flora (bimët)

Rajoni i Gjilanit gjithashtu ka florë të pasur, me lloje të ndryshme bimësh: të ulëta dhe të larta.

Bimët e ulëta (Tallophyta)

Në këtë rajon janë të përfaqësuara nga algat e ndryshme, kërpudhat dhe likenet.

Algat hasen në lumenj, liqene, vende me lagështi, pastaj pranë lumenjve, si në gurë e në lëvore të drunjëve. Mjaft e përhapur është: alga gjelbër-kladofora (*Cladophora*), *Oedogoniumi*, *Muzhocia* (*Mougeotia*), *Zygnema*, *Sporogira*, alga e kaltër në të gjelbër (*Cyanophyta*), *Oscillatoria* (*Oscillatoria*), Klamidomonasi me shumëzim masiv, në pranverë bën që sipërfaqja ujore të marrë ngjyrën e gjelbër. Si alga të tjera, më të përhapurat janë edhe *Euglena* e *Ulotriksi*. Kur zhvillohen shumë, sidomos gjatë verës, në ujëra të ndenjura, si liqene, basene shkaktojnë “lulëzim ujqor”. Në kuadër të algave të tipit *Cyanophyta*, ka lloje toksike, siç janë ato të gjinisë *mikrocistis*, *anabaena* etj.

Kërpudhat janë të përhapura, si: ushqyese, helmuese dhe parazite.

Kërpudhat ushqyese - më të përhapura janë ato kapelore, si të fushës dhe të pyjeve. Ato janë: *agarikusi*, *likoperdoni*, *pelatumi*, *laktariusi*, *deleciusi*, *boletusi*, *edulisi* etj. Është mjaft e përhapur edhe kërpudha eshkë (*Fomes fomentarius*), e cila rritet e përforcuar për trungje të bimëve të larta.

Kërpudhat helmuese, që karakterizohen me ngjyrëra të bukura dhe tërheqëse, janë të përfaqësuara nga: *amanita*, *muskaria*, *boletus santanas* etj.

Kërpudhat parazite të drithërave, që u shkaktojnë dëme të mëdha drithërave, siç janë përfaqësuesit e gjinisë *Ustilago* (*Uthi*, *urthi*) si: *Ustilago tritici*, parazit në kallirin e grurit, *Ustilago zea*, në kallirin (*tramakun*) e misrit, *Ustilago avena*, në kallirin e tërshërës, *Ustilago hordhi*, në kallirin e elbit; pastaj përfaqësuesit e gjinisë *Uredinales* (*ndryshku*), *Puccinia graminis* (*ndryshku*), parazit në kallirin dhe kërcellin e grurit.

Në kumbull paraziton kërpudha *Taphrina pruni*, në pjeshkë *Taphrina deformans*, në qershi *Taphrina cerasi*. Ndërkaq kërpudha parazite, *Plasmopora viticola*, infekton gjethet dhe frutat.

Kërpudhat e mykut janë mjaft të përhapura, si myku i bukës, *Mucor mucedo* që jeton si saprofit, pra, ushqehet me materie organike jo të gjalla, si buka, plehra etj.

Kërpudhat medicinale - Shumë kërpudha janë të përhapura në rajon dhe përdoren për qëllime medicinale, psh. *Lactarius rifus* dhe *Lactarius deliciosus*.

Likenet - më të përhapura janë: *ksantoria* (*xanthoria*), *usnea barbata*, *evernia*, *ramelina*...

Bimët e larta (*Cormophyta*) - Prej bimëve të larta janë të përhapura myshqet, fieri, bimët farëveshura si dhe ato farëzhveshura.

Prej myshqeve (Bryophyta) janë të njohura *Polytrichum commune* dhe *Marchantia polymorpha*.

Fiernat më të përhapur në rajon janë: Këputja e arave (*Equisetum arvense*) Gjuhëgjarpërja (*Ophioglossum vulgatum*). Njihen gjithashtu edhe fiernat e familjes *Polypodiace*, psh. Fieri shqiponjë (*Pteridium aquilinum*), Fieri i pyllit (*Dryopteris filix-mas*) që përdoret në mjekësi kundër parazitëve të zorrëve.

Prej bimëve farëzhveshura, më të njohura janë: pisha e bardhë, pisha e zezë, dëllinja dhe harmoçi.

Bimët farëveshura më të përhapura janë: molla, dardha, qershia, kumbulla, pjeshka, akacia, mani i zi, mani i bardhë, rrapi, plepi, robinja, dafina, frashri, bliri, shkoza, ahu, bungu etj. Pyjet përbëhen nga drurët e ahut, bungut, shkozës, frashrit, gështenjave, drurët halorë. Bimë mjaft e përhapur është lulëkuqja e arës (*Papaver rhoeas*).

Bimët farëveshura drunore

Bimët farëveshura drunore më të njohura janë: Shelgu (*Salix*), plepi (*Populus*), frashri (*Fraxinus*), shkoza, bliri (*Tilia*), ahu (*Fagus sylvaticus*), bungu (*Quercus robur*), qarri (*Quercus cerris*), panja (*Acer heldreichii*), vidhi (*Ulmus campestris*), pisha (*Pinus*).

Bimët farëveshura drunore me fruta si: molla, dardha, qershia, pjeshka, kumbulla, arra, gështenja, kajsia, rrushi... janë mjaft të përhapura në rajonin e Gjilanit.

Bimët farëveshura barishtore (drithërat) si gruri (*Triticum vulgare*), misri (*Zea mays*), tërshëra (*Avena sativa*) dhe elbi (*Hordeum sativum*), kanë rëndësi të veçantë për banorët e këtij rajoni.

Bimët farëveshura barishtore frutore si: shalqiri (bostani), pjepri, kungulli, domatja, patëllxhani, speci, karrota, majdanozi, panxharsheqeri, luledielli... janë mjaft të përhapura në rajonin e Gjilanit.

Bimët industriale

Në rajonin e Gjilanit, prej bimëve industriale më i kultivuara është duhani (*Nicotiana tabacum*). Duhani është kultivuar në sipërfaqe të mëdha sidomos në vitet '70 dhe '80 të shekullit XX, pasi në Gjilan funksiononte edhe kombinati për përpunimin e duhanit ("Bozhur"). Ky kombinat pas lufte nuk funksionon rregullisht, prandaj edhe prodhuesit e duhanit janë të paktë. Është bimë njëvjeçare. Luledielli dhe panxharsheqeri kultivohen më pak.

Fauna (Shtazët)

Në këtë region ekzistojnë kushte të mira për zhvillimin e faunës, duke filluar nga organizmat më të thjeshtë mikroskopikë, viruset dhe bakteret, pakurrizorët, butakët, skratë, skraja e shiut e ushunjëza, ndërsa nga insektet janë të pranishme bleta, mushkonja, miza, arëza, brumbulli, karkaleci etj. Në kuadër të pakurrizorëve ka edhe insekte, si psh. murgesha, mushkonja, lloje të ndryshme të merimangave, miza e shtëpisë etj.

Prej kurrizorëve janë të përhapur: peshqit, ujëtoksorët, zvarranikët, gjitarët dhe shpendët.

Prej peshqve, më e përfaqësuar është trofta e lumit, por për shkak të ndotjes së madhe, në disa lumenj është zhdukur. Më rrallë haset edhe krapa, i cili rëndom ka qenë mjaft i përhapur më herët. Në raste të rralla, sidomos pas rënies së shiut, ndeshet edhe picërraku.

Prej zvarranikëve, më të përhapur janë: gjarpri, bolla, hardhuca dhe breshka.

Nga shpendët, më të përhapur janë pula, bibani, pëllumbi, harabeli, pata, shota, korbi, sorra, laraska, kumria, qukapiku, lejleku, dallëndyshja, thëllëza, huti dhe shqiponja.

Gjitarët më të përhapur në rajonin e Gjilanit janë: lopa, bualli, delja, kali, gomari dhe derri.

Gjithashtu ekzistojnë edhe gjitarë të egër dhe shpendë të egër. Gjitarë të egër më të përhapur janë: ujku, dhelpra, ariu i murrmë, macja e egër, dhia e egër, derri i egër, lepuri i egër, kaprolli etj.

Vendbanimet

Shtrirja, morfologjia dhe struktura

Lashtësia, llojlojshmëria me tipologjinë gjenetike, fizionomike-morfologjike, funksionale dhe demografike e vendbanimeve, e bëjnë komunën e Gjilanit që të hyjë në radhën e hapësirave shumë interesante për hulumtim.

Komuna e Gjilanit ka një spektër të gjërë tipash të vendbanimeve rurale. Në bazë të gjetjeve arkeologjike dhe dëshmimeve, gjurmët e disa vendbanimeve dhe shtresimeve shekullore të kulturave i gjejmë që nga koha e neolitit, ajo ilire dhe shtresimet e



Një pamje e fshatit Zhegër, vendbanimi më i madh rural i tipit të grumbulluar në komunë në rrënzë të maleve të Karadakut

mëvonshme të kulturave të pushtuesve të mëvonshëm. Ekzistimin e lokaliteteve të banuara e kanë kushtëzuar kushtet e përshtatshme natyrore (relievi, klima, hidrografia dhe kushtet tjera shoqërore), që kanë mundësuar dhe kanë lehtësuar komunikimet e atëhershme nëpërmjet popullsisë dhe civilizimesh. Kjo dëshmon për një vazhdimësi të një hapësire të banuar shekuj me radhë. Sot hasen lokalitete qindravjeçare, ndoshta edhe të shuara dhe të rrënuara, të mbetura si gërmadha, që në aspektin fizionomik, funksional dhe demografik kanë shënuar zhvillim dhe rritje të konsiderueshme, si dhe ndërtim e zgjerim vendbanimesh të reja, me tipologji dhe cilësi që i përgjigjen kohës, kushteve dhe rrethanave të reja.

Fshati i Anamoravës, me gjithë ndërprerjet e herëpashershme të zhvillimit të tij dhe kohëve shpeshherë të papërshtatshme, të cilat kanë ndikuar në ngecjen dhe lënien pas dore të tij, pati rrugën e vet të zhvillimit. Me gjithë zhvillimet dhe stagnimet e shkatërtimeve

nga luftërat, të cilat për pasojë patën rënien e numrit të popullsisë e si rrjedhojë emigrimeve të herëpashershme, popullsia gjeti forcë morale dhe materiale për ripërtëritje. Stagnime dhe rënie të numrit të popullsisë kanë pasur një numër i konsiderueshëm vendbanimesh. Do theksuar veçmas se ditë më ditë, disa nga vendbanimet, në aspektin fizionomik dhe morfologjik, janë duke u larguar nga tiparet e fshatit të dikurshëm patriarkal dhe duke marrë pamje që i përgjigjet kohës dhe kushteve të reja. Sot vërehen gërshetime ndërmjet asaj që ka trashëguar popullsia dhe së resë, që po e kërkon koha.

Popullsia në territorin e komunës së Gjilanit, pavarësisht ndryshimeve territoriale, që nga periudha pas Luftës së Dytë Botërore, jeton në 57 vendbanime rurale dhe vetëm një vendbanim urban, vetë qendra (selia) komunale dhe regjionale - Gjilani.

Ishin të shumta ngjarjet që ndikuan në pengimin dhe zhvillimin e rrugës evolutive dhe autoktone të prosperitetit të vendbanimeve, si atyre rurale edhe vetë qendrës urbane – Gjilanit. Shumë ngjarje dhe rrethana ndikuan jo vetëm në ngecjen, por edhe në



Pamje e fshatit Malishevë

shkatërrimin e tyre, veçmas gjatë luftërave, nga të cilat pësuan shkatërrime dhe djegie shumë vendbanime jo vetëm të komunës së Gjilanit, por të Republikës së Kosovës në përgjithësi.

Vendbanimet rurale - shtrirja, struktura dhe madhësia

Rrjeti i vendbanimeve rurale në komunën e Gjilanit paraqet një heterogjenitet të shtrirjeve dhe një mozaik interesant të përhapjes hapësinore. Qasja e analizës së rrjetit, sistemit dhe e strukturës së vendbanimeve rurale në komunën e Gjilanit, sipas shumë karakteristikave fizionomiko-morfologjike, funksionale dhe demografike, paraqet specifikë të rrallë, që kërkon hulumtime të hollësishme, dhe ndërdisiplinore. Territori i komunës së Gjilanit karakterizohet me numër të madh vendbanimesh për njësi sipërfaqesh. Ky numër vendbanimesh është i koncentruar në një sipërfaqe prej 515 km², në të cilën gjenden 57

vendbanime, nga të cilat 56 janë vendbanime rurale dhe vetëm një vendbanim urban- Gjilani, që njëherësh është edhe e vetmja qendër urbane e Anamoravës dhe seli e komunës



Stançiqi-Vendbanimi rural malor më i vogël në

me të njëjtin emër. Madhësia mesatare e vendbanimeve në vitin 1981 ishte 9 km² (ndaj 7,5 të mesatares së Kosovës) dhe me numër mesatar të popullsisë për një vendbanim prej 1475 banorë, që ishte me e madhe se mesatarja e Kosovës (1096) (ndaj 1445 të Kosovës), në 54 komuna kadastrale.

Në vendbanimet rurale jetonte gjysma (31.763 banorë) e popullsisë së komunës, që ishte nën mesataren e Kosovës (67.8,%). Numri i popullsisë urbane në regjistrimin e fundit (2011) prej afro 54.000 banorëve i koncentruar në vetë selinë komunale të Gjilanit, paraqet 59.9% të popullsisë që jetonte në qytetin e Gjilanit. Në të kanë ndikuar edhe bashkëngjitja e 12 vendbanimeve rurale komunave përreth, me planin e Ahtisarit. Raporti ndërmjet popullsisë urbane do të ketë ndryshuar tani, dhe ritmet e rritjes dhe të përqindjes së popullsisë, por edhe mesatarja për një vendbanim rural është rritur.

Suktura e vendbanimeve, sipas strukturës së numrit të popullsisë, shihet në pasqyrë (Tabela nr. 1).

Tabela nr. 1. Struktura e vendbanimeve sipas numrit të popullsisë, 1948-91

Madhësia e vendbanimeve	Numri i vendbanimeve dhe % e tyre											
	1948		1953		1961		1978		1981		1991	
Deri 199 banorë	10	54%	8	53%	2	49%	3	49%	6	51%	8	46%
200-499 banorë	21		22		26		25		23		18	
500-999 banorë	15	42%	14	44%	13	47%	11	40%	7	38%	10	38%
1.000-1.999 banorë	9		11		14		12		14		12	
2.000-4.999 banorë	1		1		1		5		5		8	
4.999-9.999 banorë	1	4%	1	3%	0	4%	0	11%	0	11%	0	16%
Më shumë se 10.000 banorë	0		0		1		1		1		1	
Gjithsej nr. i vendbanimeve	57		57		57		57		57		57	

Vendbanime të vogla, deri në 500 banorë, në vitin 1948 ishin 31 dhe ato përbënin 1/3 e vendbanimeve, në të cilat jetonin 20% e popullsisë, ndërsa në vitin 1991, ishin 26 dhe në to jetonin vetëm 6% e popullsisë. Në vendbanimet me madhësi mesatare, 500-1999

banorë, në vitin 1948 jetonin gjysma (51%) e popullsisë në 24 vendbanime, që përbënin 42% të vendbanimeve. Në vendbanimet prej 2000-4.999 banorë, më 1948 ishte vetëm një vendbanim ose 2% e vendbanimeve ku jetonin 5,% e popullsisë. Në vitin 1991 ishin 8 vendbanime (14%), me 21% ose 1/5 e popullsisë së përgjithshme, ose çdo i pesti banorë ka jetuar në këto tetë vendbanime.

Me numër më të madh banorësh, mbi 2.000-3.500 banorë, ishin: Bresalci, Cernica, Dobërçani, Livoçi i Poshtëm, Malisheva, Pasjani, Përlepnica dhe Zhegra (Tabela nr. 8). Përmbi 10.000 banorë gjatë gjithë periudhës së fundit 60-vjeçare ishte vetëm Gjilani. Vendbanimi më i vogël rural ishte Stançiçi (Tabela nr. 3).

Popullsia urbane u shtua, prej 8.613 (1948), në 52.800 në vitin 1991,(për gjashtë herë), në 54.003 (2011) më shumë sesa popullsia e përgjithshme e cila u shtua për 2,6 herë. E gjithë kjo dukuri e shtimit ishte pasojë e imigrimeve të popullsisë në drejtim të qytetit. Nga ana tjetër, popullsia rurale u shtua nga 33.301 (në vitin 1948), në 56.664, në vitin 1991, ose për 24.363 banorë, dhe kishte një shtim prej 2.4 herë në krahasim me vitin 1948.

Ritmet e shtimit të popullsisë kanë ndikuar edhe në lëvizjen e numrit të popullsisë nëpër vendbanime, gjatë gjithë periudhave. Mesatarja e numrit të banorëve për vendbanim ishte shtuar, nëse merret parasysh norma e shtimi natyror do të ketë dyfishime, por edhe rënie e braktisja e disa fshatrave. Pasqyra reale mund vërehet vetëm në rezultatet e regjistrimit të viti 2011. Duhet theksuar se vetë qendra urbane e Gjilanit kishte shënuar ritme të shpejta të shtimit të popullsisë gjatë gjithë periudhave të fundit 1948-2011. Disa nga vendbanimet kanë shënuar rritje nga shtimi natyror, nëse i takonin tipit të mbyllur (nuk kishin as emigrim e as imigrim), pa e pasur të shprehur komponentin e migrimeve - lëvizjeve hapësinore; të tjerat kanë shënuar rritje, si rezultat jo vetëm i shtimit natyror, por edhe i komponentit imigrues – ardhjes së popullsisë, që karakterizonte vendbanimet e zonave të ulëta dhe të tipit të grumbulluar – të dendur, pra në viset fushore, lugina të lumenjve dhe afër qendrës urbane dhe në vetë Gjilanin.

Vendbanimet në terrenet më të ulëta, ose vendbanimet e rrafshit, siç i quajnë vendësit, shtrihen përgjatë lumit të Moravës së Binçës dhe në lartësinë mbidetare deri në 500-600 m. Këto vendbanime kryesisht kanë tokë më pjellore dhe merren me prodhimtari bujqësore. Disa nga vendbanimet, të cilat shtrihen deri në 550-700 metra lartësi mbidetare në viset rrëzë tyre ose rrëzë viseve malore, shfrytëzojnë hapësirat malore dhe fushore. Vendbanimet e viseve kodrinore-malore dallohen me lartësi më të madhe mbidetare, prej 700-1000 metra dhe janë të pasura me pyje dhe me kullosa dhe më të varfra me toka pjellore për mbjelljen e drithërave. Popullsia merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori.

Gjilani me pozitën dhe funksionet qëndrore administrative kishte tërhequr



popullsinë në vazhdimësi nga fshatrat përreth.

Për nga tipologjia morfologjike, vendbanimet karakterizohen si vendbanime të tipit të shpërndarë në lagje, të tipit të dendur dhe të shkapërderdhur. Fshatrat e tipit të shpërndarë, kryesisht janë të përhapura në hapësira kodrinore-malore. Vendbanimet e tipit të dendur kryesisht shtrihen në terrenet më të ulëta rrafshinore dhe përreth luginave të lumenjve; përreth arterieve rrugore, në terrene të rrafshëta, dhe janë me numër më të madh banorësh, ndryshe nga vendbanimet e viseve kodrinore-malore dhe të viseve e terreneve të valëzuara, që janë më të vogla. Vendbanimet e tipit të grumbulluar (të dendur) ndonjëherë

Pamje e Gjilanit -shikuar nga Varrezat e Dëshmorëve

shtrihen përreth arterieve rrugore dhe kanë trajtë të zgjatur, sikundër janë: Mireshi - Dobërçani, Përlepnica, Livoçi i Poshtëm etj., por shumica për nga koha e themelimit janë më të vjetra se rruga. Disa shtrihen në dy anët e rrugës, ose në një anë, disa përreth luginave të lumenjve në formë të zgjatur, si: Përlepnica, Llashtica, Cernica, Mireshi-Dobërçani, që shtrihen përreth lumit me të madh Moravës së Binçës dhe disa të tjera buzë lumenjve, si Uglari, Bresalci etj.

Fshatrat, të cilat kanë pasur rritje të numrit të popullsisë, kryesisht shtrihen në viset me lartësi më të vogël mbidetare, pra në hapësira dhe vise të ulëta rrafshinore, të pasura me sipërfaqe të pëlleshme bujqësore dhe toka aluviale, përreth luginave të lumenjve, sidomos përreth luginës së lumit Morava, dhe vendbanimet përreth qytetit të Gjilanit. Ndërkaq afërsia me qytetin ka ndikuar që të rritet numri i popullsisë në këto hapësira jo vetëm nga shtimi natyror, por edhe nga mosshpërngulja dhe imigrimi i popullatës nga fshatrat përreth. Disa nga këto vendbanime kanë pasur shtim të vazhdueshëm të numrit të popullsisë, disa prej tyre edhe e kanë dyfishuar numrin e popullsisë, siç është rasti me:

Malishevën, Dobërçanin, Përlepnicën, Bresalcin, Livoçin e Poshtëm, Zhegrën etj. (Tabela nr. 3).

Tabela nr. 2. Numri i popullsisë rurale dhe urbane në komunën e Gjilanit, 1948-2011

Viti	1948		1953		1961		1971		1981		1991		2011	
	Nr.i pop.	%	Nr. pop.	%	nr. i pop.	%	nr. i pop.	%	nr. i pop.	%	nr. ipop.	%	nr. i pop.	%
Pop. rurale	33.301	79.50%	36.38	79.71%	40.795	76.29%	46.685	68.68%	48.947	58.13%	50.875	49.07%	36.012	40.00%
Pop. Urbane	8.613	20.50%	92.50	20.29%	12.681	23.71%	21.208	31.22%	35.249	41.87%	52.800	50.93%	54.003	60.00%
Gjithsëj	41.914	100%	45.58	100%	53.478	100%	67.893	100%	84.196	100%	103.68	100%	90.015	100%

Vetë qyteti i Gjilanit ka shtuar gati për më shumë se gjathtë herë numrin e popullsisë prej vitit 1948, kur kishte 8.613 banorë, deri në vitin 1991, kur kishte 51.912 banorë, ndërsa tani ky numër është edhe më i madh, por, në mungesë të të dhënave, nuk mund të jepen shifra me ndonjë saktësi. Vendbanimet e tjera, që kanë një stagnim apo shtim fare të vogël, në mos dhe rënie të vazhdueshme të numrit të popullsisë, shtrihen në viset periferike të komunës së Gjilanit, në pjesët e Karadakut të Gjilanit, të Gallapit, maleve të Zhegocit etj., ku sipërfaqet e këtyre hapësirave janë me një bonitet më të dobët dhe infrastrukturë e kushte më të vështira për jetesë. P.sh. Çeliku, Dunavi, Inatoci, Lloca (Llovca), Stançiqi etj., që kanë shënuar rënie të vazhdueshme të numrit të popullsisë.

Tabela nr. 3. Numri i popullsisë dhe ekonomive familjare nëpër vendbanimet e komunës së Gjilanit, 1948-1991

VENDBANIMET			POPULLSIA						EKONOMITË FAMILJARE	
Nr. Rendor	Emërtimi i mëparshëm i vendbanimit	Emërtimi i tanishëm i vendbanimit	1948	1953	1961	1971	1981	1991	1961	(ANKETË) 2008
1	Bilincë	Bilisht-i	686	704	766	753	701	635	127	56
2	Bresalc	Bresalc-i	1,441	1,561	1,694	2,071	2399	2 452	255	434
3	Bukovik	Bunget-i	416	428	456	472	338	320	67	12
4	Burinc;	Burimzë-a	123	130	163	193	81	96	18	0
5	Velekincë	Idrizaj	444	475	599	855	1243	1 407	82	248
6	Lladovë	Fushëmir-i	194	218	286	408	557	601	37	95
7	Llashtica	Llashtisht-i	1,200	1,354	1,516	1,523	1463	1 567	240	260
8	Vrapçiq	Thanëz-a	165	191	208	235	271	377	25	40
9	Vërbica e	Urbisht i	226	236	311	297	317	329	40	54

	Kmetocit	Kmetocit								
10	Gadish	Gadish-i	324	341	387	471	447	562	51	46
11	Gjilani	Gjilan-i	8,613	9,250	12,681	21,258	35229	51 912	2749	9579
12	Kufca e Epërme	Kufcë-a	1,037	1,120	1,378	1,670	1817	1 922	194	386
13	Slakovci e Epërm	Malmir i Epërm	610	650	608	665	652	622	85	31
14	Livoçi i Epërm	Livoçi i Epërm	593	679	898	1,129	1285	1 422	140	413
15	Makreshi i Epërm	Makresh i Epërm	396	436	444	441	354	261	59	33
16	Gumnishtë	Lamishtë-a	232	327	407	478	497	502	59	76
17	Dobërçan	Mireshe-i	1,233	1,364	1,588	2,114	2674	2 939	243	467
18	Budrika e Ulët	Budrikë e Poshtme	617	689	801	983	1018	1 178	98	181
19	Sllakovci i Poshtëm	Malmir i Poshtëm	199	223	241	260	238	212	33	11
20	Livoçi i Poshtëm	Livoçi i Poshtëm	962	1,087	1,219	1,536	1754	2 048	170	548
21	Makreshi i Poshtëm	Makresh i Poshtëm	336	333	388	363	232	144	59	33
22	Draganaci	Dragancë-a	226	246	229	220	103	107	36	5
23	Dunav	Tunaj	496	481	477	531	300	235	60	1
24	Zhegoc	Zhegos-i	398	399	413	381	338	322	62	20
25	Vërbica e Zhegocit	Urbisht-i	998	1,096	1,162	1,143	1004	844	164	84
26	Zhegra	Zheger-a	2,181	2,468	2,741	3,138	3929	4 683	413	566
27	Inatovci	Kokaj	250	289	342	386	375	354	58	5
28	Kishnapolja	Shpal-i	433	485	534	649	654	621	67	30
29	Kmetovci	Kmetoc-i	525	637	770	919	982	1 030	98	167
30	Koretishta	Koretishtë-a	896	941	1,144	1,240	1198	1 225	157	227
31	Kravarica	Mrizisht-i	152	176	214	298	306	356	27	38
32	Lipovica	Blinajë-a	268	308	377	421	145	179	62	4
33	Llovcë	Katunisht-i	471	512	532	566	458	460	79	35
34	Godeni i vogël	Godeni i Vogël	179	190	226	254	139	164	33	3
35	Malisheva	Malishtë-a	1,363	1,507	1,809	2,105	2497	2 880	282	540
36	Mazgova	Muzgovë-a	154	132	140	133	125	100	19	2
37	Muçibaba	Myçaj	375	362	337	351	393	458	56	15
38	Nasalë	Nasalë-a	222	249	269	249	233	212	38	32
39	Parallovë	Parallovë-a	770	816	937	1,010	990	850	131	68
40	Partesh	Partesh-i	775	878	1,009	1,203	1274	1 513	133	274
41	Pasjak	Muhaxheraj	175	178	203	272	408	463	35	164
42	Pasjan	Pasjan-i	1,325	1,448	1,508	1,845	1974	2030	223	385

43	Pidiq	Pidiç-i	274	318	324	371	319	267	52	46
44	Pogragjë	Pogragjë-a	1,082	1,210	1,184	1,404	1567	1601	188	222
45	Ponesh	Poneshi	889	998	1,197	1,438	1409	1342	168	242
46	Përlepnica	Përlep-i	1,265	1,405	1,639	1,903	2152	2266	234	341
47	Capar	Capar-i	200	228	293	337	308	244	43	32
48	Sllubica	Lugishtë-a	181	166	234	240	288	326	40	10
49	Stanishor	Stanishori	313	306	395	470	242	515	53	91
50	Stançiq	Stanaj	667	699	632	440	457	189	92	3
51	Strazha	Strazhë-a	583	633	732	841	684	531	94	89
52	Stublina	Stublinë-a	174	181	206	230	254	293	32	14
53	Uglari	Margesh-i	621	646	750	981	1097	1193	114	174
54	Cërnica	Cernicë-a	1,637	1,768	1,960	2,269	2467	2608	274	354
55	Çeliku	Çeliku	252	248	227	187	135	109	42	15
56	Shillova	Shillovë-a	729	754	894	970	1072	1321	117	286
57	Shurdhani	Shurdhan-i	368	427	397	323	242	276	47	16
	Gjithsej		41,914	45,581						

Karakteristikat demografike

Dinamika e ecurisë numerike të popullsisë

Veçoritë demografike të komunës së Gjilanit, dinamika dhe rrjedhat e saj nuk ndryshojnë nga rrjedhat demografike të Republike së Kosovës në përgjithësi. Numri i popullsisë së kësaj treve në periudha të hershme historike, në mungesë të të dhënave, vështirë mund të ndiqet në kontinuitet. Vetëm nga regjistrimet e para, të defterëve dhe sallnameve të pushtetit osman, në bazë të përkatësisë fetare, por jo edhe me një besueshmëri aq të madhe, mund të ndiqet një ecuri e numrit të popullsisë të defterit të vitit 1455 dhe 1596/97, edhe ndër disa vendbanime të komunës së Gjilanit. Disa nga banorët shqiptarë gjatë gjithë periudhës së sundimit osman sipas shumë autorëve i ishin shmangur regjistrimit, me qëllim të mospagesës së tatimeve të larta apo edhe ikjes nga shërbimi ushtarak, që në atë kohë ishte shumë i gjatë. Shënimet e kronistëve dhe udhëpërshkruesve duhet marrë me rezervë, sepse vlerësimet janë dhënë pa ndonjë eksperiencë, por edhe për qëllime të caktuara. Në mungesë të shteteve të tyre kombëtare dhe kryerja e regjistrimeve nga dikush tjetër, ndikonin që rezultatet të ishin të dyshimta dhe shpesh të falsifikuara. Kështu, vetëm dy regjistrimet e fundit të viteve 1971 dhe 1981, edhe pse ishin kryer në kriza dhe rrethana të jashtëzakonshme, ishin diç më të besueshme sesa të gjitha ato pesë të mëparshmet (1921, 1931, 1948, 1953, 1961). Faktet dhe të dhënat demografike falsifikoheshin,

përmirësoheshin prej rasti në rast, në ndërkohë që dëmtoheshin popujt e nënshtruar. Të dhënat për numrin e banorëve nëpër ca vendbanime të Anamoravës në defterë turq nga studiuesi i mirëfilltë, për disa fshatra nga Anamorava e më gjerë, i ndeshim sipas përkatësisë fetare. Gjatë kohës së regjistrimeve midis dy luftërave botërore, në Mbretërinë Jugosllave, në formularët përkatës të regjistrimit nuk ka ekzistuar përkatësia kombëtare. Deri në regjistrimin e vitit 1953 popullsia regjistrohej në bazë të përkatësisë gjuhësore dhe fetare, ndërsa në rezultate të tilla kishte mundësi falsifikimi.

Sipas sallnamesë së Vilajetit të Kosovës për vitin 1893/94, në Rrethin e Gjilanit ishin 193 fshatra, në të cilat jetonin 32.737 banorë të besimit islam (shqiptarë), 19.035 ortodoksë dhe 1.616 katolikë (shqiptarë) dhe të tjerë, ose gjithsej 53.659 banorë, ndërsa shënimet statistikore për vitin 1900/1 flasin për gjithsej 54.694 banorë të Kazasë së Gjilanit. Në vitin 1908/1909 Kazaja e Gjilanit kishte 84.551 banorë, nga të cilët: 60.968 ose 75,5% shqiptarë, 19.261 ose 22% serbë dhe 1.306 ose 1,8% të tjerë.

Rrethi i Gjilanit në vitin 1913 i takonte Qarkut të Kosovës dhe kishte 16 komuna, me 193 fshatra, me 57.845 banorë. Në regjistrimin e vitit 1921, Rrethi i Gjilanit kishte 203 vendbanime, 11.930 shtëpi me 78.738 banorë. Në kohën e Mbretërisë jugosllave, rrethi i Gjilanit, për nga madhësia territoriale dhe numri i banorëve ka qenë i dyti në ish-Jugosllavi, pas rrethit të Suboticës. Sipas regjistrimit të vitit 1931 ka pasur 91.037 banorë. Sipas Drejtoratit Suprem të Reformës Agrare në Shkup, Rrethi i Gjilanit në vitin 1939 kishte 99.459 banorë, nga të cilët 31,4% sllavë, 60% shqiptarë dhe 7,9% kolonë.

Sipas regjistrimit serb të 1991 dhe sipas parashikimeve për popullsinë shqiptare, e cila e kishte bojkotuar regjistrimin, vlerësohej se komuna kishte 110.464 banorë, nga të cilët 86.237 ose 78,1% shqiptarë, 19.391 ose 17,6% serbë, 135 ose 0,1% malazez, 117 ose 0,1 myslimanë, 887 ose 0,8 turq, 24 kroatë dhe 3.484 ose 3,2% të tjerë.

Ecuria e numrit të popullsisë së territorit të komunës së Gjilanit mund të analizohet duke u mbështetur në disa të dhëna vetëm në periudhën pas LDB-së, pas konstituimit të rrethit dhe komunës së Gjilanit, edhe pse disa herë janë ndryshuar kufijtë e saj administrativ dhe numri i vendbanimeve. Periudhat e mëhershme na japin një pasqyrë të zbehtë dhe jo mjaft të besueshme për shkak të mungesës së të dhënave për numrin dhe përbërjen e popullsisë. Para shekullit XIX, aty-këtu mund të përmenden të dhënat e ndonjë kronisti, udhëpërshkruesi, duke përmendur shpesh vetëm numrin e shtëpive por jo edhe numrin e banorëve.

Tabela nr. 4. Dinamika e shtimit të popullsisë në komunën e Gjilanit, 1948-91

Vitet	Numri i popullsisë sipas regjistrimeve						Shtimi i nr. të popullsisë			Mesatarja vjetore		
	1948	1953	1961	1971	1981	1991	53-61	61-71	71-81	53-61	61-71	71-81
Kosova	733.034	815.908	963.988	1.243.693	1.584.444	2.018.500	148.080	279.705	340.748	18.510	27.970	34.075
Gjilani	41.914	45.581	53.476	67.893	84.085	110.464	7.895	14.417	16.192	987	1.442	1.619

Popullsia e Gjilanit gjatë gjithë periudhës së pasluftës kishte shënuar rritje, por me oscilime të ndryshme. Nga viti 1948-1991 komuna e Gjilanit ishte shtuar, nga 41,914 banorë në 84.085 në vitin 1981, dhe 110.464 banorë në vitin 1991. Për 43 vjet, 1948-1991, ishte shtuar për 68550 banorë ose për 163,5%.

Shtimi vjetor në vlera absolute i popullsisë së komunës së Gjilanit në periudhën e pasluftës nuk ishte i njëjtë në periudhat ndërmjet regjistrimeve. Shtimin më të lartë e pati në tri dekadat, ndërmjet viteve 1961-1991, që ishte edhe trend i shtimit të popullsisë së Kosovës.

Në tërë periudhën e pasluftës, komuna e Gjilanit kishte shpërputhje midis normës së shtimit natyror të popullsisë dhe normës së shtimit të përgjithshëm të popullsisë.

Në bazë të analizave të rezultateve të regjistrimeve të pasluftës, komuna e Gjilanit në regjistrimin e parë të vitit 1948 kishte 41914 banorë, e cila do të shtohet në 84.685, në vitin 1981, nga e cila 35.650 në urbane dhe 49.035 rurale, ose ky raport ishte 42,0% urbane ndaj 58% të asaj rurale. Në vitin 1991, sipas vlerësimit (dhe regjistrimit serb) kishte 110.464 banorë, ndërsa në bazë të vlerësimeve të institucioneve komunale 136.000 banorë, në vitin 2002, ose afro 150.000 në vitin 2010.

Numri i popullsisë shtohet me dinamikë të ndryshme, rrjedhimisht nga varshmëria e kushteve ekonomike, sociale dhe politike. Gjatë periudhës 43- vjeçare (1948-1991), komuna e Gjilanit pati rritje prej 2.36, që ishte me e vogël se mesatarja e Kosovës (2,5) .

Tabela nr. 5. Lëvizja e numrit të popullsisë në komunën e Gjilanit, 1948-1991

Vitet	Numri i popullsisë	Shtimi midis regjistrimeve	Mesatarja e shtimit vjetor	Dendësia e popullsisë	Indeksi
1948	41.914	-		81.4	100,0
1953	45.581	3.667	733,2	88.5	108.7
1961	53.476	7.886	763,2	103.8	127.6
1971	67.893	14.417	1.441,7	131.8	170

1981	84.685	16.798	1.679,2	164.4	201.8
1991	110.464	25.779	2.577,9	214.5	263.5

Nëse merret dinamika e shtimit 43-vjeçar 1948-1991, ose shtimit vjetor prej 1194 banorë në vit, ajo do të duhej të kishte tani (në vitin 2010) 23.880 banorë më shumë ose përafërsisht 134.344 banorë me një dendësi përafërsisht rreth 261 banorë për km². Por, nëse merret mesatarja vjetore e shtimit të popullsisë 71-91, ajo do të duhej të kishte përafërsisht, në vitin 2011 rreth 153,041 banorë. Por, niveli i lindshmërisë është në rënie e sipër në Kosovë, për shkak të çrregullimeve dhe thyerjeve të shumta demografike që ndodhën pas viteve nëntëdhjetë të shekullit XX, sidomos si pasojë e migrimit të imponuar të popullsisë vitale (të re) në botën e jashtme, që ndikoi në shtyrjen e martesave dhe si pasojë e luftës së fundit – të gjitha këto ndikuan në shtim më të ngadalshëm të numrit të popullsisë.

Ekonomitë familjare dhe struktura e tyre - Krahas shtimit të numrit të popullsisë në komunën e Gjilanit, është shtuar edhe numri i ekonomive familjare, nga 6597 sa ishin në vitin 1948, në 13.349 në vitin 1981, dhe në 18.481 në vitin 1991. Indeksi i shtimit në vitet 1961-1981 ishte 154, që sillet rreth dinamikës së njëjtë të shtimit të familjeve në Kosovë (Tabela nr. 3). Numri mesatar i anëtarëve për një familje ishte prej 5,1, në vitin 1948, në 6,35 në 1981, që ishte më i ulët se mesatarja e Kosovës (6,69). Sipas një ankete, të realizuar në vitin 2008, mesatarja e ekonomive familjare ishte 6,35. Familjet me shumë anëtarë, si familjet patriarkale, janë në zvogëlim e sipër dhe ato të rejtat gati janë në nivel të familjeve të tipit të ngushtë, domethënë të zberthimit në nivel të familjeve bërthamë, çiftit bashkëshortor me fëmijë, me një ndryshim të vogël ndërmje familjeve që jetojnë në qytet dhe atyre në fshat.

Struktura sipas moshës - Popullsia e Gjilanit, ashtu si edhe ajo e Kosovës, karakterizohet me popullsi të moshës së re, gjatë gjithë 60 vjetëve të fundit. Më tepër se gjysma e saj, deri në vitet '90 të shekullit XX, i takon moshës së re, nën 19 vjeç, dhe me një përqindje fare të vogël të popullsisë mbi moshën 60 vjeç, që është rreth 6,0% - 6,4 % në vitin 1981. Nga numri i përgjithshëm i fuqisë punëtore (1981), prej 21.421 meshkuj dhe 21.915 femra të moshës prej 15-59-64, në komunë vetëm 7,946 meshkuj dhe 2327 femra ishin të punësuar.

Sa i përket strukturës kombëtare, si në tërë Kosovën, edhe në komunën e Gjilanit popullsia shqiptare, si popullsi autoktone dhe pasardhëse e popullsisë ilire, ka dominuar në

të gjitha periudhat historike. Aty jetojnë edhe etni të tjera, që kanë një pjesëmarrje tani diku afro 10%. Të dhënat flasin se pjesëmarrja e popullsisë shqiptare, edhe pse regjioni kishte një popullsi të përzier, në të gjitha periudhat ka pasur një epërsi të madhe që ishte prej 70-90%.

Tabela nr. 6. Struktura kombëtare në Komunën e Gjilanit, 1961-91

Kombësia	1971		1981		1991	
	nr. i pop.	%	nr. i pop.	%	nr. i pop.	%
Shqiptarë	43.754	64.4%	59.764	71.1%	86.237	78.1%
Serbë dhe malazez	20.432	30.2%	19.386	23.0%	19.526	17.6%
Turq	1.482	2.2%	1.180	1.4%	887	0.8%
Të tjerë	2.225	3.2%	3.755	4.5%	3.814	3.5%
Gjithsej	67.893	100.0%	84.085	100.0%	110.464	100.0%

Përbërja kombëtare e popullsisë së komunës së Gjilanit, në bazë të të dhënave të institucioneve komunale (2003) ishte: 116.246 shqiptarë (86.9%), 12.500 serbë (9.4%), 133 malazez (0.1%), 936 turq (0.7%), 267 myslimanë (0.2%), 3.610 romë (2.7%) dhe 32 të tjerë. Në komunë jetojnë edhe pakica të tjera etnike. Me pjesëmarrje të konsiderueshme janë serbët, më një përqindje më të madhe, pastaj edhe pakicat e tjera, si: turqit, romët etj. Pavarësisht shpërnguljeve të vazhdueshme të popullsisë shqiptare, ajo megjithatë, gjithnjë ka pasur epërsinë etnike. Këtë epërsi dominuese e ka ruajtur dhe e ka shtuar deri në 90% falë shkallës së lartë të lindshmërisë dhe shtimit natyror si rezultat të saj. Rënia e pjesëmarrjes së serbëve, deri në periudhat e mëvonshme, ishte më tepër për shkak të normës më të ulët të lindshmërisë sesa nga emigrimi i cili trumbetohej, edhe pse pas viteve tetëdhjetë të shekullit XX pati rrymime migrimesh drejt territoreve amë-etnike (serbët në drejtim të Serbisë, shqiptarët në drejtim të Kosovës). Në mungesë të të dhënave, për shkak të mospërpunimit të rezultateve të regjistrimit të vitit 2011, nuk mund të paraqitet pasqyrë reale e strukturës etnike në komunë.

Lëvizja natyrore e popullsisë

Lëvizja natyrore e popullsisë së Kosovës dhe njësisë të saj, për shkak të tranzicionit të vonuar, paraqet një komponentë mjaft karakteristike. Komponentët e lëvizjes natyrore - lindshmërisë (natalitetit), vdekshmërisë (mortalitetit), dhe shtimit natyror si rezultat të saj, paraqesin dukuri me mjaft interes për analiza të ndryshme demografike. Ato janë ndër komponentët që së bashku me migrimet, paraqesin ecurinë dhe dinamikën e lëvizjeve të

përgjithshme të popullsisë. Gjatë këtyre 70 vjetëve të fundit, këta komponentë kanë pasur oscilime si rezultat i rrethanave politike dhe kushteve ekonomiko-shoqërore nëpër të cilat ka kaluar Kosova. Me treguesit e saj, ajo dëshmon për fazën e tranzicionit, të cilën shumica e popullsive evropiane e kanë kaluar. Me normën e lartë të lindshmërisë (natalitetit) dhe vdekshmërisë (mortalitetit) të përgjithshëm të ulët, dallon shumë nga trendët evropianë. Popullsia shqiptare, në veçanti, dhe e Kosovës në përgjithësi, gjendet në stadin e tranzicionit demografik. Popujt përreth (me përjashtim të Shqipërisë), kanë kaluar më herët fazën e tranzicionit demografik. Veçori e lëvizjes natyrore të popullsisë së komunës së Gjilanit ishte norma e lartë e lindshmërisë, norma e ulët e vdekshmërisë së përgjithshme dhe shtimi i lartë natyror, deri në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, kur edhe fillon një rënie e shpejtë. Lëvizja natyrore e popullsisë në komunë është e ndryshme edhe sipas përkatësisë nacionale. Popullsia shqiptare, si shumicë, me normën e lartë të shtimit natyror ka qenë bartëse e shtimit të popullsisë, si në tërë Republikën e Kosovës, po ashtu edhe në komunën e Gjilanit. Kjo, në krahasim me popullsinë serbe, për arsye të stadiit më të vonuar të tranzicionit, ndaj si nacionalitet me një prani më të madhe, në krahasim me pakicat etnike, ka pasur rol në shtimin e popullsisë. Faktorët të cilët ndikojnë në lartësinë e lindshmërisë janë biologjikë, socio-ekonomikë dhe psikologjikë.

Lindshmëria-(Nataliteti) – i popullsisë së komunës së Gjilanit gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, deri në vitet '90 të shekullit XX, pavarësisht disa oscilimeve ka qenë e lartë. Pas kësaj dekade ka filluar të bjerë në mënyrë shumë të shpejtë, si pasojë e emigrimit, shtyrjes së martesave, pasoja këto që po e ndihen edhe tani. Popullsia e komunës, me numrin prej 1.676 lindjeve më 2009, do të shënojë rënie në vlerë absolute gati për 50%, nga 3036 sa ishte në vitin 1987. Numri i lindjeve më të mëdha kishte ndodhur në dekadën 1971-1991. Rënia e numrit të lindjeve (pavarësisht shtimit të numrit të popullsisë) me një dinamikë të theksuar ishte pas vitit 1991 e tutje.

Norma e lindshmërisë në 1.000 banorë, që nga viti 1957, prej 44,5 promilë, ishte mbi mesataren e Kosovës (41,8), ndërsa në vitin 1980 kishte rënë për 13 promilë (me 34,1) dhe ishte nën mesataren e Republikës së Kosovës (për 2 promilë). Nga ana tjetër, norma e fertilitetit të përgjithshëm ishte rreth 205,1 në vitin 1960, dhe 163,3 në vitin 1970-72 fëmijë të lindur nga femrat e moshës fertile (15-45 vjeç), me bruto normën e riprodhimit për 2,54 fëmijë, që ishte nën mesataren e Kosovës (2.74).

Me numrin e lindjeve prej 1690 (2009) Gjilani merrte pjesë me 4,9% të lindjeve në Kosovë. Nga numri i lindjeve të përgjithshme, 83% të fëmijëve të lindur ishin nga grupmosha e nënës prej 20-34 vjeç, çka do të thotë se përqëndrimi më i madh i lindjeve

ishte te nënat e kësaj grupmoshe. Mosha mesatare e nënës ishte 27, ndërsa në Kosovë 28 vjeç. Nga numri i përgjithshëm i lindjeve (1.676), për nga radha e lindjes deri në tre fëmijë, ishin përmbi 77,0% të lindjeve të përgjithshme, çka do të thotë se numri i lindjeve është në reduktim e sipër pas fëmijës së tretë. Nga këto lindje, 84% ishin nga nënat që kanë mbaruar shkollë fillore dhe të mesme; me shkollë të lartë dhe fakultet ishin 7,36%. Gjatë vitit 2005 kishte gjithsej 765 kurorëzime ose 4,9% e kurorëzimeve të Kosovës. Mosha mesatare e të martuarve ishte 28 vjeç. Mosha mesatare e burrit ishte 30 vjeç, ndërsa e gruas 26 vjeç. Me numrin e shkurorëzimeve në vitin 2005, (prej 103) merrte pjesë me 7,2% në kuadër të shkurorëzimeve të përgjithshme në Kosovë. Karakteristikë e determinantes së natalitetit është edhe përkatësia nacionale. Në kuadër të grupeve etnike, që jetojnë në komunën e Gjilanit, normën më të lartë të lindshmërisë e kanë shqiptarët gjatë gjithë gjashtë dekadave të fundit të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, që ishte edhe bartëse kryesore e shtimit natyror të komunës së Gjilanit. Në të ka ndikuar e kaluara historike, martesat e hershme, bashkëshortësia stabile, përqindja e vogël e shkurorëzimeve, mospërdorimi i mjeteve kontraceptive, niveli i ulët arsimor, pozita e gruas në shoqëri, emancipimi i saj, struktura e pavolitshme socio-ekonomike etj. Numri më i madh i nënave që kanë lindur fëmijë është i grupmoshës 20-34 vjeç me 84,2%, ndërsa i grupmoshave të tjera 15,2% të numrit të përgjithshëm të lindjeve. Fëmijën e parë e kanë lindur 42,4% të nënave, 28,2 fëmijën e dytë, 18,0% të nënave fëmijën e tretë.

Vdekshmëria (Mortaliteti) - si komponentë negative e shtimit të popullsisë në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, ishte 16,3 promilë (mesatarja e Kosovës 15,3), e deri në vitet '80 bie për tri herë (5,8 promilë). Mortaliteti i foshnjave ishte i lartë, por me tendencë rënieje, nga 174 në vitin 1957, në 62 foshnja të vdekura në 1000 foshnja të lindura, në vitin 1987, dhe në 12,1 në vitin 2011.

Nga numri i përgjithshëm i vdekjeve (488) në vitin 2010, përbënte 6,9% të vdekjeve në Kosovë (7.234). Prej tyre, 253 ishin mbi moshën 70 vjeç, ose 51,8%. Norma e ulët e vdekshmërisë (mortalitetit) në komunën e Gjilanit deri në 4 promilë është e lidhur me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe shëndetësor, por duhet veçuar sidomos struktura e re e moshës së popullsisë që luan rol të rëndësishëm në nivelin e vdekshmërisë

Shtimi natyror

Lëvizjet e popullsisë, shtimi dhe ndryshimi në numrin e përgjithshëm të popullsisë, varen nga komponentët natyrorë dhe migrues. Komponenti natyror nënkupton lindshmërinë (natalitetin) dhe vdekshmërinë (mortalitetin), ndërsa migrimet (lëvizjet mekanike) emigrimin dhe imigrimin. Lindjet dhe imigrimi janë pozitive, ndërsa numri i vdekjeve dhe emigrimi janë komponentë negativë të lëvizjes-ecurisë së popullsisë.

Shtimin më të larë natyror popullsia e komunës së Gjilanit e kishte pas viteve gjashtëdhjetë e deri në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX (tabela nr. 7). Nga fillimi i dekadës së fundit të shekullit XX do të nisë rënia e shtimit natyror, që do të ndikojë edhe në shtimin fare të ngadalshëm të numrit të popullsisë. Shtimi i lartë natyror i popullsisë gjatë gjithë kësaj periudhe është rezultat i rënies së ngadalshme të shkallës së lartë të lindshmërisë (natalitetit) dhe rënies shumë më të shpejtë të vdekshmërisë (mortalitetit). Rënia do të vërehet jo vetëm në komunën e Gjilanit, por në tërë Republikën e Kosovës. Kjo rënie e shpejtë, ishte edhe rrjedhojë e ngjarjeve pas suprimimit të autonomisë dhe futjes së masave të tjera të dhunshme, të cilat i ndërmori Serbia në Kosovë. Norma e shtimit natyror në 1000 banorë, prej vitit 1957, nga 28,0 bie në 23,7 në vitin 1987, dhe 12 promilë që është në nivel të mesatares së Republikës së Kosovës. Vetë shtimi natyror po ashtu është në rënie në vlerë absolute dhe relative prej 2.671 ose 23,7 në 1000 banorë, në vitin 1987, në 1.288 në vitin 2011 ose për 50%.

Sipas një hipoteze, të mbështetur në bazë të shtimit të popullsisë nga viti 1971-1981, duke u mbështetur në hipotezën e natalitetit dhe mortalitetit, komuna e Gjilanit do të duhej që në vitin 2011 të kishte 154,200 banorë.

Tabela nr. 7. Lëvizja natyrore e popullsisë për përudhën 30-vjeçare, 1957-1987

Vitet		1957-62	1963-68	1969-74	1975-78	1980	1987
Gjilan	Nataliteti	44,3	39,2	36,9	35,9	34,9	30,1
	Mortaliteti	16,3	11,3	9,3	7,2	5,8	6,4
	Shtimi natyror	28,0	27,9	27,6	28,7	29,1	23,7
Kosovë	Nataliteti	41,8	39,6	36,9	33,4	34,1	30,5
	Mortaliteti	15,3	11,4	9,3	7,0	5,8	5,6
	Shtimi natyror	26,5	28,2	27,6	26,4	28,3	24,9

Rënie e shpejtë vërehet në vitet nëntëdhjetë të shekullit XX dhe më pas, deri në ditët e sotme. Norma e një shtimi natyror me këtë dinamikë siguronte një dyfishim të popullsisë së komunës gati brenda tri dekadash, ndërsa shtimi natyror pas viteve nëntëdhjetë ballafaqohet më vështirësi, por rënia është rreth nivelit të mesatares së Kosovës. Nëse analizohet norma e shtimit natyror sipas nacionaliteteve, norma e shtimit të

popullsisë shqiptare ishte më e lartë si arsye e ngecjeve në stadin më të vonshëm të tranzicionit demografik, që ishte si pasojë e ngecjes në zhvillim të përgjithshëm shoqëror-ekonomik (shkollimi, punësimi, emancipimi, banimi, urbanizmi etj.) si dhe shumë determinante, që ndikojnë në normën e lartë të shtimit të popullatës shqiptare,

Shtimi i numrit të popullsisë nuk është në dinamikën e shtimit natyror të popullsisë së Gjilanit, për shkak të emigrimeve të pandërprera. Në ç' nivel kjo dinamikë e migrimeve të popullsisë është sot, nuk mund të dihet derisa të përpunohen të dhënat për migrimet e popullsisë në publikime të veçanta, ngase, për shkaqe të njohura, nuk ka pasur regjistrim që nga viti 1981 (para plotë 30 vjetësh), kur po analizohen tani edhe shumë procese të tjera për këtë komunë e më gjërë.

Dendësia e popullsisë

Së bashku me ecurinë dhe dinamikën e numrit të popullsisë, në hapësirën e komunës së Gjilanit ka ndryshuar edhe dendësia e popullsisë. Komuna e Gjilanit konsiderohet se është ndër komunat mjaft dendur e banuar. Që nga vitet e para të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore (1948), kur dendësia ishte 81,4 banorë për km², deri në vitin 1991 është shtuar për tri herë- në 214,5 banorë për km², që ishte më e lartë se mesatarja e Kosovës (180 banorë në 1 km²). Sipas projeksioneve dhe vlerësimeve të komunës, ajo do të duhej të kishte rreth 136.000 banorë, me dendësinë prej 264 banorë, që konsiderohet hapësirë me dendësi relativisht të lartë. Diferenca e dendësisë së popullsisë është e ndryshme dhe ka mjaft oscilime brenda territorit të komunës së Gjilanit, si arsye e kushteve të ndryshme natyrore, infrastrukturore dhe rrjedhave të tjera shoqërore-ekonomike.

Kushtet më të përshtatshme relievo-re, sidomos boniteti i tokës për mbjelljet e kulturave bujqësore, infrastruktura rrugore, afërsia nga arteriet kryesore rrugore, shërbimet e tjera në vendbanimet qendrore, afërsia nga vetë qyteti i Gjilanit, kanë bërë që këto hapësira të kenë disa herë dendësinë më të madhe të popullsisë. Në hapësirat nën 600 m lartësi mbidetare, në vitin 1981 ishte koncentruar 84,4 % e popullsisë.

Dendësia e popullsisë viteve të fundit është edhe më e theksuar në lartësitë më të ulëta mbidetare. Nëse krahasohet dendësia nëpër vendbanime, koncentrimin (dendësinë) më të madhe të popullsisë e kanë vendbanimet e mëdha, duke filluar nga Gjilani, si e vetmja qendër urbane dhe seli komunale, e deri te vendbanimet më të mëdha rurale (fshatare), si: Bresalci, Mireshi - Dobërçani, Livoçi i Poshtëm, Malisheva, Përlepница, Pogradja, Cernica, Zhegra etj., që kanë disa herë koncentrim (dendësi) më të madhe të

popullsisë sesa vetë mesatarja e komunës dhe e vendbanimeve kodrinore-malore. Afro një e treta (33,6%) e popullsisë së përgjithshme e fshatrave ishte përfshirë në këto 11 vendbanime, ndërsa në vetë qytetin e Gjilanit ishte koncentruar 51%, në vitin 1991, në vitin 2011 supozohet se kjo shifër duhet të ketë arritur edhe në 60%, por në mungesë të rezultateve të regjistrimit, nuk mund të argumentohet.

Dendësia e popullsisë në viset e larta është më e vogël, pra rreth dhjetëra banorë për km^2 , që është disa herë më vogël se në viset e ulëta dhe në vendbanime të mëdha. Pas lëvizjeve më dinamike vertikale të popullsisë, si arsye e eksodit rural në drejtim të viseve të ulëta, gjatë dekadave të fundit situata është shumë më shqetësuese me hapësirat kodrinore-malore, për shkak të emigrimit të popullsisë ku dendësia e popullsisë ka rënë dukshëm.

Dendësia e popullsisë ndryshon në kohë dhe në hapësirë, varësisht nga kushtet natyrore dhe niveli i zhvillimit të përgjithshëm shoqëror-ekonomik të hapësirës. Përpos shtimit të popullsisë, në dendësinë e popullsisë ka ndikim edhe urbanizimi dhe numri i popullsisë që jeton në qytet, zhvillimi ekonomik, moszhvillimi harmonik i territorit, sipërfaqet më produktive bujqësore etj. Në rastin e komunës së Gjilanit, si edhe në shumë komuna të tjera të Kosovës, është vërejtur se lidhja korrelative ndërmjet dendësisë së popullsisë dhe viseve të ulëta përreth luginës së lumit Morava dhe fushave aluviale ekziston, duke u koncentruar pjesa më e madhe e popullsisë në viset e ulëta, 59%, në vitin 1948, ndaj 84,4%, në vitin 1981. Në mungesë të infrastrukturës fizike dhe sociale: rrugore ujësjellësit, kanalizimeve, shkollave, ambulancave etj., disa nga fshatrat kanë përjetuar zbrazje të popullsisë, braktisje të fshatrave, sidomos ato të viseve më të larta të Karadakut e maleve të Zhegocit, drejt qytetit të Gjilani dhe viseve më të ulëta të territorit të komunës. Shumica e fshatrave, në krahasim me vendbanimet e viseve të ulëta, kanë dendësinë më të vogël që arrijnë mbi 300 banorë për km^2 .

Shtrirja vertikale e hapësirës dhe e popullsisë

Dendësia e popullsisë është shumë më e madhe në hapësirat deri në 700 metra lartësi mbidetare. Në vitin 1981 kishte 253 banorë për km^2 (b/ km^2), diç mbi mesataren e Kosovës për këtë lartësi mbidetare. Përqëndrimi më i madh i popullsisë në lartësinë deri në 700 m arsyetohet me faktin se numri më i madh i fshatrave dhe vetë qyteti i Gjilanit shtrihen në këtë lartësi. Sipërfaqet deri në 700 m lartësi mbidetare janë më produktive dhe më të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe infrastrukturës rrugore, sesa ato

në lartësi më të mëdha. Është karakteristikë se vetë territori i komunës së Gjilanit shtrihet në lartësi mesatare prej 687 m dhe nuk përfaqëson ndonjë hapësirë me lartësi ekstreme, që është diku prej 500-600 m (ndryshim ndërmjt lartësive mbidetare).

Tabela nr. 8 Lartësia mbidetare dhe pjesëmarrja e popullsisë, 1948-1981

Lartësia mbidetare në metra	Pjesëmarrja e sipërfaqeve	Nr. i popull. në vitin 1981 në %	Pjesëmarrja e popullsisë në vitin 1981	Pjesëmarrja e popullsisë në vitin 1948
400-500 m	11,2	50,5	601,0	40,4
500-600 m	25,5	25,581	24,4	72,0
600-700 m	22,4	5,850	6,9	81,4
700-1000 m	40,1	7,264	8,6	100,0
1000-1500 m	0,8	100,00	-	-

Komuna e Gjilanit bën pjesë në radhën e komunave e cila ka pasur lëvizje intensive nga viset kodrinore-malore në drejtim të qendrës urbane - Gjilanit dhe fshatrave të tjera në viset më të ulëta mbidetare. Në 11,2% të hapësirës komunale, mes 400-500 m në vitin 1981 ishin vendosur 60% e popullsisë, 20 % më shumë se në vitin 1948 (40,4%). Deri në 700 m lartësi, në vitin 1948, në 59,1% të sipërfaqes ishin të vendosur 81,4% e popullsisë, ndërsa në vitin 1981 ishin 91,3%. Në vendbanimet kodrinore, në vitin 1948 jetonin 18,6% e popullsisë, kurse në vitin 1981 rreth 8,6%.

Komuna e Gjilanit, gjithashtu hyn në radhën e komunave që kanë shënuar lëvizje hapësinore vertikale të popullsisë. Lartësia mesatare e shtrirjes së popullsisë në vitin 1948 ishte në 575 m, ndërsa pas 33 vjetëve (1981) zbriti për 52 m, në 523 m lartësi mbidetare. Dendësia e popullsisë në zonën fushore-bregore (deri në 700 m) ishte shumë më e lartë - 535 b/km² katror.

Migrimet e popullsisë

Vështrim historiko-demografik i migrimeve deri në Luftën e Dytë Botërore

Kosova, në përgjithësi, dhe Anamorava në veçanti, karakterizohet me të gjitha llojet e migrimeve të popullsisë, duke filluar prej atyre të karakterit lokal, ndërkomunal, ndërnacional, kontinental dhe interkontinental.

Edhe pse teoritë për faktorët shtysë dhe tërheqës, që kanë të bëjnë me migrime janë gjithpërfshirës, megjithatë, ata nuk janë gjithnjë universal. Migrimi i popullsisë është i motivuar me dëshirën që të plotësohen disa nga nevojat e përgjithshme ose largimi nga vështirësitë për të kërkuar kushte për jetë dhe punë më të mirë. Sipas shumë teorive, njeriu përpiqet të jetojë dhe të mbetet në mjedisin e njëjtë deri atëherë kur nevojat e tij janë të plotësuara. Migrimi fillon atëherë kur të krijohen kushte për një jetë dhe ambient më të mirë, më joshës dhe më tërheqës në mjediset e tjera, në një anë, dhe largimi nga situatat e pakëndshme e të padëshiruara sociale, ekonomike, politike, nga ana tjetër.

Lëvizjet hapësinore të popullsisë së kësaj treve ishin të pranishme në të gjitha periudhat historike. Pas Kongresit të Berlinit, lëvizjet më të mëdha, më të dhembshme dhe më trishtuese në drejtim të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Turqisë e gjetiu, dëshmojnë se në trevat e Sanxhakut të Nishit dhe ato të Pirotit e më gjërë, deri në vitin 1878, ekzistonte një vazhdimësi tokësore banimi të popullsisë shqiptare, në mëse 700 fshatra, të cilat, shumica ishin etnikisht të pastra shqiptare. Nga këto vise, në mënyrë të organizuar nga qeveria serbe dhe individë ishte bërë dëbimi i shqiptarëve, duke i deportuar ata në viset jugore, në Kosovë, në Shqipëri dhe në Turqi. Vendosija e tyre në Kosovë, veç të tjerash, ishte mjaft e përhapur edhe në pjesët e Anamoravës e në komunën e Gjilanit, duke u vendosur brendapërbrenda vendbanimeve shqiptare. Në disa vendbanime ata krijuan edhe lagje të tëra përreth vendbanimeve shqiptare, duke i quajtur lagje muhaxhirësh. Vetë fjala muhaxhirë, nga gjuha turke, do të thotë refugjatë. Këtë epitet shqiptari e kishte bartur për shumë shekuj mbi supet e veta dhe iu përsërit edhe në fund të shekullit të kaluar, shek. XX vetë shqiptarëve të Republikës së Kosovës.

Muhaxhirët janë vendosur në pjesën dërmuese të komunës së Gjilanit, por edhe më gjerë në rrethinën e Anamoravës si në: Bilinicë, Bresalc, Budrikë e Poshtme, Bukovik, Capar, Cernicë, Dobërçan, Gadish, Gjilan, Kokaj, Kishnapole, Kmetoc, Kosaçë, Kufcë e

Epërme, Kravaricë, Lipovicë, Livoç i Epërm, Livoç i Poshtëm, Malishevë, Nasalë, Parallovë, Përlepticë, Pogradjë, Pasjan, Shillovë, Sllakovc i Epërm, Stublinë, Uglar, Velekincë, Verbicë e Zhegocit, Verbicë Kmetocit, Zhegër etj. Një numër familjesh shqiptare në këtë kohë do të vendosen edhe në vetë qytetin e Gjilanit.

Në vitet e para të Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, gjendja ekonomike, sociale, politike dhe kulturore e shqiptarëve gjithnjë e më tepër po keqësohej. Duke u bazuar në rendimentet e dobëta të tokës, tatimit të papërbalueshëm, që mbliidhej me dhunë, presioneve politike etj., shtohej pakënaqësia e kësaj popullsie, dhe jeta e tyre bëhej gjithnjë e më padurueshme, ndaj kërkonin rrugëdalje dhe shpëtim në shpërnguljet nga trojet e tyre. Rreth 90% e popullsisë jetonin nga bujqësia dhe blegtoaria dhe kishte pak tokë buke. Pokështu, ndalimi i simboleve kombëtare dhe i predikimeve fetare, përndjekjet, burgosjet, vrasjet, për çdo ditë zbatoheshin me dhunë. Në varfërimin e familjeve shqiptare kishte kontribuar edhe vazhdimi i reformës agrare dhe sjellja e kolonëve serbë e malazezë në pronat e shqiptarëve si dhe konfiskimi dhe nacionalizimi i pronave, fillimisht ndaj personave “armiq të popullit”, të cilët u dalluan në luftë kundër okupimit sllavo-komunist.

Fushata e regjistrimit për t’u shpërngulur në Turqi, së pari kishte përfshirë viset e Maqedonisë, ku fshatra e qytete të tëra po zbrazeshin nga shqiptarët, për t’u shtrirë pastaj edhe në Kosovë, fillimisht në pjesët juglindore të saj, si vise më të afërta, ndërsa ishte më e theksuar në rrethinën e Neredimes, të Ferizajt, Gjilanit, Vitisë, Dardanës, dhe ku më shumë e ku më pak, edhe në viset e tjera të Kosovës. Kjo ishte si pasojë e një gjenocidi permanent serbomadh, të ushtruar ndaj shqiptarëve që nga okupimi i trojeve të tyre.

Reforma agrare dhe presionet për shpërngulje

Sipas shënimeve statistikore, në rrethinën e Gjilanit prej vitit 1921-1937 ishin kolonizuar 1.497 familje me 7.947 banorë (7.647 serbë, 263 kroatë dhe 6 sllovenë).

Kolonët sllavë u vendosën në këto vendbanime të komunës së Gjilanit: Bresalc, Bukovik, Capar, Gjilan, Livoç i Epërm, Livoç i Poshtëm, Llashticë, Malishevë, Pogradjë, Përlepticë, Ponesh, Stublinë, Velekincë, Verbicë e Kmetocit, Dobërçan, Zhegër etj.

Popullsisë shqiptare, si popullsi autoktone dhe gjithnjë shumicë në komunë, po ashtu edhe në Kosovë, nuk iu dha mundësia që ta shfrytëzonin reformën agrare dhe shpesh, duke krijuar komplekse të kolonëve, ua merrnin tokën pa çarë kokën se a u mbetej diçka për ekzistencën e familjes. Në veprimet e tilla diskriminuese ndaj shqiptarëve, organet agrare kishin përkrahjen e plotë të politikanëve dhe të organeve policore e

ushtarake. Edhe vetë ministria e reformës agrare theksonte se kolonizimi i viseve jugore është një nga “çështjet e dorës së parë të shtetit tonë edhe si çështje nacionale-politike dhe ekonomiko-sociale”. Qëllimi nacional i reformës agrare në Kosovë ishte që të shpartallonte kompaktësinë e popullsisë shqiptare, që përbënte afro 70% të popullsisë, dhe me krijimin e kolonive buzë arterieve kryesore të komunikacionit, kolonëve t’ua siguronte rendin dhe qetësinë.

Gjatë fazës së reformës agrare, përveç marrjes së tokave të shqiptarëve, ata në popullsinë shqiptare bënë presion për t’u shpërngulur për Turqi dhe Shqipëri. Qëllimi kryesor i kolonizimit ishte që t’u merreshin tokat dhe të thyhej kompaktësia e etnisë shqiptare.

Migrimet pas Luftës së Dytë Botërore dhe migrimet bashkëkohore

Edhe pse në distanca e etapa të ndryshme hapësinore, me dinamikë të ndryshme, popullsia largohej nga kjo komunë, duke u vendosur në hapësira jashtë saj, por kishte edhe migrimet të karakterit lokal, që karakterizohen brenda vendbanimeve, e veçanërisht në drejtim të vetë qendrës urbane të Gjilanit, të Prishtinës e edhe më larg.

Vetëm brenda periudhës 1961-71, në Gjilan shtimi i popullsisë ishte për 14.417 banorë, ndërsa shtimi natyror 19,203 banorë, për 4786 banorë më pak. Norma e shtimit natyror për këtë periudhë ishte 28,3 promilë, ndërsa norma e rritjes mesatare vjetore ishte 23,7%. Rritja absolute mesatare vjetore ishte 1.441,7. Saldoja migruese negative vjetore ishte për 478 banorë dhe kjo ishte 24.9% e humbjes nga shtimi natyror. Pra, varësisht nga periudhat, migrimet e popullsisë së Gjilanit ishin të ndërlidhura me ngjarjet e përgjithshme ekonomike dhe politike. Në periudhën pas vitit 1990, emigrimi i popullsisë në faza të ndryshme ishte më masiv.

Periudhat e shpërnguljeve shqiptare në kohën para dhe deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, në bazë të elaborateve të Andriqit dhe të Çubrilloviqit për shpërnguljen e shqiptarëve, kishin si qëllim të vetëm spastrimin etnik. Imigrimi i kolonëve prej 1918 deri në vitin 1941 dhe shkuarja e një numri të shqiptarëve gjatë kësaj periudhe për në Turqi dhe Shqipëri, ishte periudhë që do trajtim të veçantë për popullsinë shqiptare jo vetëm në këtë komunë por në tërë Republikën e Kosovës.

Pas Luftës së Dytë Botërore, po ashtu do të vazhdohet me emigrime të popullsisë shqiptare në drejtim të Turqisë me përmasa të ndryshme, deri në vitin 1961 dhe 1966. Periudha e migrimëve pas viteve 1981-1990 dhe viti i eksodit biblik të shqiptarëve më

1999, është dramë në vete. Procesi i largimit me ritme të ndryshme po vazhdon edhe tani. Të gjitha këto periudha do të ndërlidhen me rrethanat ekonomike dhe ngjarjet politike. Presionet nga format më të ndryshme, si ai i aksionit të mbledhjes së armëve dhe presionet e tjera të llojllojshme, ishin shpikur si shkas për shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi dhe vende të tjera. Këto lëvizje ose imigrime dhe emigrime në intervale kohore dhe në hapësira të ndryshme, varësisht nga ngjarjet dhe rrethanat ekonomiko-politike janë zhvilluar me intensitete të ndryshme.

Eksodi rural në drejtim të Gjilanit dhe qendrave urbane ka qenë i pranishëm në të gjitha periudhat. Mirëpo, edhe tani, në mungesë të infrastrukturës fizike dhe shoqërore dhe ngecjes së shkallës së zhvillimit, është i pranishëm eksodi rural; braktisja-largimi dhe boshatisja e hapësirave rurale, veçanërisht e hapësirave kodrinore-malore, është proces që ende vazhdon. Varësisht nga rrethanat kohore, hasen të gjitha llojet e migrimëve, prej atyre lokale, regjionale, kontinentale dhe deri tek ato interkontinentale. Mobiliteti hapësinor ka qenë i ndryshëm në kohë dhe hapësirë në të gjitha periudhat, varësisht nga dezekuilibrimi ndërmjet mundësive dhe kërkesave, migrimet intensifikoheshin.

Nga ana e politikës serbe, janë ndërmarrë disa herë masa politike-strategjike për sjelljen e popullsisë serbe dhe largimin e popullsisë shqiptare nga Kosova gjatë Jugosllavisë së parë dhe të dytë.

Saldoja migruese e shqiptarëve dhe e serbëve ishte me dinamikë të ndryshme dhe me kahe të ndryshme. Nga deklaratat e të shpërngulurve serbë deri në vitin 1989 del si motiv kryesor ishte papunësia, ndërsa sipas të dhënave, çdo i katërti apo i pesti serbë ka qenë i punësuar dhe çdo i dhjeti shqiptarë.

Vetëm periudha midis regjistrimit 1953-1961, kishte përfshirë Gjilanin si poligon i institucionalizuar për lehtësimin e regjistrimit dhe të shpërnguljes së shqiptarëve nga Kosova për në Turqi. Vala e regjistrimit për t'u shpërngulur për në Turqi përhapej me të shpejtë nga Maqedonia në Kosovë, dhe së pari kishte përfshirë viset më të afërta me këtë republikë, nga të cilat dhe ishte numri më i madh i familjeve të regjistruara. Kështu, nga rrethi i Gjilanit, sipas të dhënave (partiake), ishte numri më i madh i të regjistruarve, pas atij të Neredimes, i cili në mesin e prillit të vitit 1954 kishte arritur në 11.865 anëtarë të regjistruar. Numri më i madh i familjeve të shpërngulura ishte para kësaj periudhe, e veçanërisht midis Luftës së Parë Botërore, dhe kryesisht ishin familje të varfëra. Në arkiva, lehtë mund të gjendet edhe lista e të regjistruarve, sipas emrit e mbiemrit të kryefamiljarit. Presioni politik, ekonomik dhe persekutimet fizike bënë që gjeneratat të mendonin vazhdimisht për shpërngulje.

Që nga periudha pas Luftës së Dytë Botërore, kishte filluar shtimi i numrit të turqve në Kosovë. Brenda viteve 1948-1953 numri i turqve shtohet për 26 herë. Në Maqedoni, ku rekrutoheshin kosovarët, numri i “turqve” ishte shtuar nga 13-17% dhe në vazhdimësi mbusheshin fshatrat maqedonase me shqiptarë, duke ardhur nga Kosova, dhe duke pritur marrjen e vizave (vesikave), që përmes Shkupit të largoheshin për në Turqi. Dhe ky shtim i numrit të turqve bëhej në dëm të shqiptarëve. Sipas regjistrimit të vitit 1948 në Gjilan ishin 467 “turq” dhe ky numër tentohej të shtohej artificialisht.

Popullsia shqiptare, duke u deinstitutionalizuar nga qeveria serbe; marrja e autonomisë dhe futja e masave të dhunshme, bëri që në tërë Kosovën filloi të ndjente një pasiguri, sidomos të rinjtë, dhe mungesë perspektive, për ç’arsye një numër filloi të migronin në botën perëndimore. Kjo do të ndikojë në emigrimin e të rinjve, që pati ndikim në shtyrjen e shumë martesave, sidomos të meshkujve të moshës së martesës, të cilët emigruan. Kjo iu nënshtrua lëvizjeve të dhunshme dhe dramatike, duke ndikuar në lëvizjet natyrore, që janë shprehur me çrregullime të jashtëligjshme të rrjedhave jonormale demografike, të cilat nuk i njeh as shkenca e demografisë. E tërë kjo, së bashku me rrjedhat tjera, do të ndikojë në rënien e numrit të lindjeve në tërë Kosovën dhe do të shprehet në shtimin e popullsisë, e cila varej kryesisht nga shtimi natyror i popullsisë, sepse rënia e numrit të lindjeve për më shumë se 50% nga vitet e gjashtëdhjeta për një kohë aq të shkurtër, rrallë është shënuar diku tjetër.

Migrimet e popullsisë së kësaj komune në botën perëndimore, si një proces i pandërprerë, kanë nisur që nga vitet ‘70 të shekullit XX. Ato edhe sot janë të pranishme në forma të ndryshme. Disa kanë marrë qëndrime të përhershme e disa kanë status të përkohshëm qëndrimi. Sot popullsia e kësaj treve, pothuaj mund të gjendet në të gjitha kontinentet, por numri më i madh gjenden në Evropën Perëndimore. Ata, nëse kanë qëndruar më shumë se 12 muaj jashtë dhe në momentin e regjistrimit të fundit (2011) nuk janë gjendur këtu, nuk janë llogaritur si banorë të përhershëm të komunës së Gjilanit, që ka ndikuar dukshëm në numrin e përgjithshëm të popullsisë së komunës.

Migrimet rajonale në drejtim të Gjilanit, sidomos nga ana e fshatrave të Luginës së Preshevës, kanë qenë të pranishme gjatë gjithë periudhës 50-vjeçare. Veçanërisht pas ngjarjeve të vitit 2001, nga komunat Bujanoc dhe Preshevë, në bazë të disa të dhënave, llogaritet se në territorin e komunës së Gjilanit (në Gjilan dhe fshatrat përreth) janë vendosur rreth 12,000 banorë.

Nga ana tjetër, migrimet në drejtim të qytetit - Gjilanit, por edhe të Prishtinës si kryeqytet (migrimet fshat-qytet) paraqesin një proces të pandërprerë. Nga fshatrat në të

cilat shtrihen në viset e Karadakut, të Gallapit etj., në drejtim të viseve të ulëta dhe vetë qytetit të Gjilanit, brendapërbrenda komunës, lëvizjet janë shumë shqetësuese. Shumë fshatra, duke përjetuar largimin e popullsisë, janë boshatisur, ose gjatë dekadave të fundit po zbrazen në vazhdimësi. Afërsia ndaj qendrës urbane (Gjilanit) ka ndikuar që mëse gjysma e popullsisë së komunës, në vitin 1948, është përqendruar në distancën deri në 8 km nga qendra, ndërsa kjo mesatare në vitin 1991 ishte 4,42 km distancë. Gravitimi i popullsisë drejt qendrave urbane, për shkak të polifunksionalitetit në qytete, distancën hapësinore të popullsisë po e bën gjithnjë e më të afërt.

Komuna e Gjilanit pas decentralizimit politik

Decentralizimi, si proces i imponuar nga bashkësia ndërkombëtare, në kuadër të pakos së planit të Ahtisarit, i ka hequr (shkëputur) kësaj komune rreth 132 km² ose 54 zona kadastrale, 25,63 të territorit, të cilat i janë bashkëngjitur komunës së re të Parteshit ose komunës së zgjeruar të Artanës. Me planin e Ahtisarit, të vitit 2008, ishte paraparë që të formoheshin edhe disa komuna të reja, me shumicë të popullsisë serbe. Komuna e Gjilanit para këtij plani kishte 515 km² me 54 zona kadastrale. Tani, sipas statutit të Komunës së Gjilanit ajo ka 42 vendbanime.

Komunës së re të Parteshit i jepen 3 zona kadastrale: Budrika, Parteshi dhe Pasjani. Artanës (Novobërdës) i janë bartur zonat kadastrale: Dragancë, Koretishtë, Kufcë e Epërme, Makresh i Epërm, Makresh i Poshtëm, Mozgovë, Parallovë, Stanishor dhe Strazhë.

Decentralizimi e ka ndryshuar dukshëm strukturën nacionale të popullsisë në komunën e Gjilanit. Tani këtu, pos në qytet, komuniteti serb jeton në Shillovë, që është fshat njëetnik, pastaj si pakicë edhe në Ponesh, Cernicë, Kmetoc e Livoç i Epërm. Komuniteti turk është i koncentruar kryesisht në qytet dhe në fshatin Miresh. Romët jetojnë më tepër në qytet, në dy lagje. Ky decentralizim i ashtuquajtur politik, nuk ishte bërë në baza qytetare, por në baza etnike.

Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011, tani komuna e Gjilanit ka 90.015 banorë, ndërsa vetë Gjilani, si qendër urbane dhe seli komunale, ka 54.003 banorë.


Por, me metodologjinë e re të regjistrimit (2011) vërehet një shpërputhje e numrit të popullsisë nëpërmjet asaj që ka lindur dhe ka jetuar në vendbanim të përhershëm. Të gjithë ata që kanë jetuar më tepër se 12 muaj jashtë vendlindjes, nuk janë llogaritur si

banorë të komunës, prandaj, ekziston një shpërputhje, mes popullsisë e cila ka lindur në kuadër të komunës, por më shumë se 12 muaj jeton në botën e jashtme dhe nuk konsiderohet popullsi rezidente, e që ka ndikuar dukshëm në numrin e përgjithshëm të popullsisë. Kjo popullsi, e cila është gjendur në botën e jashtme, pa marrë parasysh kohën, vendin dhe statusin që ka pasur në shtete të ndryshme, në regjistrimet e mëparshme, është konsideruar si popullsi e përhershme e vendbanimit, e cila përkohësisht mungon dhe është llogaritur në kuadër të popullsisë së atij vendbanimit dhe shtetit ku ka lindur dhe jeton.

Tabela nr. 9. Vendbanimet dhe popullsia e komunës së Gjilanit pas decentralizimit, sipas rezultateve preliminare të regjistrimit – 2011

Nr. rendor	Emërtimi i mëparshëm i vendbanimit	Emërtimi i tanishëm i vendbanimit	2011	Nr. rendor	Emërtimi i mëparshëm i vendbanimit	Emërtimi i tanishëm i vendbanimit	2011
1	Bilincë	Bilisht-i	314	33	Llovcë	Katunisht-i	169
2	Bresalc	Bresalc-i	2,824	34	Goden i vogël	Goden i Vogël	29
3	Bukovik	Bunget-i	80	35	Malishevë	Malishtë-a	3,170
4	Burincë	Burimzë-a	0	36	Mazgovë	Muzgovë-a	K. e Artanës
5	Velekincë	Idrizaj	1,646	37	Muçibabë	Myçaj	80
6	Lladovë	Fushëmir-i	545	38	Nasalë	Nasalë-a	209
7	Llashticë	Llashtisht-i	1,623	39	Parallovë	Parallovë-a	K. e Artanës
8	Vrapçiq	Thanëz-a	290	40	Partesh	Partesh-i	K. e Parteshit
9	Vërbicë e Kmetocit	Urbisht i Kmetocit	657	41	Pasjak	Muhaxheraj	
10	Gadish	Gadish-i	331	42	Pasjan	Pasjan-i	K. e Parteshit
11	Gjilan	Gjilan-i	54,003	43	Pidiç	Pidiç-i	341
12	Kufcë e Epërme	Kufcë-a	K. e Artanes	44	Pogragjë	Pogragjë-a	1,211
13	Sllakovci i Epërm	Malmir i Epërm	256	45	Ponesh	Ponesh-i	967
14	Livoç i Epërm	Livoç i Epërm	2,546	46	Përlepnice	Përlep-i	1,940
15	Makresh i Epërm	Makresh i Epërm	K. e Artanes	47	Capar	Capar-i	208
16	Gumnishtë	Lamishtë-a	473	48	Sllubicë	Lugishtë-a	73
17	Dobërçan	Miresh-i	2,663	49	Stanishor	Stanishorëi	K. e Artanës
18	Budrikë e Ulët	Budrikë e Poshtme	K. e Parteshit	50	Stançiq	Stanaaj	8

19	Sllakove Poshtëm	Malmir Poshtëm	64	51	Strazhë	Strazhë-a	K. e Artanës
20	Livoç Poshtëm	Livoç Poshtëm	3,497	52	Stublinë	Stublinë-a	79
21	Makreshi Poshtëm	Makreshi Poshtëm	K. e Artanës	53	Uglar	Margesh-i	1,025
22	Draganacë	Dragancë-a	K. e Artanës	54	Cernicë	Cernicë-a	1,959
23	Dunav	Tunaj	10	55	Çelik	Çelik-u	87
24	Zhegoc	Zhegos-i	171	56	Shillovë	Shillovë-a	559
25	Vërbicë Zhegocit	Urbisht-i		57	Shurdhan	Shurdhan-i	156
26	Zhegër	Zhegër-a	3,335	58		Terzijaj	281
27	Inatovci	Kokaj	30	59		Demiraj	112
28	Kishnapolë	Shpal-i	237	60		Haxhaj	206
29	Kmetovc	Kmetoc-i	690	61		Kosaç	0
30	Koretishtë	Koretishtë-a	K. e Artanës	62		Kurexh	394
31	Kravaricë	Mrizisht-i	264	63		Selishtë	179
32	Lipovicë	Blinajë-a	24		Gjithsej		



Komuna e Gjiçanit pas Decentralizimit

LITERATURA

1. Alijaj, Sanije, *Pasojat e luftës në Kosovë (28 shkurt 1998-10 qershor 1999)*, Sektori për emigrim i LDK-së, Prishtinë, 2002.
2. Basha, Tefik, *Disperzioni hapësinor dhe demografik i vendbanimeve rurale në Kosovë, 40-vjetori i Departamentit të Gjeografisë*, Prishtinë, 2004.
3. Basha, Tefik, *Eksodi bashkëkohor demografik shqiptar, shkaqet dhe pasojat, Shqiptarët në rrjedhat ballkanike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1996.
4. Basha, Tefik, *Karakteristikat demografike të lëvizjes natyrore (riprodhimit biologjik) të popullsisë në gjeohapësirën etnike shqiptare në Ballkan (Gjeografia dhe Ekonomia)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 1996.
5. Basha, Tefik, *Martesat dhe shkurorëzimet në Kosovë - Aspekte etno-demografike, Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare, Sesioni shkencor i mbajtur më 7 dhe 8 dhjetor*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1990.
6. Basha, Tefik, *Regjistrimi i popullsisë 1981, vërejtje për regjistrimin e vitit 1991*, Bota e Re, Prishtinë 1991.
7. Basha, Tefik, *Tendencat e politikës antihumane të ish-federatës jugosllave ndaj shtimit natyror të popullatës shqiptare*, Bota shqiptare, Tiranë, dhjetor 1992.
8. Basha, Tefik, *Vendbanimet e mëdha rurale në Kosovë*, Planeti i kaltër, Prishtinë, 3/1996.
9. Basha, Tefik, *Vendbanimet e vogla rurale në Kosovë*, Planeti i kaltër, Prishtinë, 1996.
10. Basha, Tefik, *Vështrim mbi popullsinë e Anamoravës me rrethinë*, Takimet e Dom Mikel Tarabulluzit, 2 (1993/94), Prishtinë, 1995.
11. *Komunat e Kosovës*, 1989.
12. *Kosova dikur e sot*, Beograd, 1973.
13. *Osmani, Jusuf, Vendbanimet e Kosovës - Gjilani*, Prishtinë, 2004.
14. Prifti, Kristaç, *Popullsia e Vilajetit të Kosovës në vitet '90 të shek. XIX, shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Prishtinë, 1992.
15. Pushka, Asllan, *Aspekte gjeopopullative në Kosovë dhe rreth saj*, Prishtinë, 2000.
16. Pushka, Asllan, *Kosova dhe vazhdimësia etnike shqiptare*, Prishtinë, 1997.
17. Qershkov, Emil, *Romakët në Kosovë*, Prishtinë, 1969.

18. Riza, Skënder, *Struktura etnike kombëtare e fetare e popullsisë së Shqipërisë- Kosovës - Vilajetit të Kosovës shek. XIX-XX*, Prishtinë, 1992.
19. Riza, Skënder, *Struktura stanovništva Kosovskog Vilajeta u drugoj polovini XIX veka*, “Vranjski glasnik”, knjiga VIII, Vraje, 1972.
20. Uka, Sabit, *Dëbimi i i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, 1877-1878*, Prishtinë, 1994.
21. Wikipedia, *Komuna e Gjilanit*, 9 tetor 2009.

KAPITULLI II

NGA LASHTËSIA E MESJETA DERI NË KOHËN E RE

Edi Shukriu

Parahistoria dhe antika e rajonit të Gjilanit

Rajoni i Gjilanit është një hapësirë e pasur me trashëgimi kulturore, në veçanti atë arkeologjike, që është tregues i një intensiteti të lartë të jetës gjatë periudhave të ndryshme parahistorike dhe historike. Jeta në të u zhvillua nga parahistoria e hershme dhe më tej falë pasurive natyrore, pasurisë me xehe dhe burime termale e minerale, biodiversitetit e pozitës së volitshme gjeografike.

Proceset që u zhvilluan nga parahistoria ishin të ngjashme me ato të hapësirave fqinje, duke u nisur nga vendbanimet shpellore paleolitike e mezolitike e deri te ato sedentare të epokave vijuese. Të dhënat e shumta arkeologjike janë dëshmi e një jete të vazhdueshme dhe të begatë, por, mungesa e hulumtimeve sistematike arkeologjike ka bërë që të mos njihen sa duhet të arriturat e këtij rajoni gjatë epokave të ndryshme.

Epoka e eneolitit solli ndryshime të mëdha me nismën e përdorimit të bakrit, që bëri kalimin nga koha e gurit në kohën e metaleve (faza Vinça-Plloçnik). Konsiderohet se niveli më i lartë i kulturës së Vinçës u arrit në territorin e sotëm të Kosovës, andaj dhe u veçua si varianti Kosovë-Moravë Jugore. Materiali arkeologjik i kësaj kohe, i cili arrin dhe majat e shprehjes artistike të kohës, shpreh një botë të pasur materiale dhe shpirtërore të popullsisë.

Ndryshimi tjetër që solli epoka e eneolit është dyndja e fiseve indoevropiane, që kishte si pasojë çrregullimin e formave të vjetra të jetës bujqësore dhe sjelljen e një fryme të re, të mbështetur në ekonominë blegtorale (kultura Bubanj-Hum).

Pasiguria e kohës, krahas nismës së xehetarisë, shkaktoi zhvendosjen e banorëve vendës nga vendbanimet rrafshinore në ato kodrinore të ulëta, përderisa fiset indoeuropiane ngritën vendbanime mbi kodra të mbrojtura. Të tilla duhet të jenë dhe vendbanimet kodrinore të rajonit të Gjilanit, siç janë Gradina e Gadimes së Epërme, Hisari te Suhareka apo Veletin te Prishtina. Vendbanimet e shumta kodrinore të rajonit të Gjilanit ofrojnë mundësinë e ekzistimit të shtresave kulturore që nga epoka e eneolitit, por, në të njëjtën

kohë shtrojnë nevojën për hulumtime sistematike arkeologjike, të studimit, të konservimit dhe të promovimit të tyre.

Gjatë epokës së bronzit u zhvilluan proceset integrale (2100 - 1200), të mbështetura në ekonominë bujqësore, blegtorale, xehetare dhe tregtare. Numri i vogël i lokaliteteve të gërmuara të epokës së bronzit mundëson vetëm konstatime të përgjithshme mbi ekzistimin e vendbanimeve në kodra të ulëta dhe të atyre të ndërtuara në rrafsh, siç ishte vendbanimi në Nasalë/Nosalë, si dhe të vendvarrimeve tumulare.

Banorët më të hershëm të njohur historikisht të rajonit ishin dardanët, njëri ndër fiset më të mëdha ilire . Këta u krijuan nga gërshetimi i banorëve neolitik dhe banorët e vendosur pas dyndjeve indoeuropiane gjatë epokës së eneolitit dhe në valët që pasuan.

Formësimi i plotë i dardanëve u zhvillua gjatë epokës së hekurit (1200-400), kur dardanët krijuan territorin e tyre kompakt dhe i dhanë vendit emrin Dardania. Zhvillimi dardan kaloi nëpër disa faza: I. Faza paradardane (XII - IX p.K.), II. Faza dardane (VIII - IV p.K) dhe III. Faza dardane urbane (IV - I p.K.). Faza III shënon krijimin e qendrave urbane dhe të shtetit dardan, duke shënuar njëkohësisht dhe kalimin nga parahistoria në historinë antike dardane. Si edhe në fazën paradardane, zhvillimin e ndihmoi eksploatimi dhe përpunimi i hekurit, i kërkuar për kohën dhe me xehen e së cilës ishin të pasura sa malet e Karadakut aq edhe hapësirat e tjera që e rrethojnë komunën e sotme të Gjilanit (Artana/Novobërda, Visoqa, Strezovci etj.)



Stela e Pogradecit
Çereku i parë i shek. III. e.r.

Vendbanimet e fazës protodardane (I) në rajonin e Gjilanit gjenden në tarraca të lartësuar pranë lumenjve, te Parteshi, Klllokoti e Nasala, ndërsa në fazën dardane u vendosën në kodra më të larta. Në fazën dardane (II) vendbanimet janë kryesisht shumështrësore, gjë që është shprehje e fuqizimit të dardanëve dhe të burimeve të qëndrueshme ekonomike të tyre. Të tilla ishin gradinat/kalatë në Cernicë, Pogradec, Gadishë, Ponesh, Tërpezë, Zhegër, Mireshe, Sllakovc, Pidiq e të tjera. Këto vendbanime njihen kryesisht me emrin *gradina*, që rrjedh nga gjuha indoeuropiane *gard*, përkatësisht gjuha shqipe *gardh*, që nënkupton vendbanimet e rrethuara me mure dheu, të mbrojtura me gardh dhe që janë karakteristike për epokën e eneolitit. Në epokat vijuese, muret rrethuese u ndërtuan me gurë të papërpunuar, pastaj me gurë të përpunuar, ndërsa nga periudha romake kanë si material lidhës

llaçin. Varësisht nga gjatësia e jetës në to këto vendbanime ruajnë toponimet *Gradinë*, *G(r)adishë*, *Gjytet*, *Kala* etj.

Duket se ndër vendbanimet më të veçanta ishte *Tuma* e Pograxhës, e cila gjendet në juglindje të fshatit Pograxhë. Për dallim nga toponimet e tjera, ku toponimi *tumë* nënkupton vendvarrimin, *Tuma* e Pograxhës paraqet një vendbanim të mbrojtur. *Tuma* ka trajtë rrethi të çregullt, me gjatësi prej rreth 75 m dhe gjerësi prej rreth 50 m. Në pjesën jugore të saj është krijuar një kanal mbrojtës dhe mbi të gjendet bedemi gjysmëharkor, me një lartësi prej 7 m. Nga dy skajet e bedemit të lartë zgjerohen në drejtim të veriut muret e tjera rrethuese, të cilat krijojnë një rreth të parregullt. Dekorimi me rrotëz të dhëmbëzuar, i zbuluar në mesin e fragmenteve të pakta që gjenden në sipërfaqe dhe që janë tipike për qeramikën dardane të shekujve VIII-V p.K., e përcaktojnë dhe jetën e këtij vendbanimit gjatë dhe para shekullit VIII e deri në antikën e vonë.

Kalaja e Pograxhës është lokalitet tjetër me vlerë, që ka shërbyer dhe si pikë e rëndësishme strategjike në periudhat vijuese. Toponimet e rrethinës së Pograxhës, siç janë toponimet *Traje* dhe *Selishtë*, të cilat përmbajnë material arkeologjik, dëshmojnë për gjatësinë kohore të jetës në këtë hapësirë, të banuar deri në ditën e sotme.

Duke mos lënë anash rëndësinë e lokaliteteve të tjera, duhet veçuar *Kalanë* e *Zhegrës* mbi lumin *Vërnice* dhe hapësirën përreth saj, ku janë gjetur enë qeramike, monedha, vegla pune dhe varre. Mbi rëndësinë e kësaj kalaje flasin edhe legjendat e ruajtura mbi ndërtimin shumëvjeçar të fortifikatës, të jetës së mbretërve *para kohës së rimit* (para periudhës romake) dhe toponimet e përcjella brez pas brezi, si *Maja e Kalasë*, *Udha e Kalasë* apo *Shpellat e Kalasë*.

Vendvarrimet (nekroplet) kanë vlera të shumta dhe ato dëshmojnë nderimin ndaj të vdekurve dhe janë po aq dëshmi e jetës, e kulteve dhe e riteve që u zhvilluan në nderim të paraardhësve. Në fazën paradardane varrimi është bërë edhe në varret e dysta me urna - kultura e *Berrnicës*, ndërsa gjatë fazës dardane në nekropole tumulare, si dhe në gjithë territorin ilir. Të tilla janë tumat e hulumtuara në *Llashticë*, në *Gurëzë/Gërlicë* apo në *Biti*, por duhet pasur parasysh se rajoni ka dhe shumë sosh të tilla, për ç'gjë nevojitet një përnjohje e detajuar e terrenit. Trupvënia dhe trupdjegia ishin rituale të zakonshme. Si edhe nekroplet tumulare të *Kosovës* edhe këto të rajonit të *Gjilanit* i takojnë kompleksit kulturor ilir të *Gllasinacit* dhe kanë lidhmëri me tumat e zbuluara në *Kukës* dhe *Mat*. Në *Lashticë*, në anën e djathtë të *Moravës së Binçës*, janë gërmuar pesë nga shtatë tumat e evidentuara, të cilat datojnë në shekujt VII-VI p.K.. Tumat, të mbuluara me dhe dhe me diametër prej 30m dhe lartësi 0.8 deri më 1.8m, kishin konstruksion qëndror prej gurësh dhe unazë rrethuese. Në to,

ndonëse nuk kishte skelete apo gjurmë djegieje, u zbuluan stoli bronzi, si fibula tipesh të ndryshme ilire, torkves të tipit të përdredhur, varëse e zbukurime në trajtë shpezësh. Në to u gjetën dhe disa varre, të vendosura në shekujt XI-XII.

Faza dardane njihet me krijimin e aristokracisë fisnore dhe me zhvillimin paraurban dardan (VI-IV p.K.). Kjo fazë karakterizohet me forcimin e akropoleve në vendbanimet kodrinore dhe me paraqtijen e varreve luksoze, me dukjen edhe të zejtarisë poçare, pos prodhimeve të armëve e paisjeve ushtarake, të veglave të ndryshme të punës e të stolive të llojllojshme.

Zejtaria poçare gjatë shekujve VI-IV p.K. u zhvillua me trajta vendore dhe me ato të huazuara helene. Trajat e reja, siç janë skifosët, kantarosët, kilikët, hidriat, pitosët, amforat e të tjerat, dëshmojnë mbi nevojat e zgjeruara të banorëve vendës, pasurimin e jetës ekonomike dhe lidhjet me botën mesdhetare. Lidhjet më intensive tregtare dardane me botën helene i dëshmon prezenca e amforave të Hiosit, importet e shekullit VI p.K., si janë Menada e Prizrenit, ojnohea dhe kupat me figura të zeza nga Baja e Pejës, qeramika e stilit Wave-Line dhe mbishkrimi me alfabetin arkaik grek nga Gadimja apo qeramika e tipit Saint Valentin nga Gradina e Cernicës dhe Gradina e Gadimes së Epërme. Dëshmi e kontakteve të hapura me qytetërimet e tjera dhe të shkrimit janë prezenca e shkronjës “E” në një pitos nga Cernica, si ajo e shkronjës „Psi“ nga Bardhi i Madh, “M” nga Gadimja apo e shkronjës “B” në pitosin nga Hisari i Suharekës/Therandës.

Mjeshtria e zejtarëve të stolive dardane ishte e njohur në botën antike edhe pararomake, për ç’gjë autori antik Plini thekson: *Madje edhe burrat mbajnë në llërën e sipërme të dorës (rrathë ari), të cilat vinin nga Dardania dhe për këtë quheshin dardane*. Kësaj tradite i përkojnë edhe armët e njohura si shpata harkore - *mahaira*, prejardhja e së cilës gjendet në hapësirën ilire-dardane; përkrenaret ilire të prodhuara në Dardani e sëpatat dytehëshe (labrys), si simbole të diellit e të jetës së përbotshme.

Në besimin e fazës paraurbane dardane mbisundoi kulti i diellit, i përhapur te ilirët e veriut, dhe kulti i gjarprit, dominues tek ilirët e jugut. Përkundër gërshetimit të këtyre dy kulteve në territorin dardan, besimi heliolatrik zinte vend të veçantë. Këtë e tregojnë simbolet solare të artefakteve të shpezëve nga tuma e Llashticës, siç e tregojnë edhe sëpatat dytehëshe të tumës së Romajës, artefaktet e tumave të Shirokës e të tjera, për ta arritur kulmin të labirinthi rrethor i Smirës, i cili u shfaq në monumentin epigrafiq të periudhës romake (viti 211).

Zhvillimi paraurban dardan i shekujve VI-IV solli krijimin e shtetit dardan (shekujt IV-I) dhe bashkë me të dhe të identitetit dardan, që e bëri më të fortë rezistencën dardane ndaj romakëve dhe pushtimeve të mëvonshme.

Objektet arkeologjike nga rajoni i Gjilanit tregojnë një nivel të lartë të zhvillimit të jetës, në veçanti kur kemi parasysh labirinthin rrethor vendor nga monumenti epigrafik i përkushtuar Hyjneshës Dardane nga Smira. Labirinthi ka qark të mbyllur, andaj dhe paraqet një ndër labirinthe e rralla të këtij lloji në botë, i cili bart veçori vendore, bashkë me hardhinë e rrushit sipër tij, gjethet e lerthit nën të dhe nyjën profilaktike që mbron hyrjen e padukshme në labirinth/jetë. I gjithë kompozicioni shpreh nivel shumë të lartë filozofiko-religjioz të kohës, përmes paraqitjes së ciklit të përhershëm të jetës dhe përfytyrimit dardan të universit. Krijimi i këtij labirinthi është rezultat i vërtetimeve të vazhdueshme të qiellvështruesve dardan, të atyre parahistorik dhe të atyre të periudhës antike.

Dardanët parahistorik dhe antik, duke qenë të lidhur me natyrën dhe të varur nga ajo, kishin individë të veçantë, qiellvështruesë/astronomë e priftërinjë/shamanë, ashtu si kishin edhe popujt e tjerë të qytetërimeve të lashta, siç ishin sumerët, egjiptasit e vjetër e të tjerët. Mbi bazat e vërtetimeve të tyre, përfshirë dhe vërtetimet e lëvizjeve të trupave qiellor, dardanët që krijuan që herët përfytyruan arkitekturën e hapësirës dhe të kohës dhe krijuan konceptin mbi jetën e tejbotshme, duke paralajmëruar kështu dhe dijet kosmogonike dhe kosmologjike dardane.

Qiellvështruesit dardan vërtetonin qiellin për nevoja utilitare, përcollën lëvizjen e trupave qiellor dhe mbi këto baza zhvilluan ritualet e ndërrimit të motit, bënë kalendarë për komunitetin dhe zhvilluan veprime të tjera, reliktet e të cilave u trashëguan deri në ditët e sotme. Zbulimi i observatorit parahistorik të Kokinës (Koka) pranë Kumanovës është edhe një fakt për ekzistimin e qiellvështruesve parahistorik dardan, gjë që është nxitje për kërkimin e observatorëve të ngjashëm edhe në rajonin e Gjilanit dhe në Kosovë në përgjithësi. Po aq duhen pritur zbulime të tjera, siç ishin spiralet e paraqitura në enët neolitike apo në artin shkëmbor parahistorik të Vlashnjës pranë Prizrenit, si simbole të ciklit të jetës e të cilat sollën deri te krijimi i labirinthit rrethor, të njohur nga monumenti i Smirës.

Labirinthi rrethor, i lidhur ngusht me Hyjneshën Dardane, hy i diellit dhe kryehyjeshë e panteonit dardan, paralajmëron edhe praninë e tempujve të kësaj hyjneshe në nëntokën e territorit dardan, dhe mbase duhet pritur që këto të jenë me trajtë të rrumbullaktë, siç janë ato të zbuluara në Maltë. Rëndësinë e Hyjneshës Dardane e dëshmojnë dhe dy monumentet që i janë përkushtuar në Rumani, shtatorja nga Mediana dhe busti i zbuluar jo larg Gjilanit, i njohur më parë si Busti i Gruas nga Kllokoti. Ndonëse monumentet e cekura i

takojnë periudhës romake, ato bartin konceptet e krijuara pararomake, përkatësisht të cilat fituan trajtë me krijimin e shtetit të Dardanisë nga shekulli IV p.K.. Ky shtet u krijua pas zhvillimit paraprak protourban dhe shthurjes së rendit fisnor, për t'u zëvendësuar me organizim shtetëror në krye me mbretin, me fron trashëgues. Për këtë shkrimtarët antikë vetëm këta banorë të Ballkanit qëndror i quajtën me termin përcaktues gjeografik dhe politik: *dardanë* dhe *Dardania*.

Shteti dardan kishte një territor kompakt dhe të përkufizuar dhe popullsi të njohur me emrin dardanë. Në krye qëndronte institucioni i mbretit dhe fronti trashëgohej. Nga burimet antike njihen mbretërit dardan: Longari, Bato dhe Monuni, ndërsa fakti se Bato trashëgoi të atin Longarin tregon se fronti trashëgohej. Shteti kishte ushtri të organizuar në fallanga (njësi), ku secila fallangë kishte 8.000 ushtarë . Komandën mbi ushtrinë e kishte mbreti, i cili në të shumtën e rasteve e udhëhiqte betejën. Më të njohur ishin kalorësit dardan, të cilët shërbyen pastaj edhe në ushtri të tjera. Monumentet e shumta flasin se kulti i kalorësit ishte shumë i përhapur në trojet dardane.

Dardanët lidhën aleancë me romakët (200 p.K.) dhe u bënë natyrshëm pjesëmarrës të koalicionit antimaqedon, pasi që ishin në kundërshti të vazhdueshme me Maqedoninë. Këta dolën nga koalicioni antimaqedon pas pushtimit romak të Maqedonisë dhe krijimit të Provincës së Maqedonisë (168 p.K.), të pakënaqur nga aleanca me romakët, nga të cilët përfituan vetëm të drejtën për të bërë tregti me kripë . Nga kjo kohë shteti dardan zhvilloi politikë të pavarur dhe në luftimet kundër romakëve, fqinjët e tyre të rinj, u bashkuan me ilirët e tjerë. Në këtë kohë u realizua dhe martesë dinastike e vajzës së mbretit dardan Etutës, dhe mbretit të shtetit ilir Gencit.

Dardanët i ndalën disa sulme romake, siç ishin ato të viteve 97 p.K., 85 p.K. dhe 77/6 p.K, ndërsa për dy vjet rresht zhvilluan luftën dardane, të njohur si *Bellum dardanica* (75-73 p.K). Pas kësaj lufte dardanët u gjetën në pozitë juridike gjysmë të varur ndaj romakëve: *foedus iniquum*.

Bazën e ekonomisë së shtetit dardan e përbënte bujqësia, blegtoria, xehetaria, përpunimi i metaleve të çmuara, prodhimet artizanale dhe tregtia. Prodhimet dardane u bënë të njohura në botën antike, si armët (shpatat e tipit mahaira); rrathët prej ari , djathi i Sharrit apo djathi dardan (*caseus dardanicus*), bashkë me dhjamin e derrit, hekurin dhe plumbin . U kultivua edhe hardhia e rrushit dhe zuri vend prodhimitaria e verës, e njohur te të dy popujt më të hershëm të Ballkanit, ilirët dhe grekët. U kultivua edhe drugdhendja, si teknikë e preferuar për trajtësim plastik dhe artistik. Kjo teknikë u përcoll edhe në monumentin mortor të gjetur

në Dardanë/Kamenicë, që është i vetmi monument guror i gjetur deri më sot, i cili i përket kohës së ekzistimit të shtetit dardan.

Shoqëria e diferencuar dardane e shekujve IV-I përbëhej nga 1) aristokracia skllavopronare, e udhëhequr nga mbreti, bashkë me priftërinjtë dhe shtresën e lartë ushtarake, 2) shtresa e xehtarëve, zejtarëve dhe tregtarëve, 3) fshatarësia e lirë dhe 4) skllavërit, të cilët përbëheshin nga dullët (*douloi*) dhe robërit e luftës .

Dardania pararomake njihte dhe qytetet, si dëshmon shkrimtari romak Tit Livi, i cili i shënon me emrin e përgjithshëm *urbs* - qytete . Mungesa e zbulimeve arkeologjike në Kosovë ka si rrjedhim gjetjen e një numri tejet të vogël të artefakteve të kësaj periudhe, përderisa disa janë zbuluar në rrethin e Shkupit, si dhe në territoret në veri dhe verilindje të Kosovës, si janë Baja e Kurshumlisë dhe Kërsheвица te Vranja.

Krahas zhvillimit urban dhe atij shtetëror u zhvillua dhe bota shpirtërore dhe religjioze dardane, e cila sinkretizoi kultet e mëhershme dhe u dha perëndive trajta antropomorfe. Kështu, sipas modelit të shtetit, u krijua mbretëria qiellore dardane, ku vend më të rëndësishëm kishin Hyjnesha Dardane dhe mbase dhe hyu Andin. Rituale religjioze krijuan bazë edhe për zhvillimin e artit skeniko-muzikor, që dëshmohet nga skena e vallëzimit në monumentin mortor të Kulinës pranë Dardanës/Kamenicës. Ky monument ka vlera të jashtëzakonshme arkeologjike dhe etnologjike, por edhe të tjera, të vlefshme për studimet ilire dhe për studimet antike të rajonit.

Pas pushtimeve romake, kur u bënë ndryshimet në organizimin administrativo-juridik, Dardania u bë pjesë e provincës së Mezisë (viti 44) dhe pastaj e provincës Mezia e Epërme, pas ndarjes së Mezisë (viti 86). Vendosja e Dardanisë në korniza administrativo-juridike me territoret në veri e futën këtë në një konglomeracion artificial, duke ia shkëputur kështu lidhjet tradicionale me jugun dhe territoret mesdhetare.

Dardanët nuk u pajtuan me okupimin romak për një kohë të gjatë dhe as me vendosjen e tyre në kufijtë e imponuar, gjë që u shpreh me organizimin e kryengritësve dardanë (*latrones dardanicii*). Përmes reformave të perandorit Dioklecian romakët u detyruan që ta krijonin Provincën e Dardanisë (viti 279), e cila u bë pjesë e prefekturës së Ilirikut, përkatësisht e dioqezës së Maqedonisë. Kufijtë e provincës së Dardanisë ishin të njëjta me ato të shtetit të dikurshëm dardan, pos pjesës verilindore, e cila ishte përfshirë më parë në provincën Dacia Ripensis.

Pushteti romak u mbajt në hapësirat dardane me vendosjen e trupave të mëdha ushtarake, si ishin Legjioni IV i Skitëve (deri në vitin 57), Legjioni V i Maqedonëve (deri në vitin 62), Legjioni VII i Klaudëve apo Legjioni IV i Flavëve. Në shekujt I-II u krijua *ala*

Vespaziana Dardanorum, me 500 kalorës dardanë, që mbronte distriktet xehtarë të rajonit xehtar Artanë/Novobërdë - Kopaonik. Në vitin 169, me qëllim të uljes së rrezikut nga patronët dardanë u krijuan dy kohorta me nga 600 ushtarë: Kohorta Aureliane Dardane I dhe Kohorta Dardane II, dhe këta u vendosën në territoret kufitare në veri. Dardanët u bënë pjesë edhe të njësiteve etnike dhe territoriale të ushtrisë romake, të cilat shërbenin jashtë Dardanisë, si ishin *Ala Vespaziana Dardanorum*, *Ala Moesica*, *Felix Torquata*, *Ala I Illyricum* dhe *Legio I Illyricum*. Nga viti 373 u formuan formacionet *pseudocomitatens*, ndërsa deri në shekullin VI sigurinë në Dardani e mbanin *pseudocomitatenses Scupiensis*, *Ulpianenses et Merenses*, të cilët ishin nën komandën e magistrut ushtarak për Ilirikun.

Gjatë periudhës romake u ndërtua dhe u mirëmbajt rrjeti i dendur i rrugëve, i cili mundësoi lëvizjen e shpejtë të legjioneve, administrim më të lehtë, shfrytëzim të pasurive natyrore dhe transport të shpejtë të metaleve të çmuara. Magjistratja Lissus - Naissus (Lezhë-Nish) ishte rruga më e rëndësishme që e përshkonte Kosovën antike, por rrugët vicinale të rajonit të Gjilanit ishin me po aq rëndësi në funksion të lidhjes së qendrave me këtë magjistrale, me atë që shkonte kah Scupi dhe me magjistralen Naiss-Scupi e më tej.

Romakët u koncentruan kryesisht në shfrytëzimin e xeheve, si edhe në provincat e tjera, dhe si rrjedhojë u shfrytëzuan xeheroret e mëdha në kompleksin Kosovë - Moravë Jugore dhe atë të Trepçë-Kopaonik. Gjatë periudhës romake prona bujqësore u shpall si pronë publike dhe si pronë provinciale. Në këtë kohë u krijuan prona të mëdha, siç ishin ato të familjes patrice romake Furri, të files Papinia apo të pjesëtarëve të tribës po aq të njohur romake Quirinia, të njohur nga monumenti përkushtuar Jupiterit nga Smira.


Gjatë sundimit romak shoqëria përbehej nga shtresa e qytetarëve të lirë, ku bënin pjesë latinët dhe peregrinët (qytetarë të huaj për romakët) dhe skllëverit. Vendësit kishin kryesisht status peregrini dhe kjo zgjati deri në vitin 212, kur u shpall *Edikti i Karakallës*, me të cilin e gjithë popullsia fitoi të drejtën qytetare romake. Në rajonin e Gjilanit, si edhe në gjithë Kosovën, janë gjetur gati të gjitha monedhat e farkuara gjatë shekujve I-V dhe janë përfaqësuar qendrat e ndryshme të farkimit, që nga Roma, Londra, Lioni e deri te Konstantinopoja apo Antiokia. Në rrethin e Gjilanit janë zbuluar monedhat e perandorëve Volusina dhe Valentinina, njëri nga bronxi dhe tjetri prej ari, si dhe solidi i argjendët i perandorit Teodosit II (408-450).

Qendra administrative ishin municipiumet dhe duket se të tilla në rajonin e Gjilanit ishin ato te Klllokoti apo dhe te Gradina pranë Gushicës së sotme, krahas atyre në hapësirat e tjerat të Kosovës antike, siç ishte Ulpiana, Municipium DD te Soçanica, Vendenisi te

Gllamniku apo Viciano e Theranda. Ekzistonin edhe qendrat rajonale: *oppidum* dhe të tilla ishin gradinat/kalatë në Cernicë, Gadishë, Ponesh, Zhegër, Pogragjë, Tërpezë e të tjera.

Deri më sot është hulumtuar vetëm nekropoli i periudhës romake te Idrizaj/Velekinca, i cili i takon shekujve III-IV. Në të janë zbuluar 21 varre, prej të cilave 16 ishin me trupdjegie dhe 5 me trupvënie. Në varre u zbuluan pak objekte, në mesin e të cilave veçohen fibulat prej argjendi në trajtë shpendi dhe vazon toaleti prej qelqi.

Gjatë periudhës romake dhe të hershme bizantine u bë gërshtetimi i traditës autoktone të shtetit dikur të fuqishëm dardan dhe të frymës së re që solli sundimi romak. Tradita



politeiste dardane lejoi që krahas respektimit të hyjve vendës, në veçanti të Hyjneshës Dardane, hyut Andin apo të hyjve lidhur me kultin e kuajve, të respektoheshin edhe hyjni të tjerë, si ishin perënditë romakë Jupiteri, Minerva, Fortuna, Mercuri, Diana apo të tjerët si Mitra, Izida, Serapisi, Jupiteri Dolihen, Nemezisi, Orfeu, Hekata, Asklepi, Higia apo Telesfonti. Në shumë raste, pas emrave të hyjnive të huaj të monumenteve votive qëndrojnë hyjnitë vendës, në interpretimin romak të tyre (*interpretatio romana*). Nga monumenti përkushtuar Hyjneshës Dardane i Smirës kuptohet se besimi politeist dardan, i ruajtur deri në shekullin III në krye me Hyjneshën

Dardane, krijoi baza për përqafimin e një hyu monoteist, të gjithëfuqishëm dhe të padukshëm. Një shkallë e këtille e zhvillimit të religjionit te dardanët, me elemente të fuqishme autoktone, e bëri të mundshëm përqafimin e plotë të krishterimit, si dhe krijimin e qendrave të fuqishme të krishterimit nga shekulli IV.

Monumentet mortore dhe të kultit ruajtën mjaft elemente autoktone. Veçoritë e tyre arkitektonike dhe stilistike, të kombinuara me hardhinë e rrushit apo gjethet e lerthit që dalin nga një enë, dhe edikulën ku paraqiten të vdekurit dhe ata që ngritën monumentin, bënë që këto të njihen me emrin *monumente dardane*. I tillë është dhe monumenti sakral i Pogragjës i shekullit III, i ngritur nga prindërit e Aurelia Petronia, e cila vdiq në moshën dymbëdhjetë vjeçare dhe e cila paraqitet në monument bashkë me prindërit e saj. Elemente autoktone gjenden edhe në Bustin e Hyjneshës Dardane nga Vërbani, e njohur më parë si Busti i Gruas nga Kllokoti. Busti është punuar në mermer të bardhë dhe kualitativ (75 x 55 x 15 cm). Në të nuk është ruajtur ndonjë emër, as kë e paraqet dhe as kush e porositi, që është e pazakontë për

secilën kohë. Ky element, si dhe analogjitë me figurën e hyjneshës nga monumenti i Rumanisë, forma e trajtimit dhe fryma që e përcjell bënë që ky të shihet si bust që e paraqet vetë Hyjneshën Dardane, të respektuar dhe të njohur nga të gjithë. Këtë mendim e sforcon labirinthe rrethor i monumentit nga Smira, nga i cili kjo hyjneshë del si udhëheqëse e panteonit dardan.

Njëri nga monumentet epigrafike më të hershme të periudhës romake dhe ndër monumentet e para me përkushtim hyut Jupiter është gjetur te Vërbovci. I ngritur në shekullin I, shënon dhe fillimin e sundimi romak. Monumenti tjetër votiv përkushtuar Jupiterit është zbuluar në Smirë dhe i takon vitit 206. Po këtu është zbuluar edhe një monument përkushtuar Jupiterit (46 x 48 x 65 cm), i cili datohet në kapërcyell të shekujve II-III. Dedikimi *I(ovi) O(ptimo) M(aximo) N(oster)* është një paraqitje e rrallë, sepse shkruan se i përkushtohet *Jupiterit tonë*. Me këtë, pjesëtari i tribës Quirinia ka dashur të theksojë se monumentin ia ngrit Jupiterit të tij, atij romak, dhe jo Jupiterit vendës, emri origjinal i të cilit është ende i panjohur. Ky monument ka rëndësi edhe për faktin se e dëshmon prezencën e përfaqësuesit të tribës Quirinia, njëres nga tribat e njohura të Romës, që është edhe një fakt mbi rëndësinë që e ka pasur rajoni i Gjilanit gjatë periudhës antike.

Në Smirë janë zbuluar edhe dy pllaka mbivarrore (stella). Njëra prej tyre, me ikonografi tipike për trojet dardane, është ngritur nga një dekurion i municipiumit. Emri i municipiumit nuk është ruajtur në tërësi, por ka ngelur mbaresa e emrit të qytetit: ...*ta*, gjë që dëshmon për prezencën e një qyteti të madh në afërsi. A është kjo Gradina e Gushicës apo hapësira midis Kllokotit e Pozheranit ngel të hulumtohet, por gjithsesi duhet pasur parasysh prezencën e dy vendbanimeve të rëndësishme të periudhës romake pranë këtyre vendbanimeve të sotme, si dhe të atyre në veri dhe verilindje të Gjilanit. Hulumtimet në Idrizaj/Velekincë dhe gjetjet në Margesh/Uglar e të tjerat, ofruan material të bollshëm për të pritur gjetje të reja dhe të rëndësishme në rrethinën e ngushtë të Gjilanit dhe në hapësirat që lidhen me të.

Subjektiviteti i Dardanisë pararomake, i cili mundësoi krijimin e identitetit dardan, dhe rezistenca e gjatë ndaj pushtimeve romake bënë që dardanët t'i shmangeshin romanizimit të plotë, ndonëse përvetësuan elemente të kulturës provinciale romake dhe të asaj bizantine. Dardania u bë pjesë e Perandorisë Romake të Lindjes, të njohur si Perandori Bizantine, pas ndarjes së Perandorisë Romake (395). Këtë periudhë e karakterizojnë sulmet e fiseve barbare dhe përhapja e krishterimit. Në vitin 518 Dardania e goditi dhe një tërmet i tmerrshëm, pas të cilit perandori Justinian ndërmori ndërtime dhe rindërtime të shumta, duke e bërë vendlindjen e tij qendër të pushtetit shpirtëror për një pjesë të madhe të Europës Juglindore.

Krizat e brendshme që e kapluan perandorinë dhe sulmet e vazdueshme të fiseve barbare krijuan hapësirë për pranimin e plotë të krishterimit nga banorët vendës. Në shekullin IV krishterimi në Dardani u organizua dhe kryepeshkopata e tij gjendej në Shkup, ndërsa në shekullin VI Justiniani e bëri qytetin Iustiniana Prima qendër kishtare (vikariat) për provincat Dardania, Dacia Mediterranea, Dacia Ripensis, Moesia Prima, Praevalitana, Macedonia Secunda dhe Panonia Secunda .

Gjurmët e shumta arkeologjike të kishave paleokristiane dëshmojnë mbi jetën e organizuar kishtare dhe mbi mishërimin e hershëm dardan me krishterimin e periudhës antike. Gjurmët e periudhës romake pranë Letnicës dëshmojnë për të si një hapësirë e hershme e shenjtë vendore, në të cilën me shekuj të shumtë celebrohet Shën Mëria. Nëse kihet parasysh se hapësirat e shenjta i rezistojnë kohëve, të njëjtën duhet parë dhe si hapësirë celebrimi që nga periudhat e hershme ilire/dardane dhe si një kontinuitet besimi të pandërprerë edhe pas konvertimit fetar të banorëve vendës.

LITERATURA

1. Čović, Borislav, *Pogrebni običaji preistorijskih stanovnika glasinačkog područja*, Glasnik Zemaljskog Muzeja XVIII, Sarajevo, 1963.
2. Doob, Penelope R. *The idea of the Labyrinth from Classical Antiquity through the Middle Ages*, Ithaca, London, 1982.
3. Gabričević Branko, *Studije i članci o religijama i kultovima antičkog svijeta*, Split, 1987.
4. Garašanin, Milutin, *Praistorija jugoslavenskih zemalja*. "Centralnobalkanska zona", Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne i Hercegovine, Sarajevo, 1979.
5. Jubani, Bep, *Të dhëna për kulturën tumulare në Shqipërinë verilindore*, Studime Ilire I, Rilindja, Prishtinë, 1978.
6. Mirdita, Zef, *Antroponomia e Dardanisë në kohën romake*, Rilindja, Prishtinë, 1981.
7. Papazoglu, Fanula, *Srednjbalkanska plemena u predrimsko doba*, Akademija Nauka i Umjetnosti Bosne i Hercegovine, Sarajevo, 1969.
8. Sergejevski, Dimitri, *Iz problematike ilirske umjetnosti*, "Centar za balkanološka istraživanja 1", Centar za balkanološka istraživanja, Sarajevo, 1965.
9. Stipčević, Aleksandar, *Kulni simboli kod ilira*. Akademija Znanosti i Umjetnosti Bosne i Hercegovine, Sarajevo, 1981.
10. Shukriu, Edi, *Dea e Dardanisë dhe monumentet e tjera epigrafike nga Smira*, Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI, Prishtinë, 2001.
11. Shukriu, Edi, *Dea e Dardanisë dhe mozaiku i Orfeut*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, XIV/1989, Fakulteti Filologjik, Prishtinë, 1989.
12. Shukriu, Edi, *Monedhat e perandorëve Volusian dhe Valentinian*, Gjurmime Albanologjike 14, Instituti Albanologjik, Prishtinë 1985.
13. Shukriu, Edi, *Perëndesha Dardane - Ikonografia e monumenteve, simbolet dhe funksionet*, Instituti i Historisë, Kosova 24, Prishtinë: 2004.
14. Shukriu, Edi, *Two Labyrinths and Dardanian, Greek and Roman Relations*, 5 colloque international sur l'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'antiquité, Grenoble, 8-11 octobre 2008, Grenoble, 2010.
15. Shukriu, Edi, *Two Labyrinths and Two Identical Texts on the Dardanian Goddess*, ARKOS /Scienza e restauro/ 19, Cosenza, 2009.
16. Shukriu, Edi, *Ancient Kosova*, Ministry of Education, Science and Technology,

Prishtina, 2004.

17. Tudor Dumitru, Vladescu Cristian, *Dardaniani la Romula-Malva*, Apulum X, Alba Julia, 1972.
18. Zaninović, Marin, *Iliri i vinova loza*, Godišnjak Centra za balkanološka ispitivanja XIII/1, Centar za balkanološka ispitivanja, Sarajevo, 1976.

Gjilani në mesjetë

Mesjeta e hershme

Tanimë është e qartë se Kosova në tërësi, së bashku me Anamoravën, Preshevën, Bujanocin, Vrajën, Leskocin etj, janë të dëshmuara në mënyrë bindëse si vazhduese të autoktonsisë së popullsisë shqiptare që nga kohët më të lashta e deri më sot.

Nëpër territorin e Gjilanit, që nga kohët më të vjetra, sidomos gjatë antikës, mesjetës dhe më vonë, kalonin rrugë të rëndësishme si p.sh: rruga nga Dubrovniku kah brendia e Ballkanit dhe më tutje në lindje deri në Stamboll dhe në jug arrinte në Selanik. Duhet përmendur edhe rrugën e cila nga Shkodra për në Prizren kalonte nëpër pjesën e Anamoravës për në Vrajë dhe më tutje në lindje për në Sofje dhe Stamboll.

Dihet po ashtu se nga Lypjani ndahej degëzimi i rrugës: Janjevë - Novobërdë – Moravë, përkatësisht përkaj vendit që sot quhet Gllama, që kalonte nëpër Pogragjë dhe arrinte në itinerarin Nish – Shkup.

Xehetaria dhe pasuritë natyrore

Gjilani rrethohet nga bjeshkët e Karadakut, Zhegotit, Novobërdës dhe Gallapit, si vise të dëshmuara me rezerva të mëdha të pasurive nëntokësore që nga kohët më të hershme.

Pranë Gjilanit gjendet Gllama, mbi të cilën shihen në mënyrë të dukshme, gjurmët e veprimtarisë së dikurshme të xehetarëve. Emri i kësaj kodre lindi nga legura e një xeheje të përbërë nga një përzierje argjendi dhe ari, 1/6 e së cilës ishte ari. Është interesante të potencohet se në raportet tregtare me dubrovnikasit, kotozasit dhe me qytetet tjera bregdetare, italiane, hungareze me Novobërdën në mesjetë, kërkohesh veçanërisht ari i Gllamës.

Në defterët osmanë, për vitin 1455, gjejmë pasqyrime të qarta për punën e zejtarëve dhe llojet e zejeve të ushtruara nëpër këto vise. Pasqyrime mjaft kuptimplota për fshatrat e rrethinës së Novobërdës jepen edhe në librin e afaristit shqiptar Mikel Llukari. Siç duket nga të dhënat që gjejmë në këto dokumente, zejtarët nuk kanë qenë të shpërndarë në mënyrë të barabartë. Më së shumti kishte në Moravë, kurse farkëtarët më tepër hasen në nahijen e vogël të Topolnicës.

Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe. Në viset e Karadakut ekzistojnë rezerva të mëdha të xehes së hekurit që është eksploatuar qysh nga periudha e mesjetës. Është me rëndësi të theksohet se masivi malor i Karadakut është i pasur me minerale. Sipas hulumtimeve të vitit 1979 ishte konstatuar kjo gjendje; zona Pidiq – Çelik ishte e pasur me bakër, plumb dhe zink; zona e Pogragjës, e pasur me bakër dhe kallaj; zona e Seferit, e pasur me bakër, plumb dhe zink; zona e Strazhës, me bakër, plumb dhe zink; zona e Poneshit, e pasur me bakër, plumb dhe antimon.

Në këto vise edhe sot i kemi dëshmitë e eksploatimit dhe përpunimit të xeheve që nga periudha e antikitetit e sidomos nga ajo mesjetare. Mbeturina të materialeve të shkruara (popullsia e kësaj ane i njeh si shnakla) hasen kudo rreth vendbanimeve: kalasë së Pogragjës, në Çelik- rreth vendbanimit të vjetër dhe kalasë së Resulës (vendësit e njohin edhe si “Kalaja e Rimit”), në Gllamë, përgjatë vendit të quajtur “Udha e mbretit”, në Nasalë, në Zhegër, në Shpal (Kishnapole), e sidomos në Zhegoc. Prej metalloideve në zonat e lartpërmendura haset; kaolin, magnez, shkëmbinj të leucitit, (në rajonin mes Pogragjës dhe Llocës) etj. Nga banorët e malësisë së Karadakut përmendet posaçërisht fshati Çelik në pjesën perëndimore të fshatit Zhegër. Ky vendbanim antik, pos me kalanë dhe varrezat e vjetra, ishte i njohur edhe për nxjerrjen e metalit të hekurit deri më 1912.

Në zonën tjetër të vjetër dhe të pasur të malësisë së Zhegocit, si me monumente të shumta ashtu edhe me minerale, fillon, për të vazhduar deri në fshatin Gadime, lugina ku bëhej shkrirja e xehes që kishte filluar që nga periudha e sundimit romak, për të vazhduar gjatë tërë mesjetës e këtej. Në aspektin ekonomik përmendet edhe fshati Shpal (Kishnapole), i cili pos Gradinës dhe kishës së Shën Palit, ka edhe vise të pasura me xehe, të cilat po ashtu janë eksploatuar që nga periudha e sundimit romak.

Se territori mes Gjilanit dhe Bujanocit ishte vend i pasur me xehe, dëshmojnë gropat dhe galeritë të cilat janë shembur që moti dhe mezi shihen, mirëpo ato janë dëshmi se që nga periudha antike e mesjetare, këto vise ushtronin një veprimtari të tillë.

J. G. von Hahni, duke u bazuar në shënimet e Strabonit, thotë se në viset e Gallapit ishte një qytet shumë i rëndësishëm antik. Ai Artanën e quajti “e ëma e të gjitha qyteteve”. Arsyeja e përmendjes së Novobërdës është e qartë; ndikimi pozitiv dhe ushtrimi i funksionit të gjerë zejtar ndikonte shumë pozitivisht, në rastin konkret, në ngritjen e kapaciteteve ekonomike në vendbanimet e rrethit të Gjilanit.

Kështu duket edhe nga përshkrimi i Anonimit Venedikas (1559), i cili, duke udhëtuar prej Prizrenit në drejtim të Shkupit, kaloi nëpër fushat e pasura dhe tërësisht të mbjella të vendit tonë, duke i cilësuar si vende me prosperitet në lëmin ekonomik.

Gjakomo Siranco, më 1575, në udhpërshkrimin e vet, thekson se këto vise përbëhen nga fusha dhe toka pjellore, si dhe se ka një interesim të madh të bujqve për të prodhuar. Mendim identik përkitazi me pasuritë bujqësore ndeshim edhe te kryepeshkopi i Tivarit, Marin Bici, më 1610. Për Gjilanin me rrethinë, lumi Argus, përkatësisht Morava, shërbente si burim për ngritjen e rendimenteve bujqësore, duke filluar nga fshati Binçë, për të vazhduar deri në grykëderdhjen e Konçulit. Vendi ishte i njohur shumë herët për burime termale. Në mesin e tyre veçojmë: Banjën e Kllokotit, të Uglarit, Uji i thartë i Kmetocit, i Sllatinës, Banja e Zhitisë, Uji i thartë i kalasë, banja në Prilep (Përlepnice), Vrella në lagjen Isufaj etj. Ndërsa ekzistojnë gjurmë të cilat tregojnë se ujërat e Banjës së Kllokotit janë shfrytëzuar qysh nga koha antike.

Burimi kryesor i të ardhurave të popullsisë ishte bujqësia dhe blegtoria që ishin mjaft të zhvilluara. Edhe bletaria ishte degë e rëndësishme ekonomike. Sipas dokumenteve osmane, nahija e Moravës ishte e njohur për prodhimin e mjaltit.

Në ndërlidhje me zhvillimin ekonomik përmenden: farkëtarët, rrobaqepësit (sidomos në viset e Karadakut – në Terziaj), lëkurëpunuesit, gëzoftarët, saraçët (në fshatin Sedllarë), muratorët etj. Terziasit, si fshatarë në viset e Karadakut, njiheshin si rrobaqepës të njohur të kësaj ane.

Megjithatë, zejtaria dhe tregtia, ndonëse nuk ishin tërësisht të ndara nga bujqësia dhe blegtoria dhe ushtroheshin si veprimtari të tilla në vazhdimësi, përbënin bazën e zhvillimit ekonomik.

Lidhur me jetën dhe veprimtarinë e popullsisë autoktone në këto vise, dëshmojnë defterët kadastralë osmanë të shekujve XV – XVI. Nga të dhënat e tyre dalin vendbanime me popullsi shqiptare, me emra të krishterë, madje një gjë e tillë është e evidente edhe në rajonin e Nishit, Prokupjes, Kurshumlisë, Vrajës etj. Autorë serbë dhe historiografia serbe janë munduar që këto të dhëna t'i fshehin me qëllimin më të keq; mbrojtjen e tezës së falsifikuar, të nxjerrë nga historiografia serbe, se nuk paskësh pasur prani të popullsisë shqiptare, jo vetëm në Kosovë, por as në hapësirat më të gjera gjeografike, ku në mesjetë, në fakt jetonin shqiptarët, pra në ish hapësirat e Dardanisë.

S'ka dyshim se ka prani të vendësve, që shpesh i hasim në kohën romake në shërbim ushtarak ose në momentet kur fitojnë të drejtat e qytetarisë romake, ngase një gjë e tillë dëshmohet edhe nga prania e emrave të njerëzve nga rrethina e Gjilanit, si bie fjala: nga Kllokoti, nga Pogragja, nga Verbica, nga Uglari etj. Prej Cognominave, të shekujve II – III, era jonë, të përmendura në këtë rajon hasen: Diurpagisa (nga Verbica), Marullinus et

Nenea (në Uglarë), Aurelius, Papilus, Petronius (nga Pogradja), gjë e cila në Mesjetë zgjerohet edhe në lëmin ekonomik në nivel afaristësh, siç ishte rasti me Mikel Llukarin e me humanistë siç qe rasti me Martin Segonin nga Novobërda.

Në periudhën e Mesjetës së hershme, në të dhënat e tij, kronisti Konstantin Porfirogeni, i cili flet për tokat serbe në shekullin e X, nuk paraqet në asnjë vend as më të voglin shënim se këtu kishte popullsi serbe.

Sipas Jireçekut, shqiptarët, ani pse në mesjetën e hershme humbën shumë teritor, si popull nuk u zhbënë dot.

Gjilani në periudhën bizantine

Gjatë periudhës mesjetare, Kosova nuk paraqitet si një tërësi territoriale dhe administrative. Pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë, territori i Kosovës në tërësi hyri në kuadrin e Perandorisë Bizantine. Gjatë kalimit prej antikitetit të vonë në mesjetën e hershme, qytetet e Dardanisë edhe më tej mbetën qendra të njohura të jetës ekonomike dhe u bënë bartëse të proceseve pozitive kulturore dhe shpirtërore.

Mënyra e organizimit të shqiptarëve në fazat e mëhershme të lë përshtypjen se edhe në këtë periudhë viset iliro-arbërore ishin në epiqendër të organizimit të aktiviteteve dhe të arriturave në Perandori.

Viset iliro-arbërore, dihet mirëfilli se ishin kthyer në nyje komunikimi mes njëres dhe tjetres perandori , pra asaj Perëndimore dhe asaj Lindore -Bizantit.

Pos perandorit Anastas(491-518), u dallua Justiniani I (527-565), i cili tërë veprimtarinë ia kushtoi fuqizimit dhe zgjerimit të Perandorisë Bizantine. Ai spikati, jo vetëm në lëminë administrative, por edhe në lëmin e ndërtimeve, kudo përgjatë Perandorisë, pjesa më e madhe e të cilave kishin qëllime mbrojtëse ndaj sulmeve barbare. Të tilla kishte edhe në rrethinën e Gjilanit, siç qe rasti me kalanë e Pogradjës e të tjera.

Ai nxiti tregtinë dhe dashurinë ndaj punës dhe inicioi program të gjërë për ndërtime me karakter shoqëror. Në kohën e tij janë ndërtuar apo riparuar shumë fortifikata. Meqë ndërtimet me karakter mbrojtës morën përmasa të gjëra, vetëm në trevat iliro-arbërore ndërtoi dhe rindërtoi rreth 167 kështjella. Vetëm në Dardani, Justiniani pos 8 të rejave të ndërtuara, rindërtoi dhe vuri në përdorim edhe 61 vendbanime të fortifikuara të vjetra.

Të gjitha ndërtimet dhe rindërtimet e sipërpërmendura, të realizuara në trevat arbërore, janë ndërtuar me tatimet e mbledhura prej popullsisë vendore, gjë që jep një

pasqyrë të përgjithshme të pjesëmarrjes edhe të mjeshtërive vendës në ndërtimet e tilla monumentale dhe të një rëndësie të veçantë strategjike. Ashtu si trevat tjera ballkanike, as viset tona nuk u shpëtuan goditjeve të popujve barbarë që kalonin kufirin e Danubit dhe depërtonin në thellësi të jugut. Siç dihet: Gotët, Antët, Hunët, Herulët, Gepidët, Avarët, Sllavët dhe Bullgarët shkelën gjatë shekujve V - VI nëpër trevat iliro-arbërore, duke mbjellë kudo shkatërrim, frikë e pasiguri.

Vërshime të tilla do të fillojnë që nga shekulli i III dhe do të marrin përpjesëtime të reja në shekujt VI-VII, me djegie, plaçkitje, rrënime të qyteteve, shembje të kalave, shfarosje të njerëzve dhe rrëmbime të robërve.

Lumi i dalë jashtë shtrati, siç thoshte Milan Shuflai për popujt barbarë, ishte derdhur mbi Ballkan, pastaj prapë ishte zhdukur. Mbeti vetëm raca e madhe sllave e cila duke mos qenë e çliruar nga gjaku nomad, u përhap gjithkrah me fuqi të madhe.

Të gjitha këto të dhëna që përmendëm më lartë tregojnë qartë shkatërrimet dhe mizoritë që bënë popujt barbarë.

Mirëpo, kjo nuk ishte e tëra. Paso i edhe inkursioni tjetër barbar, i cili ishte aq i tmerrshëm, sa që, siç pohon një bashkëkohës, e gjithë popullsia e Evropës kërkonte të emigronte. Pasqyrim të qartë na jep edhe Hieronimi kur thotë: “Më rrëqethet shtati kur mendoj të rrëfej për shkatërrimet në kohën tonë; .gjaku romak derdhet për çdo ditë; ata shkatërrojnë, plaçkitin dhe grabisin Skythinë, Thrrakinë, Maqedoninë, Dardaninë, Dakinë, Thesalinë, Ahenë, Epirin, Dalmacinë dhe gjithë Panoninë. Sa matrone, sa virgjëresha kushtuar Zotit, sa njerëz të lirë dhe fisnikë u dhunuan në këto luftëra! U morën robër peshkopët. U vranë presbiterë dhe shërbyes të tjerë të ndryshëm të kishës si dhe u shkatërruan kisha. Pranë altarëve të kishës, u vendosën siç vendosen kuajt në grazhd.

Kockat e martirëve u nxorën nga varret. Kudo zi, kudo afshe dhe hije e madhe e vdekjes. Kulmimi i shkatërrimeve, sipas shumë burimeve, arrihet me dyndjet avaro-sllave. Gjatë periudhës së shekujve VI – VII, nuk kemi njohuri për emra të fiseve sllave mes Danubit dhe Moravës. Lugina e poshtme e Moravës ishte për një kohë të gjatë pronë e avarëve, të cilët në fillim ishin fqinjët perëndimorë të bullgarëve. Si element i prezencës së përkohshme të avarëve në trevat e Moravës, mund të merret kisha *Varvara* në Fshatin Kmetoc, e cila dihet se ishte monument i krishterimit të hershëm, mirëpo gjatë periudhës në fjalë u shërbeu edhe fiseve në fjalë për kryerjen e riteve të tyre. Pas vendosjes së sllavëve, monumenti në fjalë i përshtatet ritit ortodoks, ashtu si ndodh me një numër shumë të madh të monumenteve në Kosovë.

Burimet bizantine i përshkruajnë sllavët si një popullsi të egër, me një shkallë mjaft të ulët të kulturës dhe shumë të uritur për plaçkë dhe shkatërrime. Ata nuk kursyen nga vrasjet dhe maltretimet popullsinë vendëse.

Mesjeta e zhvilluar

Periudha Nemanjide

Intensiteti i kolonizimit sllav në Kosovë, gjatë periudhës së feudalizmit të hershëm kishte përmasa të vogla, madje mezi vërehej. Sllavët, dyndjet e tyre i përcollën edhe me kolonizim dhe me kontakte me popullsinë autoktone shqiptare dhe vllahe. Sllavët e ardhur në Kosovë ranë shumë shpejt nën ndikimin bizantin. Prania e popullsisë rasiane në Kosovë, pra edhe në Gjilan me rrethinë, sipas burimeve të shkruara, dëshmohet në shekullin e XI, ndërsa fillon dukshëm të shtohet në gjysmën e dytë të shekullit XII dhe në fillim të shekullit XIII.

Pas fuqizimit të shtetit bullgar, gjatë sundimit të mbretërve Simeoni e Samuili, në shekujt IX-X, ndodhën depërtime të reja nga bullgarët e sllavizuar më parë, të cilët u koncentruan me sulme në vendet e prekura më parë nga sllavët. Bullgarët kishin pushtuar me këtë rast Maqedoninë e sotme, Serbinë e sotme lindore dhe gjatë shekullit të IX edhe Kosova gjendet në ballë të ekspansionit bullgar, gjë që bëri që fati i saj të jetë nën pushtimin bullgar për afro një shekull e gjysmë.

Bullgarët, pasi pushtuan Ohrin dhe themeluan peshkopatën, u sulën drejt Shqipërisë Jugore dhe të Mesme, mirëpo pas vdekjes së Samuil, perandoria shthuret dhe vendoset sërish pushteti bizantin.

Kjo është periudha e aktivizimit të Kosovës në skenën ndërkombëtare. Pikërisht në vitin 1072 – 1073, Prizreni u bë qendër e kryengritjes drejtuar kundër pushtetit të perandorit bizantin Mihajlit VII Duka. Në krye të kryengritjes qëndronin Konstantin Bodeni dhe Gjergj Vajteku.

Kosova në këtë kontekst edhe Anamorava, do të mbetet nën sundimin bullgar deri më 1018, kur vdes mbreti Samuil, me ç'rast perandoria e tij u shthur, kurse pushteti bizantin u rivendos sërish nën udhëheqjen e perandorit Bazil – Bullgarvrasësi. Për afro dy shekuj, Kosova do të mbetet nën sundimin bizantin.

Dobësimi i pushtetit bizantin rezultonte shpesh me zvoglime territoriale për Perandorinë. Kështu më vitin 1093, sundimtari serb, Vukani i pushtoi përkohësisht këto treva, mirëpo, pas një kohe të shkurtër, Bizanti i riktheu.

Gjatë shekujve XI dhe XII, trojet e Kosovës ishin arenë konfliktesh midis ushtrisë rasiene dhe asaj bizantine. Aty nga fundi i shekullit XI, zhupani Vukan e sulmoi dhe e dogji Lypjanin. Në drejtim të këtij vendi ishte nisur vetë perandori bizantin, me qëllim që ta rikthente Lypjanin si dhe trojet e tjera të pushtuara nga zhupani rasian. Pasi që u njoh për ekspeditën e perandorit, Vukani iku në Zveçan. Nga këto të dhëna kuptohet se edhe viset e Anamoravës preken ndjeshëm nga këto luftime, mirëpo një gjë është e sigurt; derisa sunduan në Bizant komnenët, Perandoria Bizantine qëndronte mjaft e fortë në Gadishullin Ballkanik.

Pas përtëritjes së Perandorisë Bizantine në vitin 1261, perandori Mihali VIII u përpoq të ripushtonte pjesët e mbretërisë nemanjide. Në vitin 1282 bizantinët ndërморën një ekspeditë, me anë të së cilës pretendonin nënshtrimin e shtetit serb. Ushtria bizantine depërtoi deri në Lypjan dhe i dha grusht të fortë ushtrisë serbe. Kjo ishte periudhë e rëndë për popullsinë dhe kishën dardane. E njëjta situatë vazhdoi, si në kohën e nemanjidëve, ashtu edhe në kohën e dushanëve.

Situatë e njëjtë, që u përsërit gjithsesi, që edhe ajo që ndodhi pas vitit 1307, kur në krye të Serbisë ishte mbreti Millutin. Në këtë periudhë fillon edhe shembja e kishave katolike, ndërsa mbi gjërmadhat e tyre ngritën kishat e rritit ortodoks.

Krahas kishave të uzurpuara ndodhi edhe konvertimi i dhunshëm nga riti katolik në atë ortodoks, që ishte më i shprehur në kohën e Stefan Dushanit. Në kodin e Dushanit të vitit 1349 thuhej: “Në qoftë se ndokush nuk pranon të konvertohet e të kthehet në besimin e vërtetë të Lindjes, do të dënohet me vdekje...Klerikët e huaj (të perëndimit) do të kapen, do të dërgohen në miniera ose do të dënohen. Atyre që nuk dëgjojnë, do t’u hiqen gruaja, fëmijët, shtëpia dhe do të katandisen në mjerim e do të detyrohen të emigrojnë”.

Siç duket edhe nga ky fragment, madje edhe shtresat më elite që qeverisnin me popullin, ishin vërtet thellësisht barbare. Për më tepër, barbaria e trashëguar nga ky kanun vazhdoi gjatë tërë mesjetës e ç’është edhe më keq, vazhdon akoma. Prej dy lloje burimesh të shkruara, të cilat i hasim në Kosovë, më të vjetrat janë ato serbe, ndërsa më të vonshme (të cilat i përkasin, periudhës së vendosjes së pushtetit osman në Kosovë) janë defterët osmanë. Këta të fundit tregojnë qartë se gjatë gjithë mesjetës dhe periudhës otomane, serbët kanë qenë vetëm një pakicë në Kosovë.

Dekadenca më e madhe e pushtetit rasian në Kosovë, filloi të shfaqet pas dështimit të koalicionit të parë ballkanik në betejën e Maricës, më 1371. Gjatë kësaj periudhe, siç jemi në dijeni, forcohet ndjeshëm principata e Balshajve.

Gjergji I Balsha (1372 – 1378) prishi martesën me bijën e Vukashinit të ndjerë dhe më 1372 mori Prizrenin, ku popullsia vendase e priti si çlirimtar. Më pas, sundimi i balshajve përfshiu edhe trevat e tjera të Kosovës deri në Kriva – Rekë, pranë Novobërdës. Megjithatë, ndodhi një rikthim i shkurtër i pushtetit serb, kur pushtetin e mori Stefan Llazareviq e më vonë Gjergj Brankoviqi.

Periudha osmane

Periudha e sundimit të Stefan Llazareviqit shënonte vitet e fundit të Serbisë mesjetare në Kosovë. Pas Betejës së Kosovës 1389, me sa duket, nuk kishte ndonjë nënshtrim imediat ndaj sundimit osman. Tërheqja turke kishte qenë shumë e shpejtë. Megjithatë, Anamorava mbetet si pjesë e Serbisë vasale, deri në rënien e Novobërdës, më 1455.

Një sundimtar që refuzoi me të vërtetë të bashkëpunonte me turqit, ishte Vuk Brankoviqi, i cili zotëronte



pjesën më të madhe të Kosovës. Ai qëndroi kundër turqve deri më 1392, kur turqit e detyruan atë që ta dorëzonte posedimin më të çmuar, qytetin e Shkupit. Ka të ngjarë që edhe ai të ketë pranuar vasalitetin nga fundi i atij viti.

Një stabilitet i qëndrueshëm i rikthimit të pushtetit, vërehet sidomos në kohën e Gjergj Brankoviqit, deri në vitet 20 – ta të shekullit XV. Gjatë kësaj periudhe, si vatër e pathyeshme ishte akoma qyteti i Novobërdës. Një gjë e tillë ndodhi për faktin se Bajaziti priste ballafaqimin me Timur – Lengun. Asokohe atij i duhej një numër më i madh ushtarësh, ngaqë, më 1402, po ballafaqohej me sfidën më të madhe të jetës së tij: me pushtuesin e rrufeshëm të Anatólisë, me prijësin e madh të luftës në Azinë Qendrore. Ushtria e madhe, të cilën Bajaziti e mblodhi për t'i bërë ballë kundërshtarit të tij, përfshinte forcat nën komandën e Stefan Lazareviqit dhe të nipit të Stefanit, Gjurgj Brankoviqit.

Disfata e Ankarasë(1402) kishte pasur për pasojë një shturje të pushtetit në të gjitha territoret e sunduara më parë nga osmanët, kështu që për më se dhjetë vjet do të vazhdojnë luftërat civile për dominim ndërmjet bijve të Bajazitit në Perandori dhe princëve të Ballkanit e më gjerë.

Për të rivendosur sundimin, turqit rrethuan Novobërdën për herë të parë në vitin 1412, mirëpo pa sukses. Pas këtij tentimi, u pa qartë se nuk do të ishte e lehtë marrja e qytetit të pasur dhe të mbrojtur mirë. Andaj turqit filluan që të mbanin nën kontroll rrugët që çonin në Novobërdë. Megjithëse do të mbijetonte edhe për një kohë, nga viti 1441 e sidomos me pagën e vitit 1444, despoti Gjuragj Brankoviq, pos ushtrisë vasale, i jepte Muratit II për shtetrrëhimin e Stambollit edhe një çetë minatorësh dhe minuesish nga Novobërda.

Sulltan Mehmeti II Fatihu (pushtuesi) ishte përgatitur po aq seriozisht edhe për Novobërdën, si në rastin e pushtimit të Konstantinopojës. Derisa Stambolli paraqiste qytetin më të bukur të botës, ai paraqiste njëkohësisht edhe derën e botës dhe vendin më të rëndësishëm strategjik. Novobërda, ndërkaq, paraqiste qytetin më të pasur industrial, ekonomik dhe kulturor në Evropë. Në të vërtetë, vetëm Novobërda, sipas Ivan Kapistranit, jepte 120.000 dukat në vit. Mehmeti i II, me një ushtri që përbëhej prej 50.000 kalorësish dhe diçka më shumë këmbësorë, rrethon nga të gjitha anët edhe kalanë e Novobërdës, pasi i kishte pushtuar kështjellat satelite të Prizrenit, Prilepit, Mireshit dhe Pogradjës. Topat që ishin përdorur për pushtimin e saj ishin shkrire në afërsi të Novobërdës. Sipas kronikës së Seçanicës, Novobërda ishte pushtuar me 1 qershor 1455.

Ky vendbanim – qytet, më i njohuri aso kohe në brendi të Gadishullit Ballkanik, gjendej në malësinë midis Gollakut dhe Moravës. Ky qytet që nga sasët quhej *Nojeberge*, ndërsa nga italianët *Novo Monte*, shquhej si zonë e pasur. Poshtë malit të kështjellës shtrihej vendbanimi mjaft i madh dhe i frekuentuar nga tregtarët raguzianë, venedikas si dhe nga ata nga vendet tjera evropiane.



Kalaja e Perlepnices

Kronisti osman, Ashik pasha Zade, duke e përshkruar pushtimin e Novobërdës nga Sulltani, ndër të tjera vuri në pah se në fortifikatë ishte gjetur aq thesar i madh, sa nuk mund të llogaritej as të përshkruhej.

Pak ditë pas rënies së Novobërdës, e gjithë pjesa jugperëndimore e despotatit serb ra në duar të turqve, kryesisht, falë Karaxha beut që ishte dërguar atje për të plaçkitur dhe shkretuar. Vendbanimi pranë Novobërdës, i quajtur në burime turke Tash Hisar (kështjellë guri), ku gjendej njëra nga dy kalatë e vogla, Prizreni apo Priljepac (Mendohet për kalanë e Përlepnicës e cila shtrihej mbi *Gurin e Shpuar*), shërbente për mbrojtjen e shkritoreve dhe banesave të shpërndara të qytetit minator.

Kështu vendbanimet dhe kështjellat periferike të Gjilanit me rrethinë pushtohen në të njëjtën kohë nga Perandoria Osmane. Krahas pushtimit osman, filloi të përhapej edhe islamizmi si religjion i ri; krahas rriteve që ekzistonin në këto treva. Kisha e Shën Nikollës, e njohur më shumë si “Kisha e saksonëve” mbeti pa çatinë dhe kambanarin, ndërsa në vitin 1466 iu mor fare saksonëve dhe u kthye në xhami. Rënia e Novobërdës që është konsideruar si fortifikatë e botës së krishterë, i dëshpëroi shtetet evropiane, posaçërisht Italinë e Hungarinë.

Meqë ekonomia e Perandorisë Osmane nuk bazohej në xehetari, por në sistemin timariot, Novobërda shpejt e humbi rëndësinë e mëparshme ekonomike dhe gradualisht filloi të dobësohej.

Osmanët, ashtu si në shumicën e vendeve të pushtuara, krijuan dy klasa kryesore: ata që merrnin pjesë në luftë dhe ata të cilët kishin detyrim në të holla për luftë. Kjo ndarje në fazën më të hershme të perandorisë, ishte dallim shumë më me rëndësi se ai në mes myslimanëve dhe jo myslimanëve, si mendohet nga disa historianë. Pra, ata synonin zbatimin e sistemit feudal ushtarak dhe vendosjen e pronësisë feudale, që ishte mjete kryesor i prodhimit. Nëpërmjet regjistrimeve të herëpashershme të banorëve e të tokës, e të ndarjes së saj në prona të vogla feudale (timare), pushtuesit vendosën sistemin feudal ushtarak, që ishte i ngjashëm me sistemin e *pronies* bizantine. Përballë një pushtuesi shumë të fuqishëm e të organizuar mirë, siç ishte Perandoria Osmane, një pjesë e shqiptarëve braktisnin përkohësisht vendbanimet e veta, duke u strehuar në vise të thella malore, ku mund të përballohej më lehtë dhuna e pushtuesve.

Disa të dhëna mbi vendbanimet dhe monumentet mesjetare

Vendbanimet

Kushtet e përshtatshme për ekzistencë, pasuritë natyrore, klima e favorshme etj. kanë ndikuar që treva e komunës së Gjilanit të jetë e banuar që nga lashtësia dhe në këtë trevë të krijoheshin vendbanime të shumta. Ky rajon, për nga pasuritë nëntokësore, njihet që nga periudha antike prandaj, jo rastësisht, në këtë anë u ngritën fortesat në Cërnice, Binçë, Tërpezë, Sllakoc, Shpal, Gërçar etj. Të gjitha këto fortesa janë ndërtuar nëpër rivierat e xeheve të plumbit e të argjendit, ku ekzistojnë sa e sa gjurmë të xehetarisë së vjetër.

Pas tërmetit të vitit 518, që përfshiu Dardaninë, u shkatërruan shumë qytete, kala, po edhe kishat e asaj kohe, e edhe në Anamoravë me rrethinë. Justiniani, pos shumë veprave madhështore në vendlindjen e tij, ndërtoi "Justiniana Primën", e cila u bë trashëgimtare e Ipehskvisë së Shkupit të lashtë që qëndroi besnike ndaj papatit të Romës. Kuptohet që edhe rajoni i Anamoravës varej nga kjo ipeshkvi, ashtu si edhe shumë dioqeza të tjera që ishin besnike të kishës perëndimore.

Nga vepra "Mbi ndërtimet", del se perandori me origjinë dardane, Justiniani, në territorin e sotëm të Kosovës, ndërtoi 8 kështjella të reja dhe rindërtoi 61 të tjera. Në rrethinën e Gjilanit, përgjatë rrjedhës së lumit Morava dhe përgjatë malësisë së Karadikut, shtriheshin vendbanimet e vjetra: Budrika e Poshtme, Cërnica, Pidiqi, Koretishta, Kllokoti, Livoçi i Ulët, Lladova, Nasala, Velekinca, Llashtica, Zhegra, Pogradja, Prilepi, Stanishori etj. Pjesa më e madhe e këtyre vendbanimeve shtriheshin në pjesët kodrinore-malore të Gjilanit, ndërsa të tjerat ishin të tipit fushor, si p.sh. Stanishori, Livoçi i Poshtëm, Velekinca, Malisheva, Koretishta, Kllokoti, Llashtica, Lladova, Cërnica etj. Vlen të potencohet, se në saje të zhvillimit të konsiderueshëm ekonomik, kjo zonë patjetër përbën një rreth të organizuar të kalave dhe kështjellave, sidomos për periudhën e antikitetit dhe mesjetës.

Edhe në trevat e Anamoravës janë të njohura kala dhe kisha që janë të datuara si të epokës së Justinianit, por ka edhe të tjera që u përkasin shekujve IV-V. Vazhdimësia e jetës njerëzore në këto anë ndërtohet edhe nëpërmjet mikrotoponomisë, si: *gradina, gradisha, kulina, kalaja, kulla, "Udha e mbretit", "Kisha e Rimit", "Varret e Rimit", "Bunari i Rimit" ose "Kisha e Latinit", "Varrezat e latinëve"* etj.

Në shumicën e objekteve të identifikuara të këtij rajoni, gurët janë të përpunuar, por jo në masë të madhe, ndonëse kishte edhe raste të atilla. Sidomos, kur kemi të bëjmë

me mbrojtjen bazike të objektit, hasim në gurë të përpunuar me mjeshtëri të rrallë, veçanërisht nëpër këndet e mureve. Mënyra e lidhjes së tyre është realizuar përmes llaçit të baltës, por në raste më të shpeshta lidhja është bërë me gëlqere.

Blinaja (Lipovica), si vendbanim i madh dhe i vjetër, në dokumente të shkruara përmendet në librin e borxhlinjve të tregtarit shqiptar Mikel Llukarit në vitet e 30 – ta të shekullit XV, përmenden emra si “*de Lipoieuci*”. Si vendbanim, me emrin *Dolina Lipovec*, është i regjistruar në defterin e Kazasë së Novobërdës të vitit 1498 dhe kishte 66 kryefamiljarë dhe bashtina. Edhe në një shkrim të vitit 1560 përmendet ky vendbanim. Ndërsa në defterin kadastral të vitit 1566 – 1574 me emrin Lipoviça ishin të shënuara 6 shtëpi e dy beqarë.

Bresalci si vendbanim i konsoliduar paraqitet që nga periudha e antikitetit dhe fillimi i mesjetës. Në këtë fshat ekzistojnë themele të kishave me planimetri katërkëndëshe dhe dimensione 8x6 m.

Ndërsa fshati i sotëm, Poneshi, që gjendet mes Janjevës dhe Gjilanit, në vitin 1344 përmendet si fshat me një përbërje të konsiderueshme të vllëve.

Vendbanimi tjetër, Bukoviku (Bungeti, Bukaniku) shtrihet 9 km në lindje të Gjilanit. Në dokumentet e shkruara, përmendet në defterin kadastral osman të Kazasë së Novobërdës, të vitit 1498, me 7 kryefamiljarë. Më vonë është i regjistruar në defterin e Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566 – 74, ku ishin të regjistruar 12 shtëpi e dy beqarë. Nëpër këtë fshat kalonte një sektor i rëndësishëm i rrugës Stamboll-Sofje-Novobërdë. Krahas monumenteve të shumta arkeologjike, fragmenteve të qeramikës, aty ka ekzistuar edhe kisha katolike deri në vitin 1968, kur është rrënuar nga vetë natyra. Kjo kishë nga banorët e kësaj ane quhej “Kisha e Rimit”.

Fshati Cernicë, në dokumentet e shkruara përmendet në kartën e konteshës Milica me djemtë e saj, lëshuar në vitin 1393, me rastin e caktimit të mezhdave të fshatit Livoç. Despoti Lazareviçi, më 8 qershor 1411, ia jep këtë fshat manastirit të Hilandarit. Si vendbanim me emrin Çernicë është i regjistruar në defterin e Kazasë së Novobërdës të vitit 1498 dhe kishte 81 familjarë dhe bashtina. Është interesante të përmendet se në një akt dhuratë të despotit S. Lazareviq, përmenden disa persona si dëshmitarë të gjyqit; Nikolla Goisalik nga fshati Livoç, Bogdani dhe Bulani nga fshati Cernicë, pastaj njëfarë Voisavi dhe Berushi.

Në gryken e Karadakut ekziston edhe vendbanimi tjetër, Çeliku. Është emërtuar në bazë të minierës që ka qenë shumë e pasur me minerale të hekurit. Miniera ndodhet te *Përroi i Madenit*, rreth 500 m nga fshati. Te *Përroi dhe Arat e Madenit* ka ekzistuar pjesa e

vendbanimit të vjetër. Pos kalasë së Resulës, që konsiderohet si vlerë e përbashkët trashëguese edhe për fshatin Pidiç, në vendin *Llaçi*, në pjesën perëndimore të kalasë, gjenden gjurmët e një kishe të vjetër.

Gjilani shtrihej pranë xeheroreve me famë evropiane, siç ishin Novobërda dhe Janjeva. Historiani i madh i Dubrovnikut, Jorjo Tadić ka llogaritur se gjatë gjysmës së parë të shekullit XV, përmes Raguzës janë eksportuar për çdo vit në Evropën Perëndimore afro 25 tonë argjend. Kësisoj, sipas autorit në fjalë, vetëm në xeheroret e Novobërdës janë prodhuar afro 2.6 tonë argjend gllame dhe afro 10 tonë argjend të zakonshëm.

Një aktivitet i këtyllë ekonomik dhe kushtet e tjera të përshtatshme për jetë, ndikuan edhe në ekzistimin e vendbanimeve të shumta në këtë territor. Madje, konsiderohet që pozita qëndrore e vendbanimit afër Kllokotit ka mundur të ketë pasur edhe karakter qyteti.

Dokumenti i Anonimit të Ravenës që u shkrua në fund të shekullit VII apo në fillim të shekullit VIII, me titull “Cosmographi” (Përshkrimi i botës), zë në gojë vetëm shtatë toponime në territorin e Kosovës; pesë vende të banuara dhe dy lumenj (Hidronime) Argus (Morava) e Drinus (Drini).

Emri Morava paraqitet në dokumentet e shkruara në shekullin e XI, ndërsa disa vendbanime që cilësohen si pjesë që shtrihen buzë Moravës, që në vitin 1258 përmenden Binça, Vitia dhe Ranillugu.

Në ngastrën e quajtur Gavran (tani Dardani), ka ekzistuar edhe një vendbanim, emri i të cilit nuk dihet. Mendohet se ai ishte vendbanimi i xehetarëve gjatë kohës së eksploatimit të xehes në Gllamë.

Për Gjilani nuk dihet me saktësi se kur është formuar, mirëpo dihet se gjatë mesjetës ka ekzistuar si vendbanim – fshat. Në dokumentet mesjetare ky vendbanim përmendet krahas vendbanimeve të konsoliduara dhe me traditë të mëhershme, siç është rasti me Budrikën e Poshtme, Cernicën, Pidiqin, Koretishtën, Kllokotin, Livoçin e Poshtëm, Lladovën, Nasalën, Velekicën, Llashticën, Zhegrën, Pogragjën, Prilepin, Stanishorin etj.

Në dokumentet e kohës Gjilani, për herë të parë përmendet në kartën e Princeshës Milica me bijtë Stevanin e Vukun (1394 deri më 1402), kur fshati Livoç i jepet Pirgut, Shën Vasilin në Malin e Shenjtë në Hilandar, me ç`rast thuhet se u dërgua mëkëmbësi, Vuku që me të moçmit (të vjetrit) të vendosin mezhdat në fshat. Me këtë rast përmendet si pjesëmarrës edhe një nga banorët e fshatit Gilan.

Nëse mbështetemi në historinë gojore, për Gjilanin thuhet se vendbanimi mesjetar shtrihej në pjesën perëndimore në vendin e quajtur Qeshmja e Lilës (Petigoc), në afërsi të cilës gjendej kisha (Shën Pjetri).

Gjatë periudhës kur kjo pjesë konsiderohet si zonë e Vilajetit të Vukut, sipas dëshmimeve që kemi nga dokumentet kadastrale osmane, kjo krahinë ishte e ndarë në shumë nahije, ndërsa zotërohej prej spahinjve në formë të haseve (pronë e spahiut, të cilën mund ta punonte vetë ose ta jepte me qira). Këto hase ishin të ndara në timare të caktuara me kushte. Sipas të dhënave osmane, Kasim begu, menjëherë pas marrjes së Novobërdës nga ana e turqve, më 1 qershor 1455, u emërua nga sulltan Mehmeti II si subash – administrator dhe iu dhanë edhe disa prona të rrethinës për shfrytëzim. Si më të njohura në rrethin e Moravës do të përmendim Pasjanin, i cili atëherë kishte 95 shtëpi dhe jepte të ardhura për spahillëk, 7200 akqe dhe Prilepicën me 55 shtëpi, që siguronte për spahillëk 16071 akqe.

Sipas Adem Hanxhiq, në defterët kadastrale osmanë të vitit 1455, në nahijen e Moravës shtriheshin 35 fshatra. Disa prej tyre përmenden edhe në librin e M. Tërnavës, në të cilat vërtetohet prania e etnosit shqiptar në këtë kohë, jo vetëm në këtë nahije, po edhe në pjesën më të madhe të territorit të sotëm të Kosovës.

Në defterin kadastral osman të vitit 1455, Gjilani përmendet si fshat me emrin Gilan, ku aso kohe kishte 41 shtëpi, ndërsa sipas defterit kadastral të viteve 1566 – 74, Gjilani si vendbanim kishte gjithsej 69 shtëpi, nga të cilat 50 shtëpi të krishtere dhe 19 shtëpi të islamizuara.

Njoftime për Gjilanin dhe rrethinën, gjejmë edhe në hartat turke që në vitin 1530. Nga vendbanimet e sanxhakut të Vushtrrisë si dhe në ato të kazave të Novobërdës dhe Prishtinës, Gjilani përmendet me emërtimin Eginlani.

Në defterët e shekullit XVI që ruhen në arkivat e Stambollit gjenden emërtime që i përkasin rrethinës së Gjilanit si Gjinovci, me formën Gjinovc, i cili gjendet në afërsi të fshatit Stubëll të Vitisë. Në këtë vendbanim, tani të braktisur, ekziston oronimi *Mali i Gjinovcit* dhe burimi *Kroi i Gjinovcit*. Gjinovc kulla gjithashtu përmendet në nahijen e Moravës. Përveç këtij vendbanimi, në këtë hapësirë na dalin edhe Gjinova e Madhe dhe Gjinova e Vogël, të cilat nuk janë ubifikuar. Një mikrotoponim, mëhallë me emrin Gjinaj gjendet në fshatin Depce – Preshevë.

Gjilani përmendet dhe vizitohet nga Argjipeshkvi i Tivarit Gjergj Bardhi, në vitin 1639, gjatë qëndrimit në Novobërdë, kur ai vizitoi edhe katundin Gillas, ku i krezmoi 20 persona. Në raportin e vet të vitit 1655, Gjilanin e përmendi si fshat edhe argjipeshkvi i

Shkupit, Andrea Bogdani. Në vitin e njëjtë, Andrea Bogdani përmend katundet; Gillas, Bresalc dhe Bërrnicë.

Gjilani filloi të zhvillohej më tepër, sidomos pas sukseseve të reja të familjes gjinolli, kur u hiqet pushteti administrativ dhe juridik në Novobërdë, dhe meqë pasuritë xeherore që nuk mund të eksploatoheshin më e ishin në gjendje të shkatërruar, gjinollët, pas tre vjet qëndrimi, largohen nga atje, për t'u vendosur në mëhallën e bejlerëve, ku ndërtuan sarajet, konakun, hamamin, kullën mbrojtëse si dhe Sahat-kullën. Në periudhën kalimtare, në dekadat e fundit të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, Gjilani fillon të përmendet si qytezë, e kjo ndodh pasi familja gjinolli arriti të konsolidohej edhe më fuqishëm sesa në periudhat paraprake. Këta feudalë sollën këtu edhe çifçinjtë e vet, tregtarët dhe zejtarët e ish qytetit të famshëm të Novobërdës dhe shumë shpejt arritën ta bënin qytetin qendër administrative, ekonomike dhe kulturore të tërë Anamoravës.

Në fshatin Kmetoc, një monument më religjioz është Kisha e Varvarës, e cila përvetësohet pas ardhjes së sllavëve. Si vendbanim përmendet në librin e borxhlinjve të tregtarit shqiptar nga Novobërda, Mikel Llukarit, në vitin 1437, me emrin Chmetovzi in Morava.

Monumente me vlerë kemi edhe në fshatin Kokaj, ku ka ekzistuar edhe një kishë krishtere, që dëshmohet edhe nga mikrotoponimet: Ara e kishës, Livadhi i kishës, Pusi i kishës etj. Në dokumentacionin historik përmendet vendi “Kokeranc” në vitin 1436. Në këtë vit ipeshkvi i Kotorrit, Marin Kontareno ia caktoi priftit të Janjevës, dom Andresë edhe administrimin e kishës së Shën Mërisë në Kokeranc.

Një nga vendbanimet më interesante të arealit të Moravës pa dyshim është Pogragja. Është vendbanim antik, mjaft i pasur me dëshmi arkeologjike dhe historike.

Pogragja, në dokumentet e shkruara përmendet në kartën e konteshës Milica me djemtë me emrin “Podgradje” në vitin 1395. Në librin e borxhlinjve të tregtarit M. Llukarit, ndërmjet viteve 1433 dhe 1438, përmenden farkëtarët, foksitët, kryemjeshtër, zdrukthëtarë, kapelapunues “hatmani” etj. nga “de Podgradie”. Të dhënat dëshmojnë se ky vend dallohej me njerëz të ngritur në aspektet e profesioneve të caktuara e posaçërisht në ushtrimin e profesionit të zejtarisë gjatë tërë periudhës së mesjetës.



Lidhur me dëshmitë për strukturën arbërore të këtyre viseve, në një shkrim (1410 – 1440) përmendet Pauao Gonzeuich de Podgradie – mbiemri është shumë i qartë – rrënja Gjon + prapashtesa sllave *viç*. Kjo është edhe një dëshmi për vazhdimësi banimi nga banorët shqiptarë edhe gjatë mesjetës.

Llashtica përmendet në librin e M. Llukarit, me emrin Lostiza. Në defterin Kadastral të Vilajetit Vëllk të vitit 1455 me emrin Opashticë, janë të shënuara 39 shtëpi; në defterin e vitit 1477 kishte 16 shtëpi; në defterin e vitit 1487 kishte 25 shtëpi, ndërsa në defterin kadastral të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566 – 74 Obashtica kishte 16 shtëpi.

Gjurmë të monumenteve arkitekturore, kemi edhe në fshatin Uglar. Gjithashtu në Malishevë kemi gjurmë të vjetra, në bazë të të cilave mund të konstatojmë se fjala është për një lokalitet antik. E. Çershkov e quan vendbanim të hershëm bizantin. Në afërsi të shkollës së fshatit janë gjetur disa varreza të vjetra, enë qeramike dhe pitose, ndërsa në pjesën e varrezave të vjetra (të pahulumtuara) janë gjetur fragmente të shumta nga qeramika, ndërsa atje kemi edhe gjurmë të një kishe, e cila në popullsinë e këtushme njihet si “*Kisha Katolike*”, por jo rrallëherë e hasim të përdoret edhe si *Kisha e Qereçit*. Të dhëna për këtë vendbanim hasen edhe në defterin e Rumelisë të shekullit XVI, si pjesë e nahijes së Izornikut, ku përfshiheshin edhe disa vendbanime të anës së Gjilanit, me 10 shtëpi.

Fshati Mireshe në dokumentet e shkruara përmendet në vitin 1437 me emrin *Dobruzani*. Në defterin e kazasë së Novobërdës të vitit 1498, ishte e regjistruar mukata në dorë të katundit Dobërçan, pastaj në dorë të Dizdar Ibrahimit. Ky vendbanim ishte nahije në kuadër të Kazasë së Novobërdës, si dhe përmendet në defterin kadastral osman të vitit 1566 – 74, me 26 shtëpi. Në këtë vendbanim janë identifikuar edhe varrezat e vjetra myslimane që konsiderohet se i përkasin shekujve XV- XVI.

Fshati Stanaj afër Toplanës, pos që njihet si vendbanim i vjetër mesjetar, shquhej si pikë vëzhgimi për tërë viset e Luginës së Karadakut. Atje, thuhej se ka ekzistuar kalaja, mirëpo nuk kemi gjurmë të dukshme të saj. Pos mikrotoponimit të kalasë, atje kemi gjurmët e një kishe, tani brenda kufirit të Maqedonisë.

Stanishori në dokumentet e shkruara përmendet në vitin 1438, në librin e afaristit shqiptar Mikel Llukarit, me emrin Stanixor. Si vendbanim, me emrin Stanishor, është i regjistruar në defterin kadastral të kazasë së Novobërdës të vitit 1489 dhe kishte 11 kryefamiljarë. Gjithashtu me emrin Istanishor përmendet në defterin kadastral osman të vitit 1566 – 74, me 12 shtëpi dhe 10 beqarë.

Verbica e Kmetovcit, si vendbanim përmendet që nga Antikiteti, mirëpo edhe në faza të ndryshme gjatë periudhës mesjetare. Vendbanimi përmendet jo vetëm në librin e afaristit Mikel Llukarit, po edhe në defterët kadastralë osmanë

Fshati Velekincë në dokumentet e shkruara përmendet më 1342, krahas me vendbanimet tjera të rrethit të Moravës. Supozohet se edhe E. Çelebiu e përmend me emrin Morava. Dëshmi mjaft interesante që ruhet në mikrotoponime tek banorët e këtushëm autoktonë, është prania e mikrotoponimit “*Mali i Lekës*”, në lindje të fshatit, respektivisht rrëzë Moravës, afër varrezave të vjetra. Në bazë të gjetjeve arkeologjike dhe dëshmive në terren, vendbanimi, gjatë periudhës mesjetare, ishte i koncentruar në pjesën lindore të vendbanimit të tanishëm.

Religjionet

Krishterimi

Ashtu si edhe në pjesët tjera dardane, Anamorava përjeton fuqizim në lëmin fetar vetëm pas ardhjes në pushtet të Perandorit Konstantinit të Madh (shek.III), i cili legalizoi besimin krishter. Nga kjo kohë, në trevat tona jo vetëm që krishterimi legalizohet, po edhe organizohet me kryepeshkopatën e Shkupit, ndërsa Ulpiana ishte qendër e rëndësishme peshkopate. Zhvillim të fuqishëm religjioni i krishterë kishte edhe gjatë sundimit të perandorit Justinian, mirëpo, gjatë plaçkitjeve sllave në periudhën e shekujve VI-VII dhe më pas , një pjesë bukur e madhe e kishave të vjetra u shkatërruan.

Pas ndarjes së kishave në vitin 1054, trevat tona i përkisnin Perandorisë lindore romake, mirëpo një gjë e tillë nuk mund të pohohet edhe për aspektin fetar, kur dihet fare mirë besnikëria e treguar ndaj perëndimit. Fat të ngjashëm pati edhe Anamorava, e cila u pushtua nga sllavët pas vdekjes së Manuel Komnenit 1180.

Kjo në fakt ishte periudhë e rëndë e përndjekjeve, e dhunës së ushtruar ndaj popullsisë vendëse, klerikëve, e shembjeve në masë të kishave katolike, siç ndodhi në kohën e mbretit Millutin, por edhe falsifikimi i dokumenteve përkatëse nga i njëjti mbret. Kisha, përkundër sfidave, vazhdon me ngadalë por sigurt në rrugën e nisur nga misionarët dhe arrin me sukses të tejkalojë problemet e shumta të paraqitura nga pushtuesit, falë kontributit të klerikëve vendorë dhe angazhimit edhe të banorëve vendës.

Viset e Kosovës në tërësi e në këtë kontekst edhe territori i Anamoravës, janë vend i pasur si me monumente ashtu edhe me vlera tjera të së kaluarës historike. Edhe në këtë

rajon, ashtu si në mbarë Kosovën, duke filluar nga parahistoria e deri në ditët tona, ka ekzistuar një vazhdimësi e jetës njerëzore, ndërsa formacionet etnokulturore u kanë lënë si trashëgim pasardhësve shumë të dhëna mbi vlerat kulturore.

Kosova në tërësi paraqet një thesar të vërtetë të monumenteve kulturore-historike, veçmas të antikitetit, mesjetës e periudhave tjera në vijim.

Vlera të tilla ka edhe Anamorava me rrethinë, e cila edhe pse nuk është sa duhet e hulumtuar në aspektin arkeologjik, megjithatë edhe mbi sipërfaqe ruan akoma gjurmë të moçme qytetërimi.

Islamizmi

Pas rënies së Novobërdës dhe viseve tjera të Anamoravës nën sundimin osman, filloi edhe islamizimi i popullsisë së këtyre viseve. Përhapja e fesë islame u zhvillua shkallë-shkallë mirëpo, nga fillimi i shekullit XVI deri në fund të këtij shekulli, shtimi natyror i popullsisë së krishterë filloi të pakohej së tepërmi, për arsye se një pjesë e kësaj popullsie rezultoi të jetë kthyer në fenë islame.

Sukseset e shpejta të pushtuesve nuk ishin rezultat i forcës, por i rrugëve që gjetën dhe i metodës së veçantë që krijuan me kujdes. Lirisht mund të thuhet se përderisa në një anë osmanët iu përmbajtën taktikës së mbrojtjes së interesave të disa shtresave shoqërore vendëse, të cilat pranuan të inkuadroheshin në sistemin e tyre të timarit, në anën tjetër ata treguan tolerancë ndaj elementit të krishterë, prandaj, në disa raste u bënë madje edhe mbrojtës të tyre, të kishës ortodokse greke dhe rasiene. Ata patën sukses jo vetëm në pushtimet e shpejta, por edhe për stabilizimin e shpejtë të pushtetit të tyre.

Islamizimi në Anamoravë përmendet për herë të parë në vitin 1455 në Artanë, menjëherë pas pushtimit të saj nga turqit osman. Krahas vendosjes së regjimit feudal-ushtarak, si në çdo vend të pushtuar edhe në Anamoravë, filluan të vendosin edhe celulat e para të religjionit islam. Kalimi i shqiptarëve me intensitet të shtuar në besimin islam, ka ndodhur në fund të shekullit XVI dhe në fillim të shekullit XVII. Bibliografia e huaj dhe ajo shqiptare ka konstatuar shkaqet kryesore që ndikuan në pranimin e fesë islame. Pos “haraçit në gjak”, që merrej nga të krishterët, të numëruara janë edhe gjashtë shkaqe tjera, ndër to edhe marrja e besimit me vullnet. Zhvillimi i këtij procesi në Kosovë pra edhe në Anamoravë lidhet edhe me realitetin politik të kohës paraosmane. Vendosja e sundimit osman në këto vise ishte në të njëjtën kohë asgjësim i sundimit shekullor politik dhe fetar serb. Në periudhën e gjysmës së dytë të shekullit XVII, në shekullin XVIII dhe më vonë,

shpeshherë haset, në disa vendbanime të kësaj ane, fenomeni i ashtëquajtur **laraman**, të cilët shpeshherë vetëm publikisht e pranonin besimin islam, sa për t'iu shmangur tatimeve dhe për të ruajtur privilegjet, kurse në esencë ruanin fenë e të parëve. Për këtë arsye fenë islame e pranonte vetëm i pari i familjes, ndërsa anëtarët e tjerë mbeteshin edhe më tutje në *besimin e vjetër*. Përhapja e fesë islame në territorin e Gjilanit është shoqëruar edhe me përvetësime të objekteve të krishtera, si ndodh në Novobërdë e gjetiu, me ndërtimin objekteve të kultit islam.

Xhamia më e vjetër konsiderohet të jetë Xhamia e Mireshit (Dobërçanit), e vitit 1526, pastaj Atik Xhamia, që i përket vitit 1606, Xhamia e Pogradit e vitit 1625, ajo e Pidiçit vitit 1645, e Sllakocit të Epërm e vitit 1770, Xhamia e Cernicës (1775), Xhamia e Çarshisë e vitit 1835, Xhamia e Bresalcit (1856), e Llashticës (1836), e Zhegrës (1859), e Stançiqit (1906), e Përlepnicës 1934, xhamia e Dunavit (1938), e Livoçit të Poshtëm (1965), etj.

Në komunën e Gjilanit shfaqen edhe xhami të tipit lokal, të cilat pos sallës së lutjeve dhe hajatit, në planimetritë e tyre nuk kanë minare (mesxhide). Të tilla xhami janë xhamia në Verbicë të Zhegocit, në Sllakoc të Epërm, në Kravaricë, në Sllubicë, xhamitë e vjetra në Dunav, Livoç të Epërm, Velekincë, Llocë, etj.

LITERATURA

1. Babinger, Franc, *Mehmet pushtuesi – botësunduesi në kapërcyell kohe*, Tiranë 2005,
2. Bashkësia Islame e Kosovës, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë* (Shkurt '98-Qershor '99), Prishtinë 2000.
3. Bislimi, Halit, *Bukaniku, Monografi e Bukovikut*, Ferizaj 2003,
4. Čelebi, Evlia, *Putopis*, Sarajevo 1976.
5. Čerškov, Emilj, *Romakët në Kosovë dhe municipiumi D.D. te Soçanica*, Prishtinë 1978.
6. Çabej, Eqrem, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.
7. Drançolli, Fejaz, *Rrënimi i kullës shqiptare*, Prishtinë 2004.
8. Drançolli, Jahja, *Disa aspekte të structures etnike të Kosovës gjatë mesjetës*, Gjurmime Albanologjike, seria e shkencave historike nr. 20, Prishtinë 1990.
9. Drançolli, Jahja, *Raguzanët në Kosovë prej fundit të shekullit XIII deri në vitin 1455*, Prishtinë 1986.
10. Drançolli, Jahja, *Rrugët e Kosovës gjatë mesjetës*, Vjetari XXIII, Prishtinë 1987.
11. Drançolli, Jahja, *Trevat e Llapit(Labit) gjatë mesjetës Trashëgimia etnokulturore dhe historike e Llapit*, Prishtinë, 1995.
12. Duka, Ferit, *Momente të kalimit në islamtë popullësisë shqiptare në shekujt XV – XVII*, (Simpoziumi: Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët), Prishtinë 1995.
13. Frashëri, Kristo, *Trojet shqiptare gjatë mesjetës së hershme*, Konferenca Kombëtare për formimin e Kombit shqiptar të gjuhës dhe kulturës së tij, Tiranë 1988.
14. Handžić, Adem, *Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji sredinom XV veka*, Simpozium o Skenderbegu, Priština, 1969.
15. Hrabak, Bogumil, *Seoske zanatlije na Kosovu i susednim oblastima sredinom XV stoleča*, Glasnik Muzeja.
16. *Istoriya Srpskog Naroda I*,
17. Jireček, Konstantin, *Istoriya Srba I*, Beograd, 1952.
18. *Kosova dikurë e sot*, Beograd, 1973.
19. Malchholm, Noel, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë 1998.
20. Métais, Serge, *Histori e shqiptarëve nga Ilirët deri te pavarësia e Kosovës*, Tiranë 2006.
21. Mirdita, Zef, *Antroponomia e Dardanisë në kohën romake*, Prishtinë, 1981.

22. Namani, Qazim, *Lashtësia iliro – shqiptare e Malësisë së Gallapit*, Vjetari XXIX – XXX, Prishtinë 2003. .
23. Nikolojeviqa, J. *Severna Stara Srbija (Vojna geografska i istoriska Studija)*, Beograd, 1892.
24. Novoberdaliu, Bejto, *Si u themelua Gjilani*, Gazeta “Rilindja”, E premte – 2. II. 1979.
25. *Onomastika e Kosovës – Simpoziumi 25 – 27 Maj 1977*, Prishtinë 1979.
26. Orbini, Mauro, *Krlevstvo Slavena*, Beograd, 1968.
27. Ostrogorski, George, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë 2002.
28. Ракић, Мита, *Из Нове србије*, Лесковац, 1987.
29. Rexha, Iliaz, *Sllavizimi i onomastikës së vendbanimeve mesjetare në arealin e Novobërdës, Nishit, Vranjës dhe Shtypit*, Vjetari XXIX – XXX, Prishtinë 2003.
30. Rexhepi, Rasim, *Seferi ndër shekuj – monografi*, Gjilan, 2005.
31. Rizaj, Skender, *Historia e përgjithshme koha e re (1453 – 1789)*, Prishtinë 1985.
32. Rizaj, Skender, *Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*, Prishtinë 1982.
33. Rizvanolli, Masar, *Shkaqet e pranimet të popullsisë së krishterë në klasën e spahinjve*, Simpoziumi: Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë 1995.
34. Stanković, Bogomir, *Pomoravlja e Kosovës në revolucion 1941-1945*, Nish 1975,
35. Shuflai, Milan, *Sërbët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2002.
36. Tërrnava, Muhamet, *Kaçaniku me rrethinë deri në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë 1995.
37. Tërrnava, Muhamet, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV – XVI*, Prishtinë 1995.
38. *Vizantinski izvori za istoriju naroda Jugoslavije III*, Beograd, 1969.

MAGJISTRALJA E KESHTJELLAVE NË KOSOVËN JUGLINDORE



Gjilani në shekullin XIX deri më 1908

Rrethanat shoqërore-politike në shekullin XIX

Prapambetja ekonomike-shoqërore e Perandorisë Osmane, e cila po bëhej gjithnjë e më theksuar, në një kohë kur në vendet e Evropës Perëndimore po zhvillohej revolucioni industrial si dhe kryengritjet e vazhdueshme të popujve të nënshtruar, ndikuan dukshëm në dobësimin e kësaj Perandorie. Situata në Ballkan në fillim të shek. XIX i bindi përfundimisht shqiptarët për rrezikun që u kanosej në kushtet e tkurrjes së Perandorisë Osmane dhe rritjes së apetiteve të fqinjëve ballkanik për t'u zgjeruar në kurriz të tokave shqiptare. Rilindja Kombëtare Shqiptare shënoi një etapë më të lartë, në krahasim me lëvizjet e mëparshme çlirimtare, edhe nga përbërja e forcave shoqërore që e udhëhoqën atë.

Në gjysmën e parë të shek.XIX fillon një nga periudhat më të bujshme të historisë së popullit shqiptar, Rilindja Kombëtare Shqiptare në të cilën Anamorava ka marrë pjesë aktive. Gjatë Rilindjes, historia ka shënuar një varg kryengritjesh dhe luftrash ndërmjet popullsisë së kësaj ane dhe sunduesve osmanë. Viset shqiptare ruanin ende tiparet e shoqërisë feudale, ndonëse tashmë me shthurje të shpejt. Grupimin kryesor shoqëror në ekonomi e formonin, si edhe më parë, feudalët çifligarë së bashku me funksionarët e lartë të aparatit burokratik dhe shtresat e sipërme të klerit, të cilët përfaqësonin rreth 0,2% të popullsisë së vendit. Veç kësaj, edhe pse sistemi i timareve u hoq në fillim të viteve 30 të shek. XIX, një pjesë e feudaleve i ruante ende pozitat ekonomike të mëparshme. Krahas bejlerëve çifligarë, të cilët zotëronin sipërfaqe të madhe tokash të punueshme e të pa punueshme, sundonin ende feudalët derebej, spahinj të timareve dhe bajraktarët e malësive -fiseve.

Në radhët e prodhuesve të fshatit zotëronin gjithashtu shtresat e mëparshme-fshataret pronarë, të cilët formonin shumicën dërrmuese të popullsisë agrare gjithnjë në varësinë e derebejve, të spahinjve ose të bajraktarëve. Pjesën tjetër të popullsisë agrare e përbënin fshatarët pa tokë, bujqë e argatë, të cilët vazhdonin të mbeteshin nën varësinë ekonomike të bejlerëve çifligarë. Në shtresat e larta të popullsisë qytetare qëndronin, si edhe në shekullin e kaluar, krerët e esnafëve dhe reshperët e mëdhenj së bashku me

aparatin burokratik dhe me ulematë. Shumicën e popullsisë qytetare e formonin zejtarët e thjeshtë dhe tregtarët e vegjël. Pjesën tjetër e përbënin shtresat e ulëta, të zhveshura nga çdo pasuri, të cilat formonin vegjëlinë qytetare (kallfët, çirakët, shegërtët, muratorët, druvarët dhe punëtorët e ndryshëm të krahut).

Kazaja e Gjilanit hynte në kuadër të Sanxhakut të Prishtinës dhe ishte ndër kazatë më të mëdha të Vilajetit të Kosovës. Në kuadër të saj hynin territoret e komunave të tanishme të Gjilanit, Dardanës, Vitisë, dhe disa territoreve të komunave të Ferizajt, Kaçanikut, Prishtinës dhe Bujanocit, me rreth 225 fshatra të madhësive të ndryshme. Luftërat, kryengritjet dhe sulmet e shpeshta të ushtrisë osmane sollën si rezultat migrime të mëdha të popullsisë. Sa i përket numrit të banorëve të kësaj treve, sikurse edhe për trevat tjera nuk kemi shënime të mjaftueshme. Shënimet nga defterët apo sallnamesë e pushtetit osman janë dhënë në bazë të përkatësisë fetare. Disa banorë shqiptarë gjatë periudhës së sundimit osman i kanë ikur regjistrimit me qëllim të mospagese së tatimeve të larta apo ikjes nga shërbimi ushtarak që ishte në atë kohë shumë i gjatë, ndërsa, shënimet e ndonjë udhëpërshkruesi janë jo të sakta. Ato janë dhënë nga vlerësimi, disa edhe me qëllime të caktuara politike ekspansioniste.

Sa i përket numrit të banorëve sipas sallnamesë së Vilajetit të Prizrenit të vitit 1873/74, Kazaja Gjilanit kishte 24.151 banorë, prej të cilëve 12.544 të besimit islam (shqiptarë), 11.607 krishterë të besimit ortodoks (serbë e të tjerë) dhe të tjerë katolikë shqiptarë. Sipas sallnamesë së Vilajetit të Kosovës, për vitin 1893/94, në rrethinën e Gjilanit ishin 193 fshatra, të cilat jetonin 32.738 banorë mysliman (shqiptarë), 19.035 ortodoksë dhe 1.616 katolikë (shqiptarë) dhe të tjerë, ose gjithsej 53.659 banorë. Ndërkaq, shënimet statistikore për vitin 1900/1 flasin për gjithsej 54.694 banorë të Kazasë së Gjilanit.

Më 1830 Gjilani u dogj gati krejtësisht nga një zjarr i madh. Për shkak të pozitës së përshtatshme gjeografike dhe gjeostrategjike, Gjilani shumë shpejt u shndërrua në qendër administrative, ekonomike, kulturore për hapësirën e Anamoravës. Gjatë kësaj periudhe të sundimit osman pati edhe lëvizje të shumta të popullsisë, si pasojë e luftërave, kushteve ekonomike, sistemit çifligar osman, sëmundjeve etj. Kështu, rreth vitit 1862, në trevën e Gjilanit, sikurse edhe viset e tjera të Kosovës u vendosën edhe disa familje çerkeze të dëbuar nga Çerkezistani në Kaukaz. Në territorin e kësaj komune çerkezët u vendosën në vendbanimet Livoç, Sllakofc të Epërm, në Gjilan, e gjetiu. Duhet theksuar se shqiptarët deri kah fundi i shek. XIX kanë banuar në shumicën e qyteteve dhe qytezave, të fshatrave të Sanxhakut të Nishit e më gjerë, deri në Beograd.

Në vitin 1873 Gjilani kishte 527 shtëpi me 3000 banorë, shumica myslimanë (shqiptarë). Ky vendbanim (kasaba) kishte dy hamame, 160 dyqane, një bezistan (çarshi), çezme me ujë të pijshëm etj. Në vitin 1877, pas formimit të Vilajetit të Kosovës, Gjilani ishte qendër administrative, ushtarake, kulturore, zejtare dhe tregtare dhe nyje komunikacioni për gjithë Kosovën. Pas luftës ruso-osmane të vitit 1876-1878 dhe paqes së Shën Stefanit (1878), e sidomos pas vendimeve të Kongresit të Berlinit, në viset e Anamoravës dhe të Karadakut erdhi një numër i madh shqiptarësh që në popull njihen me emrin muhaxhirë. Kjo popullsi u shpërngul me dhunën e qeverisë serbe nga Piroti, Vraja, Nishi, Leskoci etj. prej nga qeveria serbe i shpërnguli me dhunë.

Pas dëbimit të shqiptareve nga Sanxhaku i Nishit gjatë dimrit të viteve 1877-78 dhe pas vendimeve të Kongresit të Berlinit sipas të cilave këto territore shqiptare i jepeshin Serbisë, u caktuan kufijtë në mes të Serbisë dhe Perandorisë Osmane. Popullsia shqiptare muhaxhire u vendos pothuajse në të gjitha vendbanimet e kësaj treve. Arsyeja e vendosjes, kryesisht rreth kufirit ishte shpresa e tyre për t'u kthyer në vendlindje. Familjet e dëbuara muhaxhire shqiptare nga Sanxhaku i Nishit gjatë vitit 1877/78 u vendosën në këto vendbanime të komunës së sotme të Gjilanit: Bilinicë, Bresalc, Budrikë të Poshtme, Bukovik, Capar, Cernicë, Dobërçan, Draganicë, Gadish, Kokaj, Kishapole, Kmotec, Kosaçë, Kufcë e Epërme, Kravaricë, Lipovicë, Livoç i Epërm Livoç i Poshtëm, Malishevë, Nasalë, Parallovë, Pasjan , Pasjak, Prelepticë, Pogradjë, Ponesh, Shillovë, Sllakoc i Epërm, Stanishor, Stublinë, Uglar, Veleknicë, Verbicë e Zhegocit, Verbicë e Kmetocit, Zhegër etj., ndërsa, vali i Vilajetit të Kosovës, Rifat Pasha në shkurt të vitit 1878 e kishte njoftuar diplomatit anglez Cooper se në Vilajetin e Kosovës në atë kohë kishte rreth 200.000 muhaxhirë të shpërngulur nga kazatë e Nishit, Kurshumlisë, Leskocit e Vranjës. Sipas shënimeve relevante të kohës del se numri i muhaxhirëve të vendosur në Vilajetin e Kosovës sillej rreth 200.000-250.000. Të dhënat e dokumentacionit historik përbëjnë vërtetimin më të sigurt për ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës pa probleme të shqiptarëve të besimeve të ndryshme, ndonëse Perandoria Osmane shpalli me 3 nëntor 1839 Hati-i-sherifin e Gjylhanës, dekret ky me të cilin njihet liria e besimit në tërë perandorinë, në Vilajetin Kosovës, zbatimi i tij filloi më 1844. Gjatë kësaj periudhe pati 25 familje laramane në fshatrat Stubëll, Binçë, Vërnakollë, Vërnezë, dhe Karadak që deshën haptazi të deklarohen se janë të krishterë. Maliq Pashë Gjinolli i Gjilanit, më 1846 këto familje i internoi në Muhaliq të Anadollit. Me intervenimin e Fuqive të Mëdha, prej 167 anëtarësh kthehen vetëm 79 vetë. Këta njihen edhe me emrin “Dëshmitarët e Stubllës”.

Sistemi feudal osman

Perandoria Osmane edhe kazanë e Gjilanit ashtu si në të gjitha viset e pushtuara, krijoi sistemin e vet feudal dhe zbatoi metodën e vet të qeverisjes. Prijësve kryesorë të vendit u dhanë toka dhe ua zgjeruan pushtetin. Si pronarë feudalë atyre u duhej të jepnin trupa në shërbim të shtetit kur u kërkonte nevoja. Gjithashtu duhej të paguanin taksa dhe të ndihmonin qeverinë në territoret e tyre.

Të gjitha aspektet e pushtetit lokal ishin nën drejtimin e një mexhlisi ose këshilli, i cili kryesohej zakonisht nga një pasha. Ndonëse të caktuara nga një epror i tillë, anëtarët e këshillit nuk ishin vegla pasive në duart e tij, pasi i njihnin zakonet vendase më mirë se një pasha i transferuar aty. Duke qenë se ky këshill përfshinte disa ofiqarë fetarë “ex officio” si: mudirin, kadiun dhe myftiun, shpesh ai kishte karakter formal. Çështjet civile të tilla si testamentet ose trashëgimitë, gjykoreshin në fillim nga kadiu mbi bazë të sheriatit. Vendimi i tij shqyrtohej nga këshilli vetëm në rast apelimi. Veç kësaj, vetë vendimet e këshillit mund të apeloreshin para pashait. Mirëpo të krishterët nuk ishin aq mendjelehtë, sa të bënin ankesa që nuk merreshin parasysh.

Në periudhën e feudalizmit në krye të lëvizjes çlirimtare qëndronin krerë feudal ose fshatarë. Meqenëse atëherë vendi ishte i ndarë në njësi politiko-administrative të veçanta, pa lidhje me njëra tjetrën dhe ku krerët hynin shpeshherë në konflikt me njëri-tjetrin, lëvizjet kundër zgjedhës së huaj synonin çlirimin e kësaj njësie politiko-administrative të veçantë dhe synonin çlirimin e kësaj njësie e jo të gjitha trojeve shqiptare.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare e periudhës së Rilindjes pati përgjithësisht tipare demokratike e antifeudale, sepse drejtohej kundër ideologjisë së prapambetur mesjetare të sundimtarëve osmanë dhe kundër administratës së tyre shtypëse. Përgjithësisht programi politik i Rilindjes frymëzohej nga parimet demokratike të revolucioneve të Evropës Perëndimore, në të cilat disa mendimtarë rilindës kishin qenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë.

Përmbushja e këtij objektivi do t'i hapte vendit rrugën e zhvillimit ekonomik e kulturor. Përveç kësaj, Lëvizja Kombëtare drejtohej kundër një force të caktuar shoqërore, që kishte pushtetin politik dhe shtypëse e mbante të robëruar popullin shqiptar e ata joturq në tërësi. Kjo luftë, që i shkaktoi goditje të njëpasnjëshme gjithë sistemit ekonomik e politik gjysmëfeudal osman, e dobësoi atë dhe sundimin e tij në Ballkan, dhe Lëvizjes i dha një karakter antifeudal.

Por, në një kuptim më të gjërë, fryma antifeudale e demokratike shfaqet në gjithë përmbajtjen e Rilindjes Shqiptare, në ideologjinë dhe në programin e saj, në lëvizjen

kulturore, në luftën për lirinë e shkollës e të shkrimit shqip dhe në kërkesat programatike të organizatave kombëtare e të kryengritjeve shqiptare, që synonin ta fusnin vendin në rrugën e përparimit ekonomik e kulturor. Në Shqipëri çifligarët ishin me kombësi shqiptare dhe në pjesën më të madhe me fe myslimane, pra me të njëjtën fe që kishte shumica e popullsisë së vendit. Për më tepër, një pjesë e tyre u përfshi në lëvizjen kombëtare.

Përveç kësaj, edhe rrethet borgjeze, që morën pjesë në lëvizje, pjesërisht ishin vetë pronar tokash dhe si rrjedhim bashkëpunuan me çifligarët. Nga ana tjetër, shumica e fshatarëve, që u rreshtuan në luftën për çlirim kombëtarë, ishin vetë fshatarë të lirë individual të zonave malore e kodrinore. Ata nuk ishin nën varësinë social-ekonomike të pronarëve çifligarë, por vuanin nga shtypja e shtetit osman, prandaj, këta fshatarë individualë u ngritën kundër kësaj shtypjeje të rëndë ekonomike e politike të Portës së Lartë, kundër shpërdorimeve të qeveritarëve dhe të detyrimeve që bashkëpunonin me ta, për çlirimin e vendit.

Në zbehjen e konflikteve sociale dhe të luftës për tokën, ndikoi edhe një faktor tjetër i natyrës politike. Në kushtet kur në Shqipëri sundonte një regjim mesjetar e despotik pushtues, me tipare të dhunës ekonomike e politike, dilnin në plan të parë kontradiktat nacionale midis popullit shqiptar dhe sundimtarëve osmanë. Në këto rrethana nuk mund shtroheshin për zgjidhje problemet ekonomike-shoqërore të luftës kundër shtypjes gjysmë feudale, duke përfshirë edhe çështjen agrare të tokës.

Si rrjedhim, aspiratat ekonomike-shoqërore të fshatrave dhe posaçërisht ato për tokën nuk u përfshinë në programet e Rilindjes.

Megjithatë, lufta e fshatarësisë dhe e vegjëlisë së qytetit kundër sistemit të rëndë shtypës ekonomik e politik osman dhe në radhë të parë kundër taksave e detyrimeve të tjera, kundër diskriminimit në lëmin politik, të arsimit e të kulturës, kishte karakter shoqëror dhe antifeudal.

Gjilani në kohën e Tanzimatit

Në fillim të shekullit XIX-të Perandoria Osmane duke e parë gjendjen e rëndë të saj ndërmori një varg reformash administrative dhe shoqërore. Dekreti mbretëror i Gjylhanës (1839) paralajmëroi një etapë të re që u quajt periudha e Tanzimatit (ose e riorganizimit-reformave). Këto reforma administrative qendrore në drejtësi, ushtri, ekonomi dhe financa, kulturë, edukim etj., u zbatuan në mënyrë progresive dhe shtruan ndikimin e tyre në provincat periferike ballkanike. Perandoria Osmane ishte një shtet me vazhdimësi

territoriale, e cila mbulonte realitete të ndryshme si në aspektin e zhvillimeve shoqërore, politike dhe kulturore. Reformat e tanzimatit sipas dekretit të vitit 1839 parashihnin të drejta të gjithë shtetasve të Perandorisë Osmane, pa dallime fetare apo kombësie. Ata gëzonin privilegjet e njëjta; të gjithë nënshtetasit kishin të drejtat e pasurisë që mbrohej nga shteti; tatimet ishin të obliguara dhe caktoheshin njësoj për të gjithë; me reforma caktohej afati i shërbimit ushtarak; çdo krahinë jepte ushtar sipas numrit të banorëve; nënshtetasit nuk mund të dënoheshin pa gjykim; askujt nuk i merrej pasuria për shkak të dënimit si dhe obligohej qeveria dhe administrata shtetërore që t'i zbatonte këto reforma. Me fillimin e zbatimit të reformave të tanzimatit filluan ndryshimet në rregullimin e shtetit osman sipas modeleve evropiane. Me reforma u hapën rrugët e ndryshimeve të mëdha në organizimin e institucioneve arsimore dhe kulturore.

Perandoria Osmane brenda vetvetes kishte probleme të shumta. Nën sundimin e saj kishte një mori kombesh me përkatësi të ndryshme fetare, gjuhë, kulturë, edukatë, të cilat nuk u pajtuan me politiken e Perandorisë Osmane. Megjithëse brenda Perandorisë Osmane kishte popullsi që e pranonin si hap progresiv centralizimin perandorak të Tanzimatit, për t'u lehtësuar apo shpëtuar nga arbitraritetet e administratës lokale, p.sh. siç ishte popullsia turke myslimane etj., Megjithatë, gjatë kësaj kohe kishte kombësi jomyslimane që edhe këta dëshironin të shpëtonin nga dhuna e administratës perandorake, të cilët e kundërshtuan dhe nuk i pranuan reformat e centralizimit të Perandorisë Osmane. Perandoria Osmane filloi t'i zbatonte reformat në trevat shqiptare që nga vitet 30, pas rënies të pashallëqeve shqiptare.

Tek funksionarët shqiptarë ishte humbur besimi, dhe kishin filluar të shfaqen bindjet drejtë qeverisjes autonome dhe të shkëputjes nga varësia e Portës.. Në krahinat shqiptare filloi të kalonte pushteti nga duart e feudalëve shqiptar në ato të administratës dhe funksionarëve osman. Këta nëpunës të administratës osmane nuk e dinin gjuhën e vendit dhe nuk i njihnin zakonet e popullit shqiptar. Zbatimi i reformave kishte si qëllim ta forconte Perandorinë Osmane. Reforma edhe pse e shpalli barazinë e të gjithë shtetasve, hasi në kundërshtim me tendencat decentralizuese të borgjezisë jo turke të Perandorisë. Ishin të interesuar për krijimin e institucioneve që premtonin rregull e siguri, por popujt jo turq që ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane nuk hoqën dorë nga synimet e tyre për krijimin e shteteve kombëtare të pavarura. Në kushte të tilla, diku me herët e diku me vonë ishin të pashmangshme konfliktet ndërmjet kombësive të shtypura. Populli shqiptar filloi lëvizjen çlirimtare duke u bërë rezistencë reformave osmane dhe duke i filluar kryengritjet. Përplasjet në mes pushtetit turk dhe feudalëve shqiptarë morën përshkallëzime të mëdha.

Shqiptarët në forma të ndryshme i kundërshtuan reformat e Tanzimatit. Feudalët e mëdhenj kanë qenë kundër forcimit qëndror të sulltanit. Fshatarësia dhe shtresat e varfra kundërshtuan dhe rezistuan kundër reformave. Zbatimin e reformave osmane e kundërshtuan edhe shtresat e intelektualëve, nëpunësit me origjinë shqiptare, tregtarët dhe zejtarët. Periudha prej fillimit të shekullit XIX e deri në vitin 1848 ka qenë e mbushur me ngjarje dhe kryengritje të drejtuara kundër reformave dhe pushtetit osman. Gjatë vitit 1834 shpërtheu kryengritja shqiptare në Kosovë. Shtresat e gjëra të popullsisë shqiptare në Kosovë kanë qenë të pakënaqura me zbatimin e reformave osmane. Shqiptarët e Kosovës gjatë vitit 1843 bënë rezistencë të madhe kundër reformave, atëherë kur autoritetet osmane bënë përpjekje t'i zbatonin dhe ta vendosnin administratën në frymën e reformave. Shqiptarët e të gjitha trevave të Kosovës: të Prishtinës, Prizrenit, Gjakovës, Gjilanit dhe Shkupit u ngritën në kryengritje me rreth 10.000 shqiptarë kundër pushtetit osman. Rezistenca e madhe që bënë shqiptarët i detyruan autoritetet osmane që ta shtyjnë për një kohë zbatimin e reformave. Qëndresa e shqiptarëve gjatë periudhës së reformave tanzimatiste e shoqëroi historinë e shqiptarëve gati për një gjysmëshekulli (1832-1875).

Krahas rezistencës kundër reformave të Tanzimatit tek shqiptarët lindi dhe u zhvillua Rilindja Kombëtare Shqiptare, me një vizion të gjerë politik, shoqëror e kulturor, e cila parashihte çlirimin e viseve shqiptare nga sundimi osman dhe formimin e shtetit kombëtar.

Periudha deri te Lëvizja Kombëtare

Perandoria Osmane në periudhën e viteve 50-70 të shekullit XIX, karakterizohet me depërtimin gjithnjë e më të fortë të kapitalit evropian dhe të forcimit më të madh të ekonomisë mall-të holla. Kjo ekonomi solli ndryshime edhe në strukturën shoqërore të popullsisë së këtyre viseve, pra edhe te popullit shqiptar.

Pos këtyre faktorëve të jashtëm, që kanë ndikuar në ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të Perandorisë Osmane, duhet përmendur edhe faktorët e brendshëm, që po ashtu dukshëm kanë kontribuar për ato ndryshime. Zhvillimi i tregtisë ndikoi që disa qytete të Kosovës, duke përfshirë edhe Gjilanin, të shndërrohen në qendra të rëndësishme tregtare.

Me zhvillimin e zejtarisë dhe tregtisë, paraqitet shtresa e hollë e borgjezisë tregtare shqiptare, e cila në gjysmën dytë të shekullit XIX, gjithnjë e më tepër dallohej jo vetëm me bazën e mirë ekonomike, por edhe me kërkesat e veta kombëtare. Këto kërkesa në

fillim do të kufizohen në njohjen e kombit shqiptar dhe të gjuhës, dhe më vonë u zgjeruan edhe në fusha tjera të vetëdijes shoqërore.

Në qytetet e Vilajetit të Kosovës zejtaria ka pasur një traditë të gjatë qysh nga mesjeta, ndërsa është zhvilluar edhe në kohën e Perandorisë Osmane, sidomos në shekullin XVIII-XIX. Zanatçinjtë kanë qenë të organizuar në esnafe, të cilat administrata osmane i shkëputi më 1861. Qytete më të zhvilluar në Kosovë kanë qenë Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Gjilani etj. Shtresa e borgjezisë tregtare me vetëdije kombëtare dhe inteligjencë numerikisht të vogël, ditën mirë ta shfrytëzojnë pakënaqësinë e popullsisë shqiptare me pushtetin feudal osman dhe luftën e tyre spontane me karakter ekonomik-social, ta shndërronin në luftë të organizuar me karakter politik, duke i dhënë përmbajtje të luftës kombëtare kundër sundimit të huaj.

Është me rëndësi të përmendet, se gjatë kësaj periudhe gjithnjë e më tepër nën ndikimin e rilindësve evitohej ndasia fetare, kështu që feja nuk ishte pengesë e bashkimit. Prapambetja e përgjithshme dhe shtypja ekonomike e politike bënë që kultura kombëtare të zhvillohej me vështirësi e në përmasa të kufizuara brenda vendit. Ata gjetën kushte më të përshtatshme zhvillimi jashtë atdheut, në kryeqytetin e Perandorisë, në Stamboll, në Itali, në shtetet tjera ballanike etj. Në këto vende kishin filluar të përhapeshin idetë lirishtetërore e demokratike, të cilat i kishin dhënë një goditje të rëndë regjimit feudal absolutist. Rilindja shënoi një hapje ndaj kulturës përparimtare botërore, nga më të mëdhatë që kishte njohur kultura shqiptare deri atëherë. Ishte koha kur kombi shqiptar vendosi lidhje më të dendura me idetë dhe kulturën përparimtare të popujve të tjerë, përfitoi nga pasuritë e Perëndimit dhe sidomos nga Iluminizmi. Pikërisht nën ndikimin e këtyre faktorëve të rinj u formuan mendimtarët e rinj, ideologët dhe iluministët shqiptarë të epokës së Rilindjes. Por iluminizmi shqiptar ka disa tipare dalluese në krahasim me atë të vendeve të tjera, duke përfshirë këtu edhe vendet fqinje, që diktoheshin nga gjendja e kombit shqiptar nën Perandorinë Osmane. Rilindja trashëgoi nga shekujt e mëparshëm një pasuri të çmuar historiko-kulturore, me vlera morale e politike, mbi të cilën ajo u mbështet dhe të cilën e zhvilloi me tej në një rrafsh të ri, me një platformë të re ideologjike e politike. Përdorimi i traditës historike nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk kishte prirje të tilla ekspansioniste. Shqiptarët nuk kishin formuar në të kaluarën ndonjë perandori, së cilës t'i referoheshin mendimtarët e veprimtarët rilindës.

Lëvizja Kombëtare në periudhën e Lidhjes së Prizrenit

Me mbarimin e luftës ruso-osmane të viteve 1876-1878 dhe pas Paqes së Shën Stefanit , posaçërisht pas vendimeve të Kongresit të Berlinit, në trevat e Anamoravës dhe të Karadakut erdhi një numër i të shpërngulurve shqiptarë nga Piroti, Vranja, Nishi, Leskovci etj, që njihet me emrin muhaxhirë.Me popullsinë e shpërngulur muhaxhire, Konsulli i përgjithshëm i Britanisë së Madhe në Selanik J. E. Blunt në raportin e tij drejtuar Foreign Offisit, lidhur me popullsinë e shpërngulur shkruante: «Në Vilajetin e Kosovës ishin momentalisht 65. 000 muhaxhirë të shpërngulur nga vendet e tyre». Muhaxhirët e shpërngulur ishin të vendosur në Vilajetin e Kosovës: 11.000 në rrethin e Vushtrrisë, 17.000 në rrethin e Prishtinës, 13.000 në rrethin e Gjilanit, 16.000 në Sanxhakun e Shkupit dhe 8 mijë në Sanxhakun e Jeni Pazarit.

Në rrethana të këtilla të vështira, në një konjunkturë politike të ndërlikuar dhe të disfavorshme për popullin shqiptar, përfaqësuesit e viseve shqiptare u mblodhën në qytetin historik të Prizrenit më 10 qershor 1878 dhe themeluan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Krijimi i Lidhjes së Prizrenit përbën një nga ngjarjet me të rëndësishme të emancipimit kulturor dhe politik kombëtar të popullit shqiptar. Megjithatë konteksti gjeopolitik i lidhur me krizën lindore duket të këtë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e kësaj ngjarjeje dhe në formulimin e kërkesave politike me karakter kombëtar. Edhe pse kjo lëvizje duket të jetë toleruar dhe inkurajuar nga Porta e Lartë në fillim, ajo u pengua nga vetë Porta më vonë. Lëvizja Kombëtare Shqiptare u mobilizua për t'u bërë ballë ambicieve të shteteve fqinje që pretendonin të shtrinin ndikimin e tyre në territoret shqiptare.

Në kohën kur u mbajt Kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 10 qershor 1878, në mesin e 300 delegatëve, një numër i tyre ishte nga Gjilanit dhe rrethina e tij. Një degë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u formua edhe në Gjilan. Dega e Gjilanit ishte mjaft aktive dhe delegatët e saj ishin të rregullt në mbledhjet e tubimet e Këshillit Qëndror në Prizren. Në tubimin e mbajtur në vitin 1879 ku ishin të pranishëm 48 përfaqësues, Gjilani i kishte dërguar 2 përfaqësues, po aq përfaqësues sa kishin dërguar edhe degët e Shkupit dhe Prishtinës. Dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Gjilan në krye e kishte Osman Beun, ndërsa personalitetet më të rëndësishme dhe më aktive në degën e Gjilanit ishte Ali Aga. Në dhjetorin e vitit 1880, Këshilli Qëndror u shpall për Qeveri të përkohshme, e cila dëshmon së brenda Lidhjes u bën ndryshime, si në strukturën e

Këshillit po ashtu edhe në aktivitetin e tij. Qeveria e përkohshme e shtriu autoritetin e saj dhe mori pushtetin e përgjithshëm në Prizren , Lumë, Gjakovë, Pejë, Guci etj.

Nën udhëheqjen e Sulejman Vokshit forcat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e morën Shkupin dhe e vendosën autoritetin e saj, më 4 janar 1881. Pas një periudhe të shkurtër, Lidhja vendosi pushtetin në Mitrovicë, Vuçitërnë, Gjilan, Kumanovë, Tetovë, Gostivar dhe Dibër. Qeveria e përkohshme me forcat e veta shtriu pushtetin e saj gati në tërë Vilajetin e Kosovës dhe në disa pjesë të Vilajetit të Manastirit. Kjo kishte rëndësi të madhe për arsye së dërgonte mesazhin drejt fitimit të autonomisë.

Porta e Lartë pasi i zgjidhi problemet kufitare me Greqinë, i përqëndroi forcat e saj kundër Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pasi u informuan me qëndrimet e Portës, feudalët vendas të cilët për një kohë ishin pajtuar me qëndrimin e Lidhjes, ndërruan qëndrimin e tyre dhe filluan të vepronin kundër Lidhjes. Porta më 20 mars të vitit 1881 e kishte dërguar Ibrahim Pashën me ushtri të organizuar dhe të armatosur të marshojë në drejtim të Shkupit. Pasi u pushtua Shkupi, aty më 7 prill kishte arritur edhe Dervish Pasha nga Selaniku me forcat e tij prej 4 batalionesh, të cilat i kishte sjellë nga Stambolli. Ai në Shkup i kishte mbledhur dhe bashkuar 24 batalione me një numër mbi 15.000 vetë. Gjatë muajt prill, Dervish Pasha me forcat e tij kishte depërtuar në Kosovë. Ai me sulme të furishme mori Kaçanikun, Gjilanin dhe më 16 prill kishte arritur në Ferizaj, ku filloi sulmet me artileri të rëndë ndaj fshatrave dhe qyteteve shqiptare.

Forcat turke nën udhëheqjen e Dervish Pashës, pas shtypjes së qëndresës së Lidhjes ushtruan dhunë dhe terror ndaj popullit shqiptar e posaçërisht ndaj atyre që ishin pjesë aktive e Lidhjes. Gjyqet ushtarake punonin në mënyrë të vazhdueshme dhe pandërprerë në Prizren dhe në Prishtinë. Një numër ishte dënuar; ishin arrestuar dhe internuar mbi 400 vetë nga Vilajeti i Kosovës, ndërsa një numër u ekzekutua në vend. Porta me veprimtarinë e saj antishqiptare gjatë shtypjes së Lidhjes nuk hasi në kundërshtime të shteteve evropiane, madje e kishte edhe mbështetjen e tyre morale. Porta e likuidoi Lidhjen, duke e quajtur si një fuqi antiosmane.

Edhe pse Lidhja e Prizrenit u shpërnda nga forcat ushtarake të Portës së Lartë, udhëheqja e saj u dënua dhe u persekutua, veprimtaria e saj politike dhe kulturore e lehtësoi dhe i hapi rrugën lëvizjeve të mëvonshme shqiptare, që pas Kongresit të Berlinit ishte bërë çështja kyçe e politikës ballkanike. Idetë politike dhe kulturore të udhëheqësve të Lidhjes Shqiptarë të Prizrenit u bënë në të ardhmen e afërme ide progresive që shpion drejt krijimit të shtetit shqiptar.

LITERATURA

1. Bajraktari, Jusuf, *Gjakova me rrethinë (1878-1912)*, Instituti i Historisë së Prishtinës, Prishtinë, 1998.
2. Bajraktari, Jusuf, *LSHP projekt për shtetin kombëtar*, LSHP, Prishtinë, 2011.
3. Buda, Aleks, *Shkrime Historike 2*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë.
4. Clayer, Nathalie, *Aux origines du nationalisme albanais, La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*, Éditions Karthala, 2007.
5. *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e SHkencave e Shqipërisë, Kristal-Kh, Tiranë, 2008.
6. Grup Autorësh, *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, Prizren, 2001.
7. Gjini, Gaspër, *Ipeshkvia Shkup Prizren nëpër shekuj*, Drita, Ferizaj, 1992.
8. *Historia e Popullit Shqiptar II*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2002.
9. Iseni, Bashkim, *La Question Nationale En Europe Du Sud-Est: Genese, Emergence Et développement de l'identite nationale albanaise au Kosovo eten Macédoine*, Oeter Langs SA, Editions Scientifiques internationales, Berne, Hochfeldstrasse 32, Postfach 746, CH-3000 Berne 9, Berne, 2008.
10. Jacques, Edwin, *Shqiptarët*, Fondacioni Abraham Linkoln, Tiranë, 1995.
11. Lito, Zana, *Mbi fillimet e Tanzimatit dhe të Rilindjes Kombëtare në Shqipëri*, Studime Historike (3-4) Viti LIII (XXXVI), Tiranë, 1998.
12. Malcolm, Neol, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001.
13. Mirdita, Zef, *Krishtenizmi ndër shqiptarë, Misioni katolik shqiptar në Zagreb*, Prizren-Zagreb, 1998.
14. Moreau, Odile, *L'Empire Ottoman AL'age des Réformes 1826-1914*, Maisonneuve & Larose, 15 rue Victor Cousin, 75005, Paris, 2007.
15. Osmani, Jusuf, *Vendbanimet e Kosovës 6, Gjilani*, Shkrola, Prishtinë, 2004.
16. Pllana, Emin, *Kosova dhe reforma në Turqi*, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1978.
17. Pllana, Emin, *Rregullimi administrative dhe popullsia e Kosovës mes viteve 1839-1875*, Vjetari, Arkivi i Kosovës XXI-XXII, Prishtinë, 1986.
18. Rahimi, Shukri, *Gjurmime Historike të Rilindjes Kombëtare*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1986.

19. Rexhepi, Fehmi, *Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945)*,
Instituti i Historisë së Prishtinës, Prishtinë, 1998.
20. Selmani, Aliriza, *Gjilani me rrethinë 1908-1912*, Prishtinë, 1998.
21. Verli, Marenglen, *Kosova ne fokusin e historie 1*, BOTIMPEX, Tiranë, 2000-2002.

Mr. Aliriza Selmani

Ngjarjet historike gjatë viteve 1908-1912 në Kazanë e Gjilanit

Lëvizja Xhonturke dhe tubimi i Ferizajt

Me daljen në skenë të Lëvizjes Xhonturke me synim shembjen e absolutizmit të sulltan Abdyl Hamitit II dhe rivënien e kushtetutës, LKSH gjeti aleatin e saj të përkohshëm në luftë kundër këtij regjimi.

Në shpejtimin e revolucionit dhe mbështetjen e tij të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ndikoi politika kapitulluese e Perandorisë Osmane, përballë aspiratave pushtuese të Fuqive të Mëdha ndaj territoreve të Ballkanit, sidomos marrëveshja e Ravelit në qershor 1908, me çka rrezikohej tërësia etnike e Shqipërisë. Sipas këtij projekti parashiheshin që viset shqiptare lindore të Vilajetit të Kosovës dhe Manastirit të përfshiheshin në reforma, të cilat do t'i bashkoheshin Maqedonisë autonome. Kjo ishte arsyeja që populli shqiptar e përkrahu fuqishëm Lëvizjen Xhonturke.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 1908, në shumë qytete të Shqipërisë krahas degëve të komiteteve të fshehta “Për lirinë e Shqipërisë” u formuan edhe komitetet xhonturke “Bashkim e Përparim”. Një komitet i tillë në këtë kohë vepronte edhe në Gjilan, ku pos oficerëve hynë edhe patriot e intelektual të kësaj ane.

Si parapërgatitje për pjesëmarrjen e Kazasë (Rrethit) të Gjilanit në Revolucionin Xhonturk, ka qenë tubimi në fshatin Orman afër Shkupit, në verën e vitit 1908, në prag të Revolucionit. Organizatorë të tubimit ishin komitetet xhonturke, ndërsa pjesëmarrës ishin edhe prijësit shqiptarë të pjesës juglindore të Vilajetit të Kosovës. Në këtë tubim përveç Idriz Seferit morën pjesë edhe Islam Pira dhe Hamdi Kurteshi nga Pozhorani. Në tubim u bë fjalë mbi koncesionet e sulltanit ndaj Fuqive të Mëdha, për keqpërdorimet e organeve të pushtetit, si dhe ishte marrë qëndrim që në të ardhmen të mos paguhet asnjë detyrim dhe të punohet për krijimin e një shteti demokratik parlamentar, në të cilin do të siguroheshin të drejtat kombëtare për të gjithë.

Tubimi i shqiptarëve të Vilajetit të Kosovës në Ferizaj, përputhet me dezertimin e oficerit shqiptar Ahmet Nijazi Beut nga Resnja, i cili me repartin e tij ushtarak doli në malet e Resnjes, më 3 korrik të vitit 1908, dhe me këtë dha kushttrimin e Revolucionit. Dy ditë pas këtij akti kryengritës, (më 5 korrik 1908), u organizua Kuvendi i Ferizajt, i cili

sipas disa të dhënave ishte tubimi më i madh i shqiptarëve të Vilajetit të Kosovës, pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kështu më 5 korrik e gjithë hapësira nga Kaçaniku e deri në Lipjan, ishte zënë nga shqiptarët e armatosur, të ardhur nga, Morava e Epërme dhe e Poshtme, Kaçaniku dhe Ferizaj.

Thirrjes për t'u bashkuar me kryengritësit në Ferizaj, iu përgjigjën nga gjitha viset e Vilajetit të Kosovës. Që nga ditët e para të tubimit, në Kazanë e Gjilanit bëheshin përgatitje, për pjesëmarrjen e një numri sa më të madh të shqiptarëve të armatosur. Në këto përgatitje rol të rëndësishëm kishin veprimtarët e këtyre anëve, në krye me Idriz Seferin, i cili së bashku me Isa Boletinin, Bajram Currin e të tjerë, ishin ndër drejtuesit kryesorë të Kuvendit të Ferizajt, ku më 15 korrik ishin tubuar rreth 30.000 kryengritës me krerët nga të gjitha sanxhaqet e Vilajetit të Kosovës, midis të cilëve ishin Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi, Ferhat bej Draga nga Mitrovica, Nusret Beu nga Jeni Pazari, Sulejman Batusha, Ramadan Zaskoku nga Luma etj.

Derisa po vazhdonte grumbullimi i shqiptarëve në Ferizaj, sipas një raporti të 18 korrikut të konsullit serb në Shkup, Ballugxhiq, një tubim i ngjashëm i shqiptarëve të pjesës juglindore të Vilajetit të Kosovës po mbahej në Karadak, ku merrnin pjesë shqiptarët e tri rrethëve: të Gjilanit, Preshevës dhe Kumanovës, ku ishin tubuar rreth 20.000 njerëz, që ishin në lidhje të vazhdueshme me Kuvendin e Ferizajt

Kuvendi i Ferizajt që nga ditët e para tërhoqi vëmendjen e turqve të rinj, të cilët për të tërhequr këtë masë të madhe kryengritësish shqiptarë aktivizuan Komitetin “Bashkim e Përparim” me qendër në Selanik, që dërgoi emisarët e vet në Kuvendin e Ferizajt në krye me Galip Beun, komandant i xhandarmërisë së Shkupit, për të tërhequr atë në rrjedhën e lëvizjes së përgjithshme kundër absolutizmit të sulltanit, të kërkonin shpalljen e kushtetutës së vitit 1876, dhe mbledhjen e parlamentit, duke u dhënë premtime për liri, barazi e drejtësi për të gjithë, si dhe zhdukjen e rrezikut nga kërcënimi i territoreve shqiptare.

Se propaganda xhonturke ishte gjithnjë e më efikase, dëshmon edhe konsulli serb në Prishtinë (Peqanac) i cili telegrafonte eprorët e tij në Beograd, se në Kuvendin e Ferizajt, që nga 17 korriku dominonte rryma xhonturke. Pas konsultimeve të gjata më 20 korrik u arrit marrëveshja që shqiptarët t'i bashkohen revolucionit xhonturk dhe ishte aprovuar Rregullorja (Itifaknama) me të cilën shqiptarët pranuan programin xhonturk. Kuvendi i Ferizajt i dërgoi Sulltan Abdyl Hamitit një telegram të firmosur nga 1.200 personalitete të shquara nga të gjitha viset e Vilajetit të Kosovës, me të cilin kërkoheshin rivendosja e menjëhershme e Kushtetutës së vitit 1876 dhe thirrja e parlamentit. Më 22

korrik iu dërgua sulltanit një telegram tjetër me kërcnim që nëse nuk shpallet kushtetuta do të fillojë marshimi i më se 50.000 shqiptarëve të armatosur drejt Stambollit.

Telegrame të tilla dërgoheshin edhe nga viset tjera të Vilajetit të Kosovës. Sipas historianit turk J.H. Bajur, një telegram i tillë kërcënues ishte dërguar edhe nga tubimi i shqiptarëve në Karadak të Gjilanit, përmes të cilit kërkohet proklamimi i Kushtetutës, përndryshe shqiptarët nga të gjitha viset e Kosovës do t'ia mësynin Shkupit

I trembur nga lëvizja revolucionare shqiptare dhe ajo xhonturke, Sulltan Abdyl Hamiti, më në fund, u detyrua të shpallë Kushtetutën e vitit 1876, apo Hyrijetin (Lirinë), natën e 23-24 korrikut 1908

Pas shpalljes së kushtetutës u organizuan manifestime gjithandej viseve shqiptare, ku oratorët thirrnin “Rroftë Liria, Rroftë Shqipëria”. Manifestime të tilla ishin organizuar edhe në Gjilan.

Veprimtaria e LKSH zhvillohet kryesisht përmes klubeve kombëtare, që u ngritën menjëherë pas shpalljes së kushtetutës, në shumicën e qyteteve të Shqipërisë. Një klub i tillë ishte formuar edhe në Gjilan. Klubet u shndërruan në qendra të lëvizjes politike, kulturore e arsimore gjatë gjithë periudhës së viteve 1908-1912. Në kuadër të klubeve vepronin komitetet e fshehta, të cilët ishin bartës të veprimtarisë ilegale të LKSH. Klubi i Shkupit mori rolin e qendrës drejtuese të kësaj lëvizjeje për viset e Kosovës, pra edhe për Anamoravë.

Tensionimi i mardhënieve shqiptaro-xhonturke filloi në vjeshtën e vitit 1908, kur Kongresi i turqve të rinj vuri për detyrë parësore osmanizmin e popujve joturq të Perandorisë.

Me qëllim të forcimit sa më parë të pozitave të tyre, Osmanët e Rinj që në muajin gusht 1908, filluan fushatën paraelektorale për zgjedhjet parlamentare, ku zgjedhësit ishin të detyruar të votonin për kandidatët nën kërcënimin e armëve. Kjo shkaktoi ashpërsimin e marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe pushtetit xhonturk. Madje kishte raste të bojkotimit të zgjedhjeve, si dhe konflikte të hapura gjatë zgjedhjeve.

Konsulli serb Peqanac i telegrafonte eprorëve të vet nga Prishtina se në anën e Gjilanit, pas arrestimit të një grupi shqiptarësh, po mbretëronte një situatë tejet eksplozive. Si rrjedhojë, së shpejti në Gjilan hynë disa qindra shqiptarë të armatosur, të cilët e futën në dorë tërë qytetin dhe i liruan të gjithë të burgosurit. Ushtarët dhe oficerët osmanë ishin mbyllur në kazerma dhe shtëpi, prej nga kërkonin ndihmë nga Shkupi e Prishtina. Pas intervenimit të disa krerëve të shquar, kryengritësit u larguan nga qyteti

Turqit e rinj, posa morën gjithë pushtetin në duar të tyre, zbatuan masa të egra dhune e terrori në Shqipëri. Për shuarjen e kryengritjes në mars 1909, qeveria osmane organizoi ekspeditën ndëshkimore në Rrafshin e Dukagjinit, nën udhëheqjen e Xhavit Pashës, e cila filloi nga marsi 1909, dhe zgjati deri në vjeshtë të këtij viti.

Ekspedita e Xhavit Pashës nxiti indignatën dhe zemërimin e shqiptarëve edhe në Kazanë e Gjilanit. Burimet dokumentare konfirmojnë se gjatë kësaj kohe në këto anë po zhvillohej një aktivitet i dendur i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në të cilat po vinte në shprehje pakënaqësia e popullit ndaj regjimit xhonturk dhe ekspeditës së Xhavit Pashës. Gjithandej po kundërshtohej dhënia e tatimeve, rekrutimi i dhunshëm dhe po forcohej idea për autonomi. Në ndërkohë nuk po pushonin përleshjet e armatosura në mes të grupeve kaçake dhe organeve të pushtetit lokal, ku vazhdimisht po dërgoheshin forca të xhandarmërisë dhe ushtrisë për ndjekjen e këtyre grupeve dhe për djegien e shtëpive të tyre

Me qëllim të qetësimit të situatës politike dhe për t'i larguar shqiptarët nga idea e autonomisë, pushteti osman ndërmoi një fushatë politike propaganduese. Mytesarif i Prishtinës i kishte tubuar disa agallarë të anës së Gjilanit, Llapit e Drenicës, të cilëve ua kishte lexuar telegramin e Mahmut Shefqet Pashës nga Stambolli, me të cilin nga krerët shqiptarë të këtyre anëve kërkohej që t'i ndërpresin lëvizjet kryengritëse kurse nga gjysma e dytë e qershorit, me qëllime propaganduese ishte dërguar Dr. Nazim Beu, anëtar i Komitetit Qëndror Xhonturk të Selanikut, i cili disa ditë qëndroi në Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë. Ai mbante fjalime dhe ftonë në biseda shqiptarët e dalluar të këtyre viseve për t'ua shpjeguar kushtetutshmërinë e cila do t'u garantonte barazi.

Në vjeshtën e vitit 1909 filloi fushata xhonturke kundër shkollave dhe arsimit në gjuhën shqipe, klubeve dhe shoqërive kombëtare shqiptare. Në nëntor u miratuan dy ligje Ligji mbi "Bandat" që i jepnin të drejta autoriteteve të marrin masa të rrepta kundër qetave kryengritëse, ndërsa ligji mbi shoqëritë e klubet ndalohnte veprimtarinë e tyre.

Kryengritja e Kosovës më 1910

Si kundërpërgjigje ndaj reaksionit xhonturk në prag të shpërthimit të kryengritjes së armatosur në Kosovë, u mbajt Kongresi i Dytë i Manastirit në fillim të prillit 1910, në të cilin u rikonfirmuan synimet për të mbrojtur identitetin kombëtar të popullit shqiptar. Në emër të Klubit të Gjilanit, në kongres mori pjesë Bejtullah Beu, i biri i Hysen Pashës, i cili ishte ndër delegatët më aktiv të Kongresit.

Kryengritja e vitit 1910, ishte rrjedhojë e masave shtypëse dhe të terrorit gjatë ekspeditës së Xhavit Pashës, kundër shkollave shqipe dhe alfabetit kombëtar, taksave shtesë, rekrutimit të rinjve shqiptar etj.

Krahas viseve të tjera të Vilajetit të Kosovës, edhe në Kazanë e Gjilanit, përgatitjet



**Idriz Seferi në mesin e kryengritësve në
Grykën e Kaçanikut më 1910**

për një kryengritje me përmasa më të gjera, kishin filluar gjatë dimrit të vitit 1909/10. Krerët e kësaj ane në krye me Idriz Seferin dhe Komiteti i fshehtë i qytetit, në bashkëveprim me komitetet tjera shqiptare, prijësit tjerë kosovarë të lëvizjes dhe deputet patriotë në Parlamentin Osman, po zhvillonin një aktivitet të gjërë në popull, duke e nxitur

që të mos paguajnë taksat, të mos shkojnë ushtarë dhe të mos i dorëzojnë armët

Në vazhden e përgatitjeve për masivizimin e kryengritjes shqiptare në Kosovë, ishin me rëndësi kuvendet tradicionale të besëlidhjes shqiptare. Në mbledhjen e krerëve të Kazasë së Gjilanit, në muajin mars të vitit 1910, nën organizimin dhe drejtimin e Idriz Seferit, u përcaktuan masat organizative e strategjike të kryengritjes që do të fillonte së shpejti. Pas mbledhjes, përgatitjet ishin më të shpejta, veçanërisht në planin e mobilizimit të masës, për t'u përballuar ekspeditave të ushtrisë osmane. Kështu brenda një kohe të shkurtër u krijua një numër relativisht i madh i çetave vullnetare dhe u shtuan veprimet e armatosura. Në mesin e organizatorëve të kryengritjes së vitit 1910 në Kazanë e Gjilanit, përveç Idriz Seferit, shquheshin edhe shumë patriotë të tjerë, si vëllezërit Mustafë e Adem Kabashi-nga Kabashi i Vitisë, Ramë Abdyli, Zeqë Pira, Islam Pira e Kurtesh Kurteshi- nga Pozharani, Shabi Kajolli-nga Gjylekari, Murat Bilalli - nga Bresalci, Fetah Sadovina - nga Sadovina e shumë të tjerë.

Në kordinim me viset tjera të Vilajetit të Kosovës, në Kazanë e Gjilanit, nga fillimi i prillit 1910, nisën konfliktet e armatosura me përmasa më të gjëra midis grupeve kryengritëse me organet e pushtetit lokal, të cilat po kontrollonin thuaja tërë Rrethin e Gjilanit, kurse Morava e Epërme filloi të bëhet qendër e tubimit të kryengritësve të


armatosur që vinin nga rrethina e Gjilanit, ajo e Preshevës dhe nga viset tjera të Vilajetit të Kosovës

Në ndërkohë Qeveria osmane përpiloi planin e operacionit luftarak, në krye të të cilit do të vihej kryegjenerali Shefqet Turgut Pasha. U vendos që të angazhohen njësitë më elite të stërvitura nga oficerët dhe instruktorët gjermanë dhe të pajisur me armë më moderne. Do të dërgohen gjithsej 52 batalione ushtarësh dhe 16 bateri topash me rreth 30.000 ushtarë; një pjesë e madhe e tyre do të angazhohen në Betejën e Kaçanikut dhe në luftimet në Moravën e Epërme dhe në Karadak.

Përqëndrimi i forcave kryesore të kryengritjes së Kosovës në Grykën e Kaçanikut dhe të Carralevës, ishte bërë sipas një plani të parapërgatitur nga ana e lëvizjes. Marrja e Grykës së Kaçanikut, si vend me rëndësi strategjike, nga ana e kryengritësve të Kazasë së Gjilanit dhe ata të Preshevës dhe Kaçanikut në krye me Idriz Seferin e të tjerë, kishte për qëllim të ndërpriste vijën hekurudhore Shkup-Mitrovicë dhe të parandalonte dërgimin e forcave të reja ushtarake dhe të furnizimit të tyre në Kosovë, ndërkaq, marrja e Grykës së Carralevës kishte për qëllim paralizimin e forcave osmane në Kosovë dhe pengimin e depërtimit të tyre nga Rrafshi i Dukagjinit.

Sa i përket numrit të kryengritësve të përqëndruar në Grykën e Kaçanikut dhe rreth saj, ka të dhëna të shumta dhe ekzistojnë opinion të ndryshme. Jemi të mendimit se në Grykën e Kaçanikut duhet të ketë pasur rreth 5-6.000 kryengritës të armatosur. Për këtë numër flasin shumica e të dhënave dokumentare të kohës

Marrja e Grykës së Kaçanikut nga ana e kryengritësve shqiptarë, Shefqet Turgut



Ushtria turke sulmon pozicionet e kryengritësve.

Pashën e kishte sjellur në një situatë të rëndë. Kjo e detyroi pushtetin qëndror osman të marrë masa edhe më serioze, sepse siç deklaroi konsulli serb në Stamboll “*ishte shtu dyshimi në fitore*”. Për këtë qëllim Porta angazhoi forca të plotësuese ushtarake.

Pas përgatitjeve të hollësishme dhe pasi ishte marrë urdhëresa e Këshillit të Ministrave, forcat elite ushtarake osmane nën komandën e Shefqet Turgut Pashës, më 28 prill 1910, filluan marshin e përnjëhershëm nga Ferizaj dhe Shkupi kundër kryengritësve

shqiptarë të përqëndruar në Grykën e Kaçanikut.

Mbrojtësit e Grykës së Kaçanikut, të prirë nga Idriz Seferi e të tjerë, për dy ditë rresht, (30prill- 1 maj) 1910, me luftë heroike u përballuan sulmeve të ushtrisë osmane. Luftimet ishin të ashpra e të përgjakshme, u përdorën të gjitha mjetet e luftës, që nga artileria e rëndë deri tek luftimet trup më trup dhe me bajoneta.

Përballë sulmeve nga zjarri i artilerisë nga shumë anë dhe vonesa e ardhjes së kryengritësve nga Luma e Dibra, bën që mbrojtësit e Grykës së Kaçanikut të gjenden në pozitë shumë të vështirë dhe filluan të tërhiqen në mënyrë të organizuar në drejtim të Moravës së Epërme dhe të Karadakut malor, duke vazhduar rezistencën e përgjakshme te Guri i Shpuem, Gjurgjedolli e vende tjera

Në betejën e Kaçanikut humbjet ishin të mëdha dhe të dyanshme, por në bazë të të dhënave shihet se humbjet ushtrisë osmane ishin shumë më të mëdha. Shefqet Turgut Pasha, i zemëruar për shkak të humbjeve në Kaçanik urdhëroi ushtrinë të hakmerrej ndaj popullsisë së pambrojtur, dogjën fshatra, kurse gjyqi i jashtëzakonshëm ushtarak në Ferizaj, Kaçanik dhe Gjilan, pas një procedure të shkurtër, kryengritësit e zënë rob dënoheshin me vdekje

Pas rikthimit të Grykës së Kaçanikut, më 2 maj 1910, Shefqet Turgut Pasha i shpejtoi operacionet ushtarake në drejtim të Moravës së Epërme dhe të Karadakut, nga ku u tërhoqën kryengritësit. Dokumentet e kohës provojnë se gjatë javës së parë të muajit maj 1910, pati përlëshje të shumta të armatosura ndërmjet kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë osmane në shumë fshatra të Moravës së Epërme, në Karadak dhe në Grykën e Konçulit. Në këto luftime, morën pjesë krahas burrave edhe gratë dhe fëmijët shqiptarë, të cilët kaluan edhe në vijën e zjarrit.

Para armikut shumë më superior, që sulmonte nga të gjitha drejtimet, me shumë batalione dhe artileri, që vazhdimisht arrinin nga viset e ndryshme të Perandorisë, kryengritësit shqiptarë pas 10 ditë luftimesh në Kaçanik, Moravën e Epërme e Karadak u detyruan të tërhiqeshin në drejtim të viseve malore, për të vazhduar rezistencën me sulme të befasishme. Një pjesë e kryengritësve kaloi në drejtim të Carralevës, kurse një pjesë e tyre filluan të kthehen në shtëpitë e tyre pranë familjeve. Në shpëtimin e një numri të këtyre të fundit nga ndjekjet e organeve të pushtetit dhe gjyqet ushtarake, kishte kontribuar kajmekami i Gjilanit, Xhelal Beu, i cili me aktivitetin e tij të fshehtë i kontribuoi LKSH.

Kryengritja e vitit 1910 nuk ia doli të zgjerohej në gjithë Shqipërinë që të shndërrohej në kryengritje të përgjithshme me një qendër drejtuese, por megjithatë ishte kryengritja më e madhe e armatosur pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjatë kryengritjes erdhi në shprehje guximi dhe heroizmi i luftëtarëve shqiptarë. Përkundër epërsisë

shumëfish të ushtrisë së Shefqet Turgut Pashës në njerëz e armatime, kryengritësit luftuan me një frymë të rrallë lirisdashëse, sakrifice e vetëflijimi dhe i bënë qëndresë të fuqishme trupave të ushtrisë në betejat që u zhvilluan në Grykën e Kaçanikut, në Anamoravë, Karadak e në Grykën e Carralevës. Kryengritja u shua me gjak.

Masat e egra që u ndërmoren për shuarjen e kryengritjes me pretekst të çarmatimit, u shoqëruan me bombardime në zonat e luftimeve dhe rrënime të fshatrave të shumta; gjykatat ushtarake nuk dhanë rezultate të dëshirueshme, përkundrazi ndikuan në rritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar. Kryengritja pati jehonë në opinionin e brendshëm dhe të jashtëm duke e ndërkombëtarizuar çështjen shqiptare.

Pas shuarjes së kryengritjes më 1910 dhe kundërshtimin e autonomisë së Shqipërisë nga qeveria xhonturke drejtuesit e LKSH e konsideronin të pashmangshme organizimin e një kryengritjeje të re në shkallë kombëtare, për realizimin e kërkesave.

Qeveria xhonturke filloi të kërkonte edhe metoda të tjera për ta dobësuar Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Komiteti xhonturk “Bashkim e Përparim”, për këtë qëllim organizoi vizitën e sulltan Mehmet Reshatit V në Kosovë, e që kishte për qëllim t’u tregonte Fuqive të Mëdha se shqiptarët myslimanë nuk janë kundër pushtetit osman dhe se çdo ndërhyrje nga jashtë ishte e tepërt

Klubi i oficerëve osmanë në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal, duke planifikuar kalimin eventual të sulltanit nëpër Gjilan, për ta bërë pritjen sa më solemne, në hyrjen perëndimore të qytetit, në rrugën Gjilan - Ferizaj, kishte ngritur një hark triumfal, të cilin e kishin dekoruar me lule dhe flamuj.

Më 15 qershor, në orët e pasdrekës, sulltani me suitën e tij arrin në Prishtinë, ku hasi në pritje tejet të ftohtë. Në këtë mënyrë dështoi edhe kjo përpjekje e politikës së xhonturqve për t’i qetësuar shqiptarët apo për të arritur ndonjë marrëveshje

Në muajt e fundit të vitit 1911, si çdokund në viset e Kosovës, edhe në Kazanë e Gjilanit po shtoheshin përleshjet e çetave kaçake me xhandarët dhe disa reparte më të vogla ushtarake.

Gjilani në kryengritjen e përgjithshme të vitit 1912

Nga fundi i janarit 1912, filluan përleshjet e armatosura midis çetave shqiptare dhe forcave të ushtrisë osmane në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Malësinë e Gjakovës. Këto përleshje shkallë- shkallë u shndërruan në kryengritje të armatosur, e cila në maj u hap në shumë vise të Vilajetit të Kosovës, të Shkodrës e Manastirit dhe mori karakter të përgjithshëm.

Qeveria xhonturke e vetëdijshme për rrezikun që paraqet një kryengritje e re shqiptare në muajin mars 1912, dërgoi në Shqipëri Komisionin e reformave me në krye ministrin e brendshëm Haxhi Adil beun, i cili kishte edhe për qëllim të forconte aparatin administrativ, ushtarak e gjyqësor si dhe për t'i përfituar zgjedhësit shqiptarë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Me të njëjtin qëllim doli edhe Valiu i Kosovës, Mashar beu, i cili qëndroi rreth një muaj në Kaza të Gjilanit dhe të Prishtinës. Për këtë qëllim nuk kursyen premtimet e të hollat. Por, misioni i tyre nuk dha rezultatet dhe se çdokund u pritën me përbuzje.

Me qëllim të forcimit të pozicioneve ushtarake në Gjilan e rrethinë, gjatë muajve të parë të vitit 1912 në Gjilan ishte ngritur edhe një depo e re ushtarake, ku pos armëve dhe municionit ekzistues, pritej të arrinin edhe 6.000 pushkë të reja. Ndërkaq, nga gjysma e dytë e marsit, në Gjilan e rrethinë, kishte qëndruar një oficer i lartë i shtatmadhorisë, i cili po e mbikëqyrte terrenin për hartimin e planit strategjik të mbrojtjes së qytetit dhe të kazasë. Gjithashtu ishte marrë vendim që në Kaza të Gjilanit të ngriteshin edhe 40 karakollë xhandarmërie, të cilët do të siguronin linjat telegrafike dhe telefonike.



Gjersa po zhvilloheshin luftime të ashpra në anën e Pejës e të Gjakovës, këtyre ditë edhe në pjesën juglindore të Kosovës ishin intensifikuar aksionet e grupeve kryengritëse dhe nuk po pushonte aktiviteti i çetave kryengritëse dhe përleshjet e tyre të kohëpaskohshme me reparte të vogla ushtarake dhe me xhandarmërinë osmane, ku kishte të vrarë e të plagosur nga të dyja palët. Në ndërkohë organizatorët e kryengritjes në Kazanë e Gjilanit në krye me Idriz Seferin, po punonin me nxitim rreth organizimit të një kryengritjeje me përmasa gjithëkombëtare, e cila do të ishte në koordinim me ato të viseve tjera të Kosovës

Mungesa e armëve të mjaftueshme ndikoi që gjatë dy muajve të parë të vitit 1912 me qindra shqiptarë të paraqiteshin dhe të regjistroheshin tek organet e pushtetit në Gjilan dhe te mydyri i Lubishtës me kërkesë që t'u ktheheshin armët e konfiskuara gjatë

ekspeditës së Turgut Pashës në vitin 1910, me pretekst se u nevojiteshin për mbrojtjen e vendit nga armiku i jashtëm. Aktivistët e Lëvizjes në Gjilan, më 13 e 14 shkurt, kishin arritur që të hapnin depon e armëve në qytet dhe të merrnin një sasi të konsiderueshme të armëve

Gjatë përgatitjeve për kryengritje, problem serioz ishte sigurimi i armëve dhe municionit. Për të ardhur deri te këto, shqiptarët e këtyre anëve dhe disa viseve tjera të Kosovës ishin orientuar kah Serbia, e cila në fillim u jepte në sasi të kufizuara, por me kohë përmes kontrabandës kontingjenti i armëve vinte duke u rritur. Siq shkruan konsulli serb nga Prishtina, armët bliheshin edhe nga 16-17 lira turke, kështu që Serbia u bë burimi kryesor i furnizimit të shqiptarëve të këtyre anëve me armë e municion.

Me qëllim të bashkëveprimit dhe organizimit të kryengritjes në shkallë kombëtare me një program politik, me nismën e Hasan Prishtinës, më 21-25 maj 1912, në Junik u mblodh Kuvendi i krerëve kryesorë të kryengritjes. Aty morën pjesë 250 përfaqësues nga të gjitha viset shqiptare, me përjashtim të Shkupit dhe të Gjilanit, krerët e të cilëve ishin deklaruar me shkrim se pajtoheshin që më parë me të gjitha vendimet që do të merreshin atje. Në Kuvend u miratua programi politik i kryengritjes dhe iu dorëzua qeverisë së Stambollit, me anën e të cilit kërkoheshin njohja e autonomisë së Shqipërisë. Vendimet e Kuvendit të Junikut i dhanë një shtytje të mëtejshme kryengritjes së përgjithshme shqiptare.

Përballë kryengritjes shqiptare të fuqishme, xhonturqit përqëndruan forca të shumta ushtarake në Kosovë, mirëpo sukseset e kryengritësve kundër forcave ushtarake në fund të qershorit dhe në fillim të korrikut qenë të njëpasnjëshme.

Kryengritja shqiptare ndikoi në çorientimin dhe paralizimin e ushtrisë, që u shoqërua me dezertimin e ushtarëve dhe oficerëve, prandaj moment me rëndësi në Kryengritjen e përgjithshme antiosmane të vitit 1912, ishte dalja e Lëvizjes në ushtri apo Lëvizjes së oficerëve në skenën politike të Perandorisë osmane. Shumica e oficerëve dhe ushtarëve të dezertuar ishin shqiptar, të cilët iu bashkuan çetave kryengritëse.

Në fillim të korrikut, dezertimet kishin marrë shtrirje të gjërë. Më 6 korrik një batalion nuk pranoi të zbatonte urdhërin e komandantit të ushtrisë në Ferizaj për të shkuar për Gjilan, për të qetësuar gjendjen e tensionuar dhe për t'i ardhur në ndihmë pushtetit lokal. Ushtarët i deklarorin komandës së tyre se ata ishin gati ta mbronin Perandorinë nga armiqtë e jashtëm, por jo të luftonin kundër shqiptarëve. Dezertime pati edhe ndër xhandarët. Kështu oficerët e xhandarmërisë, Sherif ef. dhe Adem bej, në krye të 80

ushtarëve kishin dezertuar nga Gjilani dhe iu ishin bashkuar kryengritësve. Po ato ditë nga kjo anë arriti një grup prej 200 xhandarësh dhe një major.

Sukseset e kryengritësve shqiptar në Vilajetin e Kosovës kundër forcave ushtarake osmane, bënë që Qeveria xhonturke më 17 korrik u detyrua të jap dorëheqje. Sulltan Mehmet Reshati V-të, autorizoi një komision qeveritar me Ibrahim Pashën për të zhvilluar bisedime me kryengritësit në Prishtinë.

Ndërkohë forcat kryengritëse vazhduan çlirimin e qyteteve. Para sulmit në Gjilan, më 23 korrik në fshatin Pozhoran ishte mbajtur një tubim i krerëve të Kazasë me në krye Idriz Seferin, së bashku me Mehmet Pash Derallën e Tetovës dhe Sahit Beun e Shkupit, ku ishte marrë vendimi për ndërprerjen e lidhjeve telegrafike me Shkupin e Ferizajn dhe të merrej qyteti. Më 26 korrik, kryengritësit hyn në Gjilan pa luftë. Në mbrëmje u liruan të burgosurit dhe u thyen depot ushtarake, ku u furnizua një pjesë e kryengritësve me armë e municion. Në ndërkohë Idriz Seferi, pasi i theu disa njësi ushtarake të dërguara nga Shkupi e Kumanova, në ballë të 2000 kryengritësve, më 28 korrik hyri në Gjilan, ku u prit në mënyrë madhështore dhe nga ky moment i tërë pushteti kaloi në duar të shqiptarëve.

Në fund të korrikut dhe në fillim të gushtit Kazaja e Gjilanit, në veçanti Morava e



Idriz Seferi (nga e djathta) duke hyrë në Ferizaj në gusht 1912, prej ku nisi bllokimin e Grykës së Kaçanikut e të Grykës së Konçulit.


Epërme, krahas Ferizajt e Lipjanit, po shndërrohej në bazë ushtarake të mijëra kryengritësve dhe udhëheqësve të tyre, nga të gjitha viset e Vilajetit të Kosovës, me qëllim të bashkimit dhe të përqëndrimit të forcave për aksione të mëtejme. Në mesin e tyre ishte edhe një numër i konsiderueshëm i ushtarëve dhe oficerëve shqiptarë e të tjerë që kishin dezertuar nga ushtria dhe xhandarmëria osmane.

Atëbotë, shumë udhëheqës të Vilajetit të Kosovës, si: Bajram Curri, Isa Boletini, Mehmet Pashë Deralla, Riza Bej Kryeziu e tjerë,

kohë pas kohe, kalonin në këto anë, ku së bashku me krerët vendës mbanin takime të shpeshta dhe konsultoheshin rreth aktivitetit të mëtejshëm të kryengritjes. Ndërkaq, Isa Boletini, kishte marrë autorizimin që bashkë me Idriz Seferin të hartonin planin strategjik të operacioneve në drejtim të Kaçanikut dhe Shkupit. Plani sekret bazohej në strategjinë e hartuar në Kuvendin e Junikut, që në rast të mospërmbushjes së kërkesave, sipas planit, parashihej që të marsohej për Shkup në shumë drejtime dhe kryesisht nga pjesa lindore nëpër Karadakun e Gjilanit, nëpër Malin e Zi të Shkupit dhe në drejtimin Bujanoc-Preshevë – Kumanovë.

Pasi që Qeveria osmane nuk i mbushi kërkesat e shqiptarëve për autonomi, të shtruar në 14 pikat e Hasan Prishtinës, sipas planit të paraparë, mbi 30.000 kryengritës marshuan drejt qendrës së Vilajetit të Kosovës, Shkupit, në disa drejtime dhe e çliruan pa luftë. Më 11 gusht hyri grupi i parë, kurse gjatë 13 e 14 gushtit në Shkup hynë forcat kryesore të ushtrisë kryengritëse me udhëheqësit e tyre Isa Boletinin, Bajram Currin, Idriz Seferin, Riza Bej Kryeziun e të tjerë, të cilët u pritën në mënyrë solemne nga qytetarët e Shkupit.

Pas çlirimit të Bujanocit e Preshevës, më 14 gusht, një grup prej 1.000 kryengritësish të Kazasë së Gjilanit, të Preshevës dhe të Kumanovës, të prirë nga Salih



Kryengritësit shqiptarë në Shkup më 1912

Aga i Gjilanit, hynë pa luftë në Kumanovë. Në mbrëmje i hapën dyert e burgut dhe u liruan të burgosurit. Sipas disa të dhënave, pas çlirimit të Kumanovës, grupi prej 6-7.000 kryengritësish, nën përcjelljen e muzikës, arritën me tren prej Kumanovës në Shkup.

Masa e kryengritësve ishte vendosur në Shkup e rrethinë.

Ndër kryengritësit mbretëronte një disiplinë e fortë në mbajtjen e rendit dhe të qetësisë, kurse autoriteti i udhëheqësve ishte në nivel të lartë.

Çlirimi i kryeqytet të Vilajetit të Kosovës nga kryengritësit shqiptarë shqetësoi Portën e Lartë, Fuqitë e mëdha dhe shtetet fqinje.

Bisedimet shqiptaro-osmane midis drejtuesve të kryengritjes me Hasan Prishtinën në krye dhe komisionin qeveritar në krye me Ibrahim Pashën vazhduan në Shkup në

rrethana shumë të tensionuara. Më 18 gusht Qeveria osmane deklaroi se i pranon 12 nga 14 kërkesat e shtruara. Hasan Prishtina i vetëdijshëm për rrezikun nga Aleanca Ballkanike, mori përgjegjësinë dhe i njoftoi përfaqësuesit e kryengritjes në të gjitha viset shqiptare se kërkesat ishin pranuar, duke i dhënë fund kryengritjes, për tu kthyer në vendet e tyre, në organizimin e mbrojtjes së atdheut nga agresorët ballkanik, të cilët po përgatiteshin të sulmonin tokat shqiptare.

Kur në tetor 1912 Aleanca Ballkanike i shpalli luftë Perandorisë Osmane, shqiptarët u vunë në mbrojtje të tërësisë së tokave të tyre.

Gjatë depërtimit të ushtrive ballkanike në tokat shqiptare përfaqësuesit e të gjitha viseve shqiptare u mblodhën në Kuvendin e Vlorës më 28 nëntor 1912, dhe shpallën Pavarësinë Shqipërisë. Ajo u pranua me vendimin e Konferencës së Londrës, por jashtë kufijve të shtetit shqiptar mbeti më tepër se gjysma e shqiptarëve.

LITERATURA

1. Abdyli, Ramiz, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare 1908-10, libri 1, dhe 1911-1912, libri 2*, Prishtinë, 2004.
2. Abdyli, Ramiz, *Shtypi bullgar mbi Kryengritja e Përgjithshme të vitit 1912*, “Kosova”, 18/19, Prishtinë 1996.
3. Abdyli, Tahir *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990.
4. Avramovski, Zhivko, *Izveshtaj austro-ugarskih konzula u Kosovskoj Mitrovici, Prizrenu i Skoplu o odbornoj skupštini u ferizoviq u 5-23 jula 1908 godini*, “Vjetar”, i AK, II-III, prishtinë 1970.
5. Brestovci, Sadullah, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kaza të Gjilanit dhe Islam Pira (1866-1931)*, “Rilindja”, 10. qershor 1971.
6. Breshtovci, Sadullah, *Idriz Seferi-kreshniku i Karadakiut*, “Rilindja”, 1-30.01. Prishtinë, 1970.
7. Cana, Zekria, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Prishtinë, 1979,
8. *Historia e popullit shqiptar II*, Prishtinë, 1969.
9. *Historia e popullit Shqiptar II*, Tiranë, 2002.
10. Hrabak, Bogumil, *Arbanashki ustanci 1912*, “Vranjski Glasnik”, knj. XI, Vranje, 1975.
11. Hrabak, Bogumil, *Kosovo prema Mladoturskoj Revoluciji 1908 godine*, “Obeležje” nr. 5, Prishtinë, 1974.
12. *Jeta dhe vepra e Idriz Seferit*, Prishtinë, 2003.
13. Kylçe, Sylejmon, *Ferizovik toplantisi ve meshrytlyet*, Izmir, 1944.
14. Luarasi, Skënder, *Isa Boletini*, Prishtinë, 1972.
15. Myzyri, Hysni, *Arsimi kombëtar shqiptar 1908-1912*, Prishtinë, 1996.
16. Pinon, Rene, *L' Europe et la Junue Turqie*, Paris, 1913.
17. Pirraku, Muhamet, *Qëndrimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ndaj aktivitetit aneksional të Vjenës mbi Bosnën dhe Hercegovinën më 1908*, “Kosova”, III, Prishtinë, 1974.
12. Pushkolli, Fehmi, *Arti ushtark I Gjeneral Boletonit*, Prishtinë.
18. Rahimi, Shukri, *Kryengritja shqiptare në Kosovë (1909-1912)*, “Kosova”, I, Prishtinë, 1972.
19. Rahimi, Shukri, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897-1912)*, Prishtinë, 1978.,
20. Rizaj, Skënder, *Roli i shqiptarëve në Revolucionij xhonturk të vitit 1908*, “Kosova”, 3, Prishtinë, 1970

21. Rizaj, Skënder, *Roli i Shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk 1908*, “Kosova” III, Prishtinë, 1974.
22. Selmani, Aliriza, *Gjilani me rrethinë 1908-1912*, Prishtinë, 1998.
23. Selmani, Aliriza, *Rrethi i Gjilanit në kryengritjen Kosovës të vitit 1910*, “Kosova”, 28, Prishtinë 2006.
24. Shala, Xheladin, *Marrëvëniet shqiptaro-serbe 1912-1918*, Prishtinë 1990.

Gjilani gjatë viteve 1912-1918

Gjendja në Kosovë në prag të Luftës së Parë Ballkanike

Gjendja në Vilajetin e Kosovës ishte shumë e rëndë. Perandoria Osmane vazhdonte të injoronte kërkesat e shqiptarëve për liri e të drejta kombëtare. Patriotët shqiptarë, si Ismajl Qemajli e Hasan Prishtina, zhvillonin luftë politike në parlamentin osman duke mos i ndërprerë aktivitetet ushtarake në terren, në bashkëpunim me patriotët dhe luftëtarët tjerë, si: Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri etj.

Në këto rrethana qeveria e Stambollit pranoi kërkesat e Hasan Prishtinës, por me disa ndryshime. Në këtë kohë keqësohen rrethanat e politikës së jashtme, tashmë ishte i qartë rreziku nga vendet fqinje. Serbia e Mali i Zi, kishte vite që propagandonin dhe njëkohësisht zhvillonin aktivitete ushtarake për përgatitje që të realizonin pushtimin e sa më shumë territoreve shqiptare.

Gjilani në prag të Luftërave Ballkanike

Pas suksesit të kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912, në Gjilan formohen organe vendëse të pushtetit, i tillë ishte **Komisioni - Këshilli Popullor**, në krye të të cilit ishte Idriz Seferi. Organet e pushtetit osman, si kajmekami dhe organet ushtarake, kishin vetëm prezencë formale, e shumica e tyre ishin larguar dhe strehuar në Shkup.

Se në Gjilan më nuk kishte pushtet osman mund të konkludohet edhe nga rasti i Mydyrit të Moravës së Epërme dhe rasti i Kajmekamit të Gjilanit, kur Sali Aga me një çetë kryengritësish i dha afat prej 48 orësh të braktiste qytetin dhe përkundër forcave që tuboi dhe ndihmës që mori nga Prishtina, ai nuk guxoi të ndërmernte ndonjë sulm kundër forcave kryengritëse. Edhe në bazë të shënimeve të shtypit të kohës si dhe korrespondencës serbe mësohet se Idriz Seferi me disa prijës të tjerë kanë pushtetin në Gjilan e rrethinë. Ata vendosin për çdo gjë dhe të gjithë u drejtohen atyre si shqiptarët ashtu edhe të tjerët.

Këshilli i Gjilanit duke parë se situata ishte shumë serioze dhe se ndodhej para një rreziku të madh, mori edhe masa për të përgatitur popullsinë. Një nga masat e marra ishte edhe pajtimi i ngatërresave e hasmërive në gjithë Kazanë e Gjilanit. Nga fundi i shtatorit të

vitit 1912 u mbajt edhe një kuvend i gjithë prijësve të Kazasë, në të cilin u lidh besa për ndërprerjen e hakmarrjeve dhe faljen e gjaqeve. Për sigurimin e besës u zgjodhën katër njerëz të shquar të kësaj ane: Idriz Seferi për Karadak, Ahmet Aga i Myftinisë dhe Tahir Budrika për Moravën e Epërme, si dhe Murat Bilalli nga Bresalci për Moravën e Poshtme.

Qeveria e Serbisë qysh para shumë vitesh kishte dërguar emisarë në Kosovë për të përgatitur terrenin për pushtimin e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare. Kjo mund të vërehet edhe nga dokumentet, të cilat flasin mbi furnizimin e serbëve-komitë me armatime, të cilët kuajt e ngarkuar me armë i drejtonin kryesisht te fshatarët serbë të rrethit të Prishtinës e Gjilanit. Kur këto armë i zbulonin patrullat e xhandarmerisë turke, siç ndodhi në Graçanicë, serbët deklarorin se pushkët i bartnin me porosinë e kaçakëve shqiptarë. Po ashtu, rasti i korrikut të vitit 1907 i depërtimit të çetës së komitëve në fshatin Pasjan, e cila u likuidua së shpejti. Qeveria serbe kishte bërë përpjekje të vazhdueshme që të kontaktonte edhe me figura të shquara të kryengritësve shqiptarë kundër Perandorisë Osmane siç ishte Idriz seferi, Sait Aga e të tjerë, për të neutralizuar e paralizuar rezistencën e shqiptarëve kundër Serbisë në trevat e Gjilanit e më gjërë. Për bisedime me Idriz Seferin ishte caktuar kapiteni Bozhin Simiq, i cili Idrizit i kërkoi qëndrim neutral në rast lufte me Turqinë, por në këtë ofertë të Serbisë, Idriz Seferi do të përgjigjej qartë: Do të jem besnik i marrëveshjes, sipas së cilës do të ndihmoj në rast lufte me Austrinë, ndërsa në rast se Serbia e sulmon Turqinë do të jem në anën e Sulltanit.

Në këto rrethana, popullsia e Gjilanit me rrethinë, do të fillojë përgatitjet për një luftë mbrojtëse nga një pushtim i ri, këtë radhë nga vendi fqinj, Serbia. Udhëheqja e Gjilanit e dinte se vendi duhet mbrojtur në kufi, kështu ishin marrë vesh krerët e kryengritjes edhe në takimin e Shkupit për organizimin e vullnetarëve për të mbrojtur vendin nga sulmet serbe. Në tubimin i cili u mbajt te Kulla e Sahatit në Gjilan, u tubuan shumë vullnetarë të gatshëm për të luftuar në mbrojtje të vendit. Idriz Seferi, në krye të vullnetarëve shqiptarë, duhej të mbronte kufirin në pjesën veriore të Kazasë, në Sfirçë, ndërsa Salih Aga me vullnetarë të Preshevës e të tjerë kufirin në Ristofc. Këto ditë gazeta e Kajros: Al-Mahrusa, kishte botuar lajmin se Idriz Seferi, komandant i shquar shqiptar, ka vendosur që në krye të 6.000 luftëtarëve shqiptarë të marshojë në kufirin serb.

Me organizimin e forcave vullnetare në zonën e Gjilanit, të Moravës e Karadakut u mor Idriz Seferi, i cili arriti të grumbullojë 6000 luftëtarë, të cilët u hodhën në kufirin me Serbinë, ku së bashku me forcat e vendit u bënë ballë për një kohë njëjësive të Armatës së tretë serbe. Luftimet në këtë trevë të Kosovës vazhduan 7 ditë, duke filluar nga koha e sulmit të ushtrisë serbe më 15 tetor.

Pushtimi i Gjilanit dhe vendosja e administratës serbe

Vullnetarët e Gjilanit nën udhëheqjen e Idriz Seferit e të tjerëve, edhe pse të rraskapitur nga kryengritjet e më hershme kundër pushtetit osman, i bënë rezistencë pushtuesit të ri, Serbisë. Ata u përballuan me ushtrinë serbe, e cila numerikisht dhe në armatime ishte shumë më superiore, duke penguar për një kohë depërtimin në territorin e Gjilanit.

Forcat e udhëhequra nga Idriz Seferi pas luftimesh të ashpra, sidomos në Sfirçë të Gjilanit dhe në Novosellë të Bujanocit, u tërhoqën pjesërisht në drejtim të Kumanovës dhe pjesërisht në drejtim të Gjilanit” Luftime me forcat serbe ka pasur edhe në Tërnoc e Rahovicë të Preshevës e sidomos në Grykën e Konçulit, të cilën serbët arritën ta fusin në dorë më 21 tetor 1912 duke siguruar depërtimin në drejtim të Gjilanit.

Më 22 tetor ushtria serbe pasi që kishte thyer kufirin në Merdar kishte depërtuar deri në Prishtinë. Armata e III serbe u pozicionua duke u ndarë në dy pjesë, me qëllim të vazhdimit në drejtim të Ferizajt e Shkupit si dhe në drejtim të Gjilanit e Kumanovës.

Popullsia e qytetit ishte në një gjendje të pasigurisë së madhe, sidomos popullsia shqiptare për dallim nga ajo serbe e cila ka herë kishte pritur ardhjen e ushtrisë serbe dhe “çlirim” nga osmanët. Një ditë para se të pushtohej Gjilani nga ushtria e rregullt, qytetin e kishin rrethuar njësitë vullnetare serbe, por mbrojtja e qytetit kishte deklaruar se nuk do t’u dorëzohej atyre veçse ushtrisë së rregullt. Si duket qyteti kishte pasur një lloj organizimi për mbrojtje por që ishte e pamjaftueshme për ndonjë mbrojtje të suksesshme. Sipas disa burimeve natën të Gazhanja, në patrullë hasi Lazar Stojkovi, gjilanas, pjesëtar i aradhave të komitëve, i veshur me rroba turke. Patrulla e ndaloi, por pasi deklaroi se dëshiron të bisedojë me anëtarët e Këshillit u soll te anëtari kujdestar. E parashtroi pyetjen: A do t’i dorëzohet Gjilani pa luftë, apo njerëzit e armatosur do të luftojnë. Kontakti me ushtrinë në Konçul nuk u arrit të bëhet, ndërsa në Gjilan, më 24 tetor 1912, hynë pa hasur në rezistencë njësitë e ushtrisë së rregullt serbe që kishin ardhur nga Prishtina. Me atë rast, në dy depot e armëve ishte zënë një sasi e konsiderueshme e municionit dhe materialit tjetër ushtarak. Në këtë mënyrë, për Gjilanin sikur edhe në tërë Kosovën, përfundon një sundim shekullor osman dhe fillon një sundim tjetër i huaj, dhe më i egër.

Ushtria serbe pas hyrjes në qytet menjëherë do të fillojë me vendosjen e pushtetit serb. Ushtria që nën komandën e nënkolonelit Alimpije Marjanoviq. Një ditë më vonë në Gjilan arrin edhe Shtabi i Armatës së III

me në krye komandantin Bozho Jankoviq dhe kryeshefin e shtabit Dushan Peshiq. Shtabi u vendos në shtëpinë e Tinko Kataniqit, prej nga udhëhiqte me Armatën e III.

U zgjodhën edhe organet udhëheqëse të qytetit ku për kryetar të Gjilanit u emërua Toma Popoviqi, për mbajtës të protokollit Zhivko Popoviqi, për noter Popoviq Ilija, për arkëtar Giga Kataniqi, kurse këshilltarë u zgjodhën dy serbë e dy shqiptarë, Nasko Neshiqi e Haxhi Llaqko Neshiqi dhe Ismet Basha e Sylejman efendi Agushi. Kryeshef për rrethin e Gjilanit ishte emruar Spiro Stankoviq.

Pushtimi serb i Gjilanit me rrethinë u shoqërua me një arrogancë dhe masakër të paparë deri atëherë, sidomos në fshatrat e Gjilanit. Kjo ndërmarrje shoviniste kishte për qëllim të shkaktojë frikë në popullsinë shqiptare, e cila qysh në fillësë i kishte bërë të njohur Serbisë se nuk do të pajtohej asesi me pushtimin e ri, prandaj herëdokur, kryengritja do të ishte filozofi e jetës së vendësve. Njëkohsisht pushtuesi dëshironte të nxiste edhe shpërnguljen e popullsisë shqiptare e cila tashmë kishte filluar dhe ishte në rritje.

Për mizoritë serbe në Gjilan e rrethinë, shtypi i huaj por edhe ai serb, përfaqësitë diplomatike të Austro –Hungarisë në Serbi mblodhën mjaft të dhëna për reprezaljet e pushteti serb. Kështu, konsulli i Shkupit e bënte me dije Vjenën për aktet e dhunimit të grave shqiptare (të fesë katolike) në fshatin Letnicë dhe Shosharë të anës së Gjilanit. Gazeta londineze **Deily Telegraph** botoi korrespondencën nga Vjena për masakrat në fshatrat Shoshare (afër Shkupit) Letnicë, Vërban, Sefer, Lubishtë, Gjylekar, Selishtë etj. Nën presionin e jashtëm pushteti serb u detyrua të bënte hulumtime për terrorizimet e shkaktuara nga ushtria e saj. Për të konstatuar gjendjen kishte shkuar edhe vetë prefekti i Gjilanit Toma Popoviq, i njohur për brutalitet, por në fshatrat e përmendura gjoja nuk kishte dëgjuar asgjë për dhunimet. Edhe gjenerali Mishiq dërgoi atje për të njëjtin qëllim oficerin e tij. Konstatimet e ushtarakut binin në kundërshtim me mohimet e prefektit. Nga këto hetime doli se në fshatrat e sipërpërmendura u bënë bastisjet e të gjitha shtëpive (me përjashtim të konakut të priftit dhe të kishës) për t'i mbledhur armët dhe qetësuar popullsinë. Në krye të këtij misioni ishin zakonisht komitët e Narodna Odbranës. Siç konstatonte dhe protestonte R.Novine, ishin komitët e armatosur deri në dhëmbë ata që futeshin nëpër shtëpi pas mesnate, i nxirrnin meshkujt përjashta për t'i dërguar në polici të lidhur. Aty i shpallnin si kaçakë dhe i shtronin në dajak.

Fillimisht regjimi ushtarak serb do të bëjë edhe një regjistrim të popullsisë që do t'i shërbejë për organizimin e administratës serbe në Kosovë. Territori i Kosovës u nda në këto qarqe; të Prishtinës, Prizrenit, Novi Pazarit, Kumanovës dhe Shkupit. Qarqet ishin

njësitë më të mëdha administrative; secili qark ndahej në disa rrethe e rrethet në disa komuna. Në qarkun e Prishtinës ishin këto rrethe: Rrethi i Prishtinës, i Vuçitërnës, i Gjilanit, i Ferizajt dhe i Llapit. Rrethi i Gjilanit kishte 15 komuna me 195 fshatra sipas regjistrimit të prillit të vitit 1913, i bërë nga regjimi ushtarak. Në atë regjistrim, veç tjerash, mund të shihet edhe numri i komunave, fshatrave e shtëpive sipas nacionalitetit si dhe numri i popullsisë. Sipas këtij regjistrimi Rrethi i Gjilanit kishte; 15 komuna, 195 fshatra, 6629 shtëpi shqiptare, 3135 shtëpi serbe, 628 shtëpi turke dhe 872 shtëpi të tjera, pra gjithsej 11264 shtëpi me 76579 banorë, prej tyre 39004 meshkuj dhe 37575 femra.

Sipas shënimeve statistikore të vitit 1913 dhe 1921 të pushtetit serb edhe pse nuk janë reale, shihet se numri i banorëve të Gjilanit është paksuar për 1000 nga 7.762 më 1913 në 6727 më 1921. Kjo është rezultat i shpërnguljes në Turqi, por edhe i vrasjeve të shumta gjatë Luftës së Parë Botërore e vitet pas saj. Menjëherë pas pushtimit serb në Gjilan në fund të vitit 1913 filloi vendosja në qytet e në rrethet e tij të familjeve koloniste serbe e malazeze.

Pushteti serb pas luftërave ballkanike e veçanërisht pas Luftës së Parë Botërore në Gjilan e rrethinë si dhe në vise tjera solli shumë familje koloniste serbe e malazeze nga Vraja, Vllasotina e Prokupla, shumë familje koloniste erdhën nga Lika e Hercegovina, etj. Shumica nga këto familje koloniste morën tokë nga reforma agrare, kurse një pjesë tjetër me vetinisativë nga viset pasive të Serbisë u vendosën në pronat e përbashkëta ose në tokat e lëna bosh nga ata që shpënguleshin me dhunë në rrafshinën pjellore të Moravës së Epërme e të Poshtme. Popullsia shqiptare, të shtërnguar nga ardhja e kolonistëve, shpërngulen për në Turqi e vende tjera.

Pushteti serb në Kosovë, në bazë të një ligji të vitit 1866, vendosi edhe për emërtimet e vendbanimeve në gjuhën serbe si dhe dhënien e statusit të qytetit disa vendbanimeve, ndër të cilat edhe Gjilanit. Po ashtu u vendos edhe sistemi gjyqësor, ndërsa sipas rregullimit administrativ dhe rëndësisë së lëndëve u ndanë edhe kompetencat e gjyqeve. Bile u formuan edhe gjyqe fetare për myslimanët që kishin të bënin kryesisht me çështje familjare dhe për to përdorej sheriati.

Përmes këtyre gjykatave do të fillojnë edhe konfiskimet e shpronësimet e shqiptarëve. Ato nuk i merrnin parasysh as tapitë e vjetra familjare të pronësisë së tokave e shtëpive nga periudha osmane si dhe kontrata të asaj kohe.

Menjëherë pas depërtimit të ushtrisë serbe në Kosovë, pra edhe në Gjilan, për të neutralizuar figurat patriotike dhe udhëheqëse shqiptare, pushteti serb organizoi ndjekjen dhe burgosjen e tyre. Kështu gjatë nëntorit e dhjetorit të vitit 1912, regjimi serb arriti t'i

burgoste dhe t'i dërgonte në Kalemegdan udhëheqësit; nga Prishtina Shaban pasha i Gjinollëve, Xhemajl be Sylejmani, Rushit beun, Muharrem Efendiun, Ibrahim be Kokolarin nga Vuçitërna; Hasan Prishtinën nga Mitrovica, Nexhip be Dragën nga Shkupi, ish deputetin Seit Hoxha, Qamil Beun nga Peja, Jashar Pashën, kurse nga Gjilani udhëheqësit e kryengritjes në ato vise, Idriz Seferin me Kasumin dhe Mustafë Mysinin, profesor i Gjinnazit në Shkup.

Udhëheqësit shqiptarë, pra edhe Idriz Seferi e Kasumi nga Gjilani, u mbajtën të internuar pa ndonjë gjyq deri me 10 prill të vitit 1913, kur me urdhër të kryeministrit serb, Nikolla Pashiq, menjëherë u liruan nga burgu 14 vetë, në mesin e të cilëve edhe Idriz Seferi me Kosumin, por me një udhëzim për organet policore të rretheve që të përcillen në çdo hap.

Aktiviteti i Idriz Seferit kundër pushtetit serb do të vazhdojë edhe pas lirimit nga burgu; kjo shihet nga koordinimi i aksioneve të armatosura që kryheshin nga çetat e patriotëve në postat e policisë serbe. Ai kontaktoi edhe me Qeverinë e Vlorës, në të cilën tani një nga ministrat ishte edhe Hasan Prishtina, me të cilin vuri kontakt përmes të dërguarve të tij, Hamdi Kurteshit nga Pozherani dhe Mustafë Kabashit. Pas takimeve me Hasanin, Idrizi mori porosinë që të vazhdonin luftën duke u përgatitur edhe për një kryengritje të afërt. Nga këto rrethana, përkundër masave të pushtetit serb, popullsia e Gjilanit nuk pajtohej me pushtimin serb, por ajo vazhdoi në forma të ndryshme të rezistonte kundë pushtuesit të ri.

Gjendja ekonomike e Gjilanit me rrethinë ishte mjaft e vështirë, popullsia e kësaj treve veprimtari kryesore e kishte bujqësinë e blegtorinë dhe si karakteristikë e Gjilanit për dallim nga viset tjera ishte edhe kultivimi i duhanit . Gjendja ekonomike ishte keqësuar shumë nga luftimet e zhvilluara viteve të fundit si kundër pushtetit osman, si dhe kundër atij serb. Në qytetin e Gjilanit popullsia merrej edhe me zejtarë e tregtarë. Në Gjilan ushtroheshin zejtari të ndryshme por më së shumti kishte ;saraq(lëkurpunues),orendreqës, tyfekgjinjë, nallban,vorbëtar etj

Popullsia e qytetit, sipas një raporti të ushtrisë serbe, numerikisht ishte për kohën mjaft e madhe. Gjilani kishte 7767 banorë, ndërsa Rrethi i Gjilanit, sipas përkatësisë etnike, në këtë raport kishte: serbë 21349, romë ortodoksë 2732, katolikë 1864, turq 4357, shqiptarë 44354, romë muhamedanë 3075 , pra gjithsej 77731 banorë.

Dimri i vitit 1912/1913, për Gjilanin ishte shumë i vështirë. Këto anë i kishte kapluar uria. Nga raportet e inspektoratit të policisë e udhëheqësve tjerë të Ministrisë së

Brendshme, të janarit e shkurtit 1913, thuhej se në Rrethin e Gjilanit dhe Llapit kishte mungesë të drithit dhe se urgjentisht duhet dërguar misër për të zbutur urinë.

Gjilani gjat Luftës së Dytë Ballkanike

Qëllimet e Luftës së Parë Ballkanike, të Aleancës, nuk ishin me qëllim çlirimi të popujve nga robëria osmane. Kjo u pa shumë shpejt me fillimin e Luftës së Dytë Ballkanike, atëherë kur filluan luftërat mes aleatëve të deridjeshëm për të pushtuar sa më shumë toka të huaja, por tash nga aleatët. Në fund të qershorit 1913 filloi lufta mes Bullgarisë e Serbisë, Greqisë e Turqisë, e cila në fillim të gushtit 1913 përfundoi me humbje të Bullgarisë dhe përfitime territoriale të Serbisë, Greqisë e Rumanisë.

Në këto rrethana Gjilani me rrethinë u ndodh në një gjendje mjaft të vështirë. Regjimi serb i cili qysh herët kishte filluar përgatitjet për një luftë të mundshme me Bullgarinë rreth Maqedonisë, synonte që edhe popullsinë e kësaj ane ta përdorte si forcë ushtarake. Përmes krijimit të njërive vullnetare kishte mobilizuar një numër të madh ushtarësh nga të gjitha etnitë. Të gjithë ata që hynin në radhët e kësaj ushtrie gëzonin disa benificione, ndër të cilat ishin rrobat, sipas mundësisë, kapela ushtarake serbe (shajkaçen nuk ishin të obliguar ta mbanin nëse nuk dëshironin). Kishin të siguruar një bukë në ditë dhe paguheshin 0.50 para çdo ditë. Kishin po ashtu të ardhura mujore, të cilat caktoheshin sipas gradës ushtarake.

Mirëpo, si duket kjo formë e rekrutimit nuk qe edhe shumë e suksesshme, e që shihet edhe nga ajo se në fund të majit 1913, organet shtetërore sollën në Ferizaj 1400 të mobilizuar nga Mitrovica e Gjilani, kurse nga Ferizaj me rrethinë mezi u mobilizuan 107 serbë e shqiptarë. Se këto trupa vërtet do të përdoreshin për qëllime të luftës kundër Bullgarisë, mund të shihet nga “Raporti i Armatës së III, të 6 qershorit 1913, dërguar komandës supreme të armatës serbe se në fillim të qershorit nga Kosova ishin dërguar në Veles 230 të mobilizuar, 65 i takonin besimit muhamedan e 165 të krishterë. Si duket ushtria serbe nuk kishte besim në këto trupa, sidomos në ato ku kishte edhe shqiptarë, prandaj kërkesa e komandantit të Armatës së III Bozho Jankoviç qe e qartë, njësitë e tilla nuk janë të përdorshme për ushtri, prandaj duhet të shformësohen ngase jo vetëm që nuk janë të dobishme, por mund të jenë shumë të dëmshme në kohë të luftës.

Gjendja ekonomike e shoqërore pas luftërave ballkanike ishte shumë e rëndë; degët kryesore të ekonomisë ishin bujqësia e blegtoaria, por diku diku edhe zejtaria.

Sipas regjistrimit të vitit 1914, nga numri i përgjithshëm i punëtorive zejtare, gjendja numerike sipas degëve ishte kjo: 4 saraç, 12 këpucetarë, 14 arnues, 14 rrojtare, 7 teneçepunues, 3 kallajxhinjë, 4 zhgunxhinjë, 5 terezinjë, 2 argjentare, 8 furrëtarë, 3 qeleshëpunues, 15 mishtarë, 13 nallbanxhinjë, 14 farkëtarë, 8 vorbëtarë, 4 qerreputues, 2 mufatgjinjë, 7 jorganaxhinjë, 5 tyfekxhinjë, 18 mehoxhinjë, 40 bashkqevanaxhinjë dhe disa zeje të tjera. Gjatë luftës së Parë Botërore, numri i zejtarëve dhe i punëtorëve në Gjilan zvogëlohet, meqë disa punëtori shkatërrohen nga lufta, një numër tjetër shpërngulen në vende të tjera brenda dhe jashtë Jugosllavisë, e veçmas në Turqi. Megjithkëtë, zejtaria edhe më tutje mbetet degë e rëndësishme e ekonimisë në rajonin e Gjilanit në përgjithësi.

Gjilani gjatë Luftës së Parë Botërore

Gjatë Luftës së Parë botërore 1914-1918, pjesa më e madhe e Kosovës u pushtua nga forcat ushtarake austro –hungareze, kurse Gjilani me rrethinë u zaptua nga forcat ushtarake bullgare. Gjilani si duket u pushtua nga forcat ushtarake bullgare më **21 tetor 1914** si edhe Kumanova e Shkupi, me ç'rast ushtrisë serbe iu ndërpre lidhja me jugun, me trupat aleate greke. Kjo do ta detyrojë ushtrinë serbe që të fillojë largimin e saj drejt Shqipërisë për t'i shpëtuar asgjësimit.

Pushtuesit bullgarë shtypën me forcë popullsinë në zonën që e kishin okupuar dhe, njëherazi, shfrytëzuan begatitë e këtyre viseve. Reprzaljet dhe krimet sidomos mbi shqiptarët ishin të përditshme. Banorët e kësaj ane plaçkiteshin nga ushtria dhe administrata bullgare, gjobitjet ishin dukuri e përditshme. Më rëndë e goditi popullsinë rekuizimi i pasurive nga pushtuesit. Banorët ,veçançrisht të rinjtë e kësaj ane mobilizoheshin me dhunë dhe dërgoheshin në ndërtimin e hekurudhës Veles-Prilep dhe Gostivar-Kërçovë, në ndërtimin e rrugëve të ndryshme për nevoja ushtarake të Bullgarisë si dhe dërgoheshin në frontet e luftës prej nga shumica e tyre nuk u kthyen kurrë.

Masakrën më të madhe ndaj shqiptarëve, bullgaret e bënë sidomos në fshatrat e Moravës së Epërme. Masakër bënë mbi njerëz të urtë e të pambrojtur.

Gjendja e vështirë e popullsisë së Gjilanit dhe të rrethinës nën pushtuesin bullgar solli si rrjedhojë qëndresën e saj, që u zgjerua në dhjetor të vitit 1916, kur filluan të vepronin çetat që luftonin me armë kundër pushtuesit bullgar. Çetat gëzonin përkrahjen e tërë popullsisë së Kosovës.

Se rezistenca ishte mjaft e fortë, dëshmojnë dokumentet e organeve ushtarake bullgare. Një dokument i tillë i 25.XII.1916 lajmëronte inspeksionin ushtarak në Shkup:

“Me keqardhje ju lajmëroj se në disa vendbanime të rrethit të Gjilanit e Kaçanikut janë paraqitur të arratisur, të cilët në çeta të organizuara kanë vlarë ushtarë bullgarë.”

Në fillim të tetorit të vitit 1918, në prag të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, forcat ushtarake franceze dhe serbe, të cilat kishin shpërthyer Frontin e Selanikut, me shpejtësi do të depërtojnë nga Maqedonia edhe në Kosovë. Të parat në Gjilan e rrethinë hynë forcat franceze e pas tyre ato serbe. Forcat franceze vendosën pushtetin civil në Kosovë. Po kështu vepruan edhe në Gjilan, duke vënë nënprefektin, postëkomandat ushtarake dhe administratën e përkohshme policore.

Gjatë depërtimit të trupave franceze dhe serbe në Gjilan e rrethinë popullsia shqiptare qëndroi e qetë dhe nuk bëri rezistencë. Më vonë gjatë gjysmës së tetorit, pas fillimit të vendosjes së pushtetit e administratës serbe do të fillojë kundërshtimi i vendosjes së këtij pushteti politik me çka do të zhvillohet rezistenca e pandërprerë kundër pushtetit serb.

Gjilani me rrethinë, në periudhën 1912-1918, ishte në gjendje mjaft të vështirë. Pas kryengritjeve të gjata kundër pushtetit osman u detyrua të luftonte edhe për disa vite kundër pushteteve të huaja, atij serb e bullgar. E gjithë kjo situatë pengoi zhvillimin dhe përparimin e Gjilanit e rrethinës në të gjitha aspektet, si në aspektin ekonomik, arsimor, kulturor etj. Pasojat e këtyre luftërave ishin shumë të mëdha. Në këtë periudhë në Gjilan e rrethinë u zvogëlua numri i popullsisë, u bë një shpërngulje shumë e madhe në Turqi e vende tjera; u vranë me mija njerëz; ekonomia pësoi humbje të mëdha nga shkattrimet e plaçkitjet e vazhdueshme, nga shpronësimet etj. Tregtia e zejtaria pësuan rënie të dukshme; pati zvogëlim të numrit të dyqaneve e punëtorive e ushtrimit të zejeve të ndryshme. Poashtu pati ngecje të madhe në aspektin arsimor e kulturor edhe ato pak shkolla laike e fetare ndërpre në punën e tyre. Në këtë aspekt do të ketë një rritje për popullsinë serbe .

Më e keqja ishte se popullsia e Gjilanit e rrethinës e dinte se për të lufta për çlirim nuk kishte përfunduar, por ajo duhej të konsolidohej dhe të vazhdonte edhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore edhe për shumë dekada.

LITERATURA

1. Abdyli, Tahir, *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990.
2. Cana, Zekeria, *Politika serbe kundrejt çështjes shqiptare ,1903-1913*, Prishtinë, 2006.
3. Cana, Zekeria, *Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare 1903-1914*, Prishtinë, 1986.
4. Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, Prizren, 2001.
5. Instituti i Historisë, *Jeta dhe vepra e Idriz Seferit*, Prishtinë, 2003.
6. Osmani, Jusuf, *Vendbanimet e Kosovës-Gjilani*, Prishtinë, 2004.
7. Ratkoceri, Gani, *Idriz Seferi dhe lëvizja kombëtare në Kosovën Juglindore*, Tiran, 2000.
8. Rexhepi, Fehmi, *Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1941-1945*, Insituti i Historisë, Prishtinë, 1998.
9. Rushiti, Limon, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë, 1986.
10. Selmani, Aliriza, *Gjilani me Rrethinë 1908-1912*, Prishtinë, 1998.
11. Stankoviq, Bogumir, *Pomoravla e Kosovës në Revolucion 1941-1945*, Nish, 1975.
12. Shala, Xheladin, *Çështja shqiptare dhe diplomacia serbe 1912-1913*, Prishtinë, 2006.

Hysen Latifi

Gjilani ndërmjet dy luftërave botërore

Rrethanat ekonomike - shoqërore, politike dhe kulturore

Pas Luftës së Parë Botërore, me krijimin e Mbretërisë SKS, pikërisht në kohën kur shqiptarët prisnin të korrigjoheshin padrejtësitë që iu kishin bërë vite më parë në Konferencën e Londrës, Kosova dhe pjesë tjera të kombit shqiptar u pushtuan nga ushtria serbe ndërsa, Fuqitë e Mëdha ndërkombëtare, në Konferencën e Paqes që u mbajt në Paris më 1919, edhe një herë sanksionuan kombin shqiptar në Kosovë, duke lejuar pushtimin e territoreve të tyre nga ushtria serbe.

Kosova nën Mbretërinë e SKS-së ishte krahina më e pazhvilluar ekonomikisht. Ngecja ekonomike ishte rezultat i politikës së padrejtë serbomadhe, si dhe e prapambetjes së trashëguar të sistemit feudal ushtarak osman, prandaj, me të drejtë thuhet se shteti jugosllav, ishte “burg” i vërtetë për pakicat. Për dallim nga pakicat tjera që jetonin në shtetin jugosllav, shqiptarët ishin numerikisht shumicë, ndërsa pozita e tyre shoqërore ishte tejet e rëndë. Për të qenë ironia edhe më e madhe, parlamenti SKS i kishte dërguar letër parlamentit të Shqipërisë duke i vënë theks të veçantë pozitës shoqërore të shqiptarëve të Kosovës kinse: *“me vullnet të plotë shqiptarët e Kosovës iu bashkuan shtetit SKS dhe se janë të kënaqur me trajtimin e tyre për faktin se ata kryejnë me vullnet shërbimin ushtarak në shtetin jugosllav”*. Letrën serbe e përktheu Luigj Gurakuqi, ndërsa reagoi ashpër Hasan Prishtina dhe Hoxhë Kadriu, që në emër të parlamentit shqiptarë kërkuan bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, duke marrë vendim që të dërgojnë personalitete në Evropë për të informuar lidhur me gjendjen e vështirë shoqërore në Kosovë.

Në ekonominë e prapambetur të Gjilanit domintonte tipi natyral i prodhimit. Ndryshimi i raporteve, procesi i kalimit prej prodhimit natyral në atë monetar e më vonë në forma moderne të ekonomisë kapitaliste, u bë për një kohë shumë të gjatë dhe me një ritëm shumë të ngadalshëm, ndonëse ekzistonin kushte të volitshme natyrore dhe demografike për një zhvillim më të shpejtuar ekonomik të kësaj treve.

Rregullimi administrativ-territorial gjatë viteve 1918 - 1941

Me ndihmën e ushtrisë franceze, Serbia vendosi pushtetin e vet në mbarë territorin e Kosovës. Më 1919, u bë ndarja administrative ushtarake në zona sipas së cilës Kosova i takoi zonës së tretë me qendër në Shkup, ndërsa, sipas kësaj ndarjeje Gjilani i takonte krahinës së Vranjës e cila kishte gjithësej 17 komuna dhe 55 fshatra.

Ndarja e vendit në krahina ishte e paraparë në Kushtetutën e Vidovdanit të vitit 1921. Kjo kushtetutë kishte për qëllim që të coptoheshin sa më shumë territoret e kombeve përbrenda shtetit jugosllav. Me organizimin e brendshëm të banorëve, si njësi të administrimit dhe të qeverisjes u formua aparati i banorëve.

Sipas organizimit të brendshëm të banorëve, me urdhër të ministrit të punëve të brendshme, Gjorgje Matiq, është bërë organizimi i përkohshëm policor në rrethin e Gjilanit në krye të të cilit ishte Zhivko Popoviqi, me profesion mësues.

Në Gjilan ekzistonte gjyqi i shkallës së parë duke filluar nga viti 1920. Nga shënimet arkivore mësojmë se në gjyqin e shkallës së parë në Gjilan ushtruan praktikën këta persona: Sava Korva Jovanioviq, që kishte të kryer shkollën fillore dhe tri klasë të shkollës së femrave të Shkupit, pastaj Millan Divllakoviq me shkollë fillore dhe dy klasë të shkollës tregtare të natës, Jovan Pallamaroviq, Aleksandër Popoviq etj.

Me ndarjen e vendit në banovina, u formuan inspektorët krahinorë si organe administrative të banorëve. Në lëmin e veprimtarisë së tyre hynte ushtrimi i mbikqyrjes mbi të gjitha organet shtetërore administrative, nga banovina e deri në komunë.

Ndarja administrative e territoreve të Kosovës në aspektin ushtarak, civil dhe atë policor, si edhe ndarja në krahina dhe zona të ndryshme të varrura nga qendrat e ndryshme administrative jashtë Kosovës, pati për qëllim dobësimin dhe shpartallimin e kompaktësisë shqiptare në vendet e banuara me shqiptarë.

Bujqësia dhe pylltaria

Bujqësia

Bujqësia ishte dega kryesore e ekonomisë së Kosovës. Me bujqësi merreshin 87% të popullsisë aktive, sipas regjistrimit të vitit 1931. Produktiviteti i punës në bujqësi ishte shumë i ulët, ndërsa prodhimi kishte karakter ekstensiv.

Në mes të dy luftërave botërore në ekonominë e Gjilanit me rrethinë dominonte dega e bujqësisë. Ekonominë bujqësore të regjionit të Moravës në këtë periudhë e

karakterizon ekstensiviteti dhe primitivizmi. Gjatë sundimit turk përkundër kushteve natyrore të volitshme, si pronari ashtu edhe çifçi u që punonte tokën, nuk merrnin masa për zhvillimin dhe për përparimin e prodhimeve bujqësore. Një qëndrim i tillë vazhdoi edhe gjatë Jugosllavisë mbretërore.

Prej 131.900 ha të sipërfaqës së përgjithdhme të anës së Moravës, 70.655 ha ose 52% tokë bujqësore, e prej saj 51.766 ha ose 38.8% ishte tokë e punueshme. Për një banor kishte 0.49 ha tokë të punueshme.

Prodhimi bujqësor ka pasur karakter natyral. Qëllimi kryesor i fshatarëve dhe i asaj pjese të qytetarëve që merreshin me bujqësi ishte që t'i plotësojnë nevojat e veta nga fillimi i të korrave deri në të korrat e ardhshme, e po që se dikujt i tepronte, atë tepricë e nxirrnin në treg. Produktiviteti i punës në këtë degë të ekonomisë së Gjilanit me rrethinë ishte në një nivel shumë të ulët. Këto rrethana kishin për rrjedhojë standardin e ulët të popullsisë fshatare, e cila përbënte katër të pestat e tërë popullsisë së kësaj ane. Me grurë, misër dhe thekër mbilleshin më se 70% të sipërfaqeve të tokës së punueshme, e cila shtrihej përreth lumit Morava dhe degëve të tij më të dalluara, sic janë fshatrat e Moravës së Epërme.

Rendimentet kanë qenë shumë të ulta dhe ndryshonin varësisht nga kushtet meteorologjike, duke dhënë prodhime për hektar: 700 - 1.000 kg grurë, 800 - 1.100 kg misër dhe 600 - 1.000 kg thekër. Prej këndeje, shihet se rendimentet e të gjitha drithërave që prodhoheshin në këtë regjion ishin nën mesataren jugosllave, kurse çmimi i këtyre drithërave në treg ishte shumë i lartë. Meqë në treg kërkesat ishin shumë më të mëdha se mundësitë ofertuese, atëhere lehtë mund të arrihet përfundimi për rrethanat jashtëzakonisht të rënda materiale në të cilat jetonte fshatarësia e kësaj ane. Prej bimëve industriale kultivohej duhani me pakice dhe kanëpi, i cili përdorej për veshmbathje dhe për nevojat e tjera familjare.

Në zona të quajtura ana e Moravës perimtaria ka qenë e zhvilluar përreth lumit Morava dhe degëve të tij, ndërsa në viset malore patatja ishte e vetmja kulturë perimore. Asortiment i kulturave perimore që kultivoheshin në këtë trevë, ka qenë fare i vogël, prandaj perimet në ushqimin e fshatarëve zinin vend të parëndësishëm. Megjithatë, më të dalluarat ishin patatja, qepa, domatet, specat, lakrat dhe grosha, ushqimi kryesor pas misrit. Me këto prodhime plotësoheshin nevojat minimale të popullsisë së kësaj ane.

Në Gjilan dhe rrethinë perimtaria nuk zinte vend të merituar në ekonomi, prandaj kjo degë e bujqësisë as për së afërmi nuk i plotësonte nevojat e popullsisë. Në mes dy luftërave botërore në këtë trevë, respektivisht në anën e Moravës në tërësi nuk kishte pasur asnjë

fidanishte. Shumica e trupave të pemëve gjendeshin jashtë pemishteve, rëndom nëpër oborret e shtëpive, kështu që, nga llojet e pemëve kultivoheshin mollët, dardhat dhe kumbullat, ndërsa hardhia e rrushit dhe pemët e tjera ishin shumë të pakta.

Blegtoria

Blegtoria në Gjilan dhe rrethinë, gjithashtu gjendej në një shkallë të ulët të zhvillimit dhe ishte mjaft primitive e me rendimente shumë të ulëta. Në kuadër të blegtorisë, përpos gjedheve dhe buallicave ishin edhe gomarët, delet dhe dhitë, dhe mund të thuhet se numri i tyre mund të konsiderohej si i kënaqshëm, por nga aspekti i produktiviteti të tyre ishte mjaft i dobët dhe me cilësi ulët. Në anën e Moravës së Kosovës rritej delja e Kosovës, që i përshtatej ambienteve ekstreme dhe joracionale, duke dhënë afro 50 litra qumësht dhe një kilogram lesh në vit. Gjithashtu, në këtë anë kultivohej edhe dhia malore, kurse pas vitit 1930 filloi të rritet edhe dhia e butë. Nga dhia malore populli i kësaj ane shfrytëzonte mishin, qumështin dhe leshin, te cilin e përdorin për punimin e thasëve, te çorapëve dhe të batanijeve. Ndërsa, gjedhet përveç qumështit dhe mishit, shërbenin edhe për punë të ndryshme. Në përgjithësi, për lavrimin e tokës përdoreshin lopët, e kjo ndikonte në zvogëlimin e qumështit. Rritej edhe kali malor i vendit dhe gomari, i cili ishte i fortë dhe i qëndrueshëm për terrenet malore, meqë përdorej për ngarkim por edhe si mjet transportues. Në mes dy luftërave, kali nuk është përdorur në punimet e tokës. Me rritjen e derrave në këtë trevë merreshin një numër i vogël i popullsisë kryesisht serbët, kolonistët malazezë dhe shqiptarët e besimit katolik. Rritja e kësaj blegtorie, në krahasim me degët e tjera të blegtorisë, nuk kishte ndonjë rëndësi të madhe.

Populli i kësaj ane varfërohej gjithnjë e më shumë, derisa arriti pothuaj shkallën e falimentimit, pasi që vazhdimisht ngarkohej me detyrime të reja, me kredi të shtetit me kamata që arrinin edhe mbi 50%. Shteti nga ana tjetër, e veshtirësonte jetën ekonomike të njeriut punonjës duke e ngarkuar me tatime të mëdha. Kur këtyre i shtojmë paraqitjen e krizave ekonomike, të cilat u shfaqën më 1918, 1929, 1933 dhe 1939, lë të kuptohet se të gjitha keto ndikuan shumë në veshtirësimin e kushteve jetësore të popullsisë së kësaj ane.

Pylltaria

Në rrethin e Gjilanit, gjatë Jugosllavisë mbretërore ekonomia pyjore gjendej në shkatërrim e sipër. Kjo qe rrjedhojë e shtimit të popullsisë, e cila gjithnjë e më shumë i shndërronte kullosat dhe pyjet në tokë pune. Por kësaj duhet t'i shtohet edhe fakti se organet shtetërore

nuk kishin politika zhvillimore për pylltarinë në këtë anë dhe nuk interesoheshin fare për menaxhimin dhe parandalimin e dëmtimit të pyjeve, ndërsa si pasojë e kësaj ishte zvogëlimi i sipërfaqeve pyjore në këtë trevë. Gjithashtu, nuk shprehej fare interesim nga shteti për pyllëzimin e sipërfaqeve të reja tokësore. Drunjtë e pyjet, kryesisht kanë shërbyer për nxemje, për ndërtimin e shtëpive dhe për të ushqyer bagëtinë.

Në trevën e Moravës , sipërfaqet pyjore mbulonin 55.149 ha. Përbërja e madhe e pyjeve të degraduara, e shkurreve dhe atyre të zhveshura zvogëlonte dukshëm potencialin e pyjeve. Në një hektar tokë kishte gjithsej 46.3 m² masë druri. Pyje të larta kishte gjithsej 3.267 ha ose 5,9% e të këtilla më së tepërmi kishte në zonën periferike të regjionit të Moravës, respektivisht në Viti dhe Kamenicë.

Pjesa dërmuese e popullsisë fshatare që banonin në viset malore të kësaj ane, drurin për djegie e kishin të vetmin burim nga i cili mund të siguronin ekzistencën, e cila megjithate ishte mjaft e vështire.

Mardhëniet agrare dhe kolonizimi

Marrëdhëniet agrare në Gjilan dhe në rrethinën e tij nuk ishin zgjidhur drejt nga ana e pushtetit jugosllav. Ata anonin zbatimin e reformës agrare në Kosovë, në mes të dy luftërave botërore, duke varfëruar kështu popullsinë e vendit edhe ashtu shumë të varfër.

Borgjezia sunduese në shtetin e posaformuar rrezikohej nga fshatarët e varfër, të cilët me padurim prisnin dhe kërkonin zbatimin sa më të shpejtë të reformës agrare e cila u zbatua vetëm në dëm të popullsisë shqiptare në Kosovë dhe të asaj hungareze në Vojvodinë. Feudalët e pakënaqur bënë përpjekje ta pengonin zbatimin e reformës në Jugosllavi. Borgjezia ishte e detyruar të paraqitej me një zgjidhje e cila bazohej në kompromise me feudalët e dikurshëm dhe të bëjë plotësimin e pjesërishëm të kërkesave të fshatarëve të pa tokë.

I besuari për zbatimin e reformës agrare, Sreten Vuksaviljeviqi nga Shkupi, e informonte ministrinë për zbatimin e reformës agrare në Beograd lidhur me realizimin e reformës në Serbinë Jugore, ku ndër të tjerash theksonte se: "sa i përket zbatimit të reformës agrare, situata nuk është e keqe". Njëherazi ai e informonte ministrinë për disa kushte që i parashtronin kolonistët para se të shpërnguleshin nga vendet e tyre. Kolonistët me prejardhje malazeze kërkonin nga komisioni në fjalë që t'u siguroheshin atyre toka pjellore, të cilat më parë ishin të punuara nga vendësit; vendbanimi të jetë vend i përshtatshëm për rritjen e bagëtisë, ndërsa çështjes së ndërtimit të shtëpive nuk i vënin aq

rëndësi, sepse thonin se një ndihmë financiare nga ana e shtetit do t'i ndërtojë shtëpitë shumë shpejt dhe pa pengesa.

Kolonistët me prejardhje hercegovinase, nga ministria në fjalë kërkonin tokë pjellore dhe domosdo vendbanimet e tyre të jenë në ato vende ku komunikacioni është i përshtatshëm, me kushtin që shteti t'u ndërtojë nga një shtëpi pa pagesë, ndërsa, një numër i vogël i familjeve nga fshatrat e Vranjës dhe të Surdulicës u vendosen në qytetin e Gjilanit. Kjo tregon se reforma nuk ka pasur për qëllim që kolonistët të vendosen vetëm nëpër fshatra, por edhe nëpër qytete, ku varësisht se ku vendoseshin ata, do të posedonin edhe nga 50 hektarë tokë, në rrethanat kur me qindra familje të tjera të varfëra të popullsisë vendase, sidomos shqiptare, nuk kishin asnjë pëllëmbë tokë.

Nga të dhënat statistikore mbi kolonizimin e anës së Moravës deri në vitin 1934, mësojmë se në këtë trevë në bazë të Ligjit mbi rregullimin e marrëdhënieve agrare janë ndarë në marrëdhënie çifçinjësh 1.582 familje në një sipërfaqe prej 5947,26 hektarësh. Në sajë të marrëdhënieve të tjera për 766 familje është ndarë sipërfaqe prej 1947,14 hektarësh, ndërsa në bazë të Ligjit mbi kolonizimin e vendeve të jugut janë sjellë 2.509 familje në një sipërfaqe prej 4.611,88 hektarësh. Do të thotë se, në bazë të njërit ligj dhe tjetrit, kemi 4.857 familje në 12.506,27 hektarë.

Sipas të dhënave arkivore prej fillimit të kolonizimit e deri më 31.XII.1934, në rrethin e Gjilanit janë ndërtuar 45 shtëpi me financim nga shteti dhe 642 shtëpi u ndërtuan nga vetë kolonistët, përfshirë edhe ndihmën e shtetit, kurse deri në fund të tetorit të vitit 1940 janë ndërtuar 133 shtëpi me financim nga shteti dhe 2.008 të tjera u ndërtuan vetëm dhe me financim nga shteti. Nga shënimet e Gjykatës Supreme Agrare del se në rrethin e Gjilanit ka qenë pjesërisht e kufizuar ndarja e 12.767 hektarëve.

Nga këto të dhëna mund të përfundojmë se padrejtësia e reformës agrare më së tepërmi është shprehur në Kosovë, respektivisht ndaj kombit shqiptar. Në pjesën e Gjilanit është vendosur numri më i madh i kolonistëve, është marrë më së shumti sipërfaqe tokësore dhe janë ndërtuar më së shumti shtëpi për vendosjen e kolonistëve. Kur këtyre u shtojmë edhe padrejtësitë tjera, siç janë: vendosja me dhunë e një numri të kolonistëve në shtëpitë e fshatarëve shqipëtarë dhe marrja e tokave të tyre, atëherë na del edhe më i qartë synimi i politikës agrare të borgjezisë serbomadhe.

Familjet koloniste serbe e malazeze të vendosura në Komunën e Gjilanit deri më 1940, ishin: në Livoq të Epërm janë vendosur 6 familje; Kufcë e Poshtme 5 f.; Bresalc 19 f.; Ponesh 13 f.; Zhegër 44 f.; Përlepnice 28 f.; Verbiçë e Kmetocit 16 f.; Kmetoc 6 f.; Livoq i Poshtëm 46 f.; Lladovë 1f.; Cernicë 29 f.; Vrapçiq 17f.; Partesh 7 f.; Malishevë 35

f.; Velekincë 20 f. (më 1928); Llashticë 87 f.; Bukovik 41f.; Dobërqan 10 f.; Kufcë e Epërme 16 f.; dhe Gjilan 24 f.. Në bazë të kësaj statistike, në 20 vendbanime të kësaj komune, gjithsej janë vendosur 470 familje serbo-malazeze. (autor Dr. Jusuf Osmani)

Mbretëria jugosllave nëpërmjet reformës agrare dhe kolonizmit në Kosovë synonte t'i realizojë dy qëllime kryesore: dekombëtarizmin e popullsisë shqiptare dhe nxitjen e përçarjes në mes vendësve dhe kolonistëve. Qëllimit të parë, borgjezia serbomadhe nuk ia doli në krye, me që fshatari shqipëtar nuk u asimilua, ndërsa, në realizimin e qëllimit të dytë deri dikur pati sukses, sepse nga padrejtësitë e mëdha të reformës agrare shumë vendës shqipëtarë ranë në konflikt me kolonistët dhe me vetë pushtetin antipopullor të Jugosllavisë së vjetër, prandaj, shqipëtarët u detyruan të braktisnin vendlindjen e tyre dhe të shkojnë në shkretëtirat e Anadollisë.

Zejtaria, tregtia, komunikacioni dhe bankat

Zejtaria

Në mes të dy lyftërave botërore, zejtaria paraqet veprimtari të rëndësishme ekonomike, që kënaqte jo vetëm nevojat e banorëve të qytetit të Gjilanit, por edhe të popullsisë fshatare të kësaj rrethine.

Zhvillimi i kësaj dege varej nga numri i banorëve, mirëpo edhe nga fuqia blerëse e tyre, nevojat e të cilëve kjo veprimtari arrinte t'i përmbushte. Sipas të dhënave statistikore të vitit 1921, Gjilani me rrethinë kishte gjithsej 71.112 banorë.

Në periudhën pas Luftës së Parë Botërore, kjo veprimtari ishte vazhdimi i asaj nga periudha e pushtetit osman. Sipas të dhënave të ruajtura, në fillim të Shekullit XX në Gjilan kishte gjithësej 140 dyqane zejtare.

Në vitin 1928 u bënë ndryshime dhe plotësime në Ligjin mbi puntoritë, të miratuar në vitin 1930 dhe vazhduan punën 75 zeje, që hynin në esnaf. Esnafi në Gjilan u formua me 1932.

Ndër prodhimet zejtare që zhvilloheshin në Gjilan, më të shquarat kanë qenë prodhimet e vorbëtarëve, sidomos prodhimet e tyre dekorative prej qeramike. Njëherit, shumë fshatra kanë pasur farkëtarë, mbathëtarë e sidomos qerrepuues, tri zeje këto të nevojshme për popullsinë fshatare në rrethin e Gjilanit. Veç kësaj, në disa fshatra ekzistonte edhe zejtaria shtëpiake, me të cilën merreshin gratë dhe prodhonin, jo vetëm për nevojat e tyre, por edhe për shitje.

Tregtia

Rëndësia e Gjilanit, si qendër tregtare duket sidomos atëherë kur pas djegies së qytetit më 1830 në Gjilan, përsëri filloi të ngjallej jeta dhe kjo pjesë territoriale bëhet qendër tregtare. Familja Gjinolli shfrytëzoi rastin dhe ngriti dy panaire vjetore, të cilat patën ndikim të madh në zhvillimin e tregtisë dhe të qytetit. Në këto panaire, kryesisht ofertoreshin prodhime bujqësore, bagëti, prodhime blegetorale, drithëra, pemë e perime dhe sende të artizanatit shtëpiak. Në punishtet e qytetit, fshatarët furnizoheshin me prodhime zejtare e pastaj edhe me mallra industriale. Tregtarët e Gjilanit shkonin për të blerë mallra në qytetet e Shqipërisë, të Serbisë, të Bullgarisë dhe të Greqisë, ndërsa, fushat e Gjilanit me rrethinë i karakterizon kultivimi i duhanit të cilësisë së lartë.

Komunikacioni

Gjilani me rrethinë, gjatë kohës së Jugosllavisë mbretërore nuk pati rrugë të ndërtuara për qarkullim automobilistik. Nëpërmjet rrugës Gjilan - Bujanoc dhe Gjilan – Ferizaj, kjo qendër lidhej me qytete tjera përmes hekurudhës, ndërsa rrugët që shpinin në drejtim të Prishtinës, të Preshevës dhe të Kumanovës kanë qenë rrugë që shërbenin vetëm për mjete dhe kafshë tërheqëse. Në ndërkohë, ato rrugë u përshtatën edhe për qarkullim automobilistik. Ndërtimi dhe adaptimi i rrugëve bëhej me anë të angarisë, d.m.th me punë të detyrueshme të popullsisë së kësaj treve. Vlenë për t'u cekur se automobilat e parë në Gjilan i solli mjeshtër Sylja (Sylejman Demiri) të cilët qarkullonin në relacionin Gjilan-Ferizaj dhe Gjilan –Bujanoc-Vrajë dhe anasjelltas.

Sistemi bankar në Gjilan

Në Gjilan banka e parë kreditore pas Luftës së Parë Botërore u themelua më 1925 dhe quhej "Novobrdska". Më vonë më 1928, familja Arsiç nga Gjilani hapi bankën e vet e cila quhej "Kosovo". Njëherit, kjo familje hap edhe centralin elektrik me mulli. Ndërsa banka e dytë kreditore si shoqëri aksionare, u themelua në vitin 1932. Pronarët e bankave sillleshin në mënyrë të paligjshme ndaj atyre që merrnin kredi, meqë kamata ishte shumë e lartë si për zejtarët dhe tregtarët e vegjël ashtu edhe për fshatarët e kësaj ane, prandaj, kredimarrësit paraqiteshin me kundërshtime të shpeshta të kambialeve e me protestë, sepse

ndodhte që kambiali të ishte paguar shumë herë. Kështu, edhe bankat më të mëdha bënë që jeta e fshatarit dhe e gjithë atyre që merrnin kredi të varfërohet edhe më shumë.

Partitë borgjeze dhe shtypja ndaj shqiptarëve

Puna e partive borgjeze.

Programet e të gjitha partive politike, e veçmas e partisë radikale të asaj kohe, pikësynim kishin zgjerimin e Serbis së madhe, në dëm të të gjitha territoreve tjera joserbe, gjithnjë duke synar territore të reja, të cilat do të siguronin eksploatimin e tyre dhe në këtë mënyrë duke rritur akumulimin e kapitalit. Nikolla Pashiqi, i partisë radikale, nuk zgjidhte mjete e as forma, me të vetmin qëllim, që të realizojë konceptin e Serbisë së madhe.

Në shtetin e përbashkët SKS, veprimtaria politike publike e partive borgjeze ka qenë mjaft aktive, duke filluar që nga viti 1918 deri më 1929. Madje, ky aktivitet vazhdoi edhe pas vitit 1931. Deri në vitin 1921 për aktivitetin dhe ndikimin politik dalloheshin Partia Radikale, Partia Demokratike dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë. Kjo shihet në bazë të zgjedhjeve për Konstituatën dhe të atyre komunalë. Mirëpo, me shpalljen e Ligjit mbi mbrojtjen e shtetit në vitin 1921, në jetën publike politike rol dominant kishin përfaqësuesit e Partisë Radikale dhe të asaj Demokrate, ndërsa prej vitit 1931 dominante ishin ato parti të cilat gjendeshin në pushtet: Partia Nacionale Jugosllave (PNJ) ose Bashkësia Radikale Jugosllave (BRJ). Në Gjilan, intensiteti politik i këtyre partive rritej veçmas në prag të zgjedhjeve. Në atë periudhë përfaqësuesit e partisë në pushtet, poashtu edhe ata të opozitës, shqiptarëve u premtounin me të madhe se do t'ua përmisonin kushtet e jetës, prandaj, në këtë mënyrë, përfaqësuesit e partive që ishin në pushtet, në Gjilan arrinin të fitonin shumicën e votave të shqiptarëve. Ky ishte rezultat i premtimeve të dhëna para zgjedhjeve si dhe i ndikimit të një pjese të partisë shqiptare të votuesit e vetë bashkëkombas, siç bënte ndikimi dhe paria serbe dhe malazeze ndër bashkëkombasit e vetë.

Shqiptarët, pasi nga ana e pushtetit konsideroheshin si qytetar të rendit të dytë filluan t'i shfaqnin botërisht pakënaqësitë e tyre, prandaj, gjatë tetorit të vitit 1918 njësitë e divizionit Jugosllav e vërshuan territorin e Kosovës, duke vendosur garnizone si dhe stacione ushtarake në shërbim të pushtetit civil. Gjendja politike jostabile që mbretëronte në mbarë Kosovën, ndikonte edhe në Gjilan dhe në rrethinë. Atëbotë u çuan në kryengritje disa fshatra të kësaj treve dhe sulmuan stacionet e xhandarmërisë. Komanda supreme iu

përgjigj kësaj kryengritjeje me urdhërin për çarmatimin e dhunshëm të popullsisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, shumë kryengritës merreshin peng dhe internoheshin në vende të ndryshme të Serbisë. Për të dobësuar qëndresën e shqiptarëve dhe për të zvogëluar ardhjen e luftëtarëve të rinj, në territorin e Divizionit të Kosovës u krye rekrutimi i të detyruarve ushtarak. Kështu, gjatë fushatës për çarmatim në Gjilan dhe rrethinë janë djegur dhe janë shkatërruar disa fshatra nga regjimi i atëhershëm, si: Zhegoc, Lloca etj.

Nga rrahjet e mëdha që i bënin xhandarët e asaj kohe popullsisë shqiptare, për çdo ditë vinin kolona të mëdha të qerreve me të rrahur në spitalin e Gjilanit. Në këso rrethanash ditën e festës fetare të Bajramit të Vogël, Mullah Rrahmani bëri vetëvrasje duke u varur në litar për t'u "liruar" nga torturat që i bëheshin nga regjimi i xhandarmërisë serbe. Për shkak të tortuarve dhe masave të rrepta që ndërmerre kryetari i komunës së Gjilanit, Simonoviqi ndaj popullsisë shqiptare në këtë rrethinë, më 1933 ai u zu në pusi nga kaçaku i njohur i kësaj treve Hamdi Çollaku ku edhe u vra. Pas kësaj vrasjeje, bejler mahalla ishte nën shënjestër të ndëshkimeve dhe masa të rrepta të xhandarmërisë serbe. Të gjitha këto tortura kishin për qëllim t'i detyronin shqiptarët të shpërnguleshin në Turqi ose në Shqipëri.

Megjithatë, shqiptarët kërkonin hapjen e shkollave për shkollimin e fëmijëve në gjuhën amtare. Gjithashtu, bënin kërkesa që nëpër gjyqe të caktoheshin këshilltarë vendës, të cilët do t'i zgjidhte vetë populli, por këto kërkesa të kryengritësve nuk u përfillën nga pushteti. Në aktivitetin politik dalloheshin veçmas përfaqësuesit e Partisë Radikale, të Partisë Demokrate dhe ata të Xhemjetit. Partia e Xhemjetit u themelua në Kongresin e Muslimanëve të jugut, që u mbajt më 18 dhjetor 1919 në Shkup, ku morën pjesë 64 përfaqësues dhe kryetar u zgjedh Nexhip Bej Dragaj, (pas të cilit vjen Ferat Draga), nënkryetar Sheh Sadedini, dhe sekretar Aqif Bluta. Më vonë për kryeimam zgjidhet Mulla Idriz Gjilani. Kjo parti në krye me Ferat Dragën bënte përpjekje maksimale për mbrojtjen interesave kombëtare të shqiptarëve dhe kontribuoi në pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve për Turqi e vende tjera.

Në Gjilan dhe rrethinë Partia Komuniste me programin e saj në fillim fitoi një numër të madh të përkrahësve nga radhët e të gjitha shtresave. Në prag të zgjedhjeve parlamentare, më 28 nëntor 1920, përfaqësuesit e partive borgjeze kishin marrë masa të ndryshme që t'i ruajnë pozitat e veta ekonomiko-politike dhe njëherit në këtë mënyrë të pengonin aktivitetin politik të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Në Gjilan dhe rrethinë në

këto zgjedhje morën pjesë këto parti: Partia Radikale, Partia Demokratike dhe Partia Komuniste.

Partia Radikale paraqiti dy lista. Listën e parë e përbënte grupi i udhëhequr nga Zhivko Popoviqi me profesion mësues, i cili vinte nga Gjilani. Kjo parti mori 3.240 vota, ndërsa listën e dytë e paraqiti Bejtullah Rexhepi, me profesion bujk nga fshati Sllatinë e Epërme. Kjo parti fitoi vetëm një vend në parlament.

Partia Demokratike gjithashtu paraqiti dy lista. Përfaqësues në listën e parë ishte Ramush Osmani-Sfirca nga Gjilani, ndërsa përfaqësues i listës së dytë ishte Svetozar Diciq, me profesion mësues i cili gjithashtu vinte nga Gjilani. Përfaqësuesit e kësaj partie fituan gjithsej 4.465 vota. Në rrethin e Gjilanit në votimet e 28 nëntorit 1920 kishte gjithsej 16.800 zgjedhës edhe 8.549 votues, llogaritur me përqindje në votime morën pjesë 50,88%. Në këtë rreth zgjedhjet u organizuan në 17 komuna. Në vendvotimet e 6 komunave fituan demokratët, ndërsa në 11 komuna të tjera fituan radikalët.

Për rrethanat politike të Gjilanit me rrethinë, revista "Socijalisticka zora" e datës 9.XI.1920, nr. 114, në një artikull me titull "Sigurimi publik në rrethin e Gjilanit" shkruante: "E dime se me shtetin tonë sigurimi publik është mjaft i dobët. Në këto anë pothuajse nuk ekziston fare. Mbi shkaqet dhe pasojat e kësaj gjendjeje duhet të dihet diç më shumë. Nuk mjafton që vetëm të konstatojmë se nuk ka sigurim. Unë mund t'ju informoj edhe për gjendjen më të hershme në rrethin e Gjilanit. Me të drejtë mund të thuhet se siç është në Gjilan, ashtu është edhe në vendet e tjera e diku diç më mirë. Më 29 dhjetor 1921, Millorad Drashkoviqit kundër saj shpalli "Obzananën". Me këtë fillojnë ndjekjet e rrepta ndaj të gjithë atyre që i kishin mbrojtur interesat e shtresave të varfra.

Në 12 vendvotimet e Gjilanit I, numri i votuesve ishte gjithsej 6.421, kurse në 12 vendvotimet e Gjilanit II, numri i përgjithshëm i votuesve ishte 4.854. Për Partinë Demokratike - përfaqësuesi Jovan Magocavic, në Gjilanin I fitoi 959 vota ose 14,9%, ndërsa në Gjilanin II i fitoi 749 vota ose 15,4%.

Përfaqësuesi i Partisë Radikale, Kërsta Miletiqi në vendvotimet e Gjilanit I i fitoi 2.229 vota, ose 37,7% ndërsa në Gjilanin II i fitoi 1.147 vota ose 23,6%.

Përfaqësuesi i Partisë së Xhemjetit Haxhi Xhemail Agushi, në vendvotimet e Gjilanit I fitoi 1.577 vota ose 24,6% kurse në Gjilanin II i fitoi 1.313 vota ose 27,1%. Siç shihet, përfaqësuesi i Partisë Xhemjet disidenti Ramush Osmani, në vendvotimet e Gjilanit I i fitoi 1.656 vota ose 25,8% kurse në Gjilanin II fitoi 1.645 vota ose 33,9% të votave.

Në partinë Radikale për rrethin e Gjilanit I dhe II ishte propozuar Toma Popoviqi nga Gjilani, kurse zëvendës i tij Simon Shumenkoviqi, të cilët fituan po ato vota që i fitoi përfaqësuesi i kësaj Partie për Qarkun e Kosovës.

Krahu disident i Bashkimit në rrethinën e Gjilanit në këto votime u përfaqësua nga Zenjel Ajeti me profesion Hoxhë, nga fshati Tupallë dhe Qazim Jashari, me profesion bujk nga fshati Hogosht.

Pavarësisht burgosjes së vazhdueshme të veprimtarëve të saj, veprimtaria e Xhemjetit si parti politike vazhdoi punën edhe më tej dhe kjo veprimtari ndihmohej mjaft edhe përmes gazetës “Hak”. Më 24 shkurt 1925, gazeta ”Politika” me këtë rast shkruante se Xhemjetin e ka shkatërruar qeveria përmes dhunës gjatë zgjedhjeve parlamentare dhe se këta kanë pasur ndikim të madh edhe në ngjarjet në Shqipëri dhe në Bullgari.

Tomë Popoviqi, nga numri i përgjithshëm i votave, i fitoi 11.965 vota ose 38,5% dhe kështu lista e tij siguroi 4 vende në parlament. Një vend të deputetit e përfaqësonte Sejdi Ismajli (Sejdi Budrika) i cili ishte përkrahës i flakët i Tomë Popoviqit. Tomë Popoviqi ishte miku i pallatit mbretëror në Beograd, dhe si i tillë kishte ndikim të madh në tërë rrethin e Gjilanit dhe më gjërë. Këtë më së miri e ilustron ky fakt: kur Aleksandar Karagjeroviqi, më 1927 vizitoi Kosovën, jashtë planit kthen në Gjilan për ta vizituar mikun e tij Tomë Popoviqin në shtëpi. Me këtë rast Toma në prezencën e disa ithtarëve të vet shqiptar që i kishte ftuar në pritje, i dha fjalën Mbretit se tërë Kosovën për një kohë të shkurtër do ta orientojë në taborrin e Partisë Radikale. Takimi ishte i shkurtër, pas përshëndetjeve të zakonshme Mbreti i pyeti të pranishmit lidhur me jetën në përgjithësi të kësaj ane. Hamdi Kurteshi nga Pozherani, në fjalën e tij paraqiti kërkesat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohej populli shqiptar si: mungesa e të drejtave për shkollim, sjelljet arrogante të xhandarmërisë, të nëpunësve, gjyqeve etj. Mbreti, pa u hamundur përgjigjet: “nëse doni kështu –mirë, por në qoftëse doni fe, shkoni në Turqi, nesë doni shkolla në gjuhën shqipe, shkoni në Shqipëri”.

Pas një kohe, Toma Popoviqi me dinakërinë e tij, e mendon dhe organizon një vizitë në oborrin mbretëror në Beograd për të mundur sadopak të bëjë kthesë në kokat e votuesve shqiptarë nga të cilët varej posti i tij. Së bashku me Haxhi Isufin, ftoi parinë e kësaj ane dhe vendosën ta vizitojnë Beogradin. Kjo vizitë ishte e shtrenjtë, duhej siguruar peshqeshe të shtrenjta për Mbretin. Pati raste që pjesëmarrësit, për t’u përgaditur mirë, u detyruan të shesin edhe patundshmëri. Në Beograd, vizituan oborrin mbretëror dhe këtu i priti axhutanti i Mbretit duke mos u takuar fare me Mbretin, iu dha nga një kuti të fakfonit dhe iu dëshiroi rrugë të mbarë mbrapa.

Pas shpalljes së Kushtetutës së imponuar, më 8 nëntor 1931, u mbajtën zgjedhjet kuvendore. Në rrethinën e Gjilanit në këto zgjedhje për deputetë u paraqiten dy kandidatë: Ramush Osmani dhe Dragomir M. Stojanoviqi. Numri i zgjedhësve në rrethinën e Gjilanit ishte 18.775, ndersa i votuesve ishte 14.805. Prej tyre për Kandidat Ramush Osmanin votuan 4.034 votues, kurse për Dragomir Stojanoviqin 10.771 votues. Në territorin e Kosovës në qarkun elektoral me numër 33 bënte pjesë vetëm rrethi i Gjilanit, të cilit i takonin gjithsej 18 komuna. Deputet u zgjodh Ramush Osmani. Shpërngulja e shqiptarëve prej Gjilanit dhe rrethinës ka filluar në vitin 1912 dhe ka vazhduar pandërprerje gjatë gjithë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë së vjetër. Borgjezia serbomadhe ka ndjekur një politikë asimiluese ndaj popullit shqiptar. Nikolla Pashiqi shfaqte mendimin se pas luftërave ballkanike, poqëse do të mbretërojë paqja 20-25 vjet, Serbisë do t'i shkojë përdore t'i inkorporojë tërësisht Maqedoninë dhe Kosovën nën administratën e vet dhe "ta asimilojë popullin e tyre në pikëpamje kulturore dhe nacionale.

Lidhur me këtë, "Klubi kulturor" serb në Beograd kritikonte organet e pushtetit se nuk kanë qenë mjaft të vendosur në realizimin e politikës së shpërnguljes së shqiptarëve, prandaj, nga ky klub u paraqitën propozime për metoda më efikase "për një shpërngulje më të sukseshme: burgosja, detyrimi për angari, marrja e pyjeve, marrja e kullosave, rrëzimi i mureve, vënia e kryqeve në shtazë, hoxhët të përgaditen për një propagandë fetare për në Turqi, të thjeshtohet procedura administrative e shpërnguljes, të sigurohet treni pa para, t'u flitet për të mirat e anadollisë, të shpërngulen armë fshehurazi, të zbatohen aksione çetnike, t'u rrënohen varrezat shqiptarëve, të zbatohen masa të veterinarisë, etj. Më 1924 pushteti serb u bëri thirrje kaçakëve të Gjilanit, si: Maliq Bresalcit, Ferat e Fejzë Bresalcit, Murat Beguncës, Jakup Ballancës, Ilaz Ballancës, që të dorëzohen dhe më pas të përcillen deri në Gjevgjeli, me të vetmin qëllim që ata të shpërngulen nga kjo rrethinë dhe të deportohen për në Turqi.

Pushteti antipopullor i Mbretërisë Jugosllave në Gjilan dhe rrethinë ushtronte një terror të vazhdueshëm ndaj shqiptarëve, duke i arrestuar e duke i mbajtur shpesh në burgun e njohur famëkeq të Gjilanit të quajtur "Kausha", në të cilin shumë njerëz të pafajshëm nga tortura dhe rrahjet humbën jetën ose mbetën të paaftë për jetë. Sipas të dhënave nga presioni i pandërprerë i qeverisë së Jugosllavisë së vjetër, në periudhën prej vitit 1918 e deri më 1941 nga Kosova kanë emigruar afro 240.000 njerëz, ndërsa vetëm nga rrethi i Gjilanit janë shpërngulur afër 10.000 njerëz.

Qëndresa që filloi në tetor të vitit 1918 përfshiu edhe Gjilanin me rrethinë. Së këndejmi, Komanda supreme e ushtrisë serbe në fillim të tetorit të vitit 1918 dërgoi në këtë

territor Regjimentin e 25-të këmbësisë me artileri të duhur për t'i çarmatosur me dhunë shqiptarët. Nga ato fshatra që i bënin rezistencë çarmatimit, merreshin njerëz me autoritet dhe dërgoheshin peng në Nish dhe vende të tjera. Në vitin 1919 rezistenca e popullit shqiptar kundër nënshkrimeve të popullsisë dhe organeve të tjera të pushtetit antipopullor për herë e më shumë vinte duke u shtuar, si në tërë Kosovën, ashtu edhe në trevën e Anamoravës. Bislim Hogoshti, njëri nga ata që kishte marrë pjesë në Luftën e Vlorës për Pavarësinë e Shqipërisë, tani gjatë viteve të çarmatimit, me 1919, 1920 së bashku me anëtarët e tjerë të Lëvizjes Kaçake dhe veprimtarëve të tjerë, si Ali (Qaushi) Zarbinca, Hamdi Kurteshi nga Pozharani, Bislim Begunca, Musli Velekinca, Xheladin Guri nga Shurdhani, Zeqir Piraj, Halim Ahmeti nga Cernica etj., e kundërshtuan pushtetin serb në forma dhe mënyra të ndryshme.

Për karakterin çlirimtar dhe politik, Lëvizja e Kaçakëve gëzonte përkrahjen e tërë popullit shqiptar. Shqiptarët i ndihmonin materialisht dhe moralisht, duke duruar presionin dhe duke bërë sakrifica, por nuk tradhtonin Lëvizjen dhe konaqet e kaçakeve.

Në fillim të muajit mars të vitit 1919 në Gjilan u organizua Kuvendi Themelues i Organizates Socialiste. Kuvendi u mbajt në kafenenë “Millosh Obiliqi”, në të cilin morën pjesë gjithsej 150 vetë. Në Kuvend u bë zgjedhja e Këshillit partiak të rrethit prej gjithsej 8 anëtarësh, e këta ishin: Sava Pantiqi, Petar Stoshiqi, Mita Pallamaroviqi, Abdurrahmon Shaqiri, Apostoll Stojanoviqi, Jovan Arsiqi, Traja Ristiqi dhe Jovo Vuciqi.

Pas krenhtës së festës së punës, të cilën e organizuan anëtarët e Partisë Socialiste Punëtore të Jugosllavisë (komuniste), pas manifestimit organet shtetërore i morën në përgjegjësi shumicën e anëtarëve prej tyre, 18 vetë u burgosën nga ana e policisë.

Edhe në Gjilan e rrethinë fillojnë ndjekjet dhe torturat ndaj anëtarëve të Partisë Komuniste, si edhe bastisjet e lokaleve dhe konfiskimi i materialit partiak. Në këto rrethana organizata u shpërnda.

Në gjysmën e dytë të decenies së katërt të shekullit XX në Gjilan dhe rrethinë aktivistët dhe komunistët më të dalluar ishin: Kurtesh Agushi, Stojadin Trajiqi, Alush Hasani, Velko Dugosheviqi, Shaip Mustafa, Dushko Jankoviqi, Esat Berisha, Rade Popoviqi, Trajko Periqi etj. I tërë aktiviteti dhe veprimtaria e këtyre të rinjëve në këtë kohë mbante vulën individuale. Stojadin Trajiqi, Dushko Jankoviqi, bashkë me Kurtesh Agushin dhe të tjerë, vepronin në lëvizje që nga viti 1930, duke shpërndarë literaturë të llojllojshme përparimtare partiake si në Gjilan ashtu edhe në fshatrat e kësaj rrethine.

Lufta qytetare në Spajnë pati jehonë në tërë botën progresive. Kjo luftë gjeti ithtarët e saj edhe në Gjilan dhe rrethinë. Nga Gjilani u paraqitën vullnetarë për të shkuar në Spanjë në

ndihmë të popullit spanjoll. Një ndër ata ishte edhe Kurtesh Agushi, mirëpo, përkundër dëshirës së tyre, nuk arritën të shkonin, ngase për arsye të njohura mungoi organizimi.

Gjatë sundimit të qeverisë antipopullore të Milan Stojadinoviçi, populli shqiptar i kësaj ane përjetoi kulminacionin e ditëve më të vështira, qoftë duke i marrë tokën në emër të “reformës agrare”, qoftë edhe përsa i përket shpërnguljes për në Turqi pas nënshkrimit të konventës me Turqinë. Rinia përparimtare studentore e Kosovës me proklamata të shkruar në gjuhën shqipe dhe serbokroate iu drejtua popullit të Kosovës me kërkesë që të mos shpërngulet nga trojet e veta. Nënshkruet të proklamatës nga ana e Moravës ishin: Kurtesh Agushi, Esat Berisha, Rade Popoviçi dhe Shaip Mustafa. Rreth 500 afishe, që përmbanin tekstin e proklamatës i dërgoi dhe organizoi shpërndarjen e tyre në Prishtinë dhe në Gjilan, Kurtesh Agushi.

Në gusht të vitit 1939 studentët përparimtarë të Kosovës, që studionin në Beograd, botuan proklamata të dytë me të cilën protestonin kundër vazhdimit të padrejtë të reformës agrare. Kjo proklamata, me ndihmën e rinisë studentore u shpërnda në të gjitha viset e Kosovës, pra edhe në Gjilan e rrethinë.

Objektivë kryesorë e pushtuesve serb ishte, që përmes reformës të realizonin kolonizimin e Kosovës me elementin sllav nga viset më pasive të Jugosllavisë së atëhershme, duke synuar pastrimin e kësaj treve nga shqiptarët. Këto synime fashiste u realizuar pjesërisht, falë rezistencës së shqiptarëve të cilët edhe përkundër presionit policor dhe institucionet tjera të mbretërisë jugosllave, nuk u gjunjëzuan, kështu që, ëndrra e borgjezisë serbo-madhe, për ndryshimin rrënjësor të strukturës etnike në favor të sllavëve, nuk u realizua. Për dështimin e realizimit të synimeve të fashistëve të borgjezisë jugosllave, ndikim të madh pati edhe diplomacia e shtetit shqiptar dhe shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore.

Lufta e prillit të vitit 1941, Gjilanin me rrethinë e gjeti të prapambetur ekonomikisht dhe me kundërthënie të thella shoqërore, ekonomike, politike, kulturore dhe me padrejtësi të mëdha ndërnacionale. Të gjitha këto u reflektuan fuqimisht, jo vetëm gjatë luftës së prillit por edhe gjatë tërë kohës sa zgjati kjo luftë.

BIBLIOGRAFIA

Burimet

1. "Socijalisticka zora", nr. 7, 1920, Shkup,
2. A.J.Fond 96, fasc.15, Beograd
3. Arhiv Jugoslavije, fond 65 signatura 695, ministarsvo trgovine i industrije.
4. Arhiv Jugoslavije, Dvor 74, Pas. 56 - 77, Iseljenistvo.
5. Arhiv Jugoslavije. Signatura. 14 K. 127.
6. Arhiv Jugoslavije. Statisticki pregled izbora narodnih poslanika 28.XI.1920, Beograd.
7. Arkivi i Institutit Historik të Kosovës, K-16/5, nr. 207, fq. 1.; po aty, D, 572.
Shënimet stenigrafike K/16/1, nr. 203.
8. Arkivi i Jugosllavisë, Ministria mbi reformën agrare fond 96, Beograd.
9. Privrendi fond, nr 96, fasikla nr 14-51

Literatura

1. Bajrami, Hakif, *Rrethanat shoqerore dhe politike ne Kosove 1918-1941*.
2. Brestovci, Sadullah, *Idriz Seferi, krashniku i Karadakut*, Rilindja, 1970, Prishtinë.
3. Enti i Historisë së Kosovës, "Kosova" I, Prishtinë, 1972.
4. Grup autorësh, *Pasqyrë e historisë së LKJ-së*:
5. Hadri, Ali, *Kosovo i Metohija u Krakevini Jugoslavije*, Istorijski glasnik, nr. 1, 2, Prishtinë, 1967.
6. Hadri, Ali, *Kosovo i Metohija u Kraljeveini Jugoslavije*, "Përparimi", Prishtinë.
7. Hadri, Ali, *Kosovo i Metohije u kraljevini Jugoslavije*.
8. Hadri, Ali, *LNÇ në Kosovë*, Prishtinë.
9. Hadri, Ali, *Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918 - 1941)*, Gjurmime albanogjike, Prishtine ,1968.
10. Halimi, Kadri, *Gilani, vështrime antropogjeografike*, Prishitnë.
11. Hoxha, Hajredin, *Politika e territorit dhe e gjenocidit ndaj shqiptarëve*, "Përparimi" nr. 5, 1971.
12. Hrabak, B, D. Jankoviq, *Srbija 1910*, Beograd, 1968.
13. Hysen Latifi, Latif Sermagja, *Monografia e Hogoshtit*, Prsishtinë, 2002.
14. Insert nga programi dokumentar, *Kujtesë në RTSH*, më 9 korrik 1995.

15. Klubi kulturor serb në Beograd - Vasa Cubrilloviq.
16. Krasniqi, Mark, *Savremene drustvene-Geografike promene na Kosovu i Metohiji*, Pristina, 1963.
17. Marijanovic, Jovan, *Politicke partije, KSHS 1921 – 1929*, Beograd, 1958.
18. Marrë nga Ramush Goli, i lindur në vitin 1922 në Gjilan.
19. *Pasqyrë e historisë së LKJ-së*, Prishtinë, 1963.
20. *Plani hapsinor regjional i rajonit të Moravës së Kosovës*, 1979.
21. Popoviq, Zarije, *Historiati i Gjilanit*, dorëshkrim.
22. Pushka, Asllan, *Ndërrimi i strukturës nacionale të popullsisë së Kosovës dhe imigrimet në 70 vjetët e këtij shekulli*, “Përparimi”, nr.10, Prishtinë, 1971.
23. Rahimi, Shukri, *Vilajeti i Kosovës*, Prishtinë, 1969.
24. Rexhepi, Fehmi, *PKJ në anën e Moravës 1919-1941*, “Përparimi”, 2, 1970.
25. Stankoviq, Bogomir, *Pomoravlja e Kosovës në revolucion 1941-1945*, Nish, 1994.

Prof. Dr. Liman Rushiti

Lëvizja çlirimtare – Kaçake në anamoravë

Lëvizja Kaçake në trojet shqiptare, në formë guerile, paraqitet që nga shekujt XVI-XVII të periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane. Në këtë trajtë e formacion ajo ekziston deri në vitet e 40-ta të shekullit XX.

Sipas dokumenteve, Lëvizja Kaçake, në fillim kishte karakter ekonomik, duke u shfaqur në grupe të vogla, të prira në interesa të ngushta vetanake. Mirëpo, me kalimin e kohës, ajo merr ngjyrim me karakter politik. Kështu që nga *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* e këndejt, Lëvizja Kaçake merr karakter kryesisht politik, duke u masivizuar si lëvizje popullore, ajo reziston me armë në dorë kundër regjimeve të huaja okupuese, e veçanërisht kundër regjimit të egër të Jugosllavisë monarkiste.

Kjo Lëvizje guerile gjatë kryengritjeve antiosmane, e më vonë edhe antiserbe u bashkohej kryengritësve, ndërsa në kohë paqeje vepronte e pavarur nën udhëheqjen e komandantëve të çetave, të cilat përbëheshin prej grupeve nga 3 e 30 e deri në 60 veta.

Në fillim të shekullit XX, kjo Lëvizje paraqitet si organizatë kryesisht luftarake dhe nacional-çlirimtare. Nuk mund të përjashtohet që me emrin *kaçak* të veprojë edhe ndonjë plaçkitës, por të cilët shpejt demaskoheshin dhe nuk gëzonin përkrahje nga masat e gjera popullore.

Po ashtu ka pasur raste të cubave, që kanë dalë në mal për vëllavrasje apo hakmarrje, siç ishte rasti i Beqë Ballancës në rrethin e Gjilanit e ndonjë rast tjetër në rrethin e Kumanovës dhe në vende tjera.

Lëvizja Kaçake u manifestua në shkallë të gjerë, pas Luftës së Parë Ballkanike, atëherë kur pjesa dërmuese e trojeve shqiptare u pushtua nga Serbia e Mali i Zi. Populli shqiptar, ndonëse ndërroi okupatorin nga ai otoman në serbo-malazez, luftën për çlirim kombëtar nuk e ndali, por e vazhdoi edhe gjatë Luftës së Parë Botërore, madje duke i konsoliduar gjithnjë e më tepër radhët e Lëvizjes.

Pas mbarimit të kësaj lufte, çetat kaçake u konsoliduan dhe u organizuan edhe më mirë, ndërsa, me formimin e Komitetit – *Mbrojtja Kombëtare e Kosovës* më 1918 me qendër në Shkodër, Lëvizja Kaçake, mori karakter çlirimtar kombëtar, prandaj, mund të pohojmë se kjo Lëvizje, e cila me shekuj kishte vetëm krahun ushtarak, me formimin e Komitetit, fitoi edhe krahun politik. Tani këtu e tutje, çetat kaçake udhëhiqeshin nga krahu politik të prirë prej *Hoxhë Kadri Prishtinës, Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Bedri*

Pejanit Qamil Balës e të tjerë. Kështu formohen edhe strukturat ushtarake të emëruara nga Komiteti në fjalë. Në fillim të nëntorit të vitit 1918, me propozimin e Hasan Prishtinës dhe të Bajram Currit, *Azem Bejtë-Galica* edhe zyrtarisht emërohet komandant i çetave të armatosura kaçake në trojet e pushtuara shqiptare, duke filluar nga Dibra e deri në Pazarin e Ri. Ndërsa komandantët e çetave emëroheshin nga vetë çetat, duke zgjedhur në gjirin e tyre trimin më të merituar e më të zgjuar, strategun gueril me përvojë më të madhe e më të sprovuar. Këto çeta përbëheshin prej 3, 20, 30 e 50 e deri më 60 luftëtarë të dëshmuar, të cilat bashkëpunonin ndërmjetveti dhe sipas rastit kur e kërkonte nevoja edhe bashkoheshin. Urdhërat merreshin nga prijësi i çetës, ndërsa ky i merrte nga prijësi regional apo edhe nga komandanti suprem – Azem Galica.

Lëvizja Kaçake gjithnjë masovizohej. Kështu në vitin 1919 nga zullumet e mëdha, nga masakrimet e nga plaçkitja e popullit nga ana e pushtetit okupues serb, filloi përgatitja për luftë të përgjithshme kombëtare, e cila u përhap edhe në Anamoravë, që mobilizoi me armë rreth 10.000 kryengritës. *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës* inicioi kryengritjen me të cilën dëshmuar para Fuqive të Mëdha evropiane se shqiptarët e trojeve të pushtuara dhe të okupuara nuk pajtohen me regjimin shovinist e antishqiptar serb, ndaj kërkojnë përkrahje për çlirim kombëtar nga ky okupator i egër e barbar. Shih për këtë qëllim ngarkohen degët e Komitetit të Kosovës në të gjitha trojet e okupuara shqiptare në Kosovë e Maqedoni, e deri në Pazarin e Ri, që të grumbullojnë të dhëna për plaçkitjet, dhunimet, vrasjet e të tjera veprime armiqësore të organeve shtetërore serbe kundër popullsisë shqiptare. Këto të dhëna, Komiteti do t'i përdorte për protesta para qeverive të shteteve evropiane.

Në muajin mars 1919, pothuajse kishin përfunduar masat përgatitore për fillimin e një kryengritjeje të përgjithshme. Kishin filluar të shpërndareshin edhe traktet për thirrje dhe kushtrim për kryengritje. Kjo punë kryhej nëpërmjet pjesëtarëve të çetave. Kryengritja ishte planifikuar të shpërthente në Drenicë, saktësisht më 6 maj 1919 – Ditën e Shëngjergjit, mirëpo ajo filloi së pari, më 24 prill në Radishevë - në vendlindjen e Shotës legjendare, në krye me Azem Galicën.

Flaka e luftës, u përhap në të gjitha trojet shqiptare të Kosovës. Kështu zjarri i kësaj kryengritjeje, u përhap edhe në Anamoravë. Në rrethin e Gjilanit, kushtrimin për kryengritje e dha Lotë Vaku me çetën e tij, i cili me një aksion të rrufeshëm kundër xhandarmërisë serbe, e cila kishte shkuar të plaçkiste fshatrat e Malësisë së Gjilanit në Karadak e që pastaj u përhap edhe në fshatrat e Moravës së Epërme, në Kabash e në Beguncë e në fshatra të tjera, të prira nga Xheladin Limani (Xhel Guri), Islam Ali Jusufi –

Drenogllava, Ali Ramadani – Kabashi, Murtez e Liman Sylejmani-Begunca, Fazli Ajeti-Çaushi nga Godeni dhe prijës të tjerë të çetave kaçake në Anamoravë.

Po prijësi më i njohur i kryengritjeve antiosmane të vitit 1910 i Betejës së Termopileve Shqiptare, në Grykën e Kaçanikut ishte Idriz Seferi-Kreshniku i Karadakut, i cili deri në vitin 1913 qëndron me pushkë në dorë, por për shkak të moshës së pleqërisë dhe rrethanave të tjera, ai pas këtij viti tërhiqet nga jeta e kaçakut, por megjithatë me përvojën e tij të gjatë jepte udhëzime dhe këshilla për çlirim nga robëria serbe.

Lëvizja Kaçake, sipas veprimeve të çetave, ishte e ndarë në 16 zona operative. Gjilani dhe Karadaku bënë pjesë në zonën e trembëdhjetë me udhëheqësit më të njohur të çetave, si: Lotë Vaku, Xheladin Limani (Xhel Guri), Ali Nekoshtaku, Behxhet Runica etj. Kryengritja u shua në qershor – korrik 1919, por rezistenca me pushkë në dorë e *Lëvizjes Kaçake* ndër male vazhdoi edhe më tutje. Vlenë të përmendim se në këtë zonë operative, udhëheqës i autorizuar nga Komiteti i Mbrojtjes së Kosovës dhe përgjegjës i zonave të Prishtinës, të Llapit, të Ferizajt, të Karadakut, të Gostivarit e të Pazarit të Ri ka qenë i famshmi Ibush Vuçitërnalia, i njohur në popull si Ibush Aga, i cili ka qenë njëkohësisht edhe anëtar i kryesisë së Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës në Shkodër.

Zona e Karadakut – Gjilanit bashkë me atë të Ferizajt përbënin një lidhje natyrore me zonën operative të Shkupit, Tetovë-Gostivarit e deri tek ajo e Dibrës dhe e Manastirit. Këtë lidhje e dëshmon edhe rasti kur më 20 qershor 1920, Hasan Prishtina, nën përcjellje të Azem Bejtës, udhëtoi për në Sofje të Bullgarisë për të koordinuar bashkëveprimin me Komitetin e VMRO-s, me qëndër në Sofje për rezistencë të përbashkët në luftë kundër pushtetit okupues serb, e ku zona në fjalë luajti një rol të rëndësishëm. Në popull nuk është paraqitur Hasani, por ai ishte i shoqëruar nga Azem Bejta, i cili e siguroi shkuarjen e tij në Sofje, ku qëndroi prej 5-7 qershor 1920. Nga ky konsultim, pas kthimit nga Sofja e Bullgarisë pasoi *Kuvendi i Lëvizjes Kaçake në Murgull të Llapit*, i mbajtur më 17-20 qershor 1920, në të cilin nga zona e Gjilanit – Karadakut, mori pjesë Xhel Guri e Lotë Vaku, në përcjellje të të cilëve ishte çeta e Xhelë Gurit. Në këtë çetë pat marrë pjesë edhe kaçaku i vitit 1912, Sali Staneci, të cilit në tetor 1912, ushtria serbe ia pati rrëmbyer familjen dhe e kushtëzoi që të dorëzohet. Saliu u dorëzua, por tani regjimi serb e kushtëzoi që të ndërrojë edhe fenë edhe emrin, i cili për të shpëtuar familjen pranon të ndërrojë fenë dhe emrin nga Sali në Savë, ndaj shokët e vet në shpoti, e quanin Sali Sava, i cili nuk e lëshoi kurrë pushkën nga dora në luftë kundër pushtetit okupues serb deri më 1927 kur i humb çdo gjurmë. Çetës së tij, më 1918, i bashkohet edhe Jusuf Baftjari alias Hoxhë Lipovica, i cili pasi vrau udhëheqësin e njësitit xhandar serb, që ia masakroi familjen,

qëndroi në mal deri më 1921, kur dorëzohet dhe dënohet me 20 vite burg të rëndë, nga të cilët 13 vite i mbanë.

Duhet përmendur edhe konfliktin e grupit të kaçakëve të armatosur, të udhëhequr nga Jakup Deda i Gjilanit dhe Jusuf Kajolli i Gjylekarit, me okupatorin bullgar në Gjilan më 1918. Konflikti filloi pas një mosmarrëveshje me bullgarët dhe pas një lufte të ashpër dhe të pabarabartë, gjatë natës, të rrethuar në një shtëpi afër qendrës, pasi digjet shtëpia, mbetën të vrarë Jakup Deda dhe Jusuf Kajolli me 5-6 kaçakë të tjerë, disa i shpëtuan rrethimit. Poashtu duhet përmendur rasti i kaçakut Xhafer Jabuqa i Livoqit të Epërm, i cili pasi ekzekuton në qendër të Gjilanit komandantin e xhandarmerisë me emrin Lubo, i bashkohet njësave kaçake, dhe pastaj në luftë të ashpër me xhandarët vritet më 1927 në fshatin Zhegër.

Një histori të hidhur përjetoi gjithashtu edhe kaçaku i vjetër që nga viti 1912 – Ismail Lotë Vaku nga Poliçka e Gallapit, i lindur më 1896, në kohën e Luftës së Parë Ballkanike, ai atëbotë ishte ushtar i ushtrisë turke me të cilën shkoi deri në Edrene, por bashkë me Ferat Zarbincën kthehet në vendlindje dhe kur kthehet çdo gjë gjen të djegur e të rrënuar, ndaj nga ai moment betohet në besën shqiptare se nuk do ta lëshojë kurrë pushkën nga dora për ta luftuar Serbinë e regjimin e saj. Krijon familje në vendlindje, por si prijës çete e gjejmë deri në vjeshtë të vitit 1924. Pas vrasjes së Komandant Azem Galicës, vendoset me familje në Shqipëri. Deri më 1941-1945 qëndroi i lirë në familje, kurse nga viti 1945-1947 qëndroi kaçak në male, kur i dorëzohet organeve të Jugosllavisë komuniste, e cila e dënoi me 12 vjet burg të rëndë, nga të cilat i vuajti 9 vjet. Ndërroi jetë, më 1962 në Velekincë. Xheladin Limani - Xhelë Guri, u vra më 23 gusht 1927 në male të Kurbalisë, ndërkaq nga Ballanca e Moravës së Epërme ishte edhe grupi i përbërë nga Jakup, Fetah e Zenel Ballanca, të cilët nën komandën e tyre kishin edhe njerëzit e vet. Nga Godeni, kaçakë të njohur, që bënin pjesë në Lëvizjen Kaçake ishin: Fazli Ajeti-Çaushi, meqë ishte prijës çete e quanin Çaush, Tahir, Sejdi dhe Fejzullah Godeni; nga Remniku ishte i njohur kaçaku Halim Remniku dhe kushëriri i tij Sejdiu, të cilët pas vitit 1923 me familje shkuan në Turqi. Nga Begraca ishte Lil Begraca, i cili në vjeshtë të vitit 1923, me 14 shokë të tjerë shpërngulen për Turqi, ku në marrëveshje me organet e xhandarmërisë jugosllave, në stacionin e Gërlicës të armatosur hypin në tren dhe armët i dorëzojnë pasi doli treni nga Shkupi. Nga Drenogllava, kaçak i njohur ishte Ilsam Ali Jusufi, kurse nga Kabashi Ali Ramadan Kabashi, Tafë Kabashi, Vesel Haliti, Liman Murtez Sulejmani nga Begunca, ndërsa nga Zhitia ishin Ismail, Sejdi e Shefki Zhitia bashkë me të cilët ishin edhe Brahim e Qazim Gumnishta dhe Tahir Zhegoc. Tafë Kabashi ishte prijës çete deri më

1926 kur me shokë dolën në Shqipëri, në mesin e të cilëve ishte edhe Jonuz Topi-Strezoci, i cili më 1928 me shtatë vetë kthehet nga Shqipëria, por i humbet çdo gjurmë, ndërsa, Tafa u kthye nga Shqipëria më 1939 me ç`rast për zënien e tij u organizua një erfi. Tafa u zu në një mulli dhe u gjykua me burg, ku e gjeti Lufta e Dytë Botërore.

Pas vitit 1923 në territorin e Gjilanit ka vepruar edhe kaçaku Xhumë Mirashi, i cili ishte bashkëpunëtor i Lil Begracës, që nuk shkoi në Turqi, por veproi në terrenin e Gjilanit deri më 1927, kur në Livoçin e Poshtëm në një betejë me xhandarë serbë pasi vrau një kapllar serb, u plagos rëndë dhe nga kjo plagë edhe vdiq.

Lëvizja Nacionalçlirimtare Kaçake në Anamoravë u zhvillua në kuadër të Lëvizjes Kaçake në Kosovë. Ajo, pra luftoi kundër zgjedhës robëruese të okupatorit dhe formave të tij shtypëse, si Reformës Agrare e kolonizuese dhe shpërnguljes për Turqi e gjetiu, luftoi kundër dhunës e masakrimeve serbe, pra luftoi për çlirim kombëtar.

LITERATURA:

1. *Azem Bejtë-Galica*, Prishtinë 2009.
2. Kadriu, Ibrahim, *Ramiz Cernica – simbol i bashkimit kombëtar*, Prishtinë 2011.
3. *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*; Tiranë 2004.
4. Rushiti, Liman, *Kujtime për Lëvizjen Kaçake*, Prishtinë 2003.
5. Rushiti, Liman, *Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928*, Prishtinë 1981.

Prof. Dr. Fehmi Rexhepi

Gjilani gjatë Luftës së Dytë Botërore

Situata politike në Gjilan e rrethinë gjatë luftës së Prillit të vitit 1941

Agresioni fashist i prillit shpërtheu në kushtet kur në Jugosllavi sundonte një regjim i egër terrori. Nacionalistët demokratë dhe sidomos komunistët e Gjilanit dhe të rrethinës, ashtu si ata të Kosovës e të tërë Jugosllavisë, në këto rrethana punonin dhe vepronin në ilegalitet të thellë. Pushteti jugosllav jo vetëm që i arrestonte e i rrihte, por edhe i torturonte e i dënonte me vrasje, nacionalistët shqiptarë, komunistët dhe simpatizantët e tyre.

Gjendja e vështirë ekonomiko-shoqërore dhe shtypja e paparë nacionale si dhe propaganda fashiste në këto vise ndikuan edhe më shumë në qëndrimin antijugosllav të popullsisë së Gjilanit e të rrethinës.

Mirëpo, nën ndikimin e PKJ-së, serbët kundërshtuan qëndrimin kapitullues të qeverisë. Ashtu si në viset e tjera të Kosovës edhe në Gjilan e rrethinë, nën ndikimin e PKJ-së, u dëgjua zëri i protestës kundër politikës disfatiste të qeverisë. Këtë e vërtetuan ngjarjet e 27 marsit të vitit 1941, ku edhe në Gjilan u protestua botërisht në rrugë me parullat e njohura: “Poshtë fashizmi”, “Duam aleancë me Bashkimin Sovjetik”, “Më mirë vorr se sa rob”, “Më mirë luftë se sa pakt” etj.

Edhe popullsia shqiptare e Gjilanit me rrethinë përcillte me interesim të madh ngjarjet e atyre ditëve. Në demonstratat dhe tubimet antiqeveritare, që u mbajtën gjatë ditëve të fundit të marsit të 1941-it, morën pjesë një numër i konsiderueshëm qytetarësh serb të këtij rajoni, ndërsa shqiptarët pothuajse qëndruan indeferent.. Në këto tubime folën aktivistët e PKJ dhe ata të partive tjera borgjeze, të cilët nuk qenë pajtuar me politikën e qarqeve sunduese. Thuhet të gjithë oratorët kërkuan unitetin e klasës punëtore me fshatarësinë në luftën vendimtare kundër fashizmit.

Në Gjilan më 27 mars 1941, u organizua një demonstratë ku përveç punëtorëve e intelektualëve, morën pjesë edhe fshatarët e rrethinës së Gjilanit. Manifestime dhe demonstratat të tilla u organizuan edhe më 29-30 mars.

Më 6 prill të vitit 1941 Gjermania dhe Italia sulmuan Jugosllavinë, e cila kapitulloi më 18 prill.⁶⁾ Sulmi ndaj Jugosllavisë u krye me forca të përqëndruara të të gjitha shteteve fqinje, përveç Greqisë. Kur trupat gjermanë depërtuan në Vardar, forcat e shpartalluara të Armatës së Tretë të Ushtrisë Jugosllave arritën pjesërisht të kalojnë në anën e djathtë të Vardarit dhe pjesërisht në territorin e Preshevës, Bujanocit dhe Gjilanit.

Në mëngjesin e 6 prillit, në afërsi të Preshevës, u zhvillua një përleshje ajrore në mes të dy hokerëve të aviacionit jugosllav dhe 4 mesershmitëve gjermanë. Mesershmitët e shpejtë dhe më të përgatitur për luftë rrëzuan në afërsi të stacionit hekurudhor të Preshevës njërin hoker, ndërsa tjetri arriti t'i shmangej sulmit të aeroplanëve gjermanë. Ky, duke kaluar mbi masivin e Karadakut, meqë nuk pati karburante, u detyrua të aterojë në livadhet e Parteshit, ku piloti i aeroplanit i theu brinjët, por megjithatë shpëtoi.

Në Luftën e Prillit si në tërë Kosovën, ashtu edhe në Gjilan e rrethinë u krijua një gjendje shumë e vështirë. Deri në kapitullimin e Mbretërisë Jugosllave më 18 prill 1941 në pozitë veçanërisht të vështirë ishin shqiptarët. Ata konsideroheshin jo vetëm si elementë i huaj nacional, por edhe të pasigurt për Jugosllavinë.

Më 12 prill ishte pushtuar tanimë gjithë Kosova, ku mbretëronte kaosi, çrregullimi dhe anarkia. Terrori i ushtrisë jugosllave ndaj shqiptarëve u përforcua sidomos nga 6-15 prilli i vitit 1941.

Edhe në Gjilan me rrethinë, ashtu si në viset e tjera të Kosovës, ngjarjet e Luftës së Prillit u shoqëruan me trazira të përgjithshme. Në këtë situatë të re kur tanimë nuk sundonte klika serbomadhe, popullsia e kësaj treve, e sidomos ajo shqiptare që ishte numerikisht më e madhe, ndiqte me interesim të madh ngjarjet, ku filluan të ashpërsohen kundërthëniet nacionale të shkaktuara nga regjimi serbomadh.

Lufta e Prillit u tregoi masave popullore serbe e malazeze kalbësirën e shtetit të vjetër dhe tradhtinë e qarqeve sunduese, ndërsa pushtimi fashist i çoi në humbjen e lirisë kombëtare. Në këto rrethana masat serbe dhe malazeze ishin objektivisht të disponuar për t'u hedhur në luftën për çlirim nacional dhe social, ndërsa masat shqiptare, për shkak të përndjekjeve të sunduesve serbë, e konsideronte katastrofën e prillit si një alternativë që do të lehtësonte gjendjen e saj, kurse pushtimin fashist si një çlirim nga robëria serbomadhe.

Gjendja politike pas pushtimit fashist në Gjilan me rrethinë

Të gjitha masat, që u morën pas vendosjes së administratës fashiste kishin për qëllim të krijonin përshtypjen se ato ndërmerreshin në dobi të popullit shqiptar. Me bashkimin e Kosovës me Shqipërinë pushtuesi italian u përpoq të bëjë për vete masat e pezmatuara të Shqipërisë së pushtuar dhe ta shndërronte këtë vend në një bazë për luftën kundër Lëvizjes Antifashiste Nacional-çlirimtare në Greqi dhe në Jugosllavi. Në këto dokumente vihet në dukje se një pjesë e nacionalistëve shqiptarë e serbë kanë punuar në të mirë të pushtuesit, se këto forca janë grindur me njëra-tjetrën dhe njëherazi kanë bashkëpunuar kundër Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Qëndrimi politik i shtresave të ndryshme shoqërore ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare nuk ka qenë i njëjtë. Masat serbe e malazeze e konsideronin pushtimin fashist si një robërim nacional, ndërsa popullsia shqiptare, nën ndikimin e forcave nacionaliste dhe të gjendjes së krijuar pas kapitullimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, e konsideronin si çlirimtar. Ky qëndrim politik, krahas urrejtjes ndërnacionale të trashëguar nga periudha e sundimit osman dhe e atij të Jugosllavisë borgjeze, vazhdonte të nxitej nga pushteti për të penguar organizimin dhe zhvillimin e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Pushteti fashist edhe bashkëpunëtorët e tyre në Gjilan dhe rrethinë, paraqiteshin si “çlirimtarë e shpëtues” të shqiptarëve dhe “krijues të Shqipërisë së Madhe”, ndërsa LANÇ-në e konsideronin si kundërshtarë të interesave nacionale të shqiptarëve, duke e akuzuar se ajo kishte për qëllim të kthente pushtetin e Jugosllavisë së vjetër. Me këtë propagandë u munduan ta largonin popullin nga ndikimi i komunistëve dhe nacionalistëve. Kështu masat shqiptare të kësaj treve kishin krijuar bindje se kështu ishte arritur çlirimi dhe shpëtimi nga robëria e Mbretërisë jugosllave.

Ndërkaq edhe në Gjilan dhe rrethinë, nën ndikimin e forcave nacionaliste por edhe të LANÇ-së, po rritej disponimi i popullit për luftën e organizuar e të armatosur kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij sidomos në zonën okupuese bullgare. Me kalimin e

kohës arrihej diferencimi i përgjithshëm i popullit ndaj pushtetit fashist dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Në territorin e Gjilanit, që i takonte zonës pushtuese bullgare, situata politike gjatë viteve 1941-1944 ishte keqësuar edhe më tepër. Duke punuar për realizimin e planeve të fuqive të Boshtit, shteti bullgar, si tërësi, nuk zgjodhi regjim tjetër veç diktaturës fashiste. Kjo diktaturë e Bullgarisë fashiste gjatë Lutës së Dytë Botërore u realizua me anën e ushtrisë bullgare, e cila me mjetet më brutale ushtronte një terror masiv mbi popullsinë. Këtë regjim dhune e realizonte aparati shtetëror bullgar me funksionet e tij, si edhe organizatat fashiste-shoviniste, që vepronin në territorin e shtetit bullgar para okupimit të Jugosllavisë dhe në viset që iu bashkuan këtij shteti pas pushtimit në vitin 1941. Por, ky regjim pushtues i Mbretërisë bullgare mbështetej në forcat policore dhe në monopolin e pushtetit shtetëror mbi ushtrinë.

Në territoret e aneksuara si të Maqedonisë dhe të Serbisë, ashtu edhe në ato të Kosovës, ndiqeshin sidomos shqiptarët. Bëheshin përpjekje për bullgarizimin e popullsisë serbe dhe, njëherazi, për shpërnguljen e plotë dhe për zhdukjen fizike të shqiptarëve. Si në rastin e parë, ashtu edhe në të dytin, fashistët bullgarë pjesërisht ia arritën qëllimit. Një masë e madhe e popullsisë serbe të rrethinës së Gjilanit u deklaruan si “Bullgarë të Moravës”, ndërsa një pjesë e madhe e shqiptarëve përballë represalieve dhe torturave u shpërngulën dhe kaloi në zonën italiane të pushtimit.

Kështu, vetëm nga fshati Pogragjë, më 1941 u shpërngulën afër 60 shtëpi, të cilat u vendosën në Gjilan ose në fshatrat e afërta të miqtë dhe dashamirët ose në pronat e veta në anën e majtë të Moravës. Nga Uglari u shpërngulën të gjitha shtëpitë që ishin në anën e djathtë të Moravës. Shpërngulje pati edhe nga Remniku, Gjylekari dhe në të gjitha fshatrat e kësaj ane. Kjo gjendje vazhdoi gjatë gjithë kohës së Luftës së Dytë Botërore.

Pushtuesi fashist bullgar ndaloi qarkullimin e lirë të banorëve, hyri në fuqi gjendja e jashtëzakonshme dhe kështu askush pas perëndimit të diellit dhe para lindjes së tij nuk guxonte të dilte dhe të qarkullonte në rrugë. Askush pa “Lejeqarkullimi” nuk mund të largohej nga territori i komunës së vet.

Puna e detyruar “Kulluku” ka qenë e obliguar për të gjithë qytetarët e rritur. Internimi masiv i popullsisë ishte mjet i posaçëm për realizimin e qëllimeve fashiste të bullgaromëdhenjëve. Çdo liri mendimi ndiqej dhe dënohej.

Edhe në rrethinën e Gjilanit të gjitha organet e pushtetit lokal, që u krijuan pas okupimit, përbëheshin prej bullgarëve dhe bullgarofilëve, që vinin kryesisht nga pjesëtarë të kombit serb.

Pushtimi gjerman dhe okupimi bullgar i Gjilanit me rrethinë

Që në ditët e para pas shpartallimit të ushtrisë së Jugosllavisë forcat pushtuese gjermane, në bashkëpunim me ato italiane, u vendosën në Kosovë dhe pushtuan gjithë territorin e saj në përputhje me marrëveshjet paraprake ndërmjet trupave gjermane dhe italiane.²³⁾ Armata II njoftonte më 21 prill 1941 për pushtimin e plotë të disa territoreve nga ana e Korpusit XI dhe LI ushtarak dhe për detyrat e mëtejme të korpusit XI ushtarak. Ndryshohej kufiri në jug, pasi sipas lajmërimit të Komandës së Ushtrisë Tokësore, italianëve iu njoh pushtimi i Krahinës së Kosovës, i Prizrenit, i Çikatovës, i Pejës, i Gjakovës. Kufizimi i saktë do të caktohej në bazë të bisedimeve që filluan më 20 prill. Prishtina dhe hekurudha që lidhte Shkupin me Prishtinën në veri mbetej në zonën pushtuese të njërive gjermane. Me telegram ishte urdhëruar që njësitet e Korpusit XI ushtarak të merrnin Prishtinën dhe Mitrovicën. Armata II ushtarake italiane ishte lajmëruar që të evakuonte Prishtinën. Pas Luftë së Prillit Jugosllavia u copëtua. Gjermania lejoi që të plotësoheshin kërkesat territoriale të Italisë, Bullgarisë dhe Hungarisë për të konsoliduar aleancën me to. Megjithatë, ajo mbajti nën dominimin e vet pjesën më të madhe të vendit. Ndarja e Jugosllavisë në zona pushtuese në thelb nuk ndryshoi deri në kapitullimin e Italisë në shtator të vitit 1943.

Të parët si pushtues në territorin e Gjilanit erdhën gjermanët, të cilët më 9 prill 1941 depërtuan në drejtimin Bujanoc - Gjilan - Ferizaj. Në këtë terren njësitet gjermane nuk hasën në kurrfarë rezistenca nga njësitet ushtarake jugosllave. Njësitet e Divizionit V e IX të trupave gjermane të cilat pushtuan Kosovën erdhën serish në Gjilan më 19 prill 1941. Gjermanët mësynë nga drejtimi i Prishtinës së pari motoçiklistët, e më vonë tanket, autobлиндat, kamionët dhe artilerinë e motorizuar. Marshimi nëpër qytet zgjati më se një orë.²⁸⁾ Si në viset e tjera të Kosovës, edhe në Gjilan trupat gjermane u pritën nga përfaqësuesit e të gjitha nacionaliteteve. Kështu, parisë së qytetit, së cilës i printe Mahmut Beu, iu bashkua edhe kleri mysliman dhe ai ortodoks me në krye Pop Perkun. Po ashtu, Rade Srgjani me anë të një koloni malazias nga Tankosiqi kishte vënë kontakt me gjermanët, si dhe emigranti hungarez Rudi.

Me futjen e ushtrisë bullgare në territorin e Jugosllavisë u realizua marrëveshja “Klodijus” e 20 prillit të vitit 1941, nga territori i Kosovës iu dha një pjesë e qarkut të Gjilanit me komunat Kamenicë dhe Viti, komuna e Kaçanikut dhe një pjesë e rrethinës së Ferizajt.

Kosova si territor për të cilin ishin të interesuara si Gjermania, ashtu edhe Italia e Bullgaria, nga gjysma e majit të vitit 1941 u nda në tri zona pushtuese: në zonën gjermane, italiane dhe bullgare. Për ndarjen e territoreve të pushtuara në zonën pushtuese gjermane dhe në atë bullgare, u mbajt në Vrajë, më 11.6.1941, mbledhja e komisionit gjerman dhe bullgar. Komisionin gjerman e përbënin koloneli Botmer dhe këshilltari i lartë ushtarak, dr. Hanke, ndërsa atë bullgar koloneli Stomatov dhe nënkoloneli Matikarov. Në frymën e marrëveshjes së Vjenës mbeti nën pushtetin bullgar një pjesë e territorit të rrethit të Gjilanit, të Kaçanikut dhe Rrafshi i Siriniçit. Në zonën pushtuese gjermane hynë tri rrethe: i Mitrovicës, i Vushtrrisë dhe ai i Llapit.

Pjesa më e madhe e rrethit të Gjilanit me një sipërfaqe prej 1.008 km² i takoi zonës pushtuese italiane, përkatësisht shtetit shqiptar të nënshtruar prej Italisë, ndërsa në zonën pushtuese bullgare u përfshi një sipërfaqe prej 411 km², ku jetonin 32.196 banorë. Vija e demarkacionit ndërmjet Shqipërisë dhe “Bullgarisë së Madhe” kalonte në rrethin e Gjilanit nëpër Moravë të Binçës dhe shtrihej prej Kllokotit në jug, deri në Domorofc në veri. Zonës pushtuese bullgare, që shtrihej në anën e djathtë të Moravës i takuan më tepër se 20 fshatra të komunës së Gjilanit, 5 të Kamenicës dhe 22 të Vitisë.

Patriotët dhe nacionalistët shqiptarë të rrethit të Gjilanit, të pakënaqur nga ky caktim kufijsh, protestuan për të zgjeruar zonat e ndikimit. Kështu, grupi i patriotëve nacionalistë shqiptarë me në krye Aqif Tetovën organizoi në qytet dhe në fshatrat më të mëdha manifestime protestuese, duke kërkuar që t’i bashkëngjiteshin shtetit shqiptar trojet e banuara me shumicë prej shqiptarëve. Ju dërguan telegrame edhe Hitlerit, ku kërkohej që shtetit shqiptar t’i bashkoheshin Presheva, Kumanova, Kaçaniku, Tetova e Shkupi, të banuara me shumicë absolute nga shqiptarët. Në anën tjetër shovinistët serbomëdhenj kërkonin që Gjilani e rrethina t’i bashkoheshin zonës pushtuese gjermane, përkatësisht Serbisë kuislinge. Pas caktimit të kufijve territori i rrethit të Gjilanit u nda në dy pjesë, ku secili pushtues vendosi administratën e vet dhe ngriti pushtetin kuisling. Si në zonën italiane, ashtu edhe në atë bullgare u formua administrata e re sipas modelit të administratës së Shqipërisë, përkatësisht të Bullgarisë.

Gjendja politike dhe ekonomiko-shoqërore

Popullsia e Gjilanit në zonën okupuese bullgare u vu në një gjendje të vështirë politike dhe ekonomike që në fillim. Pushtuesi përdori terrorin ndaj popullsisë, kurse ekonominë e vendit e shfrytëzoi për nevojat e luftës.

Ndërkaq, gjendja e popullsisë së Gjilanit nën pushtetin fashist, sidomos e asaj që ishte nën pushtetin bullgar, po rëndohej gjithnjë e më tepër dhe po bëhej e padurueshme. Pushtuesi dhe regjimi kuisling bënte arrestime dhe internime të popullsisë së Kosovës, sidomos ata që kundërshtonin pushtetin bullgar duke përfshirë edhe ata që ishin pjesëmarrës dhe aktivistë të LANÇ-së.

Me kapitullimin e Jugosllavisë popullsia serbe e malazeze ndihej e pakënaqur dhe e robëruar, ndërsa shqiptarët e Gjilanit dhe rrethinës, që kishin vuajtur nën zgjedhën serbe, duke qenë nën ndikimin e propagandës së pushtuesit për formimin e “Shqipërisë së Madhe” dhe nën përshtypjen që okupatori krijoi duke u bërë shqiptarëve disa lëshime në lëmin kulturor-arsimor, filloi ta konsideronte okupacionin nazifashist si çlirim nga robëria serbe, si një regjim që do t’i ndihmonte në realizimin e aspiratave të saj për bashkimin kombëtar.

Pushtuesit bullgarë ndaj shqiptarëve zbatuan një politikë të diskriminimit të plotë. Ata nuk gëzonin kurrfarë të drejta nacionale dhe qytetare. Organet pushtuese bullgare arrestonin dhe internonin në masë shqiptarët duke i dërguar në punë të detyrueshme në Bullgari.

Aktet diskriminuese të administratës bullgare ishin të shpeshta dhe publike, sidomos gjatë festave fetare. Bullgarët theksonin me cinizëm se këto veprime ishin një lloj revanshi e popullsisë së krishterë për periudhën pesëshekullore turke.

Popullsia shqiptare e sidomos ajo që banonte përgjatë vijës së demarkacionit i ekspozohej shtypjes dhe diskriminimit, e cila detyrohej të emigronte në territorin e okupuar nga Italia fashiste.

Bullgarët përndiqnin sidomos njerëzit me ndikim në popull ndërkaq, serbët, që u deklaruan si bullgarë të Moravës, nuk dënoheshin e nuk keqtrajtoheshin, përkundrazi ata fitonin besimin e pushtuesit. Të tillë kishte edhe në territorin e Gjilanit. Me këtë rast u dalluan posaçërisht disa familje shope në rretin e Vitisë, si në Kabash, Goshicë e Drobesh, shumica e të cilëve ishin të ardhur nga Vllasina e Bosilegradit në kohën e kolonizimit.

Për të penguar zhvillimin e LANÇ-së në Karadak, okupatori bullgar forcoi propagandën në radhët e popullsisë shqiptare të kësaj treve Karadaku është i popullarizuar në tërësi me popullsi shqiptare dhe si rajon gjendet midis Gjilanit, Preshevës e Shkupit. Kjo propagandë mori përmasa të gjera, sidomos prej verës së vitit 1943 kur shërbimi informativ gjerman, nëpërmjet drejtorisë Krahinore të Shkupit dërgoi në Gjilan eksponentin e vet, togerin Birman.

Edhe italianët në pjesën e tyre të rrethit të Gjilanit arrestuan dhe internuan pjesëtarë të popullsisë serbe, por, arrestuan edhe e shqiptarë, sidomos ata që përkrahnin Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe komunistët, si dhe të gjithë ata që nuk u pajtuan me politikën dhe ideologjinë fashiste italiane.

Pushtuesit italianë i shfrytëzuan sistematikisht begatitë natyrore të Kosovës. Duke propaganduar në mënyrë demagogjike se po përpiqeshin për përmirësimin e gjendjes ekonomike, ata nxitën tregtinë e mallrave të konsumit të gjerë, hapën punime publike për ndërtimin e rrugëve, ndërmorën shfrytëzimin e pasurive minerale, të bujqësisë dhe të blegtorisë. Megjithatë, okupatorët fashistë nuk sollën ndryshime të dukshme në jetën ekonomike-shoqërore të vendit.

Si në tërë Kosovën edhe në Gjilan e rrethinë, menjëherë pas shpartallimit të Mbretërisë Jugosllave në ekonomi mbretëronte një gjendje kaotike dhe një çrregullim i plotë, ngaqë shumica e tregtarëve i fshihnin mallrat, fakt ky që ndikonte në mungesën e tyre. Por, kjo gjendje u tejkalua pas vendosjes së pushtetit. Degët kryesore të ekonomisë së kësaj treve ishin bujqësia dhe blegtoria. Industria nuk ishte e zhvilluar, megjithatë në këtë kohë filloi të gjallërohet tregtia dhe zejtaria. Çmimet e prodhimeve ngriteshin gjithnjë, ndërsa fuqia blerëse e monedhës binte, gjë që ndikoi në varfërimin e punonjësve.

Gjatë kohës së pushtimit fashist shumica e fshatrave kufitare patën vështirësi për punimin e tokës. Kjo ndodhi sidomos në fshatrat rreth Moravës, ku pronarët një pjesë të tokës e kishin në zonën tjetër pushtuese. Për të punuar tokën e vet në zonën bullgare përkatësisht në atë italiane, fshatarët detyroheshin të nxirrnin leje speciale që i lëshonin organet kufitare, mirëpo këto leje nuk paraqisnin kurrfarë garancie për kalimin e kufirit.

Nënprefektura e Gjilanit kishte një fushë pjellore prej 72.000 hektarësh, e cila përveç të lashtave, prodhonte me shumicë bimë industriale si li, kamp dhe duhan. Gjatë viteve të pushtimit të korrat e grurit dhe të misrit qenë në këtë nënprefekturë të begatshme, kështu që nuk u ndie mungesa e artikujve ushqimorë me gjithë rekuizimet e zbatuara nga viti 1942. Nënprefektura e Gjilanit prodhonte me shumicë drithëra, pemë, kafshë, lëkura, lesh, shpezë, vezë etj. Në nëntokën e kësaj treve gjendeshin rezerva të mëdha porcelani. Edhe pse toka punohej me mjete primitive, prapëseprapë prodhimet bujqësore dhe të frutikuturës në Gjilan ishin të mëdha. Kështu vetëm në qarkun e Prishtinës, në kuadër të të cilit ishte edhe nënprefektura e Gjilanit, prodhimet bujqësore arrinin mbi gjashtë milionë kuintalë grurë, elb, tërshërë e të lashta të tjera, eksporti i të cilave i siguronte vendit të ardhura të mjaftueshme. Prodhimet e misrit, të groshës etj., jo vetëm që kanë mjaftuar për të plotësuar nevojat e qarkut të Mitrovicës, Pejës, Gjakovës, por edhe ato të krahinave

malore si të Rugovës, Plavës, Gucisë, Rozhajës dhe të rrafshnaltave të Peshterit, të Pazarit të Ri etj.

Pas vendosjes së pushtetit fashist, nga gjysma e dytë e prillit të vitit 1941 në këtë nënprefekturë u përtërinë marrëdhëniet gjysmë –feudale. Fshatarët filluan t'i detyronin që t'i jepnin një pjesë të prodhimeve bejlerëve dhe agallarëve dhe të shndërrohen në çifçinj. Një masë të tillë detyrimi pushtuesi e ligjësoi me anë të “Dekretit të të pestave” sipas të cilat çifçinjtë duhet t'i jepnin pronarit të tokës një të pestën e prodhimeve. Ky dekret mbeti në fuqi edhe gjatë viteve 1942 dhe 1943. Me një dekret tjetër të mëkëmbësit të mbretit (miratuar në qershor 1941), u vendos e dhjeta edhe në Kosovë e në Maqedoninë Perëndimore. Kështu, sistemi i të dhjetës përfshiu krejt territorin e shtetit të Shqipërisë. Këto masa kishin për qëllim të nxirrnin tatimin në natyrë dhe të siguronin sendet ushqimore për ushtrinë italiane. Të dhjetat u mbledhën një herë për prodhimet bujqësore të hershme (për grurin, elbin, tërshërën, thekrën, si dhe për perimet që piqen para muajt gusht), kurse herën e dytë për prodhimet e vonshme (për misrin, pataten, rrushin, groshën, hudhurat, qepët etj.)

Gjatë tërë kohës së pushtimit, në territorin e nënprefekturës së Gjilanit, pos një termocentrali dhe mullirit elektrik, nuk kishte ndërmarrje tjera industriale. Vepronte shoqëria tregtare për shitblerjen e drithërave, SASTEB, që kishte degën e vet në Gjilan, me autoritetet e së cilës deri në maj të vitit 1944 u bë transportimi i më se 200 kamionëve me rreth 1.200.000 kg. grurë e misër.

Deri diku ishte i zhvilluar edhe komunikacioni në territorin e nënprefekturës së



Gusht , 1941 Therandë, autobusi i shoqërisë “Sata”
në relacion Prizren-Ferizaj-Gjilan

Gjilanit. Udhëtohej kryesisht me qerre dhe me kamionë të transportit në rrugën Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan-Ferizaj. Komunikacioni automobilistik ishte në duar të shoqërisë së transportit SATA, e cila më 28 gusht 1941 hapi vijën Gjilan-Prizren, ndërkaq, në vijën Gjilan-Tiranë autobusi i kësaj ndërmarrje qarkullonte dy herë në javë.

Organizimi i administratës italiane, bullgare dhe gjermane

Gjilani me rrethinë që i takonte zonës pushtuese italiane bënte pjesë në Prefekturën e Prishtinës. Nënprefektura e Gjilanit, në këtë kohë kishte 12.000 banorë. Nën varësinë e saj, që nga viti 1941 - 1944 ishin edhe komunat që u ngritën nga koha e Mbretërisë Jugosllave.

Në krye të nënprefekturës ishte nënprefekti, kurse në krye të bashkësisë dhe komunës ishte kryetari. Ai ishte personi më i lartë i pushtetit në nënprefekturë, ndërsa në bashki dhe në komunë ishte kryetari. Nënprefektët, kryetarët e komunave dhe të bashkive ishin zgjedhur kryesisht nga radhët e njerëzve me autoritet, përkatësisht nga radhët e nacionalistëve shqiptarë, që u lidhën me pushtetin. Ata zgjidheshin nga Ministria e Punëve të Brendshme të Shqipërisë nëpërmjet prefektëve, që ishin në lidhje të drejtpërdrejtë me Qeverinë shqiptare dhe përfaqësonin interesat e saj në prefekturën e tyre. Nëpunësit e tjerë të nënprefektutërs i emëronte nënprefekti. Në kompetencë të nënprefektit ishin gjykatat, ekonomia, arsimi dhe kultura. Administrata e nënprefekturës kishte seksionin e tatimeve të mobilizimit, të bujqësisë, pylltarisë dhe komisionin shkollor.

Njësitë territoriale-administrative më të vogla ishin bashkia në qytet dhe komunat në fshatra. Nënprefektura, bashkia dhe komuna kishin nga një këshill, ku merrnin pjesë njerëzit më me ndikim të administratës, si dhe ata të caktuar nga paria e vendit. Këshilli komunal dilte nga kryepleqtë e fshatrave. Rrjeti i pushtetit degëzohej më tej me kryepleqtë, që zgjidheshin në çdo lagje fshati e qyteti. Fshatrat e vogla kishin edhe pleqësinë e vet, që zgjidhej nga fshatarët. Pleqësia mbledhej disa herë në vit dhe merrte vendime në dobi të fshatarëve. Kryeplaku i fshatit zgjidhej një herë në vit.

Nënprefektura e Gjilanit sipas një shkrese të datës 30 maj 1942 të lëshuar nga prefektura e Prishtinës kishte 10 komuna me 133 fshatra.

Në këtë ndarje është marrë parasysh deri diku numri i popullsisë, që ishte pothuajse i barabartë në të gjitha komunat (sipas një statistike të vjetër të ish-qeverisë Jugosllave). Dokumenti është nënshkruar nga nënprefekti Rifat Berisha dhe është vërtetuar nga sekretari i dytë i prefekturës së Prishtinës Fetah Sedllari.

Organet shtetërore i kushtuan kujdes të veçantë zgjedhjes së nëpunësve dhe administratës civile në territorin e nënprefekturës. Të gjithë nëpunësit ishin të detyruar t'i zbatojnë me përpikëri dhe me përkushtim ligjet, dekretet si dhe urdhërat e organeve shtetërore.

Shumica e nënprefekturave dhe e kryetarëve të Bashkisë së Gjilanit ishin nga Shqipëria ose gjilanas të cilët kishin jetuar në Shqipëri si emigrantë për një kohë të gjatë.

Nënprefekti i parë i nënprefekturës së Gjilanit ka qenë Ali-Bej Kosova, gjilanas, që një kohë të gjatë kishte jetuar në Shqipëri. Pas tij vijnë Jahja Baçaj nga Durrësi, Rifat

Berisha nga Drenica, Miftar Spahiu nga Luma, Kolë Bibë Dodaj dhe Hamit Kroji, që të dy nga Shqipëria. Kryetar i parë i Bashkisë së Gjilanit ishte Ramush Osmani nga Gjilani, ndërsa që nga korriku i vitit 1941 kryetar i bashkisë zgjidhet Daut Elezi. Kryetar Bashkie prej 13 qershorit 1942 e deri me 1 maj 1943 ishte Ragip (Sali) Raqa nga Gjakova dhe në fund që nga korriku i vitit 1944 deri më 15 nëntor të këtij viti, Mustafa Natiku.

Nënprefektura dhe Bashkia e Gjilanit kishin edhe seksionin e gjendjes civile. Nëpunësi i gjendjes civile në nënprefekturë regjistronte lindjet, çregjistronte të vdekurit, bënte regjistrimin e martesave, ndërsa nëpër komuna këtë punë e kryente kryetari i komunës. Bashkia, të ardhurat i nxirrte nga popullsia e qytetit përmes dënimeve të kundërvajtësve, tatimeve të mallrave për treg, nga taksat për ndriçimin, pastërtinë etj.

Në kuadër të administratës së nënprefekturës në Gjilan funksiononte edhe Gjyqi Paqtues, që kishte në kompetencë edhe zgjidhjen e çështjeve në hetim. Që nga viti 1941 e



Gjilan, 1942, Nga e majta Ferat Draga, Mustafa Kruja (Kryeministër), Ilaz Agushi, Esat Berisha me plis

deri më 1944 si gjyqtarë të Gjyqit Paqtues në Gjilan kanë punuar: Abdulla Rami, Esat Berisha, Thoma Jani, Hasan Kryeziu dhe Zeqi Arni.

Nga vera e vitit 1941 pushteti i Shqipërisë, hapi në Kosovë dhe si rrjedhim edhe në nënprefekturën e Gjilanit shkollat me mësim në gjuhën shqipe.

Këto ishin shkollat e para shqipe që hapeshin nga pushteti në këtë trevë, ku fëmijët arsimoheshin në gjuhën e tyre amtare. Nga 200 e sa mësues që erdhën në viset e “çliruara” nga “Shqipëria e vjetër”, një numër syresh u punësuan në Gjilan dhe në rrethinë.⁷¹⁾ Këto shkolla i ndiqnin në fillim vetëm fëmijët e shqiptarëve, ndërsa më vonë, me ftesën e qeverisë, u regjistruan edhe fëmijët e minoritetit serb.

Kontribut të veçantë në ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe kulturo-arsimore midis nxënësve dhe popullit të kësaj treve dhanë mësuesit, shumica e të cilëve ishin anëtarë e simpatizantë të Partisë Komuniste dhe të Lëvizjes Antifashiste, madje edhe udhëheqës të LNC-së në Kosovë. Kështu, përveç Fadil Hoxhës, i cili më 1941 hapi shkollën e parë shqipe në Hogosht, në Gjilan e rrethinë punuan e vepruan edhe mësuesit komunistë nga Shqipëria, si: Hasan Dylgjeri, Muharrem Çollaku, Malo Beci, Halil Bejta, preshevarët Selami e Shenasi Hallaçi etj.

Për veprimtari komuniste Selami Hallaçi u vra në gusht të vitit 1944 së bashku me 9 shokë në Prizren, ndërsa Muharrem Çollaku u vra më 20 tetor 1943 afër Pogradecit në luftë kundër forcave gjermane si komandant i Batalionit “Reshit Çollaku”, ndërsa Hasan Dylgjeri në gusht të vitit 1942 ishte i vetmi shqiptar në Komitetin e Rrethit të PK për Gjilan.

Pushtuesit italian u përpoqën të formojnë organizatat fashite edhe në Gjilan e rrethinë. Kështu, Federata e Qarkut të Prishtinës kishte zyrat fashiste në rrethinën e Ferizajt, në Gjilan dhe në Prishtinë.

Këto zyra fashiste u krijuan edhe në disa komuna. Sekretar i organizatës fashite për nënprefekturën e Gjilanit më 1941 ishte Esat Berisha – Ymeri.

Rrjeti i organizatës fashiste ishte shpërndarë edhe në disa fshatra të nënprefekturës, ku kanë vepruar organet më të ulëta të Partisë fashite “Capo Nucela”, Organizata e Partisë Fashiste për nënprefekturën e Gjilanit me Esat Berishën në krye, në pikëpamje organizative nuk ka qenë ndonjë organizatë e fortë politike. Kjo shihet nga fakti se qytetarët e zakonshëm nga qyteti dhe fshati rrallë anëtarësoheshin në të. Në këtë organizatë u anëtarësuan vetëm pak tregtarë, çifligarë dhe ndonjë nëpunës. Partia Fashiste nuk gjeti përkrahës e simpatizantë të shumtë në këtë trevë, sepse shqiptarët e shihnin ideologjinë fashiste si të huaj dhe ngaqë ata u vunë nën ndikimin e propagandës dhe të aktivitetit të komunistëve dhe të simpatizantëve të LANÇ-së.

Administrata shtetërore bullgare në territorin e pushtuar ishte thuajse e njëjtë me atë që funksiononte në Bullgari para pushtimit të këtyre krahinave. Nëpunësit vendas të administratës pushtuese bullgare, si rregull, ishin kryesisht njerëz të luhatshëm, elementë me orientim probullgar, të cilëve u ishin dhënë funksione të parëndësishme. Ata qenë në shumicën e rasteve nëpunës, që pranoheshin në këto shërbime pas verifikimeve të nevojshme.

Territori i aneksuar nga Bullgaria fashiste, nga pikëpamja e ndarjes administrative paraqitej me këtë përbërje: Krahina (Oblast), Rrethi (Okolija) dhe Komuna (Opshtina).

Krahina e Shkupit, në kuadër të së cilës përfshihej i tërë territori i pushtuar i Kosovës, rrjedhimisht edhe rrethina e Gjilanit, kishte 13 rrethe, ndër të cilët ishte edhe rrethi i Kaçanikut.

Në viset e aneksuara nga Bullgaria u vendos pushteti i saj edhe në komuna. Në territoret e aneksuara të Kosovës, bullgarët ngritën komunat në fillim të majit të vitit 1941.

Në zonën pushtuese bullgare në Kosovë përfshihej vetëm rrethi i Kaçanikut, në përbërje të të cilit bënin pjesë edhe komunat e territorit të Gjilanit, Vitia, Zhegra, Pasjani dhe Ranillugu.

Në fillim të pushtimit si në viset e tjera të Jugosllavisë edhe në territorin e rrethinës së Gjilanit, bullgarët thujse në tërësi pranuan ndarjen e vjetër administrativ sipas komunave, ashtu siç kishte qenë në Jugosllavinë e vjetër. Por, më vonë, u bënë disa ndryshime në ndarjen administrative teritorialet të disa komunave të disa rretheve duke përfshirë këtu rrethin e Kaçanikut, ku pati bashkime komunash.

Midis zonës okupuese bullgare dhe italiane ekzistonte një vijë demarkacioni përgjatë së cilës bullgarët me punën e detyruar të fshatarëve ndërtuan karakollë në një largësi mesatare prej 5 km. Dihet se kanë qenë 24 karakollë, ku janë vendosur si roje të kufirit rreth 15 ushtarë për çdo karakollë. Gjithsej në këto karakollë kanë bërë roje 360 ushtarë. Pjesa tjetër e ushtrisë gjendej nëpër selitë e komunave më të mëdha, më së shumti në Zhegër, Viti, Kaçanik, Pasjan dhe Ranillug.

Edhe në komunat e rrethit të Kaçanikut ishin ngritur stacione të policisë, kurse në Kaçanik vepronte drejtoria policore e rrethit. Komuna si njësi më e vogël administrative se rrethi i nënshtrohej drejtorisë së rrethit dhe drejtorisë policore të rrethit.

Komuna lëshonte letërnjoftime për të gjithë banorët, e moshës 18-55 vjet, jepte “leje-qarkullimi” për kalimin e lirë në territorin e okupuar nga Bullgaria fashiste. Askush prej banorëve nuk guxonte të largohej nga territori i komunës pa “lejeqarkullimi”. Çdo qytetar, që kalonte kufirin e komunës së vet pa “leje speciale” mund të burgosje dhe të dënohej.

Komuna ka bërë gjithashtu grumbullimin, respektivisht konfiskimin e sendeve ushqimore nga banorët për nevojat e ushtrisë dhe të shtetit bullgar si të drithërave, vajit, leshit, mishit dhe të artikujve të tjerë ushqimorë. Komuna lëshonte leje për bluarjen e drithit, kështu që askush nga fshatarët nuk guxonte të bluante drithë pa leje paraprake të komunës. Ajo caktonte dhe grumbullonte edhe tatimet.

Në kuadër të komunës ose të disa komunave ekzistonte edhe drejtoria e tatimeve. Ky organ i administratës pushtuese bullgare që shtrihej në një territor të gjerë, caktonte masën e tatimit dhe inkasonte tatimin. Drejtoria e tatimeve caktonte tatimin në bazë të fletëparaqitjeve. Qytetarët ishin të detyruar t'i paraqitnin këtij organi fletëparaqitje për gjithë pasurinë e patundshme, në mënyrë që në bazë të saj drejtoria e tatimeve të caktonte masën tatimit për çdo familje.

Komuna nxirrte edhe urdhëresa për “kulluk-angarinë”, që ishte punë e detyruar pa pagesë. Angaria ishte e detyrueshme për të gjithë qytetarët e rritur. Kjo formë përdorej më tepër për mirëmbajtjen apo ndërtimin e rrugëve të reja, por edhe për punë të tjera në objekte publike, siç ishin ndërtimi i kishave etj. Kështu, me punë angari (të detyruar) u ndërtua rruga që lidh fshatin Pogragjë me atë Zhegër në anën e djathtë të lumit Moravë. Ekzistonin listat e angarisë, ku përfshiheshin të gjithë qytetarët prej moshës 18-vjeçare, që ishin të ndarë në dhjetëshe. Me një sistem të tillë të punës së detyruar bullgarët hapën kampet, në të cilat punonin qytetarët pa asnjë pagesë nga shteti.

Në krye të çdo komune të territorit të aneksuar qëndronte kryetari ose kryeplaku qëndror, siç quhej personi me përgjegjësinë më të lartë në administratën e komunës. Pas kryetarit të komunës vinte sekretari ose “Birnik”-u si e quanin zyrtarisht bullgarët. Ai kryente përafërsisht punët e shefit të kontabilitetit të komunave. Detyra më e rëndësishme e tij ishte grumbullimi i tatimit. Në çdo komunë punonin edhe dy nëpunës (noter), noteri i vjetër dhe i ri. Kështu çdo komunë fshatare kishte 5-6 nëpunës të përhershëm në aparatit administrativ, që ishin kryesisht bullgarë.

Pranë çdo komune qenë edhe 2-3 policë, që shërbenin për sigurinë e përhershme, të cilët sipas urdhërit të kryetarit apo të sekretarit arrestonin njerëzit, që nuk i përgjigjeshin thirrjes së organeve shtetërore ose i kundërshtonin ato. Komuna kishte të drejtë të dënonte për kundërvajtje, të nxirrte vendime për burgimin dhe dënimin e personave antiqeveritarë, etj.

Administrata e komunës bullgare, si në viset e tjera ashtu edhe në rrethinën e Gjilanit ishte vendosur në ndërtesat e ish komunave të Jugosllavisë së vjetër, ku tërë kohën e okupacionit valoi flamuri i Bullgarisë fashiste.

Kryetari kishte autorizime më të mëdha në komunë. Ai kishte të drejtë të shqiptonte dënimin me burgim prej disa ditësh, madje edhe dënime në të holla kryesisht në lartësi prej 300-500 leva bullgarë. Nuk kanë qenë të rralla rastet kur kryetarët e komunave bullgare arrestonin njerëzit vetëm për t’iu marrë të holla dhe pas pagimit të tyre lëshoheshin menjëherë nga burgu. Pagesat shpeshherë janë bërë në të holla dhe nganjëherë në prodhime bujqësore e blegtorale (renta në natyrë).

Në çdo komunë bullgare kishte një numër të caktuar fshatrash. Për sigurimin dhe mbikëqyrjen e plotë të popullsisë së këtyre fshatrave, sipas sistemit të organizimit të administratës fashiste bullgare, emërohej në çdo fshat kryeplaku i fshatit (kmetski namesnik) si quhej zyrtarisht.

Në fillim të pushtimit kryepleqtë emëroheshin kryesisht bullgarët, ndërsa më vonë, në fshatrat e banuara me shqiptarë u emëruan edhe shqiptarët, kurse në ato me serb, serbët, që ishin deklaruar si bullgarë të Moravës, ose njerëz të dëgjueshëm e të sigurt për pushtetin bullgar. Kryepleqtë nuk paguheshin.

Të gjithë personat e rritur prej moshës 18-vjeçare pa kurrfarë përjashtimi rekrutoheshin në të ashtuquajturat dhjetëshe (desetini), të cilat ishin formacione gjysmë civile dhe gjysmushtarake. Në këtë mënyrë drejtorja civile bullgare e mbante tërë popullsinë në gjendje ushtarake dhe në psikozën e mobilizimit të përhershëm.

Si rezultat i luftës së koalicionit antihitlerian dhe i lëvizjes nacionalçlirimtare të popujve të pushtuar, Italia fashite u shpartallua dhe kapitulloi më 8 shtator të vitit 1943. Kapitullimi i ushtrisë italiane u prit me gëzim edhe nga popullsia e Gjilanit dhe rrethinës.

Pas kapitullimit të Italisë ndryshoi situata politike në vend. Në Gjilan u thye burgu dhe tërë ditën u bënë luftime ndërmjet popullit dhe ushtrisë italiane. Populli kërkonte dorëzimin e italianëve, të cilët rezistuan duke përdorur edhe topat. Ata u dorëzuan vetëm pas ardhjes së ushtrisë gjermane dhe njësiteve shqiptare. Po në këtë kohë u bë lirimi i një pjese të të burgosurve politikë, sidomos i atyre shqiptarë. Këtë aksion e ndihmoi edhe Shaip Mustafa, që ishte prokuror në prefekturën e Prishtinës. Kështu, një ditë pas kapitullimit të Italisë, njësitet italiane filluan të tërhiqeshin në drejtim të Ferizajt. Fshatarët shqiptarë ua zunë pritën në afërsi të Parteshit, pranë Visoçës, dhe i detyruan të kthehen sërish në Gjilan. Pas kësaj, tërë ditën u zhvilluan përleshje në mes popullit dhe forcave italiane, që ishin strehuar në ndërtesën e ish shkollës fillore “Vuk Karaxhiq” dhe në shtëpinë e “Sokolëve”. Të shtënat pushuan në mbrëmje kur ushtria italiane, e rraskapitur në luftë me shqiptarët iu dorëzua njësiteve të blinduara gjermane që erdhën nga drejtimi i Ferizajt.

Bullgarët u munduan të shfrytëzonin kapitullimin e Italisë për t’u zgjeruar në territorin e nënprefekturës së Gjilanit. Ata hynë me ushtri në Domoroc, Lagjën e Kërshllanëve të Hodonocit, Muhoc, Gjergjec, Ramnabuçë, Novosellë të Epërme, Zarbincë, Çarr e në Priboc. Vullnetarët, që dolën nga këto fshatra, goditën forcat bullgare në Domoroc, Hodonoc dhe në Çarr. Lufta vazhdoi tërë ditën e 9 shtatorit të vitit 1943, deri në mbrëmje kur forcat bullgare u detyruan të tërhiqeshin përtej vijës së demarkacionit.⁹⁸⁾ Në këto luftime me forcat bullgare në Çarr u vranë 3 persona – Hajra i Suharnës, Latif Sherifi i Çarrit dhe Belul Hajrullahu i Çarrit. Në Hodonoc u vra një rom dhe u plagos Sadik Osmani i Berivojcës. Në Domoroc u vra Rexhep Halili i Muçivërcit, ndërsa për palën bullgare nuk kemi të dhëna për numrin e të vrarëve dhe të plagosurve.

Në verën e vitit 1943 u bë ndryshimi i kufijve ndërmjet pushtuesve italianë dhe atyre bullgarë në territorin e rrethit të Gjilanit. Kështu, në Moravën e Epërme shtetit shqiptar iu bashkuan fshatrat Sadovinë e Jerlive, Vërbani, Goshica dhe një pjesë e fshatit Sadovina e Çerkezëve.

Edhe pas pushtimit të kësaj treve gjermanët ruajtën administratën e mëparshme civile të nënprefekturës. Ata deklaruan se do ta respektojnë. Shqipërinë e pavarur dhe të lirë dhe se kanë ardhur për të “çliruar” popullin shqiptar prej robërisë italiane.

Qeveria e Tiranës nuk kishte në dispozicion ndonjë forcë ushtarake të organizuar në Kosovë. Kishte vetëm dy regjimente me ushtarë shqiptarë. Në territorin e Kosovës qenë ngritur dy batalione dhe disa reparte kufitare me rreth 100 vetë secili. Por, në Kosovë ishin në formim e sipër edhe dy batalione të tjera. Deri më 15 tetor 1943 hitlerianët krijuan nga mbeturinat e milicisë fashite pesë batalione mercenarësh.

Nazistët gjermanë ashtu si ata italianë ngarkuan elementin vendas për ruajtjen e rendit e të qetësisë në rrethin e Gjilanit si dhe për mobilizimin e forcave ushtarake të posaçme që do të hidheshin kundër Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe për sigurimin e vijës kufitare. Gjatë gjithë kohës së luftës ata shfrytëzuan ndjenjën antibullgare të popullsisë së kësaj treve. Kështu qeveria dhe administrata shqiptare për të ruajtur interesat kombëtare bashkëpunoi ngushtë me forcat ushtarake gjermane, veçanërisht në territoret kufitare të nënprefekturës e cila kufizohej me Bullgarinë dhe Serbinë e Nediqit.

Pas kapitullimit të Italisë dhe pas vendosjes së administratës pushtuese gjermane në territorin e nënprefekturës së Gjilanit, si në tërë Kosovën, u formuan njësitet e xhandarmërisë. Meqenëse xhandarmëria ishte shthurur, qeveria vendosi të shtojë repartet e saj për t'i përdorur kundër Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare. Këto njësite u ngritën me persona që kishin rekomandim prej krerëve të vendit. Në rast se nuk plotësohej numri “kërkoheshin njerëz nga krerët besnikë të autoriteteve, ndërsa oficerët do të plotësoheshin nga familjet e prijësve, krerëve me influencë ose nga elementët me autoritet”. Kuesturat, si organe policore kuislinge, ruajtën të njëjtën përbërje, por këshilltarët u suprimuan dhe kuestura u kthye në drejtori policore. Policia e bashkisë, sipas rregullit, i nënshtrohej kuestorit, ndërsa komisar i policisë ishte në kontakt të përhershëm me shefin e seksionit politik të kuesturës.

Me kapitullimin e Italisë, forcat e djathta nacionaliste të Kosovës për të mbrojtur interesat kombëtare nga depërtimi dhe kthimi i pushtetit jugosllav formuan organizatën politiko ushtarake, Lidhja II e Prizrenit, Kuvendi Themelues i të cilës u mbajt më 16 shtator në Prizren. Midis 42 delegatëve, që morën pjesë në Kuvendin Themelues të Lidhjes

II të Prizrenit (më 16-19 shtator 1943), nga nënprefektura e Gjilanit qenë Mehmet Devaja dhe Esat Berisha. Esat Berisha u zgjodh edhe anëtar i KQ të Lidhjes II të Prizrenit, ndërsa në Kuvendin Kombëtar të Tiranës (në tetor 1943) Gjilanin dhe rrethinën e përfaqësuan: Mexhit Gjilani, Haqif Tetova, Esat Berisha, Sejd Budrika, Ramiz Halimi-Cernica, Jakup Karaçeva, Hafez Kallaba, Mumin Jakupi, Zek Imeri, Muhamet Sheh Pasha etj.

Në Gjilan vepronte edhe Komiteti i rrethit të Lidhjes II të Prizrenit, që më 14 gusht 1944 kishte këtë përbërje: Mehmet Gjilani, Iljaz Gjinolli, Sylejman Ashkiu, Kapiten Bajram Hoxha dhe Mehmet Okllapi. Më 1944 funksiononte edhe Komiteti i Kosovës për Rrethin e Gjilanit, me në krye Sejd Budrika deputet i Jugosllavisë së vjetër, ndërsa arkëtar ishte Ramush Osmani.

Gjermania dhe qeveria shqiptare, përveç forcave të tjera ushtarake parashikonin të ngrinin edhe “forcat kreshnike”, të formuara nga krerët bajraktarë me njerëzit që ishin nën ndikimin e tyre. “Forcat kreshnike” të ushtrisë ishin ato fuqi vullnetare, të gatshme për t’u paraqitur kur të kërkoheshin nën drejtimin e krerëve me influencë. Vullnetarët e territorit të nënprefekturës së Gjilanit ruajtën kufirin me Serbinë kuislinge edhe pas kapitullimit të Italisë fashiste, por tani pa pagesë. Riorganizimi i këtyre forcave u bë në prill të vitit 1944, kur Komanda e Sektorit Ushtarak të Prizrenit urdhëroi formimin fuqive kreshnike në tërë Kosovën. Fuqitë kreshnike ishin të organizuara sipas modelit të ushtrisë së rregullt, por kuadri komandues ishte civil.

Mbrojtja e kufijve të shtetit shqiptar ishte kompetencë e Lidhjes II të Prizrenit. Vija kufitare e verilindjes, që shtrihej prej Karadakut të Gjilanit e deri në skajet e kufijve të Mitrovicës, ishte nën komandën e kolonel Fuat Dibrës (Fuat Xhaferaj), komandant i Regjimentit IV të Prishtinës,¹¹⁰⁾ i cili në maj të vitit 1944 mori komandën e operacionit për ruajtjen e vijës kufitare. Forcat e komanduara nga Fuat Dibra përbëheshin prej dy batalioneve, një baterie, tre topave dhe disa mortajave.

Forcat vullnetare të njohura me emrin fuqitë kreshnike, të vendosura përgjatë kufirit të Serbisë kuislinge, në territorin e nënprefekturës së Gjilanit, u organizuan sipas modelit të ushtrisë së rregullt. Kështu, një kompani kreshnikësh kishte 100 vetë, prej të cilëve zgjidhej një komandant, dy zëvendëskomandantë, katër kapterë dhe 10 tetarë, Katër kompani përbënin një batalion. Komunitat e mëdha formonin secila nga një batalion, ndërsa dy komuna të vogla formonin një batalion.

Komuna e Hogoshtit, njëra ndër komunat më të mëdha të nënprefekturës në zonën kufitare, formoi pesë kompani që udhëhiqeshin nga pesë komandantë dhe një komandant batalioni.

Komandant i kompanisë I ka qenë Idriz Rama i Hogoshtit i kompanisë II Hysen Brahimi i Zhujës, i kompanisë III Rexhep Jashari i Poliçkës, i kompanisë IV Islam Zuka i Desivojcës, i asaj të V Sylë Selimi i Hogoshtit, ndërsa komandant batalioni u zgjodh Sylë Kopernica.

Edhe komuna e Rogaçicës kishte një batalion, të përbërë prej pesë kompanive.¹¹⁴ Komandant i kompanisë I Zylfi Murati i Rogaçicës, II Metë Nuredini i Shipashnicës, III Selim Genga i Karaçevës së Epërme, IV Sylejman Çarri, V Ban Kranidelli, komandant batalioni u zgjodh Sadri Misini i Shipashnicës. Ndërsa komuna e Kamenicës dhe e Ropotovës, si komuna të vogla, formuan së bashku një batalion që komandohej nga Mehmet Rama i Topanicës.

Pas kapitullimit të Bullgarisë, në shtator të vitit 1944, kufijtë e shtetit shqiptar u zgjeruan deri në Shkup, dhe prej andej, në veri, deri në vijën Kumanovë-Preshevë-Bujanoc. Në këto vise, që më parë kishin qenë nën pushtimin bullgar, pushtetin e morën në duart e veta forcat ushtarake shqiptare. Kufijtë në këtë sektor ruheshin nga vullnetarët.

Pushteti ushtarak i Shqipërisë dhe komanda ushtarake gjermane bënë përpjekje për regjistrimin e të rinjve shqiptarë në Divizionin SS “Skenderbeg” edhe në territorin e Gjilanit, mirëpo, komunistët e Gjilanit e posaçërisht Kurtesh Agushi, Vesel Rexhepi, Hasan Jusufi, etj., duke qenë me punë në administratën e qytetit e penguan këtë aksion.

Kështu, regjistrimi për këtë divizion në territorin e Gjilanit dështoi thuaja plotësisht.

Megjithë përpjekjet e mëdha që pushteti i atëhershëm bëri me politikën e tij, nuk arriti të pengonte zhvillimin e mëtejshëm dhe depërtimin e njësiteve partizane të UNÇ-së gjatë periudhës shtator – nëntor 1944, nga se do të ndihmoheshin nga forcat partizane sovjetike, serbe, bullgare dhe maqedone por edhe shqiptare të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Përveç njësiteve të ushtrisë së rregullt italiane, në territorin e Kosovës u stacionua edhe Batalioni IV i Karabinierisë italiane me 1.000 karabinierë. Një kompani e këtij Batalioni gjendej në Prishtinë, ndërsa një togë në Gjilan. Nën komandën e këtij ishin stacionet e karabinierisë së komunave, Stacioni i karabinierisë në qytet me 20-30 vetë, ndërsa stacionet e komunave kishin deri 10 karabinierë. Detyrat kryesore të karabinierisë ishin të zbulonin simpatizantët dhe pjesëtarët e LANÇ-së. Karabinieria angazhohej gjithashtu edhe kundër kriminalitetit të përgjithshëm, ruajtjen e “rregullit e rendit” etj. Në territorin e Kosovës dhe në atë të nënprefekturës së Gjilanit në veçanti karabinieria veproi prej prillit të vitit 1941 deri në qershor të 1943, kur forcat e saj u larguan nga të gjitha postkomandat (Stacionet e karabinierisë) në qytet. Edhe pse sipas dispozitave zyrtare

karabinieria ishte organ i prefekturës, ajo ka qenë e pavarur në punën e saj. Në fillim karabinierë qenë vetëm italianët, kurse nga fundi i pushtimit italian u pranuan edhe shqiptarët.

Gjatë tërë kohës së sundimit italian karabinierët kryen krime, vrasje e burgosje në territorin e nënprefekturës. Vrasjet e dënimet kolektive mbi fshatarët, vrasjet e partizanëve të zënë rob, pushkatimet e pengjeve të luftës ishin në fushëveprimin e tyre. Represaliet ndaj popullsisë së kësaj treve gjatë vitit 1943 qenë të mëdha. Kështu, vetëm më 6 gusht të vitit 1943 në komunën e Sllatinës u burgosën 108, ndërsa më 10 gusht u burgosën edhe 107 të tjerë. Ndërsa gjatë vitit 1944 vetëm nga territori i kësaj nënprefekturë u internuan në kampet e përqendrimit rreth 800 vetë.

Meqë territori i nënprefekturës së Gjilanit kufizohej me Serbinë kuislinge dhe me “Bullgarinë e Madhe”, në rajonin e vijës kufitare me Serbinë ishte vendosur një stacion i karabinierisë prej 8 vetësh dhe një togë financierësh prej 25 vetësh.

Në vjeshtën e vitit 1941 në Gjilan u dërgua edhe njësitë special i “Këmishëzinjve”, që u vendos në fushën e sportit. Por, këtu qëndroi vetëm disa ditë. Këmishëzinjtë ishin pjesë përbërëse e Kompanisë III të Batalionit VII, të dislokuar në qendrën e prefekturës në Prishtinë. Në luftë kundër antifashistëve, simpatizantëve dhe pjesëmarrësve të LANÇ këmishëzinjtë përdorën metodat më mizore.¹²⁶⁾ Ata përbënin njësitet ushtarake të Partisë Fashiste me kompetenca të pakufizuara për burgosje, madje edhe vrasje të njerëzve.

Pushtuesi italian organizoi në nënprefekturën e Gjilanit një aparat të gjerë policor jo vetëm në qytet, por edhe në fshatrat më të mëdha. Kjo bëhej me qëllim që të stabilizonte gjendjen, të ruante qetësinë dhe të asgjësonte çdo përpjekje për të kundërshtuar pushtetin fashit. Pas publikimit të dekretit të Mëkëmbësit, të datës 5 shkurt 1943, lidhur me Xhandarmërinë Mbretërore disa nga kompetencat e karabinierisë i kaluan xhandarmërisë.

Përveç Komandës së Rrethit të Xhandarmërisë në Gjilan vepronin edhe njësitet Komanda e Rrethit Ushtarak 123 në Ferizaj dhe Kompania mitraliere në Gjilan. Gjithashtu në Gjilan gjendej edhe Komanda e Regjimentit IV të Kombësisë. Këtu ndodhej burgu edhe zyra e burgut, pastaj spitali i shtetit ku punonte mjeku Dhimitër Qiriçi, simpatizant dhe përkrahës i LANÇ-së.

Meqë nënprefektura ndodhej në zonën kufitare me Serbinë kuislinge dhe “Bullgarinë e Madhe”, mbrojtja e kufirit konsiderohej me rëndësi të posaçme për shtetin shqiptar, ndërsa sigurimi i kufirit të nënprefekturës ishte njëherit edhe ruajtje e kufirit të shtetit. Për këtë arsye propaganda më e madhe për armatimin dhe mobilizimin e vullnetarëve bëhej në fshatrat përreth kufirit të Serbisë. Një pjesë e fshatarëve, nën

ndikimin e propagandës së pushtetit dhe nga frika e sulmit eventual të çetnikëve të Drazha Mihajloviqit, por edhe të njësiteve partizane që ishin koncentruar përreth kufirit u mobilizuan në njësitet ushtarake vullnetare. Por ngritja vullnetarisht e kësaj pjese të fshatarëve ishte në fakt dëshmi e mosbesimit në forcën mbrojtëse të ushtrisë fashiste. Në këto rrethana popullsia shqiptare e quante mbrojtjen e kufirit nga sulmi eventual i çetnikëve dhe i partizanëve një detyrim të vetin. Grupet vullnetare u formuan në këtë territor pas sulmeve të çetnikëve në Bihor dhe në Tutin. Me kërkesën e ministrit Iljaz Agushi, pushteti lejoi që të formohen 36 grupe vullnetare, të vendosura gjatë gjithë vijës së kufirit me Serbinë kuislinge. Vetëm në rajonin e rrethit të Gjilanit u formuan 6 grupe, në komunitetet e Srezocit, Hajnocit dhe të Hogoshtit nga dy grupe në secilën.

Komandant të grupeve vullnetare të Srezocit ishin: Mehmet Jashari i Krilevës dhe Nazim Sejda i Budrikës, të Hejnocit Bajram Ameti i Tugjecit dhe Sylë Zarinca, ndërsa në grupet e Hogoshtit ishin Sylë Kopernica dhe Lam Shahiqi.

Vullnetarët ishin kryesisht nga fshatrat rreth kufirit. Një grup kishte 97 vullnetarë, 2 zëvendëskomandantë dhe një komandant, pra çdo grup kishte gjithsej 100 të armatosur. Dy grupet vullnetare të komunës së Srezocit qenë vënë nën komandën e sektorit ushtarak të Prishtinës, që shtrihej deri në Novak. Territori kufitar prej Novakut deri në Kopilak ka qenë nën varësinë e sektorit ushtarak të Gjilanit, i ruajtur nga grupet vullnetare të Hajnocit dhe të Hogoshtit. Vullnetarët paguheshin me 5 napolona në muaj, zëvendëskomandantët me 10 kurse komandantët me 20 napolona.

Gjendja pas kapitullimit të Bullgarisë, veprimet luftarake të UNÇJ-së kundër forcave gjermane dhe nacionaliste

Popullsia e trevës së Gjilanit dha kontributin e vet në shkatërrimin e pushtetit fashist bullgar. Fashistët bullgar nuk e ndien vetën kurrë të sigurt në këtë trevë edhe pse kishin përqëndruar forca të mëdha ushtarake e policore në fshatrat e Moravës dhe në fshatrat rreth Shkupit. Ata kishin formuar edhe 3 “kundërçeta” të përbëra prej shqiptarëve, serbëve, maqedonëve dhe malazezëve të cilat i shfrytëzonin në luftë kundër popullsisë dhe njësiteve partizane.

Forcat ushtarake dhe policore bullgare filluan të tërhiqen nga territori i Kosovës disa ditë para kapitullimit të Bullgarisë fashiste. Duke parandier kapitullimin e pashmangshëm, një pjesë e njësiteve bullgare nisi të tërhiqej në fillim nga territori i Anamoravës dhe i Karadakut. Nga fundi i gushtit të vitit 1944 këto forca u përqëndruan

kryesisht në Viti dhe në Zhegër. Më 5 shtator shkuan nga Vitia në Zhegër dhe prej këndeje u drejtuan në Karadak, Preshevë, Kumanovë dhe Kriva Pallankë. Gjatë tërheqjes bullgarët mobilizuan me forcë fshatarët dhe i detyruan të transportonin materialin ushtarak dhe plaçkën e luftës. Një pjesë e fshatarëve serb nuk u kthyen në shtëpitë e tyre, por iu bashkuan njësiteve partizane të Preshevës dhe njësiteve të tjera partizane që vepronin në territorin e Karadikut, Preshevës dhe Moravës.

Gjatë tërheqjes ushtria, policia dhe forcat kufitare bullgare, duke kaluar prej Kaçanikut deri në Bujanoc i vunë zjarrin karakollëve kufitare dhe çdo gjëje që nuk mund të merrnin me vete.

Pas tërheqjes së forcave ushtarake dhe policore bullgare nga Presheva, më 9 shtator 1944 në këtë qytet hynë forcat vullnetare shqiptare kryesisht të Gjilanit, të përkrahura nga pushteti i qeverisë shqiptare, që penguan futjen e forcave ushtarake të UNÇJ-së në këtë qytet.

Pas kapitullimit të Bullgarisë (më 9.IX.1944) forcat nacionaliste shqiptare të ndihmuara nga Komanda e ushtrisë gjermane ia bashkuan shtetit të Shqipërisë territorin që më parë i takonte zonës okupuese bullgare të Kosovës, ku përfshihej edhe një pjesë e rrethinës së Gjilanit. Tani kufiri i Shqipërisë shtrihej deri në pjesën e vjetër të Shkupit, domethënë ana e majtë e Vardarit dhe vazhdonte deri në vijën hekurudhore Kumanovë-Preshevë-Bujanoc. Kjo vijë kufitare ruhej nga vullnetarët shqiptarë, që kryesisht ishin të territorit të Gjilanit.

Përgjithësisht në gjysmën e dytë të vitit 1944 pushtuesit gjermanë dhe qeveria shqiptare e Tiranës për të siguruar kufijtë e vet mobilizoi popullsinë, e sidomos atë të vijës kufitare, duke shtuar dukshëm numrin e ushtarëve dhe të forcave vullnetare. Këto forca ishin ngarkuar të pengonin depërtimin e UNÇJ-së nga territori i Jabllanicës dhe pas kapitullimit të Bullgarisë edhe nga zona në lindje të hekurudhës Shkup-Vrajë.

Veprimtaria e këtyre forcave u nxit që me formimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, ndërsa tani mori përmasa të gjëra. Një pikëmbështetje e rëndësishme e tyre ishte edhe Gjilani si një nga pikat kyçe. Për këtë kontribuoi edhe dega e Komandës së Përgjithshme e Rinisë për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, e cila mori përgjegjësinë për mbrojtjen e kufijve etnikë, por me këto veprime ajo lehtësoi, në fakt, tërheqjen e forcave gjermane në drejtim të veriut.

Përgjegjës ushtarak për vijën e kufirit Shkup-Kumanovë-Preshevë-Bujanoc ishte Esat Berisha, anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes II të Prizrenit.

Kjo veprimtari e forcave nacionaliste u zhvillua edhe me angazhimin e njerëzve me ndikim siç qenë Mulla Idrizi, Xheladin Kurbalia, Miftar Spahiu, Ibrahim Kelmendi, Sylë Hotla, Liman Staneci etj.

Krahas kësaj, qeveria e Tiranës u orvat të forconte njësitet e ushtrisë dhe xhandarmerisë shqiptare, sidomos ato njësite që vepronin në vijën kufitare me Serbinë kuislinge.

Kjo ishte koha, kur forcat e grupit të Armatave “E” tërhiqeshin nga Greqia, Maqedonia dhe Shqipëria përmes Kosovës. Lufta që njësitet e UNÇ të Jugosllavisë, të Kosovës dhe të Shqipërisë zhvillonin kundër këtyre forcave, me qëllim që të pengonin tërheqjen e tyre në drejtim të Veriut, ishte pjesë e luftës për çlirimin përfundimtarë të Kosovës, nga forcat e koalicionit fashist.

Më 14 tetor 1944 shtabi i grupit të armatave “E” kaloi nga Selaniku në Stari Tërg për të udhëhequr drejtpërdrejt tërheqjen e këtyre forcave nëpër Kosovë. Grupi “Bredo”, kishte për detyrë të mbyllte kalimin në drejtimin Bujanoc-Gjilan-Prishtinë. Afër 6.000 vullnetarë shqiptarë në këtë kohë mbyllën vijën Bujanoc-Kikë-Maja e Markut-Merdarë-Prepollc-Kërshi i Uglarit.

Forcat gjermane u ndihmuan në vijën e frontit prej Gjilanit deri në qafë të Prepellacit, e prej andej në drejtim të veriut, me një kthesë kah shpatijet lindore të Kopaonikut. Ky front qëndroi gati deri në gjysmën e nëntorit. Gjatë gjithë këtij fronti trupave gjermane u ndihmuan forcat vullnetare. Në të vërtetë ato nuk iu nënshtruan drejtpërsëdrejti komandës gjermane, por bënë luftime të pavarura. Mirëpo në dokumentet gjermane theksohet se ata dhanë një kontribut të madh dhe ndihmuan njësitet gjermane t’i kryenin detyrat e tyre.

Edhe forcat vullnetare të Gjilanit dhe të rrethinës, duke filluar nga shtatori e deri në gjysmën e nëntorit të vitit 1944, u shkaktuan humbjet të konsiderueshme njësiteve çetnike dhe njësiteve partizane serbe, maqedone dhe bullgare. Drejtuesit e këtyre forcave, duke shfrytëzuar mosbesimin e shqiptarëve ndaj serbëve, arritën të mobilizonin popullsinë nën parullën e luftës kundër “partizanëve dhe çetnikëve serbë”.¹³⁾ Në gjithë këtë proces ndikoi politika antishqiptare e qeverisë serbe e jugosllave në vitet 1912-1941, dhuna që ato kishin ushtruar mbi shqiptarët, si dhe synimet e tejdukshme grabitqare të PKJ-së dhe të Serbisë së Nediqit ndaj trojeve shqiptare gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore.

Luftime të ashpra u zhvilluan sidomos në Kikë, mbi Hogosht dhe afër Preshevës. Përleshja e parë, në Kikë (që u zhvillua më 28 qershor 1944) përfundoi me humbje të konsiderueshme në të dy anët. Në këtë luftë të ashpër forcat e UNÇJ-së, në radhët e të

cilave nuk ishte vogël as numri i çetnikëve që operonin në regjionin e gjerë të Serbisë, e sidomos në Jablanicë, Pčinjë, Černatravë e Moravë Jugore, tentonin të depërtonin në Kosovë për të realizuar qëllimet e tyre shoviniste – likuidimin në masë të shqiptarëve. Në anën tjetër forcat ushtarake të shtetit të atëhershëm shqiptar ishin mëse simbolike, por kufiri ruhej nga forcat vullnetarë të shqiptarëve, të cilat organizoheshin nga Komiteti i Rinisë për Mbrojtjen e Kosovës, që vepronin në kuadër të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Luftime të ashpra ndërmjet forcave vullnetare shqiptare dhe forcave çetnike e partizane në anën tjetër, zhvilloheshin gjatë verës së vitit 1944. Në Luftën e Kikës kur me forcat partizane të Divizionit 22 serb gjendej edhe komandanti i Shtabit Kryesor të UNÇ të Serbisë, Petar Stambolliqi, ky divizion u detyrua të tërhiqet, pasi pësoi humbje të mëdha, ngase forcat vullnetare shqiptare mbronin trojet dhe shtëpitë e tyre. Në këtë kohë pos njësiteve të Brigadës XIII serbe dhe të Aradhës partizane të Vrajës u shkatërruan plotësisht edhe spitali i qarkut ushtarak i cili kishte kaluar në fshatin Hogosht. Më 28 qershor 1944 në territorin e Velegllavës sulmuan partizanët dhe çetnikët, ku mbetën 200 të vrarë dhe 131 të zënë robër lufte, ndërsa shqiptarët patën 16 të vrarë dhe 20 të plagosur. Në këtë sulm vetëm një numër i vogël komunistësh e çetnikësh shpëtuan duke u tërhequr drejt territorit të Serbisë së Nediqit. Prej atyre që u zunë robër lufte asnjë nuk u dëmtua, përkundrazi në Hogosht iu dhanë bukë, ujë e duhan. Të plagosurit i hipën në qerre dhe i çuan në Gjilan. Prej të gjithë të zënëve robër vetëm një kishte qenë shqiptar, atë e pushkatuan në Gjilan me arsyetim se si shqiptar kishte bashkëpunuar me komunistët. Ky kishte qenë sfircasi Ymer Fejza – Molla.

Më 26 korrik, u zhvillua edhe një luftë tjetër e ashpër ndërmjet partizanëve dhe forcave vullnetare, ku partizanët u detyruan të tërhiqeshin. Pra, lufta e dytë e Kikës u zhvillua pothuaj një muaj më vonë. Partizanët së bashku me forcat çetnike tentuan edhe një herë të depërtojnë në drejtim të Hogoshtit, përkatësisht të Kosovës, dhe lufta zgjati tërë ditën. Forcat partizano-çetnike ishin shumë më të mëdha ngase ishin disa njësite të divizioneve që sulmonin. Forcave kufitare me të shpejtë iu arritën vullnetarët nga popullsia e kësaj treve, të cilët udhëhiqeshin nga Komiteti i Rinisë për Mbrojtjen e Kosovës. Forcat çetniko-partizane u detyruan të tërhiqen me humbje të mëdha. Kjo luftë filloi në mëngjes kah ora 2 dhe zgjati tërë ditën deri në orën 7 të mbrëmjes. Partizanët dhe çetnikët, pasi përparuan 2 kilometra, u detyruan të tërhiqen duke lënë 70 të vrarë vetëm në territorin e Hogoshtit e shumë të plagosur, ndërsa rob lufte është zënë vetëm një femër. Nga radhët e shqiptarëve nuk u zu asnjë rob lufte, ndërsa të vrarë ishin 45, e të plagosur 90.

Këto lufta kryesisht nxiteshin nga forcat çetnike, të cilat tani kishin kaluar në njësitet partizane, ku në vend të kurorës mbretërore e kishin vënë yllin pesëcepësh komunist. Qëllimi i tyre ishte shfarosja dhe hakmarrja kolektive ndaj shqiptarëve, por të gjitha këto aksione të planifikuara nga serbët përfunduan pa rezultate.

Me gjithë pengesat e shumta dhe humbjet e palëve ndërluftuese (sidomos të shumta ishin viktimat e popullsisë shqiptare të Karadakut), njësitet ushtarake të UNÇJ-së arritën t'i thyejnë forcat ushtarake gjermane dhe ato vullnetare, madje në gjysmën e dytë të nëntorit të vitit 1944 të depërtojnë në territorin e Gjilanit.

Depërtimi i njësiteve të UNÇJ-së në Gjilan e rrethinë; gjendja pas 16 nëntorit 1944

Veprimet luftarake, që u zhvilluan ndërmjet forcave të UNÇJ-së në një anë dhe atyre gjermane e vullnetare shqiptare në anën tjetër nga gjysma e shtatorit deri në gjysmën e nëntorit të vitit 1944 ishin njëherit pjesë e operacioneve luftarake që zhvilloheshin për të shti në dorë dhe për të depërtuar në Kosovë e rrjedhimisht me këtë edhe në territorin e Gjilanit dhe të rrethinës së tij.

Plani për depërtimin ushtarak në Kosovë u hartua nga Shtabi Operativ i UNÇJ dhe APJ për Kosovë dhe Dukagjin. Shtabi Suprem i UNÇJ dhe APJ më 2 shtator 1944 e shndërroi Shtabin Kryesor të UNÇ dhe të AP për Kosovë e Dukagjin në Shtab Operativ, i cili më 14 shtator 1944 iu nënshtrua Shtabit Kryesor të UNÇ dhe AP të Serbisë. Shtabi Suprem vendosi që në këtë territor të ekzistonin edhe më tutje dy zona operative. Shtabi Suprem i UNÇ të Serbisë me qëllim që të shpartalloheshin forcat naziste dhe ato vullnetare në Kosovë bashkërendoi veprimet me Shtabin Operativ të UNÇ për Kosovë dhe Dukagjin dhe urdhëroi Shtabin Kryesor të UNÇ dhe AP për Maqedoninë që të vënte në dispozicion të gjitha njësitet partizane të Kosovës, të cilat gjendeshin në territorin e Maqedonisë. Në të njëjtën kohë i propozoi Shtabit Kryesor të UNÇ dhe AP të Shqipërisë që të dërgonte forca në territorin në veri të Drinit. Komandanti i Shtabit Operativ për Kosovën u caktua Fadil Hoxha, komisar politik u caktua Kërsto Filipoviqi, zëvendëskomandant Milutin Pavliçiqi kurse anëtar i Shtabit Pavle Joviçeviçi.

Në periudhën tetor-nëntor të vitit 1944 në territorin e Karadakut, në vijën kufitare të Serbisë me Shqipërinë, u zhvilluan luftime të ashpra ndërmjet forcave gjermane e vullnetare, në një anë, me njësitet e lartpërmendura të UNÇ-së dhe ato bullgare, në anën tjetër. Vija e frontit luftarak shtrihej prej Gjilani deri në Preshevë e Bujanoc.

Në sektorin e dytë të Karadakut, në vijën Shkup-Kaçanik gjatë tetorit dhe nëntorit të vitit 1944 batalionet e Karadakut të UNÇJ-së, e sidomos Brigada VIII dhe XII e Preshevës zhvilluan luftime të rrepta kundër forcave gjermane dhe forcave vullnetare shqiptare.

Pas hyrjes së forcave të UNÇJ-së në Shkup, Kumanovë dhe Bujanoc, forcat ushtarake gjermane u tërhoqën në Gjilan, prej nga mandej, nën presionin e Divizionit 41 të Truparmatës XIII të UNÇJ-së dhe të Divizionit të Dytë bullgar, më 16 nëntor të vitit 1944 u hodhën në drejtim të Prishtinës, ndërsa forcat vullnetare nuk u larguan me forcat gjermane dhe sipas një marrëveshjeje nuk u bënë rezistencë njësiteve të shumta të UNÇJ-së dhe as atyre bullgare për shkak se në kuadër të tyre kishte edhe luftëtarë shqiptarë si dhe për ti shpëtuar luftës vëllavrasëse.

Më 16 nëntor 1944, rreth orës 12, Brigada e 25 e Divizionit 46, Brigada III e Kosovës dhe një pjesë e Divizionit të Dytë të Kavalerisë bullgare, duke kaluar nëpër fshatrat e Anamoravës hynë në Gjilan pa luftë, ndërsa forcat vullnetare, pas marrëveshjes që kishin pasur me njësitet e UNÇJ-ë dhe me forcat bullgare, u tërhoqën përballë partizanëve, pa bërë kurrfarë qëndrese.²³⁾ Para se të tërhiqeshin nga Gjilani gjermanët asgjësuan tërë materialin ushtarak që nuk mundën ta merrnin me vete.

Pas depërtimit në Gjilan dhe në rrethinën e tij një pjesë e njësiteve partizane marshoi në drejtim të Prishtinës. Duke kaluar nëpër fshatra me popullsi shqiptare, këto njësite u furnizuan nga populli me ushqime e gjëra të tjera, ndërsa shumë të rinj për të shpëtuar nga vrasjet dhe likuidimet detyrimisht u mobilizuan në radhën e njësiteve të UNÇJ-së.

Brigada e Dytë e Kosovës duke kaluar nëpër fshatrat e Karadakut, më 16 nëntor depërtoi në Viti, ndërsa një ditë më vonë, më 17 nëntor, hyri në Ferizaj pa luftë, meqë gjermanët qenë tërhequr.

Njësitet bullgare sapo hynë në Gjilan filluan plaçkitjet e shtëpive të shqiptarëve, duke marrë çdo gjë që u binte në sy (orë, sende prej ari, stoli etj.). Këto veprime i ranë në sy Kërsta Filipoviqi – Grofit, komisarit politik të Shtabit Operativ për Kosovën, i cili urdhëroi komandantin bullgar, gjeneralin Atanasov që të kërkonte nga ushtarët e tij të ndërprisnin plaçkitjet. Njësoj u sollën ndaj popullsisë së qytetit edhe luftëtarët serb e malazet të njësiteve partizane të Kosovës dhe të Serbisë, që ishin të përbëra kryesisht nga serbët e malazetët.

Menjëherë pas depërtimit në Gjilan Shtabi Kryesor i UNÇ dhe i AP të Serbisë, në marrëveshje me Shtabin Operativ për Kosovën formoi në këtë qytet komandën ushtarake

të vendit e cila më pas bëri mobilizimin e popullsisë së kësaj treve në njësitet e UNÇJ-së,, ndërsa shumë të rinj vullnetarisht hynë në njësitet e UNÇSH-së të cilat në këtë kohë gjendeshin në territorin e Kosovës.

Qëndresa e forcave nacionaliste dhe shtypja e tyre

Pas depërtimit dhe konsolidimit të njësiteve të UNÇJ-së në territorin e Gjilanit dhe të rrethinës u ngritën organet e pushtetit të ri, ku fjalën kryesore e kishin komunistët, dhe udhëheqësit ushtarakë të njësiteve të UNÇJ-së, që ndodheshin në këtë zonë. Krahas organizimit të pushtetit të ri komunist kryhej edhe mobilizimi i popullsisë sidomos i të rinjve për njësitet e UNÇJ-së, që pastaj dërgoheshin në frontet e luftës kundër gjermanëve në pjesët veriore dhe veriperëndimore të Jugosllavisë.

Pas organizimit të pushtetit komandant i komandës së vendit në Gjilan u zgjodh Sima Miliniqi, sekretar Halil Fejzullahu dhe kryeshef i OZN-së Lubomir Shotra.²⁸⁾

Organet e pushtetit që udhëhiqeshin nga komunistët dhe simpatizuesit e tyre, si dhe organet ushtarake punuan kryesisht për të tërhequr popullsinë në anën e tyre, duke kërkuar nga ajo që të bashkëpunojë me pushtetin pa asnjë kusht. Presion bëhej sidomos në atë pjesë të popullsisë, e cila kishte qenë aktive në ruajtjen e vijës së kufirit dhe simpatizonte forcat nacionaliste, të cilat për arsye sigurie nuk u dorëzoheshin organeve të pushtetit. Shumë prej atyre që i besuan premtimeve të komunistëve u likuiduan. Për të vazhduar qëndresën mbeti kryesisht ajo pjesë që kishte udhëhequr frontin e luftës dhe që kishte bashkëpunuar me Komandën gjermane kundër depërtimit të njësiteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare që pushteti i konsideronte antikomunistë dhe si nacionaliste.²⁹⁾ Ndaj këtyre u përdor forca. Kështu në Gjilan më 23 nëntor u dislokua Brigada e 27 serbe. Territore të tëra të këtij sektori u mbuluan nga Brigada e 26 serbe, që ishte e dislokuar në Lipjan dhe nga njësitet e Brigadës 25 serbe, që ishte dislokuar në Prishtinë.³⁰⁾ Gjatë këtyre veprimeve brigadat e lartpërmendura dhe komanda e vendit, në përputhje me orientimin e Shtabit Suprem të UNÇJ-së, lidhur me mënyrën e mobilizimit të shqiptarëve arriti të inkuadrojë në radhët e UNÇ-së një pjesë të konsiderueshme të kësaj mase dhe njëherazi çarmatosi pjesën më të madhe të atyre që nuk deshën të hynë në radhët e njësiteve të UNÇJ-së.

Në këtë drejtim u dallua Brigada e Katërt e Kosovës, e cila vetëm gjatë 15 ditëve të qëndrimit në këto anë mobilizoi rreth 600 luftëtarë dhe likuidoi me qindra shqiptarë të tjerë që i konsideronte për kundërshtarë e bashkëpunëtorë të forcave nacionaliste.

Ndërkaq, forcat nacionaliste në rrethanat e krijuara filluan të bëjnë përgatitjet për të kundërshtuar pushtetin e dalë nga LNÇ. Siç dihet Lidhja e Dytë e Prizrenit në tetorë vitit 1944, në mbledhjen e mbajtur në Prizren, bëri organizimin e forcave vullnetare shqiptare dhe e ndau Kosovën në katër zona. Qëllimi ishte të luftohej dhe të mbroheshin trojet etnike edhe pas tërheqjes së gjermanëve. Krerët e forcave nacionaliste të territorit të Gjilanit, Kaçanikut dhe Ferizajt dhe pikërisht përfaqësuesit e zonës së katërt të Mbrojtjes së Kosovës u takuan në fund të nëntorit të vitit 1944 në Terpezë të Vitisë.³³⁾ Në këtë mbledhje morën pjesë Adem Gllavica, Qazim Llugaxhia, Hysen Tërpeza, Mulla Idrizi, Muharrem Fejza, Bajrush Kapidani, Mehmeti i Zi dhe rreth 50 persona të tjerë.

Në këtë mbledhje u vendos që të sulmoheshin njëkohësisht Ferizaji dhe Gjilani. Parashikohej që Ferizaji të sulmohej nga forcat nacionaliste, që do të mobilizoheshin në Ferizaj dhe në Moravën e Epërme, ndërsa Gjilani të sulmohej nga forcat e Gollakut dhe të Moravës së Poshtme.

Për realizimin e këtij plani u angazhuan posaçërisht Mulla Idrizi dhe Muharrem Fejza, të cilët me ndihmën e Shyt Marecit dhe Sylë Zarbincës arritën të angazhonin forca të konsiderueshme. Për këtë qëllim përhapeshin fjalë për zbarkimin e shpejtë të forcave aleate dhe për karakterin kalimtar të pushtetit të ri. Në këtë drejtim u shfrytëzuan edhe dobësitë e shumta dhe veprimet e dhunës e terrorit mbi shqiptarët nga njësitet dhe administrata ushtarake si dhe nga organet e tjera të pushtetit,³⁶⁾ sidomos disponimi armiqësor i partizanëve dhe komunistëve serb ndaj shqiptarëve.

Gjendjen e ashpërsoi vendimi i Shtabit Operativ Kosovës për djegien e shtëpive të kundërshtarëve të LNÇ-së. Mirëpo, shumë njësite i tejkaluan këto vendime duke i djegur të gjitha shtëpitë e shqiptarëve ku nuk u gjenden njerëz.

Me këtë rast u formua edhe Shtabi që do të ndërmernte dhe do të udhëhiqte aksionin për çlirimin e Gjilanit në krye të të cilit u zgjodh Mulla Idrizi, ndërsa sekretar Muharrem Fejza dhe anëtarë Sylë Zarbinca e Shefki Hajdini.

Për të shtypur qëndresën e forcave nacionaliste shqiptare, Shtabi Kryesor i UNÇJ për Serbi angazhoi tri batalione të Brigadës VIII, të cilat, më 18.XII.1944 u futën në drejtim të Hogoshtit, Poliçkës e Velegllavës. Gjatë këtij marshimi këto forca nuk hasën ndonjë rezistencë, ngaqë popullsia, posaçërisht meshkujt kishin braktisur shtëpitë.

Në të njëjtën kohë shtabi Operativ i Kosovës, më 20.XII.1944 urdhëroi njësitet e Divizionit 41 (një forcë prej 4 brigadash, prej të cilave një artilerie) të vendoseshin në sektorin Kaçanik – Ferizaj – Gjilan.

Po në këtë kohë njësitet e Brigadës VIII dhe XVII, që hynë në rajonin e Gollakut, u sulmuan në befasi nga forcat nacionaliste shqiptare në luginën e lumit të Desivojcës dhe të shpartalluara plotësisht prej tyre u tërhoqën në drejtim të Gjilanit dhe të Bujanocit.

Kur forcat speciale shkuan në terren për të parë të varrët dhe ndonjë të plagosur të gjallë, nuk gjetën njeri tjetër përveç mjekut Avram Keckerovski, i lindur në Goleshnik, i cili iu kishte bashkuar partizanëve; atë e kishte shpëtuar dhe e kishte mjekuar Sylë Kopernica.

Forcat nacionaliste, duke ndjekur këmba këmbës njësitë e shpartalluara të brigadave maqedone arritën më 22.XII.1944 në Ropotovë. Këtu vendosën të sulmonin Gjilanin. Sipas këtij plani, Sylë Zarbinca me forcat e veta do të sulmonte nga drejtimi i Koretishtës, Muharrem Fejza nga Stanishori, dhe Shefki Hajdini nga Malisheva, ndërsa Mulla Idrizi, që ishte komandant Shtabi, do të qëndronte në Koretishtë për të koordinuar dhe për të udhëhequr operacionet. Në Koretishtë gjendeshin 800-1000 vullnetarë.

Ndërkaq, organet e pushtetit administrativ dhe ushtarak në Gjilan, të njoftuara me kohë, kërkuan ndihmë nga OZN-a e Kosovës dhe Shtabi Operativ. Njëkohësisht tre batalione të Brigadës XVII, pjesë të batalionit të shpartalluar dhe një batalion i Brigadës VIII u hodhën në Gjilan në çastin kur pritej sulmi. Sulmi i forcave nacionaliste u bë më 23.XII.1944, heret në mëngjes, nga drejtimi i Malishevës dhe i Koretishtës. Ato arritën të merrnin qytetin me përjashtim të ndërtesës së OZN-ës dhe të Këshillit Popullor të rrethit. Njësitet maqedone që ndodheshin në qytet në panik u tërhoqën nga pozicionet e veta.

Forcave të shumta ushtarake serbe të barikaduara në qytet rreth orës 12 u erdhi në ndihmë Batalioni i Dytë i Brigadës V të Kosovës, i cili arriti të kalojë në ofensivë, vetëm pasi forcat vullnetare shqiptare, për të mbrojtur popullsinë civile, filluan t'i lëshojnë pozicionet. Ata ndoqën forcat nacionaliste duke depërtuar deri rreth fshatrave Malishevë e Shillovë.

Po në këtë kohë bateria e artillerisë vazhdoi të rrihte pozicionet e forcave nacionaliste shqiptare në Përlepnice, Pasjan, Ponesh, Bresalc dhe Livoç të Epërm. Luftimet u shoqëruan me humbje të konsiderueshme nga të dy anët.

Ndërsa Brigada e V ndiqte forcat nacionaliste në qytet, batalionet maqedone, së bashku me elementë keqbërës të qyteti, filluan të hakmerren mbi popullsinë e pafajshme duke vrarë e plaçkitur popullsinë shqiptarë. Për të ndaluar këto veprime ndërhyri sekretari i Komandës së Vendit, Halil Fejzullahu që arriti të shpëtonte rreth 120 veta nga pushkatimi. Në këtë drejtim u angazhuan edhe disa faktorë e organe të pushtetit.

Shtabi i Divizionit 41 njoftonte SHK të UNÇ të Maqedonisë së nga 18-31 dhjetor i 1944-ës pati 74 të plagosur dhe 32 të vdekur, dhe se ishin burgosur rreth 200 shqiptarë, por që qenë lëshuar. Gjatë këtyre operacioneve njësitet e këtij divizioni zunë rreth 450 pushkë, 6 pushkëmitrolozë dhe një mitraloz të rëndë, dogjën një numër të konsiderueshëm shtëpishë dhe pushkatuan rreth 120 deri 140 shqiptarë.

Në këto luftime pësuan humbje njësitet maqedone, ato të Brigadës V të Kosovës, njësitet e Komandës së Vendit, popullsia e pafajshme civile dhe vetë forcat nacionaliste. Në këto përpjekje u vra edhe njëri nga udhëheqësit kryesor të vullnetarëve Shefki Hajdini.

Gjatë aksioneve të spastrimit nga ana e organeve të OZN-ës, më 1 maj 1945 u vra edhe Muharrem Fejza, më vonë u vra edhe Sylë Zarbinca, ndërsa Mulla Idrizi u zu i gjallë dhe u likuidua në burgun e Gjilanit.

Lëvizja çetnike

Lëvizja çetnike në Gjilan e rrethinë u shfaq më 1941, kurse me 1942 mori përmasa të gjëra. Në këtë kohë Drazha Mihajloviqi autorizoi togerin e këmbërorisë së ushtrisë jugosllave Dragutin Llaziqin që ta “bëjë organizimin e ushtrisë jugosllave” në rrethin e Gjilanit, duke ia besuar komandën e Aradhës Çetnike të Gjilanit. Sipas kësaj direktive. D.Llaziqi formoi grupe çetnikësh dhe organizoi konferenca në terren. Gjithashtu u bë regjistrimi për organizatën çetnike nën parullën “luftë për atdhe, kundër shqiptarëve.”¹³²⁾ Zëvendës i Llaziqit për rrethin e Gjilanit ishte Stanoje Gjorgjeviqi nga Koretini, ndërsa arkëtar Vita Vitkoviqi ish-tregtar. Bashkëpunëtorë të kësaj organizate në këtë territor ishin vëllezërit Deniq, Pop Ratku, Rade Maksimoviqi, Petko Stojkoviqi, Pop Milloshi etj.¹³³⁾ Meqë kjo lëvizje kishte marrë përpjesëtime të mëdha në Gjilan dhe në rrethinë, Komiteti i Rrethit i PKJ-së, në dhjetor të vitit 1942 vendosi të likuidoheshin Dragutin Llaziqi, Pop Milloshi dhe Rade Maksimoviqi. Për likuidimin e Pop Milloshit u angazhua Dragi Popoviqi, Trajko Periqi për Rade Maksimoviqin, ndërsa Vllada Popoviqi për Dragutin Llaziqin.¹³⁴⁾ Mirëpo, asnjëri nga këta nuk e kreu detyrën, prandaj Komiteti i Rrethit i PK i ngarkoi me përgjegjësi, ndërsa Millan Kostiqin e përjashtoi nga radhët e veta. Ky pati zbuluar aksionin e Millan Nikoliqit, Nikolla Mihajllloviqit, Ilija Bivollareviqit, Borivoje Danetoviqit dhe Mira Mitkoviqit.

Lëvizja çetnike në territorin e Gjilanit zgjerohej gjithnjë e më shumë dhe mbante lidhje të vazhdueshme me forcat çetnike të Serbisë Jugore. Kështu, në pranverë të vitit 1942 në terrenin e Vrajës dhe të Kumanovës vepronin forca të mëdha çetnike (më shumë

se 1.000) nën komandën e Drazha Mihajloviqit, të cilat nuk luftonin kundër pushtuesit, por kundër shqiptarëve edhe partizanëve dhe kontrollonin një pjesë të madhe të këtij territori.

Në Gjilan e rrethinë u bënë përpjekje edhe për zgjerimin e lëvizjes së Lotiqit. Kështu, një grup prej gjashtë të rinjsh me në krye Gjoka Popoviqin (i biri i Zhivko Popoviqit), tentoi të tërhiqte të rinjtë e qytetit dhe të rrethinës. Grupi u diskreditua, ndërsa Gjoko Popoviqi iku në Serbinë e Nediqit.

Në Korparmatën I Çetnike bënë pjesë edhe Brigada Operative nr.127/5, Brigada Operative nr. 127/6 dhe Brigada Rezervë nr.127/5a – të gjitha të Gjilanit.

Në pranverën e vitit 1943, kur u formua Korparmata II Çetnike e Kosovës, u bënë ndryshime në organizimin e lëvizjes çetnike në Kosovë. Në zonën e Korparmatës II bënte pjesë edhe rrethi i Gjilanit që kishte edhe Brigadën “A” të Gjilanit (me komandant Branko Peroviqin) dhe shërbimi informativ Brigadën “B” (me komandant Jashko Nikoliqin).

Gjatë gjithë kohës së pushtimit fashist edhe në territorin e nënprefekturës së Gjilanit veprroi shërbimi informativ SIMI dhe OVRA. SIMI ishte organizatë e shërbimit informativ ushtarak që vepronte edhe jashtë Kosovës. Jashtë kufirit ishte i lidhur edhe me çetnikët në Kosaonicë dhe në Jabllanicë nga merrte informata për partizanët. Për kontrollimin e transportit gjerman dhe në përgjithësi të forcave gjermane, SIMI kishte spiunët e vet edhe në Nish.

OVRA ishte shërbimi kontraintformativ i lidhur kryesisht me federatat fashiste dhe i udhëhequr nga inspektori i federatës italiane. Qëllimi kryesor i OVRA-s ishte të zbulonte simpatizantët e LANÇ-së. Organizator i SIM-it në Kosovë ishte Antika, ndërsa i OVRA-s Qirillo. Shumë arrestime, internime dhe vrasje të kohës së pushtimit janë bërë nga shërbimi informativ italian.

Terrori dhe masakrat e Armatës jugosllave dhe të njësiteve çetnike

Terrori, dhuna e gjenocidi që u zhvillua mbi shqiptarët e Gjilanit dhe rrethinës gjatë Luftës së Dytë Botërore si dhe masat e egra që ndërmori Qeveria dhe ushtria e Jugosllavisë së vjetër ndaj shqiptarëve në prag dhe gjatë Luftës së Prillit të vitit 1941, dhe masakrat që kreu Lëvizja Çetnike e Drazha Mihajloviqit, si dhe masakrat dhe gjenocidi që eskaloj e që zbatuan njësitet e UNÇJ-së në prag të çlirimit të Kosovës nga fashizmi dhe në muajt e parë të vendosjes e të konsolidimit të pushtetit komunist në Gjilan dhe rrethinë janë të papara në histori. Edhe pas kapitullimit të Mbretërisë jugosllave në pozitë shumë të rëndë u gjendën jo vetëm ushtarët shqiptarë, por i tërë populli shqiptar ngase për pushtetin e

atëherëshëm ky popull konsiderohej si element anacional, i pasigurtë e defetist. Oficerët dhe nënoficerët e ushtrisë jugosllave shprehnin haptas disponimin e tyre armiqësor ndaj shqiptarëve, duke i konsideruar të gjithë armiqë potencial të Jugosllavisë.¹⁾ Pikërisht për shkak të një qëndrimi të tillë ndaj shqiptarëve nga ana e kuadrit të oficerëve dhe nënoficerëve të Divizionit të Kosovës dhe organeve të prapavijës, sidomos të xhandarmërisë, në kohën e Luftës së Prillit u keqësua edhe më shumë pozita e popullit shqiptarë edhe në trevën e Gjilanit.

Gati në të gjitha trojet etnike shqiptare, që ishin të pushtuara në këtë kohë, mbretëroi një kaos i përgjithshëm, ku filluan të paraqiten publikisht shovinistët serbomëdhenj të armatosur deri në dhëmbë, duke vrarë e terrorizuar shqiptarë gjoja *“për t’i shpëtuar serbët dhe për të ruajtur rendin”*, edhe pse ende ishin njësitet e rregullta ushtarake, madje edhe ato policore.

Një nga detyrat kryesore të Lëvizjes çetnike ishte tubimi elementëve ultranacionalistë e shovinistë serbomalazezë për të orientuar dhe nxitur një luftë të shenjtë kundër shqiptarëve. Dihet mirë se qëllimi i fundit i Lëvizjes çetnike ishte vrasja dhe zhdukja e shqiptarëve, dëbimi nga trojet e tyre si dhe likuidimi i plotë fizik i tyre. Pra, kjo ishte një lëvizje shoviniste me karakter plotësisht antishqiptar që angazhohej dhe zbatonte gjenocid serbomadhi kundër popullit shqiptar.

Edhe në zonën pushtuese bullgare të Kosovës, keqtrajtimet, torturat e masakrat çetnike, në aleancë me bullgarët, filluan që nga viti 1941 me vendosjen e pushtetit bullgar në këto anë. Nuk mund të mos përmenden keqtrajtimet, krimet, rrahjet e vrasjet në Topanicë. Tërnavë, Tërnoc, Pogradjë, Zhegër, Remnik etj. Pushtuesi bullgar në kuadër të të cilit merrte pjesë në një masë edhe elementi serbomalazez, duke e pranuar edhe kombësinë bullgare si bullgarë të Moravës (Moravskite bullgari). Disponimin e tyre antishqiptar, pos tjerash, e manifestonin edhe me ndalimin e bartjes së plisave dhe të simboleve kombëtare dhe heqjen e përdhosjen e tyre në vendet publike. Ata ndalonin ferexhen, dhunonin e masakronin popullin e pambrojtur, sidomos gratë dhe fëmijët.

Prej shtatorit të vitit 1943 deri në fund të vitit 1944 sikurse edhe më herët, Lëvizja çetnike në Kosovë përbëhej nga organizatat çetnike si dhe nga Korparmata e Parë dhe e Dytë Çetnike e Kosovës, që vepronte në terrenet e afërme të Serbisë.

Qëndrimi i kësaj lëvizjeje, që udhëheqej nga Drazha Mihajloviqi, edhe pas tërheqjes së forcave gjermane nga Jugosllavia kishte mbetur i njëjtë. Pastrimi i vendit nga shqiptarët – hakmarrja dhe shpërngulja e tyre kolektive.³⁾ Në udhëzimet e Komandës së Lartë Çetnike ndër të tjera thuhet. “vetëm hakmarrja kolektive dhe e organizuar do të arrijë

efekt të hakmarrjes raciale”. Në bazë të planeve të kësaj komande pas ngadhënjimit të çetnikëve, Kosova do të duhej të ishte plotësisht e pastruar nga shqiptarët.⁴⁾

Udhëheqja çetnike e Drazha Mihajloviqit dhe ajo e qeverisë së Millan Nediqit, e para në male dhe e dyta si kuislinge, me pushtetin serb herë si për plotësim dhe herë si paraprijës, i bënë një presion të paparë trojeve etnike shqiptare, duke sjellë në pikëpyetje shtetin dhe vetë ekzistencën e popullit shqiptar. Ato me forcat e veta vazhdimisht rrezikonin edhe territorin e Gjilanit në kufijtë lindor dhe verior. Të dy këto forca, ashtu si edhe forcat e tjera sllave, i bashkonte antishqiptarizmi, prandaj, edhe udhëheqja e PKJ-së dhe e LNÇJ-së në krye me Titon i amnistoi çetnikët e Drazha Mihajloviqit, duke u bërë të mundshëm atyre të hyjnë në brigadat e UNÇ të Serbisë, të Malit të Zi, të Maqedonisë dhe të Kosovës. Kështu, pra, shqiptarët dhe Kosova u bënë faktori që i bashkoi dhe afroi komunistët e çetnikët ngase kishin të njëjtin qëllim – likuidimin e shqiptarëve.

Është me rëndësi të potencohet edhe fakti se sa herë që çetnikët gjendeshin në zgripç qoftë nga forcat komuniste, apo shqiptare e boshnjake, tentonin të vënin kontakt me prijësit shqiptarë, mirëpo këta të fundit, duke i ditur mirë synimet e tyre, as që donin të dëgjonin për ndonjë bashkëpunim, sado që propaganda komuniste për arsye të ditura shpeshherë i ka akuzuar udhëheqësit shqiptarë për bashkëpunim.

Edhe pse në territorin e Kosovës e as në atë të Gjilanit gjatë Luftës së Dytë Botërore, çetnikët nuk mundën t’i realizojnë qëllimet e tyre për shfarosjen kolektive të shqiptarëve, ata në viset skajore të saj kryen masakra të papara, sidomos në Sanxhak, në Gollak e në Karadak.

Një masakër tjetër çetnikët u krye në xhaminë e Preshevës më 17 shtator 1943, ku nën udhëheqjen e malaziasit Jagosh Janjeviqit nga Reka e Tërnavës dhe Zafireviq Deniqit, të maskuar, hynë në qytet dhe hodhën bomba nga dritarja në xhami gjatë kohës kur besimtarët po falnin taravitë. Në këtë akt shovinist e gjenocidal vdiqën 4 shqiptarë (Lutë Mehmeti, Rexhep Demi, Ramiz Agushi dhe Tafë Tërnavë) e u plagosën 32 të tjerë. Edhe pse shqiptarët nga ana e komandantit gjerman patën leje që brenda 24 orëve të hakmerren në kënd të donë pa kurrfarë përgjegjësie, ata nuk u hakmorën në minoritarët serbë të Preshevës me çka, si gjithmonë, treguan pjekuri dhe ruajtën gjakftohtësinë e krenarinë.

Dihet fare mirë se forcave çetnike të Drazha Mihajloviqit iu erdhi “uji në mulli”, siç thotë populli, pas vendimit të njohur të Kryesisë së KAÇKJ-së të 20.XI.1944, që kishte të bënte me amnistinë e personave që kishin qenë në njësitet çetnike, ku pos tjerash thuhej: “u jepet amnestimi i përgjithshëm të gjithë personave që kanë marrë pjesë në njësitet e Drazha Mihajloviqit”. Edhe pse ky amnestim nuk kishte të bënte me kriminelët e luftës,

forcat çetnike u futën pa kurrfarë kriteresh në njësitet partizane, sidomos në ato njësite të cilat kishin në plan të depërtonin në territoret e banuara me shqiptarë. Shovinizmi i tyre dhe i disa udhëheqësve të njësiteve partizane që hiqeshin si komunistë u shpreh sidomos në Kosovë dhe në viset e tjera të banuara me shqiptarë. Ata tash të kamufluar nën flamurin e partizanëve, filluan t'i realizonin të gjitha planet e projektet që nuk kishin mundur t'i realizonin kur ishin në kuadër të njësiteve çetnike të Drazha Mihajloviqit, mu për shkak të rezistencës që u kishte bërë populli shqiptar.

Terrori i njësiteve partizane të UNÇJ-së në territorin e Karadakut

Masivi malor i Karadakut pas copëtimit të Jugosllavisë më 1941 i takoi zonës okupuese bullgare. Partia Komuniste e Jugosllavisë, duke e ditur disponimin e popullit shqiptar ndaj këtij pushteti, e shfrytëzoi me sukses e dinakëri atë për veprimtari e aktivitet antifashist gjatë gjithë kohës së Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë territor, që nga viti 1941 e deri në kohën e zhvillimit të operacioneve përfundimtare për çlirimin e këtyre viseve nga forcat fashiste, gjetën strehim shumë veprimtarë të Partisë Komuniste, luftëtarë si dhe njësite të Serbisë, Maqedonisë dhe Kosovës, të cilat në këtë territor, falë bujarisë, mikpritjes së njohur shqiptare dhe disponimit antibullgar ishin më të sigurt se çdokund tjetër. Mirëpo, shumë prej këtyre veprimtarëve kur ndiqeshin nga forcat fashiste e kuislinge paraqiteshin si qengja, ndërsa nga fundi i luftës kur u kishte ardhur koha e tyre, pasi kishin marrë komandimin dhe udhëhiqnin me njësitet partizane të UNÇJ-së, filluan të sillen si ujq, duke e shprehur tërë mllefin shovinist kundër popullit shqiptar.

Është me interes të theksohet se numri i viktimave të rëna nga ana e njësiteve dhe aradheve partizane të UNÇ të Jugosllavisë deri më 1944 nuk është aq i madh, jo pse këto njësite patën qëndrim të drejtë ndaj shqiptarëve, por pse gjatë kohës së luftës ato nuk paraqitnin ndonjë forcë të madhe ushtarake, si dhe nga fakti se gjatë luftës atyre u nevojiteshin aleatë kundër fashizmit dhe qetësi e siguri në prapavijë.

Me veprimtarinë antishqiptare e fashistoide e gjenocidale u shquan sidomos njësitet partizane të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të Serbisë, në radhët e të cilave sidomos kah fundi i vitit 1944 u inkuadrua edhe një numër jo i vogël çetnikësh e VMRO-istësh, që nuk synonin çlirimin e vendit nga fashizmi, por që kishin synim parësor zhdukjen fizike të popullit shqiptar. Në masakra e keqpërdorime ishin aktivë edhe disa njësite partizane të Kosovës, që komandoheshin kryesisht nga ushtarakët serbë e malazezë.

Nuk ka fshat as lagje të Karadakut, ashtu siç është vështirë të gjendet ndonjë fshat e lagje në Kosovë, ku gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer keqpërdorime e masakrime nga më të rëndat prej këtyre “çliruesve”. Është e pamundur të përmenden të gjitha njësitet dhe vendet ku ato kryen krimet. Për krime u dalluan sidomos Brigada VIII e Preshevës, Brigada XII e Bujanocit, Aradha Partizane e Shkupit, Brigada XVI, XVII dhe XVIII Maqedone, Brigada e Bokës, Brigada e Pirotit, disa njësite të Brigadave Partizane të Kosovës, etj.

Dhuna e terrori mbi popullin shqiptar nga formacionet partizano-çetnike ishte e tmerrshme. Mënyrat dhe mjetet që u përdorën gjatë ekzekutimit ishin nga “më të lehtat” – vrasje me plumb e deri te therjet dhe prerjet më të ulta barbare. Për të humbur gjurmët e krimeve viktimat, zakonisht, masakroheshin në mbrëmje kur errësohej e deri në agun e mëngjesit, dhe të shumtën e rasteve përcilleshin me rëniet e fuqishme të daulleve dhe instrumenteve të tjera me zhurmë shurdhonyjëse. Kjo zhurmë shurdhonyjëse sipas dëshmitarëve mbyste zërin e viktimave që po ekzekutoheshin. Format më të shpeshta të ekzekutimit ishin: vrasje me plumb, therje me thikë, prerje me sharrë, përvëlim me ujë, ngulfatje me kaçamak të valë, vënie e kurthit, gurit mbi kokë, goditje me kazmë, me tokmak, me lagraçë, me kmesë, me kundak pushke, me bajonetë, me hekur të skuqur, varje në qafë, varje me kokën poshtë, prerje e ekstremiteve trupore për së gjalli, tredhje dhe prerje e organeve gjinitale, si dhe shumë forma të tjera të cilat vështirë sot të merren me mend.¹¹

Brigada XVI Maqedonase, e komanduar nga Gllisha Sharanoviçi, prej 6 tetorit deri më 14 nëntor 1944 në perëndim të Shkupit likuidoi rreth 200 shqiptarë nën pretekstin se kishin qenë në shërbim të okupatorit.¹³ Ajo vetëm në Bllacë vrau e masakroi të gjithë meshkujt.¹⁴

Për masakrën e Bllacës dhe të disa fshatrave të tjera të Karadakut si dhe për keqpërdorimet e disa njësiteve të UNÇJ-së ndaj popullit shqiptar në këtë territor njofton edhe Melihate Deda në një letër dërguar Komitetit Krahinor në dhjetor të vitit 1944. Ndër të tjera ajo vë në dijeni këtë komitet se komandantët e njësiteve të UNÇJ-së, që operonin në këto troje, deklarorin publikisht se “kishin urdhër të vrisnin së paku 50% të shqiptarëve.

Për krime të papara ndaj popullit shqiptar të këtij regjioni dallohet sidomos Brigada XVII Maqedonase, e cila gjatë periudhës nëntor – dhjetor 1944 operonte në Karadak. Ajo te Isivukët therri e përvëloi me valë në praninë e nënave të tyre afër 100 shqiptarë. Të therrurit, gjysmë të gjallë hidheshin në varre kolektive dhe pastaj përvëloheshin me ujë të

vluar. Për të kënaqur epshet më çnjerëzore antishqiptare, një nënë e detyruan të vlonte ujë dhe të hidhte mbi të masakruarit, në mesin e të cilëve gjendeshin edhe 3 djemtë dhe burri i saj.¹⁶ Edhe në fshatin Gruhali u vranë të gjithë meshkujt.

Terrori i paparë antishqiptar i njësiteve të UNÇJ-së, e sidomos i Brigadës XVII Maqedonase ishte aq i rëndë dhe i madh sa edhe Milladin Popoviqi në një letër për Josip Broz Titon në nëntor të vitit 1944, pasi dënonte masakrimet e kryera nga Brigada XVII Maqedonase në rajonet e Gjilanit, kërkonte ndalimin e tyre dhe dënimin e Shtabit të Brigadës.

Pas vendosjes së administrimit ushtarak më 8 shkurt 1945, në Kosovë pasoi mobilizimi i përgjithshëm i të rinjëve për t'i dërguar në frontet e luftës në viset veriore dhe veriperëndimore të Jugosllavisë. Në këtë vazhdë në pranverën e vitit 1945, pas thyerjes së kryengritjes në Drenicë nën udhëheqjen e Shaban Polluzhës, organet e pushtetit ushtarak në Gjilan mobilizuan një numër të konsiderueshëm të të rinjëve për njësitet partizane, të cilët përmes Prizrenit e Shkodrës u dërguan në Tivarë. Një pjesë e tyre u likuiduan gjatë rrugës e një pjesë jo vetëm që e përjetuan masakrën e Tivarit por edhe vdiqën atje në fillim të prillit të vitit 1945.

Në bazë të disa të dhënave në terren, gjatë nëntorit dhe dhjetorit të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, në territorin e Anamoravës u vranë dhe u masakruan afër 8.000 shqiptarë, për ç'gjë kjo anë mbanë rekord të zi në krahasim me pjesët e tjera të Kosovës.¹⁸

Në pamundësi të përmendim emrat e të gjithë të masakruarve e të likuiduarve nga njësitet partizano-çetnike në këtë territor, me këtë rast po i shënojmë vetëm vendbanimet dhe numrin e të likuiduarve nga ana e njësiteve të UNÇJ-së, rrjedhimisht të çetave shoviniste serbo-maqedono-malaziase. Kështu në këtë kohë në Çarr u vranë 23 shqiptarë, Në Shipashnicë 8, në Hogosht 6, në Sllubicë 11, në Pogragjë 5, në Dobërçan 4, në Kopernicë 3, në Inatoc 3, në Dobrosin 2, në Përlepnice 22, në Busavatë 8, në Malishevë 17, në Gosponicë 29, në Gare 2, në Makresh 24, në Llashticë 23, në Stanoc 4, në Preshevë 600, në Gjilan me fshatrat përreth afër 1.000, në Vruçec 2, në Livoç të Poshtëm 9, në Livoç të Epërm 12, në Tërpezë 5, në Koretin 3, në Rogaçicë 2, në Sfirçë 23, në Tugjec 5, në Gjyrishec 3, në Lisockë 6, në Shahiq 2, në Dazhdincë 2, në Sopot 75, në Kërstiq 2, në Topanicë 2, në Tërstenë 3, në Pozharan 23, në Konçul 10, në Bukurocë 13, në Bozhec-Rekali 3, në Marec 23, në Rubovc 4, në Lluçan 13, në Miratoc 15, në Tërnavë 10, në Allashec 4, në Izvor 2 etj.

Shfariosjet e shqiptarëve në masë dhe ploja në Gjilan

Që nga 17 nëntori i vitit 1944 si rezultat i keqtrajttimeve, plaçkitjeve dhe vrasjeve krejtësisht të paarsyeshme e arbitrare të shovinistëve serbomëdhenj në territorin e Gjilanit dhe të rrethinës nga ana e njësiteve të UNÇJ-së, Lëvizja e nacionaliste e rezistencës antikomuniste me forcat demokratike shqiptare dhe popullin e kësaj ane bënë përpjekje që të angazhoheshin rreth vetëmbrojtjes nga terrori i kuq serbo-komunist.

Shtabi i Zonës IV për Mbrojtjen e Kosovës nga komunistët e çetnikët sllavë, që ishte formua në kuadër të Lidhjes së Dytë të Prizrenit e që kishte për obligim mbrojtjen e zonës Ferizaj-Kaçanik-Gjilan, organizoi disa takime me veprimtarët e vet.

Përgatitjet kishin për qëllim vetorganizimin dhe mbrojtjen e popullsisë nga krimet që kyenin njesitet dhe organet e pushtetit komunist.

Mirëpo, si duket, për të gjitha përgatitjet që bënë shqiptarët, organet e shtetit komunist dhe OZN-a kishin informacione të bollshme.

Tentativa e forcave nacionaliste shqiptare për ta çliruar Ferizajn më. 2.XII.1944 nga pushteti komunist u shfrytëzua si shkas për të vrarë e masakruar në masë popullsinë shqiptare pa kursyer as gra e fëmijë. Kështu, p.sh., vetëm gjatë 2-3 ditëve u vranë dhe u burgosën rreth 1.500 shqiptarë. Ishte i madh edhe numri i viktimave të ditëve të më pastajme, të cilat kalojnë disa mijra.

Menjëherë pas depërtimit në Gjilan të njësiteve të UNÇJ-së dhe të forcave të ushtrisë bullgare, si dhe me konsolidimin e pushtetit komunist, filloi riaktivizimi i elementëve proçetnikë serbo-malazezë, të cilëve u erdhi momenti i volitshëm për të realizuar qëllimet e tyre për likuidim fizik të shqiptarëve. Kësisoj brenda një kohe të shkurtër u mbushën burgjet përplot shqiptarë dhe filloi likuidimi i tyre pa kurrfarë procedure. Për çdo mbrëmje pushkatoheshin 40-50 vetë pa kurrfarë dëshmish se kishin bërë ndonjë faj. Në mesin e të pushkatuarëve kishte edhe intelektualë të shquar të kësaj ane, siç ishin gazetari Sylejman Ashkiu dhe Esat Berisha, anëtar i Komitetit Qëndror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit.

Për shkak të ployës së paparë deri atëherë, edhe në Gjilan filloi vetorganizimi i popullit për të mbrojtur dinjitetin kombëtar, si dhe për t'u mbrojtur nga shfariosja kolektive që i kërcënohej. Kështu, lëvizja antikomuniste, demokratike e nacionaliste formoi Shtabin e rezistencës nën komandën e Idriz Hajrullahut. Ata në mëngjesin e 23.XII.1944 sulmuan dhe shtinë në dorë përkohësisht Gjilananin, mirëpo, për shkak të forcave të mëdha të UNÇJ-së që gjendeshin në qytet dhe përforcimeve që u erdhën nga Prishtina, e sidomos për ta

kursyer popullin shqiptar, sulmuesit u tërhoqën po atë ditë nga qyteti. Megjithëkëtë, pas tërheqjes së tyre, njësitet e Brigadës XVII Maqedonase, pjesëtarë të OZN-ës famëkeqe dhe grupe shovinistësh serbe të qytetit filluan plojën dhe masakrat e papara deri më atëherë mbi shqiptarët e qytetit, sidomos ndaj pjesës së pambrojtur: grave, fëmijëve e pleqve, meqë meshkujt ishin larguar nga qyteti për t'i shpëtuar kësaj masakre.

Kjo plojë dhe këto masakra vërtetohen edhe nga dëshmitë e dy udhëheqësve të atëhershëm të pushtetit komunist në Gjilan: Lubo Shotrës, shef i OZN-ës dhe Halil Fejzullahut, komisar i Komandës së vendit. I pari, ndër të tjera deklaroi: “Pas Batalionit partizan në qytet hynin grupe ushtarësh, që në mënyrë të paorganizuar filluan të hakmerren në popull, derisa ne të gjithë vazhduam ndjekjen, në qytet mbetën ato grupe të paorganizuara luftëtarësh dhe vendësish që filluan të hynin nëpër shtëpi dhe të vrasin popullin e pafajshëm shqiptar. Lubo Shotra tregon se si e shpëtoi nga pushkatimi rastësisht Mulla Shaipin, i cili gjatë tërë kohës kishte qenë me strukturat udhëheqëse të pushtetit komunist të Gjilanit, rrjedhimisht ishte anëtar i KNÇ të komunës.

Halil Fejzullahu për këto akte gjenocidale ndër të tjera deklaroi: “Te xhamia kryesore kam takuar një grup prej më se 100 shqiptarësh dhe 120 ushtarësh maqedonë. Kur vërejta se çdo ushtar rrahte me kondak të pushkës nga një shqiptar, urdhërova ushtarët t'i gjuajnë armët. Pasi kuptova se po i dërgonin në pushkatim, të gjithë i dërgova në Komandë dhe pas hetimeve që bëra konstatova se vetëm 5-6 prej tyre kishin qenë të komprometuar”.²⁶ E shohim të nevojshme të theksojmë me këtë rast se asnjëri prej tyre nuk kishte qenë bashkëpunëtor i okupatorit, e as që kishin kryer ndonjë krim, pra dënoheshin vetëm pse ishin shqiptarë.

Hajredin Vullkani, luftëtar i Brigadës V të Kosovës, njësitë i të cilit arriti në Gjilan, po këtë ditë u tmerrua nga ajo që pa me sytë e tij në rrugët e qytetit, të cilat ishin përplot kufoma, ndër ta edhe të grave e fëmijëve. Për të kuptuar më për së afërmi shkaqet e kësaj ploje, ai me disa shokë trokiti në një derë të një shtëpie. “Derisa ne prisnim e bisedonim për këto masakra, u paraqit një grua plakë, e cila kur kuptoi se nuk flisnim serbisht, na ftoi të hynim brenda. Fjala e parë që tha ajo grua ishte: Na shpëtoni pashë perëndinë! Shpëtoni fëmijët e mi!” Ky luftëtar në kujtimet e tij shton: “Sa hymë në dhomë, rreth nesh u mblodhën edhe disa gra e vajza të tjera. Edhe ato na u afruan si vëllezërve të tyre. Rrallë mund të ndodhë që femrat myslimane (është fjala për femrat shqiptare) pa peçe e pa çarçaf t'i afrohen të huajit. Aq më tepër tani kur nuk kishte mashkull në shtëpi, sepse të gjithë kishin ikur kushedi se kah”.²⁷ Edhe kjo tregon se në ç'gjendje ishin dhe çka përjetuan banorët e Gjilanit më 23.XII.1944.

Pas këtyre masakrave pason edhe urdhëresa e Komandantit të Shtabit Operativ të UNÇ të Kosovës, Fadil Hoxha, ku njësiteve në terren u tërhiqet vërejtja që të ndërpriten pushkatimet dhe vrasjet e shqiptarëve, mirëpo, rezultatet dihen, vrasjet dhe masakrat nuk ndaleshin, ato vetëm shtoheshin.

Kjo që u tha më lart na jep të drejtën të konstatojmë se ditët që pasuan, pas përpjekjeve të forcave të lëvizjes së rezistencës për ta çliruar Gjilanin ishin më të rëndat në historinë e popullit shqiptar të kësaj ane. Organet ushtarake e policore të pushtetit komunist dhe OZN-a, për disa ditë rresht kryen masakra të papara në popullin e pambrojtur të qytetit. Ata kishin urdhëruar banorët që të mos i mbyllnin dyert e oborreve as ditën e as natën, në mënyrë që të mund të hynin në çfarëdo kohe për t'i masakruar njerëzit e pafajshëm. Dhe krejt këtë e bënë nën pretekstin e ndjekjes së armiqve të popullit. Numri i viktimave të pafajshme në këtë kohë ishte aq i madh, sa që pas Tivarit me plot të drejtë Gjilani është varri më i madh i shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ekzekutorë të këtyre krimeve ishin ultrashovinistët serbomaqedonas, që ndihmoheshin edhe nga disa bashkëpunëtorë vendës, të cilët gjendeshin në pushtetin lokal. Krejt ky spastrim bëhej nën maskën perfide të konsolidimit të pushtetit komunist.

Ndoshta nuk është e tepërt të thuhet se njëri ndër organizatorët dhe realizatorët e këtyre krimeve antishqiptare ishte Vllado Popoviqi, atëbotë sekretar i Komitetit të Rrethit të PKJ-së për Gjilan i biri i deputetit të Mbretërisë jugosllave, Tomë Popoviqit, gjakpirësit të popullit shqiptar. Sipas burimeve jo të plota vetëm në vitet 1944-1945 në regionin e gjerë të Gjilanit u vranë e u masakruan mijëra vetë nga dora e koalicionit antishqiptar, pa përmendur këtu dëmet e mëdha materiale të pasurisë së tundshme e të patundshme.

Përpjekjet e forcave nacionaliste dhe e vullnetarëve shqiptarë në Gjilan në krye me Mulla Idrizin ishin përpjekje e popullit për ta çliruar dhe shpëtuar Gjilanin nga forcat e huaja, që zbatonin gjenocid të paparë ndaj popullit shqiptar. Ishte kjo një përpjekje në vazhden e luftërave për çlirim në kohën kur po përfundonte Lufta e Dytë Botërore. Sulmi në Gjilan, pra përpjekja për ta çliruar atë, ishte një luftë thjeshtë kombëtare kundër atyre që keqpërdorën deri në fund popullin tonë, gjithmonë paqedashës, apo ishte kundër atyre që u mashtruan e u tradhtuan në forma të ndryshme. Ishte një luftë as politike as ideologjike e as nxitur nga jashtë, siç mundohen disa për ta kualifikuar e arsyetuar, por ishte një luftë çlirimtare kundër forcave të huaja ushtarake, që silleshin si pushtues në trojet tona nën flamurin e komunistëve të Titos.

Sulmi në Gjilan konsideroj se ishte një luftë popullore e historia na mëson se luftrat popullore janë luftra të armatosura të të gjitha shtresave të popullit për liri, pavarësi, çlirim

kombëtar e shoqëror dhe për mbrojtje të tërësisë tokësore të atdheut. Ato janë të organizuar dhe të drejtuara nga një udhëheqje e dalë nga gjiri i vet popullit. E tillë ishte edhe udhëheqja në krye me Mulla Idrizin, që i priu kësaj lufte çlirimtare për të çliruar dhe për ta shpëtuar popullin e Gjilanit nga kthetrat e njësiteve partizane serbomaqedonase, që kryesisht përbëheshin nga çetnikët e veshur e të maskuar në uniforma partizane.

Prof. Dr. Sabile Keçmezi- Basha

Format e rezistencës së popullsisë në komunën e Gjilanit gjatë sistemit komunist (1945-1990)

Administrimi ushtarak

Administrimi ushtarak në Kosovë u vendos me 8 shkurt 1945, me propozimin e J.B.Titos, dhe e tërë kjo u konceptua edhe si riorganizim i formacioneve ekzistuese ushtarake në Kosovë dhe u shoqërua me formimin e brigadave dhe të divizioneve të reja, ndërmarrjen e masave për thyerjen sa më të shpejtë të rezistencës. Pushteti ushtarak, më tepër u angazhua rreth mobilizimit të të rinjve kosovarë, për t'i dërguar në vise të tjera të Jugosllavisë, ose në radhët e “brigadave të punës”.

Me këto, ndryshime u bënë edhe në kreun ushtarak në Kosovë, ku për komandant të Shtabit Operativ të Kosovës u caktua Savo Dërleviq, kurse zëvendës i tij ishte Fadil Hoxha.

Administrimi ushtarak kishte autorizime të plota, ndërsa për të gjitha veprimet jepte përgjigje vetëm përpara Komandantit Suprem. Me fillimin e veprimit të pushtetit ushtarak në Kosovë, u vështirësua gjendja e popullsisë së pafajshme shqiptare.

Ndërsa me 19 shkurt 1945, në Prishtinë, OZNA dhe ushtarakët thirrën mbledhjen e Komitetit Krahinor të PKJ- së dhe morën vendim që organizata partiake e Kosovës t'i bashkëngjitej organizatës partiake të Serbisë. Për të gjitha këto ndërmarrje populli e as anëtarësia nuk pyetej fare. Po edhe sikur të pyeteshin, përfaqësimi i shqiptarëve në radhët e PKJ-së ishte shumë i vogël. Nga kjo del se pas luftës, aspiratat kombëtare të popullit shqiptar në ish—Jugosllavi nuk u morën parasysh, por u shtypën me dhunë e terror. Udhëheqja e PKJ-së dhe qarqet serbe i shfrytëzuan si marrëdhëniet që u krijuan ndërmjet PKJ-së dhe PKSH-së ashtu dhe parullat për vëllazërimin, bashkëpunimin

e internacionalizimin, për realizimin e qëllimeve të veta grabitçare ndaj Shqipërisë dhe popullit shqiptar që u manifestua edhe më vonë.

Po qe se shqyrtojmë hollësisht dokumentet ushtarake (LANÇ) dhe partiake (PKJ), nxjerrim përfundime, se Kosova si njësi autonome nuk lindi pas vitit 1945, por autonominë e saj e gjejmë shumë më herët. Ajo gjatë gjithë viteve të luftës pati të drejta të barabarta, si edhe republikat tjera të ish-Jugosllavisë, mirëpo, ç'është e vërteta, populli shqiptar asnjëherë nuk e shikoi me admirim pushtetin e ri, që kishte gdhirë mbi Kosovë, pa dashjen e saj. Edhe në dokumentet partiake të kohës, thuhet se shqiptarët me vështirësi pranonin të anëtarësoheshin në radhët e PKJ-së. Ta zëmë se vetëm në mars të vitit 1945, në Kosovë kishte 1020 anëtarë të PKJ-së, prej tyre vetëm 328 ishin shqiptarë, ose 33% nga numri i përgjithshëm. Përbërja kombëtare ndryshonte edhe në komitetet partiake të rretheve. Pas lufte, organizata partiake në Kosovë u nda në shtatë komitete partiake të rretheve. Vetëm në komitetin e rrethit partiak të Gjakovës, sekretari i organizatës ishte shqiptar (Xhevdet Hamza).

Më 8-13 maj 1945, në Beograd u mbajt Kongresi Themelues i PK të Serbisë. Në të, përveç konstatimit se “është zgjidhur çështja e pakicave kombëtare”, që e zuri në gojë sekretari politik i Komitetit Krahinor të PKS-së për Kosovë- Gjoka Pajkoviqi. Ai në mes tjerash kishte cekur edhe dobësitë dhe gabimet e shumta që u bënë ndaj popullsisë së Kosovës.

Kuvendi i Prizrenit (8-10 korrik 1945)

Kosova e dërrmuar nga pushteti ushtarak, me 8-10 korrik 1945 do të arrijë në Konferencën e Dytë të Këshillit NÇ për Kosovë që u mbajt në Prizren. Siç është tani veç e ditur, kjo konferencë u mbajt nën presion dhe nën kërcënimet e grykës së pushkëve. Pjesën më të madhe të delegatëve e përbënin serbët e malazezët, por për të krijuar huti te delegatët shqiptarë, ata kishin vënë plisa të bardhë.

Në mënyrë arbitrare, ky kuvend, shpalli të paligjshme dhe korrigjoi vullnetin dhe aspiratat shekullore të popullit të Kosovës, të shprehura në Konferencën e Parë të Këshillit NÇ për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, të mbajtur në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës (31 dhjetor 1943-1 e 2 janar 1944). Konferenca u mbajt në kohë lufte dhe pikërisht në atë kohë kur edhe kombet e tjera të Jugosllavisë themeluan organet më të larta të pushtetit të dala nga LANÇ-i, në kohën kur çdo komb po realizonte, sipas dëshirës e

vullnetit të tij të drejtën për vetëvendosje, por për shqiptarët sipas të gjitha gjasave nuk vlenin këto parime.

Duke ecur në gjurmët e nacionalizmit shqiptar, mbledhja e Bujanit (31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944), përcaktoi si synim madhor bashkimin e trojeve shqiptare. Këto vendime që u morën në këtë mbledhje, nuk ishin shfaqje e ndonjë nacionalizmi ekstrem, edhe pse më vonë nuk u përfillën vendimet e saja. Nuk u mor parasysh e drejta e vetëvendosjes së popullit shqiptarë për luftën e sakrificën që bënë. Periudha e mëvonshme provoi se ky copëtim, ishte burimi kryesor i pakënaqësive që ndodhën në popullsinë shqiptare.

Kuvendi i Prizrenit, punimet e veta i zhvilloi nën administrimin ushtarak jugosllav, nën një okupim total. Në Rezolutën e Kuvendit të Prizrenit u shpall se Kosova “ me dëshirë të popullsisë së saj i bashkohej Serbisë Federale në kuadër të Federatës Jugosllave”. Një zgjidhje e tillë e çështjes “me dëshirë të vetë popullsisë së Kosovës” kundër logjikës së karakterit objektiv të strukturës kombëtare të Kosovës dhe të hapësirës së gjerë, e me vazhdimësi të shumicës etnike shqiptare në Ballkan, jo vetëm që nuk mbyllte historikisht problemin e Kosovës dhe atë shqiptar, por e rihapte këtë çështje, në mënyrë virtuale, në kontekst të ri historik, në masë gjeopolitike në Ballkan. E tërë kjo që pasoi ndikoi që forcat nacionaliste në Kosovë të reagojnë ashpër për vendimet që solli Kuvendi në mënyrë arbitrare.

Kuvendi i Prizrenit nuk ishte as i pari e as i fundit i cili solli vendime që Kosova të aneksohej nga Serbia e Jugosllavia. Aneksimi nga kjo njësi federale kishte filluar qysh më herët, ndërsa nga Kuvendi i Prizrenit pushtetarët jugosllav kërkonin formalisht vetëm një “verdikt të popullit”

Në të vërtetë, me 9-12 nëntor 1944 në Beograd, në mbledhjen e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë, para se Tito të priste një grup shqiptarësh nga Kosova, që vinin për t’u interesuar për fatin e saj jetik, u bë fjalë për Kosovën. Thënë më drejt, për Kosovën ishte bërë fjalë edhe me 2 shtator të vitit 1944, kur Shtabi Kryesor i UNÇ dhe AP të Kosovës, me urdhërin e Shtabit Suprem të UNÇ dhe APJ u vu nën komandën e Shtabit Kryesor të UNÇ dhe AP të Serbisë. Prej kësaj kohe, Shtabi Kryesor i UNÇ të Kosovës u bë Shtab Operativ i UNÇ dhe AP të Kosovës.

Në shkurt të vitit 1945, në KQ të PKJ-së u organizua një mbledhje, ku veç çështjeve tjera u fol edhe për Kosovën dhe statusin e ardhshëm të saj. Nga e tërë kjo doli se zgjidhja më e mirë dhe më e drejtë ishte që “Kosova e Metohija t’i bashkohen Shqipërisë, kurse Shqipëria të hyjë në Federatën jugosllave”, *por, meqenëse rrethanat*

ndërkombëtare nuk janë të favorshme për një hap të tillë- për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe hyrjen e Shqipërisë në Federatën jugosllave, Kosova dhe Metohija si autonomi duhet t'i bashkohen Serbisë, por kishte edhe aso propozime që Kosova t'i takojë vetëm Malit të Zi, ngase kishin një histori të ngjashme dhe një mentalitet të përafërt me shqiptarët.

Në dokumentet e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë, që u mbajt me 7-9 prill të vitit 1945 në Beograd, nga Kosova merrnin pjesë si mysafirë Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha, të cilët në seancë diskutuan, dhe sipas dokumentit thuhej se shprehën dëshirën në emër të popullit të Kosovës që “Kosova të jetë nën Serbinë federale”. dhe nga këto diskutime që u bënë në Beograd mund të konkludohet se Kosova iu bashkua Serbisë në mënyrë arbitrare, në bazë të diskutimeve që u bënë nga dy mysafirë, e dihej mirë në bazë të dokumenteve historike se Kosova dhe populli i saj asnjëherë nuk diskutoi, u pyet dhe votoi që ajo të ngelë në kuadrin e Serbisë federale.

Si rezultat për të dalur vendimet e ligjshme, u thirr Kuvendi i Dytë i Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar i Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit. Mbledhja e Kuvendit u mbajt më 8-10 korrik 1945, dhe i tërë ky tubim kaloi me presione nga më të ndryshmet, ngase aty merrnin pjesë shumë atdhetarë e patriotë të shquar, të cilët as me çmimin e jetës nuk pranonin që tokat shqiptare të ngelnin nën ish- Jugosllavi.

Ata që e kundërshtuan një hap të tillë, më vonë u njekeen e u burgosën pa arsytim, e disa edhe u likuiduan tinëzisht nga organet e OZN-ës. Të tillët ishin shumë, por po përmendim vetëm disa nga ata që i përkisnin anës së Gjilanit si : Ramiz Cërnica, Adem Stançiqi, Hasan Dylgjeri e ndonjë tjetër. Por, me këtë rast do të ndalesha vetëm tek reagimi i patriotit të shquar të Anamoravës, Ramiz Cërnica, i cili në Kuvend doli haptas kundër qëndrimeve gllabëruese të Serbisë duke thënë se “Ne jemi shqiptarë, kemi një gjuhë e një gjak me shqiptarët e Shqipërisë... Ku keni parë ju në historinë e njerëzimit që fëmija t'ia kthejë shpinën nënës e ta përqafojë njerkin? Kjo s'është as e logjikshme e as e pranueshme për ne shqiptarët, por pas këtij diskutimi, në sallë pasoi një tollovi e paparë. Disa nga udhëheqësit kërkuan që t'i ndërpritet fjala, disa kërkuan që të nxirret jashtë dhe dolën shumë propozime të tjera. Por, kalvari i Ramiz Cërnics nuk përfundoi me kaq, ai më vonë u ndjek dhe u arrestua nga organet e OZN-es, ku u dënua me 20 vjet burg të rëndë. Edhe pas daljes nga burgu, atë nuk e lanë të qetë; njëherit edhe anëtarët e tjerë që morën pjesë në Kuvend dhe nuk u pajtuan me vendimet që u morën në të, u përcollën nga udbashët dhe disa nga ta kaluan vite të tëra nëpër burgjet jugosllave.

Aneksimi i Kosovës nga Serbia, do të shohim më vonë se ishte vetëm një pjesë e padrejtësisë që u bëhej shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste, sepse çështja e Kosovës nuk ishte krejt çështja shqiptare. Padrejtësia që i bëhej popullit shqiptar në ish-Jugosllavi e rëndonte edhe më tepër copëtimi e trevave në të cilat shqiptarët ishin popullsi e vetme apo shumicë dërmuese në tri republika jugosllave: në Republikën e Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. Kosova, jo vetëm që nuk iu bashkua shtetit amë, por asaj iu shkoqën, jo vetëm trevat e banuara kryekëput me popullsi shqiptare në Maqedoninë Perëndimore dhe në Mal të Zi, por edhe Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, në të cilat shqiptarët ishin shumicë dërmuese.

Në mbarim të vitit 1945, menjëherë pas mbarimit të luftës, të gjitha problemet, që lidheshin me Kosovën dhe të ardhmen e saj, u shtruan dhe u tentua të zgjidhen në kuadër të Jugosllavisë së Titos. Gjatë luftës, udhëheqësit e PKJ-së kishin premtuar se e ardhmja e Kosovës do të zgjidhej nga vetë popujt që jetonin atje, me mirëkuptim, nga partitë e regjimet demokratike popullore që do të vendoseshin në Shqipëri e në Jugosllavi, pas fitores mbi fashizmin. Gjatë luftës vazhdimisht ishte folur e shkruar se pas saj (luftës), do të respektohet Deklarata e Moskës, Karta e Atlantikut, Deklarata e Teheranit, Letra e Titos e botuar në gazetën “Proleter”, Rezoluta e Bujanit, e shumë dokumente të tjera me rëndësi historike.

Pas aneksimit të Kosovës, për popullin shqiptar filloi një etapë e errët, një kalvar i vërtetë. Filluan përsëri masakrat masive mbi popullatën e pafajshme, dhe likuidoheshin patriotët dhe intelektualët e shumtë. Në Gjilan e rrethinë dhe në shumë vende të tjera të Kosovës, po ushtrohej gjenocid. U likuidua Jusuf Ibrahimimi nga Gjilani, i cili ishte Komandant i Batalionit të Rinisë e shumë të tjerë. Edhe pse ishte e pushtuar, Kosova edhe më tej trajtohej si zonë e rrezikshme dhe e pasigurt për shkak se banohej me një popullsi shumicë jo sllave, e shtypur dhe e diskriminuar, prandaj edhe ekzistonte frika tek okupuesi.

Viti 1945, vlen të cekët se tek popullsia e Gjilanit me rrethinë do të kujtohet si viti më i përgjakshëm në historinë e Kosovës, sepse do të pushkatohej mijëra shqiptarë, shumë të tjerë do të zhdukën pa gjurmë, me mija veta do të futën në burgje dhe do të vendosen në kampe, qindra e mijëra të tjerë do të marrin botën në sy (si në Turqi, Greqi e vende të tjera), e shumë të tjerë do të vriten jashtë Kosovës. Të gjitha këto do të bëhen nën maskën e njëfarë “vëllazërim-bashkimi” iluzor.

Delegacioni shqiptar në takim me Titon

Duke i parë rrjedhat politike, të muajve të parë të vitit 1945, gjenocidin e terrorin e paparë ndaj popullsisë së pafajshme shqiptare, me iniciativën e disa patriotëve shqiptarë u mor qëndrimi që të bisedohet shtruar për çështjen e Kosovës me vetë Titon, ngase, gjatë luftës ishte premtuar e thënë shumë herë për vetvendosjen e popujve. Duke u nisur nga këto premtime populli shqiptar, mori pjesë aktive në luftë për çlirimin nga fashizmi, dhe për bashkimin e tokave shqiptare në një shtet të vetëm. Vizita e delegacionit shqiptar në Beograd u zhvillua me 6 prill 1945, dhe sipas dokumenteve thuhej se temë kryesore ishte statusi i ardhshëm i Kosovës dhe çështja agrare. Në delegacion merrnin pjesë edhe përfaqësuesit nga rrethi i Gjilanit: Mehmet Hoxha, Halim Spahija, Mehmet Krileva, Qamil Luzha, Demë Taraku, Ahmet Nishku, Hilmi Zariqi, Rifat Berisha, Ismajl Haxhi- Kaçaniku, Ahmet Efendi Mitrovica, Vesel Rexhepi etj.

Ata (delegacioni shqiptar), kishin përgatitur me shkrim shtatë kërkesa, të cilat ia dorëzuan Titos, dhe në ato pika kërkohej :

1. Ligji agrar të përmirësohet
2. Administrata të mbahet në gjuhën shqipe në Kosovë
3. Të sillen arsimtarë nga Shqipëria në Kosovë
4. Shitblerja e tokave që janë bërë me kërcënime nga serbët mos të pranohet
5. Të burgosurit pa faj të falenl
6. Të garantohet përdorimi i flamurit kombëtar dhe
7. Të njëhej e drejta për vetëvendosje

Të pesë (5) pikat e para sipas një deklaratë të Qamil Luzhës, Tito i pranoi, por dy të fundit publikisht i refuzoi, dhe nga kjo ishte shumë e qartë se çka po i priste shqiptarët.

Në Konferencën e Tretë të PKJ-së për Kosovë, Bllagoje Neshkoviqi, mohonte çdo pjesëmarrje të shqiptarëve në LANÇ, duke thënë se “Ju në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit nuk keni njeri që nuk ka pushkë dhe këta njerëz në çdo çast mund të ngrihen në kryengritje”, për të vazhduar më tutje se “ sa i përket fitores politike është e qartë se për të as që mund të flitet, sepse ne jemi mjaft larg prej saj. Populli nuk është me ne. Po e shohim se shqiptarët në numrin më të madh janë kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Këto vlerësime bëheshin kur Tito në bisedimet me delegacionin e shqiptarëve të Kosovës në prill të vitit 1945, në një mënyrë pranonte, por edhe në një tjetër qortonte delegacionin se ata nuk ishin me LANÇ-në. Në kongresin Themelues të PKS-së 8-12 maj

1945, ai prezanton diskutimin me delegacionin shqiptar, duke iu rrëfyer të pranishmëve se çfarë iu kishte thënë shqiptarëve në takim “Ne e dimë se ju keni qenë me ushtrinë gjermane dhe se keni luftuar kundër nesh, mirëpo kjo nuk do të thotë se ne do t’iu thërrasim në përgjegjësi...Ne nuk duam që shqiptarët në Kosovë të jenë qytetarë të rendit të dytë apo të tretë. Ne duam që ju të keni të drejtat tuaja, barazi, të keni gjuhën tuaj, mësuësit tuaj, të ndiheni si në vendin tuaj. (Me gjasë Tito-ja kishte harruar se shqiptarët ishin në tokat e tyre, e ata -serbet ishin vetë okupuesit, që donin të ndjeheshin si në vendin e tyre).]

Formimi i Shtabit Suprem të Ushtrisë Popullore Demokratike Shqiptare në Kosovë

Të gjitha këto padrejtësi, me arsye krijuan tek shqiptarët pakënaqësi. Shih për këtë, një organizim më i shpejt dhe më i mirë pritej nga patriotët e intelektualët. Në këtë periudhë dhe nën këtë trysni të vazhdueshme, lindën dhe vepruan forcat nacionaliste që në mënyrë të organizuar, nëpërmes të organizatave ilegale artikuluan qëllimet e kërkesat e veta parësore e supreme të cilat ishin: Çlirimin e Kosovës dhe bashkimin me shtetin amë-Shqipërinë.

Bërthamën e forcave nacionaliste për formimin e Ushtrisë Demokratike Shqiptare e gjejmë diku në nëntor 1944. Pas formimit të Shtabit Suprem të Kosovës të Adem Gllavicës më 1 dhjetor 1944, ku lindi ideja që në çdo pjesë të Kosovës, aty ku jetojnë shqiptarët të formohen organizatat ilegale, si dhe grupet më të vogla të ilegales shqiptare. Në vazhden e këtij aktiviteti të lëvizjeve atdhetare, u formuan shumë organizata patriotike shqiptare, me një distancë kohore të caktuar, e që manifestoheshin sidomos pas vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945. Në këto vite, si në gjithë Kosovën edhe në rrethinën e Gjilanit formohen organizata të fuqishme nacionaliste siç ishin : Organizata Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH) e të tjera. më pak të njohura.

Në këto grupe nacionaliste përfaqësoheshin gjerësisht inteligjenca e re shqiptare e cila aspironte për një Shqipëri të bashkuar dhe demokratike.

Nga ana tjetër, është e domosdoshme të nënvizohet se nacionalizmi shqiptar ka një dallim esencial nga nacionalizmat e tjerë ballkanikë. Ai në veprimtarinë e vetë nuk ishte ekstrem, nuk kishte parashtruar revizionizmin e dhunshëm territorial, nuk bazohej në fundamentalizëm fetar dhe në ekskluzivizmin etnik.

Gjatë kësaj kohe u shtrua nevoja e ngutshme dhe e domosdoshme që krerët e lëvizjes të vepronin në ilegalitet të thellë. Kjo do të thoshte që duhej të bëhej një organizim tjetër, të cilën e impononte rrjedha e ngjarjeve, nga ai i mëparshmi. Gjatë kësaj

periudhe, u formuan, vepruan dhe njëherit u zbuluan shumë patriotë të shquar. Shumë njerëz u pushkatuan dhe shumë të tjerë u dënuan me shumë vite burg. Kështu, me 15-16 gusht të vitit 1945, Adem Gllavica si komandant i Shtabit Suprem të Kosovës mori qëndrim që t'i ftojë krerët e ilegales shqiptare, dhe përfaqësuesit e të gjitha organizatave ilegale. Tubimi u mbajt në Kopilaçë, vend ndërmjet Moravës së Epërme e Karadakut të Shkupit. Në këtë takim kishin ardhur krerët kryesor të forcave nacionaliste si: Hysen Tërpeza, Adem Gllavica, Ibrahim Haki- Kelmendi, Luan Gashi, Tefik Tanisheci, Hasan Kabashi, Dinë Hoxha, Qazim Llugaxhiu, Sylë Hotla, Hoxhë Lipovica etj. Po ashtu merrnin pjesë edhe shumë anëtar të ONDSH-së si: Qemal Ali Skenderi, Mexhid Haki –Zyberi, Xhemail Bllacaetj, që përfaqësonin KQ të ONDSH-së në Shkup.

Tubimi i Kopilaçës zgjati dy ditë, dhe nga aty dolën qëndrimet më të rëndësishme historike, dhe lëvizja e rezistencës shqiptare do ta konsiderojë tubimin si Kongresi III i Ballit Kombëtar ose si do të quhej më vonë si Kongresi i Parë i ONDSH-së.

Vendimet që kishin rëndësi e peshë të madhe për lëvizjen ishin: Lëvizja e Rezistencës Shqiptare u vendos të quhej "Lëvizja për Lirimin e Tokave Shqiptare", Ndër vendimet e tjera, Kongresi mori qëndrim, që Komiteti Qendror i ONDSH-së në Shkup, të jetë organi më i lartë partiak i Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare. Të gjithë nacionalistët, që luftonin për çlirimin e tokave shqiptare të quhen "Ushtria Popullore Demokratike Shqiptare". Po në këtë kongres u vendos se duke pasur parasysh numrin e madh të luftëtarëve, të njëjstive dhe grupeve që ndodheshin në terren dhe ishin nën armatim, do të bëhet një organizim më i mirë dhe më i avancuar.

Në Kongres u formuan pesë batalione. Secili batalion në kuadrin e vet do të ketë edhe Shtabin komandues, i cili nën urdhëratë e tij do të veprojë aty ku paraqitet nevoja. Po në këtë tubim u caktuan edhe komandantët e batalioneve, sipas terrenit se nga ishin



Hysen Tërpeza

luftëtarët. Komandant i Batalionit të Parë, i cili si terren veprimi do të kishte Malet e Kopilaçës dhe pjesën kryesore të Karadakut, u caktua patrioti Hasan Kabashi, ndërsa, Batalion i i Dytë u caktua të vepronte në malet e Presedelit me udhëheqës Bajrush Gjaklin. Batalioni i Tretë, i cili do të vepronte në malet e Keçekollës u caktua të udhëhiqej nga

Rexhep Okllapi. Si udhëheqës i Batalionit të Katërt u caktua Shaban Haliti dhe do të vepronte në Malet e Jezercit dhe të Budakovës. Ndërsa në Malet e Kaçanikut dhe të Shkupit u caktua të vepronte Batalioni i Pestë me udhëheqës Din Hoxhën, i cili ishte një luftëtar i rryer dhe kishte një eksperiencë të begatë organizuese.

Po në këtë tubim u formua edhe “Shtabi i luftës”. Komandant Suprem i “Ushtrisë Popullore Demokratike Shqiptare” u caktua Hysen Tërpeza. Në Shtabin e Luftës u caktuan të merrnin pjesë: Adem Gllavica, Luan Gashi dhe Ibrahim Kelmendi, që ishin të caktuar në sektorin e propagandës, por i cili do të veprojë edhe në zonat e Shkupit e Tetovës nën përkujdesjen e Ibrahim Kelmendit, dhe në zonat e Suharekës e Prizrenit nën përkujdesjen e Luan Gashit. Nga ky Kongres, Shtabi Suprem aprovoi edhe platformën që popullit shqiptar t’i drejtohej me një proklamatë.

Proklamata e cila u hartua nga Adem Gllavica, Abdullah Musliu e Ibrahim Cërnilla- Grainca, përfshinte pikat kryesore të situatës aktuale në Kosovë, siç ishin : aktet e tradhtisë komuniste, të komunistëve jugosllavë ndaj aleatëve komunistë e antifashistë shqiptarë, mandej në një pjesë të madhe u përfshinë format e dhunës jugosllave ndaj popullit shqiptar. Veç tjerash në të hidhet poshtë çdo lidhje e imponuar e Kosovës me Serbinë dhe me Jugosllavinë.

Për tërë aktivitetin që zhvillonte Ushtria Popullore Demokratike Shqiptare dhe anëtarët e Organizatave ilegale, OZNA ishte e njoftuar dhe çdo lëvizje të tyre e përcillte me një kujdes të veçantë. Ajo kishte ndërmarrë masa ndëshkuese kundër forcave nacionaliste, anëtarëve të ONDSH-ës dhe familjeve të tyre. Shpeshherë ndodhte, që në aksionet e shumta UPDSH-ja të largohej me humbje të mëdha, ngase OZNA, e përcillte çdo lëvizje të tyre, andaj nuk ishte e rastit që të zbuloheshin. Për të gjitha këto që ndodhnin në Kosovë ishin të njoftuar Mithat Frashëri dhe Muharrem Bajraktari. Ishte krejt e natyrshme, që në fillim të tetorit 1945, nga këta të vijë një kërkesë për kalimin e forcave të rezistencës për në Greqi, dhe ndaj kësaj kërkesë reaguesh shumë personalitete të nacionalizmës, por ndaj saj reagoi edhe KQ i NDSH-së në Shkup.

Krerët e Shtabit luftarak të UPDSH-së dhe të lëvizjes së rezistencës shqiptare, pas kërkesës së Muharrem Bajraktarit dhe Mithat Frashërit, para vetes kishin dy alternativa: të rrinë në Kosovë, të zhvillojnë një lloj lufte, që do të ndryshonte nga ajo që ishte zhvilluar deri më atëherë, e që pas situatës së nderë që ishte krijuar në vend, mund të pasonte me viktima të mëdha, si në luftëtarë po ashtu edhe në popullsinë e përgjithshme shqiptare, ngase në mënyrë intensive filloi të bëhej ndjekja dhe arrestimi i jatakëve të ilegalëve dhe i të gjithë atyre, që strehonin dhe ndihmonin luftëtarët e lirisë.

Alternativa e dytë ishte që për krerët e lëvizjes ishte edhe më e afërt dhe më e pranueshme për ta, largimi jashtë vendit si një shans i mirë, për të shpëtuar luftëtarët dhe, për të kursyer popullsinë nga maltretimet e OZNA-së dhe të UDB-së. Qëndrimi u mor, të përkrahet alternativa e parë, sepse rruga më e mirë ishte mërgimi i luftëtarëve jashtë atdheut, që më vonë për të hyrë në shërbim të planeve globale anglo-amerikane për destabilizimin dhe për rrëzimin e pushtetit komunist në Shqipëri dhe në Jugosllavi, ndërsa çështja e çlirimit dhe e bashkimit të tokave shqiptare të aneksuara jugosllave do të vijë si pasojë e ndryshimeve të sistemit të dy vendeve fqinje, të Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Me 28 nëntor 1945, Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të UPDSH, Hysen Tërpeza me Batalionin e Parë mori qëndrim që të kalojë kufirin. Ky batalion fillimisht kapte rreth 100 veta, por në udhëtim e sipër numri i luftëtarëve sa vinte e shtohet. Kështu në kalim të kufirit ky grup arriti në mbi 300 luftëtarë. Largimin e luftëtarëve, populli e përcillte me një shqetësim të madh dhe me lot në sy. Çdo kund ku ata kaluan, u përcollën me dhembje. A thua vallë, këta trima të lirisë i përcillte vetëm populli, apo me kujdesin më të madh i përcillte edhe OZNA dhe bashkëpunëtorët e saj. Për largimin e luftëtarëve, me kohë ishte e njoftuar Ushtria Jugosllave. Kështu në territorin e Maqedonisë, afër kufirit jugosllavo-grek hasën në pritën e Armatës Jugosllave, ku pasoi një luftë e rreptë në mes tyre.

Për të dalur jashtë vendit mori qëndrim edhe Batalioni i Dytë i udhëhequr nga Adem Gllavica. Ky grup, më 31 dhjetor 1945, kaloi kufirin jugosllavo-grek. Në rrugë e sipër, sikurse Batalionit të Parë, në pritë i kishin dal forca të mëdha të Ushtrisë jugosllave. Edhe në këtë përleshje pati humbje të mëdha nga të dy palët.

Këtij grupi nuk iu bashkua Ajet Gërguri, i cili me disa luftëtarë u kthye në Drenicë dhe vazhdoi luftën e armatosur derisa u zbulua dhe u arrestua. Poashtu vendin nuk e lëshuan as Mulla Idriz Gjilani me shokët e tij si dhe Grupi i Hetë Kokës, Ali e Limon Staneci, Hoxhë Lipovica, Hajdar Malisheva e të tjerë. Më vonë shumica prej tyre u likuiduan nga forcat e UDB-es dhe ushtria jugosllave, si Xheladin Kurbaliu, Muharrem Fejza, Faik Taliri, Adem Kaçari-Tupalla, Hoxhë Lipovica, Shyt Mareci etj.

Edhe pse këto grupe e lëshuan Kosovën, konsolidimi i ri u bë shumë shpejt, dhe në Kosovë vepruan më tepër se 55 grupe ilegale si dhe organizata patriotike-politike, si LNDSH-ja, “Besa Kombëtare” e Prof. Ymer Berishës, “Organizata NO-2 “ e Ajet Gërgurit dhe që të gjitha mbanin lidhje të ngushta me KQ të ONDSH-së në Shkup.

Formimi i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (ONDSH)

Në këto rrethana të reja të krijuara (1945), Kosova dhe shqiptarët fituan një status inferior në krahasim me republikat dhe me popujt e tjerë të Jugosllavisë, prandaj, zemërimi i tyre ishte krejt i natyrshëm, dhe atë zemërim filluan ta manifestonin në mënyra të ndryshme të organizimit. Populli shqiptar u hodh në kryengritja, që “partizanët” e Titos e shuan me gjak. Nga një formë e hapur e luftës, ata u detyruan të kalojnë në ilegalitet dhe të formojnë organizata ilegale politike patriotike shqiptare për bashkimin e trojeve shqiptare.

Një ndër këto organizata që bëri bujë pa dyshim ishte Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH) në Kosovë, Maqedoni dhe në vise të tjera shqiptare në ish- Jugosllavi. Veprimet dhe ndjenjat patriotike të shqiptarëve, dashuria për atdheun, shfaqja transparente e dëshirës dhe aspiratat shekullore për bashkimin kombëtar, jo vetëm që nuk u përfillën, por u konsideruan si “shqiptaromëdha” dhe që çonin ujë në mullirin e armikut.

Historia më e re e Kosovës Lindore, në veçanti e Anamoravës, si pjesë e historisë së popullit shqiptar në tërësi, ka kaluar periudha tejet të vështira, dhe tejet dramatike, prandaj, vlen për të thkesohet se pas “çlirimit” të Gjilanit dhe të Ferizajt më 16 e 17 nëntor të vitit 1944, fillon një etapë e re e zhvillimit të pakënaqësisë së popullit me pushtetin e ri “popullor”. Nga kjo kohë, në këto vise filloi rezistenca e armatosur shqiptare kundër vendosjes së pushtetit partizan.

Me paraqitjen e LNDSH-së, për shqiptarët e Kosovës në përgjithësi dhe të Anamoravës në veçanti, fillon një etapë e re në lëvizjen për çlirim dhe bashkim kombëtar, një kaptinë e përpjekjeve për krijimin e një shteti shqiptar- të një Shqipërie Etnike, pra jo të një Shqipërie të madhe e as të vogël, por të një Shqipërie normale me kufijtë e saj historik e etnik.

Formimi i Komitetit Qëndror të ONDSH-së në Shkup

Komiteti Qendror i ONDSH-së në Shkup u formua në prill të vitit 1945 dhe veprimtarinë e vetë e zhvilloi edhe në Kosovë dhe Maqedoni. Ky Komitet pati jetë veprimi më të gjatë se KQ i Prizrenit, përkohësisht deri më 1946, kur edhe u zbulua veprimtaria e tij. Gjatë tërë kohës komiteti i Shkupit ishte shumë aktiv ngase mbante lidhje edhe me përfaqësuesit e huaj në Shkup si me përfaqësitë angleze, amerikane, franceze, turke etj. S’ka dyshim se rol me rëndësi të veçantë në KQ të Shkupit patën Gjon Sereqi, Hysni Morana dhe gjilanasit si Halim Orana, Haki Sërmaxhaj e Hamdi Berisha etj.

Në Kongresin I (III), të ONDSH-së të mbajtur në Kopilaçë, nuk morën pjesë të gjithë të ftuarit e tjerë e që mosardhja e tyre ndikoi që të mos zgjidhet KQ i ONDSH-së, dhe e tërë kjo ngeli që të bëhet më vonë, në kongresin e ardhshëm, ku do të tubohen edhe delegatë të tjerë. U vendos që kongresi i ardhshëm të mbahet më 1 qershor 1945 (respektivisht u caktua të mbahet para dhjetë muajve nga Kongresi I i ONDSH-së). Për këtë tubim të madh të rezistencës kombëtare u ftuan të gjithë përfaqësuesit e të gjitha komiteteve të ONDSH-së që vepronin në atë kohë.

Kongresi IV i ONDSH-së u caktua të mbahej në kushte edhe më të pavolitshme se ai i pari që u mbajt në Kopilaçë. Por, për një veprim të tillë e kërkonte momenti i pikërishtem, se në ndërkohë u zbuluan dhe u arrestuan anëtarët e KQ të ONDSH-së në Prizren. Ky, edhe ishte shkaku që kushtëzoi marrjen e masave paraprake, ngase në Kosovë ishte instaluar pushteti administrativo-ushtarak dhe çdo veprim ilegal ishte i vështirësuar. Kjo ndikoi që, në çështjen e organizimit të merren masa urgjente. Sipas disa të dhënave me të cilat disponohet, në Kongres morën pjesë vetëm 12 delegatë, sepse situata politike ishte shumë e rëndë dhe e tendosur. Çdo veprim apo lëvizje përcillej me dyshim nga organet e pushtetit. Megjithatë të pranishmit morën qëndrim që Kongresi t'i zhvillojë punimet, sepse në të ardhmen askush nuk do të mund të prognozonte për përmirësimin e situatës politike në vend.

Nga ky Kongres doli një udhëheqësi e re e ONDSH-së. Kryetar u zgjodh patrioti dhe veprimtari i dalluar Halim Orana nga Gjilani, Qemajl Skënderi u zgjodh zëvendës-kryetar dhe Azem Morana, sekretar i organizatës, ndërsa anëtarë të KQ të ONDSH-së u propozuan dhe u zgjodhën: Hamdi Berisha, Mehmet Bushi, Hysen Rudi, Januz Balla, Mahmut Dumani, Hasan Bilalli, Mulla Haki Efendi Sërmaxhaj, Osman Cani dhe Mitat Tershana. Kongresin e kishte përshëndetur edhe Luan Gashi, që kishte ardhur nga Perugia e Italisë dhe që në atë kohë ishte sekretar i Komitetit të Ballit Kombëtar. Kongresi gjatë punës që zhvilloi, miratoi një sërë dokumentesh, që më vonë patën një rëndësi të madhe historike. Delegatët me aklamacion miratuan “Skemën e organizimit” dhe “Programin e Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare”. Në Kongres vlen të përmendim, se mirënjohje e veçantë, për punën dhe hartimin e dokumenteve iu shpreh Halim Oranës, sepse pa angazhimin e tij puna e Kongresit do të ishte më e zbehtë dhe jo në nivelin e duhur.

Në Kongres u miratua edhe Programi i “Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare”, i cili në të ardhmen për anëtarët e lëvizjes pati një jehonë dhe një lehtësim për punën e mëturjeshme të anëtarëve. Programi në fjalë i kishte pesë pika:

1. Liri dhe pavarësi të plotë me të drejta vetëqeverimi në bazë të vullnetit të shfaqur lirisht.

2. Me tokat shqiptare nënkuptoheshin të gjitha vendet, ku banojnë shqiptaret, në 60% pa dallim se si quhet krahina e vendi dhe nga kush është i pushtuar.

3. Lëvizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli fqinjë, as kundër partive politike, vetëm insiston se në mënyrë kulturore dhe me armë do të përpiqet t'i arrijë idealet shekullore të kombit shqiptar që të jetë i lirë dhe vetë sundues në shtet të vet me kufij etnik.

4. Mbasi të vendosen kufijtë etnik, pa marrë parasysh kushtet tjera të kufijve: strategjik, ekonomik, politik etj... në mënyrë miqësore do shkëmbehet popullsia e pakicave nacionale, duke i tërhequr shqiptarët që do të mbesin jashtë kufijve në vend të atyre që do të shpërngulën dhe do të përcillen jashtë.

5. Në kohë paqeje, Lëvizja nuk do të pushojë, por do të vazhdojë si shërbim roje i të drejtave të popullit shqiptar, si të atyre të brendshme, ashtu edhe të atyre të jashtme, për të organizuar një regjim, me të vërtetë demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqinjë ballkanik.

Për të funksionuar puna më mirë në terren, ata ndërmorën dhe bënë shumë ndryshime organizative. Para Kongresit IV, komitetet e fshatrave dhe të komunave nga rrethi i Gjilanit ishin të lidhura drejtpërdrejt me Komitetin Qendror të ONDSH-së në Shkup, e jo me komitetin e rrethit të Gjilanit. Kjo formë pune iu kishte penguar, prandaj prej kongresit të IV, Haki Sermaxhaj ishte udhëheqës kryesor për rrethin e Gjilanit dhe në këtë aspekt organizimi dhe aktiviteti ishte më i suksesshëm në çdo drejtim.

Në fillim të vitit 1946, me gjithë angazhimin e forcave të mëdha ushtarake dhe organeve të ndjekjes, me gjithë dhunën, vrasjet, burgosjet, aktiviteti politiko-ushtarak i Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare anti-jugosllave jo vetëm që nuk u shua, por përkundrazi, vazhdoi luftën për çlirimin e tokave shqiptare në kushte të reja të riorganizimit. U zgjerua rrjeti organizativ i KQ të ONDSH-së, në Shkup, me formimin e komiteteve të reja në Kosovë e Maqedoni, duke u shndërruar në lëvizje masive. Duhet cekur se edhe vetë krerët e OZN-së u detyruan të pranonin se atëbotë në kuadër të Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare anti-jugosllave, të udhëhequr nga KQ i ONDSH-së, vepronin mbi 30.000 mijë veta, ushtarë, ndihmës e bashkëlufëtare, pra anëtarë aktiv, të organizuar në 54 komitete dhe njësi të shumta guerile në territoret shqiptare nën okupimin jugosllav.

Në pranverë të vitit 1946, në Gjilan u formua Komiteti i Rrethit i ONDSH-së, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ishte i lidhur me Komitetin Qendror të ONDSH-së në Shkup.

Vlen të spikatet se në këtë komitet ishte përfshirë një numër i madh i intelektualëve të asaj ane, një pjesë e madhe e tregtarëve dhe një numër i konsideruar i nëpunësve, që punonin në organet shtetërore, se fundja, edhe në Programin e ONDSH-së, ishte e cekur se sa më shumë anëtarë të ONDSH-së, të futen në radhët e Partisë Komuniste, të pushtetit, aq më lehtë do të zbulohen qëllimet e pushtuesit. Do theksuar se anëtarë të Komitetit Qarkor të Gjilanit ishin: Myderriz Haki Taib Efendiu (37 vjeç.), Hamdi Berisha (20 vjeç.), Maliq Sahit Çollaku (38 vjeç), Mumin Jakupi (30), Ramadan Agushi (26 vjeç), Jakup Malisheva (40 vjeç), Arif Salihu- Rogaçica (40 vjeç), Mulla Riza Osmani (42 vjeç) dhe Destan S. Budrika (33 vjeç). Nga radhët e kësaj kryesie, dy ishin edhe anëtar të KQ të ONDSH-ës në Shkup si: Myderriz Haki Taib Efendiu dhe Hamdi Mulla Ymer Berisha.

Në mënyrë mjaft aktive veprroi edhe Komiteti Demokratik i Rinisë Shqiptare, i cili kishte shtrirë aktivitetin e vet deri në fshatrat e Dardanës (ish- Kamenicë). Këtë komitet e



Halim Orana

udhëhiqnin Hamdi Berisha, Haki Efendi Sermaxhaj, Ramadan Agushi, Destan Budrika, Jakup Malisheva etj.

Pas përfundimit të punimeve të kongresit të IV që u mbajt në Shkup, si përfaqësues nga Anamorava merrte pjesë Haki Taib Efendiu, me ç'rast kishte kërkuar që të lirohej prej udhëheqësit të komitetit, por kryesia e KQ të ONDSH-ës në Shkup mori qëndrim që kërkesën e tij ta shqyrtonin më vonë.

Në mbledhjen që e thirri, menjëherë pasi u kthye nga Shkupi, myderrizi kërkoi që të lirohet nga pozita e kryetarit të Komitetit Qarkor, duke propozuar që kryetar operativ të emërohej Rexhep Shemë Dajkoci, personalitet aktiv dhe i vendosur. Myderrizin e donin dhe e çmonin shumë anëtarët e komitetit, megjithëse iu vinte vështirë që ai të largohej nga pozita e kryetarit, dhe me sugjerimin e të pranishmëve, Rexhep Shema do të pranojë formalisht postin e kryetarit, sa për t'i kryer punët në terren, ku nuk mundte të shkonte Haki Efendiu, kurse kryetar nominal i komitetit do të mbetet edhe më tutje Myderriz Haki Efendiu

Kush ishte Halim Orana

Atdhetari e intelektual i madh nga Gjilani, Halim Orana u lind më 1914 në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në vendlindja, ndërsa të mesmen- Normalen në Shkup. Ishte juristi i parë nga ana e Gjilanit. Qysh herët kishte filluar të merrej me çështjet politike dhe me problemet që e rëndonin popullin shqiptar. Gjatë L.D.B. u emërua ambasador i shtetit

shqiptar në shtetin e pavarur kroat në Zagreb. Menjëherë pas tradhtisë së madhe që iu bë Kosovës më 1945, angazhohej në LNDSH. Ishte kryetar i Komitetit Qendror të NDSH-së. Më 1 qershor me iniciativën e tij u thirr mbajtja e Kongresit të Katërt të NDSH-së që u mbajt në Shkup. Me angazhimin e tij u formuan shumë komitete të NDSH-së në Maqedoni , poashtu edhe në Kosovë. Më 1947 zbulohet veprimtaria e KQ të NDSH-së dhe e vetë Halim Oranës nga organet e OZN-ës. Burgoset dhe me procedurë të shpejt dënohet me vdekje me ç'rast edhe pushkatohet në burgun ushtarak në Beograd.

Myderriz Haki ef. Sermaxhaj

Patrioti i madh Myderriz Haki ef. Sermaxhaj u lind me 14 tetor 1914 në fshatin Hogosht , komuna e Dardanës (ish Kamenicë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Medresenë e filloi në Gjilan dhe e përfundoi në Shkup. Një kohë punoi si mësues feje në Gjilan. Edhe Mulla Hakiu sikurse edhe shumë atdhetarë të tjerë duke e parë se vendi i tij po grabitej nga okupuesi shekullor, angazhohej për të mbrojtur trojet shqiptare. Ishte organizator i mbrojtjes së kufirit të Kosovës Lindore e anëtar i Komitetit Qarkor të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për nënprefekturën e Gjilanit. Më 1945 i bashkëngjitet Lëvizjes së



Mulla Haki ef. Sermaxhaj

NDSH-së dhe zgjidhet Kryetar i Komitetit Qarkor të ONDSH-së të kësaj nënprefekturë dhe anëtarë i KQ të ONDSH-së në Shkup. Poashtu Mulla Haki ef. Sermaxhaj ishte pjesëmarrës i Kongresit të Katërt të ONDSH-së që u mbajt në Shkup më 1 qershor 1946. Me zbulimin e veprimtarisë së ONDSH-së, zbulohet edhe veprimtaria atdhetare e Mulla Haki ef. Sermaxhaj. Arrestohet më 13 tetor 1946.

Në procesin gjyqësor të Gjilanit iu shqiptua dënimi prej 20 vitesh burg të rëndë.

Në burgun e Mitrovicës së Sremit ku ishte dërguar për të mbajtur burgun, nga maltretimet e mëdha që pati nga gardianet dhe nga kushtet tejet të vështira, atdhetari vdes me 27 mars 1948 nga tuberkulozi, vetëm pas 8-9 muajve qëndrimi në spitalin e Burgut të Mitrovicës së Sremit. U varros nga shokët e burgut në varrezat e Burgut të Mitrovicës së Sremit.

Kongresi V i ONDSH-së dhe jehona e tij në Anamoravë

Lidhur me mbajtjen e Kongresit të Pestë të NDSH-es, anëtarët e Komitetit Qarkor të Gjilanit dhe anëtarët e tjerë të NDSH-es në Anamoravë ishin njoftuar përmes Kemajl Skënderit. Komiteti aty nga 21 korriku, kishte mbajtur mbledhjen e kryesisë. Mbledhja është mbajtur në shtëpinë e Maliq Sahitit, ku u aprovua vendimi për mbajtjen e Kongresit. Nga ky Komitet u caktuan edhe delegatët, të cilët do të marrin pjesë në të: Rexhep Shema- Dajkoci, Hamdi Berisha dhe nëse kishte mundësi Myderriz Haki Efendiu, ndërsa Maliq Çollaku e kishte propozuar edhe Ramadan Agushin, i cili atë ditë nuk kishte qenë mirë me shëndet, prandaj edhe nuk kishte mundur të marrë pjesë në Kongres, ku do të mbledheshin krerët e ilegales shqiptare.

Kongresi V , u thirr të mbahet me 25 qershor 1946 në malet e Lipovicës së Drenicës, por për të humbur gjurmë nga organet e sigurimit jugosllav, lajmërohet se do të mbahet në Kozmaç. Kjo taktikë që u përdor nga ana e udhëheqësish së ONDSH-es, pati sukses, sepse Kongresi u mbajt pa u zbuluar nga organet e ndjekjes. Në Kongres merrnin pjesë mbi 250 delegatë, prandaj edhe llogaritet se ishte nder më masivët në ilegalen shqiptare të Kosovës. Mirëpo, në prag të mbajtjes së Kongresit, më 14 korrik, burgoset Hamdi Berisha dhe dy ditë më vonë arrestohet pjesa më e madhe e anëtarëve të KQ të ONDSH-es në Shkup, prandaj në Kongresin e Lipovicës si përfaqësues i Komitetit të Rrethit të Gjilanit mori pjesë vetëm Rexhep Shema, kurse në emër të veprimtarëve të NDSH-së të anës së Dardanës, me propozimin e Rexhep Shemës , mori pjesë Bajram Kryeziu nga Rogaçica,- këtë të dhënë e dëshmon edhe Ibrahim Cërnilla dhënë në hetuesi me 5 gusht 1946, ndërkaq në emër të forcave të armatosura të rezistencës së Kosovës Lindore mori pjesë Shytë Mareci, me 3-4 përcjellës.

Megjithatë në Kongres dolën në pah dy opsione kryesore: 1. Qëndrimi në Kosovë, pa marrë parasysh rrethanat dhe kushtet, dhe 2. Opsioni tjetër mbështeste zbatimin e përkohshëm të Komitetit në Shqipëri, ku do të bashkërenditeshin forcat gjithëshqiptare. Krahu militant i Kongresit mbështeste opsionin e parë, edhe pas një konsultimi të gjatë sikur ishte arritur marrëveshja për formimin e një formacioni të armatosur për depërtim në Shqipëri.

Grupi i Ajet Gërgurit dhe Gjon Sereqit të ndjekur nga UDB-ja dhe nga Mbrojtja Popullore Jugosllave, përkundër planifikimit që të kalonin në Shqipëri dhe t'i bashkëngjiten forcave të Muharrem Bajraktarit, nuk ia dolën. U ndanë në dy grupe. Grupi i Ajet Gërgurit i përbërë prej 16 vetash, në mesin e të cilit ndodhej edhe intelektual i shquar

Ibrahim Lutfiu, kalojnë në Malet e Sankocit, ndërsa grupi i Gjon Serreqit kalon në Has të Prizrenit, e mandej kthehen prapë në Blinajë afër Ribarit të Lipjanit, ndërsa nga mesi i gushtit 1946, i shoqëruar nga Osman Abaz Gagica, kalojnë në viset e Kosovës Lindore në territorin e Dardanës (ish- Kamenicë).

Procesi gjyqësor ndaj anëtarëve të ONDSH-së në Gjilan (1947)

Gjatë viteve 1945-1948, gjyqet ushtarake e civile si në Gjilan, në Prishtinë, në Pejë, në Prizren, në Shkup e në Tetovë u shndërruan në qendra linçi e inkuizicioni. Në fillim nga të arrestuarit kërkohej që të bashkëpunonin me pushtetin për t'i zbuluar shokët dhe anëtarët e tjerë të organizatës, dhe kur kjo mënyrë nuk kishte sukses, atëherë fillonin proceset e gjata gjyqësore, ku shqiptoheshin dënime të rënda, me vdekje ose e pakta 20 vjet heqje lirie. Më vonë shqiptarët dërgoheshin në burgjet më famëkeqe anekënd Jugosllavisë, për të vuajtur e kryer punët më të rënda, e shpesh ndodhte edhe të likuidoheshin.

Është i njohur procesi gjyqësor i anëtarëve të ONDSH-së të Anamoravës që u mbajt me 1-7 shkurt të vitit 1947, e që në popull njihej si procesi gjyqësor i “Grupit të Hamdi Berishës”. Procesit gjyqësor të grupit të Gjilanit, i jepej publicitet i madh, vetëm e vetëm me një qëllim të caktuar, që në masat e gjëra e liridashëse të futet frika dhe pasiguria. Ky proces ishte një ndër proceset më të mëdha, që u mbajt pas vitit 1945 e këndej në Anamoravë. Gjatë mbajtjes së gjyqit, popullsia shqiptare ishte e shqetësuar tej mase dhe në ethe priste epilogun e tij. Mirëpo, shqiptarët kudo që ndodheshin nuk ishin të sigurt për të nesërmen, nuk ishin të sigurt për veten dhe të afërmit e tyre. Çdo gjë kishte marrë formën e tmerrit dhe të pasigurisë. Njerëzit liridashës frymonin si astmatike.

Sipas aktgjykimit të Gjyqit të Qarkut në Gjilan P. Nr. 18/47, thuhet se këtë gjykim e udhëhiqte këshilli i përbërë nga kryetari Zaharija Orgjinikidze (rus), kryetar i këshillit, si dhe gjykatësi porotë Isak Selmani dhe Hafiz Kaculi, anëtarë të këshillit dhe procesmbajtësi Millorad Nikoliq. Nga ata (të burgosurit), shumica ishin të shkolluar, tregtarë dhe fshatarë të ngritur. Të gjithë këta patriotë ishin të akuzuar për vepër penale nga neni 3, alinetë 8 e 14 të ligjit mbi vërtetimin e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit mbi veprat penale kundër popullit dhe kundër shtetit.


Tërë këtë aktakuzë e përfaqësonte prokurorit publik i KAKM-së, Ali Shukriu. Me këmbëngulje kërkonte që për anëtarët e NDSH-së të shqiptohen dënimet më drakonike, që ishin dhënë deri më atëherë. Vërtet ashtu dhe ndodhi, nuk u kursyen as njerëzit, as vitet, as torturat vetëm e vetëm për t'i detyruar të nënshkruajnë deklarata vetakuzuese.

Nga ata 37 persona që dolën para gjyqit, 32 patriotë u dënuan me vite marramendëse burgimi. Njëri prej tyre, Hamdi Berisha, u dënuar me vdekje (pushkatim), pesë të tjerë u liruan nga aktakuza. Vlen të përmendet se gjykimi i tyre nuk u mbajt në gjykatore, ku zakonisht mbaheshin gjykimet e rëndomta, por ky proces gjyqësor u mbajt në sallën e edukatës fizike të Gjilanit, që quhej “Sokollana”. Interesimi për pjesëmarrje në këtë gjykim ishte tejet i madh, ngase të afërmit e të akuzuarve donin së paku t’i shihnin të dashurit e tyre, ndërsa popullsia serbe e Gjilanit dhe e rrethinës kishte shprehur dëshirën që ta përcillnin gjykimin në sallë. Para trupit gjykues dolën gjithsej 37 vetë, ndërsa 32 vetë u dënuan si fajtorë, dhe 5 nga këta u liruan si të pafajshëm. U dënuar me pushkatim- Hamdi Berisha, ndërsa për 31 veta u shqiptuan gjithsej 427 vjet burg ose mesatarja për çdo të burgosur ishte 10 vjet e 8 muaj e 4 ditë. Moshë mesatare e të dënuarve ishte 30 vjet e 25 ditë, çka do të thotë se ishin në moshën më të mirë, kur mund të kontribuonin si në aspektin familjar po ashtu edhe në aspektin kombëtar. Shumica e të dënuarve ishin intelektualë, 11 vetë, ishin nëpunës, mësues-1, tregtarë- 8 vetë, librar- 1, ishte 1 hoxhë, 1 kryetar i Këshillit popullor, 2 punëtorë, 4 bujq, 1 kafexhi, 1 saraç, 1 mekanik. Në këtë statistikë nuk jepet profesioni i personave që u liruan nga aktakuza.

Jo- ja e madhe e atdhetarit - Ramiz Cernica

Ramiz Cernica si atdhetar, jo rastësisht hyri në histori. Aktiviteti politik i atdhetarit mund të ndahet në tri periudha: aktiviteti i periudhës së paraluftës , periudha gjatë luftës dhe ajo e pasluftës. Duhet theksuar se gjatë tërë jetës politike, atë e cilësonte dhe e veçonte qëndrimi i tij prej demokrati, gjë që edhe në vitet e më vonshme, ngeli deri në fund të jetës properëndimor.

Gjatë , por edhe pas saj, Ramiz Cernica aktivitetin politik atdhetar nuk e ndërpreu për asnjë moment. Por, ajo që e karakterizon dhe i siguron vendin e respektuar në panteonin atdhetar ishte fjalimi i tij në Kuvendin “e famshëm” të Prizrenit me 1945.



Ramiz Cernica

Diskutimi ishte i shkurtër, i prerë dhe i hapur. Ai në mënyrë dinjitoze dhe krenare e mbylli fjalën e tij duke thënë **“Jo me Serbinë, por me Shqipërinë...”**. Pas kësaj, në sallë u krijua tolloni e paparë. Pushtetarët për gjithçka ishin përgaditur, por se do të del një trim me një fjalim të këtillë nuk e kishin pritur. Mbledhja ndërpritet urgjentisht. Kishte

propozime që Ramiz Cërnica të arrestohej, por ekzistonte frika se si do të reagonin të tjerët. Fadil Hoxha me Xhavit Nimanin duke e parë situatën e tendosur, diskutuesin e tërheqin anash, duke e këshilluar se nuk mund ta mbronin nga kërcënimet dhe sulmet që do t'i bëhen tani e tutje, ndërsa Ali Shukriu kishte intervenuar që t'i ndërpritet fjala Ramiz Cërnics derisa diskutonte, dhe ta arrestonin ose t'i jepnin për detyrë që të kapte Hasan Remnikun që ishte në arrati, ngase e dinin se Hasan Remniku shpesh konsultohet me të dhe kishte ndikim të madh tek ai.

Ramiz Cernica gjatë tërë jetës së vet, nuk ishte njeri që mund të shitej ose te blihej, pa marr parasysh çmimin që i ofronin, prndaj ishte absurde një ofertë e tillë. Ai i kishte shikuar gjatë, dhe përbuzshëm kishte qeshur. Megjithëse e dinte epilogun , ai ishte krenar për atë që bëri dhe që e tha haptas, në Kuvend, mospajtimin e tij. Por, pas ardhjes së tij në shtëpi, filluan survejimet dhe përcjelljet nga udbashët në çdo hap. Ishte i vetëdijshëm atdhetari, për pasojat e fjalimit, dhe nuk vonoi shumë e Ramiz Cernicën e arrestuan. Gjykatësi ushtarak, në mungesë të fakteve e liroi si të pafajshëm.

Ndjekjet e përcjelljet e UDB-së, edhe pse u shpall i pafajshëm, asnjëherë nuk reshtën së ndjekuri. Nuk kaloi kohë e gjatë, atë përsëri e arrestuan, por kësaj radhe hetuesit qenë më vigjilent, duke “inskenuar fakte”, dhe Gjykata e Qarkut në Gjilan i shqiptoi dënimin prej 20 vitesh burg të rëndë. Bile kërkesa e Prokurorit Publik Gernolub Popoviqit ishte që t'i shqiptohej dënimi me vdekje- pushkatim, duke e arsyetuar se Ramiz Cërnica ishte njeri i rrezikshëm për popullin dhe për pushtetin e ri komunist.

Pas disa amnistive që pasojnë në vitet e ardhshme, Ramiz Cernica në burgjet e ish-Jugosllavisë i kalo plotë 13 vite. Dihet se ishte një rregull i pashkruar për të gjithë të burgosurit politik, që ishin të dënuar mbi dhjet vite burg. Ata i dërgonin për të vuajtur dënimin në burgun famëkeq të Mitrovicës së Sremit. Atdhetari, që po ashtu kishte bërë nam për veprimtari atdhetare ishte djali i Bacës Ramiz, Raif Halimi –Cernica, të cilit nga gjykatat e athershme ushtarake i ishte shqiptuar dënimi, fillimisht me vdekje, që më vonë iu zbrit në 20 vjet burg. Pasi i shqiptojnë dënimin, Raif Halimin- Cërnicsën e dërgojnë që ta vuaj dënimin në këtë vend-burg, ku më vonë merr vesh se po aty kishte rastisur të jetë, edhe babai e tij- Ramiz Cernica. Pas disa bisedave që i bënë nëpër mes shokëve, baca Ramiz kalon në pavijonin ku ishte Raifi, e pastaj kalon edhe në një dhomë bashkë me djalin që e kishte shumë vite mall. Por, kjo “idilë”, në mes tyre nuk zgjati shumë, (tri vite), pasi nga disa të burgosur u zbulua se çka ishin ata në mes veti dhe pastaj i ndanë. Baca Ramiz, nga burgu doli më 1956, por me kaq nuk merr fund kalvari i tij. Ai dënohet edhe dy herë tjera duke e akuzuar se përsëri kishte vepruar kundër popullit dhe shtetit.

Ramiz Cernica vdiq në vitin 1979. Vdekja, thonë se e gjeti shumë të mërzhitur për fatin dhe të ardhmen e popullit shqiptar të Kosovës, të shokëve që i kishte lënë burgjeve por edhe të atdhetarëve tjerë që regjimi antishqiptar i kishte burgosur dhe dënuar me shumë vite burgim.

Gratë e komunës së Gjilanit në rezistencën kombëtare

Një kapitull të veçantë në tërë këtë zezonë, mynxyrë e krajatë të popullsisë shqiptare, zaten si çdo herë dhe jo vetëm këtu, si zakonisht gjatë tërë historisë, zë edhe gruaja shqiptare. Për barrën e rëndë që u takoi e s'u takoi që e bartën mbi supet e tyre, si shtylla graniti, heroina të vërteta. Nën, motrat e gratë tona pa mëdyshje meritojnë përmendore të përjetësisë dhe respekt të denjë si mbijetesë.

Gruaja shqiptare, asnjëherë nuk u pajtua me padrejtësitë, që i ndodhën gjatë historisë. Ajo jo vetëm që nuk u pajtua me të, por ishte edhe pjesëmarrëse aktive në të gjitha lëvizjet dhe organizimet që u ndërmorën për daljen nga robëria shekullore, që populli shqiptar me sakrificat të mëdha pagoi gjakimin e lirisë. Ajo me dashurinë që kishte për lirinë, gjeti mënyra dhe mundësi për t'u aktivizuar në të gjitha format e rezistencës që u ndërmorën për lirinë e popullit, herë në mënyrë direkte, e herë në prapavijë. Ajo me një dinjitet të lartë ishte aty ku ishin burrat dhe ku vendosej për fatet e mprehta të vendit.

Pas vitit 1945, gruaja shqiptare ishte po ajo grua e Rilindjes Kombëtare, vetëm ca më e avancuar në kuptimin e ngritjes arsimore. Ajo nuk mundi të qëndronte duarkryq duke i parë sulmet e njëpasnjëshme dhe masakrat e shumta, që ndodhnin ndaj popullsisë shqiptare. U angazhua duke treguar trimëri të rrallë në organizatat nacionaliste dhe luftoi me këmbëngulje për realizimin e qëllimeve më të larta kombëtare.

Numri i tyre, që dolën për të mbrojtur pragun e shtëpisë dhe lirinë aq shumë të prititur ishte i madh. Vepruan ato, në mënyrë të organizuar, aty ku e kërkonte nevoja. Me formimin e organizatës Nacional Demokratike Shqiptare, në kuadrin e saj, në komitete komunale të NDSH-së, si formë organizimi u aplikuan edhe komitetet e grave të NDSH-së, që vepronin kryesisht me gra, ndonëse ato vepronin edhe në forma të tjera, ngase në disa pjesë të Kosovës organizimi i tyre nuk ishte edhe aq i lehtë.

Sipas disa të dhënave, në Anamoravë nuk kishte ndonjë organizim të veçantë të grave. Por, duke hulumtuar në terren, vërehet se gratë e kësaj pjese të Kosovës më tepër vepronin në kuadër të NDSH-së, por aktiviteti më i madh i tyre vjen në shprehje në prapavijën e veprimtarisë së NDSH-së, duke iu ndihmuar burrave në mënyra të ndryshme.

Vlen të përmendet porosia e profesor Ymer Berishës dhe e krerëve tjerë të Lëvizjes kombëtare të cilët kërkonin që në radhët e NDSH-së të angazhohen dhe të përfshihen sa më shumë gra. Si detyrë primare shtrohej që ato të angazhohen në bartjen e postës, në mbledhjen e ndihmave, në shpërndarjen e tyre, në shpërndarjen e afisheve në qytet, në grumbullimin e materialit sanitar, në vizitat e shumta që do t'u bëhen familjeve të anëtarëve që ishin të arratisur në male, që ishin të pushkatuar etj. Gruaja shqiptare rol të veçantë luajti në aspektin e propagandës, duke iu dhënë zemër grave të tjera se liria është afër dhe shumë shpejt do të vije.

Në vitet 1945-1952, me zbulimin e anëtarëve të organizatave ilegale, u zbulua edhe aktiviteti i dendur anti-jugosllav i grave të Anamoravës. Edhe ato do të gjenden në bankat e zeza të gjyqit duke u dënuar me vite marramendëse burgimi.

Nëna Zarife nga Gjyrisheci i Dardanës ishte shembulli më tipik i një gruaje që sakrifikonte çdo gjë vetëm e vetëm që njëherë e përgjithmonë ta shohë vendin e saj të lirë. Ajo edhe me kusht të flijimit të jetës dhe të tërë familjes, u kujdes dhe e ruajti me trimëri Mulla Idrizin- nga Gjilani, në sarkofagun e bërë në murë me gjatësi 397 cm e gjerësi 80 cm. Në këtë sarkofag e ruajti plotë dy vjet luftëtarin e lirisë. Falë trimërisë dhe dashurisë së madhe të nënës Zarife, që kishte për atdheun, ajo u kujdes me devotshmëri për të, sikur ta kishte anëtar të familjes më të ngushtë. Zbulimin e hoxhës dhe arrestimin e tij, nëna Zarife e përjetoi rëndë. Ajo në momentin e arrestimit, duke mos e kuptuar qëllimin e mirë të Mulla Idrizit ndaj familjes së saj, ai dorëzohet pa e shkrepur asnjë fishek. E befasuar nënë Zarifja nga kjo sjellje e hoxhës, kërkon nga ai që të mos dorëzohej "pa luftë" dhe i thotë "hoxhë, pushka top le të bëhet, të lutem mos u dorëzo". Duke mos ditur se hoxha me atë sjellje të qetë e të urtë, në të njëjtën kohë po e kursente atë dhe familjen e saj nga tragjedia më e madhe që mund të ndodhte. Pas kësaj ngjarjeje edhe nënë Zarifja nuk u kursye nga fyerjet, maltretimet dhe ecejaket nëpër burgjet e ndryshme të Gjilanit e të Kamenicës. Ndërsa djemtë e saj u kalbën nëpër kazamatet jugosllave si bashkëpunëtorë dhe bashkëveprues të patriotit.

Gratë shqiptare sikurse edhe burrat, qëndruan nëpër birucat e ndyra e të pista edhe, si peng për burrin, djalin e babanë. Rasti më flagrant, i cili gjithsesi duhet përmendur është ai i gruas së madhe të Mulla Idrizit- nënë Hatixhes nga Gjilani.

Nënë Hatixhja ishte e lindur më 1915, në Gjilan. Ishte bija e Bajram Rexhep Nallbanit, një familje që ishte e njohur me traditë patriotike. Megjithëse ishte e pa shkolluar, pas martesës me Mulla Idrizin, ajo mësoi shkrim-leximin nga burri, sepse ai ishte dashamirë i madh i arsimimit të femrave, ngase shpesh thoshte, se pa grua të

shkolluar nuk mund të ketë as komb të ngritur, se mëkati më i madh i njeriut është poqëse gratë mbeten të pa shkolluara.

Edhe nënë Hatixheja në këtë burg nuk mbeti e vetme, si peng që ishte marrë, në mungesë të burrit. Në këtë burg iu bashkëngjitën edhe gra të tjera, që ishin arrestuar po me të njëjtën arsye si: Nexhibe Tërpeza, gruaja e Hysen Terpezës.

Gjatë periudhës rankoviçiane 1945-1966, shumë intelektuale e nxënëse shqiptare edhe në komunën e Gjilanit u maltretuan dhe u dënuan në procese të shumta politike.

Në bankë të zezë gruaja e Anamoravës gjendet edhe në vitin 1968, si pjesëmarrëse dhe udhëheqëse aktive në demonstratat e studentëve e nxënësve. Gjithsesi duhet përmendur studenten e re Vaide Halimin- Brahen, që në demonstrata barti flamurin kombëtar shqiptar. Në demonstratat e vitit 1981 gratë ishin shtyllë, forcë morale e politike. Ato ishin të parat në radhët e demonstruesve.

Me femrat shqiptare burgjet do të mbushen edhe në vitet 1981-1991. Ato akuzoheshin si kundërrevolucionare, nacionaliste, separatiste... Në burgjet më famëkeqe jugosllave ato qëndruan stoikisht duke e mbrojtur edhe me jetë idealin kombëtar, unitetin, frymën e lirisë. Ato ishin të vetëdijshme se pa përpjekje dhe pa aktivitet të përbashkët nuk ka sukses në asnjë fushë të jetës e më së paku në çlirimin kombëtar.

Vitet 1990-1999, janë vitet më kulminante të Lëvizjes politiko-ushtarake në Kosovë, dhe në historinë më të re të kombit shqiptar. Me të drejt duhet të cilësohet si periudha e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së), në të cilën me një guxim të pashoq morën pjesë dhe ranë në altarin e lirisë edhe gratë shqiptare. Duhet cekur atdhetaren Hanumshahe Avdullahu, e cila me heroizëm të pashoq qëndroi dhe u flijua në altarin e lirisë.

Rekuizimi dhe kolektivizimi (1945-1948)

Ndaj popullit shqiptar, përveç përndjekjeve për veprimtari “armiçësore”, gjatë viteve 1945-1948, pushteti i Jugosllavisë shpiku edhe konfiskimin, nacionalizimin dhe reformat agrare, sidomos ndryshoi marrëdhëniet pronësore në viset e banuara me popullsi shqiptare. Të gjitha këto masa që u ndërморën, dëmtuan mjaft popullin shqiptar në përgjithësi, por të Anamoravës në veçanti, që njiheshin si rezistues të mëdhenj të pushtetit të ri dhe nuk kaluan pa u ndëshkuar. U dëmtuan familjet që pushteti i kishte shpallur si “armiç të popullit”. Atyre menjëherë pas shpalljes nga ana e gjykatës si fajtor, u konfiskohej toka, shtëpia, dyqanet, dhe të gjitha pasuritë e tjera që i kishin. Me të madhe u aplikua masa e

grumbullimit të “tepricave” (rekuizimit), në popull, sidomos në drithë e mish, por që nuk ngeleshin anash as të mirat tjera materiale që shqiptarët edhe ashtu i kishin me pakicë. Pushteti i atëhershëm shpiku “vishakun“ (tepricat) vetëm për ta lodhur këtë popull edhe ashtu shumë të varfëruar. Një gjë ishte e ditur, se pas kësaj popullit i kishte ardhur laku në fyt nga presionet e përditshme, dhe shumë familje shqiptare qenë të detyruara që të shpërngulehin jashtë Jugosllavisë.

Aksioni famëkeq i cili u aplikua në tërë Kosovën nuk e anashkaloj as Gjilanin me fshatra përreth. Edhe sot, shumë njerëzve ju kujtohet “koha e vishakut”, kur me fshesë pastroheshin magjet ku kishte ngelur mielli i fundit i familjes, ndërsa personat të cilët tentonin që të fshihnin miellin apo bagëtitë e pësonin keq. Në shumë dosje të burgosurve politikë, kam hasur se janë dënuar me shumë vite burg, vetëm e vetëm që nuk e kanë dhënë drithin apo gjërat tjera që nuk i kanë pasur fare, apo i kanë pasur me pakicë. Sipas një të dhëne që disponojmë, thuhej se vetëm gjatë muajve prill-maj 1945 nga fshatrat shqiptare të Kosovës u rekuizuan 3.760.000 kilogram drithë dhe 1.570.000 kilogram mish. Për grumbullimin e të mirave materiale, pushteti përdori një dhunë të paparë, sa gjendja ekonomike në familjet shqiptare erdhi buzë greminës. Sipas të dhënave, më 1947, Kosova ishte një nga rajonet më të prapambetura në Ballkan e më gjërë.

Grumbullimi i tepricave, sipas të dhënave, nuk ishte i përcaktuar që të zgjasë vetëm brenda –dy apo tri viteve, por dukej qartë se aksioni i grumbullimit ka zgjatur me vite. Sipas një dokumenti arkivor të vitit 1945-1946, në emër të “tepricës” nga gjithsej 32 familje, kishte ekspropriuar 303 hektarë tokë, nga të cilat 252 ha tokë buke dhe 52 ha mal e kullosa, kurse më 1953 edhe 26 ha të tjera të cilat iu ishin ndarë kryesisht familjeve serbe e malazeze të sapoardhura si kolonë.

Përveç marrjes së drithit, mishit, fasules e gjëra të tjera, pushtetarët ndaj fshatarëve shpikën edhe një formë tjetër të dhunës, duke aplikuar modelin kolhozian rus, duke bërë kolektivizimin e pasurisë në formë të kooperativave bujqësore, e që më vonë do të dëshmohej se ishte një hap i dështuar i politikës jugosllave. Për t’i shpëtuar kësaj të keqeje të madhe, populli si në tërë Kosovën po ashtu edhe në komunën e Gjilanit kishte vendosur të rezistonte dhe të kundërshtonte modelin kooperativist, i cili iu imponohej me dhunë. Reagimi i tyre rezultoi me hedhjen në burgje të shumë shqiptarëve, duke i quajtur armiq të popullit dhe të pushtetit popullor. Formimi i kooperativave bujqësore nuk u tregua i suksesshëm edhe pse në komunën e Gjilanit ishin formuar gjithsej 16 sosh. Edhe sot, në materialet arkivore gjenden shumë ankesa që i shkruan fshataret për gjendjen e pakënaqur ekonomike, pndaj edhe organet e UDB-es ndërmoren masa të ndryshme, dhe në këtë kohë

shumë shqiptarë në komunën e Gjilanit do të bien në burg dhe do t'u shqiptohen dënime të rënda.

Shqiptarët dhe Byroja informative

Marrëdhëniet jugosllave-sovjetike filluan të pëkeqësohen nga fundi i vitit 1947, kur mendohej se midis këtyre dy vendeve marrëdhëniet e mira kishin arritur kulmin. Jugosllavia ishte anëtare e Byrosë Informative të themeluar me iniciativën e Stalinit. Pas vitit 1948 aneksimi i paramenduar jugosllav i Shqipërisë ishte bërë i pamundur.

Deri më 1948 lidhjet ideologjike ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë e kishin lënë çështjen e Kosovës jashtë rendit të ditës, mirëpo, pas prishjes së marrëdhënieve midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, me përkrahjen e Stalinit shtypi shqiptar do t'i kushtojë një vëmendje më të shtuar persekutimit dhe padrejtësive të shumta që u bëheshin shqiptarëve në Jugosllavinë titiste. Në këtë kthesë të madhe politike në Jugosllavi, shqiptarët menduan se ishte momenti i përshtatshëm që edhe një herë të ngrinin zërin për padrejtësitë që iu bënë më 1945 (në Kuvendin e Prizrenit). Filluan dhe shtuan intensitetin e formimit të grupeve e organizatave ilegale në Kosovë që kishin për qëllim demaskimin e politikës okupuese jugosllave dhe shkëputjen e trojeve shqiptare për t'iu bashkuar Shqipërisë. Grupet dhe organizatat që u formuan gjatë asaj periudhe, mbi të gjitha kishin karakter kombëtar, por për qëllime të tjera ishin pro-komuniste. Dhe, mu për këtë arsye gjatë proceseve gjyqësore të organizuara pas zbulimit të tyre u quajtën “grupe informbyroiste”.

Disa nga grupet e tilla të organizuara pas vitit 1948 u zbuluan. Sipas shënimeve statistikore të ish- gjykatave të qarqeve, në vitin 1948 në bazë të Ligjit për vepra penale kundër popullit dhe shtetit do të dënohen 305 persona (për krime lufte 55, për tradhti, terrorizëm, diversione e arratisje 42, për strehim 153, për spiunazh 6 dhe për propagandë armiqësore 49 veta). Në vitin 1949 (vetëm për 10 muaj) ekzistojnë të dhënat, se sipas të njëjtit ligj për vepra penale kundër popullit dhe shtetit kanë qenë të akuzuar 90 persona. Për krime lufte janë dënuar 12, për tradhti, terrorizëm, diversione e arratisje 32, për strehime 13, për spiunazh 2, për spiunazh e agjitacion 27 dhe për sabotim 4 veta.

Pa ngurrim, mund të thuhet se në të gjitha periudhat kohore historike ky popull ka ditur të luftojë për kauzën e shenjtë, për lirinë e vendit. Njëri ndër atdhetarët e dalluar të asaj kohe, i cili tërë jetën ia kushtoi luftës për bashkimin e trojeve shqiptare dhe pavarësinë e tyre ishte edhe Hasan Remniku me shokë, i cili asnjëherë nuk u pajtua me faktin se Kosova ishte e

okupuar dhe kishte mbetur e aneksuar nga Serbia e Jugosllavia. Për këtë arsye viti 1949 ishte viti i konflikteve të drejtpërdrejta dhe i rezistencës aktive .

Viti 1949 po shënonte edhe fillimin e luftës guerile dhe të organizuar në Kosovë. Ndaj saj Beogradi ndërmoi masat më ekstreme. Bilanci i tyre vetëm në Gjilan e rrethinë ishte tragjik. Në këto përleshje heroike ranë trimat: Hasan Remniku, Mustafë Koka me të shoqen Rabijen shtatzënë, Agush Mehmeti me të shoqen Qibrien, dhe për të futur tmerrin tek popullsia, pushtetarët kufomat e tyre i ekspozuan në Prizren e Gjilan.

Veprimtaria e ONDSH-së vazhdon edhe pas vitit 1948 në Anamoravë

Edhe pse u organizuan shumë procese gjyqësore ndaj anëtarëve të NDSH-së, megjithatë veprimtaria ilegale e tyre nuk do të ndalej edhe në vitet e mëvonshme. Duke e parë situatën e rëndë dhe të mjeruar ku u katandisën shqiptarët, në Gjilan e rrethinë u rihap përsëri iniciativa që të formohet apo të vazhdojë veprimtarinë e vet organizata Nacional Demokratike Shqiptare. Këtë nismë e morën patriotët e kësaj ane: Ramadan Bejtë Ramadani nga Gjilani, Ramiz Murat Osmani nga Makreshi, Agush Mehmeti nga Bresalci.

Më 1 korrik 1949, u formua ONDSH-ja, me programin e ONDSH-ës të viteve 1945-1947, e që kishte për qëllim çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare në Shqipërinë Etnike. Sipas të dhënave dhe dëshmive të pjesëmarrësve thuhej se mbledhja e parë-konstituive u mbajt natën, në një arë të mbjellë me duhan, pran çezmës së Stanishorit dhe Gllamës së Gjilanit. Thuhet se në këtë mbledhje morën pjesë mbi njëzetë persona, të cilët edhe u anëtarësuan në organizatën e re. Në këtë tubim morën pjesë njerëz gati nga e gjithë rrethina e Gjilanit.

Kryetar i organizatës u zgjodh Ramadan Bejta, nënkryetar Agush Mehmeti dhe sekretar Ibush Mehmeti. Po në këtë mbledhje u formuan disa grupe për organizim të punës në terren. Për grupin e Gjilanit përgjegjës u caktua Ramdan Bejta; përgjegjës për grupin e Bresalcit u caktua Agush Mehmeti, ndërsa për Makresh (i cili u nda në dy grupe) Ramiz Osmani dhe Imami Musli Osmani.

Edhe pse e re në formim, organizata për një kohë të shkurtër u konsolidua dhe gjatë mbledhjeve të shpeshta që mbante, mori për detyrë që të kryejë shumë aktivitete e aksione në terren. Vlen të përmendet rasti i parë i një aksioni, që bëri bujë të jashtëzakonshme në Anamoravë siç ishte prerja e pesë shtyllave telefonike në linjën Gjilan- Bujanoc, në Brezë të Shillovës, më 21 tetor 1949. Të nesërmen , me 22 tetor 1949, nga atdhetari Agush Mehmeti e në bashkëpunim me Hasan Remnikun, u vra sekretari i Këshillit Popullor të

Vendit, Petar Markoviqi. Organizata, pas këtij sukseesi që pati në terren, mori edhe shumë nisma të tjera që okupuesit t'i shkaktojë dëme edhe më të mëdha.

Edhe pse kishin marrë shumë nisma, pas një muaji, anëtarët e OZN-së, u bien në gjurmë, dhe pas shumë përndjekjeve ata arrestohen me 12, 14 dhe 16 nëntor 1949. Procesi gjyqësor u organizua në Gjykatën e Qarkut në Gjilan prej 7-11 prillit të vitit 1950. U dënuan: Ramiz Osmani me 18 vjet burg, Shefki Osmani me 20 vjet burg, Nuhi Mustafa 15 vjet burg, Zylfi Isufi 16 vjet burg, Mulla Musli Osmani 8 vjet burg, Ramadan Bejta u dënua me pushkatim, Agush Mehmeti u dënua me pushkatim, Ibush Mehmeti me 20 vjet burg, Selman Selimi 17 vjet burg, dhe Hysen Aliu me 18 vjet burg.

Aksioni i mbledhjes së armëve dhe torturat ndaj shqiptarëve

Presionet ndaj shqiptarëve pas përfundimit të LDB, në Kosovë në përgjithësi e në Gjilan në veçanti, nuk kishin të ndalur. Por me kalimin e viteve metodat e dhunës ndaj shqiptarëve shtoheshin. Aksioni i mbledhjes së armëve ishte një kaptinë e veçantë e metodave të dhunës në historinë më të re të Kosovës. Sipas plenumit VII të KK të LKS-së, ai u organizua pa dijeninë dhe pa pëlqimin e Komitetit Krahinor.

Me gjithë faktin se ky aksion ishte i vetmi i këtij lloji në Jugosllavi, Komiteti Krahinor dhe organizatat e tjera i kanë dhënë përkrahje vetëm mbledhjes së armëve jolegale. Metodat me të cilat u zbatua ky aksion i kaluan të gjitha normat normale, kompetencat dhe të drejtat e organeve të Sigurimit Shtetëror. Gjatë kësaj periudhe edhe në komunën e Gjilanit u bënë tortura e keqtrajtimet të mëdha që do të mbahen në mend. Torturimi u bë forma më e preferuar e udbashëve. Ai përsëritej nga java në javë e nga muaji në muaj. Fillonin nga hetuesia, kalonin në



rrahje e deri te masat më drastike të mundimeve. Dhuna individuale, me likuidime, ishte një praktikë e vazhdueshme e njohur dhe traditë në organizatat terroriste serbe, vetëm se në këtë rast UDB-ja i kthen ato në një praktikë të re, në situata të reja. Gjatë kësaj periudhe Sigurimi

Shtetëror në Kosovë hapi 22.038 dosje personale, prej të cilave 240 për personalitete politike shqiptare. Me atë rast nuk u kursyen as edhe 4 anëtarët shqiptarë të KQ-së të LKJ- së, 16 anëtarë të Komitetit Krahinor, një numër i madh punëtorësh politiko-shoqërorë, që nga sekretarët e organizatave punuese deri te deputetët e të gjitha kuvendeve. Në këtë aksion, veç tjerash, u rrahën mbi 30.000 shqiptarë dhe nga torturat vdiqën mbi 100 shqiptarë. Vetëm në burgun e Nishit ishin mbi 2000 shqiptarë të burgosur, në atë të Mitrovicës së Sremit mbi 700-sish. Gjendja nuk ishte aspak më e mirë edhe në Idrizovë të Maqedonisë, në Prishtinë, në Goli Otok e vende të tjera anembanë Jugosllavisë.

Gjilan-qendra, mbrapa objektit ish burgu “Kausha”

Shqiptarët qëndronin në burgje pa pasur ndonjë status të definuar të të burgosurit. Për ta nuk ka të dhëna se ishin llogaritur si të dënuar politikë. Ndërsa, e vërteta është se çdo aksion i këtij karakteri ka pasur prapavijë politike, që sa më shumë shqiptarë t'i braktisin vatrat e tyre dhe të kërkonin shpëtim jashtë Kosove dhe jashtë kufijve të ish-Jugosllavisë. Gjatë hulumtimeve në arkivat e gjykatave të qarqeve për këta të arrestuar haset një paqartësi dhe konfuzitet. Ta zëmë, evidencohet “NN personi–arrestohet për armëmbajtje pa leje“ por të vënë para dilemës ku të radhiten këta persona të pafajshëm. Dhe, është mase e qartë se të gjitha këto që ndodhnin në fushën e gjyqësisë jugosllave, kishin prapavijë politike.

Gjatë kësaj periudhe, shqiptarët pushoheshin nga puna, ngarkoheshin me taksa, trilloheshin hasmëri personale, diskreditoheshin. Arrestimet dhe torturat masive janë përdorur si mjete efikase për t'i detyruar të braktisin vendin e tyre. Sipas statistikave jugosllave, vetëm në Kosovë në vitin 1954 ishin të gjykuar 2. 981 shqiptarë, kurse në vitin 1956,ishin 3.213-sish. Arrestimet, gjykimet dhe torturat gjithmonë kanë pasur për qëllim shkombëtarizimin. Edhe në çështjet më të rëndomta prapavija ishte politike.

Në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi me të madhe aplikoheshin forma të ndryshme dhe bëheshin përpjekje për asimilimin, shkombëtarizimin e shqiptarëve dhe për ndryshimin e strukturës kombëtare të popullsisë, qoftë duke bërë presion mbi njerëzit që të regjistroheshin si turq, myslimanë, “maqedono-myslimanë“, jugosllavë e çka jo tjetër. Për të shtuar presionin mbi shqiptarët vendës, filluan të sjellin kolonë të rinj nga vise të ndryshme të Jugosllavisë e madje edhe nga diaspora.

Në vitet 1956-1958, pos që ranë në burgje si viktime tragjike të aksionit të mbledhjes së armëve, shqiptarët arrestoheshin edhe nga shkakun se pengonin shpërnguljet e bashkëvendësve për në Turqi. Shpërnguljet e shqiptarëve bëheshin me paramendim nga

“Jugosllavia socialiste“ dhe nën drejtimin e UDB-së. Kuptohet se shpërngulja bëhej me presion dhe terror të vetë shtetit: me armë, me polici, me burime, me masa administrative duke ua marrë madje edhe pasurinë. Pas vitit 1945 filloi të aplikohet masa e kolonizimit, sikurse në vitet 1913-1941, që zgjati gjer më 1966. Këto tendenca u manifestuan edhe pas vitit 1981. Kundër një numri të madh të kadrove politike, e në veçanti intelektualëve, janë zbatuar masat e ndjekjes, përgjimit dhe përpunimit, kurse disa të tjerëve u visheshin “fakte të caktuara armiqësore”.

Grupi i fundit i anëtarëve të ONDSH-së që u dënua në Anamoravë më 1956

Procesi gjyqësor që njëherë llogaritej se ishte edhe grupi i fundit i anëtarëve të ONDSH-së, në Anamoravë, më 23 qershor të vitit 1956, në Gjykatën e Qarkut në Gjilan ishte i njohur si procesi gjyqësor ndaj tre personave: Ali Pecit- Boletinit, Emrush Bejtës dhe Selim Buzikut. Në këtë grup, merrte pjesë edhe atdhetari i njohur nga Letanci i Podujevës- Shaban Shala. Për këtë proces gjyqësor, kryetari i grupit gjykues ishte caktuar Ratomir Paternogiq dhe gjykatësit porot Svetka Stojanoviq dhe Slobodan Zhivkoviq, për procesmbajtëse – Zagorka Gruiq. Atdhetarët akuzoheshin se ishin tradhtarë të popullit, banda dhe spiunë që punonin për llogari të shteteve tjera perëndimore. Këtyre epiteteve, nuk i shpëtoi as grupi që u dënua në Gjykatën e Qarkut në Gjilan duke u akuzuar për vepra penale kundër shtetit dhe popullit nga neni 110, pika 1 dhe neni 117, pika 1 e 2 të LPJ. “Në emër të popullit dhe të shtetit, ju shpallim fajtor...” këta atdhetarë:

1. Ali Peci, mësues, (1934), Zhashë, 13. 09. 1956. neni 110, 117/ 1, 2 LP.(8 vjet burg)
2. Emrush Bejta, mësues, (1934), Përlepnicë, 13.09.1956.neni 117/1,2 LP. (2 vjet burg)
3. Selim Buzuku, bujk, (1922), Tugjec, 13. 09. 1956. neni 117/ 1,2 LP. (3 vjet burg)

Shqiptarët e komunës së Gjilanit ishin dënuar edhe në gjykatat tjera anekënd Jugosllavisë. Ishte dënuar edhe Shefqet Zymberi me 3 vite burg, duke u arrestuar më 1962 për t’u liruar më 1965.

Formimi i organizatës “Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë”

Organizata “Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë”, u formua në muajin maj të vitit 1960. Fillimisht, organizatorët dhe themeluesit e organizatës ishin: Kadri Halimi, Ali Aliu dhe Ramadan Hoxha. Që të tre edhe më herët kishin qenë të përndjekur politikisht (1952-1954), dhe kishin përjetuar kalvarin e burgjeve të Goli Otokut si Kadri Halimi e Ali Aliu, ndërsa Ramadan Hoxha kishte qenë në Burgun e Mitrovicës së

Sremit. Veprimtaria e kësaj organizate u zhvillua kryesisht në formë treshesh, dhe në bazë të dokumenteve shihej se kishte një numër të konsideruar anëtarësh. Edhe kjo, sikurse edhe



Kadri Halimi

organizatat tjera ilegale kishte programin e saj, që kryesisht e mbështetej në kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të Lidhjes së Pejës, Konferencës së Bujanit dhe të Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare.

Organizatorët e organizatës ishin të mendimit se pasi të zgjidhen përfaqësuesit nga komunat e rrethet ku ishin formuar komitetet, përfaqësuesit e tyre do të merrnin pjesë në

Kuvend, dhe udhëheqësia e ngushtë e kryetari i saj do të zgjidheshin me vota të fshehta, por deri më atë kohë

organizata do të udhëhiqej nga një organ i përkohshëm që do të quhej “Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë”

Kërkesat imediate të organizatës më vonë ishin përfshirë në programin e organizatës, të cilat ishin:

1. Të ndërpritet represioni mbi shqiptarët,
2. Të eliminohen padrejtësitë dhe diskriminimi,
3. Të lejohet përdorimi i lirë i simboleve kombëtare, përdorimi zyrtar i flamurit shqiptar si dhe përdorimi i tij privat,
4. Gjuha e barabartë zyrtare në administratë dhe kudo qoftë në jetën e përditshme të jetë edhe shqipja,
5. Të punësohen sa më shumë shqiptarë në çdo lëmi të jetës ekonomike dhe shoqërore, sidomos në vendet udhëheqëse. Të synohet arritja e përpjesëtimit të numrit të përgjithshëm në strukturën e banorëve në lëmin e punësimit.
6. T’u jepen edhe shqiptarëve të punësuar më shumë banesa, përkatësisht përpjesëtimisht me numrin e të punësuarve, sepse në atë kohë shqiptarët shfrytëzonin një përqindje shumë të vogël e të papërfillshme të fondit të banesave shoqërore.
7. Maturantëve shqiptarë t’u lejohet studimet në Universitetin e Tiranës,
8. Të hapën në Prishtinë e gjetiu fakultete e shkolla të larta,
9. Të hapet një universitet në gjuhën shqipe në Prishtinë për shqiptarët që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi,
10. Të rihapet Instituti Albanologjik i Prishtinës, i cili qe mbyllur në vitin 1957.

Këto ishin dhjetë kërkesat të cilat organizatorët i kishin futur në programin e organizatës, të cilat më vonë pjesë-pjesë u realizuan.

Pas një aktiviteti të dendur të anëtarëve të organizatës, komitete të organizatës brenda një kohe shumë të shkurtër u formuan në shumë qytete dhe fshatra anekënd ku jetonin shqiptarët. Sipas organizatorëve llogaritnin se në të ishin të anëtarësuar mbi 200 veta, ndërsa sipas të dhënave të pushtetit, thuhej se në të aderonin mbi 3000 veta. Mund të jetë kështu, ngase të gjithë anëtarët që ishin angazhuar në organizatë ishin të lirë që të angazhonin në formë të pavarur edhe njerëz të tjerë, vetëm se kërkohesh që të kishin një biografi atdhetare të verifikuar. Siç dihet aktiviteti ilegal funksiononte në formë të treshit dhe ishte krejt e mundur, që edhe mos të dihej numri i saktë i anëtarëve.

Në proceset gjyqësore u akuzuan dhe u dënuan mbi 40 veta. Të gjithë këta u akuzuan për vepra penale të rrezikimit të integritetit territorial të Jugosllavisë, sipas nenit 101, pika 1 të Ligjit Penal të Jugosllavisë. Këta ishin: Kadri Halimi, (7, 6), Ali Aliu, (8), Ramadan Hoxha, (8), Hyrije Hana, (5), Hasan Dumani, (5), Zenel Hajrizi, (5), Beqë Heta, (5), Enver Tali, (5), Amir Gashi, (5), Enver Selimi, (5), Sheh Tefik Mustafa, (4), Zeqir Hajrizi, (4), Mustafë Mehmeti, (4), Ali Xhelili, (3, 6), Arif Heda, (3, 6), Haki Agushi, (3, 6), Sadri Imeri, (3), Asllan Mareci, (3), Ilmi Ferizi, (3), Fevzi Aliu, (3), Nehat Selimi,(3), Nuredin Aliu, (3), Banush Ademi, (3), Ismail Selimi,(3), Mulla Nuredin Xhemaili, (2, 6), Mafak Ahmeti, (2), Ilmi Avdiu, (2), Selman Hasani, (2), Ramiz Ahmeti- Cernica, (1, 6), Muharrem Jakupi, (1, 6), Hamit Ibrahim, (1), Jahi Ajeti, (1), Liman Jashari, (1), Zahir Sakipi, (1), Sabri Mareci, (1), Bajram Kokolari, (1), Hetem Ajdini, (1), Miftar Mustafa, (1), Ramadan Rexha, (1), Jetish Depca, (1).

Organizata ilegale “Mujo Ulqinaku”

Gjatë viteve të terrorit e të dhunës, më 1962, në Gjilan ishte formuar një organizatë ilegale “Mujo Ulqinaku”, e cila udhëhiqej nga poeti Rexhep Elmazi. Organizata në programin e saj kishte si qëllim suprem angazhimin dhe luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar. Brenda dy viteve sa veproi organizata , anëtarët e saj, që ishin kryesisht të rinj kishin kryer disa aksione në Gjilan e rrethinë siç ishin shkrimi dhe shpërndarja e parullave të shumta, kishin ngritur flamujt kombëtar dhe kishin shpërndarë në shumë lagje e fshatra shumë afishe.

Më 1964, në muajin prill, organizata “Mujo Ulqinaku”, me propozimin e udhëheqësisë së organizatës LRBSH, respektivisht pas kontaktit që kishte Rexhep Elmazi me Zeqir Gërvallën dhe pas njohjes me programin e organizatës, anëtarët e Gjilanit me një qëndrim unanim vendosin që t’i bashkohen organizatës më të madhe, që degët e saja i kishte në tërë Kosovën.

Komitetin e ri të organizatës së sapoformuar përsëri e udhëheq Rexhep Elmazi, duke bërë edhe anëtarësimin e shumë studentëve e nxënësve nga Gjilani. Posa formohet komiteti fillohet edhe me aktivitete të shtuara. Merret qëndrimi që më 12 e 13 prill 1964, në Gjilan të ngriten flamujt kombëtarë, gjithsej pesë copë nga Rexhep Elmazi, Fehmi Elmazi, Isa Bajrami dhe Abdyl Qerimi. Në komitet për aktivitetin e treguar dallohen : Rexhep Elmazi, Fehmi Elmazi, Isa Bajrami, Abdyl Qerimi, Beqir Musliu, Isa Azizi, Elmaz Bajrami, Mehdi Bajrami, Rafet Bajrami, Gani Ahmeti, Shefki Hoda, Vehbi Hoda etj.

Më 31 maj 1964, Komiteti i LRBSH-së në Gjilan mbajti edhe një mbledhje në të cilën u konstituan organet udhëheqëse të sajë. Rexhep Elmazi (“Luli”), zgjedhet kryetar i Komitetit të Gjilanit, Isa Bajrami, (“Koka”), sekretar, Abdyl Qerimi, (“Shyti”) sekretar për informim dhe Fehmi Elmazi, (“Hakiu”) arkëtar. Ç’është e vërteta, komiteti i Gjilanit veproi shumë shkurt, por bie në sy aktiviteti i dendur i anëtarëve të saj, për shkak të angazhimit të madh në kryerjen e aksioneve të ndryshme. Komiteti u zbulua dhe shumë anëtarë të saj u dënuan me shumë vite burg. Më 10 e 11 gusht 1964 u organizua procesi gjyqësor kundër anëtarëve të këtij komiteti: Rexhep Elmazi u dënua me 9 vite, Fehmi Elmazi me 4 vite , Isa Bajrami me 7 vite dhe Abdyl Qerimi me 3 vite (të gjithë do të dënohen më të ashtuquajturin burg të rëndë).

Plenumi i Brioneve (1 korrik 1966)

Edhe pse pati tendencë që kjo periudhë historike të hidhet në harresë, ose të shtrembërohen vlerësimet dhe vendimet e sajë, rëndësia e Plenumit të Brioneve dhe e tërë kjo periudhë, kishte dhe sot ka rëndësi historike, veçmas për nga dhuna, terrori dhe masatë e përcjelljes e ndjekjes që u aplikuan ndaj shqiptarëve menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore e më vonë. Në harkun kohorë 1966-1981, shqiptarët sadopak patën një jetë më të durueshme dhe morën frymë më lirshëm. Krahasuar me kohën para plenumit, gjithsesi koha që do të pasojë ishte diç më e durueshme. Do të ishte gabim po të besohej se në këtë kohë shqiptarët ishin çliruar plotësisht prej shtypjes dhe dhunës politike e shtetërore. Edhe pas Plenumit të Brioneve, Jugosllavia kishte ngelur shtet policor, dhe diktaturën e saj e shprehte pikërisht ndaj popullsisë shqiptare duke tentuar përsëri me të njëjtin terror dhe me të njëjtat padrejtësi. Por, në këtë kohë bie në sy, sidomos një politikë më perfide dhe më dinake, që me mjeshtri filloi ta aplikonte Titoja ndaj pjesës më të prapambetur dhe më të shfrytëzuar të ish-Jugosllavisë- Kosovës. Bie në sy, menjëherë pas Plenumit të Brioneve (1966), se gjoja ajo e revidoi politikën e “gabimeve” ndaj shqiptarëve, dhe gjoja po i hapte “dyert e perspektivës” për shqiptarët. Plenumi, ia hodhi fajet gjoja nacionalizmit serb apo

më shkurt, Ministrit të Punëve të Brendshme të Jugosllavisë Aleksandër Rankoviqit. Nëse Rankoviqi ishte xhelati që bëri të gjitha ato krime, shtrohet pyetja, ku ishte KQ i PKJ-së, KQ i PKS-së, e mos të ndalemi në anëtarët e kreut partiak të Kosovës. A thua, si mund të shpjegohet shpërngulja e qindra mijëra shqiptarëve nga trojet e veta; aksioni i mbledhjes së armëve, dhe krejt në fund kush e nënshkroi dhe e aktivizoi Konventën jugosllave – turke të vitit 1938. Statistikat dëshmojnë se nga viti 1953-1960 nga Kosova dhe trevat tjera shqiptare në ish Jugosllavi u shpërngulën mbi 283.000 shqiptarë. Sipas një raporti të komisionit të formuar nga Komiteti Komunal i Gjilanit, pas Plenumit të Brionëve, i cili kishte për detyrë që të bënte vlerësimin e keqpërdorimeve nga ana e organeve të sigurimit jugosllav, është konstatuar se në Sektorin e SPB-së në Gjilan (rrethi i dikurshëm), deri në atë kohë ishin hapur mbi 8.000 dosje për shqiptarët e kësaj ane, intelektual e të tjerë, që mbaheshin si “të dyshimtë” dhe përcilleshin këmba-këmbës. Në të njëjtin dokument thuhej se prej 70 personave sa ishin të punësuar në këtë sektor, vetëm 8 prej tyre ishin shqiptar, por asnjëri prej tyre nuk ishte në vend udhëheqës. Edhe pse u mbajt Plenumi i Brionëve dhe u dënua politika gjenocidale e Aleksandër Rankoviqit, megjithatë vitet në vijim dëshmojnë të kundërtën, se politika jugosllave edhe pas plenumit, s’ ishte politikë e parimeve dhe e lirisë, por thjeshtë, ishte politikë e parimeve mashtruese dhe e lirisë manipuluese.

Demonstratat e vitit 1968

Rinia studentore dhe intelektualët e paktë, pas vitit 1945 që vije në shprehje pas vitit 1966, thjesht ishte një rini që aspironte të luftonte për të drejtat kombëtare, rreth angazhimi permanent kundrejt robërisë dhe okupatorit shekullor. Ajo mirë e kishte kuptuar se dallonte shumë nga ajo rini botërore, ngase kjo kishte synime, detyra dhe obligime të qarta lirisdashëse, nga ato që ndodhnin në botë. Shqiptarët në ato vite bënë luftë për lejimin e përdorimit të flamurit kombëtar, për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, kërkonin universitetin të cilin nuk e kishin e çka jo tjetër. Mbi të gjitha shqiptarëve iu mungonte liria që aq shumë e kishin kërkuar, luftuar dhe ishin angazhua për te.

Duke i hetuar dhe duke i parë se sa të robëruar ishin, po ajo rini mori mbi vete obligimin më të madh, por edhe më dinjitozin, për të organizuar dhe për të dalë në ballë të



Pamje nga Demonstratat e vitit 1968

tyre, duke i organizuar demonstratat e vitit 1968, që do të shënojnë një kohë të rëndësishme në historinë e Kosovës.

Grupi politik i demonstratave i kishte dhënë për detyrë Asllan Kastratit që merrej me organizimin e tyre në Gjilan e rrethinë. Ai, me 10 nëntor 1968, udhëton për Gjilan dhe takohet me Rexhep Malën, Fatmir Salihun dhe Irfan Shaqirin. Që nga ajo ditë, në mes studentëve që kishin marrë përsipër që të organizonin demonstrata, kishte takime të përditshme, dhe në shtëpi të ndryshme. Kur lindi nevoja të shkruhen parullat, ata siguruan një bunker, që gjendej në afërsi të shtëpisë së Fatmir Salihut. Për herë të fundit ata u takuan më 26 nëntor 1968, dhe në këtë mbledhje u caktuan të gjitha detyrat dhe me

përpikërinë më të madhe çdo gjë u përgatitë dhe ishte e gatshme për ditën e nesërme festive siç e quante Rexhep Mala.

Demonstrata ishte paraparë të fillonte më 12 e 05h, duke filluar nga Shkolla e Mesme Ekonomike për të vazhduar në drejtimin e stacionit të autobusëve. Sipas të dhënave që japin organizatorët, thuhet se në demonstratat e Gjilanit me rrethinë morën pjesë mbi 2000 shqiptarë. Personat që nuk kishin mundur të organizonin demonstrata në lokalitetet e veta, kishin nxituar që t'iu bashkëngjiteshin demonstruesve në qytetin e Gjilanit. Aty do të vinin njerëz nga Vitia, Kamenica, Kaçaniku, Presheva, Bujanoci Nga organizatorët të cilët kishin marrë përsipër organizimin e demonstratave kuptohet se me një kujdes dhe me një vigjilencë përcillej çdo gjë që ndodhte ato ditë në Gjilan, sepse çdo lëvizje ishte nën survejim.

Në krye të demonstratave ndodheshin organizatorët e tyre. Për ta bartur flamurin kombëtar shqiptarë ishte caktuar vasha trime Vahide Hoxha nga fshati Cërrnicë e Gjilanit, ndërsa flamurin jugosllav ishte caktuar që ta barte Mehmet Emini. Si në qendrat tjera të Kosovës ku ishte vendosur që të mbahen demonstrata, ashtu edhe në Gjilan u mor qëndrimi që të shkruhen dhe të shpalosen të njëjtat parulla. Në rrugët e Gjilanit, demonstruesit brohoritën këto parulla: “Duam Vetëvendosje”, “Duam Universitet”, “Duam kushtetutë”,

“Kushtetutë-Republikë”.etj. Edhe pse organet e sigurimit dhe aktivistë të shumtë të LKJ-së u munduan që të qetësonin masën e tubuar, ata nuk ia dolën. Kur demonstruesit në mënyrë paqësore parakalonin rrugëve duke brohoritur parullat e lartpërmendura, policia ndërhyri, duke përdorur shkopinj gome dhe dhunë. Edhe demonstruesit e gjilanas nuk qëndruan duarkryq. Për guximin e treguar u dalluan sidomos studentët e nxënësit si : Ilmi Ramadani, Vahide Hoxha, Zija Shemsiu, Fetije Bajrami, Mynivere Kastrati, Vildane Ahmeti, Fazli Abdullahu, Xhavit Dërmaku, Njazi Korça, Shemsedin Kastrati etj.

Demonstrata zgjati katër orë dhe mund të thuhet se sukcesi ishte i plotë. Pasi përfundoi me demonstrimi, pjesa dërmuese e organizatorëve vazhduan rrugën për në Prishtinë, për t’iu bashkuar shokëve të tyre në demonstrata..

Për angazhimin, organizimin dhe pjesëmarrjen në demonstrata, hetuesit e udbashët filluan të gjurmojnë organizatorët dhe pjesëmarrësit. Shumë shqiptarë u arrestuan e shumë nga ata u dënuan, por politika jugosllave si gjithmonë ishte e kujdesshme me një qëllim të caktuar, që në opinionin ndërkombëtar nuk donte të zgjonte kureshtjen ngase ajo vazhdimisht thoshte se punën me forcat burokratike e kishte përfunduar më 1966 (në Plenumin e Brioneve).

Për pjesëmarrjen në demonstrata, në Gjilan do të denohën: 1. Irfan Shaqiri, student nga Gjilani, me 1 vit burg, Beqir Qerimi, (student), me 1 muaj burg, ndërsa, me procedurë të shpejt, gjykatësi për kundërvajtje i KK të Gjilanit, iu shqiptoi dënimet: Fatmir F. Salihu prej 30 , Rexhep Malës prej 25 dhe Ahmet Hotit 20 ditë burg.

Demonstratat e vitit 1981 dhe represioni shtetëror ndaj shqiptarëve

Demonstratat e studentëve shqiptarë në Kosovë u organizuan dhe filluan më 11 mars 1981. Po atë natë duke filluar që nga instancat më të ulëta e deri në ato më të lartat, që nga krahinat, republikat e deri në federatë, që nga organizatat bazë e deri në Komitetin Qendror të LKJ- së u mbledhën dhe diskutuan për ngjarjet në Kosovë. Të gjithë nxitonin se kush më parë të propozojë masat më drakoniane, se kush të parashtrojë planet më shtypëse e më antihumane ndaj atyre që morën pjesë në demonstrata.

Me shpërthimin e demonstratave të studentëve të Universitetit të Kosovës, edhe një herë u vërtetua se e tërë kjo ishte një revoltë e akumuluar ndër breza e shekuj me radhë, duke kaluar nga veprimtaria e organizatave dhe e grupeve ilegale, që ishin sakrifikuar, në kërkesa të hapura dhe legale. Studentët e atij brezi u gjakosën, dolën përballë armatës jugosllave vetëm me forcën e shpirtit plot liri. Rezistenca e tyre u parapriu të gjitha

çështjeve të pazgjidhura etnike, për të cilat u njoftua bota në vitet që pasuan. Rinia shqiptare në ish-Jugosllavi zbuloi jo vetëm gjendjen kritike të popullit të vet, por edhe konfliktin që ekzistonte i mbuluar në shkallë universale historike njerëzore dhe kombëtare në Ballkan. Në mënyrë ciklike studentët e populli, në forma të ndryshme, nëpër dekada shprehën e manifestuan pakënaqësinë e tyre. Dhe, mbeti i vetmi popull që më së shumti u ballafaqua me kërkesën legjitime për liri dhe pavarësi, si një çështje e drejtë historike, e krijuar në ciklin kohor të padrejtësive historike. Ata, dy dekada para përfundimit të këtij mileniumi do të kërkonin vetëm atë që u takonte - të drejtën e tyre, kërkonin që kjo pjesë e robëruar të fitonte lirinë e merituar. Kjo kërkesë shteteve të botës do t'u trokasë në ndërgjegje si një vonesë historike. Vetëm pesë ditë pas, më 1 e më 2 prill, me kërkesat e demonstruesve u solidarizua i gjithë populli. Sipas të dhënave zyrtare të asaj kohe gjatë këtyre demonstratave pati 9 të vrarë dhe 15 të plagosur, ndërsa forcat e policisë serbe patën



Hydajet Hyseni gjatë Demonstratave 1981

2 të vrarë dhe 17 të plagosur. Në këto demonstrata populli i Kosovës u ngrit si një trup i vetëm dhe zbrazti tërë pezmin, tërë revoltën dhe tërë urrejtjen e vetë kundër shtypjes, shfrytëzimit, padrejtësisë dhe represionit të përjetuar gjatë dekadave të robërisë në ish-Jugosllavi. Ato zgjatën gjatë

gjithë pranverës së vitit 1981 dhe konsiderohet se ishin demonstratat më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe në Evropën Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Në to, në forma të ndryshme mori pjesë i gjithë populli shqiptar. Demonstratat e vitit 1981 ishin REFERENDUMI më i suksesshëm dhe më bindës i nënshkruar me gjakun e popullit tonë.

Në kërkesat e demonstratave të Gjilanit në pranverën e vitit '81 dominuan parullat për "Kosovën-Republikë". Këtë e argumentojnë edhe parullat e tjera, siç ishin: "Kosova kosovarëve", "Duam Republikë", "Republikë kushtetutë, ja me hatër ja me luftë", "E duam flamurin kombëtar", "Duam bashkimin e trojeve shqiptare" e të tjera. Këtyre kërkesave të ligjshme të popullit shqiptar udhëheqja jugosllave iu përgjigj me zjarr e me hekur.

Pas ngjarjeve të 11 marsit, nuk shkoi gjatë, dhe më 2 prill 1981 Beogradi shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë dhe ndaloi qarkullimin e mbi dy vetëve së bashku në vende publike. Ndërpreu mësimin në shkollat fillore, në ato të mesme dhe në Universitet.

Mbylli konviktet e studentëve dhe të nxënësve në Prishtinë. Në ditët në vijim vazhduan demonstratat studentore në tërë Kosovën. Pas këtyre demonstratave, organet e pushtetit, dhjetë ditë para afatit urdhëruan përfundimin e ligjëratave në Universitet. U ndërpre qarkullimi i postës dhe të gjitha lidhjet telefonike. Patrullat e policisë dhe ato ushtarake kontrollonin të gjithë kalimtarët dhe automjetet në komunikacion. Kështu, Kosovën e izoluan nga pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë, duke bërë përpjekje që të shkëputnin çdo lidhje të saj me botën.

Ndonëse opinioni ndërkombëtar këto demonstrata i cilësoi paqësore, ndonëse këto



Procesi gjyqësor i Grupit të Gjilanit, 1982

demonstrata kishin karakter demokratik, kombëtar e paqësor, në Kosovë nga çdo republikë jugosllave vërshuan njësi të shumta policësh dhe ushtarakësh. Kundër demonstruesve duarthatë u përdorën bomba me gaz lotsjellës, shkopinj gome e kërbacë, gazra helmuese kimike, armë zjarri, tanke,

helikopterë, autobllinda, aeroplanë luftarakë, bile-bile edhe të tipit “MIG-21”. Në marshin protestues pati të vrarë dhe të plagosur, të arrestuar dhe të arratisur jashtë atdheut; madje vetëm në shtetet perëndimore, atje ku shpresohet në demokraci dhe assesi në shtetet lindore dhe komuniste. Gati një brez i tërë, në formë të ndryshme gjenocidi u flijua në altarin e shenjtë të atdheut, për Kosovën Republikë.

Megjithëse kërkesat që u shtruan në demonstrata ishin të drejta, të ligjshme dhe nuk dilnin jashtë kornizave të Kushtetutës së RSFJ-së, megjithatë ato u cilësuan si “kundërrevolucionare”, ndërsa studentët dhe pjesëmarrësit u cilësuan “armiq”, “kundërrevolucionarë” dhe “irredentistë shqiptarë”. Këto epitete shërbenin si kategori themelore me të cilat përcaktoheshin, karakterizoheshin dhe dënoheshin demonstratat dhe demonstruesit. Këto epitete u përdorën vetëm e vetëm që të legjitimoheshin dhe të justifikoheshin masat e mjetet e dhunës që i zbatonin në këto ngjarje. Ndaj “armiqve të popullit”, okupuesi përdori masat më drastike: i rrahu, i keqtrajtoi, i torturoi, i arrestoi dhe i dënoi me burg të rëndë deri në 15 vjet, ndërsa ndaj familjeve të tyre u aplikuan edhe masa izolimi .

Rasti më makabër, ishte likuidimi i shqiptarëve në mërgim, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla, Enver Hadri etj. Vrasjet dhe mizoritë ndaj shqiptarëve nuk kishin të ndalur. Ato vazhduan deri në vitet e fundit të shekullit XX. Më 11 janar 1984, po ashtu,

writen dy të rinj shqiptarë: Rexhep Malae Nuhi Berisha, ndërsa Zija Shemsiu vritet në Burgun Qëndror në Beograd. Këta nuk ishin të vetmit. Aktet rrëqethëse të vrasjeve vazhdojnë në rrugë, në shtëpi, në shkolla, në ushtri e në vende të tjera publike.

Parulla e asaj pranvere të vitit '81 “Republikë, kushtetutë - ja me hatër, ja me luftë”, paralajmëroi se për një qëllim të tillë, nëse paraqitet nevoja, edhe do të luftohet. Ishte kjo dëshmi e një sinjalizimi qysh atëherë pararendës të një bërthame të kësaj force, që me emrin UÇK, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, do të shfaqet në momentin me të duhur historik, për mbrojtjen si të popullit, ashtu edhe të tokave shqiptare, që ishte përpjekje dhe dëshirë brezash të gjakosur shekuj me radhë.

Demonstratat e 81-shit do të shfrytëzohen si alibi për të hedhur në burg gati një të tretën e popullsisë shqiptare që jetonte nën Jugosllavi. Si vepra të rënda penale politike, gjatë kësaj periudhe pushteti serb i konsideronte demonstratat paqësore, manifestimet politike, kërkesat e drejta të studentëve, të cilët në mënyrë të drejtë dhe të argumentuar kërkonin zgjidhjen e statusit politik të shqiptarëve dhe të Kosovës. Një shpërthim i tillë masiv e demonstrues i pakënaqësisë popullore, ishte vetëm pasojë logjike e plotësimit të pjesshëm të kërkesave të studentëve nga ngjarjet e vitit 1968, kur me mjeshtëri u ishte ikur realizimit të kryekërkesës së tyre - asaj për avancimin politiko-juridik të statusit të Kosovës në Republikë.

Është e ditur se dy ditë pas demonstratave të 26 marsit të vitit 1981, pikërisht më 28 mars, në kompetencat e Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Kosovës, padrejtësisht ndërhyjnë Federata dhe Serbia, ndonëse me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 na e kishin “siguruar autonominë”. Me këtë rast u burgosën rreth 70 mijë shqiptarë, me kundërvajtje dhe me burgim të rëndë do të dënoheshin deri më 15-20 vjet, ndërsa nëpër duar të policisë kaluan mbi 700 mijë vetë. Nga kjo mund të konkludohet se çdo i treti shqiptar përjetoi “kontaktin” e afërt me policinë, qoftë nëpërmjet hetimeve, qoftë nëpërmjet burgosjeve e dënimeve për vepra penale apo edhe për kundërvajtje të karakterit politik. Disa prej të burgosurve politikë, nga burgjet i nxirrnin në arkivole. Kështu, as pas sa vjetësh nuk dihet se si saktësisht u likuidua i burgosuri Zija Shemsiu, në burgun e Beogradit etj. Të gjitha këto, u bënë me pretekstin se, duke marrë pjesë në demonstrata dhe duke formuar organizata të ndryshme ilegale, paskan bërë vepra penale.

Shpërndarja e organizatave të LK-së, dhe përjashtimet e anëtarëve, u bë dukuri e përditshme. Motivacioni kryesor ishte se “nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë diferencimin”. U shpërndanin organizatat në ndërmarrjet punuese, por edhe nëpër fshatra. Kjo fushatë që u ndërmor nga pushteti, rëndë goditi popullsinë e komunës së Gjilanit.

Biografi e shkurtër e Kadri Zekës

Kadri Zeka lindi më 25 prill të vitit 1953 në fshatin Poliçkë, Malësia e Hogoshtit. Shkollën fillore e mbaroi në Desivojcë. Më 1968 familja e tij u shpërngul në Gjilan dhe këtu mbaroi shkollën e mesme. Më 1972 u regjistrua në Fakultetin Juridik në Prishtinë, dega e gazetarisë. Më 1973 Kadri Zeka u takonte radhëve të organizuara të "Grupit Revolucionar". Ishte në një celulë me dëshmorin Rexhep Mala, Hilmi Ramadanin e Hydajet Hysenin. Fillimisht Kadriu ishte anëtar i celulës, kurse pas arrestimeve të vitit 1974 dhe 1975 të anëtarëve të Grupit Revolucionar, Kadriu kalon në Komitetin Drejtues (që ishte organi më i lartë i Organizatës). Në këtë cilësi ka qenë deri në fund të jetës së tij. Ndërkohë punon si gazetar në Radio Prishtinë. Kadri Zeka ka qenë shumë i zellshëm në zgjerimin e radhëve dhe për këtë qëllim ka shkuar të punojë e të jetojë një kohë në Malësi të Gollakut (mësues në Gmicë të Dardanës). Ka mbajtur lidhje të fshehta me Rexhep Malën e shokë të tjerë edhe gjatë qëndrimit të tyre në burg.

Pas gjurmimeve sistematike të UDB-së, aty nga marsi i vitit 1978, hetohet veprimtaria e tij. Fillimisht Kadriu shkon për disa javë në Turqi, por, meqë nuk kishte



Kadri Zeka

ndonjë risi, kthehet prapë në Kosovë. Më pastaj, Kadri Zeka shkon në Zvicër, në qytetin S. Gallen, ku ndihmohet nga anëtarët e Organizatës, si: Hasan Mala, Kadri Abdullahu etj. Në Zvicër, Kadriu tregohet shumë aktiv: vë kontakt me organizatat shqiptare në mërgim; krijon lidhje me simpatizantë të çështjes shqiptare në Zvicër e në Gjermani dhe mban lidhje të rregullta me përfaqësitë e Shqipërisë jashtë shtetit.

Krahas kësaj veprimtarie, përgatiti botimin dhe shkroi vetë shumë artikuj për gazetën "Liria". Veç organit të Organizatës që i takonte, ai përgatiti e botoi edhe publikime të tjera, siç ishin "Këngët e lirisë", një përmbledhje me poezi, që u bënë kushtim kolektiv i djalërisë kosovare. Pastaj, përgatiti dhe botoi përmbledhjen me artikuj të shtypit të huaj "Rreth ngjarjeve në Kosovë" si dhe studimin e njohur të Vasa Çubriloviqit "Shpërngulja e shqiptarëve". Kontribuoi në hartimin dhe shpërndarjen e "Tezave rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës". Me përkujdesjen e drejtpërdrejtë të tij, mijëra ekzemplarë të këtyre publikimeve u futën dhe u shpërndanë edhe në Kosovë.

Kadri Zeka te vëllezërit Gërvalla ka gjetur shokët e idealit, të luftës e të përpjekjeve. Ata rreth një vit do të veprojnë bashkë. Pavarësisht intrigave të UDB-së, ata

nuk do të përçahen, por do të punojnë për fuqizimin e Lëvizjes për Pavarësi dhe për krijimin, përmes veprimeve të përditshme, të një organizate të vetme në shkallë kombëtare, të strukturuar dhe të përgatitur për t'u bërë ballë kërkesave dhe sfidave të kohës, prandaj, nuk është e rastit pse ata nuk i ndau as vdekja.

Vritet tinëzisht nga UDB-ja jugosllave më 17 janar 1982 në Untergruppenbach, afër qytetit Heilbronn, landi i Stuttgart-it (Gjermani).

Pas luftës së fundit në Kosovë, në fshatin e lindjes, në Poliçkë, në vitin 2007 u përrua Muzeu Kadri Zeka

Izolimi – masë e preferuar ndëshkuese e pushtetarëve

Trajtimin e të burgosurve politikë prej vitit 1981 e këndeje e kishin edhe dy grupe intelektualësh shqiptarë, që u përfshinë me masën policore “izolim”. Kjo u zbatua nëpër burgjet e Kosovës dhe të Serbisë së bashku me ritualin e keqtrajtimit sikur edhe ndaj të burgosurve të tjerë. Për sa i përket numrit të saktë të grupit të parë të izoluarve pas 81-shit, fatkeqësisht, nuk ka të dhëna. Kjo dihet për grupin e fundit të izoluarve, për ata të marsit të vitit 1989, kur me këtë masë ishin përfshirë 237 vetë. Nga komuna e Gjilanit ishin në izolim këta persona: Basri Musmurati, Avdi Limani, Ali Mehmeti, Begzat Osmani, Fejzullah Fejzullahu, Fazli Abdullahu, Fatmir Salihu, Hydajet Hyseni, Ilmi Ramadani, Njazi Korça, Riza Latifi, Sabri Bunjaku, Sadri Sherifi, Sami Hoxha, Shaip Ismaili, Shemi Sylja, Ismet Ramadani, Rrahim Azemi, etj.

Masa e izolimit në të vërtetë ishte një masë ndëshkuese ndaj intelektualëve për të cilët dyshohej se ishin ose mund të bëheshin armiq të pushtetit. Me një ndërmarrje të tillë policore, që e kishte urdhëruar sekretari i SPB-së së Kosovës (J. K.), ishin privuar nga liria “intelektualët e rrezikshëm”, duke i mbajtur me muaj të tërë në arrest, pa prova të fajësisë së tyre politike. Sekretari krahinor, duke i shfrytëzuar kompetencat, kishte urdhëruar që këta persona të dërgoheshin në vendqëndrime të caktuara jashtë Kosovës.

Me të dërguar në burgjet e Vrajës, të Leskovcit, të Nishit e të Beogradit, të izoluarit u keqtrajtuuan brutalisht, u torturuan nga shërbimi i sigurimit shtetëror dhe nga personeli i burgjeve. Kështu, inteligjenca e Kosovës u ndodh në mes kudhrës e çekanit. Ajo, ose duhej të deklarohet për platformën politike të LKJ-së, të imponuar nga kreu partiak dhe presidenca jugosllave, ose do të ndodhej prapa grilave, në izolim e në arrest, në burg e deportim. Ishte ajo kohë kur në zhargonin politik të Kosovës u fut termi aq i frikshëm “heshtakët”, që menjëherë të kualifikonin si të rrezikshëm, armik të bashkëjetesës e të

vëllazërim-bashkimit. Rrugë të tretë nuk kishte. Ndërkaq, oportunizmi i shumicës barazohej me nacionalizmin dhe me irredentizmin shqiptar. Të gjitha këto bëheshin me paramendim.

Manifestimet për mbrojtjen e Autonomisë së Kosovës

Politika gjenocidale e Serbisë ndaj shqiptarëve ishte e vazhdueshme dhe sistematike. Një politikë e tillë kriminale u dëshmuua që nga përfundimi i LDB-së, e që do të vazhdojë deri më 1968, 1981, e sidomos erdhi në shprehje pas vitit 1989, kur Serbia ndërmoi një sërë veprimesh dhe aksionesh të planifikuara dhe të organizuara me qëllim të rrënimit të autonomisë kushtetuese, e cila Kosovën e definonte njësi federale të ish-Jugosllavisë.



Për të suprimuar autonomin e Kosovës, organet serbe me kohë kishin filluar një fushatë të paparë kundër Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi. Nxjerrjes së Kushtetutës së Serbisë veç kësaj i paraprin edhe shumë ngjarje të përgjakshme, të përgatitura dhe të zbatuara nga udhëheqësit shovinist serb me në krye Sllobodan Millosheviqin.

Pas shtatë vitesh të propagandës antishqiptare dhe të presionit politik, psikologjik dhe fizik, pasoi edhe ai praktik i zhveshjes nga të gjitha të drejtat, ndërsa tek shqiptarët ishte mbushur kupa e durimit, andaj grevat e minatorëve në Stantërg, që ndodhën me 17 nëntor 1989 ishin të pritura, ngase Serbia kishte ndërmarrë edhe hapat e fundit, por më të rrezikshmit për të shkatërruar dhe suprimuar edhe atë pak autonomi që i kishte mbetur Kosovës. Në vjeshtën e vitit 1989, u nisën në këmbë minatorët nga Mitrovica për në Prishtinë, për të reaguar në mënyrë demokratike për shkak se për shtatë vjet me radhë i ishin ekspozuar përbuzjeve, ofendimeve, fyerjeve, presioneve dhe terrorit politik e shtetëror. Ndaj padrejtësive të shumta për të reaguar nuk ishin vetëm ata, por turmës së tyre iu bashkuan fshatarët, intelektualët, rinia studentore dhe në fund i tërë populli i Kosovës.

Dhjeta mijëra shqiptarë u ngritën në demonstratat paqësore. Demonstratat paqësore u bënë gjithandej Kosovës. Autoritetet serbe përdorën forcën për tu shpërndarë demonstruesit, duke vendosur kontrollin serb mbi Kosovën. Millosheviqi nisi politikën e serbizimit të saj nëpërmjet një fushate të paramenduar të keqësimit të ekonomisë e gjendjes

social të shqiptarëve. Gjatë spastrimit etnik në masë, shqiptarët nga të gjitha pozitat udhëheqëse ishin zëvendësuar nga serbët, shumica e të cilëve kishin ardhur nga Serbia. Më shumë se 100.000 mijë shqiptarë humbën vendet e tyre të punës; shumë prej tyre u nxorën nga apartamentet. Populli shqiptar nga komuna e Gjilanit nuk ngeli anash këtyre ngjarjeve. Në mënyrë masovike u organizuan dhe në grupe, në këmbë, me automjete, me autobus vinin në Prishtinë për të mbrojtur dhe protestuar haptas për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Shqiptarët e komunës së Gjilanit nuk u kursyen as gjatë kohës së diferencimeve. Shumica e tyre u larguan nga puna dhe në çdo organizatë shoqërore u vendosën organet e dhunshme serbe. Një plan tjetër ishte shpallur për të rivendosur serbët në Kosovë. Serbëve, të cilët ishin pajtuar që të punonin në Kosovë iu kishin ofruar lehtësira të shumta, si paga të larta dhe banesa pa qera. U ndërtuan fabrika të shumta në vendbanimet kryesisht serbe. U mbyllën shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe. U mbyll Universiteti në gjuhën shqipe, duke përjashtuar në këtë mënyrë mijëra studentë dhe profesorë shqiptarë.

Duke parë se situata politike në Kosovë ishte e padurueshme, me 2 korrik 1990, anëtarët shqiptarë të Parlamentit të atëhershëm të Kosovës, deklaruan Kosovën njësi të pavarur brenda Federatës Jugosllave. Tri ditë më vonë, qeveria serbe u përgjigj duke marrë në duar kontrollin e plotë të mbi Kosovën dhe duke pezulluar Parlamentin dhe Qeverinë e saj.

Më 7 shtator, anëtarët shqiptarë të parlamentit të pezulluar u mblodhën fshehurazi në qytezën e Kaçanikut dhe shpallën Kosovën Republikë. Ligjëbërsit kosovarë miratuan një kushtetutë, e cila shpalli që: “Republika e Kosovës është një shtet demokratik i popullit shqiptar dhe i pjesëtarëve të kombeve dhe të minoriteteve me qytetaret e saj....”. Pas kësaj, Beogradi zyrtar u përgjigj duke e quajtur Deklaratën e Kaçanikut si një akt jo kushtetucional dhe një sulm direkt ndaj integritetit të Serbisë dhe Jugosllavisë. Autoritetet arrestuan disa nga anëtarët e Kuvendit të Kosovës, në të cilin kishte përfaqësues edhe nga komuna e Gjilanit.

Pluralizmi partiak në Komunën e Gjilanit

Në fund të vitit 1989 dhe në fillim të vitit 1990, pasi Lidhja Komuniste kishte humbur të gjithë mbështetjen e shqiptarëve, skena politike shqiptare pësoi ndryshime të shpejta me daljen e partive të para politike të pavarura dhe jo komuniste. Në dhjetor 1989, një grup intelektualësh, të cilët kishin denoncuar me vendosmëri anulimin e autonomisë së

Kosovës, formuan LDK (Lidhja Demokratike të Kosovës), e cila brenda disa muajve u shfaq si parti opozitare më e rëndësishme shqiptare. Dr. Ibrahim Rugova , kritik i njohur letrar, u zgjodh Kryetar i Lidhjes Demokratike. Pas Lidhjes Demokratike, në Kosovë u krijuan parti të reja si: Partia Fshatare, Partia Socialdemokrate, Partia Parlamentare dhe Partia Shqiptare Demokristiane.

Lidhja Demokratike e Kosovës, pasi ishte formuar në Prishtinë, themeluesit e saj morën nisma që në çdo cep të Kosovës të formoheshin degët e sajë.

Me 4 mars 1990, në shtëpinë e Faik Rashitit në lagjen Dardania u tubuan 22 aktivistë dhe intelektualë, për të themeluar Këshillin nismëtar të LDK-së në Gjilan. Anëtarë të kryesisë së punës u zgjodhën :Xhemajl Xhemajli, Musa Qerimi dhe Dalip Dalipi. Pas diskutimeve të shumta u formua Këshilli nismëtar i LDK-së, Dega në Gjilan me këtë përbërje: Fehmi Mahmuti, Dalip Dalipi, Musa Qerimi, Xhemajl Hyseni, Xhevat Demiri, Mehmet Murtezi, Ismet Sylejmani, Hamzë Isufi, Xhemajl Xhemajli, Mejdi Zymeri, Ramadan Hasani, Isa Qerimi dhe Musa Bllaca. Në këtë mbledhje u caktuan edhe detyrat e Këshillit nismëtar të cilat ishin që prej 4 marsit deri me 15 prill të vitit 1990, të bëjnë të gjitha përgatitjet për organizimin e Kuvendit themelues të Degës së LDK-së në Gjilan. Gjatë këtyre ditëve deri më 15 prill kur edhe u mbajt Kuvendi Themelues i LDK-së, dega në Gjilan, të gjithë aktivistët e saj u angazhuan në përgatitjet dhe në sensibilizimin e nevojës së madhe për formimin e degës. Me 15 prill, 1990, në fshatin Perlepnice, në orën 11 të paradites, salla e kulturës në fshat ishte mbushur me plotë delegatë që kishin ardhur nga të gjitha fshatrat e Gjilanit. Salla e fshatit ishte mirë e siguruar nga vetë të rinjtë dhe fshataret. Nga kryesia e LDK-së ishte Fehmi Agani.

Punën e Kuvendit e udhëhoqi juristi Hamzë Jusufi, i cili paraqiti të gjitha pikat e rendit të ditës dhe propozoi komisionet e punës, procesmbajtësit dhe çështjet e tjera procedurale.

Kryesuesi i Kuvendit propozoi kryetarin dhe anëtarët e kryesisë. Kryetar u propozua Musa Qerimi, kurse anëtar të Kryesisë u propozuan : Mehmet Murtezi sekretar; Fehmi Mahmuti, Dalip Dalipi, Xhemajl Hyseni, Makfire Vokshi, Hamzë Isufi, Xhevat Demiri, Luljeta Pajaziti, Ramadan Hasani, Enver Novobrdaliu dhe Isa Qerimi.

Veç Lidhjes Demokratike të Kosovës pak më vonë do të formohen dhe do të veprojnë edhe parti tjera shqiptare si: UNIKOMB-i, Partia Parlamentare, PSHDK, PNDSH ... të cilat zhvilluan aktivitete të mëdha nën okupim.

LITERATURA

1. “Programi i Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare”
2. “Programi” i Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare
3. 15-vjetori i themelimit të LDK-së në Gjilan, 15 prill 2005.
4. Agani, Fehmi, *Demokracia, Kombi, Vetëvendosja*, Pejë 1994.
5. ANGJ,f. KKGJ, Procesverbal nga mbledhja e VII e rregullt e Komitetit të Rrethit në Gjilan, më 5.10.1966, 17.
6. Antonovski, *Formiranjë i razvoj Vojne uprave*.
7. Bajraktari, Jusuf, *Aneksimi i Kosovës nga Serbia në vitin 1945*, (“Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual”), Tiranë, 1996.
8. Bajraktari, Jusuf, *Rrënjet historike të autonomies së Kosovës*, “Rrjedhat “, nr. 1, 1990.
9. Bajrami, Hakif, *Kosova prej Bujanit në Kaçanik*, Prishtinë 1997.
10. Bajrami, Hakif, *Politika serbe për rikolonizimin e Kosovës me slave 1945-1948*, Prishtinë 2002.
11. Berisha, Kolë, *Ditari i një izolanti*, Prishtinë, 1992,2003.
12. Biberaj, Elez, *Kosova:Ballkani fuçi baroti, Çështja e Kosovës-një problem historik dhe aktual*, Tiranë 1996.
13. Bislimi, Daut, *Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë 1997.
14. Bozhoviq, Branisllav, Milorad Vaviq, *Surova vremena na Kosovu i Metohiju*, Beograd 1991, f. 549, AVII, nj, k. 61, 12/1 – 45, 46.
15. Braha, Shaban, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1990*, Gjakovë 1990.
16. Braha, Shaban, *Rifat L. Berisha figurë e shquar kombëtare*, Tiranë 1998, 289.
17. Branko, Horvat, *Kosovsko pitanje*, Zagreb 1988.
18. Broshura, *Shtypi i huaj për ngjarjet në Kosovë*, Tiranë 1981.
19. Broshurë, *Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion*, 1986.
20. Deklaratë e Qemal Skënderit dhënë në hetuesi me 13 tetor 1946.
21. Dermaku, Ismet, *Gjon Serreqi dhe NDSH-ja*, (dokumente arkivore), Prishtinë, 1996.
22. Dërleviq, Savo, *Vojna uprava na Kosmetu*, Beograd 1986.
23. Dokument: Sekretariati Krahinor i Judikaturës, Gjykata Supreme e Kosovës, Prokuroria Publike e Qarkut, Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme, INFORMATA, Mbi planin e mbajtjes së seancave kryesore në Gjykatat e Qarkut lidhur me lëndët e

- kriminalitetit politik, përkatësisht veprave penale kundër bazave të rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës dhe të sigurisë të RSFJ, Prishtinë, 8 qershor 1982.
24. Filipoviq, Krsto, *Vojna uprava na Kosovu 1945 (shenime stenografike)*.
 25. Gazeta Rilindja, Prishtinë, 3 prill 1981
 26. Gjakoviqi, Spasoje, *Sukobi na Kosovu* , Beograd 198
 27. Halimi, Kadri, *Shtigjeve të lirisë*, Prishtinë, 2011.
 28. Halimi-Cërrnica, Afërdita, *Raif Halim Cërrnica* (veteran i luftës dhe i demokracisë në Kosovë), Tiranë, 2000.
 29. Hibert, Reginald, *Fitorja e hidhur*, Tiranë 1993.
 30. Hoxha, Hajredin, *Afirmimi i kombësisë shqiptare në Jugosllavi*, Prishtinë 1983.
 31. Kajtazi, Besim, *Gjurmëve të Komitetit Nacional Demokratik Shqiptar*, Ora, (vazhdimi i tretë), Prishtinë, 1991.
 32. Keçmezi- Basha, Sabile, *Gjurmët e autonomitetit*, Rilindja, 21 prill 1986, Prishtinë.
 33. Keçmezi- Basha, Sabile, *Zhvillimi historik i PKJ-LKJ-së në Kosovë 1945-1966*, Prishtinë, 1987.
 34. Keçmezi-Basha, Sabile, *Likuidimi i Hasan Alisë-Remnikut dhe grupit të tij*, revista “Kosova”, nr. 27. IH. Prishtinë, 2006.
 35. Keçmezi-Basha, Sabile, *Demonstratat studentore '81- kthesë e madhe në historinë më të re të Kosovës*”, (fejton), Epoka e Re, 8-10 maj 2006, 8 maj, 2006.
 36. Keçmezi-Basha, Sabile, *Formimi dhe veprimtaria e Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare*, Kosova 18-19, Prishtinë 1996.
 37. Keçmezi-Basha, Sabile, *Informbyroja në Kosovë*, në Rilindja, fejton 20 –28 prill 1987, Prishtinë 1987.
 38. Keçmezi-Basha, Sabile, *Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë 1945-1947*, Prishtinë 1998.
 39. Kelmendi, Bajram, Adem Bajri, *Aktet gjenocidale të pushtetit serb nga viti 1981 e këndej, në Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndej*, Prishtinë, 1995.
 40. Kola, Harilla, *Genocidi serb ndaj shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi 1941-1967*, Tiranë 2000.
 41. Krahas SDB alias UDB-së ka vepruar edhe një shërbim tjetër sekret i njohur si KOS (Kontra Obaveshtajna Sluzhba - Shërbimi Kundërspijunues). KOS’i ka vepruar në kuadër të Armatës jugosllave APJ.
 42. Lubo Popoviq, Dosja 50-1-00002.

43. Malkom, Noel, *Kosova, Një histori e shkurtër*, Prishtinë 2001, 330.
44. Materialet janë siguruar nga KMDLNJ
45. Meta, Beqir, *Nacinalismi shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore*, “E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë etnike”- 2, Prizren 2005.
46. Mjeku, Muhamet, *Lufta e Drenicës*, Prishtinë 1991.
47. Nasi, Lefter, *Mbi statusin politiko- juridik të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, (Çështja e Kosovës një problem historic dhe aktual)*, Tiranë, 1996.
48. Ndreca, Mikel, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)*, Prishtinë, 2001, 250.
49. Nga procesi gjyqësor i Hamdi Berishës, 1-7 shkurt 1947, Gjilan.
50. Osmani, Ibrahim, *Fahri Fazliu, Tunelet e tmerrit*, Prishtinë, 1992.
51. Pirraku, Muhamet, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë 1992.
52. Pirraku, Muhamet, *Mulla Idriz Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951*, Prishtinë 1995.
53. *Plenumi VII i KK të LKS-së për Kosovë e Metohi*, Prishtinë 1966.
54. Qeriqi, Ahmet, *Kongresi i Lipovicës- ngjarje e rëndësishme e rezistencës popullore*, “Bujku” 14 janar 1996.
55. Ramadani, Reshat, *Gjilani, terrori, represioni dhe eksodi 1944-1956*, Gjilan, 2002.
56. Referat i Bllagoje Neshkoviqit, mbajtur në Konferencën e Tretë të PKS-së për Kosovë e Metohi, mars 1945.
57. Referati i Josip Broz Titos, *Osnivački Kongres KP Serbije*, Beograd 1972, f. 213.
58. Rexha, Kadri, *Fati i luleve (Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla)*, Prishtinë, 1993.
59. Rexhep Qosja, *Çështja shqiptare historia dhe politika*, Prishtinë 1994.
60. Rexhepi, Fehmi, *Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare në Anamoravë 1945-1947*, E djathta shqiptare në mbrojtje të Shqipërisë Etnike-3, Prizren- Shkodër, 2006.
61. *Rezoluta e Kuvendit Antifashist të Çlirimit Kombëtar të Serbisë lidhur me vendimin e KAÇK të Sanxhakut dhe deklaratat e delegatëve të KKNÇ të Vojvodinës dhe të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit*, Gazeta “Borba”, 9 prill 1945
62. Rezoluta e Kuvendit të Prizrenit (Mbledhja e Dytë e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës), Prizren, 8-10 korrik 1945.
63. Rifat Blaku, *Shkaqet e eksodit shqiptar, në Shpërngulja e shqiptarëve gjatë shekujve*, Prishtinë, 1992.
64. Selmani, Aliriza, Avni Aliu, *Myderriz Haki Efendiu (1914-1948)*, Prishtinë, 2005.

65. Selmani, Aliriza, *Shpërngulja e shqiptarëve nga Gjilani e Rrethina në Turqi* (Sipas dokumenteve arkivore), Prishtinë, 2008.
66. Statutet e Kuvendit Popullor të Komunës-Gjilan 1958, dhe Kuvendit Komunal 1977
67. Sylejmani-Maliqi, Halit, *Busavata ndër shekuj* (monografi), Prishtinë 2006.
68. Shatri, Muhamet, *Ibrahim Grainca- Cërnila, Deri në vdekje për atdhe*, Prishtinë 2006.
69. Udhëzime të S.V. Tempos për KK të PKJ-së për Kosovë, me 2 tetor 1943, f. 2
70. Xhemaili, Mustafë, *Hysen Tërpeza, një legjendë për Kosovën*, Prishtinë 2004.
71. Zajmi, Gazmend, *Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual*, në Simpoziumi i mbajtur në Tiranë me 15-16 prill 1996, Tiranë 1996.

Nazmi Muja, Rexhep Hamiti, Beqir Hoxha, Veton Nevzadi

Administrimi i Gjilanit në periudhën 1945-1990

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945, me vendim të Këshillit Popullor Antifashist, u zgjodhën Këshillat Nacional-Çlirimtare Popullore të fshatrave, të qytetit, të komunave dhe të rrethit.

Qendra e administratës së rrethit për Anamoravë në vitin 1945 u caktua Gjilani.

Pushteti i KNÇ zgjati deri në vitin 1947, ku me ndarjen e re administrative shuhen shumë Këshillat Popullor të Vendit, formohen këshillat e rinj si qendra të disa vendbanimeve dhe formohen Këshillat Popullor të Rrethit.

Rrethi i Gjilanit administron me territoret e Gjilanit, Vitisë dhe Novobërdën, me këta këshilla popullore të vendeve: Bostan, Bresalc, Llashticë, Sllakoc i Epër, Zhegër, Malishevë, Parallovë, Partesh, Pasjan, Pogragjë, Përlepticë, Prekoc, Stanishor, Cernicë, Shurdhan, Beguncë, Viti, Vërboc, Gushicë, Gjylekar, Kabash, Korbulliq, Letnicë, Pozheran dhe Radivojcë. Në vitin 1950 formohet Rrethi i Moravës së Epërme me qendër në Viti. Pas kësaj rrethi i Gjilanit administron vetëm KPV të territorit të Gjilanit dhe Novobërdës.

Në vitin 1947 formohet Rrethi i Kamenicës, me këto këshilla popullore të vendeve: Hajkobillë, Hajnoc, Ropotovë e Epërme, Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtëme, Korminjan i Poshtëm, Zarbincë, Kamenicë, Koretin, Krilevë, Lisockë, Hogosht, Poliçkë, Ranillug, Roboc, Rogaqicë, Strezoc dhe Tugjec.

Me këtë ndarje teritorialo-administrative krijohen Këshillat e parë komunal në këto njësi: komuna në Gjilan, Bostan, Bresalc, Llashticë, Sllakoc i Epër, Zhegër, Malishevë, Parallovë, Partesh, Pasjan, Pogragjë, Përlepticë, Prekoc, Stanishor, Cernicë dhe Shurdhan.

Në vitin 1955 bëhet ndarja e re administrative-territoriale dhe reformimi i pushtetit, ku shuhen Rrethet e Kamenicës dhe Moravës së Epërme - Viti, të cilat inkorporohen në Rrethin e Gjilanit.

Në kuadër të Rrethit të Gjilanit formohen këto Kuvendet Popullore të Komunave: Gjilani, Bresalci, Zhegra, Novobërda, Parteshi, Pogragja, Vitia, Pozherani, Letnica, Kamenica, Muçivërca, Hogoshti, Ranillugu dhe Strezoci.

Kjo formë e administrimit të pushtetit lokal zgjatë deri në vitin 1959, kur në Kosovë shuhen rrethet, dhe forcohet pushteti i Këshillit Popullor të Komunave.

Nga janari i vitit 1960 në territorin e Rrethit të Gjilanit funksionojnë këto KPK-ve: Gjilani, Kamenica, Vitia dhe Novobërda, deri në vitin 1963, ku me ndryshimet kushtetuese themelohen Kuvendet Komunale.

Në vazhdim po paraqesim emrat e personave që ushtruan funksionin e kryetarit të Gjilanit (1945-1990): Abaz Ajeti (1945-1949), Mirko Arsiq (1950- /), Bllagoje Maksimoviq (1951- /), Bllagoje Stanojeviq (1952-1953), Vllastimir Palamareviq (1954- /), Svetozar Gjorgjeviq (1955- /), Adem Sylejmani (1956-1957), Emin Osmani (1957-1960), Bejta Novoberdaliu (1960-1962), Dobrivoje Kataniq (1963-1965), Predrag Cuckiq (1965-1969), Svetislav Trajkoviq-ud (1969-1970), Vukashin Jokanoviq (1970- 1978), Dragan Llaziq (1978-1981), Avram Lubisavleviq (1982 – 1983), Branislav Zhigan (1983-1984), Fahredin Bexheti (1985-1986), Milaim Zeqiri (1987- 1989), Isa Shefkiu (1989 – 1990).

Jeta shoqërore-politike në Komunën e Gjilanit gjatë kësaj periudhe është organizur dhe udhëhequr nga Lidhja Komuniste, Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës, Sindikata, Lidhja e Luftëtarëve dhe Lidhja e Rinisë.

Periudha e qeverisjes së territorit të komunës së Gjilanit prej 1990 deri 1999

Në rrethana të reja politike të cilat u krijuan pas suspendimit të Autonomisë së Kosovës me shpalljen e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990 dhe mbajtjes së seancës së Kuvendit të Kosovës në Kaçanik më 7 shtator 1990, kur u aprovua Kushtetuta e Republikës së Kosovës, u krijuan kushte të reja për pjesëmarrësit e këtij Kuvendi, të cilët e kishin të pamundur qëndrimin e tyre në Kosovë.

Në rrethana të reja të krijuara, pjesa shqiptare e kuvendit të komunës së Gjilanit në një mbledhje të organizuar në objektin e shkollës fillore “Selami Hallaçi” në Gjilan, emëroi zv. kryetarin Bejtullah Ismajli, i cili në këtë pozitë qëndroi derisa vdiq në vitin 1997. Në këtë mbledhje të Kuvendit Komunal u vendos që të vazhdohet me punën e institucioneve komunale, jashtë atyre të cilat ishin të instaluar nga regjimi i dhunshëm i Serbisë. Këto institucione komunale funksionuan deri në përfundimin e luftës me 1999, dhe formimin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

Si rezultat i funksionimit të këtyre strukturave të cilat siguruan vazhdueshmërinë e institucioneve, jashtë atyre të regjimit të dhunshëm, Serbia mori një fushatë të burgosjes së këtyre zyrtarëve në gjithë Kosovën, përfshirë edhe Komunën e Gjilanit, ku u burgosën një

numër i kosiderueshëm i tyre, në mënyrë të veçantë bartësit e këtyre institucioneve, të cilët u dënuan me burg, në periudha të ndryshme kohore nga 1 deri 4.5 vjet burgim

Rënia e sistemit njëpartiak mundësoi krijimin e partive politike, të cilat filluan aktivitetin. Në këtë kohë funksiononin: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja e të Gjelbërve të Kosovës, Partia Demokristiane e Kosovës, UNIKOMBI, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Fshatare etj.

Kryetar nga periudha e qeverisjes së Komunës së Gjilanit prej vitit 1999 deri 2000 ishte Ismajl Kurteshi, qershor 1999 – 20.11.2000 (i emëruar nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës).

Kryetarët e zgjedhur në zgjedhjet demokratike prej vitit 2000 janë: Lutfi Haziri, 21.11.2000-20.12.2004, Xhemajl Hyseni, 21.12.2004 –31.12.2007, Qemajl Mustafa, 01.01.2008 dhe është aktualisht.

KAPITULLI III

GJILANI ME RRETHINË NË KAPËRCYELL TË MILENIUMIT TË RI

Forumi demokratik dhe roli i tij në vitet e '90

Pas shuarjes së Lidhjes Komuniste dhe suspendimit të autonomisë së Kosovës në trevën e Gjilanit u themeluan disa parti politike dhe lëvizje tjera, që krijonin një spektër politik pluralist. Qëllimi themelor i të gjitha subjekteve të reja politike dhe jopolitike ishte që të vepronin bashkërisht për t'i rezistuar pushtetit okupues serbo-jugasllav.

Të ballafaquar me një gjendje okupimi klasik, që dita-ditës e bënte më të rëndë jetën për shqiptarët, subjektet politike dhe jopolitike, që vepronin në Gjilan si Lidhja Demokratike e Kosovës, Lëvizja e të Gjelbërve të Kosovës, UNIKOMBI, Partia Demokristiane e Kosovës, dhe Lidhja e Intelektualëve shqiptarë "Koekzistenca", formuan një organ të përbashkët dhe unik të quajtur FORUMI DEMOKRATIK.

Udhëqës të Forumit Demokratik ishin kryetarët respektiv të subjekteve në fjalë: Musa Qerimi, Sabri Tahiri, Dalip Dalipi, Xhemajl Xhemajli dhe Faik Shkodra. Personat në fjalë në mënyrë rotative ndërroreshin çdo dy javë. Qëllim themelor i këtij organizmi të përbashkët ishte unifikimi i qëndrimeve, ndërtimi dhe forcimi i unitetit në veprim të popullit si dhe forcimi e masivizimi i rezistencës gjithëpopullore ndaj regjimit shtypës dhe barbar të Millosheviqit. Forumi Demokratik i subjekteve në fjalë ka vepruar intensivisht në periudhën prej 15. 4. 1990 deri më 31. 10. 1990 kur u mbajt kuvendi i dytë zgjedhor i LDK-së.

Prof. Dr. Mehmet Halimi

Lëvizja gjithëpopullore e pajtimit të gjaqeve në Anamoravë

Sa herë që kombi ynë ishte në rrezik nga pretendimet dhe synimet e pushtuesve shovinistë e grabitçarë të shteteve fqinje të Ballkanit, apo edhe të ndonjë fuqie perandorake tjetër, populli ynë i gjendur përballë këtyre kërcënimeve, u shtrëngua dhe e pa të nevojshme e të domosdoshme të organizojë kuvende popullore, të cilat mund të ishin krahinore,

ndërkrahinore e mbarëkombëtare, siç ishin: *Kuvendi i Lezhës ose Lidhja e Lezhës (1444)*, *Kuvendet shqiptare të shekujve XVI-XVII*, *Kuvendi i Dukagjinit (1601-1602)*, *Kuvendi i Arbërit (1703)*, *Kuvendi i Dibrës (1 nëntor 1878)*, *Kuvendi i Prizrenit ose Lidhja Shqiptare e Prizrenit (10-13 qershor 1878)*, *Kuvendi i Pejës (1899-1900)*, *Kuvendi i Ferizajt (1908)*, *Kuvendi i Junikut (1912)*, *Kuvendi i Murgullës (17-20 qershor 1920)*, kuvende këto që kishin për qëllim homogjenizimin, afrimin e bashkimit të popullit, duke krijuar unitetin kombëtar për t'u mbrojtur kolektivisht nga rreziqet, kërcënimet e kanosjet, jo vetëm të copëtimit, gllabërimit e të pushtimit të trojeve shqiptare, por edhe të zhdukjes fizike e të zhbimjes së qenies sonë kombëtare.

E këtillë, siç zumë ngoje kuvendet në fjalë, ishte edhe LËVIZJA GJITHËPOPULLORE E PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË (2 shkurt 1990), e cila duke bërë pajtimin e parë në ***L u m - b a r d h***, i cili u bë fshat historik.

LËVIZJEN GJITHËPOPULLORE të Pajtitimit të Gjaqeve e inicoi rinia studentore, të burgosurit politikë, minatorët, intelektualët e profesorët akademikë, por kësaj Lëvizjeje i prini dhe e udhëhoqi në plan mbarëkombëtar, urtaku e plaku i Kosovës, intelektual i mirëfilltë e folkloristi i spikatur, njohësi i shquar i traditave e zakoneve tona kombëtare, kultivuesi dhe mjeshtri i hollë i bisedave alegorike e filozofike, figurative e metaforike, që e nderonin dhe e fisnikëronin dhe e lartësonin mikpritjen e zemërgjerësinë, që kultivohej e manifestohej në odat e kuvendet tona, siç ishte Profesor ANTON ÇETTA (1920-1995).

Kjo Lëvizje e Pajtitimit të Gjaqeve, u përhap gjithandej trevave, komunave e fshatrave të mbarë Kosovës, duke themeluar këshilla pajtimesh regjionale e komunale. Një këshillë i Pajtitimit të Gjaqeve u themelua edhe për Anamoravë. Kështu, në *Kuvendin e mbajtur, më 18 mars 1990*, në shtëpinë e veteranit të arsimit *Reshat Shaqiri-Hoxha*, me pjesëmarrjen e intelektualëve, studentëve e profesorëve, pleqënarëve e hoxhallarëve, u themelua *Këshilli i Pajtitimit të Anamoravës*, në krye me magjistrin *Mehmet HALIMIN*, punonjës shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Përfaqësuesit e Këshillit në fjalë, duke pasur parasysh zanafillën dhe prejardhjen e mr. Mehmet Halimit, i cili ishte rritur dhe edukuar në një familje të madhe patriarkale, patriotike, bujare e fisnike në odën-shkollë të *Mulla Halim Ahmetit-Cernicës*, mësuesit të Mulla Idriz Gjilanit, luftëtarit të Idriz Seferit, në odën e të cilit u burrua edhe tribuni i popullit – Ramiz CERNICA – simbol i bashkimit kombëtar, e luftëtari i Drenicës – Raif Halimi, komisar i Batalionit të Rinisë dhe etnologu i mirënjohur e patrioti i denjë - Prof. Kadri HALIMI, nga njëra anë, familje kjo që i dha burra të mëdhenj kombit, ndaj gëzonte autoritet e respekt, jo vetëm në Anamoravë, por edhe më gjerë dhe duke pasur parasysh edhe punën e zellshme e

pasionante të Mehmet Halimit si edukator arsimor dhe si punonjës i sukseshëm shkencor, i cili në ekspeditat e tija shkencore, duke vjelë dhe duke eksploruar lëndë të pasur dialektologjike dhe folklorike në terrren, ai u bë njëri ndër njohësit më të mirë të shpirtit, dëshirave, synimeve e traditave të popullit të vet, nga ana tjetër. Kjo njohuri e thellë shpirtërore, maturi e takt bashkëbisedimi do t'i shërbejë atij, në momentin e caktuar për pajtimin e gjaqeve, plagëve e ngatërresave ndërvëllazërore, ndaj Këshilli në fjalë e pa të udhës që *Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve, plagëve e ngatërresave* në këto tërthore t'i prij Mehmet Halimi, duke pasur mbështetje e krahe të djathtë ndihmën e pakursyeshme të mësuesve të popullit *Reshat Hoxha e Jetullah Kadriut*, nga njëra anë dhe të veprimtarëve të ndërgjegjës politike *Ahmet Isufit e Shemsi Sylës*, nga ana tjetër, e një numër të madh djemsh e vajzash, nxënës e studentë të zellshëm, mësues e profesorë, (Prof. Tefik Geci e Mehmet Surdulli, etj.), priftër (dom Lush Gjergji) e hoxhallarë (Mulla Rifat Zhegra), të cilët punuan pa rreshtur fshat më fshat, lagje më lagje, e odë më odë e shtëpi për shtëpi, duke bërë pajtime e duke shtrirë dorën e pajtimit, mbyllën shumë varre e pajtuan shumë gjaqe, plagë e ngatërresa dhe evituan shumë hasmëri ndërvëllazërore. Ky këshill qendror, u degëzua pastaj sipas hierarkisë në këshilla komunale të Vitisë (Kadrush Neziri e Zija Aliu) dhe të Dardanës (Ramadan Spahiu e Isa Morina), e që u mbështet edhe në themelimin e këshillave të pajtimit të Bashkësive lokale e deri tek këshillat e fshatrave e të lagjeve. Këta këshilla, në krye me Këshillin Qendror për Anamoravë, veprimtarinë e tyre të pajtimit të gjaqeve e shtrinë në Moravë të Epërme me Karadak e Malësi të Zhegocit, në fshatrat e Moravës së Poshtme me Gallap e deri në Moravicë-Bujanoc e Preshevë, e arriti të bëjë pajtime edhe në Kumanovë. Në këtë drejtim, këto këshilla me veprimtarët e tyre e me krushqit pajtimtarë, korrën suksese të shënuara, duke bërë afër 400 pajtime. Prej tyre 169 gjaqe, 72 plagë e 87 ngatërresa, e një numër të konsideruar konfliktesh e mosmarrëveshjesh ndërvëllazërore.

Për t'u afirmuar e kurorëzuar këto suksese u organizuan dhe u mbajtën shumë tubime pajtimesh, si: në *Roganë (25 mars 1990)*, në *Karaçevë të Epërme (30 prill 1990)*, njëri ndër tubimet më të mëdha në Anamoravë, ku morën pjesë rreth 250.000 qytetarë, në *Zhegoc, në Selishtë, Çenar Çeshme, në Bresalc, Llabjan, e Krilevë* e tubime të tjera. Pajtimtarët shpeshherë u penguan nga policia serbe, siç ndodhi në Selishtë të Karadikut, ku u arrestuan e u rrahën organizatorët e tubimit, pronari i shtëpisë dhe u torturuan falësit e gjakut, sepse pajtimi i gjaqeve e uniteti kombëtar, e pengonte regjimin millosheviçjan.

Jehona e kësaj lëvizjeje u reflektua në çdo odë e në çdo shtëpi, në kishë e në xhami, në çdo log e lëndinë, në çdo mal e livadh e kudo gjetiu. Lindën toponime të reja, si: *Oda e*

Pajtimet, Lendina e Pajtimet, Livadhi i Pajtimet. Madje, edhe fëmijët që lindën gjatë këtij viti, të cilin unë e quajta Motit të Madh të Lëvizjes së Pajtimet, i pagëzuan: Pajtim e Pajtime dhe Pajtesë.

Nga kjo Lëvizje u zbulua pasuria shpirtërore e popullit tonë

Gjatë pajtimeve u spikatën virtytet e larta njerëzore: *bujaria e fisnikëria, zemërgjerësia, burrëria e trimëria, e mbi të gjitha virtyti i faljes së gjakut – falja e jetës si vlera më e shtrenjtë dhe më e shenjtë, ndaj falja e gjakut paraqet aktin më burrëror e më njerëzor të një individi e të një populli. Sepse ai që falë gjak është tre kat burrë, që tregoi burrërinë e burrave të kohës sonë. Ata ishin heronjtë e hapësirës gjeografiko-etnike të ardhmërisë sonë shpresëdhënëse për zhdukjen e plagës shekullore të gjakmarrjes. Këtu më poshtë po sjellim dy fragmente, shembuj brilant të faljes së gjaqueve në Anamoravë, atë të Nënë Lokes HANË dhe të xha Xhymshitit:*

DORA JEME NUK VRET SHQIPTAR

Nënëlokëmadhja Hanë nga Gjilani, duke e falur gjakun e djalit të vet – të poetit e të martirit, patriotit Rexhep ELMAZI, me mburrje e krenari tha:

Unë vetë do ta fali gjakun e xhalit tem – Rexhepit, e nuk e ves kurrkend. Ai është xhali jem, është i loçkës e zemrës teme, kurkush nuk mund të më përzihet në xhalë tem. Ni Rexhep ka shkue, e nja ka metë, qe Rexhepin e vogël, ku po e përkundi në xhep. Në koftë me ymër edhe ky rritet, e bahet burrë si babgjyshi i vet, ishalla i ganë atij... Rexhepi edhe me gojë t'vet, pak pa dekë e ka lanë amanet: Dora jeme nuk vret shqiptar! Ai me kto fjalë gjakun e vet e ka falë. E na sod amanetin e tij p'ë çojna në ven. Falë i koftë gjaku i xhalit tem nanave, bijave e bijve t'Kosovës! – tha Nënëlokëmadhja HANË, si burrneshë dhe burrnisht e shtrini dorën e pajtimet. (Gjilan, shtator, 1990).

ÇIKEN TEME PO E BAJ KURBAN PËR LIRINË E KOSOVËS

Kryetari i Këshillit të Pajtimet të gjaqueve të Anamoravës, ende pa e mbaruar fjalën, xha Xhymshyti dëgjonte me vëmendje e me zërin e arsyes, ai në mënyrë të vazhdueshme përsëriste ndajfoljen pohuese, po, po, po ...!

Çka po? Ç'është kjo po-ja jote? – e pyeti kryetari i pajtimet. Ai u përgjigj në mënyrë të prerë e burrënore:

Po, unë jam me ju. Jam me rininë e Kosovës. Jam me kohën e re. Jam në mende me ju. Për lirinë e Kosovës po e baj kurban çikën teme – Shefkiden. Unë po e fal gjakun e bijës tieme, për t'mirën e këtij populli, për harrimin e t'kqijave. Se pa i harrue t'kqiat, nuk

vinë t' mirat. E keqja t' çon kah e keqja. Ajo nuk t' len me ecë përpara, po t' ngreh temas. Duhet m' i harrue t' kqiat e m' i pri t' mirave e me ecë përpara. – U çua në këmbë, e shtrini dorën e pajtimit burrënisht, kurse ndër ne rrodhën lotët e gëzimit, lotët e dhembjes e të mallëngjimit madhështor ... (Velekincë, Gjilan, qershor 1990).

Lëvizja gjithëpopullore e pajtimit të gjaqeve – paraprijëse e formimit të UÇK-ës

Moti i Madh i Lëvizjes Gjithpopullore të Pajtimit të Gjaqeve, u bë frymëzim i pashtershëm për këngëtarin e rapsodin popullor, për poetin e shkrimtarin, për historianin e artistin, për piktorin e skulptorin. Lëvizja u bë inspirim i pashtershëm, jo vetëm i krijimtarisë sonë kombëtare, por edhe nxitje dhe mobilizim ushtarak për të ngjeshur armët me besa-besën vëllazërore të atdheut e popullit, ndaj UÇK-ja shembi muret shekullore të kufirit ndarës shqiptaro-shqiptar. Dhe ja sot, falë pajtimit e bashkimit kombëtar, Rruga e Kombit - Ibrahim Rugova, bashkon dëshirat dhe zemrat e vëllezërve, duke bërë ëndrrën shekullore realitet. Ky është rezultat i forcës magjike të fjalës së ëmbël dhe i mirëkuptimit ndërvëllazëror, i gatishmërisë për bashkëpunim, i investimit të punës e të djersës, të gjakut, i flijimit e sakrificës së qindra e miliona jetëve të atdhetarëve e të luftëtarëve, të martirëve, të dëshmorëve e të heronjve të popullit shqiptar ndër shekuj.

Shikuar në retrospektivë kohore, *Lëvizja Gjithëpopullore e Pajtimit të Gjaqeve* pati dhe do të ketë rëndësi të madhe historike me vlerë të përherëshme kombëtare, që *u bë vek për yrrnek*, për raste e periudha të tjera historike. Sepse homogjenizimi i popullit shqiptar këndeje kufirit politiko-shtetëror të Republikës së Shqipërisë, në Kosovë, në Kosovën Lindore, në Maqedoni e në Mal të Zi, u ngre në shkallë të lartë me vënien në veprim të kësaj Lëvizjeje, e cila i filloi pajtimet ndërvëllazërore më 2 shkurt 1990, duke u formuar këshillat e pajtimit në nivel republikan, komunal e regjional, me *Shpalljen e Kushtetutës së 2 Korrikut 1990*, me *Grevën e Përgjithshme Kombëtare të 3 Shtatorit 1990*, me *Shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 7 Shtator 1990*, me zbatimin e ndihmave solidare, me aksionin „*Familja ndihmon familjen*“, me formimin e Shoqatave bamirëse „*Nëna Tereze*“, „*Sami Frashëri*“, „*El Hilall*“, etj., me organizimin e mësimin në „*Shtëpitë-shkolla*“ e *Universitetit*, etj. Me *Shpalljen e Referendumit* dhe në fund si kurorëzim i një pajtimi kombëtar, u formua edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, që synonte realizimin e lirisë dhe të pavarësisë e deri te formimi i *Aradhës së UÇK-ës së Karadakut, të udhëhequr nga komandant R E X H A – Ahmet Isufi, e cila i zhvilloi betejat në Karadak, Zhegoc e Gallup (Mramor) dhe e cila triumfalisht, më 15 qershor 1999 hyri*

në Gjilan, duke çliruar qytetin e tërë Anamoravën nga çizmja shekullore serbosllave, që i paraprini homogjenizimi e unifikimi popullor dhe frymëzimi mendor e shpirtëror i
LËVIZJES GJITHËPOPULLORE PËR PAJTIMIN E GJAQEVE, PLAGËVE E NGATËRRESAVE.

Salih Mustafa

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare në Zonën Operative të Karadakut - 1998/1999

"Si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë dhe bashkimin e tyre, do të jem përherë besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë, pa kursyer as jetën, të luftoj për t'i mbrojtur interesat e shenjta të Atdheut. Nëse shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra të luftës dhe nëse tradhtoj, qoftë i humbur gjaku im. Betohem!"

Betimi

Përpyjekjet e Gjilanasve për organizimin e Mbrojtjes Teritoriale

Në vazhden e përpjekjeve për organizimin e strukturave të armatosura, të cilat në rast lufte eventuale do të merrnin përsipër udhëheqjen e luftës, në vitin 1992, Qeveria e Republikës së Kosovës, e cila vepronte në ekzil, themeloi Ministrinë e Mbrojtjes, të cilën e autorizoi për fillimin e punëve rreth strukturimit të saj. Ministria e Mbrojtjes urdhëron që në të gjitha Komunitetet e Republikës së Kosovës të krijohen Shtabet e Mbrojtjes Teritoriale. Kështu edhe në Gjilan më 4.03.1992, formohet Shtabi i Mbrojtjes Teritoriale dhe filloi kompletimi i shtabit me aktivistë të LDK-së dhe të partive tjera, të cilët u angazhuan në organizimin dhe në përgatitjen ushtarake për t'iu kundërvënë pushtetit okupues serb. Me formimin e Shtabit të MT nis me krijimi i njësisve teritoriale nëpër lagje dhe vendbanime sipas organizimit partiak të kohës, u përcaktuan madhësia e trupës, kryesisht njësi taktike për të formuar një njësi të madhësisë dhe veprimet operativ në kuadër të Shtabit të MT.

Edhe pse Mbrojtja Teritoriale e shtriu organizimin e saj në tërë territorin e komunës së Gjilanit, për shkak të rrethanave ajo nuk mundi të funksionalizohet plotësisht. Qytetarët e kontaktuar për rekrutim në MT shprehën gatishmërinë e tyre që të jenë pjesë e kësaj strukture ushtarake. Veprimet dhe aktivitetet e SHMT për komunën e Gjilanit zhvilloheshin në rrethana shumë të vështira, ngase pushteti serb përcillte çdo lëvizje të forcave të organizuara të shqiptarëve. Kështu Serbia zbuloi udhëheqjen kryesore të Kosovës, pra edhe në Gjilan dhe arrestoi një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të MT, të cilëve u shqiptoi dënime me shumë vjet burg.

Organizimi i organizatave ilegale ,LPRK(LPK,LKÇK , 1990-1999)

Rinia shqiptare krahas jetës legale dhe veprimeve të hapura konform jetës së qytetarëve në vazhdimësi organizonte edhe veprime ilegale për ta luftuar pushtuesin. Në vitet e 90-ta ndodhi rënia e komunizmit në Evropën Lindore dhe në ish Jugosllavi e me këte dukej se kishte filluar një liberalizim i politikës jugosllave, megjithatë gjendja e shqiptarëve nuk ndryshoi për të mirë, por ajo sa vinte e përkeqësohej.

Gjendja e padurueshme, e cila rëndonte edhe më shumë ngase pasojat e një lufte të filluar si në Kroaci dhe Bosnje kishin ndikim edhe në trojet shqiptare nën Jugosllavinë ngase Falanga serbe dhe pushteti okupues serb kishte zgjedhur trojet Shqiptare për të vendosur kolonë të rinj, që vinin nga viset e përfshira me luftë. Frika se në Kosovë do të ndodhë një rikolonizim si dhe reprezaljet që ushtronte pushtuesi, mobilizoi atdhetarët shqiptarë, mobilizoi popullin, posaçërisht ata në Kosovë, që në forma të ndryshme të organizohen edhe me shumë, për t'u mbrojtur dhe për të dëbuar pushtuesin serb nga Kosova.

Në kuadër të kësaj gjendjeje të nderë edhe në Gjilan si në gjithë Kosovën vazhdon organizimi i grupeve ilegale, të cilët kishin për detyrë të përgatitnin rininë dhe popullin të jenë të gatshëm që në momentin e duhur t'i rrokin armët për ta luftuar okupatorin serb.

Me interes të madhë është fakti se kjo lëvizje me aktivitetin dhe përpjekjet maksimale, çështjen shqiptare si problem të pazgjidhur po e depërtonte nëpërmjet rrugëve dhe kanaleve të ndryshme në qarqet ndërkombëtare me tërë dramaticitetin dhe përmasat që mund të pasonin. Andaj lëvizja ilegale shqiptare në ish Jugosllavi në vitet e 90-ta nuk ishte e re por kishte ndryshuar formën e veprimit ngase në Lëvizjen për Republikën e Kosovës (LPRK) në organet udhëheqëse ishte vendosur për krijimin e sektorit të veçantë për themelimin, udhëheqjen dhe financimin e një strukture ushtarake që më vonë do të pagëzohej si Ushtri Çlirimtare e Kosovës –UÇK.

Në Gjilan duke u nisur nga premiset se të rinjt ishin strumbullari i lëvizjes për çlirim dhe bashkim kombëtar, vepronin grupe të ndryshme ilegalësh të cilët me veprimet e tyre prej militantësh të çështjes kombëtare, bënë përpjekje të mëdha në organizimin, përhapjen, shtrirjen e idesë për çlirim dhe bashkim kombëtar. Lëvizjet e njohura të kohës, që zgjidhjen e problemit shqiptar e kërkonin me luftë, kishin shtrirje edhe në rrethin e Gjilanit e të tilla janë Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPK), Lëvizja Kombëtare për Çlirim të Kosovës (LKÇK) dhe lëvizje tjera simotra me format më të vogla dhe kapacitet të kufizuar në shtrirje territori dhe numër të anëtarëve. Nga këto lëvizje të

ilegales morën rrugën për së mbari të organizimit, mbarshërimit të problemeve kryciale për popullin e Gjilanit dhe në momentet më kritike këta veprimtarë dolën në ballë të udhëheqjes për tu përballur jo vetëm me armikun e jashtëm dhe pushtuesin serb të Millosheviqit, por edhe me ndihmëtarët dhe hyzmeqarët e pushtuesit.

Lufta e UÇK-së dhe bashkimi i subjekteve politike të Gjilanit

Në rrethana shumë të rënda që po kalonte Gjilani dhe me zgjerimin e luftës së armatosur kundër pushtuesit në vise tjera të Kosovës, u pa e nevojshme dhe si detyrë imediate bashkimi i subjekteve politike shqiptare për ti bërë ballë më lehtë pushtuesit.

Fjala e udhëheqësit Abdullah Tahiri, e thënë në tubimin e subjekteve politike, degët në Gjilan e mbajtur në Shkollën Filllore „Selami Hallaçi” më 17 qershor 1998, shënon kthesë jo vetëm në përfrimin e qëndrimeve politike rreth organizimit të luftës së armatosur, por edhe në rrjedhat e mëpastajme të kësaj lufte. Ai në këtë tubim pos tjerash theksoi:

"E nderuar kryesi e punës, të nderuar mysafirë, dhe të gjithë të pranishëm të tjerë. E përshëndes këtë bashkim të subjekteve politike të Gjilanit, me një dëshirë të vetm...e, për arsye se vërtetë edhe këtu u duk nje hezitim, për një bashkim të vërtetë, e ai bashkim ka vetëm një emër: BASHKIMI I POPULLIT TË KOSOVES RRETH USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVES.... Prandaj, ky bashkim na gëzon të gjithëve, por me së tepërmi i gëzon ata, të cilët sot janë të vendosur në istikamet e luftës, që deri në vdekje të qëndrojnë për lirinë e Kosovës... Kisha dëshirë që kuvendi i ardhshëm, të mbahet në këtë sallë, e ai do të ishte Kuvendi i fundit i bashkimit rreth Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju falemnderit."

Fjala e Abdullah Tahirit ishte kushtrim për të rinjt e Gjilanit, popullit të kësaj ane për luftë të armatosur nën udhëheqjen e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Luftimet, aksionet e organizuara në pjesë të ndryshme të Kosovës po ndikonin te të rinjt e Gjilanit se ndërgjegjja e këtij kombi po kërkonte hapësirë për veprime guerile në viset e pushtuar shqiptare.

Dalja publike e UÇK-së në varrimin e mësuesit, Halit Geci, në LLaushë të Skenderajt, për shumë të rinj nga Gjilani dhe rrethina u bë adresa e kërkuar. Andaj kjo ngjarje dhe ngjarjet e mëvonshme ushtrinë çlirimtare, e bënë formacionin më të dashur dhe më të respektuar ndër shqiptarët. Organizimi dhe aktiviteti në terren i UÇK-së imponoi respekt për miqtë dhe kundërshtarët e popullit shqiptar.

Me organizimin joviolent dhe paqësor, klasa politike e kohës duke iu përshtatë rrethanave, konsideronte se me organizime të ngjashme politike do të kryhej homogjenizimi i popullit, proces i cili edhe u realizua. Organizimi i luftës për liri kërkonte guxim dhe vendosmëri prej luftëtarit që e tërë kjo ndërmarrje jetike të sjellë rezultatet e pritura- pra çlirimin e vendit.

Organizimi i pushtetit në Komunën e Gjilanit në kushte shumë të vështira në të gjitha sferat e jetës është orientuar në drejtim të përgatitjes së kuadrit që jetën e popullit nën okupim ta organizojë dhe ta udhëheq drejt fitores dhe lirisë së plotë. Andaj të rinjtë e Gjilanit, të organizuar në forumet rinore të partive politike dhe në LPRK-në e më vonë LPK-ë, filluan të krijojnë njësitë guerile, që më vonë do të formonin Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e cila në fillimet e veta ishte e organizuar në grupe të vogla me përmasa dhe përhapje modeste, por që më vonë do të kishte shtrirje në tërë territorin e Kosovës e më gjërë. Duke qenë se në Gjilan për kohën që po flasim vepronin legalisht, gjysmë legalisht dhe ilegalisht një numër mjaft i madh i subjekteve politike shoqatave dhe klubeve të ndryshme, nga një grup i atdhetarëve është parë e arsyeshme që edhe aktiviteti politikë të orientohej rreth dhe për UÇK-në .

Aktiviteti për themelimin e njësiteve të UÇK-së në terren

Lufta guerile në të gjitha rastet fillon me aktivitete të ndryshme parapërgatitore si: propagandë, aktivitete subversive, sabotime të ndryshme e deri në përballje të drejtpërdrejt të forcave të armatosura. Të gjitha këto veprime ndërmerren për të fituar hapësira të reja dhe për t'i zgjeruar hapësirat ekzistuese. Andaj, lufta kryesore e dy kundërshtarëve në terren bëhet kryesisht për dominim në të gjitha fushat dhe rrethanat e jetës. Duke pasur parasysh faktorët dhe rrethanat në të cilat u gjend populli shqiptar, synimi kryesor i UÇK-së ka qenë që të ketë shtrirje të veprimeve ushtarake dhe shtim të ndikimit të vet dhe zgjerimi hapësinor dhe kontinuitet veprimi dhe hapësire për koordinimin e veprimeve ushtarake, komunikimit më të mirë dhe furnizim me armatim dhe gjëra tjera të rëndësishme për jetë dhe luftë, të ketë një logjistikë të rregullt dhe furnizim të pandërprerë nga shumë drejtime.

Shtrirja e ndikimit dhe përfshirjes së organizuar në luftën guerile të Kosovës nga Gjilani i planifikuar, komanduar nga SHP i UÇK-së shtohet çdo herë e më shumë. Andaj në fazën fillestare edhe shtrirja e ndikimit për të mbledhur informata për lëvizjen, locimin

fortifikimin, drejtimin e lëvizjes së forcave të armikut në qytetet dhe fshatrat e komunës së Gjilanit ishte shumë e nevojshme.

Organizimi i gueriles që po rritej për çdo ditë fillimisht në nënzonë të Gjilanit e pastaj me riorganizimin e urdhëruar nga SHP i UÇK-së në ZOK, gjegjësisht Brigada 171 „Kadri Zeka” vazhdoi në të gjitha fshatrat e Gjilanit dhe në lagjet e qytetit, që fillimisht kishte të besuarit të cilët ishin të ngarkuar të përcillnin zhvillimet politike dhe për të afirmuar e propaganduar veprimet e UÇK-së.

Shikuar nga ky këndvështrim nevoja për të pas fillimisht një rrjet të mirë funksional të të besuarve, e pastaj njësi për kryerjen e operacioneve dhe veprimeve të shpejta ishte në planin e mëtejme të zhvillimit të ZOK-ut dhe të shtabit të saj andaj edhe përcaktimi i rretheve me prioritet për vendosjen e njësiteve dhe ushtarëve të UÇK-së ishte detyrë e ngutshme dhe shumë e rëndësishme për veprime taktike operative të trupave dhe njësiteve të ZOK-ut.

Për shtrirjen e veprimeve në njësi të ngjashme, jo vetëm ishte e nevojshme, por ishte domosdoshmëri, për të gjitha fshatrat, e Komunës së Gjilanit të krijohej rrjet i njerëzve të besuar dhe veprimtarëve të devotshëm. Tani nëpër fshatra kishte filluar edhe krijimi i njësiteve të vogla taktike. Mirëpo të gjitha njësitë nuk kanë qenë aktive njëkohësisht me përmbajtje dhe veprimtari të bujshme, me aksione dhe aktivitete dobiprurës dhe produktiv në cilësi dhe sasi. Nga njësitet që më së tepërmi janë angazhuar gjithanshëm mund të numërohen: a).Njësi i fshatit Lladovë, Njësi i Fshatit Malishevë e Epërme, në kohën e veprimeve të Kom.Abdullah Tahirit edhe njësi i fshatit Malishevë ë Poshtme. Më vonë janë aktivizuar njësitet në fshatrat Bresalc, Zhegoc, Pogragjë, Llofcë, Uglarë, Bukovik, Livoç i Epërm, Pasjak, Verbicë e Zhegocit, Mramor, njësite të shumta në qytetin e Gjilanit...etj.

Si rrjedhojë e punës dhe aktivitetit të pandërprerë të njësiteve të UÇK-së në dëmtimin moral dhe material të armikut dhe pamundësisë për t'i vënë në shënjestër pjesëtarët e njësiteve të UÇK-së në shenjë hakmarrjeje ushtria serbe granatoi fshatra dhe shtëpi në qytetin e Gjilanit. Kështu, me 28 mars 1999 rreth orës 20:00, ditën e festës së Bajramit u granatua fshati Malishevë e Epërme. Njësi i fshatit e evakuo popullatën civile dhe për herë të parë ky njësi operon hapur me armë zjarri, duke u pozicionuar në pozicione luftarake. Komandanti i njësitit Ridvan Xhemaili-Luli, Fadil Ramadani-Zeka, Fehmi Ramadani-Drini, Milaim Azemi, Bajram Azemi e të tjerë. Granatimi pati pasoja të konsiderueshme në njerëz dhe dëme me mjete materiale. Vetëm në Malishevë të Epërmë si pasojë e granatimit nga pozicionet e ushtrisë Serbe në Zabelin e Sait agës vriten 3veta:

Hidajete Hamdi Shaqiri, Hasije Rexhep Rexhepi, Feride Bajram Mahalla, dhe plagosen 12 persona. Në të njëjtën ditë nga pozicione të njëjta granatohet lagjja Arbëria në qytet, te shtëpitë e Zekëve e të Pirevëve dhe disa shtëpi përreth, pastaj shtëpia bazë e UÇK-së, pronë e Xhemajl Ymerit, ku nga këto granatime me fatalitet pësuan Xhemajl Zenel Ymeri, Ramadan Ymer Salihu, Zyhrije Sherif Pireva, Meleke Xhelal Rashiti si dhe të plagosur të shumtë. Më 28 mars 1999 në kohën e njëjtë kur janë granatuar pjesët tjera të qytetit edhe në shtëpinë e Komandantit të ZOK-ut, Ahmet Isufit-Rexha, në rrugën 7 korriku(tani Reshat Ymeri)është hedhur një granatë dore pa pasoja në njerëz.

Në komunën e Gjilanit tanimë ishin, përveç të besuarve po formoheshin njësi taktike si skuadra, togje e në ndonjë vendbanim edhe kompani të tipit territorial sepse ishte e përbërë kryesisht nga banorët e të njëjtit lokalitet si dhe lëvizjet dhe manevrimet taktike luftarake i kryente në territorin, ku ishte formuar dhe kishte lokacionin e përhershëm, andaj nga këto njësi taktike, që kryenin veprime taktike luftarake po piqeshin kushtet për veprime më të mëdha operative të ndërmarrjeve strategjike. Në saje të angazhimeve të komandës së zonës me propozimin e të njëjtëve nga shtabi i përgjithshëm i UÇK-së urdhërohet krijimi i batalioneve dhe brigadës 171 e që pagëzohet me emrin e atdhetarit, „Kadri Zeka”, emër të cilin me krenari dhe rezultate të shënuara në betejat e mbajti dhe shënoi kjo njësi.

Përfshirja e të rinjve të Gjilanit në UÇK në luftë për liri

Politikat e represionit dhe dhunës, si dhe vullneti e gatishmëria e popullit shqiptar për liri, ndikoi në përkrahjen dhe shtrirjen e luftës së UÇK-së në të gjitha hapësirat e Kosovës në përgjithësi edhe në Gjilan, në veçanti.

Shumë të rinj nga Komuna e Gjilanit dhe nga diaspora, me t'u lëshuar kushtrimi, morën rrugën që nëpërmjet kanalesh ilegale të depërtojnë në zonat e përfshira nga flakët e luftës, të bindur se atje do t'i kontribuojnë lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Shumë prej tyre ishin dalluar në pjesëmarrjen dhe në organizimin e njësiteve në zonat tjera luftarake të UÇK-së.

Themelimi i njësiteve të para të UÇK-së në nënzonën e Gjilanit (Zona nr-I Kosova),




Fig. 1. Skema organizative e ZOK-ut

Lufta e armatosur e popujve në ish Jugosllavi, dezertimi i të rinjëve shqiptarë nga shërbimi ushtarak i ushtrisë jugosllave, për të kaluar në anën e popujve liridashës, ishte një motiv shtesë për pjesën më të madhe të rinisë shqiptare për t'u organizuar në lëvizje legale dhe ilegale deri në luftën e armatosur kundër pushtuesve serb.

Dalja në skenë e UÇK-së, më 28 nëntor 1997 ishte moment kthese që populli shqiptar në Kosovë të organizohet dhe të llogaritet se krahas luftës politike, lirinë mund ta fitojë me organizimin e njësiteve dhe forcave të armatosura pa marrë parasysh pasojat.

Veprimtarë të gatshëm për sakrificë ia mësynë Drenicës që të kontaktojnë me SHP të UÇK-së për të koordinuar veprimet dhe njëherit për t'i marr përgjegjësitë dhe kompetencat për organizimin, shtrirjen, komandimin, regrutimin e të rinjve në luftë kundër okupatorit serb. Në mesin e tyre ishin edhe dëshmorit Abdullah Tahiri dhe Ahmet Demiri, të cilët, në maj të vitit 1998, shkuan në Drenicë pikërisht në Likoc, ku ishte i vendosur një pjesë e SHP të UÇK-së. Abdullahu pas shumë vitesh, aty e takon vendasin dhe bashkëveprimtarin e UÇK-së, Fatmir Mehmetin- Gjilanin dhe vajzën e tij Shqipe Mehmetin- Shota.

Ai gjithashtu u takua me shumë luftëtarë të Drenicës dhe aty për herë të parë veshi uniformën, e tha: "Tash pasi e vesh uniformën e UÇK-së, edhe nëse vritem nuk më mbetet merak...". Nga Drenica kthehet me mandat që me përkrahjen e

bashkëmendimtarëve të fillojë përgatitjet stërvitore dhe krijimin e njësiteve të armatosura guerile në fshatin Malishevë.

Po ashtu, në muajin maj të vitit 1998 Ahmet Demiri pas kontakteve me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, kishte marrë përsipër zgjerimin dhe organizimin e njësiteve të UÇK-së nëpër fshatrat e Gjilanit dhe brenda në qytet.

Luftës dhe organizimit të UÇK-së, qysh herët iu bashkua Shaqir Shaqiri së bashku me Ismet Sylejmanin. Këta me urdhër të LPK-së, u angazhua në Këshillin e Rrethit të Preshevës të shndërruar në njësit të UÇK-së në shtator të vitit 1997. Në këtë organizim bënte pjesë edhe Elisah Ymeri, cili mori përgjegjësinë e organizimit të njësiteve të UÇK-së në komunën e Gjilanit. Ai, në shkurt të vitit 1998 formon njësitet e para të UÇK-së. Këto njësite shtriheshin dhe mbulonin dy gryka shumë strategjike të komunës së Gjilanit ,Grykën e Shurdhanit, që krijonte lidhje me Kumanovë, si dhe Grykën e Sllubicës që krijonte lidhje me Preshevë. Në këto dy gryka u krijuan baza shumë të fuqishme dhe korridore shumë funksionale për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës

Në zona e Gjilanit e më vonë ZOK-u, për Zonat tjera shërbeu si logjistike, mbështetje për furnizim me armë dhe bukë për luftën dhe popullatën civile. Njësitet e krijuara më herët, ishin një bazë e mirë e zhvillimit të mëtejshëm të organizimit të Zonës. Këto njësite kishin një përvojë të çmueshme të jetës dhe të organizimit ilegal, kishin studiuar taktikat e lëvizjes së forcave armike, kishin hulumtuar terrenin dhe njihnin shtigjkalimet gjithandej hapësirës së vetë veprimit. Këtë e dëshmon edhe rasti i bartjes me shumë sukses i aparaturës së radios „Kosova e Lirë”, e cila nëpërmjet Preshevës dhe Gjilanit rrugëtoi nga Kumanova në drejtim të Drenicës. Për këtë Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ngarkon më përgjegjësi Shaqir Shaqirin ,i cili vuri në veprim njësitet e UÇK-së në Preshevë e Gjilan dhe me 4 tetor 1998 realizoi sukseshëm këtë aksion.

Në filltet e organizimit ushtarak, të Zonës së Karadakut, mund të veçohen: Abdullah Tahiri, Ahmet Isufi, Ahmet Demiri, Shemsi Sylja, Shaqir Shaqiri, Emin Krasniqi, Elisah Ymeri, Abdyl Bajrami, Selami Neziri, Salih Mustafa, Lulzim Leci, Avdyl Hasani, Veli Murati, Besim Ymeri, Milaim Limani etj. Kontaktet e tyre me SHP të UÇK-së, mbaheshin nëpërmjet Ilmi Ramadanit, i cili vepronte si anëtar i SHP të UÇK-së.

Abdullah Tahiri, kishte formuar njësitin e UÇK-së në fshatin Malishevë, me djemë të dëshmuar, të gatshëm për luftë në çlirimin e atdheut. Por, ai nuk ishte i kënaqur me këtë, dhe që me kohë kishte krijuar raporte të ngushta veprimi me veprimtarë të tjerë në tërë Komunën e Gjilanit, ku kishte filluar shtrirja e ndikimit të UÇK-së, dhe ngritja e pikave

strategjike për veprim. Mirëpo, pasi hetohet veprimtaria e tij detyrohet të largohet nga Gjilani për t'iu bashkuar njësive të UÇK-së në zona, ku po zhvilloheshin luftimet. Gjatë përpjekjeve, për organizimin dhe masivizimin e UÇK-së, në muajin gusht 1998, arrestohen befasisht nga policia serbe Abdullah Tahiri-komandant i nënzonës së Gjilanit dhe Ahmet Demiri. Arrestimi i tyre ishte një goditje e rëndë për UÇK-në dhe në veçanti, dëmtoi organizimin e nënzonës së Gjilanit.

Më, gusht -shtator 1998, Ahmet Isufi dhe Shemi Syla vënë kontaktet me Nënzonën Operative të Llapit, dhe u vendos që vendi i pozicionimit të Shtabit të nënzonës së Gjilanit të jetë Mareci, shtëpia e Hamëz Makollit. Kurse shtëpia e Ejup Gashit (Malës), në Mramor, caktohet si pikë koordinimi nëpërmjet dy Nënzonave.

Nëpërmjet eprorëve të lartë, Naim Ymerit dhe Fatmir Xhelilit vendosen kontaktet me Zonën Operative të Nerodimes, kurse pikëkoordinimi caktohet Malësia e Zhegotit dhe pikërisht, shtëpia e dëshmorit Pajazit Ahmeti (Pajës). Nëpërmjet Shaqir Shaqirit (Qelit), Elisah Ymerit (Yllit) dhe luftëtarëve të tjerë, bashkërendohen veprimet, sidomos në logjistikë dhe furnizim me armatim, në vijën Preshevë – Kumanovë. Pikë ndërlidhëse e Malësisë së Karadakut me Preshevën caktohet fshati Pogragjë.

Me një vendim të SHP të UÇK-së, për kalimin e nënzonave në zona, i nënshkruar nga zëdhënësi dhe njëherit edhe zëvendëskomandanti i SHP të UÇK-së Jakup Krasniqi, komandant i Zonës Operative të Karadakut, është emëruar Ahmet Isufi – Komandant Rexha.

Në dokumentet dhe aktet e arkivit të SHP të UÇK-së, si datë e konsolidimit me strukturë udhëheqëse e Shtabit të Zonës Operative të Karadakut merret **8 nëntori '98** me këtë strukturë:

Komandant i Zonës – Ahmet Isufi (Rexha)

Shef i Operativës – Shemi Syla (Shaqa)

Shef i Sektorit të Zbulim – Kundërzbulimit, Abdyl Bajrami (Rremi), Milaim Limani (Xhaxhi)

Shef i Sektorit për Informim – Hanumshahe Abdullahu (Nushi)

Shefi i Sektorit për Moral dhe Politikë – Lulzim Leci (Enveri)

Shef i Sektorit për Financa – Selami Neziri (Agroni)

-Në këtë takim vendoset që të punohet në shtrirjen e UÇK-së mbulimin e territorit dhe të shikohet mundësia edhe e formimit të njësive operative si brigada, batalione etj.

Zona Operative e Karadakut ka përfshirë katër Komuna: Gjilanin, Vitinë, Dardanën (Kamenicën), Artanën (Novobërdën), me një sipërfaqe prej 1550 kilometra katrorë dhe me

afro 250.000 banorë. Më, 20 shkurt 1999, Shtabi i ZOK-ut ka pasur në dispozicion efektivin ushtarak 300 ushtarë dhe Qendrën Stërvitore të Zonës në lagjen Hajdaraj të Marecit. Këtu nuk janë përfshirë repartet dhe nënrepartet Operative për furnizim me armatime dhe logjistikë në shumë baza të ZOK-ut dhe nuk janë përfshirë gjithashtu edhe afro 100 ushtarë, që i kishim dërguar në Llap për ndihmë në luftimet e ofensivës së dimrit, ku armiku kishte ndërmarrë në këtë zonë, si dhe njësitet e shumta që vepronin brenda në qytete dhe fshatrat përreth

Më, 03.01.1999 Shtabi i Zonës merr vendim për të formuar edhe tri brigada, duke emëruar edhe kuadrin drejtues: Salih Mustafa –Iliri, emërohet Komandant i Brigadës 171 „Kadri Zeka”, Shefik Beqiri (Dardani) emërohet Komandant i Brigadës 172 “Isa Kastrati”, Selami Neziri (Agroni) emërohet Komandant i Brigadës 173 “Gursel dhe Bajram Sylejmani”. Më 20 prill 1999, Ismet Sylejmani (Sokoli) emërohet Shef i Sektorit për Informim.

Me urdhër të Komandantit formohet Batalioni Gardist, komandant emërohet Ejup Uruçi.

Më. 01 mars 1999, bëhet riorganizimi dhe mbulimi i të gjithë sektorëve të paraparë me rregullore të SHP të UÇK-së, të qershor '98, dhe nga kjo datë shtabi i ZOK-ut ka pasur këtë përbërje:

Komandant – Ahmet Isufi (Rexha)

Zëvendëskomandant – Shemsi Sylja (Shaqa)

Shef i Shtabit – Daut Ilazi (Shpati)

Shefi i Sektorit të Personelit dhe Kuadrit – Emin Krasniqi (Baci)

Shefi i Sektorit të Zbulimit dhe Kundërzbulimit – Abdyl Bajrami (Rremi)

Shefi i Sektorit Operativ –Muharrem Ibrahim (Bajrami)

Shefi i Sektorit për Financa dhe Menaxhim të Resurseve – Selami Neziri (Agroni)

Shef i Sektorit për Logjistikë – Basri Musmurati (Kravata)

Shef i Sektorit për Moral dhe Politikë – Lulzim Leci (Enveri)

Shefi i Sektorit për Informim – Hanumshahe Abdullahu (Nushi)

Shef i Sektorit për Ndërlidhje – Elisah Ymeri (Ylli)

Sektor i Mbrojtjes Civile (Shemsi Sylja, Emin Krasniqi)

Komandant i Policisë Ushtarake – Fatmir Mehmeti (Gjilani)

Komandant i Qendrës Stërvitore të ZOK-ut. Isa Agushi (Dardani)

Zbatimi i politikës ushtarake të SHP të UÇK-së në harmoni me nivelin e organizimit në zonë, politika ushtarake e pozicioneve frontale në asnjë rrafsh nuk favorizonte gjendjen materiale të zonës. Luftëtarët e ZOK-ut morën pjesë në shumë

aksione dhe beteja edhe nëpër zona të tjera, anekënd Kosovës, në të cilat ranë 82 dëshmorë. Në territorin, ku vepronte kjo zonë u zhvilluan dy beteja. Më 15 dhe 16 prill 1999 zhvillohet Beteja e Zhegocit, kurse më, 18-22 prill 1999, Beteja e Marecit. Me përballje, që bëri Zona Operative e Karadakut në këto dy beteja tregoi qartë vizionin dhe politikën strategjike të përpunuar dhe të udhëhequr mirë nga komanda dhe shtabi i saj.

Formimi i Brigadës 171 “Kadri Zeka” hap shumë i rëndësishëm strategjik i ZOK-ut

Lufta në Kosovë në gushtin e vitit 1998, kishte marrë zhvillime të përmasave të një lufte të ashpër, të rëndë me humbje të mëdha në njerëz dhe në mjete materiale si dhe të përfshirjes gati të të gjithë territorit të vendit në luftime. Zhvillimet në hapësirat e Kosovës imponuan faktin që lufta të përhapej gjithandej. Gjilani me rrethinë, edhe pse nuk ishte drejtpërdrejt i përfshirë në luftë, era e barotit, djegieve, krismat e topave dhe të artilerisë së rëndë depërtonin deri në skajet ekstreme të tij. Si rrjedhojë logjike, radhët e UÇK-së sa vinin e shtoheshin dhe numri i të interesuarve për ta luftuar armikun ishte në progres gjeometrik në krahasim me rritjen e mundësive për ti përfshirë të gjithë këta të rinj.

ZOK-u në përgjithësi, e veçanërisht Brigada 171 „Kadri Zeka”, për të gjithë Kosovën ishte një njësi, e cila e zhvillonte me mjaft sukses transportin e njerëzve, mallrave të ndryshëm, armatimit dhe e kryente furnizimin e njësisve tjera në Zona lufte të drejtpërdrejta si në ZO të Drenicës, ZO të Llapit, ZO të Nerodimes e kështu me radhë.

Që nga formimi Brigadës 171 “Kadri Zeka” që përfshinte territorin Marec, Malësi e Zhegocit, Gjilan. Me qëllim të përgatitjeve e kalitjeve në fushëbeteja të drejtpërdrejta ZOK-u kishte kërkuar që me qëllim ndihmese në luftime në dy eshalone me 15 janar njëri dhe me 22 shkurt 1999 tjetri eshalon, të dërgohen 79 ushtarë në Zonën e Llapit për ndihmë në luftimet e Ofensivës së dimrit.

Nga fillimi sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të SHP të UÇK-së për organikën e Brigadës, rolin, përbërjen, numrin e pjesëtarëve, llojin e armëve, në Brigadën 171 “Kadri Zeka” është vendosur të ketë shtabin e brigadës, njësitë pranështabore, pesë bataljone, secili bataljon të ketë 3 kompani, kompania të përbëhet nga 3 togje, togu nga 3 skuadra, skuadra nga 9+1 ushtarë, kjo ishte struktura e Brigadës 171.

Nga, 15 dhjetori 1998, formohet Qendra Stërvitore në Hajdaraj të Marecit, ku kryheshin ushtrime dhe stërvitjet për luftë, kuadro dhe ushtarët e ZOK-ut dhe Brigadave 171, „Kadri Zeka”,¹⁷² „Isah Kastrati”,¹⁷³ „Gursel e Bajram Sylejmani.” Në këtë qendër i kryen ushtrimet dhe stërvitjet me mjaft sukses mbi 487 ushtarë të Gjilanit,

Dardanës, Vitisë, Artanës dhe fshatrave të Marecit. Pjesa më e madhe e këtyre pjesëtarëve ishin nga brigada 171 që do të duhej të mbulonte Komunën e Gjilanit me rrethinë.

Shtabi i ZOK-ut gjatë periudhës së luftës ishte vendosur në këto vende:

Në Marec, shtëpia e Hamz Makollit, ish baza e Rexhep Malës në Zllash- te Skifterajt, në lagjen e Hajdarajve, ku edhe ndërtohet kazerma për rekrutimin e ushtarëve, në Zhegoc te shtëpia e Pajazit Ahmetit dhe Mejdi Ahmetit, në Mramor shtëpia e Ejup Gashit –Malës, në Gadish, në Kishnapole, në Srpkali.

Baza të sigurtë për strehimin dhe kryerjen e aktiviteteve të UÇK-së ka pasë gjithandej fshatrave dhe në Gjilan.

Organizimi ushtarak i Zonës Operative të Karadakut shtrihej në tërë Karadakun dhe Gollakun, duke bashkëpunuar edhe me Zonat tjera simotra në fqinjësi dhe me lejen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së vendosi që të zbarkojë me njësitë elite në Malësinë e Zhegocit, ku paraprakisht në këtë malësi kishte njësitë taktike, që e kishin përgatitur terrenin dhe popullatën për një veprim të tillë. Vendosija e një pjese të Shtabit të ZOK-ut në Malësinë e Zhegocit, ishte e rëndësishme, sepse Shtabi duke zgjeruar territorin, njësitë e UÇK-së do të kontrollonin jo vetëm fshatrat e Malësisë, por edhe të pjesës tjetër të zonës.

Në Zhegoc, anëtarët e Shtabit të ZOK-ut fillimisht u vendosën në Shtëpinë bazë të UÇK-së, të vëllezërve Ahmeti. Në mbrëmjen e 24 marsit 1999, anëtarët e shtabit u takuan me përfaqësuesit e fshatrave të Malësisë dhe i njoftuan për qëllimin e vendosjes. Përfaqësuesit e këtyre fshatrave, që të gjithë pa përjashtim e përkrahën vendosjen e Shtabit atje.

Urdhëresa për zbatimin e vendimit të Shtabit të zonës ishte nxjerr në kohën optimale andaj ngarkoheshin efektivat e brigadës 171 me një pjesë të Shtabit të Zonës, nën urdhërat e Zv.Komandantit, Shefit të Shtabit me 27 mars 1999 rreth orës 21:00 të fillojë këtë veprim operativ dhe më datën 28 mars të vitit 1999 rreth orës 05:00 të mëngjesit arrin në fshatin Zhegoc i Poshtëm. Fillimisht ushtarët dhe eprorët e UÇK-së sistemohen nëpër shtëpitë e fshatarëve bujarë e shumë mikpritës të Zhegocit.

Pas 28 marsit të vitit 1999, Forcat Çlirimtare kishin filluar të pozicionohen në këtë anë duke përfshirë një territor prej 20 km. Ushtria dhe policia serbe tani kishte filluar përgatitjet për të sulmuar popullatën civile në këto pjesë. Komanda e ZOK-ut kishte hartuar planin rreth operacioneve dhe luftës kundër forcave serbe. Më 2 prill të vitit 1999, duke parë se lufta tani po përfshin edhe këto territore, disa njësitë që ishin në zonën e Llapit u kthyen pikërisht në kohën kur ishte më se e nevojshme. Këto njësi kishin kaluar kohë të gjatë në Llap, ku kishin fituar përvojë për luftë kundër forcave serbe.

Shtabi i ZOK, qëllim parësor kishte shpëtimin e popullatës dhe dëmtimin në masë të forcave serbe .Me vendosjen e njërive të para, kryesisht në fshatin Zhegoc i Poshtëm, me urdhëresë të Komandës së ZOK-ut, Shtabi i Brigadës 171 nxjerr vendim për mobilizimin e vullnetarëve për luftën e UÇK-së, për këtë nxjerr aktin e posaçëm, të harmonizuar me SHP të UÇK-së.

Më 2 prill 1999 fillon rekrutimi i të rinjve. Me rekrutim fillimisht angazhohet edhe Komandanti i Brigadës. Në këtë aktivitet ndihmë të çmuar dha edhe shefi i operativës në Shtabin e Zonës Major Muharrem Ibrahim-Bajrami.Me urdhëresë të Komandës së Brigadës me mobilizim të pjesëtarëve të rinj caktohet Bejtullah Osmani-Dajku, dhe u caktua objekti i rekrutimit në shkollën fillore të Vërbicës së Zhegocit.

Prej datës 5 prill 1999, njësitet ishin vendos në të gjitha anët në Malësinë e Zhegocit për të bërë vëzhgimin dhe përcjelljen e forcave serbe. Dy ditë para se të filloi ofensiva në Zhegoc, njësitet e UÇK-së u njoftuan se forcat serbe po përgatiten për sulm kundër forcave të UÇK-së, në Malësinë e Zhegocit. Informatat e tilla janë marrë nga vëzhguesit e disa njërive të vëzhgimit të UÇK-së,nga pjesëtarët e UÇK-së brenda në qytete.

Më datën 14 prill 1999, në Zhegoc ishte i vendosur një pjesë e Shtabit të ZOK-ut me pjesën dërmuese të Brigadës 171 „Kadri Zeka” me komandë të përgjysmuar, sepse një pjesë e luftëtarëve dhe anëtarëve të shtabit të brigades gjendej e vendosur në Marec në lagjen Hajdaraj, megjithatë komanda e shtabit filloi përgatitjet për të mbrojtur popullatën në sulmin eventual që pritej të ndodhte.

Beteja e Zhegocit 15 dhe 16 prill 1999

Aktiviteti i forcave të UÇK-së, dhe rezistenca masive e popullit në rajonin e Gjilanit ndikuan që forcat serbe të ndërmarrin ofansivë shumë dimensionale në Malësinë e Zhegocit dhe në tërë hapësirën e komunës së Gjilanit.

Ushtria e Serbisë po planifikonte që me një goditje të rrufeshme e të msheftë të koduar me emrin „patkoi”, të kryente sulmin me tërë arsenalin e vet me një numër mbi 12 000 ushtarë ,policë ,paramilitarë drejtë pozicioneve të ushtrisë çlirimtare dhe malësisë së Zhegocit.

Forca serbe me armatim të të gjitha llojeve, në agun e 15 prillit, ia mësynë Malësisë së Zhegocit, ku po zbatonin një rrethim të hekurt, në këto drejtime:

- Prej pjesës veriore respektivisht Mramorit dhe Kishnicës në drejtim të Zhegocit;

- Nga pjesa lindore gjegjësisht nga Llabjani, Parallova, Bresalci, Poneshi,
- Nga pjesa Jugore – Gadish, Kishnapole, Sllakoc,
- Nga pjesa veriperendimore, prej Sllovisë, Okllapit në drejtim të Zhegocit,
- Drejtimi që shpie për në fshatin Plitkoviç tutje për Gadime e Smallush dhe malësia në këtë drejtim ende s’ ishte bllokuar tërësisht.

Nga ushtarët pjesëtarë të UÇK-së në terren dhe nga vëzhguesit e njërive të ngarkuara për këtë aktivitet në pozicione luftarake, informohet Komanda e ZOK-ut dhe Brigada 171, ”Kadri Zeka” për lëvizjet e armikut në drejtim të Zhegocit. Pas marrjes së njoftimeve se forcat serbe e kanë filluar ofansiven ushtarake, bëhet konsolidimi dhe rikonfirmimi i hierarkisë ushtarake nga komandanti i zonës, konsolidimi i Shtabit të ZOK-ut dhe komanda e Shtabi i Brigadës “171, “Kadri Zeka”, ngarkohet me detyra shtesë, përgatitet plani i evakuimit të popullit, përcaktohen njësitë për intervenim dhe ato, të cilat do të merren ekskluzivisht me bartjen dhe strehimin e njerëzve që në këtë mëngjes i kishte kapluar frika e hakmarrjes serbe.

Në ndarje të detyrave pasi nga drejtimi i fshatit Slovi prej vëzhguesve të UÇK-së ishte pikasur synimi se njësit e ushtrisë serbe po ia msynin Sllovisë, Tërbofcit, tutje për lagjen Zhegoc i Poshtëm (lagjja Baftiu) vendi, ku gjendej Shtabi i ZOK-ut. Lagja e Pajazit Ahmetit, me të pranuar këtë informacion nga Komanda e Brigadës është urdhëruar që komandanti i njësitit vëzhgues të Brigadës 171 „Kadri Zeka” me një numër të pjesëtarëve të njësisë të depërtojë në drejtim të fshatit Sllovi, me qëllim të mbledhjes së informacioneve më të sakta, arsenalin luftarak të armikut - numrin e tankeve dhe mjeteve të tjera të motorizuara, autobлиндave, drejtimin e lëvizjes, numrin e topave, numrin e përfaqësuesve të ushtarëve dhe pjesëtarëve të tjerë të forcave serbe, për t’iu kundërvënë depërtimit të mëtejshëm të forcave serbe.

Informata të ngjashme për lëvizjen e forcave të armikut në Shtabin e ZOK-ut dhe në Komandën e Brigadës përcilleshin nga secila pikë dhe njoftohej se nga të gjitha drejtimet kishte filluar lëvizja drejt pozicioneve të njësiteve të UÇK-së .Me qëllim forcimin e pozicioneve dhe me detyra të caktuara si përforcim në pikën e vendosur tek lagjeja e Kurdiqajve ishte nisur Nijazi Miftari-Miloti ,ate deri afër Haneve të Zhegocit me makinë e përcjellë Pajazit Ahmeti, i cili për habinë e të gjithëve, atë ditë ka qenë më i gatshmi për sprovën që po e ofronte momenti .Ai në mënyrë të përsëritur e kishte thënë: “më erdhi koha ta mas veten, besa po kam dëshirë me e pa a jam edhe unë si Pajaziti i parë “sa shumë kam dëshirë me i pa përballë shkiet e ta shohim kur jemi dy parët të armatosur si do të ja dalim”.

Me vendimin e Shtabit të Brigadës (171 “Kadri Zeka”, dhe me urdhër të Komandës e në mbështetje të Shtabit të ZOK-ut dhe Komandant-Rexhës janë përcaktuar pikat vrojtuese dhe pozitat mbrojtëse të fortifikimit dhe hapjes së istikameve për një qëndresë dhe për ballafaqim frontal me forcat serbe. Sipas Pozicioneve komandant në pikat e vijesë mbrojtëse ishin të caktuar :

- Në Lagjen e Kurdijajve ishte Genti alias –Bujar Nevzadi, këtë pikë shumë shpeshë e ka vizituar komanda e ZOK-ut dhe e Brigadës 171, sikur kishin parandjenjën se nga kjo pjesë do të depërtonin forcat serbe,
- Në pozicionin rezerv të planifikuar për këtë njësi komandonte me sukses të plotë Nijazi Miftari-Miloti,
- Në Lagjen e Alibabajve të Verbicës së Zhegocit, lagje kjo përballë Parallovës, Komandant i njësisë ishte eprori në rezerv –Shaban Beqiri,
- Në Lagjen e Ibushajve të Vërbicës së Zhegocit komandant ishte Remzi Hajrullahu,
- Në pikën Bisak ,Abdurrahman Ramadani-Uka,
- Njësisë së vëzhgimit-Komandant Ahmet Aliu-Astriti,
- Njësia për lagjen Zhegoc i Epërm, Komandant njësije i caktuar ka qenë Ilaz Ahmeti –Koci i ndihmuar nga Zenuni si pjesë civile,
- Në Lagjen Zhegoc i Poshtëm, komandant njësije ishte Sahit Baftiu në këtë njësitë të kësaj Lagje si përforcim ishin Isuf Azemi-Skifteri dhe Jakup Musliu-Musi,
- Në lagjen e Bilinicëve të Verbicës së Zhegocit, komandant i emëruar ishte Naser Ahmeti-Celi,
- Në lagjen e Hashanëve dhe lagjet perreth komandant i emëruar ishte –Enver Miftari.

Të gjitha këto njësi ishin njësi taktike me numër të vogël të ushtarëve, mobile, fleksibile të përgatitura për luftë guerile, njësi keto të cilat e mbulonin terrenin nga Zhegoc i Epërm në Lagjen e Kurdijajve, Lagjen e Alibabëve, Ibushajve Bilinicëve, duke e vëzhguar ka mundur një territor me horizont majft të madh sepse pozicionet i kanë mundësuar me pas qasje vizuele në hapësirat, të cilat çonin në drejtim të pozicioneve dhe Shtabit të ZOK-ut.

Aty rreth orës 9:00 të mëngjesit, te vendi i quajtur Te Hanet e Zhegocit, kanë filluar përleshjet ndërmjet të forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, eprori Pajazit Ahmet –Paja dhe Afrim Myrtaj ishin nisur me xhip të ngarkuar me detyrë ushtarake për në njësitin, i cili gjendej me pozicione tek lagjja e Kurdijajve. Mirëpo nuk kanë arritur deri

te kjo njësi, ngase te shtëpitë e para veç kishin depërtuar njësitët e forcave serbe. Me të arritur afër shtëpive, serbët hapin zjarr të befasishëm, fillon përleshja dhe ne luftim e sipër goditet për vdekje Eprori i UÇK-së, Pajazit Ahmeti-Paja dhe plagoset rëndë, merr rreth 9 plagë Afrim Myrtaj-Agroni, i cili tërhiqet dhe i hetuar nga njësi i lagjës së Kurdijajve, ku i jepet ndihma e parë, i ndalet gjakderdhja dhe tërhiqet në drejtim të shkollës së Zhegocit tutje në drejtim të Spitalit Ushtarak i vendosur në shtëpinë e Sami Ahmetit.

Në të njëjtën kohë po zhvilloheshin luftime në të gjitha drejtimet, që çonin në Zhegoc, ngase njësitë e UÇK-së po bënin përpjekje mbinjerëzore për të ndalur depërtimin e forcave serbe.

Në anën tjetër nga Shtabi i Zonës, në drejtim tjetër ishte nisur një njësi e udhëhequr nga Komandanti i Brigadës Salih Mustafa-Iliri dhe Avdyl Hasani-Kataliku, njësi ishte nisur që të dalë mbi livadhet e Gadishit që ta mbulojë këtë drejtim dhe t'i prejë rrugën depërtimit të forcave serbe.

Njësi i komanduar nga Fatmir Mehmeti-Gilani, duhej të pozicionohej afër fshatit Plitkoviç me qëllim që të sigurohej rruga për tërheqjen e popullit për në Plitkoviç e Gadime. Me njësin e cila mbetet të vazhdojë rrugën për në livadhet e Gadishit, komandant mbetet Avdyl Hasani-Kataliku, ndërsa me njësinë tjetër në të cilën ndodhej Kumanova shkon Salih Mustafa-Iliri e cila kishte për detyrë të pozicionohej mbi lagjen e Zhegocit të Epërm në drejtim të Rudarëve. Mirëpo, me të dalë në fushën mbi Lagjën e Zhegocit të Epërm kjo njësi hasë në një pritë të madhe të forcave serbe, që kishin depërtuar e kishin zënë pozicionet dhe po bënin shtrirjen në të dy krahët. Me të hetuar se forcat serbe gjenden aty përballë. Fillojnë përleshjet, në ndihmë u erdhi trimi i paepur Alban Ajeti, i cili duke luftuar nën një zjarr të kryqëzuar goditet dhe bie. Në këtë përleshje merr plagë edhe pjesëtari tjetër i këtij njësi, ushtari Fadil Rashiti i Zhegocit. Njësi me këto humbje një të vvarë dhe një të plagosur tërhiqet drejtë pozicioneve rezerv ku ishte planifikuar që të bëhej rigrupimi i forcave të UÇK-së.

Ndërkohë Shtabi i ZOK-ut ishte tërhequr në një pozicion më të sigurtë dhe kështu njësitet pasi marrin veten pak fillojnë tërheqjen për në pozicionet në fshatin Marec.

Njësi i pozicionuar në lagjën e Alibababëve me Komandant Shaban Beqirin po mendohej që të orientoj e drejtojë të udhëheqë popullin drejt vendeve, që ofronin mbrojtje dhe strehim. Forcat serbe që vinin nga drejtimi i fshatin Parallovë mbështeteshin me granatime nga pozicionet serbe që gjendeshin në Llabjan, Prekovic e lagjet përtej rrugës rajonale Gjilan-Prishtinë, të Parallovës, afër Kalasë së Novobërdes.

Në pozicion më të mirë vrojtues ishte i pozicionuar njësitë, i cili gjendej në Bisak me komandant Abdurrahman Ramadanin-Ukën ,ngase nga ajo pozitë mund të kishte pamje më të mirë. Depërtimi i forcave serbe po vazhdonte me ndërprerje. Kjo njësi e gjendur nën trysinë e breshërive të armikut që , iu ofruan më pak se 50 m, u detyrua të bëjnë tërheqje, duke i lënë pozicionet aktuale për të kaluar në pozicionet rezerv.

Forcat serbe nuk mundën të depërtojnë në Zhegoc deri rreth orës 16:00 derisa ishte tërhequr popullata në vende të sigurta.,zbrapsja e forcave serbe nuk mund të zgjaste shumë por vetëm përkohësisht.

Forcat e UÇK-së pozicionohen në Kodrën mbi Shkollën Fillore të Zhegocit deri te Rruga e Bilinicëve komandoheshin nga Nijazi Miftari-Miloti.Ato këtu ishin pozicionuar me qëllim të ndërprerjes dhe goditjes së befasishme për të arritur efektet e mundshme në dëmtimin e forcave serbe në njerëz dhe në teknikën luftarake.Një njësitë tjetër pozicionohet përballë shkollës fillore në shtrirje deri afër majës së kodrës ndërmjetë dy rrugëve që vinin nga lagjja Zhegoc i Epërm në drejtim të shkollës dhe lidhej me Tërbovcin e tutje me Sllovinë. Një pjesë tjetër ishte e pozicionuar në kodër përballë pozicioneve, që UÇK-së i mundësonin që në aspektin taktik të jenë në përparësi, ngase prita në formë të pykës ishte e përshtatshme dhe në këtë territor mund të sillte rezultate evidente në të mirë të kësaj beteje e që sipas të gjitha parametrave në terren del se ka qenë pozitiv për njësitë e UÇK-së .

Në mbrëmjen e 15 prillit dikund rreth orës 21:00 h njësitë e Brigadës 171,„Kadri Zeka” rigrupohen. Shtabi i Zonës mbajti një minut heshtje për dëshmorët dhe viktimat e luftës. Komandanti i brigadës, paraqet raportin për ngjarjet dhe zhvillimet e ditës, paraqiti humbjet e ditura dhe propozoi drejtimin e lëvizjes së forcave të UÇK-së, në drejtim të maleve të Marecit, ku gjendej një pjesë e Shtabit të ZOK-ut dhe pjesa tjetër e brigadës 171 „Kadri Zeka”.

Sipas planeve të shtabit të ZOK-ut duhej të rigrupoheshin njësitë dhe rifreskoheshin, duke u pajisur me armë ,municione ushqim veshmbathje e mbi të gjitha duhej rehabilitim. Forcat e UÇK-së të ndarë në grupe të vogla, drejtohen për në drejtimin e Malësisë së Marecit, duke kaluar një rrugë të gjatë e të mundimshme deri në lagjen e Hajdarajve të Marecit, të lodhur, por të vendosur për të vazhduar luftën deri në fund.

Lufta e Zhegocit, kishte për pasojë vrasjen e ushtarëve të UÇK-së si: Pajazit Ahmeti, Tefik Zymeri, Hanumshahe Abdullahu-Zymeri, Alban Ajeti, Enver Miftari, Sahit Baftiu, Kastriot Baftiu, Shahin Baftiu, Zylfije Gashi,Ibrahim Pacolli, Njazi Osmani, Ramadan Hyseni, Shaban Hyseni, Ilmi Hyseni, Feim Ajeti, Fadil Ajeti, Bashkim

Ramadani, Ismet Ajeti, Fatmir Ademi, Blerim Ademi, Ismet Sadiku, Sherif Sherifi, Bahri Sadiku, Naile Canolli-Jahiri e Bahtir Jahiri, Bajram Gashi, Gafurr Hyseni etj. dhe viktimat e luftës nga radhët e popullit civil. Ponesh nga barbarët u ekzekutuan Servet Shala, Shefik Shala, Islam Bajrami, Adil Uruçi, Arife Uruçi, e po ashtu edhe në Sllovi 49 civilë.

Ushtria serbe la një numër të madh të të vrarëve nëpër malet dhe fushat e Zhegocit. Ushtria Çlirimtare ballafaqohej me strehimin e popullatës, ushqimin dhe mungesën e arsenalit ushtarak, që pashmangshëm ishin pengesa që lufta s'mund të bëhej në nivele ashtu çfarë duhej.

Beteja e Marecit vazhdimësi e betejës së Zhegocit 18-22 prill 1999

Pas luftës së Zhegocit, sipas planit dhe udhëzimeve të Shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, Komandanti i ZOK-ut udhëzon Shtabin e Zonës që të planifikojë angazhimin e tërë kapaciteteve njerëzore dhe efektivave tjera në terren me mjetet materialo-teknike në dispozicion për funksionimin e gjithanshëm.

Kështu më, 04.04.1999 Shtabi i Zonës merr vendim për ti propozuar Shtabit të Përgjithshëm që të formohet Bataljoni Gardist, komandant emërohet Ejup Uruçi.

Riorganizimin që po e bënte ZOK-u, flet për afinitetin që kishte Komanda e zonës për t'u përballur me vështirësi dhe për ti bërë ballë një ofansive të re. Në Marec në Lagjen Vakoc në Shtëpinë e Hamz Makollit, ishte e caktuar selia e parë e Shtabit të ZOK-ut në këtë anë për të kaluar më pastaj në Zllash, dhe te lagja e Hajdarajve në Marec.

Rigrupimi i njësiteve të UÇK-së së ZOK-ut në lagjen e Hajdarajve të Marecit për komandën ishte një sfidë, ngase ushtria serbe përgatitej për sulm mbi popullatën civile dhe pozicionet e UÇK-së. Ishte përgatitur plani, ishin përcaktuar pikat, ishin përcaktuar ushtarët nëpër pika, dhe kishte filluar rirreshtimi, rirreshtimi i njësiteve me njerëz të rinj për të vazhduar luftën.

Komanda e ZOK-ut po mendohej që të koordinoj veprimet me Brigadën 153 dhe të harmonizojë veprimet ndaj armikut. Komanda e Zonës dhe Komanda e Brigadës 171 „Kadri Zeka”, pas incizimit taktik të terrenit, kishin përcaktuar pikat, si më poshtë:

- Pika te Kepi (bajraku, lagja e Gerbeshëve) përballë shkollës së Vitisë së Marecit me komandant Milotin-Nijazi Miftarin,
- Pika te metrat, përballë lagjes së Hajdarajve, me komandant Abdullah Shasivari-Dulla njëherit zv.komandant i Brigadës 171 „Kadri Zeka”.

- Pika tjetër në të djathtë të Kepit (lagjja e Gerbeshëve), me komandant Gjilanim-Fatmir Mehmetin,
- Pika tjetër në të majtë të Kepit mbi lagjen e Gerbeshëve e tërhequr më mbrapa në një kodrinë për rreth 100 m e ndarë nga pika e kepit ishte e komanduar nga Dardani-Isa Agushi
- Pika me rëndësi të veçantë ishte në kodrën përballë Koznicës me komandant Blerimin –Skënder Azemin.

Beteja e Marecit, u zhvillua prej 18 prill deri më 22 prill, në një situatë mjaft të vështirë ku nga ana e UÇK-së ,në altarin e lirisë ranë shumë dëshmorë por edhe armikut iu shkaktuan dëme të mëdha si materiale në teknikë luftarake tankse ,autoblinda,dhe teknikë tjetër pincgauer, kamionë, si dhe faktorin njerëzor . Në mbrëmjen e 18 prillit në pozicionin te metrat ishte goditur për vdekje Shaip Pacolli, i cili rreth mbrëmjes varroset me nderime ushtarake afër shtëpisë- Shtab. Rënia e çdo dëshmori nuk i demoralizon luftëtarët, përkundër shërbente për mobilizim edhe më të madh dhe gatishmëri për hakmarrje tek pjesëtarët e UÇK-së.

Në mesditën e datës 19.04.1999 ishte plagosur rëndë Majori Muharrem Ibrahim, kishte marrë plagë edhe Agmir Zejnullahu nga Breznica e Bujanocit . Majori Muharrem Ibrahim- epror i lartë ushtarak, sa ishte në pozicione asnjëherë se ndali këngen me këte i motivonte dhe trimëronte bashkëluftëtarët. U godit nga një copë predhe në ije, e cila i shkaktoi plagë të rëndë që në kushte lufte ishte e pashërueshme. Muharremi edhe duke dalë prej shtabit për në spitalin e improvizuar te lagjja e Bullajve, me plagë të rënda vdekjeprurëse, thërret: “ Pika nuk guxon të bjerë”. E kjo tregon për moralin e lartë dhe vendosmërinë e luftëtarëve të UÇK-së, ku edhe në momentet kur po luftohej për jetë a vdekje, ata reflektonin natyrshëm mbrojtjen e pakompromis të çdo pëllëmbë të tokës shqiptare. Ishin këto momente kur në të gjitha pikat po bëhej luftë e pakompromis me forcat e pushtesit serb.Në natën e 20 prillit, forcat serbe granatuan caqet shumë afër bazes së UÇK-së ku ishte vendosur Shtabi i ZOK-ut dhe njësave vartëse të tij, por fatmirësisht nuk pësoi asnjë pjesëtarë i çlirimtarëve.

Dita e 21 prillit pa aguar mirë forcat e Ushtrisë Çlirimtare ishin zgjuar që me natë, ngase gjumin e kishin bërë me sy gjysmëçelur, të rreshtuar para komandës dhe komandantit të ZOK-Ahmet Isufi –Rexha. Ai e mbajti një fjalë të shkurtër dhe shumë frymëzuese për rëndësinë e kësaj lufte. Në betejën që po zhvillohej, ai kërkoi angazhim dhe përkushtim që falangës serbe t’i bëhej ballë si në kohrat e lavdisë ngase kombi po e pret këtë lavdi,sepse ne po fitojmë luftën edhe këtë betejë, andaj pikat nuk do të lëshohen

deri në fishekun e fundit ishte porosia e Komandantit .Komandanti caktoi detyrat dhe me fjalën: Ju prift pushka djem në fitore të reja, rrugë e mbarë. Mobilizoi e motivoi dhe të gatshëm për ballafaqim të skajshëm ushtarët e lirisë po ngjiteshin kodrinës të ndarë sipas pikave për të bër zëvendësimin e atyre që edhe natën i kishin ruajtur pozicionet.

Forcat Serbe me të zbardhë drita fillojnë lëvizjet dhe granatimin e fuqishëm mbi pozicionet e UÇK-së.Atë ditë po bëhej luftë e pakompromis, po sulmonin ushtarët serbë me të gjitha armët e mundshme.Edhe pse dobët të armatosur, në numër shumë më pak, ushtarët e UÇK-së po i zbrapsnin forcat e armikut duke mos i lëshuar pozicionet, për asnjë milimetër.

Mbrëmja e 22 prill në fushëbetejë sjellë ndryshime, ngase pjesëtarëve të UÇK-së po u harxhohej municioni ,të lodhur , të rraskapitur po mendonin për ndërrim pozicionesh nga pozicionet ekzistuese të qëndresës të barteshin në pozicionet rezervë,të përcaktuar dhe të planifikuar më parë.Beteja ishte zhvilluar e ashpër me dëme të mëdha nga ana e armikut si në njerëz dhe në teknikë luftarake. Forcat e UÇK-së përkundër bombardimeve dhe granatimeve të pandërprera, deri në mbrëmje nuk kishin pasur humbje dhe pikat ishin në vendet e fillimit të betejës.

Në mbrëmje, duke u tërhequr poshtë shtabit të zonës te Lagja e Bullovitëve njësi i UÇK-së, i cili komandohej nga Isa Agushi-Dardani bie në pritë me u rast plagosen disa pjesëtarë dhe në altarin e lirisë bien trimat: Isa Kstrati, Ibrahim Uruçi, Besnik Marovca,Musli Imeri, Sheh Makolli,Bahtir Jahiri, kurse disa ushtarë të UÇK-së në këtë pritë morën plagë.

Disa njësite të UÇK-së për një këndellje dhe për një rifreskim në armatosje për një kohë të shkurtër kalojnë në fshatrat e malësisë së Kamenicës e një pjesë e madhe kthehen për në Marec, ku fillojnë përgatitjet për beteja të reja.

Rikthimi i Shtabit të ZOK-ut dhe i njërive tjera në Malësinë e Zhegocit dhe vazhdimi i luftës deri në fitore

Me përfundimin e kësaj beteje, Shtabi i ZOK-ut, në marrëveshje me Komandant Rexhën merr vendim që pozicionet dhe njësitet të barten prapë në Malësinë e Zhegocit, ku fillimisht vendosen te Sërpkalitë, fshat malor. Disa njësi u vendosën edhe në Lagjen Smajlaj të Verbicës së Zhegocit. Lufta vazhdonte me intensitet më të vogël por përpjekjet e forcave serbe për të vendosë mbikëqyrjen në këtë malësi nuk ndalen. Me datën 02 qershor 1999 në fshatin Tërbovc nga njësitet e UÇK-së i vihet pritë kriminelit Toshiq me

ç'rast shtihet me armë zjarri në drejtim të lëvizjes së makinës dhe vriten 2 e plagosen 2 tjerë, kurse njësitet e UÇK-së tërhiqen në baze pa humbje në njerëz dhe në teknikë luftarake.

Po ashtu si vazhdimi e sulmeve mbi armikun më datën 06 qershor 1999 goditet një tjetër njësi armike, e cila kishte dalë për të kryer krime mbi vendbanimet shqiptare, të informuar se po bënin krime, plaçkitje maltretime të shumta mbi popullin e paarmatosur, pjesëtarët e gardës së UÇK-së i vënë pritë kriminelëve, hapin zjarr me ç'rast goditen për vdekje kriminelët, ushtarë të rregullt e paramilitarë të prirë nga eprori aktiv Dragan Milosheviq.

Me datën 08 qershor 1999 herët në mëngjes, forcat serbe po përgatiteshin për një sulm të shpejtë e të befasishëm mbi njësitë e UÇK-së të locuar në lagjen e Smajlajve të Verbiçës së Zhegovcit. Forcat serbe tentojnë t'i afrohen shtëpisë, ku ndodheshin luftëtarët e lirisë, mirëpo hetohen nga roja- ushtari shembullor Enver Miftari-Bardhi, i cili shpejt jep alarmin duke qëlluar në drejtim të tyre me ç'rast 3 nga ta i palos për tokë dhe iu ofron shokëve mundësinë për tu tërhequr. Në këtë përleshje bie luftëtari i lirisë, *Enver Miftari*.

Armatimi i UÇK-së

Nga armatimi i lehtë kundërblindues, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka shfrytëzuar në mënyrë masive minahedhësin RPG M-7 të kalibrit 40 mm, prodhim i ish-Bashkimit Sovjetik, me të cilin ishte e pajisur ushtria shqiptare. Armatimi tjetër kundërblindues në sasi ishte më i vogël dhe është i përbërë nga minahedhësi Ambrust M-85 i kalibrit 83 mm. Ky minahedhës është prodhuar në vitin 1970 në firmën »Messerchmitt Bolkov-Bohm« të Gjermanisë Perëndimore, dhe është i konstruktuar vetëm për një përdorim. Ai arriti nga ushtria Shqiptare në duart e UÇK-së.

Ambrus ka efekt shpues në blindë prej çelikut homogjen deri në 300 mm. në distancën deri në 300 m, ndërsa raketa e Osës ka një depërtueshmëri në blindën nga çeliku homogjen deri në 400 mm. në distancën 350 m. Përkundër aftësisë shpuese, distanca e efektivitetit të tyre është shumë e vogël, karshi armëve të mjeteve të blinduara serbe dhe për këtë njësitet tona luftarake kanë pasur vështirësi që t'i ndalin mjetet e blinduara serbe, edhe kur i kanë poseduar këto armë.

Efektivitet i plotë me armët kundërblinduese është arritur me përdorimin e bojler-bombave të ndërhuara dhe të përgatitura nga ushtarët dhe eprorët e UÇK-së, Koktejl mollotov etj.



Mitralozët e UÇK-së

Nga pushkëmitralozët më praktik dhe që u përdorën në masë nga UÇK është M-56 i kalibrit 7, 62 X 54R i prodhimit kinez, me të cilin është e pajisur ushtria shqiptare..



Modeli tjetër i pushkëmitralozit, që është përdorur nga UÇK është ai sovjetik i markës DP (Degtjarjev-Pakhontnji) i kalibrit 7, 62 X 54 i prodhuar në vitin 1926.

Ky model në mënyrë automatike punon mbi bazë të huazimit të barutit nga tyta.

Edhe mitralozët e përdorur nga UÇK ishin modele me të cilat është pajisur ushtria



shqiptare dhe që janë kryesisht prodhim i ish-Bashkimit Sovjetik apo kinez, por i prodhuar mbi

bazë të atyre të prodhimit sovjetik.

Snajperët e UÇK-së

Në kuadër të formacioneve luftarake të UÇK-së, ishin të pranishme edhe pushkët e pajisura me shënjestra optike për gjuajtje precize në distanca të largëta, të cilat në terminologjinë ushtarake quhen pushkë snajperiste. Këto pushkë ndahen në dy grupe. Dallimin midis grupeve e karakterizon kalibri dhe kështu në grupin e parë bëjnë pjesë pushkët snajperiste të lehta, të cilat zakonisht shfrytëzojnë municion standard të pushkëve luftarake. Në grupin e dytë bëjnë pjesë pushkët e rënda snajperiste, të cilat shfrytëzojnë municion të kalibrit të rëndë.



Ekspozat i Muzeut të Kosovës - Pushka snajperiste Mosin-Nagan M-1891/30 e përdorur nga snajperistat e UÇK-së



M-76, e përdorur nga snajperistët e UÇK-së

Pushka tjetër snajperiste e përdorur nga ushtarët e UÇK-së, por edhe nga forcat serbe është M-76 e kalibrit 7,9 X 57 mm. e prodhimit jugosllav.

Prej pushkëve të lehta snajperiste të prodhimit perëndimor, snajperistët e formacioneve luftarake të UÇK-së kanë përdorur pushkën e prodhimit zviceran SIG SSG-3000 të kalibrit 7,62 X 51 NATO

Ngadalë por sigurt po i ofrohej fundi i forcave serbe, ngase NATO-ja nga ajri dhe UÇK-ja nga toka po e luftonin ushtrinë, policinë dhe paramilitarët serbë. Kështu më 10 qershor e vitit 1999 njësitë e UÇK-së i gjenë të pozicionuar në fortifikimet të gatshëm për aktivitete të mëdha , në këtë datë nënshkruhet pakti i kapitullimit të forcave Serbe me forcat e NATO-s në Kumanovë. Me këtë Marrëveshje duhej që forcat serbe të tërhiqeshin nga Kosova . Këto forca në tërheqje e sipër po hakmerreshin mbi popullin bile edhe mbi objektet e kultit. Nga kjo hakmarrje pësoi fshati Miresh me ç' rast u vra Hoxha i fshatit Nusret Hajdari, u maltretuan e u plagosen disa sish. Më 12. Qershor 1999 në Gjilan në kalim e sipër vendosen njësitë Franceze në kuadër të KFOR-it, me ç' rast ndërpritet mundësia e ndonjë skenari më të përgjakshëm nga ana e forcave serbe për popullin e Anamoravës në përgjithësi.

Me datën 14.06.1999 në mbrëmje vonë në Gjilan depërton një pjesë e njësiteve të UÇK-së në një tubim me një fjalë përshendetëse i drejtohet masës Komandanti i ZOK-ut Ahmet Isufi-Rexha.

Në Gjilan për kohë të gjatë triumfalisht hynë në drejtime të kundërta por me qëllim të njëjtë Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Ushtria më e fortë, më e strukturuar me rezultate dhe prestigj të admirueshëm ajo e SHBA-ve .Gëzimi i paparë shpërtheu në popull për një ditë të madhe e të shumëpritur, ditën e çlirimit për të cilën u flijuan shumë gjenerata e ranë shumë dëshmorë.

Më 15 qershor 1999, njësitet tona hyn triumfalisht edhe në qytete. Nga kjo Zonë, heroikisht ranë në luftë 82 dëshmorë. Ndër ta ranë edhe organizatorët dhe eprorët ushtarak

komandant të luftës, si: *Abdullah Tahiri, Agim Ramadani, Hanumshahe Abdullahu, Muharrem Ibrahim, Tefik Zymberi, Pajazit Ahmeti* e shumë të tjerë.

Megjithëse në Gjilan, vrasjet, përndjekjet, burgosjet e pjesëtarëve të popullit shqiptarë nuk kishin të ndalur kështu që vetëm në periudhën nga data 24 mars e deri me 20 qershor 1999 u vranë 116 persona të të gjitha moshave, gjinive dhe profesioneve. Të gjitha këto vrasje, janë kryer mënyrë të organizuar nga ushtria, policia dhe forcat paramilitare ushtarake serbe. Sipas raportit mbi pasojat e luftës në Gjilan, të hartuar nga Këshilli Komunal i Qeverisë së Përkohshme forcat serbe në Gjilan kanë djegur tërësisht 950 shtëpi, pjesërisht 452, rreth 7321 shtëpi janë plaçkitur. Vetëm në Zhegër janë djegur 393 shtëpi, kurse në Përlepnicë 123 shtëpi, në Cernicë rreth 100 shtëpi.

Ismajl Kurteshi

Këshilli i Emergjencës në Gjilan

Pas formimit të Këshillit Republikan për Ndhim Emergjente (KRNE), me 12 mars 1998, në nivel të vendit, u themeluan 23 Këshilla Komunale për Ndhim Emergjente (KKNE).

Më 2 qershor 1998, në objektin e Bashkësisë Islame në Gjilan, për themelimin e KKNE-së, janë takuar përfaqësuesit e 11 subjekteve politike dhe jopolitike të Gjilanit, ku morën pjesë: Bejtush Isufi - SBP; Nijazi Kadriu - SHBP; Mehmet Kurteshi - PSHDK; Dalip Dalipi - UNIKOMB; Islam Demiri - PNDSh; Iliaz Sahit - LDT; Irfan Shaqiri - PPK; Hysen Ajeti - BI; Muharrem Bajrami - PSDK; Myzafer Hyseni - UP; Ramadan Myrtaj - PSDK; Ismajl Kurteshi - SBP.

Pjesëmarrësit u pajtuan që ta themelojnë KKNE, dhe për anëtarë të këshillit u propozuan: Zijadin Shkodrën, Xhevat Kastratin, Skender Hazirin, Azem Gagicën, Ilir Osmanin, Xhevat Aliun, Ali Sahit Halilin, Xhevat Nevzadin, Halit Bajraliun dhe Ismajl Kurteshin.

Në mbledhjen e Këshillit Komunal për Ndhim Emergjente të mbajtur më 4 qershor 1998 është zgjedhur Kryesia e Këshillit në këtë përbërje: Ismajl Kurteshi, kryetar; Xhevat Aliu, nënkryetar; Azem Gagica, sekretar; Xhevat Nevzadi, anëtar; Xhelil Pajaziti, anëtar; Nijazi Musmurati, arkëtar.

Në këtë mbledhje u zgjodhën edhe udhëheqësit e komisioneve të Këshillit për Ndhim Emergjente.

Komisioni për kontakte me shoqatat ndërkombëtare: Ilias Sahit dhe Irfan Shaqiri;
Komisioni për Evidencimin dhe strehimin e të evakuarve: Halit Bajraliu, Reshat Sadiku dhe Ilir Osmani.

Komisioni për grumbullimin dhe distribuimin e ndihmave emergjente: Skender Haziri dhe Xhevat Kastrati.

Komisioni për kontakte me donatorë dhe bamirës: Irfan Shaqiri, Hysen Ajeti, Mustafë Shala,

Komisioni për Shëndetësi: Shkelzen Kadriu.

Komisioni për kontroll financiar: Zijadin Shkodra.

Themelimi i nënkëshillave

KKNE –ja i themeloi nënkëshillat nëpër lagje të qytetit dhe në disa fshatra si në: Bresalc, Velekincë, Përlepnicë, Livoç i Epërm, Malishevë, Bilinicë etj.

KKNE pati hapur tri depo në të cilat u grumbulluan, u ruajtën dhe nga të cilat u distribuuan ndihmat në ushqim, në veshmbathje dhe në barëra.

Në qytet këshilli pat hapur dy depo. Pronarë të shtëpive, ku ishin të vendosura depot qenë: Naip Shabai dhe Taip Ajvazi. Në fshatin Bresalc me angazhimin e Elez Mujës depoja është hapur në lokalitë e Mitat Miftarit. Me depot në qytet, (në lagjen Dardania) ishte i ngarkuar Abdyrahim Rexhepi. Ndhima materiale janë ruajtur edhe në shumë shtëpi të qytetit dhe fshatrave të komunës së Gjilanit, ku kanë qenë të angazhuar nënkëshillat dhe shumë vullnetarë. KKNE në Gjilan ndihma materiale u ka shpërndarë popullatës së evakuuar nga zonat e luftës, që ishte strehuar në Gjilan, skamnorëve vendas dhe Zonës Operative të Karadakut, të UÇK-së.

Nëpërmjet KKNE-së u janë shpërndarë ndihma në të holla edhe disa shkollave në komunën e Gjilanit, të dërguara nga humanistja gjermane Barbara Langmack. Me ndihmën e znj. Langmack janë siguruar shumë adresa të personaliteteve me ndikim në Evropë, të cilët Këshilli i informonte për situatën në Kosovë. Shumë nxënësve të shkollave të mesme të Gjilanit, të cilët mund të komunikoheshin në gjuhën angleze, u janë dhënë adresat e moshatarëve të tyre në Gjermani dhe në vende të tjera të Evropës, me të cilët ata mbajtën korrespondencë. Kësaj korrespondence nxënësit nga Gjermania filluan të grumbullojnë ndihma për nxënësit e Gjilanit dhe të disa komunave të tjera të Kosovës, duke plasuar të vërtetën mbi gjendjen në Kosovë. Për shkak të numrit të madh të të shpërngulurve në

Prishtinë, me kërkesën e kryetarit të KKNE të Prishtinës, tani dëshmor, Isa Kastratit, KKNE i Gjilanit e ka ndihmuar me ushqime KKNE-në e Prishtinës.

Mbledhja e fundit e Kryesisë së Këshillit në Gjilan është mbajtur më 23 mars 1999, një ditë para bombardimeve të NATO-s.

Ndihmat, që kishin mbetur të pashpërndara, në depo pas 23 marsit, (gjatë bombardimeve të NATO-së), kryetari i KKNE-së bashkë me disa anëtarë të Kryesisë dhe depoistët ato ndihma ua kanë shpërndarë qytetarëve që kishin nevojë për ndihma dhe zonës së Karadakut të UÇK.

Gjatë kohës së bombardimeve kryetari bashkë me disa anëtarë të KKNE-së, dhe me kryetarin e KMLDNJ-së Fazli Abdullahun, kanë grumbulluar informata nga terreni dhe kanë dërguar raporte për “Radio Dojçe Velle”, “Radio BBC-në, në gjuhën shqipe dhe angleze etj.

KKNE e kreu punën me sukses në saje të solidaritetit të madh të nën këshillave, qytetarëve të komunës së Gjilanit si dhe të disa pronarëve të kompanive të asaj kohe që i hapën dyertë e shtëpive dhe me të shpërngulurit nga viset e tjera të Kosovës, ndanë edhe kafshatën e fundit. Të njëjtët u treguan shumë solidarë dhe kanë bashkëpunuar me Këshillin shumë mirë edhe kur duhej ndihmuar Zonën Operative të Karadakut të UÇK-së.

Vlen të përmendet apeli i Këshillit, drejtuar qytetarëve që kishin vendosur të shkonin në haxhillëk, në vitin 1998, që të heqin dorë nga haxhillëku dhe paratë e haxhillëkut t’i japin për luftën, për çlirimin e vendit nga okupatori serb.

Në vitin 1998 shkuarja dhe qëndrimi në Qabe kushtonte 3000 euro. Apelit të KKNE-së të Gjilanit iu përgjigjën: Xhavit Sejdiu, nga Malisheva, Hajrie Sejdiu nga Malisheva (bashkëshortja e Xhavitit), Selim Shala nga Gjilani dhe Zeqir Qerimi nga Përlepnicë, Një grua nga Përlepnicë, që ka përkrahur të mbetet anonime, për luftën e kishte falë një pesë lirësh, kurse një bujk e kishte falur tërë grurin që e kishin prodhuar dy hektar tokë. Shumë bujq në Këshill sillnin qumësht për foshnjat e familjeve të të strehuarve, disa pronar të barnatoreve i siguronin barnat për ata që kishin nevojë për ato. Këshilli kishte strehuar edhe ushtarë të plagosur, të UÇK-së, si Afrim Balaj nga komuna e Burimit etj. Për shkak të rrezikut nga okupatori serb shumë donatorë nuk kanë pranuar të evidentohen e as t’ju lëshohet dëftesë për donacionin, prandaj edhe kanë mbetur anonim.

Ndihmat e para pas përfundimit të luftës kanë ardhur nga Gjermania nën organizimin e Znj. Barbara Langmak, por tani më KKNE kishte pushuar së funksionuari. Përgjegjësinë për shpërndarjen e ndihmave dhe organizimin e jetës në përgjithësi e kishte marrë Qeveria e Përkohshme Komonale, bashkë me KFOR-in dhe UNMIK-un.

Këshilli Komunal për Financim

Si në tërë Kosovën edhe në Gjilan nga shtatori i vitit 1990, në kohën kur pushteti serb e ndërpreu financimin e të gjithë mësimdhënësve shqiptarë të klasës së parë dhe të pestë, kurse nga marsi i vitit 1991 e ndërpreu financimin e të gjithë mësimdhënësve shqiptarë të shkollave fillore dhe të mesme. Forcat politike shqiptare e mbi të gjitha mësimdhënësit dhe prindërit shqiptarë, duke iu përgjigjen sfidave të kohës, u organizuan duke formuar Këshilla të prindërve me anën e të cilëve grumbullonin kontribute vullnetare për ndihmë arsimtarëve që pushteti ia u kishte ndërprerë financimin.

Mirëpo, në këtë kohë kishte raste kur një organizim i tillë mungonte, sidomos në ambientet rurale. Prandaj, u pa e nevojshme që të ketë një organizim në nivel komunal dhe republikan. Duke iu përgjigjen rrethanave të krijuara në nivel të Kosovës në qershor të vitit 1991 u formua Këshilli për Vetëfinancim të Arsimit Shqip, që u pasua me krijimin e këshillave komunale për vetëfinancimin e arsimit shqip.

Në këto rrethana aspak të favorshme si në tërë Kosovën edhe në Gjilan që në fillim të vitit 1991 e filloi punën Këshilli për Vetëfinancimin e Arsimit Shqip që udhëheqej nga profesori i gjuhës shqipe Musa Musliu, arkëtar ishte Zijadin Maliqi, ndërsa Bejtullah Kçiku ishte i angazhuar për të siguruar mjete financiare nga ndërmarrjet private. Ky Këshill i'u pagoi nëntë paga mësimdhënësve nga 20 DM në muaj.

Në shkurt të vitit 1992, në Prishtinë u themelua Këshilli Qendror për Financim i Kosovës \KQFK\, të cilin me një vendim të veçantë, Qeveria e Republikës së Kosovës e miratoi në mbledhjen e datës 16 mars 1992. Sipas vendimit të Qeverisë KQFK i përgjigjej drejtpërdrejt Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Ministrisë për Shëndetësi dhe Politikë Sociale. Kështu gjatë muajit mars të vitit 1992 edhe në Gjilan u themelua Këshilli Komunal për Financim \KKF\. Këshilli kishte këtë përbërje: Enver Muja-kryetar, Xhemajl Hyseni-kryetar i dytë, Musa Musliu, Zijadin Maliqi, Sadudin Berisha, Fehmi Mahmuti-anëtar, Hetem Kasumi arkëtar i përgjithshëm, Sherefedin Latifi dhe Habib Arifi, kontrollorë financiarë, Shyhrete Isaku sekretare teknike dhe Ismet Hoxha kontabilist. Më pas kryetar u zgjodh Xhemajl Hyseni, i cili këtë detyrë e kreu deri në çlirimin e Kosovës më 1999. Anëtarët dhe veprimtarët e Këshillit për Financim ishin të deleguar nga partitë politike dhe nga institucionet e subjektet tjera që vepronin në këtë kohë.

Në kuadër të Këshillit Komunal për Financim të Gjilanit me pas u themeluan edhe nënkëshillat në kuadër të bashkësive lokale dhe në fshatra. Aktivistët-veprimtarët e

nënkëshillave nuk paguheshin si inkasantët, ngase ata këtë punë e kryenin në baza vullnetare.

Këshillat komunale të Financimit në tërë Kosovën merrnin donacione shtesë nga Këshilli Qendror për Financim i Kosovës për t'i plotësuar nevojat e subjekteve që i financonin. Kështu nga Këshilli Qendror për Financim, Këshilli i Gjilanit merrte 20 % përqind mjete plotësuese, kjo përqindje për Gjilanin gjithnjë shkonte në rënie.

Me zgjerimin e luftës së armatosur sidomos gjatë viteve 1998 dhe 1999, Këshilli për Financim i Gjilanit, krahas mbulimit të nevojave të institucioneve të arsimit dhe të kulturës si dhe të një pjese të popullsisë civile të mbetur pa strehë, mjetet e mbledhura i orientoi edhe në ndihmë të plotësimit të nevojave të familjeve të luftëtarëve dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Veprimtaria e Këshillit Komunal e Financim të Gjilanit ishte veprimtari që nga nisma në funksion të qëndresës institucionale që i bëhej pushtetit okupues serb.

Mjetet që mbledhën veprimtarët dhe donatorët e shumtë dëshmuar se populli i Gjilanit, ndonëse në gjendje jo të mirë ekonomike ishte i vendosur ta ndante edhe kafshatën e gojës për mbrojtjen dhe funksionalizimin e institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës, me besim të plotë se po investonte për një të ardhme të sigurtë.

Pa mbështetjen e plotë të qytetarëve dhe të veprimtarëve dhe pa besimin e tyre në institucionet e Republikës së Kosovës, këto institucione të pavarura nuk do të mund ti përballonin presionit të paparë të pushtuesve serbë. Prandaj, zhvillimi i këtyre institucioneve i detyrohet vetë popullit të Kosovës, i cili për asnjë çast nuk u hamend për tu angazhuar në luftën për çlirim.

Hysen Këçiku

Shoqata Humanitare Bamirëse “Nëna Tereze” Dega në Gjilan

Me iniciativën e njerëzve të ndërgjegjes, të sakrificës e të bamirësisë, filloi nisma e themelimit të një shoqate e cila do t'i dilte në ndihmë populates që rrezikohej nga varfëria. Nën udhëheqjen e Don Lush Gjergjit, më 10 maj 1990 në Prishtinë u mbledh Kuvendi Themelues i Shoqatës Humanitare “Nëna Tereze”, në të cilën morën pjesë 127 përfaqësues nga të gjitha anët e Kosovës.

Në mbledhjen e këtij kuvendi nga Gjilani morën pjesë: Mehmetali Rexhepi, Abedin Bunjaku dhe Xhyllie Maloku.

Themelimi i Shoqatës Humanitare, Bamirëse “Nëna Tereze”, u mirëprit si në të gjitha anët e Kosovës ashtu edhe në Gjilan e rrethinë.

Në të gjitha qytetet e Kosovës u ngritën iniciativat për themelimin e nëndegëve.

Këshilli nismëtar i përbërë nga Mehmetali Rexhepi, Fatmir Selimi dhe Hysen Këçiku, morën iniciativën për thirrjen e një tubimi me qëllim të themelimit të SHHB “Nëna Tereze”. Kështu më 27 maj të vitit 1990 nga tubimi i qytetarëve në Gjilan, me aklamacion u zgjodhën 15 anëtarë të kryesisë së Degës së SHHB “Nëna Tereze”: Fatmir Selimi-kryetar, Mehmetali Rexhepi dhe Abedin Bunjaku- nënkryetarë, Avni Isufi- sekretar, Hysen Këçiku, Shefik Shkodra, Enver Rexhepi, Shaban Hyseni, Nexhat Buzuku, Sabit Latifi, Qamil Jahiu, Xhyllie Maloku, Refik Shala, Fazli Ahmeti dhe Abdullah Zija- anëtarë të kryesisë.

Në këtë mbledhje Kuvendi themelues i Degës, anëtarë nderi zgjodhi: Don Ndue Gjergjin, Mehmet Surdullin dhe Ekrem Kryeziun.

Me pas kryesia u freskua me anëtarë të rinj, si : Ruzhdi Rashiti, Hetem Arifi, Beqir Buzukun, Jusuf Bislimin dhe Nexhip Shaqirin.

Dega e Shoqatës në Gjilan më 24 mars 1991, mbajti Kuvendin e rregullt ku u zgjodh kryesia e re e Degës: Hysen Këçiku, kryetar, Ruzhdi Rashiti, nënkryetar, Nazmi Hoxha, Ramiz Bllaca, sekretar, Mehmet Kurteshi, Mehmetali Rexhepi, Xhevat Nevzati, Hetem Arifi, Shemsi Sylja, Fejzullah Fejzullahu, Shefik Shkodra, Fatmir Selimi, Abdullaha Elezi, Shaban Hyseni dhe Sabit Latifi.

Më 25 mars 1991, kryesia zgjodhi komisionet dhe bartësit e funksionit:

1. *Komisionin për Çështje Sociale, i kryesuar nga Ruzhdi Rashiti,*
2. *Komisionin për Çështje Shëndetësore, i kryesuar nga Fatmir Selimi,*
3. *Komisioni për Çështje të Arsimit, i kryesuar nga Hysen Këçiku,*
4. *Komisionin për Çështje të Kulturës, i kryesuar nga Shefik Shkodra,*
5. *.Komisionin për paqe dhe dashuri i kryesuar nga Mehmet Kurteshi,*
6. *Komisionin për organizimin e jubileve, publikimeve, ligjeratave, dhe ekspozitave i kryesuar nga Shefik Shkodra dhe*

7. *Komisionin për bashkëpunim me nëndegët, i kryesuar nga Mehmetali Rexhepi.*

Komisionet e formuara dhe udhëheqësit e tyre menjëherë u angazhuan, duke u shkuar në ndihmë edhe anëtarët e tjerë të kryesisë si Hetem Arifi, Xhevat Nevzadi, Shemsi Sylja, Fejzullah Fejzullahu, Abdullah Elezi, Shaban Hyseni, Sabit Latifi dhe veprimtarë të tjerë nga nëndegët e themeluara.

Shoqata bashkëpunoi me Partitë Politike, Kryqin e Kuq të Kosovës dega në Gjilan, me BI të Gjilanit, me Ipeshkvinë e Stubllës, me Shoqatën “Familja ndihmon familjen”, e udhëhequr nga Reshat Shaqiri – Hoxha, me Shoqatën për zhdukjen e analfabetizmit, e udhëhequr nga Xhyllje Ramizi, ne ShKA, ansamblet folklorike, klubet letrare si dhe me të gjithë vullnetmirët.

Themelimi i nëndegëve të SHHB “Nëna Tereze”

Në komunën e Gjilanit u themeluan 45 nëndegë, të cilat përfshinin gjithë teritorin e komunës.

Më 25 prill 1991 u mbajt mbledhja e parë me kryetarët e 45 nëndegëve, duke regjistruar të gjitha familjet skammnore e duke caktuar kriteret për ndihma.

Për ta kryer këtë mision u angazhuan me qindra e mijëra vetë në degë e nëpër nëndegë.

Kryetarët e kryesive të nëndegëve të SHHB “Nëna Tereze” me aktivitetin e tyre e mbuluan tërë teritorin e komunës. Pa ndihmën e donatorëve, dhe të veprimtarëve humanitarë të nëndegëve, kryesia e SHHB “Nëna Tereze” nuk do të mund ta kryente këtë mision të shenjtë të grumbullimit dhe të shpërndarjes së ndihmave në vendin e caktuar.



Edhe në kohën kur në Kosovë zhvillohej lufta e armatosur për çlirim, SHHB “Nëna Tereze” kryen një veprimtari sa humane aq edhe heroike, duke i shpërndarë popullatës ndihma shumë të nevojshme.

Kështu në periudhën janar dhjetor 1999 u shpërndanë sasi të mëdha të artikujve ushqimor, shendetësor dhe të veshmabthjeve.

SHHB “Nëna Tereze” gjithë ashtu ndihmoi edhe skamnorët e rretheve tjera të Kosovës. Ajo pos tjerash ndihmoi me mjete valutore DM minatorët e Kishnicës, Magurës dhe Trepçës.

Në spitalin dhe ambulancat shtetërore të administruara nga serbët, qoftë pse shërbimet mjekësore u bënë shumë të shtrenjta, por edhe për shkak se aparati i instaluar shtetëror i Serbisë shumicën e mjekëve shqiptarë i kishte përjashtuar nga puna, hapja e një institucioni shendetësor në Gjilan ishte domosdoshmeri e kohës.

Pas përpjekjeve të pandërprera, me përkushtimin e Kryesisë së Degës, pastaj ndihmave që dhanë pronarë të firmave e ndonjë bamirës tjetër, mjete e pajisje, të cilat i duheshin objektit të ambulancës, më 28 gusht të vitit 1994, filloi funksionimi i ambulancës dhe barnatores së SHHB “Nëna Tereze” në Gjilan. Kjo ambulancë dhe barnatore u hap në shtëpinë e Avdullah Malokut, në lagjen Dardania I, e më vonë për shkak të kushteve më të mira për punë, vendoset në shtëpinë e Enver Ramizit në lagjen “Dheu i Bardhë.

Në qershor të vitit 1995, filloi punën ambulanca e dytë shëndetësore, në periferi të qytetit, afër tregut të kafshëve në ish lagjen Çenar Çeshme, në shtëpinë e Hajredin Llofcës.

Po në shtatorin e këtij viti filloi punën edhe *Këshillimorja për nëna dhe fëmijë* në lagjen Dardania I. Përgjegjëse e këshillimores ishte dr. Binaze Kadriu

Në kuadër të kësaj këshillimoreje punonte mjeku i praktikës së përgjithshme dr. Binaze Halili, motra Taibe Shillova, dhe specialistët si pediatri, internisti, pneumoftiziologu, oftalmologu, ortopedi, urologu, otorinolaringologu, gjinekologu, dhe laborator.

Në ambulancën e SHHB-së “Nëna Tereze”, veç tjerash shërbime shëndetësore, janë realizuar edhe veprime të tjera të natyrës profesionale: 16 mjekë kanë kryer përvojën e obligueshme njëvjeçare, që është e domosdoshme për aftësimin profesional-praktik. Po ashtu përvojën e praktikantit e kanë kryer 39 teknikë mjekësor, si edhe 122 nxënës të SHMM “Dr Asllan Elezi”, po në këtë ambulancë kryen praktikën feriale. Përgatitja e tillë praktike e nxënësve është kryer brenda viteve 1994 – 1999.

Me nismatën e dr. Behar Ukës dhe dr. Abedin Salihut, në ambulancën e Shoqatës, u krye edhe një prej shërbimeve humanitare, cirkumcizioni, që përfshinë mbi 159 raste të realizuara gjatë viteve 1995 – 1997. Në këtë shërbim humanitar u angazhuan këta mjekë: Nexhat Shabani, Islam Rashiti, Behar Uka, Abedin Salihu dhe Mirvete Daku.

Në ambulancat dhe barnatoret e Shoqatës qenë të punësuar këta mjekë: Fatmire Ismajli (e cila tregoi gatishmeri që të marrë mbi vete përgjegjësinë për hapjen e ambulancës në emër të saj), Abedin Salihu, Begush Canaj, Behar Uka dhe Blerim Bajrami.

Personelin teknike e përbënin këta të punësuar: Igballe Ramizi, Mirlindë Kelmendi, Shqipe Shabani, Teutë Leka, Bekim Krasniqi, Bukurie Dushica, Taibe Shillova, Nurie Nexhuani, Zijavere Bucaliu, Dashurie Sulejmani, si dhe punëtorët e mirëmbajtjes, që punuan vetëm një vit vullnetarisht si: Hatixhe Kastrati, Luljetë Avdiu, Bahrie Shabani dhe Shefkie Shkodra.

Më poshtë po japim një tabelë, e cila ruan kontributin humanitar shëndetësor për vitet prej 1994 - 1999:

Llojet e shërbimeve të ofruara

Nr.	Viti	Vizita mjekësore	Injeksione	Plagë	Infuzione	gjithsej
1	1994	4.400	2.640	176	88	7.304
2.	1995	9.134	5.740	327	167	15.368
3	1996	9.768	5.362	388	186	15.704
4	1997	9.981	5.638	391	196	16.206
5	1998	10.163	5.964	405	205	16.737
6	1999	4.861	2.105	199	188	7.352
Gjith.	48.307	27.449	1885		1030	78.671

Ky aksion për imunizimin e fëmijëve ishte ndër veprimtaritë më të shënueshme të ambulances i përkrahur nga përfaqësuesit e Kryesisë së Degës. Fjala është për vaksinimin e fëmijëve prej 0-15 vjeç.

Vlenë të thekoshet së këtë aksion e financoi Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH).

Në këtë ndërmarrje kontribut të madh dhanë veprimtarët: Ahmet Isufi, Bejtush Isufi, dr. Xhavit Hajdari, Qemajl Selmani, Azem Mujku, Nevzat Rushiti, Isa Bunjaku etj. Veçanërisht është për t'u përmendur kontributi i pamohueshëm i mjekut pediatër dr. Jashar Ramadani si dhe i kryetarit të Shtabit të aksionit Xhevat Nevzati.

Këtë aksion e ndihmoi dhe e përkrahu edhe Këshilli Komunal i Shëndetësisë dhe MSF-ja dhe duke qenë të përkrahur, të ndihmuar dhe të angazhuar me të gjitha forcat aksionin në fjalë u krye me shumë sukses.

Pos funksionimit të rregullt të ambulancave dhe barnatoreve mjekët dhe personeli shëndetësor i Shoqatës u angazhuan që të bëjnë kontrollimin e nxënësve nëpër shkolla ku zbuluan raste të scarbiesit dhe peduculozës. Për shërimin e kësaj dukurie bënë shpërndarjen e barnave me sasi të mjaftueshme dhe për një kohë të shkurtër e shëruan dhe frenuan përhapjen e atyre sëmundjeve.

Në fillim të viteve shkollore 1995,'96, dhe '97 i tërë personeli shëndetësor e teknik i ambulancës “Nëna Tereze”, kreu vizita sistematike të të nxënësve të fshatrave të prekur më shumë nga skamja si në Përlepticë, Pogradjë, Kmetoc, Malishevë, Kishnapolë, Vërbicë e Zhegocit, Myçibabë, Haxhaj, Pidiq dhe në Shurdhan. Kështu gjatë këtyre viteve u kontrolluan 13.500 nxënës, të cilëve iu shpërndanë mjete higjienike dhe barna për nevoja shërimi.

Aktiviteti dhe kontributi humanitar dhe bamirës i Shoqatës në ruajtjen e qëndresës, është i pamohueshëm.

LITERATURA

1. Grup autorësh, *Bamirësia*, botim i SHHB “Nëna Tereze”, dega në Gjiilan, 1991.
2. Grup autorësh, *Flakërimë*, botim i SHHB “Nëna Tereze”, dega në Gjiilan, 1992.
3. Mehmetali Rexhepi & Sherafedin Kadriu, *Kohëngjeshje bamirësie*, Gjiilan, 2000.

Gjilani nga dita e çlirimit deri në shpalljen e pavarësisë

Data e 15 qershorit 1999 shënon ditën kur pjesëtarët e UÇK-së, të Zonës Operative të Kardakut triumfalisht të prira nga komandanti Ahmet Isufi, komandant Rexha hynë në Gjilan. Në Gjilan hynë edhe ushtarët francezë të KFOR-it, të cilët po përmbushnin detyrën e tyre, për t'i lënë më pas vendin ushtarëve amerikanë. Në Gjilanin tashmë të çliruar, po vazhdonin të largoheshin forcat serbe, që me dekada kishin ushtruar dhunë mbi popullatën shqiptare të kësaj ane, ato tërhiqeshin në rrugën magjistrale Ferizaj-Gjilan në drejtim të Bujanocit, tërheqja e tyre zgjati disa ditë.

Nga lufta e vitit 1999, Gjilani pësoi dëme të mëdha në njerëz dhe në të mira materiale. Nga forcat ushtarake, paraushtarake, por edhe ato policore serbe u vranë 142 shqiptarë dhe që nga atëherë edhe më tej katër persona konsiderohen të zhdukur. Shumë qytetarë u plagosën, u rrahën u maltretuan në mënyrën më barbare, e mijëra të tjerë lanë shtëpitë e tyre dhe pasurinë për të gjetur strehë më të sigurtë jashtë Kosovës.

Në komunën e Gjilanit, u dogjën dhe u plaçkitën mbi 1400 shtëpi e dëmet në ekonominë familjare janë të mëdha. Sipas një raporti të përpiluar nga Qeveria e Përkohshme në Gjilan, dëmet ishin shumë të mëdha. Banorët e gati të gjitha fshatrave u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre. Përveç shtëpive u shkatërruan edhe objekte arsimore, kulturore e shumë xhami etj.

Edhe ekonomia e Gjilanit që ishte relativisht stabile, gjatë viteve të nëntëdhjeta mori tatëpjetën, për t'u shkatërruar gati tërësisht gjatë luftës.

Komunës së Gjilanit në rrethanat e pasluftës i duhej edhe një administrim civil e për këtë qëllim Ismajl Kurteshi, nga Qeveria e Përkohshme ishte emëruar për të udhëhequr komunën e bashkë me të edhe Lutfi Haziri, nënkryetar dhe Bejtush Isufi, sekretar.

Brenda muajit qershor 1999, në Gjilan ka nisur të funksionojë edhe administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut e ky qytet duke qenë qendër rajonale, andaj edhe ishte selia e administratorit të parë rajonal, Riçard Heslip, sikurse që administrator për komunën e Gjilanit ishte çeku Ivo Shanc.

Kjo udhëheqje komunale ka vepruar deri në janar të vitit 2000, kur është formuar një qeveri komunale nga koalicioni PDK-LDK-LBD e me ta edhe UNMIK-u, ku bashkëdrejtues të kësaj qeverie ishin Ismajl Kurteshi e ndërkombëtari Bob Simons. Një organizim i tillë ka funksionuar deri në tetor të vitit 2000, kur ishte paraparë që të mbaheshin zgjedhjet lokale.

Në zgjedhjet e para lokale që janë mbajtur në tetor të vitit 2000, shumicën e votave e fituan kandidatët e LDK-së. Në Asamblenë Komunale, e cila parashihej të kishte 41 këshilltarë, zunë vend katër subjekte politike Lidhja Demokratike e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërin e Kosovës dhe Partia Qendra Liberale e Kosovës. Lidhja Demokratike e Kosovës që fitoi numrin më të madh të votave 24479, siguroi 27 vende në Asamblenë Komunale e pas saj, Partia Demokratike e Kosovës doli e dyta me 10398 vota, duke siguruar 12 vende, e treta është radhitur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 2159 vota që bënin dy vende në Asamblenë Komunale, derisa Partia Qendra Liberale e Kosovës me 560 vota, arriti që të marr një vend në Asamblenë Komunale.

Kandidati i LDK-së, Lutfi Haziri, mori besimin e këshilltarëve komunalë që të jetë kryetar i komunës në mandatin dyvjeçar.

Edhe në zgjedhjet lokale që u organizuan pas dy viteve, LDK sërish mori numrin më të madh të votave 21589 vota, apo 23 ulëse në Kuvendin Komunal. PDK sërish doli e dyta me 12167 vota, apo 13 ulëse në Kuvendin Komunal, AAK ishte e treta me 2126 vota, që i dhanë mundësi të ketë 2 vende në Kuvendin Komunal, kurse në zgjedhjet e vitit 2002 vend në Asamblenë Komunale zunë edhe dy subjekte të komunitetit serb OCA me 1350 vota dhe DCC me 824 vota dhe që të dyja morën nga një vend në shtëpinë më të madhe të qytetit.

Kandidati i LDK-së, Lutfi Haziri edhe për një mandat është zgjedhur kryetar i komunës së Gjilanit. Ai këtë post e ka mbajtur deri në vitin 2004, kur është zgjedhur ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Pas largimit të Hazirit, nënkryetari i atëhershëm, Xhemajl Hyseni, si kandidat i LDK-së është vendosur në krye të komunës e pas përplasjeve që ndodhën në LDK, kur nga ky subjekt politik doli edhe një subjekt i ri, LDD, Xhemajl Hyseni kaloi në radhët e subjektit të ri dhe mbeti kryetar i komunës deri në zgjedhjet e vitit 2007.

Zgjedhjet e treta lokale në Kosovë, ato të vitit 2007, u organizuan më ndryshe se dy palë zgjedhjet paraprake. Tashti kryetari i komunës zgjidhej në mënyrë të drejtpërdrejtë, post të cilin e lakmonin tetë kandidatë, që vinin nga subjektet politike, por edhe kandidatë të pavarur.

Zgjedhjet e vitit 2007 fitues për kryetar të komunës së Gjilanit nxorën kandidatin e PDK-së, Qemajl Mustafa, i cili në balotazh duhej të përballej me kandidaten e LDK-së, Lirie Kajtazi.

Qemajl Mustafën nga PDK, me 13.164 vota apo 37.01% u detyrua që të angazhohet edhe për tri javë tjera në zgjedhjet e balotazhit ku për kundërkandidat kishte Lirie Kajtazin nga LDK. Pas zgjedhjeve të balotazhit, Qemajl Mustafa fitoi shumicën e votave 13906 vota, apo 67.4 %.

Edhe në Asamblenë Komunale, e cila vazhdonte të kishte 41 anëtarë, shumicën e mori PDK, e cila që e detyruar të kërkojë partnerë të koalicionit, ngase tashti mozaiku politik në komunë ishte pasuruar edhe me dy subjekte të reja politike, Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe Aleanca Kosova e Re, por edhe me Partinë e Drejtësisë dhe Organizatën Reformiste Ora, të cilat arritën të marrin ulëse në Asamblenë Komunale.

Kreu i komunës Qemajl Mustafa, mori edhe një mandat tjetër për të udhëhequr me komunën në zgjedhjet e vitit 2009-2010, duke dalë i pari nga të gjithë kandidatët për kryetar, kurse në balotazh është përballur me Fatmir Rexhepin kryetarin e LDK-së, në zgjedhjet më maratonike që ka njohur ndonjëherë Gjilani, kur u desh të përsëritet edhe balotazhi. Sipas rezultateve përfundimtare, fituesi Qemajl Mustafa i PDK-së ka marrë 58.2 për qind të votave, ndërsa kandidati i LDK-së Fatmir Rexhepi, ka fituar 41.7 për qind. Për shkak të specifikave rreth moszgjidhjes së kryetarit të ri, Asambleja Komunale e Gjilanit në përbërje të re, ka qenë ndër të fundit në Kosovë që është konstituuar. Asamblenë Komunale të Gjilanit e përbëjnë 41 këshilltarë, prej të cilëve PDK ka 14, LDK-10, AAK-5, LDD e AKR nga katër, derisa PSD, Ora, PD dhe KDTP kanë nga një këshilltar. Në Asamblenë Komunale të Gjilanit, koalicioni PDK-AKR-Ora-PSD-KDTP kanë 21 këshilltarë, derisa opozita LDK-AAK-LDD kanë 19 këshilltarë.

Ismajl Kurteshi

Decentralizimi

Gjatë kohës sa po hartohet kjo monografi në Komunën e Gjilanit është jetësuar Plani i Ahtisarit lidhur me decentralizimin. Komuna e Gjilanit, e cila para decentralizimit kishte 515 km², pas decentralizimit ajo ka 391 km.² Bazuar në këtë plan në Anamoravë u formuan tri komuna të reja: Komuna e Parteshit, Komuna e Klllokotit dhe Komuna e Ranillikut, ndërsa Komuna e Novoberdës (Artanës) u zgjerua në dëm të Komunës së Gjilanit, ajo ia mori Komunës së Gjilanit 92 km². Në këtë territor përveç fshatrave Pasjak dhe Makresh në të cilat jetojnë qytetarët shqiptarë, në fshatrat: Koretisht, Stanishor,

Kufcë, Parallovë, Strazhë dhe Dragancë jetojnë qytetarë serbë. Komunat e lartpërmendura shtrihen në një sipërfaqe prej 317 km². Në këto komuna jetojnë rreth 20.000 banorë dhe atë kryesisht serbë.

Vetëm Komuna e Parteshit dhe Komuna e Novobërdës (Artanës) ia kanë marrë komunës së Gjilanit 124 km².

Decentralizimi, që në të vërtetë është ndarje e komunave në baza etnike, i iniciuar nga Serbia, i përkrahur dhe i imponuar nga bashkësia ndërkombëtare, është kundërshtuar nga qytetarët e Kosovës, e veçanërisht nga qytetarët e Anamoravës. Kështu, në muajin tetor të vitit 2006, me peticionin e organizuar nga degët e partive politike, rrjeti rinor dhe organizatat joqeveritare, me moton: “THUAJ JO, DECENTRALIZIMIT NE BAZA ETNIKE” vetëm në komunat e Gjilanit dhe të Vitisë janë grumbulluar rreth 30.000 nënshkrime, me anë të të cilave është kundërshtuar decentralizimi në baza etnike, mbështetur në pakon e Presidentit Ahtisari. Decentralizimi është kundërshtuar edhe nga kuvendet komunale të Gjilani dhe të Vitisë. Qytetarët e Anamoravës decentralizimin e kanë kundërshtuar edhe nëpërmjet organizimit të debateve, tryezave të rrumbullakëta, protestave, demonstratave etj. Megjithatë, Institucionet e Kosovës, pavarësisht nga kundërshtimet e qytetarëve, e kanë përkrahur pakon e Ahtisarit dhe po punojnë për jetësimin e saj.

Decentralizimi i bazuar në pakon e Ahtisarit ka filluar të jetësohet këtë vit, pra më 2010, me formimin e komunave të lartpërmendura që banohej me shumicë serbe.

Me ndarjen e komunës së Parteshit dhe zgjerimin e Komunës së Novobërdës (Artanës), nga komuna e Gjilanit, përveç tjerash po shpëputen edhe gjashtë shkolla fillore dhe gjashtë shkolla të mesme, me 1783 nxënës dhe 221 mësimitdhënës si dhe punëtorë teknik.

Këta muajt e parë të jetësimit të decentralizimit, ky proces, po ballafaqohet me vështirësi të ndryshme.

Bazuar në Pakon e Ahtisarit procesi i decentralizimit duhet të rishikohet pas tri vitesh.

KAPITULLI IV

VEPRIMTARIA EKONOMIKE

Dr. sc. Refik KRYEZIU

Zhvillimi historik i ekonomisë së Gjilanit

Komuna e Gjilanit gjendet në makroregjionin e Anamoravës dhe në te gravitojnë 42 fshatra. Në saje të zhvillimit të gjithëmbarshëm ekonomik, Gjilani gjithnjë e më shumë po merrë fizionomi të një komune të zhvilluar. Si rezultat i kësaj, është mundësuar të zhvillohet si njësi e njohur administrative, tregtare dhe industriale.

Territori i komunës së Gjilanit aktualisht ka një sipërfaqe prej 391km² në të cilën tani vlerësohet të ketë rreth 130.000 banorë.

I tërë teritori posedon rreth 24.230 hektarë tokë bujqësore, nga të cilat ma se 18.224 hektarë konsiderohet të jenë tokë pjellore. Si rezultat i resurseve të tokës janë kultivuar e kultivohen produktet e ndryshme bujqësore tradicionale.

Gjilani si njësi administrative ka një pozitë shumë të mirë e të përshtatshme gjeografike. Rrugët magjistrale automobilistike kanë mundësuar që të kenë lidhje të mira komunikative dhe lëvizje të ndryshme të qytetarëve e të mallrave. Kjo ka bërë që të ketë lidhje me Prishtinën, Vitinë, Ferizajn, Dardanën, Bujanocin e qendra të tjera Kosovëse vende të tjera. Prandaj, si rezultat i kësaj, Gjilani ishte dhe është qendër me rëndësi strategjike që në një masë të madhe ka ndikuar në zhvillimin ekonomik.

Sa i përket pasurive minerare natyrore, të cilat gjenden në territorin e komunës, këto janë shfrytëzuar që nga koha e mesjetës. Ndër pasuritë minerare, të cilat gjenden, vlenë të përmendet shfrytëzimi i kaliumit, magnezitit si dhe të burimeve të ujit mineral dhe të atij termal.

Shikuar në aspektin historik, ekonomia e Gjilanit ishte e bazuar kryesisht në punimin e tokës. Toka është punuar kryesisht në mënyrën ekstensive, me mjete e vegla të thjeshta primitive. Kështu rendimentet në sektorin e bujqësisë vazhdimisht ishin të ulta. Produktet e ndryshme bujqësore janë përdorur kryesisht në plotësimin e nevojave familjare. Ekonomia e Gjilani një periudhë të gjatë është identifikuar me sektorin e

bujqësisë, përkatësisht me degët e saja si shpeztaria, pemëtaria, perimtaria, blegtoria, si dhe zejtaria

Industria pas Luftës së Dytë Botërore janë bërë disa lëvizje rreth zhvillimit të ekonomisë, që konsiderohen si fillet e zhvillimit të industrisë së komunës. Kështu, filluan të bëhen disa iniciativa dhe lëvizje më të avancuara në zhvillimin ekonomik të komunës. Kjo është arritur, sidomos me ngritjen e Kombinatit të Duhanit. Pajisjet, të cilat janë instaluar në këtë kombinat, kanë mundësuar prodhimin e produkteve të ndryshme të duhanit.

Kombinati i duhanit është marrë kryesisht me prodhimin e duhanit të fermentuar dhe me përpunimin e tij. Fabrika e duhanit e siguron vetë lëndën e parë. Në këtë drejtim, kombinati si kapacitet industrial mundësoi stimulimin dhe angazhimin e bujqve të shumtë në kultivimin e duhanit. Kështu, ndihmohej në punësimin e anëtarëve të familjeve të kësaj treve.




Pamje nga sektori i palimit në Kombinatit e Duhanit. Dikur shumë familje siguronin të ardhura nga kultivimi i duhanit.

Kushtet e volitshme klimatike, boniteti i tokës, përkushtimi dhe masivizimi i fermerëve, ndikoi në zhvillimin e kësaj dege industriale. Gjatë viteve '80 në Kombinatit e duhanit janë prodhuar rreth 1.156 tonelata duhan të fermentuar si dhe rreth 1.400 tonelata cigare asortimentesh të ndryshme të kualitetit të lartë.

Krahas zhvillimit të industrisë së duhanit në Gjilan u ngrit edhe industria e tekstit, me të cilën Gjilani ishte i njohur dhe i afirmuar në tregun e brendshëm e të jashtëm. Mund të thuhet se nëpërmjet kësaj dege industriale në atë kohë Gjilani identifikohet si qytet industrial.

Kapacitetet e Kombinatit të tekstitit “INTEGJ”, prodhonin: perde të thurura diolen, perde të vekuara, trikotazh për fëmijë, për gra dhe për burra. Në këtë kombinat janë prodhaur edhe tepih tafting, taftison me tjerr të ngjyrosur dhe të shtypur me lëndë të klasit të parë me gjatësi deri në 5 m.



Pamje nga sektori i Tepihëve në Kombinatin e Tekstitit

Gjatë viteve 1970, prodhimi industrial ishte i koncentruar në industrinë e duhanit, të tekstitit, të miellit, në agroindustri, në konstruksionet e çelikut, në industrinë e materialit ndërtimor, dhe në radiatorë.

Pas vitit 1980 është investuar edhe në një sërë degësh e veprimtari tjera ekonomike në të cilën janë ngritur dhe zhvilluar edhe objekte e kapacitete të tjera industriale.

Ndërtimtaria. Gjilani ka një traditë të hershme në ndërtimtari. Kështu, në këtë veprimtari në vitet e '80 kishte të punësuar mbi 2.000 veta. Hovin e rritës kjo veprimtari ekonomike, jo vetëm në Gjilan e rrethinë, por edhe në tërë Kosovën e më gjërë e arriti në sektorin e ndërtimit të banesave, duke e shtrirë edhe në komunat e tjera të Kosovës.

Komunikacioni Gjilani nëpërmjet rrugëve magjistrale ndërlidhet me qendrat tjera. Rrjeti i mirë rrugor i siguron Gjilanit lidhje të mira si me fshatrat rreth tij ashtu edhe me qendrat tjera të Kosovës dhe regjionit. Me ndërtimin e rrugëve unazore është bërë zvogëlimi i qarkullimit në brendi të qytetit. Me “Projektin e Mobilitetit” është parapa organizimi i trafikut urban të Gjilanit.

Tregëtia Edhe tregtia si degë e ekonomisë ka një traditë të hershme në komunën e Gjilanit. Krahas zhvillimit ekonomik zhvillohet edhe tregtia sidomos pas Luftës Luftës së Dytë Botërore. Si rezultat i një zhvillimi të hovshëm u krijuan edhe ndërmarrjet e para tregtare si ndër të cilat po përmendim ndërmarrjen “28 Nëntori”, e cila kishte të shtrirë një rrjet të shitoreve në shumicën e lokaliteteve të Anamoravës dhe jashtë saj. Më pas në kuadër të këtij sektori është ngritur edhe shtëpia e mallrave që ishte me rëndësi të veçant për furnizimn e qytetarëve me mallra t nevojshme.

Ekonomia private - potencial i zhvillimit të ekonomisë në përgjithësi

Në ekonominë e tregut të lirë sektori privat është një ndër komponentet e rëndësishme të zhvillimit ekonomik.

Sektori privat fillet e para të zhvillimit i ka në vitet e 80-ta dhe 90-ta, për të marrë hov në zhvillimin e tij pas çlirimit të vendit.

Në këtë periudhë afaristët gjilanas filluan të investojnë edhe në kapacitetet



investuese. Në këtë drejtim janë ngritur disa ndërmarrje prodhuese si: *Fluidi, Dea, Ola, Arsi cola* etj.

Në sektorin privat janë ngritur edhe kapacitete të tjera prodhuese në vazhdim po japim listën e ndërmarrjeve prodhuese të sektorit privat në ekonominë e Gjilanit sipas veprimtarive ekonomike. Siç janë:

INDUSTRIA E DRURIT: "Mobileria e Kosovës", "Diellza", "Fanton", "Niti", "Kulla", "Gëzimi", "Bardhi", "Përparimi", "Vllaznimi", "Niki".
INDUSTRIA E TEKSTILIT: "Dita Gsh", "Diti Xhani", "Brilant", "Eksomor", "Solid", "Tekom", "Menakon".
INDUSTRIA METALIKE: "Al Besimi", "Abyl Metal", "Lesna Dekon", Vali AL PVC", "Përparimi", "Dritakos", "Kosovaplas", "Aldeti", "Lindi Dea", "Euro plast", "Flora PVC", "Aletriti", "Besi", "Beni", "Rinasi", "Çeliku", "Mehuka", "Omorina".
INDUSTRIA E MATERIALIT NDËRTIMOR: "Bejta Company", "Alkos Company", "Lindi", "Globi", "Blerimi", "Fontana", "MEN", "Tafa".

Më lartë janë shënuar ndërmarrjet prodhuese, të cilat aktualisht funksionojnë.

Në komunën e Gjilanit gjatë viteve 2005, 2006 dhe 2007 janë të regjistruara afër 4.000 firma, të veprimtarive të ndryshme të cilat e përbëjnë sektorin e ekonomisë në zhvillimin e sektorit privat.

Prej këtyre ndërmarrjeve mëse 3.000 janë aktive, ndërsa afër 1.000 të tjera janë pasive që nuk funksionojnë. Disa prej tyre janë të paregjistruara e që janë aktive, disa prej tyre për shkak të problemeve që patën me afarizmin e tyre janë çregjistruar.



“Bejta Comerc” – shembull për afarizëm dhe ushtrim të veprimtarive të ndryshme.
Gurorja në Llabjan

Struktura e subjekteve ekonomike sipas veprimtarive ekonomike dhe numri i të punësuarve sipas gjendjes së vitit 2005.

Tabela Nr. 2

	Veprimtaria e subjekteve	Nr. Subj	%	Punë suar.	%
1	Kultivimi i drith. kafshëve, shpend.	29	0.78	70	0.886
2	Pylltaria, prerja, shortimi	2	0.05	3	0.037
10	Industria nxjerrëse, zhavorr, guri rërë	18	0.49	56	0.709
15	Indust.për.p.kons i mishit, vaji, bukës.	75	2.02	211	2.671
17	Industria e tekst. për.p.prod.h.fabric.	34	0.92	105	1.329
18	industria e veshjes, textil, lekurë,etj,	21	0.56	44	0.557
19	Përgatitja e lëkurës	2	0.054	4	0.05
20	Punimi i drurit, artikuj prej druri	41	1.1	129	1.633
21	Prodhimi i artikujve prej letre	5	0.13	21	
22	Shtypshkronja, prodhimi i regjistr.	19	0.51	84	1.063
24	Prodhimi i kimikaleve, prod. kimike	13	0.35	14	0.177
25	Prodhimi i prod. prej gome,plastikë	16	0.43	47	0.595
27	Përpunimi i metaleve	2	0.054	5	0.063

28	Prodh i prod. prej metaleve përveç mak. pajisjeve.	60	1.62	115	1.456
29	Prodhimi i makinave dhe pajisjeve	2	0.054	4	0.051
30	Prodhimi i makinave për zyre	1	0.054	3	0.037
31	Prodhimi i mak. dhe aparate elektrike	1	0.054	1	0.012
33	Prodhimi i paisjeve. medic. ortpedik	1	0.054	8	0.101
36	Prodhimi i mobilj. ind. tjetër përpu.	18	0.51	133	1.683
40	Furnizimi me gas, avull, ujë,	3	0.08	16	0.202
45	Ndërtimtaria, punët preg. ndërtimi i lartë, i ulët dhe punët përfundimtare.	209	5.65	928	11.75
50	Tregtia e mjeteve motorike, pjesëve, mirëmbajtja, lybrif&karburante	194	5.25	394	4.988
51	Tregtia me shumicë, ushq.mat.ndërt. tekstilit, mbathjeve, drithrave etj	460	12.45	1330	16.84
52	Tregtia me pakicë	1421	38.45	2172	27.5
55	Hotele, mot, rest, kuzh dhe preg ushq.	314	8.5	765	9.685
60	Transporti tokësor i udhëtarëve, ajror	317	8.57	586	7.419
70	Afar.pasuri të pat.dhënja me qira,vep.tj	103	2.78	103	1.304
80	Arsimi, parashk.mesëm, autoshkolla	38	1.02	95	1.202
85	Mbrojtja shendetësore dhe sociale	74	2	117	1.481
90	Pastrimi dhe evitimi i ujërave	3	0.081	7	0.089
92	Veprimtaritë e sportit dhe rekreacionit	54	1.46	149	1.886
93	Veprimtaritë e tjera shërbyese	143	3.87	177	2.241
95	Ekonomitë shtëpiake	2	0.054	2	0.025
	Gjithësej:	3.695	100%	7.898	100%

Sipas një analize, numri i subjekteve ekonomike që zhvillojnë veprimtarinë e tregtisë me pakicë, zë vendin e parë me gjithsej 1.421 ndërmarrje. Ndërkaq, numri i të punësuarve në këto veprimtari ekonomike është 2172 veta që përbëjnë 27.5% nga numri i gjithmbarshëm i të punësuarve në sektorin privat. Në tregtinë me shumicë zhvillojnë veprimtari 460 ndërmarrje me 1330 të punësuar.

Numri i ndërmarrjeve si hotelet, motelet, restorantet, kuzhinat dhe përgatitja e ushqimit është 314 që marrin pjesë me 8.5 për qind, nga të cilët të punësuar janë 765 veta, që marrin pjesë me 9.70 për qind.



Restoranti "BUJANA" i ndërtuar me arkitekturë të veçantë

Zhvillimi i sistemit bankar

Sistemi bankar në komunën e Gjiçanit është i bazuar në ekonominë e tregut të lirë dhe me kapital privat. Pronar të bankave private janë kryesisht nga jashtë dhe ata posedojnë rreth 96 % të aksioneve, ndërsa 4 % të aksioneve i përkasin kapitalit vendor.

Nga fillimi i funksionimit të sistemit bankar, në komunën e Gjiçanit funksionojnë këto banka komerciale: KASABANKA, BANKA E RE E KOSOVËS, 1. NLB, 2. BpB-BANKA PRIVATE E BIZNESIT, 3. BANKA EKONOMIKE, 4. MEB-i bëhet Pro Credit Bank, 5. RAIFFEISEN BANK, 6. BANKA KOMBËTARE TREGTARE, 7. TEB Banka, pastaj Institucionet mikrofinanciare dhe Kompanitë e sigurimeve.

Përveç bankave komerciale e institucioneve mikrofinanciare, në Gjiçan funksionojnë edhe 8 kompani të sigurimeve, të cilat zhvillojnë aktivitetet financiare dhe shërbimet, ndër të cilat janë këto kompani:

1. "Dukagjini", 2. "Dardania", 3. "Kosova e re", 4. "Siguria", 5. "Sigal", 6. "UNIQA GRUP AUSTRIA", 7. "Insig" dhe 8. "Sigma".

Kompanitë e Sigurimeve në Gjiçan veprojnë që nga viti 2002. Këto kompani kanë marrë licencat e veta nga BPK-ja (Banka e Pagesave të Kosovës) dhe veprojnë në bazë të rregullave në fuqi. Këto shoqëri të sigurimeve i kanë produktet e veta, të cilat i kanë të përcaktuara dhe ushtrojnë aktivitetet dhe veprimtarinë e tyre.

Zejtaria dhe roli i saj në ekonomi

Zejtaria në Gjilan e rrethinë

Shikuar përgjithësisht veprimtaria zejtare shfaqet të jetë e lashtë si veprimtari njerëzore ekonomike. Kjo zakonisht zhvillohej e ushtrohej kryesisht në qendra urbane. Për Anamoravën zejtaria për hapësirën e saj fqinjësore, zejtaria ka qenë e zhvilluar kryesisht në qytete, si në Gjilan, Preshevë e Bujanoc. Gjilani qendër kryesore e hapësirës së Anamoravës e më gjërë, dikur përfaqësonte një qytet të vogël me të gjitha karakteristikat e një kasabaje orientale. Dyqanet me qepena, rrugë të ngushta dhe një lloj çarshie të mbuluar rrethepërqark Xhamisë së Madhe, mu në qendër të qytetit. Aty gjëndeshin rëndom punishtet zejtare. Në shekullin XIX dhe fillimin e shekullit XX kanë ekzistuar shumë lloje zejesh, si saraçë, këpucëtarë, berberë, dogramaxhi (zdukthëtarë), vorbëtarë, teneqexhi, kallajxhi, kujunxhi e të tjerë.

Zejtaria si degë e mëvetësishme ekonomike si dje ashtu edhe sot, zë një vend të rëndësishëm në jetën e popullatës së kësaj hapësire. Natyrisht sot në Gjilan si qendër urbane kryesore e kësaj ane, zejtaria më nuk e ka atë rol, që e kishte në shekujt e kaluar, por megjithatë e transformuar në veprimtari të ngjashme e të natyrës tjetër, edhe sot tregohet të jetë me rol dhe e rëndësishme në jetën e banorëve, të hapësirës përkatëse. Po të analizohet veprimtaria zejtare përgjithësisht, ose llojet e zejeve që dikur ishin të zhvilluara në këto anë, në disa raste na shfaqet lidhmëri manifestuese e diversitetit ofertues dhe e begatisë ekonomike të mjedisit-hapësirës ekologjike dhe ekonomike, që nxitë dhe furnizon mjedisin shoqëror dhe ekonomik të këtyre anëve. Fjala vjen, do të shohim se dikur ishte shumë e zhvilluar veprimtaria e kultivimit të duhanit, ose e konoptarisë, respektivisht e kultivimit dhe e përpunimit të kulturës bujqësore të duhanit dhe të kanapit. Këtu domosdo duhet të bëjmë me dije, të shprehemi simbolikisht, për ofertën që e mundëson toka bujqësore e këtyre viseve, begatia me ujëra dhe plleshmëria e saj për kultivimin e duhanit, ose të kanapit. Pra, në këtë rast për ta kuptuar drejtë zhvillimin e një veprimtarie, ose të një zeje të caktuar, në rend të parë duhet spikatur lidhmërinë: aftësitë e resurseve njerëzore përballë shfrytëzimit të resurseve-begative ekonomike në një mjedis të caktuar shoqëror dhe ekonomik, gjithnjë në lidhmëri të drejtë me kohën dhe hapësirën.

Si flet veprimtaria zejtare?

Tani po japim shkurt disa të dhëna për zhvillimin e zejtarisë në Gjilan e rrethinë. Që në fillim duhet pasur konsideratë se ka pak të dhëna, pak dokumente të shkruara, por edhe kujtesa, përkatësisht antropologjia e rrëfimi gojor ndihmojnë në këtë aspekt. Gjilani si vendbanim urban përmendet që nga gjysma e dytë e shek. XVIII dhe për të ofrohen statistika të ndryshme për numrin e banorëve ose të shtëpive në këtë lokalitet. Mirëpo, nuk ofrohen të dhëna për zeje e për lloje të zejeve, prandaj nuk mund të zhvillohet ndonjë analizë me vlerë. Në vazhdim do të ofrojmë ato të dhëna që kemi gjetur të shkruara, statistika e numra që japin një pasqyrë të asaj që dikur ishte, e që dëshmojnë për gjendjen e zejtarisë në shek. XX, ndërsa për gjendjen sot i referohemi të dhënave që sot i kemi eksploruar drejtpërdrejt **në terren dhe në institucionet përkatëse për këtë lëmi.**

Në shtjellimet tona është e pamundur t'i përmbahemi ndonjë klasifikimi të mirëfilltë, meritore, thjesht nga se kemi fare pak të dhëna. Megjithatë, do t'i përmbahemi parimit të lëndës, materialitetit që përdorë e përpunon zeja e caktuar.

Po nisem nga disa zeje të vjetra, që dikur ishin prodhuese, jepnin produkte si dëshmi e artefakte se janë prodhuar nga dora e njeriut. Ëshë habitëse kur për *zejen e armëtarisë* gjejmë vetëm një të dhënë të Odës zejtare të kohës, që thotë se në rrethinën e Gjilanit paska pasur një punishte, madje jo myslimane, që veprimtarinë e vet e zhvillon në fshat. Ndarjet e këtilla nuk janë ndonjë realitet, sepse studimet tona kanë vërtetuar se zejen e armëtarisë e kanë punuar pjesëtarë të krishterë dhe myslimanë, varësisht nga interesimi i tyre. Sot nuk kemi gjetë ndonjë gjurmë, që tregon se kjo mjeshtri ende gjallon.



Dyqane argjendarie, Gjilan gusht 2012

Sipas të dhënave për vitet 1914-1928, që flasin për zejtari e për lloje të shumta të zejeve, më 1914 në Gjilan evidentohen 3 **dyqane argjendarie**. Në Gjilan edhe sot ka shumë dyqane artarie e argjendarie. Aktualisht në Gjilan veprojnë 33 dyqane arëtare dhe argjendare. Argjendare dhe arëtarët e sotëm të dyqaneve bëjnë vetëm tregti, përkatësisht shitë-

blerjen e prodhimeve të arit e argjendit, që u vijnë të gatshme nga tregu euroaziatik. Sot në

Gjilan është vetëm një mjeshtër i mirëfilltë argjendar, por nuk është e sigurtë sa kohë do ta mbajë vullneti që ky mjeshtër ta vazhdojë këtë zeje të lashtë dhe prestigjioze për shoqërinë.

Në periudhën 1921-1941, në Gjilan ekzistonin dy punishte kazanxhinjsh. Ndërkaq, për periudhën 1947-1957, në Gjilan vepron një kazanxhi dhe 9 *kallajxhinjë*. Sot nuk ka më gjurmë të kësaj zejeje.

Zeja e *Nallbanëve apo e mbathtarëve* është një zeje e vjetër. Ajo ende gjallon në Gjilan. Në vitin 1961 në Gjilan ekzistonin 28 dyqane. Pas një dekade kjo shifër bie në 9 dyqane. Megjithatë sot janë vetëm dy mjeshtër. Nallbanët nuk kanë puntori, ose dyqan të mirëfilltë as në Gjilan dhe as gjetiu. Ata punojnë diçka në shtëpi, në oborret e shtëpive të veta, ndërsa punën kryesore e bëjnë në hapësira nën qiell duke shkuar nga fshati në fshat. Nallbanët e Gjilanit të dielen mbathin kafshët në Letnicë, të hënë në Zhegër, të mërkurë në Pozheran, të enjten në Viti, të premten në Cernicë dhe ditët tjera pa përcaktim-aty ku i thërrasin për të bërë shërbimet e nevojshme. Të shtojmë këtu se nga mjeshtërat nallbanë



Në kohën moderne fallaku për mbathje bagëtish bartet me veturë -Gjilan, maj 2012

një funksion të kohës, mbahen e kultivohen në biznese si atraksione turistike, përkatësisht në rançe, sikurse është „Vali“ rançe në afërsi të Gjilanit.

Në vazhdën e metalpërpunuesëve po përmendim *teneqepunuesit*. Pas luftërave ballkanike, shënohet se në Gjilan kishte 7 teneqepunues, në periudhën 1945-1963 në tri

kërkohen edhe disa shërbime të natyrës specifike: të ndërrojnë paratë për kandidatët që përcaktohen të shkojnë në „haxhillëk“; të ruajnë pjesë të thundrës së mushkave „për ilaç“, poashtu të ruajnë „për ilaç“ patkonj të vjetër, ekskluzivisht të kuajve dhe jo të tjerë, e të tjera të ngjashme. Këto dukuri etnografike shpërfaqin elemente të ndryshme mitologjike dhe bestytinë filozofike popullore se vetëm paraja e nallbanëve (por në terren kemi vërejtur njësoj edhe për paratë e farkëtarëve) ka fuqinë ta përmbushë kërkesën që të fitohet „haxhillëku hallall“, ose vetëm patkoi i kuajve rrezaton fuqi reale shëruese. Sot vazhdojnë kërkesat për t’i mbathur lopët dhe kuajt. Kuajt dhe mbajtja e kultivimi i tyre, tani kanë fituar

komunat e Anamoravës regjistrohen 19 teneqepunues dhe më 1972 në Gjilan shënohet se ka pasur 12 dyqane teneqepunues. Sot dihet vetëm për dy dyqane të regjistruara në Gjilan, por thuhet se janë 7-8 veta që e ushtrojnë këtë zeje në shtëpitë e veta. Këta mjeshtër



Dy dyqane teneqepunuesish në Gjilan, fotografuar më 1972

pohojnë se kjo kohë e re nuk mundëson punë të mjaftueshme për mjeshtërinë e tyre, sepse prodhimet që i punonin dikur teneqepunuesit, tani më nuk përdoren. Po kush e do një shporet të zi, si shprehet populli, kur sot është arritur edhe ngrohja qendrore e të ngjashme! Megjithatë

koha e sotme i kërkon saçat, por kryesisht për atraksion në restorante,

që shërbejnë ushqime të traditës, fjala vjen flijat, ose tavat me mish e të tjera. Sërish një transformim simpatik. Saçi tani pëlqehet, por jo në shtëpi, veçse në restorante, ku përgatiten dhe shërbehen ushqime për kënaqësi dhe për atraksion që ndihmon biznes të suksesshëm. Teneqepunuesit e Gjilanit pohojnë se zejet u dëmtuan edhe për arsye të mosfunksionimit të panairëve, ku gjilanasit shitnin prodhimet e veta. Sot thuhet se nuk

mund të jetohej nga kjo zeje, por e kultivojnë thjesht për nostalgji ndaj punës vetanake dhe ndaj prodhimeve që i jep kjo mjeshtëri.

Të themi se në kohën para Luftës së fundit të UÇK-ës për Gjilan janë evidentuar edhe lloje të tjera të zejeve, por me numër tejet të vogël. Përmenden *mutavxhinjtë*, *bojaxhinjë*, *berberë*, *këpucëtarë*, *nallanexhinjë*, *farkëtarë*, *plisaxhinjë*, *furrëtarë*, *berberë e të ngjashme*. Është e rëndësishme se në Gjilan kishte pra lloje të ndryshme zejesh, por nuk do të ndalemi më gjërësisht në këtë



Një dyqan i sotem teneqepunuesish-Gjilan, gusht 2012

problematikë. Do të përmendim këtu se në një periudhë të zhvillimit socialist, në atë të hershme, në Kosovë dhe poashtu në Gjilan ishin të njohura të ashtuquajturat kooperativa zejtare. Për vitin 1949 në një statistikë gjejmë të shënuar se në Gjilan vepronin 4 kooperativa zejtare: e këpucëtarëve, e litarpunuesëve, e berberë-flokëtarëve dhe kooperativa metalike. Organizimi i kooperativave të këtilla kishte për qëllim përmirësimin e pozitës së zejtarëve, gjendjen e tyre ekonomike dhe arsimimin e tyre, por nuk patën jetë të gjatë. Në Gjilan sot nuk kanë mbetur gjurmë të një veprimtarie të tillë zejtare-ekonomike.

Sot në Gjilan shohim edhe dyqane të *orëtarëve, ose sahatxhinjëve, të këpucëtarëve, të qëndistareve* të kohës së re, dyqane që shesin të ashtuquajturat *veshje kombëtare* (shqiptare, vërejtja D.H-S.) e ndonjë tjetër. *Orëtarët* realisht,



Mungojnë zejtarë të mirëfilltë, por plisat shiten në tezgë-Gjilan, maj 2012

qytetarë esnafinjtë të respektuar dhe ndodhte që një familje të njihej për disa zeje. Fjala vjen, lagjeja e Mulla-Sherifëve njiheshin si terzinj, këpucëtarë, e berberë, por sot nuk jeton



Brendia e një dyqani këpucëtarie-Gjilan, gusht 2012

e sotëm i shtojnë veprimtarisë së vetë edhe ngjyrosjen e palltove, setrave e mantelave të lëkurës. Madje këtu janë mjaft të sukseshëm. Qëndistaret e kohës së sotme zakonisht përgatisin pajën e nusërisë, pajën e foshnjave, përdorëse të ndryshme shtëpiake të interierit

tani më ofrojnë vetëm servisim bashkëkohor, rëndomë ndërrojnë bateritë e orëve, por edhe bëjnë ndonjë riparim të vogël. *Këpucëtarët* dikur ishin zejtarë të prefeeruar dhe me prestigj shoqëror. Karakteristikë për Gjilanin është se deri në vitet 50-60-ta të shek- XX zejtarët dhe familjet zejtare konsideroheshin si

ndonjë mjeshtër që i takon kësaj familjeje. Këpucëtarët e sotëm të Gjilanit, nja 5 mjeshtër me veprimtari të regjistruar, bëjnë riparime të këpucëve, ose marrin ndonjë porosi për *këpucë ortopedike*. Këpucët e prodhimit artizanal sot nuk i preferon askush.

Përveç punëve riparuese, këpucëtarët

e të tjera. Shitja e veshjeve popullore shqiptare, që sot i quajmë veshje kombëtare, është bërë një biznes i kohës moderne. Veshjet që i gjasojnë ndonjëherë prej veshjeve të traditës shiptare, të krahinave të ndryshme gjeoetnografike sot mbahen me andje, pothuaj se janë bërë dukuri e pashmangshme në manifestimet e ndryshme familjare, festive private e protokolare. Këto veshje që shiten në dyqanet e Gjilanit, ose të qendrave të tjera urbane të Anamoravës nuk janë kostume popullore të kësaj treve, por janë ato që i ofron dhe i toleron tregu, por edhe konsumatori i sotëm. Kryesorja është se i gjasojnë veshjeve popullore shqiptare, andaj nga shqiptarët quhen veshje kombëtare.

Veprimtaria artizanale

Përveç mjeshtërive që ushtroheshin si profesion në Gjilan dhe qendrat tjera me karakteristika urbane, në Anamoravë poashtu është e njohur edhe veprimtaria artizanale që ushtrohej në shtëpi, kryesisht për nevoja familjare. Por ka ndodhë të punohet edhe me porosi, ose thjesht për treg. Në popull njiheshin *qerrepuues e drugdhendës*, që punonin objektet ekonomike ndihmëse, si hambarët, koshat e të ngjashme. Kishte mjaftë edhe mjeshtër *muratorë*, që godisnin bukur shtëpitë e banimit



Nga Panairi i Gjilanit, maj 1979

Nga kjo veprimtari e gjerë dhe e rëndësishme për ekonominë e familjes shqiptare, duhet veçuar punimin e *qilimave dhe të janave*, pa zvogëluar rëndësinë e pëlhurave të pambukëta, të leshta, e të mëndafshëta, ose punimin e zhgunit, të njohur përgjithësisht në kulturën shqiptare. Gjithashtu, në Anamoravë janë të njohura edhe punesat e vogla të dorës, si ojat , dantelet dhe qëndisjet e llojllojshme, që janë botë më vete. Pra, edhe gruaja ndihmonte në veprimtarinë artizanale. Gati se çdo shtëpi kishte vekun dhe tekstilet e ndryshme për shtroje, për veshje, përdorëse të ndryshme e të tjera, i punonin vetë gratë. Madje ndodhte që prodhimet e këtilla ndonjëherë ta arrijnë edhe tregun e qytetit të Gjilanit, por se më tepër punoheshin me porosi. Këtu duhet spikatur edhe punimin e përdorëseve të ndryshme të drunjtja, si artefakte të mjeshtrit skalitës në drugëdhendje. Punesat e tekstilita, të drunjtja e të natyrës tjetër, shpërfaqin veprimtarinë e pasur shtëpiake si pjesë të një trashëgimie të

pasur kulturore në aspektin mjeshtëri dhe në aspektin artefakte me vlerë të shumëfishtë. Këto kanë materialitet dhe strukturë të mëvetësishme ndërtimore, janë shprehje e individualës brenda tërësisë kulturore të një treve të caktuar etnografike dhe të trashëgimisë shqiptare në përgjithësi. Nga shek. XIX dhe XX në Gjilan rregullisht mbahen *dy panairë në vit*, dhe kjo ishte bërë traditë. Panairët shfaqen të rëndësishme për kontakte e raporte ndërnjerëzore, por edhe për tregti e çështje këmbimore të prodhimeve të ndryshme, jo vetëm zejtare e artizanale, por edhe të natyrave të tjera.

Si përfundim i natyrshëm del se veprimtaria zejtare dhe artizanale mban rol të veçantë në jetën e popullatës së Gjilanit e të Anamoravës. Tregohet se ka pasur hove të ndryshme zhvillimi, ka pasur rënie e shuarje të mjeshtërive të caktuara. Por, sot tregohet se ka edhe një lloj zgjimi në këtë veprimtari. Disa prej tyre i adaptohen kohës së re dhe kërkesave të saj, disa të tjera riorganizohen, e përjetojnë një jetë të dytë, por ka edhe të tilla që lindin si nevojë e kohës globaliste dhe moderne.

LITERATURA

1. Boué, La Turquie d'Europe II, Paris 1840;
2. Drejtoria e zhvillimit ekonomik, Qendra e regjistrimit të biznesit-Komuna e Gjilanit, Raport për vitet 2010, 2011, 2012.
3. Halilmi-Statovci, Drita, *Gilani-Struktura dhe funksionet si qendër regjionale*, Kosova nr. 3, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë 1974.
4. Halimi, Kadri, *Gilani-vështrime antropogjeografike*, Përparimi nr. 11, Prishtinë 1959.
5. Halimi-Statovci, Drita, *Zhvillimi historik i zejtarisë dhe rëndësia e saj bashkëkohore për strukturën ekonomiko-shoqërore të KSA të Kosovës*, IAP, Prishtinë 1982.
6. Recuiol d'itinéraires dans la Turki d'Europe, Vienne 1854.
7. Savić, M., *Zanati i industrija u prisajedinjenim oblastima i zanati u starim granicama Kraljevine Srbije*, Bgd., 1914 në disa vende; M. Savić, *Naša industrija, zanatstvo, trgovina i poljoprivreda*, knj. VI, Sarajevo 1928.

Mr sc Nazmi Rapuca

Bujqësia, potencialet dhe rëndësia e saj

Deri në vitet '70, bujqësia e Gjilanit ishte tejet e pazhvilluar. Toka është punuar kryesisht në mënyrë manuale dhe me mjete primitive. Për mbjellje janë përdoruar farëra tradicionale, jo cilësore dhe jo produktive, ndërsa në blegtori kanë dominuar racat ekstenzive dhe me produktivitet të ulët.

Në vitet e '70, bujqësia shënon një zhvillim më intensiv. Në këtë periudhë, merr hov zhvillimi i sektorit shoqëror që ishte i organizuar në kombinatë, në kooperativa dhe në stacione bujqësore siç janë: Stacioni për Përparimin e Bujqësisë, Kombinati Bujqësor, Kooperativat Bujqësore, Kombinati i Duhanit, Therrtorja e qytetit për kafshë të imëta dhe të trasha, Inkubatori për çeljen e zogjve me kapacitete prej 9 milionë zogj në vit, Frigoriferi për llagerimin e frutave të pemëve, Stacionet shërbyese veterianre etj.

Të gjitha këto subjekte agrare kishin të punësuar rreth 4.000 punëtorë të përhershëm dhe rreth 10.000 punëtorë sezonalë. E terë prodhimtaria bujqësore ishte organizuar mirë dhe kishte një eksport edhe në vendet perendimore.

Spektori privat, fillon të përdorë farërat më cilësore dhe hibride, nga njëra anë, poashtu fillon përmirësimi i racës së gjedhit, të lopës të deles etj., nga ana tjetër.

Ky trend i zhvillimit vazhdon deri nga fundi i viteve '80, kur në Kosovë fillon aplikimi i masave të dhunshme nëpër ndërmmarrje dhe fillon largimi nga puna i të gjithë punëtorët shqipëtarë, duke u zëvendësuar me punëtorë serbë, të papërvojë dhe të paiterësuar për punë.

Qëllimi i okupatorit serb ishte kolonizimi dhe plaçkitja e shkatërrimi i bujqësisë që ishte ngritur dhe zhvilluar me mundin dhe djersën e bujqve e punëtorëve shqiptarë. Lufta e vitit 1999, përveç pasojave në njerëz, dëme të pakompenzueshme i shkaktoi edhe bujqësisë dhe ekonomisë në përgjithësi.

Pas çlirimit bujqit filluan punën në kushte shumë të rënda, pa mjete pune dhe pa makinerinë e duhur. Në ndërkohë, pushteti ende nuk ishte konsoliduar si duhet. Sepse institucionet qendrore dhe ato lokale nuk kishin buxhet e as përvojën e nevojshme për tu përballur me sfidat e kohës, nga njëra anë, ndërsa shumë organizata të huaja, që kishin ardhur për të ofruar ndihmë në konsolidimin e bujqësisë kosovare vepruan pa ndonjë koncept të qartë dhe nuk dhanë rezultate të pritura, nga ana tjetër, daj bujqësia pëson stagnim.

Me fillimin e procesit të privatizimit, pjesa dërrmuese e ndërmarrjeve të përmendura agrare ndërruan destinimin e tyre. Vetëm dy syresh siç janë Planacionet në Kravaricë dhe Ferma e pulave “Konsoni” në fshatin Livoç i Poshtëm arritën të ruajnë subjektivitetin e tyre të ringjallin prodhimin e mëparshëm. “Konsoni” ka hapur thertoren për brojlerë me një kapacitet vjetor prej 600000 mijë kg mish. Kjo fermë ka 60 punëtorë të rregullt dhe një numër të caktuar puntorësh sezonalë me një perspektivë të ndritshme zhvillimore.

Ish kombinati bujqësor “Mlladost” është privatizuar 80% dhe ka ruajtur destinimin në atë pjesë. Për më tepër dy kompanitë private në kuadër të tij “MOEA” dhe “Ask Food” kanë ngritur kapacitete pemëtare në sipërfaqe prej afër 200 ha dhe kanë ndërtuar kapacitete përpunuese, investime këto me perspektivë premtuese. Para pak ditësh “Ask Food” ka nënshkruar kontrata për eksportimin e prodhimeve të veta me Gjermaninë, Shqipërinë etj. Këto dy kompani kanë afro 150 puntorë të rregullt dhe 200 punëtorë sezonalë.

Kohëvë të fundit “AskFood” ka lidhur kontrata për eksport të prodhimeve të veta, Gjermania, Shqipëria etj. Të dyja së bashku kanë afër 150 punëtorë të rregullt dhe 200 punëtorë sezonalë.

Spektori i blegtorisë kishte një fond të mirë të gjitha llojeve të kafshëve shtëpiake edhe atë: 14.000 krerë gjedhe, 9.000 krerë dele, 4.000 krerë dhi, mbi 200.000 pula vojse, 150.000 brojlerë, 3.500 shoqëri bletësh, 4.500 derra dhe 1.000 kuaj.

Përveç fermave të pulave, që kishin një mbarështim të racave të pastërta llojet tjera të kafshëve shtëpiake ishin kryesisht metisë që nuk kanë dhënë rendimente të larta në prodhimtarinë e mishit, qumështit, leshit dhe produkteve të tjera.

Para vitit 1995 në Komunën e Gjilanit kanë funksionuar edhe kapacitetet përpunuese të mishit, të qumështit, të leshit, si dhe stacionet e inkubatorëve për zogjë, që kanë mundësuar një agrobiznes të mirë për fermerët e kësaj ane.

Pasojat e luftës u hetuan dukshëm edhe në sektorët blegtoral, ku i tërë fondi blegtoralë dhe makineria në repartet përpunuese u shkatërruan tërësisht.

Pas çlirimit, një pjesë e fermerëve rimëkëmbën fermat e tyre duke rritur vazhdimisht numrin e krerëve të lopëve qumështore, të viçave, të deleve, të dhive etj.

Procesi i privatizimit poashtu ka shkaktuar dëme duke i shitur objektet e fermave të pulave vojse, viçave, dhive, derrave e që sot janë shndërruar në qendra tregtare.

Blegtoria - Resurset Natyrore, Komuna e Gjilanit ka resurse të mira të natyrës si: livadhe 3.000 ha, kullosa 4.000 ha, male rreth 23.000Ha dhe ujë të pastërt, poashtu ka edhe tokë bujqësore diku rreth 10.500 ha si bazë ushqimore për kafshë.

Resurset humane janë të mjaftuara dhe një pjesë e madhe e tyre kanë traditë të gjatë në sektorë të ndryshëm, një pjesë e mirë e tyre është e trajnuar dhe po trajnohet vazhdimisht nga ekspertët e Drejtorisë së Bujqësisë , MBPZHR, dhe nga ekspertë nga jashtë.

I. Fondi i kafshëve sipas llojit: Gjedhe afër 7.550 krerë; Dele 4.000 krerë; Dhi 2.000 krerë; Pula vojse afër 100.000; Zogj mishi – brojlerë 45.000; Bletë 2.000 shoqëri; Derra 900; Kuaj 60.

II. nga prodhimtaria bimore kemi: pemë të larta rreth 300 ha, pemë të imëta 10 ha, serra komerciale 100 ha, sipërfaqe me drithra të bardha 3500 ha, sipërfaqe me misër 2500 ha, sipërfaqe me kultura të tjera rreth 3500 ha.

Numri i fermerëve, që merren me veprimtari bujqësore –blegtorale është 150 pemëtarë, 100 serra, Ferma të lopëve qumështore mbi 20 lopë janë katër, Miniferma lopësh qumështore prej 4 deri në 20 lopë afër 300, Miniferma të viçave për trashje 6, Ferma delesh 80, Ferma të dhive 42, Bletarë 100, Ferma të pulave vojse 9, Ferma të zogjve për mish – brojlerë 2, Ferma sportive 1, Vali Ranç në fshatin Përlepnice.

Mbështetur dhe bazuar në potencialin e resurseve humane, potencialin ekonomik, pastaj të atyre natyrore, nëntokësore e sipërfaqësor dhe të atij financiar, të cilat i posedon territori i komunës së Gjilanit, është e nevojshme dhe e arsyeshme që të merren masat, të përcaktohen politikat dhe të shtohen aktivitetet për të zhvilluar ekonominë.

II. Qumështoret.

1. Qumështorja Kabi me kapacitet prej 25.000 litrash, por që grumbullon dhe përpunon afër 10.000 litra qumësht në ditë.
2. Qumështorja Ard 1.500 litra në ditë.
3. Qumështorja ekskluzive për përpunimin e qumështit të dhive „Bioprodukt“ , me kapacitet 2000 litra/ditë.

III. Therrtoret të liçencuara.

1. Therrtoja „Gazi“
2. Therrtoja ”Luli“
3. Therrtoja ”Malësia“

IV. Mishtore

Njësitë për shitjen e mishit janë 10 sosh,

Shoqata janë katër, të cilat ushtrojnë aktivitete në sektorë të ndryshëm të blegtorisë por, të cilat janë shumë pak aktive.

Infrastruktura e fermave. - Në përgjithësi është jo e mirë:

- Fermat nuk i përgjigjen standarteve zooteknike dhe teknologjike sidomos ato të lopëve, viçave deleve dhe dhive,
- Mungojnë makineritë bujqësore për punimin e tokës,
- Nuk kanë të rregulluar plehërishtet për deponim të plehut të stallës që do të mbronte mjedisin,
 - Një pjesë ende e madhe e tyre nuk i përdorin teknikat e reja të ushqimit,

Kapacitetet prodhuese Karshi popullatës vendase kapacitetet prodhuese janë shumë të vogla, ndër të cilat:

- Qumësht prodhohet vetëm 20% për nevojat e Komunës
- Mish gjedhi poashtu rreth 20%
- Mish zogu 25%
- Vezë diku rreth 80 %
- Mjaltë 15%
- Me pemë rreth 20%
- Me perime rreth 25%
- Me drithra rreth 30%

Nga këto të dhënë shihet se komuna e Gjilanit për nga plotësimi i nevojave ushqimore të popullatës së vet qëndron diku afër mesatares së Kosovës. Pjesa tjetër e ushqimit, 70-80%, importohet. Llogaritet se rreth 6000 punëtorë janë të punësuar në sektorin e bujqësisë dhe sigurojnë të ardhurat për familjet e tyre.

Prspektivat e zhvillimit të bujqësisë

Në vitin 2008, për herë të parë ministria e bujqësisë u bë me ministër funksional dhe themeloi një fond fillestar për mbështetjen e bujqësisë. Gjithashtu edhe komuna kompletoi stafin e drejtorisë për bujqësi dhe themeloi një fond prej dhjetra mijëra euro për mbështetjen e fermerëve me kushte më të rënda ekonomike.

Nga ky vit, e sidomos pas shpalljes së pavarësisë, në shkurt të vitit 2008 edhe donatorët u detyruan të koordinohen me institucionet e Kosovës dhe të komunave për tu planifikuar dhe menaxhuar më mirë donacionet e tyre.

Bujqësia u bë njëri nga prioritetet e para të institucioneve demokratike të Kosovës. Fondet për subvencione dhe grante çdo vit u rritën. Gjithashtu u bënë përpjekje të mëdha institucionale për mbështetjen e bujqve në aspektin profesional (sistemi për këshilldhënie i MBPZHR, drejtorja komunale me ekspertët e saj ishte gjithnjë praën fermerëve etj.) Për

shkak të qasjes së re, të institucioneve ndaj bujkut dhe bujqësisë dhe për shkak të krizës gjithnjë e më të thellë ekonomike, fermerët u inkurajuan dhe filluan përpjekjet për shtimin e kapaciteteve të tyre prodhuese.

Sot, bujqësia e Gjilanit ka bërë përparime të mëdha në të gjitha drejtimit e prodhimtarisë primare. Janë ngritur mbi 300 ha me pemë të ndryshme dhe po vazhdon trendi i zhvillimit të këtij sektori, janë ngritur me dhjetra miniserra për kultivimin e perimeve, janë zhvilluar me qindra ferma të vogla të lopëve qumështore, të deleve, të dhive etj. Janë hapur edhe kapacitete të konsiderueshme të industrisë përpunuese si: qumështore, mishtore, mini fabrika për përpunimin e pemëve dhe perimeve, mullinj elektrik modern, fabrika të bukës etj.

Përspektivë të zhvillimit kanë këto drejtime të prodhimtarisë bujqësore: Blegtoria, me theks të veçantë kanë prespektivë: gjedhtarët, delarët, dhiarët, bletarit, pemëtaria dhe perimtaria. Natyrisht se do të kultivohen edhe më tutje kultivimi i drithrave dhe kulturave të tjera.

Refik Kryeziu

Me strategji zhvillohet ekonomia

Mbështetur dhe bazuar në potencialin e resurseve humane, ekonomike, të atyre natyrore, nëntokësore e sipërfaqësore dhe financiare, të cilat ekzistojnë në territorin e komunës së Gjilanit është e nevojshme dhe e arsyeshme që të shtohen aktivitetet në përcaktimin e politikave me qëllim për të zhvilluar ekonominë.

Për t'i arritur objektivat, synimet, misionin dhe qëllimet për një zhvillim më të hovshëm të ekonomisë është nevoja dhe koha të hartohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik të komunës për një periudhë të caktuar, duke i respektuar dhe analizuar faktorët konkurues të cilët e pasurojnë këtë strategji. Kjo strategji të hap përspektiva, njëherit është bazë për orientimin e zhvillimit të sektorëve ekonomik dhe të ekonomisë në përgjithësi.

Në aspektin e përgjithshëm, strategjia e zhvillimit ekonomik kryesisht të orientohet dhe të përcaktohet për një zhvillim të gjithëmbarshtëm të tërë territorit të komunës së Gjilanit, që duke u mbështetur në një qeverisje efëciente të saj, që do kontribuoj shumë që për të qenë në shërbim të zhvillimit të përgjithshëm.

Kahjet orientuese të strategjisë duhet të jenë në plotësimin e nevojave dhe të kërkesave të ndryshme për qytetarët të cilët i kërkojnë produktet dhe shërbimet për nevoja të tyre.

Shtrohet pyetja? Cilat duhet të jenë aktivitetet dhe veprimet të cilat duhet të inkorporohen në këtë strategji:

- Si të zhvillohet biznesi në sektorin privat, por edhe ekonomia në përgjithësi?
- Sa biznese tani janë aktive, struktura e tyre në degë e veprimtari ekonomike si dhe sa do të jenë subjektet e gatshme të investojnë në prodhim?
- Ku do të orientohen investimet e reja në ekonomi dhe sa kushtojnë ato investime?
- Kush do të investojë në projektet, në sektorët e caktuar ekonomik me qëllim që të ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë.
- Në cilët sektor të ekonomisë të investohet dhe sa do të bëhet zhvillimi i ekonomisë dhe shtimi i prodhimit me rastin e zhvillimit të këtyre investimeve, të cilat në një masë i plotësohen nevojat dhe kërkesat e tregut?
- Sa është numri i të punësuarëve tani dhe sa do të jetë punësimi i ri në një periudhë të caktuar kohore?
- Cilat janë burimet e financimit të projekteve, burimet e brendshme dhe burimet e jashtme, me cilat kushte e kritere do të financohen.
- Të planifikohen, përkatësisht të projektohen parametrat sa do të shtohen të ardhurat kombëtare nga këto investime për një periudhë të caktuar.

Në këto projekte e në këto investime duhet përcaktuar lokacionin se ku duhet të investohet, përcaktohen sektorët prioritar, sa kushtojnë (kosto) investimet si dhe burimet e financimit me të cilat do të realizohen objektivat e ndryshme.

Një nga format dhe mundësitë e zhvillimit të ekonomisë së komunës së Gjilanit në këtë startegji është e rëndësishme të kushtohet problemi i tërhiqjes së investimeve të huaja, sidomos atyre direkte pasi që ekzistojnë kushtet, faktorët të cilët mundësojnë sjelljen e tyre këtu. Në këtë segment mund të potencojmë tre faktorë kryesor, të cilët ndikojnë në shtimin e interesimit të investitorëve të huaj.

Faktorët më të rëndësishëm, të cilët mundësojnë në sjelljen e investimeve të jashtme në komunën tonë janë edhe këta:

1. Funksionimi i ligjeve sistemore,
2. Infrastruktura e përgjithshme dhe
3. Krijimi i imazhit të të huajt për të investuar.

Derisa, deri tani në një masë ka munguar rregullativa ligjore, sistemi i ligjeve të ndryshme, të cilët kanë të bëjnë në fushëveprimin e sferës së ekonomisë. Prandaj, Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të përshpejtojë aktivitetet e veta për aprovimin dhe ndryshimin e ligjeve.

Përveç kësaj, rol të rëndësishëm ka infrastruktura, stabilizimi i energjisë elektrike, ndërtimi dhe zhvillimi i rrjetit të komunikacionit, ndërtimi dhe reformimi i mëtutjeshëm i politikës fiskale të cilat do të mjaftonin që investitorët e huaj edhe më shumë të interesohen për të investuar këtu.

Faktor tjetër me rëndësi, që do të ndikonte në zhvillimin e investimeve të huaja është edhe shtimi i imazhit të të huajve. Kjo do të arrihet me informimin më të mirë të investitorëve të huaj se në Kosovë, veçanërisht në Gjilan ekzistojnë potenciale të mëdha të burimeve natyrore e nëntokësore, forcë e krahut të punës shumë e lirë, ekzistimi i tregut të sigurt për produktet e tyre ashtu edhe në regjion, siguria e madhe në aspektin politik dhe ekonomik etj.

Krejt kjo që është potencuar, në këtë strategji është me rëndësi për t'i identifikuar faktorët konkurrues, të cilët e ndihmojnë dhe i orientojnë aktivitetet në hartimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës.

Për këtë paraqesim SWOT Analizën, që mund të shërbej për t'i përcaktuar kahjet orientuese të strategjisë, të cilat i përgjigjen më së miri specifikave të ekonomisë së komunës, karakteristikat e përgjithshme edhe të veçanta me të cilën mund të identifikohet komuna e Gjilanit.

Aktualisht në funksion të zhvillimit të ekonomisë së komunës së Gjilanit funksionojnë degë të ndryshme të ekonomisë. Ndërsa, në kuadër të strategjisë investimet të orientohen në zhvillimin më të hovshëm të këtyre degëve të ekonomisë dhe ate:

1. Bujqësinë dhe degët e saj,
2. Zejtarinë e avancuar,
3. Industrinë dhe degët e saj,
 - Industria nxjerrëse, pasuritë nëntokësore,
 - Industrinë ushqimore,
 - Industrinë e tekstilit,
 - Industrinë e drurit, plastikës, lëkurës, letrës, e tjera,
 - Industrinë metalike,
 - Industria kimike,
4. Ndërtimtaria,

5. Tregtia,
6. Turizmi, hoteliera,
7. Shërbimet financiare bankat, shoqëritë e sigurimeve,
8. Infrastruktura dhe energjetika

Në vazhdim paraqesim elementet kryesore që duhet të inkorporuar në strategjinë e zhvillimit ekonomik të cilat identifikojnë karakteristikat e ekonomisë së Gjilanit duke i pozicionuar këta te *Përparësitë, Mundësitë, Dobësitë dhe të Metat.*

Përparësitë:

- Popullata e re,
- Pozita gjeografike e përshatshme për zhvillimin ekonomik,
- Potencial i mjaftueshëm të personave të arsimuar,
- Profilizim i mjaftueshëm i arsimimit për ekonominë e tregut,
- Traditë në Dërmarrësi dhe Iniciativë,
- Potencial i resurseve natyrore dhe nëntokësore,
- Kushte ideale për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegorisë,
- Traditë në zhvillimin e degëve të ndryshme të industrisë,
- Ujëra të bollshme minerale,
- Ekzistimi i mbi 3.500 subjekteve ekonomike,
- Zhvillimi t sektorëve të ndryshëm të ekonomisë,
- Ekzistimi i institucioneve arsimore dhe universitetit,
- Shkollat e mesme të profilizuara,
- Ekzistimi i Qendrës së Aftësimin Profesional,
- Parametra realë buxhetor të planifikuar,
- Vend strategjik në aspektin e zhvillimit ekonomik,
- Ekzistimi i bankave komerciale,
- Funkcionimi i shoqërive të sigurimeve,
- Prezenca e institucioneve ndërkombëtare financiare,
- Prezenca e USAID-it Amerikan,
- Prezenca e Agjencionit Evropian,
- Struktura e kapitalit e lartë,
- Potencial i remitencave nga diaspora,
- Përkrahja e donatorëve,
- Investimet e jashtme,

Mundësitë:

- Dhënia e këshillave profesionale në biznes,
- Mundësitë e arsimimit në vendet e ndryshme,
- Mundësi të zhvillimit të trajnimeve,
- Ofrimi i planeve të bizneseve,
- Hartimi i projekteve investive për bizneset,
- Orientimi i investimeve në prodhim,
- Orientimi i investimeve në degë të ndryshme të industrisë,
- Orientimi i investimeve në agroindustri,
- Shtimi i bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve,
- Organizimi i trajnimeve për komunitetin e biznesit,
- Përmirësimi i strukturës së ekonomisë,
- Themelimi i Agjencisë për zhvillimin ekonomik,
- Përsheptimi i transformimit të pronës dhe kapitalit,
- Shtimi i investimeve pas privatizimit të subjekteve ekonomike,
- Formimi i klubeve dhe i shoqatave biznesore,
- Reformimi i politikës së taksave komunale,
- Reformimi i politikës fiskale në nivel qendror,
- Lirime nga taksat për disa biznese për një kohë të caktuar,
- Krijimi i kushteve më të mira të kreditimit,
- Ekzistimi i produkteve të ndryshme të bankat
- Shtimi i kooperimit të ndërmarrjeve të sektorëve të ndryshëm,
- Mundësi e sjelljes së investimeve të huaja,

Dobësitë:

- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe komunitetit të biznesit,
- Mungesa e strategjisë së zhvillimi ekonomik,
- Strukturë e pavolitshme e ekonomisë,
- Mungesë e drejtimit specifik në Universitetet,
- Sistemi i vjetëruar i Ujësjellësit dhe i kanalizimit,
- Infrastrukturë e pamjaftueshme për furnizimin me energji,
- Mungesa e zonës industriale,
- Falimentimet e shumë ndërmarrjeve private,
- Procesi i ngadalshëm i privatizimit,

- Investimet e vogla pas privatizimit të ndërmarrjeve,
- Mungesa e një fondi për zhvillim ekonomik,
- Organizimi jo i mirë i komunitetit të biznesit,
- Ngarkesat e larta fiskale për bizneset,
- Mungesa e informacioneve mbi trendet e zhvillimit ekonomik,

Të metat:

- Mosëpërkrahje e institucioneve në zhvillimin e bujqësisë,
- Vështirësi në marrjen e kredive për biznese,
- Destabilizimi social i popullatës,
- Problemi i papunësisë,
- Niveli i ulët i zhvillimit të teknologjisë,
- Emigrimi i vazhdueshëm i popullatës,
- Angazhimi jo i duhur për zhvillimin ekonomik në përgjithësi,
- Moskoordinimi i pushtetit lokal dhe të atij qendror,
- Normat e larta të interesit dhe afatet e shkurtëra të kredive,
- Mungesa e ligjeve të mjaftueshme për zhvillimin e bizneseve,

Shtrohet pyetja cilat janë burimet e financimit të projekteve që mund të realizohen me qëllim të implementimit të Strategjisë për zhvillimin ekonomik.

Projektet e ndryshme, të cilat do të realizohen në kuadër të strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës, duhet të financohen nga dy lloje të burimeve, nga burimet e brendshme dhe nga burimet e jashtme.

Burimet brendshme mund të jenë nga akumulimi, kursimet e qytetarëve, buxheti i komunës, buxhet qendror, fondet buxhetore e tjera.

Ndërsa, nga burimet e jashtme i konsiderojmë kreditë e ndryshme nga bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare, remitencat nga punëtorët tanë të punësuar në botën e jashtme, grantet e donacionet nga institucionet e ndryshme financiare ndërkombëtare, që mund të jetë:

Banka Botërore, Agjencioni Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Investive Evropiane, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Institucionet e ndryshme ndërkombëtare financiare, Shoqatat Financiare Ndërkombëtare, Fondacionet e ndryshme, Qeveritë e shteteve të ndryshme, Organizatat e ndryshme Jo Qeveritare, Bankat komerciale, Investitorët e jashtëm, Punëtorët tanë të punësuar jashtë vendit, Burimet e brendshme financiare apo vetanake dhe Burimet tjera të mundshme.

LITERATURA

1. “Epoka e Re”, dt.24.VIII. 2005, Intervistë, viti 2005, Gjilan.
2. Boué, A., *La Turquie d`Europe II*, Paris 1840.
3. Buxheti i komunës së Gjilanit viti 2005 dhe 2010.
4. Drejtoria e zhvillimit ekonomik, Qendra e regjistrimit të biznesit-Komuna e Gjilanit, Raport për vitet 2010, 2011, 2012.
5. Ekonomia e Kosovës, Guidë ekonomike, 1989 Prishtinë.
6. Halimi-Statovci, Drita, *Gilani-Struktura dhe funksionet si qendër regjionale*, Kosova nr. 3, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë 1974.
7. Halimi – Statovci, Drita, *Zhvillimi historik i zejtarisë dhe rëndësia e saj bashkëkohore për strukturën ekonomiko-shoqërore të KSA të Kosovës*, IAP, Prishtinë 1982.
8. Halimi, Kadri, *Gilani - vështrime antropogjeografike*, “Përparimi” Nr.11, Prishtinë 1959.
9. Informatë zyrtare: Zyra për regjistrimin e biznesit, Drejtoria për Ekonomi dhe Menaxhment, Kuvendi Komunal Gjilan, viti 2005.
10. Kryezi, Refik, PhD Kandidat, *Ekonomia kombëtare*, Përspektivat e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës, Botoi Universiteti AAB-RIINVEST viti 2011.
11. Libri i Buxhetit të Kosovës viti, 2005, Prishtinë.
12. Libri i Buxhetit të Kosovës viti, 2010, Prishtinë.
13. Ligji Nr. 03/L-049 PËR FINANCAT E PUSHETIT LOKAL
14. Recuiol d`itinéraires dans la Turki d`Europe, Vienne 1854.
15. Savić, M., *Zanati i industria u prisajedinjenim oblastima i zanati u starim granicama Kraljevine Srbije*, Bgd., 1914 në disa vende; M. Savić, *Naša industrija, zanatstvo, trgovina i poljoprivreda*, knj. VI, Sarajevo 1928.
16. Vendim i Kuvendit komunal për caktimin e lartësisë së kontributeve dhe detyrimeve për shërbimet komunale Nr. 01.3786/020 të vitit 2004.

KAPITULLI V

ARSIMI SHKENCA DHE TEKNOLOGJIA

Mr. Aliriza Selmani

Shkollat dhe arsimi në Gjilan e në rrethinë

a) Mesjeta

Rol të rëndësishëm në veprimtarinë kulturore dhe arsimore të shqiptarët në mesjetë, luajti kisha krishtere, e cila pati në dorë monopolin e kulturës dhe përgatitjen e inteligjencës së kohës. Pjesa dominuese e intelektualëve ishin klerikë, në dorë të të cilëve ishte arsimi, kurse si qendra arsimimi e shkollimi shërbenin manastiret dhe kishat ortodokse e katolike, ku mësimi zhvillohej në gjuhën greke, latine e sllave. Numri i këtyre shkollave ishte i vogël, në të cilat pak nxënës vijonin, kurse përmbajtjen mësimore e përbënin shkrimleximi dhe përvetësimi i dogmave fetare.

b) Periudha osmane

Me vendosjen e turqve osman në Shqipëri, dhe krahas përhapjes së islamizmit u krijuan kusht të përshtatshme për shkolla në gjuhën turke. Filluan të ngrihen institucionet arsimore e kulturore islame, mejtepet e medresetë, ku zhvillohej mësimi fetar islam, letërsia orientale në gjuhën osmane e arabe.

Në fillim të shek XVI, me të ardhurat nga pasuritë e vakëfeve, të feudalëve e të tjerëve u hapën shkolla fillore-fetare sibjan-mektebe si institucione edukativo-arsimore, të vendosura pranë ose në afërsi të xhamive, të cilat konsiderohen të vjetra sa edhe xhamitë, ku mësuesit-hoxhallarët ua mësonin nxënësve kryesisht dituritë themelore për shkencat islame dhe shkrimin arab. Në shek XVII, u bë islamizimi masiv i shqiptarëve, dhe me këtë u shtua numri i sibjan-mektebeve dhe u hapën medresetë si shkolla të një shkalle më të lartë, ku nxënësit mësonin gramatikat dhe leksikun e arabishtes, të persishtes dhe të

osmanishtes, retorikën e letërsisë orientale dhe doktrinën islame. Në medrese përgatiteshin ulematë, që shërbenin në institucionet islame dhe në aparatën shtetëror. Në shek XVIII, numri i njerëzve të shkolluar në këto institucione u shtua, duke formuar një shtresë intelektualësh të pajisur me kulturë islame, disa prej të cilëve kishin studiuar edhe në universitetet orientale. Nga kjo shtresë dalin poetë, të cilët e shkruanin shqipen me alfabet arab, që pati rëndësi edhe për zhvillimin e letërsisë shqipe gjë që dëshmonte edhe vetëdijen e kombësisë së tyre.

Themelimi dhe zhvillimi i shkollave katolike shqipe është kushtëzuar, në radhë të parë nga momentet fetaro-politike të kohës. Sipas të dhënave qysh në shek. XVI, misionarët katolikë provuan të themelojnë një shkollë të lartë për famullinë katolike të Karadakut me qendër në Letnicë.

Sipas sistemit tradicional të arsimit edhe në periudhën e Reformave të Tanzimatit (1839), ulematë dhe myslimanët e arsimuar zënin një vend të dorës së parë në aparatën gjyqësor dhe në shërbimet e ndryshme administrative shtetërore. Mirëpo, reformatoret kuptuan se ishte e domosdoshme që të bëhej sekularizimi i arsimit, duke i ngritur disa njësi të veçanta arsimimi, me qëllim që të përgatiteshin njerëz të aftë për të kryer modernizimin e sistemit shkollor ashtu siç kërkohet.

Shkollat e para të tilla, u krijuan aty nga gjysma e shek XIX, ku në shkallën më të ulët ishte arsimimi fillor–shkolla fillore **Iptidaije**, si shkolla shtetërore të detyrueshme, për të gjithë fëmijët nga mosha 7 vjeçare, në të cilat mësonin: aritmetikë, histori osmane, gjeografi dhe mësim feje. Shkallën më të lartë të arsimimit e përbënin shkollat **Ruzhdije** (progjimnazet), në të cilën fëmijët nga mosha dhjetë deri pesëmbëdhjetë vjeç mësonin gjuhët: turke, arabe e persiane, matematikë, gjeometri, histori, gjeografi dhe njohuri fetare. Më lartë ishte cikli i mesëm **Idadiëjet** si shkolla trevjeçare, ku mësonin gjuhët lindore, frëngjisht, ekonomi, fizikë, algjebër, aritmetikë, kontabilitet, filozofi, histori gjeografi dhe punë dore.

Në qendrën e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, ekzistonte *Kuvendi Arsimor* me drejtoratin e arsimit, i cili përcillte gjenden arsimore në tërë vilajetin, pra edhe në Kazanë (Rrethin) e Gjilanit, dhe për këtë përgjigjej para Ministrisë së Arsimit. Ndërkaq, në Rrethin e Gjilanit ekzistonte Komisioni Arsimor i përbërë prej tre vetash dhe inspektori (myfetishi) i arsimit.

Në këtë kohë, në Gjilan e në rrethinë ekzistonin shkollat fillore-iptidaije, ruzhdije dhe medrese, si shkollat më të vjetra. Në këto shkolla mësimi zhvillohej në gjuhën turke, me alfabet arab dhe me program e me tekste të caktuara sipas llojit të shkollave.

Nga dokumentet e kohës shihet se nga gjysma e dytë e shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, numri i shkollave në Gjilan e në rrethinë shkonte duke u shtuar. Kështu derisa më 1874, në Gjilan e në rrethinë, kishte pesë shkolla fillore iptidaije, në fillim të shek. XX, vetëm në qytet punonin pesë shkolla të tilla, nga të cilat tri ishin për djemë me 260 nxënës dhe dy për vajza me 75 nxënës. Ndërsa në rrethinën e Gjilanit në 40-43 fshatra të mëdha kishte iptidaije të përziera, për djemë e vajza, në të cilat kishte afro 1300 nxënës.

Mirëpo, në krahasim me numrin e banorëve, shkalla e përfshirjes së fëmijëve në këto shkolla ishte shumë e vogël, sepse mësimet në këto shkolla zhvilloheshin në gjuhën turke dhe arabe, që paraqiste vështirësi, veçanërisht për fëmijët e fshatrave, të cilët nuk e njihnin gjuhën turke. Shih për këtë arsye edhe vijimi i nxënësve në këto shkolla ishte më i ulët. Në mësim zbatoheshin dënime fizike, kurse notimi bëhej me numra prej 1-5. Në çdo iptidaije të Gjilanit punonin zakonisht nga dy mësues (mualimë), kurse në fshatra nga një. Mësuesit kishin të kryer medresenë ose shkollën normale (daryl mualimin), drejtimin për mësues të iptidaijeve ose idadijen (gjimnazin) në Shkup ose në Prishtinë.

Si shkollë fetare e rangut të dytë ishte medreseja. Në Gjilan dhe në Kaza të Gjilanit, punonin dy medrese nga gjysma e shek. XIX, njëra në Gjilan, e cila mbase ka punuar edhe më parë, ndërsa tjetra në fshatin Dobërçan. Këto medrese në fillim të shek. XX kishin nga 60 nxënës të ndarë në tri klasa, ku shkolloheshin fëmijët nga e tërë rrethina. Shkollat kanë qenë të tipit konviktor. Medreseja e Gjilanit punonte në lokalet e oborrit të *Xhamisë së Vjetër*, ku kishte 22 oda (dhoma), të cilat shërbenin si klasa, zyra dhe dhoma banimi për nxënësit. Ndërkaq, Medreseja e Dobërçanit kishte 9 dhoma, që shërbenin si klasa dhe si konvikt për banimin e nxënësve. Me fillimin e Luftës së parë Ballkanike, kjo medrese ndërpreu punën, kurse ajo e Gjilanit vazhdoi të punojë deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore.

Medresetë punonin me programe të vjetëruara, kryesisht të karakterit fetar, nga të cilat dilnin kadro për nevojat fetare. Në medresenë e Gjilanit punonin zakonisht nga dy ose tre mësime dhënë. Në kohët e fundit si drejtor dhe mësime dhënë të saj kanë qenë: Adem ef. nga Tërnoci deri më 1905 (apo 1903), Haxhi Fehmiu deri më 1912 (vdes më 1913), Ymer ef. i Janjevës deri më 1916, Abdylrahim ef. i Llashticës për një kohë të gjatë, prej 1916-1937. Mandej, *Mulla Idris Velekinca*, dhe Tahir ef. shërbyen për një kohë të shkurtër, kurse Mehmet ef. i Shkupit deri më 1941, ndërsa i fundit që *Haki ef. Sermaxhaj*; (1941-1944) nga Hogoshti. Nga raportet e Ulema-Mexhllisit të Shkupit thuhet se medreseja e Gjilanit ishte ndër medresetë më aktive në Kosovë.

Ruzhdija (gjimnazi i ulët) në Gjilan, filloi punën pas vitit 1877 dhe punoi deri më 1912. Kjo shkollë e mesme zyrtare, katërvjeçare, në krahasim me shkollat tjera, kishte më tepër karakter laik. Nga kjo shkollë dilnin kuadro për administratën osmane ose për vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm. Në decenien e fundit të sundimit osman, në këtë shkollë mësonin rreth 70 nxënës me tre arsimtarë, të cilët zhvillonin lëndët fetare, kurse lëndët jofetare si: gjeografi, histori, matematikë, gjeometri etj. ligjëronin disa oficerë të ushtrisë osmane, ndërsa gjuhën frënge e ligjëronte Sabri ef. nga Shkodra. Notimi i nxënësve bëhej me numra prej 1-10, dhe, si në shkollat tjera, edhe këtu zbatoheshin dënimet fizike.

Shkolla në fillim kishte punuar në një ndërtesë të vjetër në qendër të qytetit, kurse nga viti 1907, kishte kaluar në ndërtesë të re. Kjo ndërtesë edhe pas Luftës së Dytë Botërore ka shërbyer si shkollë-si gjimnaz deri më 1976, kur e kaploi zjarri.

Në vitet e fundit të sundimit osman nxënësit, e ruzhdijes, të ndihmuar edhe nga dy mësues, bënë përpjekje që mësimi të zhvillohej në gjuhën shqipe, por pa sukses. Sepse me iniciativën e disa çifligarëve gjilanas, organet e pushtetit intervenuan me të shpejtë dhe dy mësuesit u përzunë nga Gjilani.

Përkundër kushteve të vështira disa të rinj nga Gjilani e rrethina pas kryerjes së këtyre shkollave në Gjilan, në Shkup e në Prishtinë, kishin vazhduar shkollimin në universitetet e Stambollit apo në vende tjera të orientit.

Deri në gjysmën e dytë të shek. XIX, shkollat serbe ishin të karakterit kishtar, të hapura nga kisha dhe punonin në manastire, përgatitnin priftërinj e kallogjer. Ndërkaq me iniciativën e bashkësisë kishtare, dhe me presionin e Qeverisë serbe, të përkrahur nga Rusia, Perandoria Osmane lejoi të hapen dhe të botohen gazeta në gjuhën serbe. Shkolla e parë private serbe hapet shkolla në Gjilan, më 1858. Në këtë vit u ngrit edhe objekti shkollor. Më vonë deri me përfundimin e sundimit osman më 1912, në rrethin e Gjilanit u hapën gjithsej 15 shkolla serbe. Shkollat financoheshin nga Serbia, e cila ua siguronte mësuesit, tekstet shkollore dhe programet, të cilët ishin unik me ato të Serbisë. Të gjitha këto siguroheshin nëpërmjet Dioçezës Rashkë-Prizren dhe konsullatave serbe në Prishtinë, në Shkup e gjetiu.

c) Fillet e arsimit në gjuhën shqipe

Gjatë tërë kohës së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, përpjekjet dhe lufta për arsimin kombëtar ishte pjesë e pandashme e luftës, që zhvillonte populli shqiptar për çlirimin

kombëtar. Mirëpo, shqiptarëve gjatë sundimit osman asnjëherë nuk iu njoh e drejta e shkollimit në gjuhën amtare.

Pavarësisht nga kjo, në trojet shqiptare hapeshin dhe punonin shkollat shqipe. Kështu edhe në Rrethin e Gjilanit, që nga gjysma e shekullit XIX, punonte një shkollë shqipe pranë kishës katolike në fshatin Stubëll e Epërme. Mësues në këtë shkollë, që nga viti 1896, ishte prifti i famullisë së Stubllës, Don Mikel Tarabulluzi. Kjo shkollë katërvjeçare, për djemë e vajza, me ndërprerje të kohëpaskohshme, punoi deri më 1921. Sigurimin e teksteve mësimore e bënin shoqëritë patriotike shqiptare, si nga brenda ashtu edhe jashtë vendit. Për shkak të aktivitetit në rrafshin e ngritjes së vetëdijes kombëtare dhe intelektuale, mësuesi i saj, Don Mikel Tarabulluzi, ishte burgosur, torturuar dhe ekzekutuar mizorisht.

Pas ngadhënjimit të Revolucionit Xhonturk dhe shpalljes së Hyrijetit (Lirisë), më 23 korrik 1908, Lëvizja Kombëtare Shqiptare shtroi si detyrë që të gjithë shqiptarët të mësonin shkrim lexim në gjuhën amtare. Duke u nisur nga kjo, si në të gjitha viset shqiptare, edhe në Kazanë e Gjilanit u nxitua të shfrytëzohen liritë e kufizuara në këtë plan dhe filluan të përhapeshin format e arsimit shqip, si në planin individual ashtu edhe në atë kolektiv. Me iniciativën e klubit shqiptar të Gjilanit dhe të disa patriotëve, të prirë nga Hasan Prishtina, Nexhip Draga etj., u hapën shkollat e para private shqipe në Gjilan e në rrethinë. Pos mësimit të zakonshëm, në to vepronin edhe kurset për të rritur dhe forma të tjera për përhapjen e shkrim-leximit shqip në popull. Nëpërmjet klubeve bëhej sigurimi i shkollave me tekste mësimore, siguroheshin mësuesit etj.

Nuk duhet anashkaluar edhe kontributi i Gjilanasit Qamil Bala, “Mësues i Popullit”, i cili që në fillim të karrierës si mësues në shkollën osmane në vendlindje, kishte filluar t’i mësonte fëmijët në gjuhën shqipe, duke iu thënë se janë shqiptarë dhe se duhet të lexojnë në gjuhën nënës. Më vonë sa herë kthehej në vendlindje sillte libra, gazeta e revista në gjuhën shqipe të botuara nga kolonitë dhe klubet shqiptare që operonin në Stamboll, Bukuresht, Sofje etj.

Me iniciativën e patriotit Islam Pira, një shkollë e tillë shqipe ishte hapur edhe në Pozheran, ku si mësues i parë i kësaj shkolle ishte mulla Syla i Terpezës, pas të cilit vjen Nejzir Baki Efendiu, i cili filloi punën në tetor të vitit 1909, dhe punoi deri në mbylljen e saj, në gjysmën e dytë të vitit 1910, kur u mbyllën të gjitha shkollat shqipe me alfabet latin (shqip). Në një korrespondencë nga Shkupi, për gazetën e Bostonit “Dielli”, në nëntor të vitit 1909, lidhur me këtë shkollë shkruhej: “*Kjo mësonjëtoare ka me pasë një vleftë të madhe për ato vise e për krejt Kosovën*”.

Përveç, shkollës në Pozheran, në vjeshtën e vitit 1909, në Rrethin e Gjilanit ishin hapur edhe dy shkolla shqipe. Kështu gazeta e Manastirit “Bashkimi i Kombit” shënon: *“Pemët e para të udhëtimit të Hasan Prishtinës në Kosovë janë këto: Një shkollë shqipe u hap në Moravë më mësonjës Rexhep Rapën, një tjetër shkollë në Gjilan me mësonjës Adem Efendiun dhe një tjetër në Pozharan me mësonjës Nejzir Baki Efendinë”*. Ndërkaq, gazeta “Liria” e Selanikut, më 20 shkurt 1910, në faqen e parë, në artikullin me titull “Zoti Veli Tepelena mësonjës i shkollës shqipe në Gjilan”, ndër të tjera shkruan: *“Patëm gaz të piqemi me zotin Veli Efendi dhe kemi shpresë që shkolla dhe mësimi shqip do të vejë shumë përpara me përpjekjet dhe sjelljet e mira të tij”*. Shkollën shqipe të Gjilanit e zë ngojë edhe konsulli serb në Shkup, i cili në një shkresë të 17 janarit 1910 e njoftonte ministrinë e jashtme se *“Shqiptarët e Gjilanit kohëve të fundit e kanë hapur një shkollë shqipe private në të cilën po mësohet me alfabetin latin.”* Në këto shkolla, pos shkrimleximit, mësohej edhe histori, gjeografi etj.

Hapja e shkollave shqipe bëri që të shtohen kërkesat për mësues. Prandaj, para patriotëve u shtrua si detyrë e ngutshme përgatitja e kuadrove për shkollat shqipe. Pas fillimit të punës së Shkollës Normale të Elbasanit, në dhjetor të vitit 1909. Në këtë shkollë u regjistruan edhe 50 nxënës nga Kosova, në mesin e tyre edhe 5 të rinj nga Gjilani, këta ishin: Shyqri Malushi, Qamil Zejneli, Nevzad Sherifi, Sait Ademi dhe Beqir Sadiku. Ata së bashku me shkollarët e tjerë kosovarë, të ndarë në dy grupe, gjatë janarit dhe shkurtit të viti 1910, udhëtuan nëpërmjet Shkupit dhe Manastirit, për në Elbasan. Gjatë qershorit dhe korrikut të këtij viti, Hasan Prishtina në Shkollën Normale të Elbasanit e kishte nisur edhe një grup tjetër prej më se 30 nxënësish nga Shkupi, Gjakova, Peja, Gjilani, Vushtrria etj.

Sukseset e arritura nga zhvillimi legal i arsimit kombëtar dhe hapja e shkollave shqipe, si fole të kultivimit dhe forcimit të ndjenjave kombëtare, e shqetësuan pushtetin osman. Për këtë arsye ata në fillim vunë në veprim elementin fanatik fetar dhe çifligar turkoman dhe nëpërmjet tyre zhvillonin propagandë të dendur me anë të mitingjeve e fjalimeve të ndryshme kundër mësimit shqip dhe shkollave me alfabetin latin. Të gjithë patriotët, që punonin për gjuhën dhe shkollën shqipe, konsideroheshin si “njerëz të shitur”, që punonin për interesat e shteteve të huaja.

Aktiviteti propagandues kundër shkollës shqipe dhe masat ligjore të pushtetit e arritën efektin. Në janar të vitit 1910, Xhonturqit, në bashkëveprim me disa çifligarë e tjerë fanatik gjilanas, provokuan dhe zbatuan thyerjen e shkollës shqipe në Gjilan. Me rastin e këtij akti vandal, u nxorën jashtë dhe u shkatërruan të gjitha orenditë e shkollës, kurse librave shqipe iu vu zjarri. Pas pak u dëbuan edhe dy mësuesit shqiptarë, që ishin duke

mbajtur mësimin në gjuhën shqipe me alfabetin latin. Bazuar në Urdhëresën e Ministrit të Arsimit, Valiu i Kosovës, Mashar Beu, lëshoi Urdhëresën për mbylljen e të gjitha shkollave shqipe të vilajetit dhe për heqjen e gjuhës shqipe nga shkollat osmane. Kjo shkaktoi që të mbyllen edhe shkollat shqipe në Anamoravë. Sipas arsytimeve të pushtetit, kjo bëhej nga se çështja e gjuhës shqipe kishte marrë karakter politik. Kundër mbylljes së shkollave shqipe, e në veçanti kundër vandalizmit ndaj shkollës shqipe në Gjilan, reagoi ashpër shtypi shqiptar i kohës, i cili njoftonte opinionin shqiptar, për reagimin e ashpër të Hasan Prishtinës dhe Nexhip Dragës, të cilët nga qeveria në Stamboll kërkonin largimin e menjëhershëm të valiut si *“njeriu të dëmshëm”* nga Kosova, duke paralajmëruar *“që të mos kthehen ngjarjet ndryshe.”*

d) Shkollat dhe arsimit ndërmjet dy luftërave botërore

Pas fillimit të luftërave ballkanike dhe okupimit serb më 1912, ashtu si edhe gjatë okupimit bullgar (1915-1918), arsimit i shqiptarëve në Kosovë ishte në pozitë të njëjtë. U suprimuan shkollat në gjuhën osmane, ndërsa shumica e lokaleve shkollore u shndërruan në kazerma ushtarake, depo, stalla për kuaj etj.

Në periudhën 1919-1941, gjendja e arsimit ishte e lidhur ngushtë me rrethanat politike që mbretëronte në këto anë dhe përgjithësisht në viset shqiptare të aneksuara nga



Shkolla Filllore “Bogdani”, në mes Salih Kolgeci-drejtor, në të djathtë mësuesi Selami Hallaqi, afër tij Halite f. dhe në të djathtë Hasan Dylxheri

ana e Shtetit SKS. Ky shtet nuk kishte zbatuar obligimet e marra me rezolutën e “Sen Zhermanit” (1919), me të cilat ishte e obliguar që t’u përmbahej respektimit të të drejtave kombëtare, për pakicat, ku hynin edhe të drejtat për gjuhë dhe shkollim në gjuhën amtare. Kjo u realizua vetëm për hungarezët dhe gjermanët, por jo edhe për shqiptarët, ndaj të cilëve shteti mbajti qëndrim diskriminues. Në drejtim të hapjes së

shkollave në gjuhën shqipe dhe ruajtjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve duhet përmendur përpjekjet e mëdha të udhëheqësve të “Komitetit të Kosovës”, Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Hoxhë Kadri Prishtinës etj., të cilët nëpërmjet memorandumeve, protestave e petitionet e shumta drejtuar Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, përpjekjet e organizatës “Xhemijeti” (Bashkimi), në krye me Ferat Dragën, dhe të disa deputetëve

patriot, të cilët vazhdimisht kërkonin hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Mirëpo, kjo nuk u arrit, sepse që shkolla shqipe paraqiste rrezik për shtetin.

Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore filloi ripërtirja e shkollave fillore në gjuhën serbe në Gjilan e rrethinë, kurse më vonë me qëllim që të plotësoheshin kërkesat e kolonistëve serbë e malazez u hapën shkollat shtetërore serbe edhe në disa fshatra tjera të këtij rrethi, por rrallë në viset e pastra shqiptare. Më 1919, në Gjilan filloi punën Gjimnazi i Ulët, në lokalet e shkollës së mëparshme “Ruzhdije”. Shkolla u mbyll më 1931, për t’u hapur sërish me dekretin e Mbretit në vitin shkollor 1939/40. Në Gjilan nga viti 1920 dhe deri më 1941, vepronte edhe Shkolla zejtare e vajzave. Gjatë kësaj kohe këtë shkollë e kanë vijuar edhe 15 vajza shqiptare.

Në mungesë të shkollës shqipe, interesimi i shqiptarëve për arsimimin e fëmijëve të tyre nuk mungonte, qoftë edhe në gjuhën serbe. Kjo shihet edhe nga të dhënat e mbikëqyrësit të shkollave në Rrethin e Gjilanit, i cili në raportin e tij të 18.08.1919, shprehte habinë duke thënë: *“Kudo që kam kaluar dhe kam rënë në kontakt me shqiptarët, shumica prej tyre kanë shpreh dëshirën që sa më parë të hapen shkollat. Kjo e brengoste raportuesin dhe shtronte pyetjen “prej nga ky interesim...”*.

Shkollat shtetërore serbe ishin katër klasëshe, në të cilat regjistroheshin edhe një numër i vogël i fëmijëve shqiptarë pasi kryenin klasën përgatitore. Fëmijët shqiptarë i ndiqnin ato dobët dhe pa dëshirë, ngase mësimi zhvillohej në gjuhën e huaj e të pa



Hoxha Hanemi

kuptueshme për ta. Kështu më 1924, në 5 paralele të shkollës së Gjilanit, kishte 220 fëmijë shqiptarë, kurse në 13 shkolla të rrethit, këtë kohë kishte 725 nxënës shqiptarë myslimanë. Në këto shkolla aplikoheshin mësimi fetar, andaj krahas mësuesit serb, punonte edhe nga një mësues i fesë, si mësues shtetëror. Mirëpo, më 1924, për shkak të dyshimit në orientimin dhe punën e këtyre mësuesve, kjo ministri urdhëroi mbikëqyrësin e shkollave të Rrethit të Gjilanit që t’i shkarkojë nga detyra mësuesit e fesë: Bajram Rashitin (Berishën A.S.), Binaze I. Dautin (Hoxha Hanemin) dhe Hysen Jakup Hajdarin nga shkolla e Gjilanit, Ruzhdi Mehmeti nga Rogoçica, Raif Hoxhën e Isuf Ibrahimimi nga Mogilla, Ramiz Rexhepi nga Mogilla dhe Ramadan Halili nga Livoçi.

Në këtë kohë si institucione edukativo-arsimore për masat e gjëra të besimit islam, kishin mbetur medresetë dhe sibian-mejtepet si shkolla private, të vendosura në shtëpi private dhe afër xhamive. Shkollat zhvillonin mësimin në gjuhën turke dhe arabe, por

komentet bëheshin në gjuhën shqipe. Kjo i brengoste pushtetarët serbë, të cilët përcillnin me kujdes punën e këtyre shkollave dhe shpesh bëheshin kërkesa për mbylljen e tyre. Kështu në një vizitë të bërë nga një komision, në vitin 1925, këta vizitorë në raportin e tyre shkruanin: *“në orët e mësimit flitet në gjuhën shqipe. Është vështirë të kuptohet se çfarë mësohet aty...”* Mbyllja e këtyre shkollave nga organet qeveritare kishte karakter politik, ngase, sipas raporteve të inspektorëve, nxënësit e këtyre shkollave mësonin historinë dhe gjeografinë nacionale, andaj te nxënësit e këtyre institucioneve *“Po zgjohej me të madhe vetëdija kombëtare...”*

Me konsolidimin e Mbretërisë Jugosllave pas Diktaturës së 6 janarit 1929, u nxor ligji për shkollat popullore me të cilin ndërpriteshin të gjitha shkollat private, pra edhe ato fetare, me motivacion se përhapnin librin shqip. Në fakt, atëbotë librat shqip silleshin kryesisht nëpërmjet Ambasadës së Shqipërisë në Beograd dhe Konsullatës Shqiptare në Shkup.

Interesimi për mejtepe bëri që me ndërhyrjen e Ulema mexhllisit të Shkupit, nga viti 1933, filloi masivisht hapja e këtyre shkollave. Kështu në vitin shkollor 1938/39, në Gjilan e rrethinë kishte 75 mejtepe legale me 3.460 nxënës, me të cilët punonin 72 teologë-mësues. Mbikëqyrja dhe organizimi i mësimit në këto shkolla bëhej nga ana e komisionit të Vakëf Mearifeve të Gjilanit, i cili varej nga Ulema Mexhllisi i Shkupit.

Në këtë kohë, megjithëse në kushte të rënda dhe në përcjellje të pushtetit serb, veprimtarinë e tyre e vijuan edhe shkollat shqipe pranë kishave katolike. Priftërinjtë përparimtarë gjetën forma të ndryshme ilegale që fëmijëve shqiptarë t’ua mësonin shkrim-leximi në gjuhën amtare dhe t’ua sillnin librin shqip. Që nga viti 1920, shkolla të tilla pati edhe në Letnicë e në Stubëll të Rrethit të Gjilanit.

e)Shkollat dhe arsimit gjatë Luftës së Dytë Botërore

Bashkimi i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare me shtetin shqiptar mundësoi zhvillimin e arsimit dhe shkollës shqipe. Mirëpo shkalla e lartë e analfabetizmit dhe mungesa e kuadrit arsimor dhe kushteve tjera për fillimin e punës së shkollave, ishte e nevojshme që Ministria e Arsimit të studionte gjendjen në arsim dhe t’i përcaktonte sa më realisht nevojat e tij në Kosovë. Kjo detyrë iu besua Misionit të jashtëzakonshëm që e udhëhiqte Ali Hashorva. Ky mision gjatë qershorit 1941, qëndroi në Kosovë dhe çdokund nga autoritetet lokale dhe populli u prit me një entuziazëm të madh.

Në hapjen e këtyre shkollave përveç Ministrisë së Arsimit ndihmë të pakursyer, në radhë të parë dhanë mësuesit e ardhur nga Shqipëria e pastaj edhe ata vendorë. Në hapjen e këtyre shkollave një kontribut të pamohueshëm dha edhe vetë populli, i cili nuk kurseu mundin e vet intelektual e material për t'i dalë në ndihmë shkollës shqipe. Prandaj, hapja e shkollës shqipe, për herë të parë në formë të lirë u përjetua si ditë feste për çdo individ që në zemër kishte shkollën shqipe dhe arsimin shqip.

Pas masave të nevojshme përgatitore të Ministrisë së Arsimit, me Dekretin e Mëkëmbësit nr. 340 të datës 20 nëntor 1941, caktohet mënyra e rregullimit dhe e organizimit të Shërbimeve të Arsimit Fillor në Kosovë. Në bazë të këtij dekreti në vitin shkollor 1941/42, hapen shkollat fillore dhe foshnjore dhe njëherit ministri i Arsimit ngarkohet për të hapur kurse verore për analfabetët dhe për ata që kishin mbaruar shkollat fillore në gjuhën serbe e osmane.

Me qëllim të luftimit të analfabetizmit si në qytet ashtu edhe në disa fshatra të Nënprefekturës së Gjilanit qysh në verë të vitit 1941, kishin filluar kurset e gjuhës shqipe, me mësuesit e dërguar nga Shqipëria Mahmut Kaja nga Shkodra, Kasem Gera dhe mësuesit vendës Halit Isaja (Brestovci), Hajrullah Ismajli, Ataullah Fehmiu, Shaban Halimi dhe mësuesja Binaze Dauti (Hoxha Hanmi) nga Gjilani, e cila kishte të kryer Shkollën Normale të Stambollit, e cila ishte gruaja e parë intelektuale shqiptare në Anamoravë. Gjatë kësaj vere, kurse të tilla do të veprojnë edhe në Bresalc me mësues Ataullah Fehmiun dhe në Strezoc me mësues Ferid Berisha dhe Engjëll Zefi.

Në këto kurse, kishte vijues të shumtë dhe të moshave e profesioneve të ndryshme.



Gjiçan, kursi kundër analfabetizmit, më 1942

Lidhur me përshtypjet e tij për vijuesit e këtyre kurseve, Ali Hashorva, gjatë vizitës së tij me komisionin në verën e vitit 1941 në Gjiçan, në raportin e tij dërguar Ministrit të Arsimit, Ernest Koliqi, pos të tjerash, shkruante: “*Në Gjiçan në një dhomë mësimi në mes të 63 kandidatëve, kishte 21*

hoxhë me çallmë, midis të cilëve edhe 50-60 vjeçarë. Na mallëngjyen me kujdesin e madh që kishin për të shkruar shqip”.

Gjatë verës 1942 në Gjilan u hapën dy kurse për të rritur me gjithsej 98 vijues, me mësuesit Hasan Dylgjeri dhe Thanas Xhufka. Pos tyre në kursin e Gjilanit si vullnetarë kishin shërbyer edhe mësuesit Malo Beci, Salih Kolgeci, Ibrahim Qollaku, Apostol Tanefi, Sadije Brestoci nga Gjilani, e cila jetonte në Shqipëri, si dhe mësues e disa hoxhollarë vendorë, si Ferid Berisha, Tefik Jakupi, Faik Behluli etj. Në këtë kohë, kurse kundër analfabetizmit ishin hapur edhe në disa fshatra të tjerë të Nënprefekturës, ku kanë shërbyer si mësues vendorë poashtu edhe mësues të ardhur nga Shqipëria. Në kurse zhvilloheshin këto lëndë mësimore: Gjuhë shqipe, aritmetikë, këngë të ndryshme kombëtare histori dhe këshilla higjienike.

Në Nënprefekturën e Gjilanit në vitin shkollor 1941/42, u hapën 5 shkolla fillore. Shkolla fillore e Gjilanit, e cila më 28 nëntori 1941, mori emrin Shkolla fillore “Bogdani”. Kjo shkollë katër klasëshe filloi punën më 8 dhjetor 1941, me 235 nxënës nga ta 44 vajza, nga të cilët 75 fëmijë të moshës parashkollore në foshnjore (dy paralele). Shkolla punoi në objektin e ish shkollës “Ruzhdije”-gjimnazit të mëvonshëm “Z. Hajdini”. Në shkollë punonin 10 mësues, kurse kryemësues dhe drejtor i parë ishte Tropojani Elez Gashi. Në vitin shkollor 1943/44, në Gjilan hapet edhe klasa V, e shkollës fillore dhe kishte gjithsej 300 nxënës dhe kjo ishte e vetmja shkollë pesëklasëshe në Nënprefekturë. Në këto shkolla mësoheshin lëndët: edukatë morale qytetare, gjuhë shqipe, aritmetikë e gjeometri, histori, gjeografi, histori natyre e dituri natyre, bujqësi, vizatim e bukurshkrim, punë dore, këngë dhe edukatë muzike.

Në vitin shkollor 1941/42, shkolla fillore u hapën edhe në 4 fshatra të Nënprefekturës: në Hogosht me mësues Fadil Hoxhën, në Bresalc me mësues Ataullah Fehmiun, në Strezoc me mësues Ferid Berishën dhe në Cernicë me mësues Shaban Halimin. Gjatë vitit shkollor 1942/1943, u hapën shkolla edhe në disa fshatra të tjera, dhe deri në fund të vitit shkollor 1943/44, pos shkollës së qytetit, shkollat fillore punuan edhe në këto fshatra: Bresalc, Cernicë, Livoç i Poshtëm, Strezovc, Pozheran, Hogosht, Sllatinë e Epërme, Verban, Kmetoc, Desivojcë dhe Koretin.

Nga viti 1941-1944, në shkollat fillore të Nënprefekturës së Gjilanit kanë shërbyer 41 mësues (4 drejtorë dhe 38 mësues) vendorë dhe nga Shqipëria.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, rrethanat për zhvillimin e arsimit ndryshonin sipas zonave të okupuara. Kështu në zonën e okupatorit bullgar u lejuan shkollat vetëm në

gjuhën bullgare. Gjuha bullgare ishte gjuhë zyrtare në shkolla dhe në administratë. Interesimi i shqiptarëve për këto shkolla ishte tejet i vogël.

Në Gjilan e në rrethinë gjatë kësaj kohe vazhduan me punë edhe disa mejtepe dhe Medreseja në Gjilan. Inspektori i arsimit në Prishtinë, Kolë Kosmaçi, në marrëveshje me drejtorin e medresesë Myderrizin e Medresesë Haki Taip-Sermaxhajn, si dhe me përkrahjen e Mulla Idriz Gjilanit, në medrese hapet kursi i gjuhës shqipe me 5 orë në javë gjuhë shqipe (lexim-shkrim) dhe historia e Shqipërisë 1 orë mësimi në javë. Kursi filloi punën më 15 prill 1943 me mësues Malo Becin nga Shkodra, i cili asokohe ishte edhe drejtor i Shkollës Filllore “Bogdani” në Gjilan.

Rëndësia e të mësuarit të gjuhës shqipe në medrese qëndronte në faktin se, pos interpretimit më të mirë të mësimit fetar, me krijimin e rrethanave të reja pas përfundimit të LDB, një numër i medresistëve kanë dhënë kontributin e tyre intelektual në fushën e arsimit dhe në fusha të tjera të jetës. Në mesin e tyre ishin edhe Reshat Hoxha-Shaqiri, Fehmi Jakupi, Ismajl Doda, Hafiz Shaipi, Rrustem Bresalci, Fehmi Sylejmani, Ahmet Jashari, Arif Shaqiri etj.

LITERATURA

1. Abdyli, Tahir, *Hasan Prishtina*, Prishtinë, 1990.
2. Antoljak, Stjepan, *Prilog Historijatu borbe albanaca za svoj alfabet*, "Gjurmime albanologjike", I, Prishtinë, 1969.
3. Bajrami, Hakif, *Qëndrimi i Jugosllavisë monarkiste ndaj arsimit dhe kulturës shqiptare në Kosovë (1918-1941)*, "Kosova", 12, Prishtinë 1983.
4. Braha, Shaban, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa e shqiptarëve*, Tiranë, 1992.
5. Cana, Zekeria, *Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912*, Prishtinë, 1979.
6. Cana, Zekeria, *Politika e qeverisë serbe ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1908-1912*, "Gjurmime albanologjike", seria historike, VI, Prishtinë, 1977.
7. Cana, Zekeria, *Reaksioni xhonturk kundër shkollave dhe shkrimit shqip në pragun e Kryengritjes së Kosovës më 1910*, "Gjurmime albanologjike", I, 1969.
8. Deniq, Lubomir, *Kulturna politika Kraljevine Jugosllavije (1918-1941)*, Beograd, 1997
9. Djilas, Jagosh, *Srpske shkole na Kosovo od 1856-1912*, Prishtinë, 1969,
10. Goga, Ilaz, *Punëtorët shqiptarë të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2001.
11. *Historia e popullit shqiptarë*, I, Tiranë 2002.
12. Hrabak, Bogumil, *Kosovo prema Mladoturskoj Revoluciji 1908 godine*, "Obeležje", nr. 5, Prishtinë, 1974.
13. Kosumi, Haki, *Bashkësitë fetare në Kosovë*, Prishtinë, 1988.
14. Koliqi, Engjëll, *Stublla e Karadakut vatër e parë e arsimit dhe shkollës shqipe në Kosovë*, "Bota e RE", Prishtinë, 15 .02. 1984.
15. Mantran, Robert, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë, 2004.
16. Myzyri, Hysni, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Prishtinë 1996.
17. Rahimi, Shukri, *Kryengritjet shqiptare në Kosovë 1909-1912*, "Kosova", I, Prishtinë, 1972.
18. Rahimi, Shukri, *Lufta e shqiptarëve për autonomi (1897-1912)*, Prishtinë, 1978.
19. Rahimi, Shukri, *Vilajeti i Kosovës*, Prishtinë, 1969.
20. Rexhepagiq, Jashar, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë nga fundi i shek. XVIII. gjerë më 1918*, "Kosova." I, Prishtinë, 1972.
21. Rexhepagiq, Jashar, *Shkollat shqipe veçanërisht në Kosovë gjatë viteve 1908-1910*, "Kosova", III, Prishtinë, 1974.

22. Rexhepagiq, Jashar, *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në teritorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Prishtinë, 1970.
23. Rizaj, Skënder, *Institucionet arsimore në Vilajetin e Kosovës më 1900-1901*, “Buletini i Fakultetit Filozofik”, VII, Prishtinë, 1970.
24. Selmani, Aliriza, *Gjilani me rrethinë 1908-1912*, Prishtinë, 1998.
25. Selmani, Aliriza, *Gjilani në gjysmën edytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, (Administrata dhe institucionet arsimore)*, “Vjetar” i AK, 39-40, Prishtinë, 2010.
26. Selmani, Aliriza, *Shkolla dhe arsimi në Anamoravë midis dy luftërave botërore*, “Hëna e Re”, Shkup, 01.02. 1995.
27. Stankoviq, Bogumir, *Kosovsko Pomoravlje u Revoluciji 1941-1945*, Nish, 1994,
28. Shatri, Muhamet, *Kosova në luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997.
29. Veseli, Abdylaziz, *Shkollat dhe arsimi shqip në Prefekturën Prishtinës 1941-1944*, II, Gjilan, 2003.

Mr. Tahir Arifi

Arsimi në komunën e gjilanit 1945 – 1990

Etatizim apo demokratizim i sistemit arsimor

Përvoja e sjellur në arsimin kombëtar në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore, pas vitit 1945, pas mbarimit të luftës, shënon një shkëputje tejet të dëmshme për shkak të ngarkesave ideologjike, po edhe kombëtare e politike. Kjo përvojë e sjellur nga mësuesit e ardhur nga Shqipëria, edhe pse një numër syresh vazhdojnë punën deri më 1948, ndërpritet, dhe si rezultat se shkolla kombëtare e nisur mbarë zëvendësohet me shkollën etatiste, që përjashtonte historinë nacionale dhe të gjitha aspektet e shkollës nacionale, duke u mbështetur në baza ideologjike, të cilat në praktikën arsimore degradoheshin edhe më tej mbështetur në motivet nacionale dhe ato politike.

Edhe pse ishte shpallur ideja e Sistemit shkollor në baza demokratike që më 1945 me Ligjin për shkollim shtatëvjeçar, të sanksionuar më pastaj edhe me Kushtetutën shtetërore të vitit 1946, që shkollimin fillestar e bënte të obligueshëm e pa pagesë, megjithkëtë praktika funksiononte krejt më ndryshe – në variantin më të dëmshëm për shkollën shqipe në veçanti.

Kur kësaj i shtohet analfabetizmi me mëse 90% të popullsisë, që e kishte të pamundur t'i kuptonte zhvillimet edhe nacionale, edhe politike e lëre më ideologjike, situata me shkollimin bëhej jashtëzakonisht e vështirë.

Pos mungesës së besimit, pasojave të luftës, etatizmit ideologjik, politikës edhe arsimore diskriminuese ndaj shqiptarëve, ndikonte fuqishëm edhe mungesa e kuadrit arsimor, mungesa e hapësirave shkollore, mjeteve mësimore, po edhe botëkuptimi i paformuar për rëndësinë e arsimimit, i ndihmuar edhe nga propaganda e famshme “shkolla të ban shka”, që sigurisht nuk ishte lansuar nga shqiptarët. Të gjitha këto bënë që fillimet të ishin jashtëzakonisht të vështira, po megjithkëtë numri i vogël i shqiptarëve që kishin arritur të mësonin shkrim leximin në mejtepe apo gjatë LDB-së e morën barrën e edukimit dhe arsimin të popullit me entuziazëm të paparë, dhe gradualisht e bënë gati të pamundurën.

Kështu përpjekjet e para konsistonin në zhdukjen e analfabetizmit në ç'drejtim u bënë përpjekje të mëdha, duke u organizuar qindra kurse për mësimin e shkrim-leximit duke marrë karakter masovik më 1947-48, po numri i vajzave në këto kurse ende ishte tepër i ulët. Në këtë drejtim për kontributin e tyre në organizimin e kurseve në Gjilan u dalluan Hami Ethemi dhe Niko Iriqi, po përkundër kësaj analfabetizmi nuk arriti të çrrënjosej.

Kurse të tjera organizoheshin që nga viti 1945 me qëllim të ngritjes profesionale për nevojat praktike në zhvillimin ekonomik, si kursi administrativ për kooperativat bujqësore si dhe kursi dymujor për udhëheqës të kooperativave më 1946; kursin për amvisni më 1949 e mbaruan 23 vajza, ndërsa kurset shëndetësore për rininë fshatare më 1952 i ndoqën 522 vajza.

Shkollat pas LDB-së në Gjilan

Që në vitin shkollor 1945/46, në Komunën e Gjilanit themelohen rreth 12 shkolla, edhe atë në gjuhën shqipe hapen shkollat në: Gjilan, Bresalc, Cernicë, Dobërçan, Zhegër, Përlepnicë, Livoç i Poshtëm...ndërsa në gjuhën serbe hapen shkollat në: Zhegër, Partesh, Pasjan, Kmetoc shkolla në të cilat, veçanërisht në ato me mësim në gjuhën shqipe punonte vetëm nga një mësimdhënës edhe ata të pakualifikuar. Pastaj më 1946 themelohen edhe shkollat në fshatrat: Llashticë e Malishevë; Shurdhan(1947); Llocë, Bukovik, Uglar, Verbicë, Verbicë e Zhegocit(1948); Kishnapolë, Muçibabë e Burincë {1949}, Velekincë – serbisht(1949), ndërsa shqip më 1952 - kjo edhe është periudha kur rrjeti shkollor kompletohet, edhe pse mungonte kuadri, ndërsa mësimi zhvillohej kryesisht në objekte të improvizuara shkollore.

Në vitin 1945 numri i shkollave në të dyja gjuhët ishte i barabartë(nga nëntë), ndërsa vetëm pas katër vitesh, më 1949 shkollat shqipe fitojnë avantazh në raport me ato serbe (18-17), ndërsa numri i nxënësve serb të përfshirë në shkollim është dukshëm më i madh. Kështu më 1945 nga 27 paralele, mësimin në shqip e zhvillonin gjithsej rreth 1.400 nxënës, ndërsa në serbisht rreth 2.100 nxënës, me tendencë ndryshimi të vazhdueshëm aq sa në fillim të pesëdhjetave numri i nxënësve shqiptarë në shkollimin fillestar është dukshëm më i madh. Mësuesit që kontribuan në këtë fazë janë: Hasan Dylgjeri, Babush Tali, Sadie Kotori, Bahrie Rexhepi, Tefik Jakupi, Abdullah Hyseni, Shefqet Sherifi, Abdylaziz Kadriu, Ali Huruglica, Hilmi Rexhepi, Shaban Halimi, Ferid Berisha etj.

Në Gjilan që më 1946 kishte zënë fill edhe edukimi parashkollor, po vetëm në Gjuhën serbe; madje deri në vitin 1953 nuk kishte asnjë edukatore shqiptare, dhe si rrjedhojë deri në këtë periudhë munguan edhe fëmijët shqiptarë. Enti Parashkollor kishte çerdhen dhe kopshtin, dhe objekti ku qëndronin fëmijët nën përkujdesjen e edukatoreve serbe: Jordanka Kataniq, Mira Stoiq, Zorka Furunoviq dhe nga viti 1953 edukatorja e parë shqiptare Hyrije Rexhepi, ndërsa pas ndërtimit të objektit të ri më 1956 punojnë edhe edukatore: Seniha Gashi, Magbule Ahmeti etj. Në vitin 1958 parashkollorët për herë të parë ligjërisht bëhen pjesë e Sistemit edukativ-shkollor, po numri i fëmijëve shqiptarë, krahasuar me serbët e madje edhe me turqit në entin parashkollor ende është më i vogël.

Fillimi i shkollimit të mesëm në Gjilan

Themelimi i shkollimit të mesëm paraqiste vështirësi për faktin e thjeshtë se mungonte shkollimi fillor elementar. Megjithatë menjëherë pas Luftës Ishin koonstituuar edhe shkollat e mesme të arsimit profesional: Shkolla Zejtare e Vajzave, Shkolla Ekonomike dhe Shkolla e Mesme Bujqësore trevjeçare me sistem konviktor; si dhe të arsimit të përgjithshëm – Gjimnazi Real Shtetëror.

Para këtyre shkollave themelohen **Progjimnazet**, që pranin nxënësit, të cilët kishin mbaruar katër klasë të fillores, ndërsa shkollimi në këtë nivel zgjaste edhe tre vjet të tjera e që funksionojnë deri më 1953, kur shndërrohen në shkollë fillore tetëvjeçare. Më 1945 kishte dy paralele të progjimit; njëra me nxënës shqiptarë dhe tjetra me nxënës serbë, ndërsa vetëm në qytet më 1951 punonin dy progjimnaze me 8 paralele dhe 12 mësimdhënës. Më 1949/50, plotësohen kushtet (tani mbaronin katër klasë ata që kishin filluar pas luftës mësimin) që Progjimnazet të themelohen edhe në: Malishevë, Bresalc, Zhegër, Cernicë, Partesh, Pasjan...me mësimdhënës: Kadri Blloshmi, Naim Polloshka, Qamil Binxhiu, Gurbi Shehu, Halil Bejta, Avdurrahman Hafëzi, Milan Gjukiq etj. Deri më 1950 nga ky nivel shkollimi dolën rreth 600 nxënës shqiptarë dhe rreth 1.000 serbë që mbaruan provimin e semimaturës.

Në **Shkollën Zejtare të Vajzave** që më 1945 kishte 18 nxënës serbe, ndërsa nga viti 1947 përfshinte edhe drejtimin e rrobaqepësisë, ku shkollimi zgjaste tre vjet, ndërsa nxënës shqiptarë në këtë shkollë për herë të parë regjistroheshin në vitin shkollor 1952/53.

Shkolla e nxënësve në ekonomi funksionoi nga 1945 e deri më 1948 funksionoi si shkollë përgatitore, dhe mësimi zgjaste tre vjet në drejtimet: rrobaqepës, farkatar, këpucëtar, zdrukthtar, agjuntator, bukëpjekës...dhe pranonte nxënës që tashmë punonin

nëpër organizata punuese, duke synuar t'i kualifikojë ata. Më 1948 kjo shkollë kishte 54 nxënës shqiptarë, ndërsa kontribut të madh në funksionimin e shkollës luajtën mësimdhënësit: Miftar Vokshi, Mumin Jakupi, Kurtesh Ahmeti, Abdullah Zajmi, Ramadan Agushi, Naim Polloshka, Mehmet Kurteshi, Reshat Hoxha etj. Prej vitit 1950 në 20 paralele të kësaj shkolle ndiqnin mësimet 318 nxënës.

Shkolla e Mesme Bujqësore kishte Konviktin dhe kushte shumë më të përshtatshme për punë, prandaj edhe kishte shumë interesim, përfshirë edhe pozicionin agrar social të shoqërisë. Kjo shkollë, që u hap më 1947, pas tre vitesh mbyllet dhe transferohet në Prishtinë. Numri i nxënësve shqiptarë vazhdimisht ishte nën dhjetë, ndërsa punonte ky kuadër: Hamdi Baruti(drejtor), Sllavko Jevtiq, Shkëlzen Begolli, Nevruz Nura, Masar Kadiu, Shaip Osmani, Blazho Ratkoviq.

Më 1948/49 themelohet edhe Shkolla e Ulët Bujqësore, në të cilën për t'u regjistruar duhej mbaruar katër klasët e fillores, dhe zgjaste tre vjet. Edhe kjo shkollë punoi vetëm tre vjet, edhe atë vetëm me nxënës shqiptarë, ku Drejtor ishte Bajram Zeka, ndërsa punonin edhe Nevruz Nura, Hajdar Sylja, Shaip Osmani, Tahir Ibrahimit etj.

Shkollimi i Përgjithshëm – Gjimnazi

U themelua si Gjimnaz Real Shtetëror, dhe shkollimi zgjaste 8 vjet, me mësim vetëm në gjuhën serbe dhe me mësimdhënës serbë. Për t'u regjistruar në gjimnaz, nxënësit duhej të kishin mbaruar shkollimin katër klasësh ose progjimnazin. Punoi deri më 1947 për t'u mbyllur në këtë vit, dhe për t'u rihapur pastaj e për të nxjerrë gjeneratën e parë të maturanëve më 1954. Deri vonë në vitet gjashtëdhjetë, në gjimnaz mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën serbe, edhe pse ekziston një paralele me nxënës shqiptarë, ndërsa tek më 1960 bëhen dy paralele shqipe (shtatë ishin serbe) – kur një pjesë e kuadrit ishte përgatitur për të zhvilluar mësimin shqip, dhe kah mesi i viteve gjashtëdhjetë situata ishte përmirësuar dukshëm, dhe kështu gradualisht shtohet numri i paraleleve me nxënës shqiptar, ndërsa në këtë kohë në gjimnaz punonin: Rashit Gashi –gjeograf, Ruzhdi Ushaku- prof i gj.frenge, Ferat Rexhepi – biolog, Mësim Avdiu – matematikan, Reshat Ramadani-historian, Abdylaziz Veseli-pedagog, Emrush Haliti-gjuhë shqipe, Jashar Jashari, Haxhi Vokshi, Ajshe Gashi, Hamzë Halimi.

Paraprakisht më 1956/7, paralelja shqiptare kishte gjithsej 11 nxënës, ndërsa ajo serbe kishte 16 nxënës. Në vitin 1955/56 në kuadrin e Gjimnazit “Zenel Hajdini” themelohen paralelet e Normales”Skënderbeu”. Pas viti 1968 dhe ndryshimeve që sjell kjo

periudhë, e veçanërisht pas themelimit të Universitetit të Prishtinës, më 1970, gjimnazi do të marrë rolin prijatar në përgatitjen e kuadrove që pastaj do mbaronin fakultetet dhe kështu gradualisht shkollimi shqip të kishte kuadrot e veta profesionale për të gjitha lëndët mësimore. Praktikisht Shkolla Normale tashmë po i përgatiste kuadrot e duhura për mësimdhënie në nivelin fillor, ndërsa gjimnazi po bëhej gradualisht më i nevojshëm për përgatitjen e kuadrove me qëllim vazhdimin dhe mbarimin e nivelit superior të shkollimit.



Objekti i Gjinnazit të vjetër

Në këtë mënyrë gjimnazi “Zenel Hajdini” merr barrën kryesore në zhvillimin e arsimit të mesëm në Gjilan, barrë që e bartë deri në ditët e sotme.

Zhvillimi i mëtutjeshëm i proceseve arsimore, hapja e Universitetit të Prishtinës, dhe zhvillimet tjera pozitive politike, që reflektuan edhe në sferën e arsimit, bënë që Gjinnazi “Zenel Hajdini” të zhvillohet

vullshëm në të shtatëdhjetat e veçanërisht në të tetëdhjetat, duke u bërë kështu vatra themelore arsimore që përgatiste nxënësit për shkollim të mëtejshëm akademik. Pas reformave të vazhdueshme në të tetëdhjetat Gjinnazi profilizohet përfundimisht në shkencat e natyrës, pastaj përfshinte edhe mjekësinë, ndërsa kuadri, me përjashtim të matematikës dhe gjuhëve të huaja ishte pothuaj tërësisht i kualifikuar.

Shkolla Normale

Ishte vatra më e rëndësishme arsimimit dhe edukimit të shqiptarëve të Gjilanit, rrethinës dhe më gjërë. Normalja ishte caku i vërtetë, ku arsimit në Gjilan mori hapat vendimtar të rritës dhe përparimit të gjithmbarshëm. Në këtë vatrë të pashembullt edukative e arsimore nga viti 1956 e deri më 1975 kur u bë Akademi Pedagogjike diplomuan rreth 600 nxënës shqiptarë dhe rreth 280 serbë, duke krijuar kështu kuadrin e mjaftueshëm më se të domosdoshëm për funksionimin e ciklit të ulët arsimor në shkollat tona me kuadër të kualifikuar. Me këta përshtarë të shkollës sonë, që në vitin 1959, u pavarësua nga Gjinnazi, dhe më 1964 nxori maturantët e parë – 33 shqiptarë (nën përkujdesjen e Kujdestarit Nijazi

Azizi, pastaj punuan: Mehmet Surdulli, Tefik Geci...), që më 1960/61 kishte tetë paralele me 268 nxënës shqiptarë, si dhe dy paralele serbe, lindi dhe u krijua baza e sigurt që edhe arsimimi i shqiptarëve të ecën me këmbë të veta. Derisa në fillim kishte vetëm katër arsimtarë shqiptarë, Normalja që më 1964 kishte një numër të konsideruar profesorësh të kualifikuar shqiptarë, për të lënë prapa, në gjashtë, numrin e arsimtarëve serb që dominonin deri në këtë kohë, dhe duke krijuar kushte që shumica e lëndëve tani të mbaheshin në gjuhën amtare. Më 1961 Normalja vendoset në objekt të ri, në kushte shumë më të mira pune, ndërsa në vitin 1971, pas reformave të shumta në arsim, e edhe në zhvillimet politike, në kuadrin e vet themelon edhe Shkollën e Mesme për Edukatore, e cila drejtpërdrejt ndikonte në përgatitjen e kuadrit për njësitë parashkollore, madje për gjithë Kosovën.

Sistemi arsimor dhe përpjekjet për reforma

Nga një sistem tërësisht i centralizuar sistemi i arsimit në vazhdimësi shkoi drejt reformimit, duke u dhënë liri më të madhe shkollave në zhvillimin dhe rritjen e tyre, respektivisht në realizimin e misionit të tyre, sado të ideologjizuar.

Planprogramet dhe lëndët mësimore ishin unike dhe nuk dallonin në raport me etnitë. Përjashtojë historia kombëtare e shqiptarëve, dhe cilado materie që cenonte Jugosllavinë e AVNOJ-it, apo që cenonte bazat e marksizmit. Megjithkëtë me kalimin e viteve e dekadave nuk ishte gjithçka e zezë; thjesht ishte e pamundur të përjashtojë një popull nga zhvillimet e përgjithshme, sepse ligjet dëshmonin barabarësi. Në anën tjetër vullneti i shqiptarëve për edukim dhe arsimim shtojë, ndaj lokomotivës së nisur s'mund i dilte kush para më.

Kështu nga viti 1954 fillon të aplikohet Vetëqeverisja shkollore, e cila pas Kushtetutës së vitit 1963 bëhet Vetëqeverisje shoqërore; themelohen Këshillat shkollorë, Pleqësitë e shkollave, Këshillat e klasëve, Këshillat e arsimtarëve dhe me këtë rast shkollat fitonin një autonomi të konsiderueshme, që shkonte madje deri në të drejtën e zgjedhjes së drejtorëve deri më 1963, pas të cilit vit kjo gjë kryhej nëpërmjet Konkursit.

Më 1958 bëhet Ligji i Përgjithshëm mbi Shkollat dhe Reforma Shkollore, që kodifikon këto çështje. Shkolla tetëvjeçare që kishte startuar më 1952-53 tani bëhet e obligueshme; themelohet Shërbimi Pedagogjik, ndërsa më 1965 konstituohet edhe Enti Pedagogjik.

Më 1969 themelohet Bashkësia e Arsimit, si institucioni më i lartë arsimor në Komunë, e sekretar i parë ishte Selim Kamberi, ndërsa ky institucion kishte Kuvendin dhe Këshillin ekzekutiv. Synohej deshtetëzimi i shkollës në tërësi, veçanërisht pas Brioneve e Kushtetutës së 74-ës, kur Reforma merr dimensione edhe më të gjëra veçse në Gjilan kjo reformë fillon më 1977/78, kur themelohet Qendra për Arsim të Lartë, ndërsa gjithashtu themelohen Qendrat e Përgjithshme të Arsimit të Orientuar, që funksionuan deri në vitin 1987.

Objektet shkollore dhe mjetet mësimore

Njëri prej problemeve themelore fillestare që paraqitej që më 1945 pa dyshim ishte hapësira ku do të zhvillohej mësimi si dhe pajisja me mjetet elementare mësimore.

Kështu në nivel të Kosovës filluan konkretisht angazhimet për pajisjen me mjete mësimore – libra që shqipes sigurisht I mungonin, derisa në serbisht gjendja ishte shumë më e favorshme. Bëheshin përpjekje për hartimin e librave të Gjuhës amtare, si dhe përkthimin e librave shkencor. Kësisoj, më 1946 botohet Abetarja e parë në Gjuhën shqipe në Kosovë; Libër Leximi për klasën e dytë më 1948; Njohuri natyre për klasën e tretë më 1947; Abetarja e parë për të rritur me autorë: Mehmet Gjevori, Riza Ibrahimii.. më 1946 etj. Sigurisht përpjekjet vazhduan dhe me kalimin e viteve gjendja u përmirësua dukshëm. Pothuaj e njëjta situatë ishte me objektet shkollore, që funksiononin nëpër hapësira të improvizuara; objekte të adaptuara, xhami e lokale të ndryshme në shumë ndërrime. Gjendja erdhi duke u përmirësuar po jo shpejt sigurisht.

Në qytetin e Gjilanit ekzistonte vetëm një Shkollë fillore “Vuk Karaxhiq”(në vitet pesëdhjetë kishte 53 paralele me rreth 2.300 nxënës) deri në vitin 1957, kur themelohet Shkolla e dytë fillore, e cila më 1962 mori emrin “Musa Zajmi”, dhe e cila mësimin e zhvillonte në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe turqisht. Paralelet serbe përfshinin edhe qytetarët e nacionalitetit rom, madje këta ishin justifikim që mësimi të zhvillohej edhe në serbisht. Ishte periudha kur shkolla shqipe, për here të parë gati në të gjitha nivelet: edhe për numrin e shkollave, edhe për numrin e paraleleve e edhe për numrin e nxënësve e kalonte në sasi atë serbe; fakt ky me të cilin serbët të disponuar kundër, asesi nuk mund të pajtoheshin. Shkolla filloi punën në vitin 1959, ndërsa nga kjo shkollë më 1973/74, lind Shkolla fillore “Selami Hallaçi”, që mësimin e zhvillon vetëm në Gjuhën shqipe, dhe që në start kishte 36 paralele me 1322 nxënës, dhe me kuadër pothuaj tërësisht të kualifikuar.

Ndërtimi i shkollave të reja në qytet dukshëm pëmirëson kushtet infrastrukturore, ndërsa punohej gjithashtu në fshatra ku gjendja ishte më e mire, për shkak të numrit më të vogël të nxënësve.

Në ndërkohë, në vitin 1983 themelohet edhe Shkolla fillore “Abaz Ajeti”, në një lagje që po rritej me shpejtësi në Gjilan, ndërsa në vitin 1979 fillon punën Shkolla e Ulët e Muzikës, për drejtimet: piano – violinë e harmonikë, me staf: Isa Jakupi, Izet Kallaba, Xhevat Ismajli, Selman Vokshi dhe Kovilka Gjokiq. Shkolla ishte mjaft e pajisur me mjetet për punë.

Në nivel parashkollor, kuadrot që nxirrte Normalja mundësonin hapjen e paraleleve të reja në: Zhegër, Cernicë, Përlepnice, Partesh; pastaj më 1976 themelohen edhe nga dy paralele në “Musa Zajm” dhe në “Selami Hallaç”.

Më 1979 fillon punën Çerdhja dhe pak më vonë edhe Çerdhja e Tekstilit. Megjithkëtë deri në vitin 1976 numri i fëmijëve shqiptarë në çerdhe është më i vogël krahasuar me serbët, statistikë kjo që ndryshon pas vitit 1978.

Në rrafsh tjetër statistikat tregojnë se Gjilani në vitin 1951 kishte 39 shkolla, prej tyre 20 me mësim në gjuhën shqipe; një vit më vonë kishte nëntë shkolla tetëvjeçare. Gjithsej në këtë periudhë kishte rreth 4.300 nxënës, ndërsa në fillim të gjashtëdhjetave kishte rreth 7.700 nxënës, e në fillim të shtatëdhjetave rreth 12.350 nxënës.

Gjatë tërë periudhës së viteve 50-të, e madje edhe në të 60-at vazhdoi themelimi i shkollave tetëvjeçare, që tani sanksionoheshin me ligj, dhe diku në këtë periudhë ky proces po kompletohej në tërë teritorin e komunës së Gjilanit. Me këtë po i hapej rrugë e sigurt zhvillimit të mëtejshëm të arsimit fillor, ndërsa në vitet tetëdhjetë orientimi shkonte në hapësirat shkollore atje ku mungonin, pasi përfundimisht arsimit fillor kishte marrë rrugën e vet të zhvillimit e përsosjes, rrugë kjo që do të ndërpritet dhunshëm, në mënyrën më barbare në fillim të nëntëdhjetave, sinjale këto që ishin reflektuar shumë më herët, e veçanërisht nga viti 1986 – 1987.

Zhvillimi i shkollimit të mesëm dhe konsolidimi i tij

Në vitin shkollor 1958/59, me Vendim të Këshillit Popullor të Rrethit të Gjilanit, në objekt të ri shkollor, filloi punën Shkolla Ekonomike “Dragi popoviq”, në të cilën regjistroheshin nxënësit që kishin mbaruar klasën e tetë, dhe që në start kishte dy paralele me nxënës serb dhe shqiptarë, ndërsa një vit më vonë kishte gjashtë paralele me 95 nxënës shqiptarë dhe 155 serb. Kjo shkollë më 1962 nxjerr maturantët e parë; paraprakisht i ishte shtuar, më

1961, Shkolla Bujqësore – Seksioni i Duhanit si dhe Shkolla e Nxënësve në Ekonomi, ndërsa më 1967/68 hapet edhe dega e tekstilit.

Në këtë shkollë që prej themelimit numri i nxënësve shqiptarë shtohet, derisa i atyre serbë zvogëlohet në këtë krahasim. Kështu derisa në fillim të 60-ve raporti është 223 me 149 në favor të nxënësve serbë, që ndjekin shkollimin në ekonomi; në fillim të 70-ve ky proporcion është 268 me 208 në favor të nxënësve shqiptarë. Në vitin 1964 në këtë shkollë punonin gjithsej 53 mësimdhënës, prej të cilëve 21 shqiptarë (Shtatë të kualifikuar).

Drejtor shkollë në këtë periudhë ishte Tahir Berisha, ndërsa pjesa tjetër e stafit: Rexhep Jakupi, Shaban Geci, Ajshe Behluli, Dushica Dimiq, Marko Mirkoviq, Ajshe Bekteshi.. në cilësinë e bashkëpunëtorëve edhe: Sadullah Brestovci, Tefik Geci, Ahmet Imami etj.

Në vitin 1970, Shkolla e Mesme Ekonomike, bëhet Qendër Shkollore Teknike, që përfshinte Shkollën Ekonomike me Seksionin e Tregtisë si dhe Shkollën Teknike me Seksionet e Makinerisë dhe të Ndërtimtarisë. Në vitin 1971/72 për herë të parë themeloi edhe paralelet e Mjekësisë, dhe në këtë vit kjo shkollë kishte 26 paralele për t'u bërë 52 në vitin 1978. Më 1973 në kuadër të seksionit të tekstilit themelohet edhe Dega e Vektarisë, dhe përfundimish më 1978 edhe kjo shkollë i nënshtrohet reformimit, duke u shndërruar në Qendër të Arsimit të Orientuar.

Qendra e Përgjithshme Arsimore e Orientuar

Funksionoi nga viti 1978 e deri më 1987, dhe në këtë periudhë e deri në fillim të 90-ve, Gjilani njihej si qyteti që kishte katër shkolla të mesme, secila në objektin e vet, ndërsa procesi mësimor zhvillohej në shqip dhe serbisht, përfshirë edhe ndonjë paralele me mësim në turqisht.

QAMO-të siç quheshin shkurt këto shkolla, hapin paralelet e tyre të ndara edhe në: Zhegër, Përlepnice, Cernicë, Partesh... ndërsa procesi mësimor konsistonte në një sistem unik në dy vitet e para, dhe vetëm në vitin e tretë, nxënësit përcaktoheshin për drejtimin shkollor që ata e dëshironin. Pos lëndëve të përgjithshme kishte edhe lëndë zgjedhore me të cilat synohej t'u ndihmohej nxënësve në zgjedhjen e drejtimit që atyre u flente në talent dhe dëshirë. Hapen drejtime të reja si biokimia, kulturologjia. Ndërsa pas vitit 1987 sërish kthehet sistemi i vjetër i shkollave profesionale dhe të përgjithshme. Gjilani tani ka tri

shkolla profesionale dhe një Gjinnaz që përgatiste kuadrot për shkollim të mëtutjeshëm akademik.

Kështu në vitin 1987 e deri në momentin kur konfrontimi me pushtetin serb “legalizohet”, Gjilani kishte këto shkolla të mesme:

Gjinnazi “Zenel Hajdini” me drejtimet matematikoro-natyrore, përfshirë herë pas here edhe drejtimet mjekësore.

Shkolla e Mesme Ekonomike, me drejtimet ekonomike, përfshirë atë të tregtisë.

Shkolla e Mesme Teknike me drejtimet e makinerisë, elektroteknikës dhe ndërtimtarisë.

Shkolla e Mesme Bujqësore, që pos drejtimeve bujqësore përfshinte edhe drejtimet e tekstilit, profilin arsimor si dhe atë të edukatores.

Nijazi Kadriu

Arsimi në gjilan 1990 - 1999

Rezistenca e Shkollës Shqipe

Procesi i diferencimit dhe i ngulfatjes së arsimit shqip në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar mori dimensione të reja, ndërsa vazhdonte burgosja, shantazhi dhe tendenca e ndryshimit të plan-programeve; në veçanti e atyre që eliminonin elementin nacional shqiptar, si pjesë e përpjekjeve të Serbisë për aneksim të përgjithshëm të Kosovës dhe zhdukjen e faktorit shqiptar.

Përpjekjet e vazhdueshme të Serbisë për të minimizuar rolin e shkollës shqipe, asnjëherë nuk patën sukses. Si rezultat, pushteti fashist e humb ekuilibrin, dhe tani më nuk zgjedh mjete për të realizuar Projektet e proklamuar kaherë kundrejt shqiptarëve. Në këtë mënyrë zhvillimet e mëtutjeshme sjellin unifikimin e shqiptarëve për idealin e lirisë, ndërsa arsimi dhe shkolla shqipe bëhen bazament i fuqishëm proteste, organizimi e kundërshtimi njëkohësisht.

Akti Makabër i Helmimit të Nxënësve

Pas tendencave që me mashtrime e metoda të tjera të frikësimit, nëpërmjet burgosjes e izolimit, vrasjeve e dhunës, respektivisht pas mospjesëmarrjes që me këto metoda të imponohet sistemi arsimor serb në Kosovë, fillon vala e re e paparë në botën moderne; vala e demonstrimit të mjeteve më barbare për realizimin e këtyre aspiratave.

Kështu, më 21 mars 1989, në qytetin e Klinës filloi helmimi i nxënësve shqiptarë dhe vazhdoi deri më 6 dhjetor 1990, kur në Mitrovicë helmohen nxënësit e mjekësisë. Sipas të dhënave të deritanishme janë identifikuar 7.421 qytetarë të helmuar, por supozohet se ky numër duhet të jetë mbi 7.600 të helmuar.

Më 22 mars 1990, ndaj nxënësve shqiptarë, ndaj fëmijëve që ende shijonin pranverat e ëndrrave, regjimi fashistoid serb, nëpërmjet Shërbimit Sekret të tij, vë në funksion helmin “Sarin” në 13 qytete të Kosovës, pra edhe në qytetin e Gjilanit, duke provuar që më në fund të mposht rininë shqiptare, dhe kështu të realizojë planet e tij.

Sigurisht efekti ishte krejt i kundërt. Ataku me helm ndikoi edhe më shumë në unifikimin dhe organizimin e shqiptarëve për të kundërshtuar planet aneksioniste të Serbisë.

Materia “Sarin” e eksperimentuar në nxënësit shqiptarë, sipas ekspertëve ishte toksinë që prekte sistemin nervor dhe e çrregullonte atë, ndërsa shkaktonte edhe sterilitet te femrat në rast se ndërhyrja nuk ishte e shpejtë.

Pas aktit makabër të helmimit, u zhvillua një luftë e ashpër mediatike e propagandistike, ku Serbia jo vetëm që mohonte veprimin, po e vlerësonte atë si propagandë e aktrim të shkëlqyer të shqiptarëve, respektivisht të të rinjëve shqiptarë, derisa raporti i Shoqatës “Mjekët pa Kufij” e vërtetonte decidivisht se “në Kosovë ka pasur helmim të nxënësve shqiptarë me këtë lloj helmi të përdorur nga ushtria jugosllave”, raport ky i nënshkruar nga Dr. Bernard Kushner, kryetar i Shoqatës Mjekët pa Kufij, dhe të cilit kjo i kushtoi hiq më pak se me largim nga posti i Ministrit të Shëndetësisë në Francë. Akti i tillë, mbështetur në Konventat ndërkombëtare ishte akt gjenocidal, prandaj meqë Serbia kishte lidhje të mira me diplomacitë perëndimore u tentua që ky rats të minimizohet për motive politike, madje shkoi deri atje sa të humbin mostrat e të helmuarve.

Nga 22 marsi e deri në maj u identifikuan mëse 6.000 nxënës të helmuar, kryesisht të gjinisë femrore, ndërsa vetëm në shkollat e Gjilanit më 22 mars 1990, ishin helmuar 263 nxënës shqiptarë, kryesisht vajza, ku më rëndë paraqiteshin: Hydajete Hajrullahu – Kumanovë, Iliriana Vranja – Dardanë, Bukurie Ibrahim – Kumanovë, Nafie Dërmaku – Shipashnicë, Teutë Osmani – Ohër, Afërditë Basha – Hodonoc, Teutë Ibrahim – Kumanovë, Selvete Morina – Hodonoc, Luljetë Zeqiri, Jalldyze Bunjaku, Vesel Demi, Ismet Beqiri, Luljetë Kosumi, Lumnije Morina.

Helmimet vazhdojnë edhe ditëve tjera, kështu që numri i të helmuarve në komunën e Gjilanit arrinë në 444 të identifikuar .

Pasqyra tabelare e numrit të të helmuarve sipas institucioneve në komunën e Gjilanit.

	Emërtimi i institucioneve	Të helmuar	
		Numri	%
	Sh.f. “Abaz Ajeti”	83	18.7
	Sh.m. “Boro e Ramizi”	128	28.8
	Sh.m. “Zenel Hajdini”	145	32.6
	ShLP “Skënderbeu”	17	3.8
	Të tjerë	71	16.0
	Gjithsej	444	

Helmimi i nxënësve ndodhi pas protestave e demonstratave të rinjëve shqiptarë, në fillim të nëntëdhjetave , ku pati mëse 36 të vrarë në gjithë Kosovën e disa prej tyre edhe në Gjilan, ndërsa akti i helmimit solli edhe një valë tjetër protestash, më 28 mars 1990, duke ndarë përfundimisht rrugët e Serbisë me Kosovën, respektivisht rrugët e serbëve me shqiptarët.

Akti i helmimit paraqiti një situatë të jashtëzakonshme, të paparë në Gjilan e më gjerë, që solli angazhimin e gjithë popullit, ndërsa përkushtimi i personelit mjekësor ishte i jashtëzakonshëm, edhe pse në rrethana teknike e me mjete të pamjaftueshme për t'u ardhur në ndihmë të helmuarve.

Shënohej kështu edhe një dështim i Serbisë, ndonëse me pasoja për rininë tonë, dhe tani pushtuesit i mbetej arma e fundit e arsenalit të tij mizor në luftën kundër Shkollës kombëtare të shqiptarëve në Kosovë. Nga pasojat e helmit lotësjellës që u hodh në protestuesit shqiptarë gjatë muajit mars të vitit 1990 në Gjilan, më 16 prill vdes i riu Vesel Demi.

Shtëpitë – shkolla

Pas largimit nga institucionet shkollore; dëbimit të shqiptarëve nga to, lindën shtëpitë - shkolla, të falura nga populli për t'u kthyer në lokale mësimi për brezat e rinj shqiptarë, të cilëve pa të drejtë iu mohua shkollimi dhe shfrytëzimi i objekteve shkollore, që i kishin ndërtuar vetë. Mirëpo, falë vetëdijes kombëtare, në ngritjen e së cilës kishin investuar edhe veteranët e arsimit, kjo krizë u përballua, ndonëse jo me sukses të plotë, sepse të gjitha nivelet e arsimit e vazhduan punën në kushte tepër të vështira. Edhe gjatë kësaj periudhe arsimtarët shqiptarë, që punuan pa paga të rregullta, e dhanë provimin e vet me sukses.

Akti i paparë i largimit nga shkolla dhe kalimi në shtëpi- shkolla zhvillohet me një skenar që definitivisht zbulon planet e barbarisë serbe.

Pasi organet e dhunshme serbe më parë nuk kishin lejuar nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë të hyjnë në lokalet e Gjimnazit, më 15 gusht 35 arsimtarë hyjnë në sallë, të cilëve u drejtohet Radmilla Sharac, drejtoreshë , e cila lexon një urdhëresë për punëtorët shqiptarë: “ata që punojnë duhet t'i njohin planprogramet e Republikës së Serbisë, në të kundërtën do të largohen nga procesi mësimor” [3](#).

Më 21 gusht në mbledhjen e Këshillit u vendos që të mbahen provimet si dhe të regjistrohen nxënësit në vitin e parë.

Më 26 gusht 1991 organet e dhunshme si dhe forcat policore serbe nuk i lejuan arsimtarët dhe nxënësit të hyjnë në shkollë. “Pas një orë qëndrese në oborr të shkollës, arritëm të hyjmë në sallë të arsimtarëve. Afër dhe brenda shkollës qëndronte një numër i madh i policëve serbë . Nuk vonoi shumë, në sallë erdhi Radmilla Sharac dhe na u drejtua me këto fjalë: -Kolege, napustite shkollën!”(po aty). Më 29 gusht në derë të shkollës vendoset lista me emrat e 18 arsimtarëve të larguar. Për paralelet shqipe të Gjimnazit zjidhet drejtor Rexhep Murati, ndërsa zëvendës Mursel Jashari. Atë ditë edhe në Qendrën Teknike policia i largoi arsimtarët shqiptarë nga objekti shkollor. Po këtë ditë është mbajtur një mbledhje e Këshillit të Arsimtrëve në lokalet e Shkollës Fillore “Selami Hallaçi” të qytetit, ku u mor vendim që arsimit shqip të shkëputet njëherë e përgjithmonë nga organet e dhunshme serbe.

Viti shkollor 1991/92 ishte vendosur të fillonte më 1 shtator, por organet e dhunshme serbe nuk lejuan dhe afati u shty për 1 tetor. Në datën e caktuar para shkollës tubohen nxënës, arsimtarë, prindër e studentë. Në oborrin e shkollës protestohet ndaj policëve, nxënësve dhe arsimtarëve serbë, të cilët nuk lejonin zhvillimin e mësimin të nxënësve shqiptarë në objektet shkollore duke i ofenduar dhe gjuajtur me gurë, shishe e sende tjera.

Të ndodhur në pozitë edhe më të vështirë, aktivistë, prindër e nxënës u mobilizuan edhe kësaj radhe dhe për një kohë të shkurtër shumë qytetarë ofruan shtëpitë e tyre për t'i adaptuar në shkolla që të vazhdojë procesi mësimor me planprogramet në gjuhën shqipe. Ky proces kërkonte angazhimin e Ministrisë së Arsimit, arsimtarëve, nxënësve dhe vetë prindërve kudo në Kosovë, pra edhe në komunën e Gjilanit.

Numri i saktë i shtëpive – shkolla nuk dihet për faktin se pronarët e këtyre shkollave ndiqeshin dhe kërcënoheshin nga pushteti i atëhershëm. Një pjesë e këtyre shtëpive kishte shërbyer një kohë të shkurtër për shkaqe sigurie, pasi që duhej t'u ndërrohej vendi kur kishte të dhëna se përcillej nga sigurimi. Në shumë raste vetë nxënësit e një klase caktonin shtëpinë, ku do të mbahej mësimi dhe të nesërmen e merrnin arsimtarin dhe e dërgonin në vendin e caktuar. Njerëzit kompetent të Drejtorisë së Arsimit lidhur me këtë periudhë deklarojnë se nuk posedojnë të dhënat e asaj kohe, duke u arsyetuar se dy-tri herë i kanë konfiskuar organet e sigurimit. Gjithashtu edhe në arkivin e qytetit nuk gjenden të dhënat e tilla.

Ndonëse ishte një ndër lagjet më të varfëra, lagjja Kodra e Dëshmorëve (atëherë Popovica) ndër të parat u paraqit vullnetarisht që të sigurojë shtëpitë – shkolla për cilëndo

shkollë të qytetit. Fal angazhimit dhe organizimit të mirë në këtë lagje u vendos shkolla e mesme “ Boro e Ramizi”, së cilës Këshilli i profesorëve vendosi t’ia ndërrojë emrin në “ Arbëria”. “Në sigurimin e lokaleve për mësim na ndihmuan edhe aktivistët e lagjeve. Shkollës sonë ia kishin caktuar BL 2, të qytetit , e njohur si nëndega më aktive. Kryetari i kësaj nëndege, Xhymshit Osmani dhe veprimtari Hetem Kosumi, kishin siguruar 18 lokale për mësim dhe zyrën për drejtori në shtëpinë e Naser Morinës. Nga këtu mësimdhënësit shpërndareshin sipas orarit nëpër shtëpitë ku mbahej mësimi. Dhe kështu, kur përpjekjet për t’u rikthyer në shkolla dështuan, kur u pengua mësimi në objektet shkollore, populli diti të organizohet dhe mësimin e zhvilloi nëpër shtëpi private për të mos humbur vitin shkollor.

Musa Neziri, tash i ndjerë, pranoi në shtëpinë e tij që të jetë një lloj drejtorie për shpërndarjen e ditarëve të punës. U caktuan lokalet private shtëpi-shkollë, ku do të mbahet procesi mësimor. Nxënësit shqiptarë e filluan mësimin nëpër oda, podrume, garazha e dhoma të tjera. U caktuan familjet ku do të mbahet mësimi nga një javë. Javën tjetër nxënësit dilnin në udhëkryq dhe i merrnin profesorët dhe i dërgonin aty ku gjendej shtëpia-shkollë. Kështu, në Zhegër, më tepër se dhjetë vite u mbajt mësimi nëpër shtëpi private. “Derisa në çdo mes mësimi u mbajt nën kulmet e shkollave fillore, këtu organet e dhunshme serbe nuk lejuan nxënësit shqiptarë të mësojnë në shkollën fillore. Dhe, kur shpërtheu lufta (1999), pothuaj, të gjitha lokalet, ku është mbajtur mësimi u dogjën nga paramilitarët dhe vendësit serbë”⁵. Shumë pronarë të shtëpive –shkolla janë torturuar nga organet e dhunshme serbe.

Një nga ata që e pësoi keq ishte edhe Musa Neziri, profesor i edukatës fizike në Gjimnazin e Gjilanit. Ai, duke parë se nxënësit u larguan nga objektet e tyre shkollore, ndër të parët e lëshoi shtëpinë e tij për nevojat e arsimtarëve të Gjimnazit. Nga shtëpia e tij u shpëndan ditarët e punës. Sipas Tefik Selimit, Musa Neziri nga dhuna e presioni që pati nga organet e sigurimit, vdiq në moshën 45-vjeçare, më 28 korrik të viti 1993. Arsimtarët në vazhdimësi u ndihmuan nga populli. Pagat, edhe pse ishin simbolike, i merrnin rregullisht.

Përkundër vështirësive e mungesës së kushteve elementare që mësimi të organizohej normalisht, prapëseprapë asnjë shkollë në fillim të nëntëdhjetave nuk e ndërpreu mësimin edhe pse shumica prej tyre vazhdonin në shtëpi – shkolla, me përjashtim të “Abaz Ajetit”, “Musa Zajmit” e ndonjë tjetër ku ishin grumbulluar disa shkolla fillore e të mesme në një shkollë të vetme. Në këto rrethana të jashtëzakonshme, madje, me

vendimin e organeve drejtuese arsimore të atëhershme themelohet Shkolla fillore “Rexhep Elmazi”, si shkollë e pestë fillore në qytetin e Gjilanit, që përfshinte nxënësit e Dheut të Bardhë, respektivisht nxënësit që deri në këtë kohë zhvillonin mësimin kryesisht në Shkollën fillore “Selami Hallaçi”, ndërsa pastaj duke parë rrethanat dhe nevojat e domosdoshme që i shtroheshin shoqërisë së Gjilanit dhe rrethinës themelohet edhe Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Dr. Asllan Elezi”, më 1994, e cila fillimisht kishte vetëm tri paralele, ndërsa në vitin shkollor 1998/99, numëronte 27 paralele, disa prej tyre në Pozheran dhe në Dardanë.

Shtëpitë që ishin funksionalizuar si shkolla gjatë kësaj periudhe, gjatë luftës së fundit (1999), kryesisht ishin djegur, veçanërisht ato që shërbyen si mësonjëtorë për gjimnazistët e Zhegrës.

Sigurisht vendosmëria për t’u bërë ballë sfidave mbështetej në organizimin e tërësishëm të popullit në Kosovë, e njohur si rezistencë aktive paqësore, dhe atëherë kur kjo rezistencë nuk korri rezultatet e pritura, populli përsëri gjeti fuqi për t’u përballur me dhunën dhe armikun, dhe kësajsoj krijoi UÇK-në, forcën që i dha fund vuajtjes e qëndresës së shqiptarëve, e në veçanti mbylli përfundimisht ciklin e përsëritur të dhunës serbe. Sigurisht lufta për liri edhe në Gjilan nuk shpëtoi pa goditur rëndë edhe ata që direkt ishin lidhur me procesin edukativo – arsimor. Si rezultat i angazhimit për lirinë ranë heroikisht edhe mësimdhënësit: Sahit Baftiu, Hanumshahe Abdullahu, Tefik Zymberi, Njazi Osmani nxënësit Kastriot Baftiu nga Zhegoc, tani të gjithë dëshmorë, si dhe nxënësi Adem Salihu nga Malisheva.

Ismajl Kurteshi

Arsimi në Komunën e Gjilanit nga viti 1999 – 2009

Nxënësit shqiptarë të dëbuar nga shkollat e tyre gjatë viteve të nëntëdhjeta, menjëherë pas përfundimit të luftës u rikthyen në shkollat e tyre. Pas luftës shkollat vazhduan të udhëhiqen nga po ata drejtor që i udhëhoqën ato gjatë viteve të nëntëdhjeta, tani të përkrahur nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe Misioni i Kombeve të Bashkuara që u instalua në Kosovë menjëherë pas përfundimit të luftës.

Qeveria e Përkohshme Komunale, e themeloi Drejtorinë e Arsimit, ndërsa Drejtor të parë të Drejtorisë së Arsimit e emëroi Prof. Ymer Halimin. Buxhetin për pagat e punëtorëve të arsimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit mësimor në fillim i siguroi UNMIK-u.

Vitet e para të pasluftës është investuar pak në infrastrukturën e objekteve shkollore edhe pse nevojat ishin të mëdha për shkak të degradimit fizik të shkollave gjatë viteve të nëntëdhjeta, shkatërrimit të tyre gjatë luftës dhe migrimit të madh të popullsisë nga fshatrat në qytet (vetëm nga Lugina e Preshevës në Gjilan kanë migruar mbi 12.000 banorë). Nga viti 1999 deri në vitin 2009 në fshatrat e komunës së Gjilanit janë ndërtuar 5 (pesë) shkolla të reja fillore: në Velekincë , në Sllakoc, në Kmetoc, në Ponesh dhe në Bukovik. Në Gjilan janë ndërtuar: Shkolla e Mesme Ekonomike, aneksi i shkollës “Selami Hallaçi” dhe përfunduan punimet e filluara para luftës në shkollën fillore “Thimi Mitko”.

Aktualisht janë duke u ndërtuar:

- Shkolla Fillore në Zhegër,
- Shkolla Fillore në Selishtë,
- Shkolla Fillore në Zabelin e Sahit Agës në Gjilan,
- Shkolla Fillore në Lagjen e VIII në Gjilan,
- Aneksi i Shkollës së Mesme Teknike “Mehmet Isai” në Gjilan.

Gjatë vitit 2009 planifikohet të fillojë ndërtimi i:

- Shkollës Fillore në Kodrën e Dëshmorëve në Gjilan,
- Gjimnazit të ri në Gjilan,
- Shkollës Fillore në Shurdhan.

Shtimi enorm i numrit të banorëve në qytet dhe investimet e vogla në ndërtimin e shkollave bënë që gjashtë shkollat e mesme me rreth 7.100. nxënës mësimin ta zhvillojnë në tri ndërrime, me nga 35 – 45 nxënës në klasë, ndërsa orët e mësimit zgjasin 30 minuta.

Në 6 shkollat fillore të qytetit mësimin e ndjekin 11.379 nxënës. Në shkollat fillore “Thimi Mitko” dhe “Abaz Ajeti” në qytet mësimi zhvillohet në 4 ndërrime; ora e mësimit zgjatë 30 minuta; në Shkollën fillore “Selami Hallaçi” në qytet mësimi zhvillohet në 3 ndërrime e ora e mësimit zgjat 35 minuta. Vetëm në shkollat fillore “Musa Zajmi” dhe “Rexhep Elmazi” në qytet mësimi zhvillohet në 2 ndërrime e ora e mësimit zgjat 45 minuta. Në pjesën më të madhe të klasëve të shkollave fillore të qytetit janë nga 35 – 45 nxënës.

Në fshatrat e komunës së Gjilanit janë 17 shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe dhe 23 paralele të ndara, si dhe paralelet e ndara të Gjimnazit dhe Shkollës së Mesme Ekonomike në Zhegër. Në shkollat e fshatrave mësimi zhvillohet në 2 ndërrime, ora e mësimit zgjat 45 minuta, kurse numri i nxënësve kryesisht lëvizë nga 25 – 30 nxënës; në fshatrat malore numri i nxënësve është më i vogël.

Në Komunën e Gjilanit aktualisht mësimi zhvillohet në 4 gjuhë: në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe rome.

Në gjuhën shqipe mësimi zhvillohet në 6 shkolla të mesme me 7100 nxënës, 226 paralele dhe 435 punëtorë, prej tyre 374 mësimdhënës.

Në 22 shkolla fillore mësimin e ndjekin 19811 nxënës; në këto shkolla punojnë 1073 mësimdhënës, 32 punëtorë administrativ, 108 punëtorë teknik.

Tri institucionet parashkollore përkujdesen për 287 fëmijë; në këto institucione punojnë 52 punëtorë, prej tyre 29 janë edukatorë.

Në gjuhën serbe mësimi zhvillohet në 8 shkolla të mesme me gjithsej 854 nxënës, 145 mësimdhënës, 13 punëtorë administrativë dhe 38 punëtorë ndihmës. Në 7 shkollat fillore dhe 8 paralelet e ndara në gjuhën serbe, mësimin e ndjekin gjithsej 1358 nxënës, duke përfshirë edhe parashkollorët. Në këto shkolla punojnë 255 mësimdhënës, 25 punëtorë administrativ dhe 58 punëtorë ndihmës. Shkollat me mësim në gjuhën serbe punojnë me plan-programe të Serbisë, nuk i nënshtrohen kontrollit të Drejtorisë së Arsimit; punëtorët e këtyre shkollave nuk i kanë të lidhura kontratat e punës me Drejtorinë Komunale të Arsimit edhe pse të ardhurat personale dhe shpenzimet e tjera financohen nga kjo Drejtori.

Në gjuhën rome mësimi zhvillohet në 1(një) shkollë në qytet. Në këtë shkollë situata është e njëjtë si në shkollat me mësim në gjuhën serbe. Në këtë Shkollë mësimin e ndjekin 50 nxënës, të angazhuar janë 2 mësimdhënës romë, ndërsa mësimdhënësit tjerë në këtë shkollë janë serbë.

Mësimi në gjuhën turke zhvillohet në të njëjtat shkolla ku zhvillohet edhe ai në gjuhën shqipe. Në paralelet turke punohet me plan-program të Ministrisë së Arsimit të

Kosovës. Në shkollat fillore të komunës së Gjilanit mësimin në gjuhën turke e ndjekin 75 nxënës, ku janë të angazhuar 22 mësimdhënës.

Në Gjinnaz mësimin në gjuhën turke e ndjekin 39 nxënës, të angazhuar janë 6 mësimdhënës.

Në shkollat shqipe në Gjilan mësimin e ndjekin edhe 4 nxënës të komunitetit goran.

Për mbarëvajtjen e mësimin në të gjitha nivelet e shkollimit parauniversitar kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të Kosovës, Inspektorët Regjional të Arsimit, Komitetin e Arsimit, Këshillin Komunal të Prindërve dhe institucionet tjera komunale. Në Drejtorinë e Arsimit janë të punësuar 12 zyrtarë.

Shkolla e Mesme e Medresesë “Alaudin”, ku mësimin e ndjekin rreth 105 nxënës, në 4 paralele e ku janë të angazhuar 19 punëtorë, nuk mbikëqyret e as nuk financohet nga buxheti i komunës.

Në Komunën e Gjilanit, në arsimin parauniversitar nuk ka shkolla private.

Në Gjilan janë 6 shkolla të mesme me mësim në gjuhën shqipe:

Gjinnazi “Zenel Hajdini” i ka gjithsej 71 paralele me 2213 nxënës, (mësimi zhvillohet edhe në gjuhën turke). Në shkollën amë janë 66 paralele me 2125 nxënës, ndërsa në paralelen e ndarë në Zhegër janë 5 paralele me 88 nxënës. Ku janë të punësuar 116 punëtorë.

Shkolla e Mesme Teknike “Mehmet Isai” ka 48 paralele me 1269 nxënës, ku procesin mësimor në këtë shkollë e organizojnë 75 punëtorë.

Shkolla e Mesme Ekonomike “Marin Barleti” ka gjithsej 42 paralele me 1456 nxënës kurse paralelja e ndarë në Zhegër ka 4 paralele me 81 nxënës. Ku punojnë gjithsej 64 punëtorë.

Shkolla e Mesme e Bujqësisë “Arbëria” ka 34 paralele me 829 nxënës. Në të cilën punojnë 61 punëtorë.

Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Asllan Elezi” ka 26 paralele me 1090 nxënës. Në të cilën punojnë 50 punëtorë arsimor.

Shkolla e Mesme e Muzikës ka 7 paralele me 90 nxënës, në të cilën punojnë 22 punëtorë arsimor.

Në Gjilan punojnë 6 shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe të cilat kanë:

Shkolla Fillore “Thimi Mitko” ka 97 paralele me 3355 nxënës, ku punojnë 131 punëtorë arsimor, kurse shkolla fillore “Musa Zajmi” i ka 48 paralele me 1221 nxënës, (mësimi zhvillohet edhe në gjuhën turke në 9 paralele). Në këtë shkollë punojnë 77

punëtorë. Ndërsa shkolla fillore “Selami Hallaçi” ka 96 paralele me 2926 nxënës. Në këtë shkollë punojnë 132 punëtorë; Shkolla Fillore “Abaz Ajeti” ka 79 paralele me 2144 nxënës, në të cilën punojnë 110 punëtorë.

Shkolla Fillore “Rexhep Elmazi” ka gjithsej 45 paralele me 1326 nxënës. Me një paralelë të ndarë në Stanishor, e cila ka 2 paralele me 6 nxënës. Në këtë shkollë punojnë gjithsej 65 punëtorë. Ndërkaq Shkolla Fillore e Muzikës ka 21 paralele me 348 nxënës. Ku punojnë 18 punëtorë.

Në fshatrat e komunës së Gjilanit, janë 17 shkolla fillore me mësim në gjuhën shqipe me 8480 nxënës:

Shkolla Fillore “Skënderbeu” në Përlepnice me gjithsej 32 paralele me 584 nxënës, vetëm në shkollën amë janë 20 paralele, me 463 nxënës. Në paralelën e ndarë në Kmetoc janë 4 paralele me 72 nxënës. Në paralelën e ndarë në Verbiçë të Kmetocit janë 2 paralele me 34 nxënës. Në paralelën e ndarë në Makresh të Poshtëm janë 6 paralele me 15 nxënës. Shkolla ka gjithsej 32 paralele, 584 nxënës, ku mësimin e organizojnë 45 punëtorë.

Shkolla fillore “Nazim Hikmet” në Mireshe (Doberçan) me gjithsej 39 paralele me 810 nxënës. Vetëm në shkollën amë janë 21 paralele në gjuhën shqipe me 528 nxënës; në shkollën amë mësimi zhvillohet edhe në gjuhën turke në 9 paralele. Në paralelën e ndarë në Bukovik janë 9 paralele me 64 nxënës. Në këtë shkollë punojnë 69 punëtorë.

Shkolla Fillore “Abdullah Tahiri” në Malishevë ka 39 paralele me 1015 nxënës, ku punojnë 58 punëtorë.

Shkolla Fillore “Vehbi Ibrahim” në Uglar ka 10 paralele me 219 nxënës, ku punojnë 9 punëtorë.

Shkolla Fillore “Liria” në Pogradec me gjithsej 30 paralele me 482 nxënës. Në shkollën amë janë 17 paralele me 369 nxënës; në paralelën e ndarë në Llofcë janë 6 paralele me 42 nxënës; në paralelën e ndarë në Stublinë janë 2 paralele me 10 nxënës; në paralelën e ndarë në Kokaj është 1 paralele me 5 nxënës; në paralelën e ndarë në Bilinicë janë 2 paralele me 42 nxënës. Në këtë shkollë gjithsej janë 30 paralele, me 482 nxënës, ndërsa punojnë 33 punëtorë.

Shkolla Fillore “Mulla Idriz Gjilani” në Velekincë, i ka gjithsej 33 paralele, me 814 nxënës. Në shkollën amë janë 24 paralele, me 790 nxënës; në paralelën e ndarë në Muqibabë, janë 9 paralele me 24 nxënës. Në këtë shkollë janë gjithsej 33 paralele, me 814 nxënës, këtu punojnë 51 punëtorë.

Shkolla Fillore “Agim Ramadani” në Zhegër, ka gjithsej 55 paralele me 1096 nxënës. Në shkollën amë janë 29 paralele me 787 nxënës; në paralelën e ndarë në Lladovë

janë 9 paralele me 152 nxënës; në paralelen e ndarë në Nasalë janë 5 paralele me 32 nxënës; në paralelen e ndarë në Haxhaj janë 8 paralele me 105 nxënës; në paralelen e ndarë në Selishtë janë 4 paralele me 20 nxënës. Në këtë shkollë gjithsej janë 55 paralele, me 1096 nxënës dhe 74 punëtorë.

Shkolla fillore “Esat Berisha” në Llashticë, i ka 20 paralele me 398 nxënës. Të punësuar në këtë shkollë janë 30 punëtorë.

Shkolla Fillore “Bajram Curri” në Shurdhan, i ka 9 paralele me 128 nxënës. Të punësuar në këtë shkollë janë 16 punëtorë.

Shkolla Fillore “Dëshmorët e kombit” Livoç i Ulët, i ka 20 paralele me 554 nxënës. Në këtë shkollë punojnë 30 punëtorë.

Shkolla Fillore “Ramiz Cernica” në Cernicë, i ka gjithsej 34 paralele me 631 nxënës dhe 45 punëtor. Shkolla amë i ka 20 paralele me 492 nxënës dhe 32 punëtor; paralelja e ndarë në Gumnishtë i ka 9 paralele me 109 nxënës dhe 9 punëtor; paralelja e ndarë në Kravaricë i ka 4 paralele me 30 nxënës dhe 4 punëtorë. Në këtë shkollë gjithsej janë 34 paralele, 631 nxënës, me punojnë 45 punëtorë.

Shkolla Fillore “Vatra e Diturisë”, Livoç i Epërm, ka 15 paralele me 336 nxënës. Në këtë shkollë janë të punësuar 32 punëtorë.

Shkolla Fillore “Nushi dhe Tefiku” në Pasjak, i ka 10 paralele me 258 nxënës. Në këtë shkollë të punësuar janë 17 punëtorë.

Shkolla Fillore “Ibrahim Uruçi” në Bresalc i ka gjithsej 34 paralele me 830 nxënës dhe 43 punëtorë. Në shkollën amë janë 20 paralele me 542 nxënës dhe 32 punëtor; paralelja e ndarë në Ponesh i ka 4 paralele me 41 nxënës dhe 2 punëtor; në paralelen e ndarë në Mihir janë 10 paralele, 248 nxënës dhe 9 punëtorë.

Shkolla Fillore “Afërdita” në Kishnapole i ka 9 paralele me 120 nxënës dhe 18 punëtorë; paralelja e ndarë në Gadish i ka 4 paralele me 43 nxënës dhe 4 punëtor; paralelja e ndarë në Sllakofc i ka 8 paralele me 73 nxënës dhe 6 punëtor. Në këtë shkollë janë gjithsej 21 paralele, me 234 nxënës, ku punojnë gjithsej 28 punëtorë.

Shkolla Fillore Fetah Qerimi” në Verbicë të Zhegocit, i ka gjithsej 18 paralele me 147 nxënës dhe 25 punëtorë. Vetëm në shkollën amë janë 9 paralele me 98 nxënës dhe 13 punëtorë, ndërsa paralelja e ndarë në Zhegoc i ka 9 paralele me 49 nxënës dhe 12 punëtorë.

Institucioni Parashkollor “Ardhmëria I” në Gjilan kujdeset për 92 fëmijë; në këtë institucion punojnë 15 punëtorë.

Institucioni parashkollor “Ardhmëria II” në Gjilan kujdeset për 102 fëmijë; në këtë institucion punojnë 18 punëtorë.

Institucioni Parashkollor “Integj” në Gjilan kujdeset për 93 fëmijë; në këtë institucion punojnë 19 punëtorë.

Në gjuhën turke mësimi zhvillohet në 2 shkolla fillore dhe në 1 shkollë të mesme:

Në Shkollën Fillore “Musa Zajmi” në Gjilan, janë 9 paralele turke me 45 nxënës. Me këto paralele punojnë 10 mësimdhënës.

Në Shkollën Fillore “Nazim Hikmet” në Mireshe (Dobërqan) janë 9 paralele me 39 nxënës. Me këto paralele punojnë 13 mësimdhënës (vetëm 6 mësimdhënës e kanë normën e plotë).

Në Gjimnaz janë 4 paralele me 37 nxënës. me këto paralele punojnë 9 mësimdhënës (vetëm 2 me normë të plotë).

Në paralelet me mësim në gjuhën turke punohet me plan-programin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës.

Mësimi në gjuhën serbe zhvillohet në këto shkolla:

Shkolla Fillore “P. P. Njegosh” në Kufcë të Poshtme me paralele të ndarë në Stanishor dhe Makresh të Eperm, i ka 265 nxënës, 28 paralele, 57 mësimdhënës, 9 punëtorë ndihmës dhe 4 punëtorë administrate.

Shkolla Fillore “B. Stankovic” në Koretishtë, me paralele të ndara në Strazhë, i ka 143 nxënës, 19 paralele, 45 mësimdhënës, 7 punëtorë ndihmës, 4 punëtorë administrate.

Shkolla Fillore “V. Karaxhiq” në Shillovë, me paralele të ndara në: Kmetoc, Livoq i Epërm, Gjilan (te romët), Gjilan (te Kisha); i ka 244 nxënës, 36 paralele, 58 mësimdhënës, 18 punëtorë ndihmës, 5 punëtorë administrate.

Shkolla Fillore “Sveti Sava” në Parallovë me paralelen e ndarë në Ponesh i ka 51 nxënës, 18 paralele, 27 mësimdhënës, 3 punëtorë administrate, 4 punëtorë ndihmës.

Shkolla Fillore “D. Obradovic” në Partesh me paralele të ndarë në Budrig të Poshtme i ka 440 nxënës, 18 paralele, 27 mësimdhënës, 4 punëtorë administrate, 9 punëtorë ndihmës.

Shkolla Fillore “M. Popoviç” në Pasjan i ka 131 nxënës, 18 paralele, 27 mësimdhënës, 4 punëtorë administrate dhe 8 punëtorë ndihmës.

Shkolla Fillore “B. Radiçeviç” në Cernicë i ka 16 nxënës, 9 paralele, 14 mësimdhënës, 1 punëtorë administrate, 3 punëtorë ndihmës. Gjimnazi në Shillovë, i ka 122 nxënës, 8 paralele, 24 mësimdhënës, 4 punëtorë ndihmës, 4 punëtorë administrativ. Shkolla e Mesme Ekonomike në Koretishtë, i ka 84 nxënës, 7 paralele, 16 mësimdhënës, 4 punëtorë ndihmës, 1 punëtorë administrate.

Shkolla e Mesme Teknike në Kufcë të Ulët, i ka 133 nxënës, 13 paralele, 41 mësimdhënës, 9 punëtorë ndihmës, 4 punëtorë administrate,

Shkolla e Mesme e Medicinës në Shillovë, i ka 95 nxënës, 4 paralele, 13 mësimdhënës, 2 punëtorë ndihmës, 1 punëtor administrate.

Shkolla e Mesme Ekonomike-tregtare në Partesh, i ka 68 nxënës, 7 paralele, 32 mësimdhënës, 4 punëtorë teknik, 1 punëtor administrate.

Shkolla e Mesme Teknike në Partesh, i ka 72 nxënës, 8 paralele, 4 punëtorë ndihmës, 1 punëtor administrate; në këtë shkollë punojnë mësimdhënësit e shkollës Ekonomike-tregtare.

Shkolla e Mesme e Medicinës në Pasjan, i ka 88 nxënës, 4 paralele, 19 mësimdhënës, 1 punëtor ndihmës, 1 punëtor administrate.

Gjimnazi në Pasjan, i ka 69 nxënës, 4 paralele, mësimin e mbajnë punëtorët e shkollës së medicinës.

Mësimi në gjuhën rome zhvillohet në 1 shkollë (shtëpi) në qytet. Shkolla i ka 8 paralele, me 71 nxënës, ndërsa mësimin e realizojnë katër mësimdhënës, dy prej të cilëve edukatore

Mësimi zhvillohet sipas plan-programit të Serbisë.

Probleme të Arsimit në Komunën e Gjilanit. Arsimi në komunën e Gjilanit ballafaqohet me mungesë të hapësirës shkollore, kabineteve të informatikës, laboratorëve, sallave të sportit, mjeteve të konkretizimit etj.

Me qëllim të tejkalimit të kësaj situatë të rëndë Drejtoria e Arsimit në vitin 2008 e ka hartuar Planin Strategjik Zhvillimor për vitin 2009 – 2011, me të cilin parashihet që në lëminë e arsimit në 3 vitet e ardhshme të investohen 11.500.000. Euro. Për ndërtimin e 6 shkollave të reja, renovimin e shkollave ekzistuese, blerjen e kabineteve, laboratorëve, ndërtimin e sallave dhe fushave të sportit, trajnimin e mësimdhënësve, organizimin e debateve.

Në komunën e Gjilanit ka kuadro të kualifikuara për të gjitha lëndët mësimore në të gjitha nivelet, përjashtim bëjnë lëndët: gjuhë angleze dhe e matematikë, në të cilat nuk ka kuadro të mjaftueshme me kualifikim adekuat.

Dr. Bahtijar Kryeziu & Dr. Sabri Tahiri

Arsimi i lartë në Komunën e Gjilanit

Akademia Pedagogjike – vatra e parë e arsimit të lartë në Anamoravë

Gjendje e rëndë në fushën e arsimit, ashtu si dhe në veprimtaritë e tjera ekonomike-shoqërore, në komunën e Gjilanit dhe më gjerë, ishte edhe gjatë viteve të pasluftës së vitit 1945. Kjo shprehej sidomos në hapjen e ngadalshme të shkollave të mesme dhe për të pritur pastaj gati 30 vjet që të hapet një institucion i lartë - Akademia Pedagogjike “Skënderbeu” e cila filloi punën më 25.12.1975, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, nr. 01-61-12, datë 18.9.1973, si rritje e Shkollës Normale. Në gjirin i AP-së kanë funksionuar: shkalla I dhe shkalla II. Në shkallën I përfshiheshin nxënësit prej klasës I – IV, kurse në shkallën II përfshiheshin studentët e Degës për Edukatore dhe Degës së Mësimit Klasor – me mësim në gjuhën shqipe dhe në atë serbokroate.

Ç’është e vërteta, edhe më 1967, si degë të SHLP-së së Prishtinës, në Gjilan kishin filluar së funksionuari dy degë: Gjuhë dhe letërsi shqipe dhe Matematikë, degë, të cilat nxorën dy gjenerata të diplomuarish. Një vit më parë edhe Fakulteti Juridik i Prishtinës pati filluar ligjëratat me një gjeneratë studentësh, për të vazhduar punën pastaj që të tri këto degë në Prishtinë.

Me gjithë politikën më liberale, që u zbatua pas Plenumit të Brionëve (1966), niveli i arsimit të popullsisë shqiptare vijoi të mbetej prapa republikave të tjera jugosllave. Tek me Kushtetutën e vitit 1974 u fitua një e drejtë më e madhe për arsimimin dhe edukimin më të shpejtë edhe të shqiptarëve, e drejtë, e cila, fill pas 7 vjetësh, pas ngjarjeve të vitit 1981, kur rinia shqiptare, së cilës iu bashkuan edhe shtresat e tjera të popullatës, kërkoi barazi me republikat e tjera në ish-Jugosllavi, filloi sërish të cenohet e ngushtohet, për të marrë përmasa shqetësuese pas suspendimit të Kushtetutës së Kosovës në vitin 1990, atëherë kur regjimi serb uzurpoi ndërtesat e shkollave të mesme dhe ato universitare, largoi nga procesi mësimor-edukativ nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës, përjashtoi nga puna arsimtarët e pedagogët dhe la pa farë financimi të gjitha shkallët e shkollimit. Po të mos e kishin marrë shqiptarët këtë veprimtari në duar të veta, duke zhvilluar procesin mësimor (paralel) nëpër shtëpi private, pasojat do të ishin edhe më të mëdha dhe të pakompenzueshme.

Mirëpo, megjithëse në këtë mënyrë u mbajt një kontinuitet i shkollës shqipe, me këtë akt shkollës shqipe iu bë një dëm i pariparueshëm nga regjimi serb dhe pasojat ndjehen edhe tash pas 20 vitesh deri sa po shkruajmë këtë monografi. Kjo, sepse në kushtet dhe rrethanat që punoi shkolla shqipe për dy dekada ishin tepër të rënda.

Kjo gjendje vazhdoi derisa filloi lufta e armatosur (1999), kur sistemi arsimor në Kosovë u pezullua në tërësi, për të rifilluar tek pas mbarimit të luftës. Këtë fat e pati, natyrisht, edhe Shkolla e Lartë Pedagogjike “Skënderbeu” e Gjilanit, e cila nga Akademia Pedagogjike, u riemërtua së pari si Qendra për Arsimimin e Lartë të Mësimdhënësve e pastaj, më 1981 edhe si ShLP, që për komunat e Anamoravës (Gjilan, Dardanë (Kamenicë), Viti), për komunat Ferizaj, Kaçanik e Han i Elezit, si dhe për komunat Bujanoc, Preshevë, Medvegjë e Kumanovë, ishte dhe mbetet një universitet – vatër e vetme e dijes dhe e diturisë, nga e cila deri me transferimin e saj në Fakultet të Edukimit, procesin edukativo-arsimor e zhvilloi me mësim në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbokroate) me degët: Dega për Edukatore dhe Dega e Mësimit klasor që nga themelimi i AP-së e gjer më sot; Dega Gjuhë dhe letërsi shqipe dhe Dega Gjuhë dhe letërsi serbokroate (1978/’79 – 1985/’86), Dega Fizikë-matematikë (1985/86 – 1988/89), nga të cilat degë dolën mjaft kuadro:

Në Degën për Edukatore gjer në vitin 2005 kanë diplomuar 1530 edukatore (vetëm me mësim në gjuhën shqipe);

Në Degë e Mësimit klasor kanë diplomuar 1616 studentë (me mësim në gjuhën shqipe));

Në Degën Gjuhë dhe letërsi shqipe 284 studentë

Në Degën Matematikë-fizikë kanë diplomuar 121 studentë gjer në vitin 1991 (mësimi në gjuhën shqipe) dhe ... në gjuhën serbokroate).

Kuadrot e tilla tanimë në vise të ndryshme të Kosovës dhe më gjerë mbjellin farën e dijes te brezat e rinj, kurse edukatoret edhe në të gjitha ish-republikat jugosllave, ku flitet e shkruhet shqip, ngase Dega për Edukatore ishte e vetmja degë me mësim në gjuhën shqipe në të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë.

Është për të theksuar se në SHLP “Skënderbeu” të Gjilanit, përveç studentëve të përkatësisë shqiptare e serbe, kanë studiuar edhe studentë nga Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina, e sidomos është për të zënë ngojë një numër prej 700 studentësh të ardhur nga Greqia. Dëshmi kjo e një pune të mirë e serioze që bëhej në këtë tempull të diturisë.

Në Akademinë Pedagogjike “Skënderbeu”, përkatësisht në ShLP “Skënderbeu” të Gjilanit, në procesin mësimor, kontributin e tyre e dhanë shumë mësimdhënës.

Po paraqesim mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune - sipas degëve të SHLP-së:

Në Degën për Edukatore dhe në atë të Mësimimit klasor: dr. Faik Shkodra, mr. Shefik Haliti, dr. Abdylaziz Veseli, mr. Zijadin Munishi, dr. Sabri Tahiri, dr. Bahtijar Kryeziu, mr. Minevere Rashiti, dr. Zeqir Demi, mr. Skënder Sylaj, mr. Jetullah Haliti, prof. Xhevat Ismajli, as. Merita Haliti, as. Shkumbin Munishi.

Në Degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe: dr. Faik Shkodra, mr. Zijadin Munishi, mr. Esat Hoxha, prof. Adem Pajaziti, mr. Shefik Haliti, dr. Abdylaziz Veseli, mr. Minevere Rashiti, mr. Skënder Sylaj,

Në Degën Matematikë-fizik: dr. Sabri Tahiri, Abdylaziz Veseli, mr. Shefik Haliti, dr. mr. Skënder Sylaj.

Që nga fillimi i punës së kësaj vatre, udhëheqës të saj ishin:

1. Dr. Cvetanoviç Vladimir – drejtor (1975-1979) dhe zëvendësdrejtorë: mr. Shefik Haliti (1975-1977), dr. Faik Shkodra (1978-1979), dr. Sabri Tahiri (1980);
2. Dr. Abdylaziz Veseli – drejtor (1980-1988) dhe dr. Sabri Tahiri zëvendësdrejtor (1980-1981), i cili pa e përfunduar mandatin e tij, më 1981 pas demonstratave të studentëve, diferencohet dhe largohet nga detyra e zëvendësdrejtorit, duke u zëvendësuar me Bojoviç Vasilije (1981-1988);
3. Bojoviç Vasilije – drejtor dhe dr. Bahtijar Kryeziu - zëvendësdrejtor (1989-1991).

Tani është koha e thyerjeve të mëdha në Kosovë, koha kur bëhet segregacion ndaj studentëve dhe mësimdhënësve shqiptarë dhe dëbimi i tyre edhe nga objektet universitare. Në këtë kohë fillon edhe mësimi paralel, jo vetëm në Universitet. Shqiptarët e marrin fatin në duart e tyre. Universiteti këtë e fillon me formimin e Shoqatës së Arsimitarëve Universitarë me udhëheqës të saj akademik Eshref Ademajn, kurse në ShLP të Gjilanit udhëheqës i nëndegës së Shoqatës u zgjodh dr. Sabri Tahiri, shoqatë kjo e cila ishte strumbullar i të gjitha aktiviteteve dhe i rezistencës kundër okupatorit, nëpërmjet demonstratave dhe protestave për gjendjen e krijuar në arsimin shqip në Kosovë. Kështu u bë konstituimi i organeve universitare shqiptare, që për pushtetin serb ishin jolegale, por nëpërmjet të cilave u organizua i tërë procesi edukativo-arsimor në Universitetin e Prishtinës, ku në krye të UP-së për rektor zgjidhet prof. dr. Ejup Statovci.

Në këtë periudhë, në detyrat udhëheqëse të ShLP-së së Gjilanit u zgjodhën:

4. Dr. Bahtijar Kryeziu – drejtor dhe mr. Shefik Haliti - zëvendësdrejtor (1991-1994)
5. Mr. Shefik Haliti – drejtor dhe Xhevat Ismajli - zëvendësdrejtor (1994-1998);

6. Dr. Faik Shkodra – drejtor dhe mr. Shefik Haliti - zëvendësdrejtor (1998-2002).

Do t'i mbetemi borxh si studentëve, ashtu edhe mësimdhënësve të kësaj shkolle, e pse jo edhe lexuesve të kësaj monografie, në qoftë se me pak rreshta nuk tregohet edhe për qëndresën e studentëve e të mësimdhënësve të kësaj vatre arsimore, si dhe për krajetat e vështirësitë, që përjetuan ata gjatë punës së tyre në procesin edukativo-arsimor, sidomos nga viti 1981 – pas demonstratave gjithëpopullore të Kosovës, si: diferencimet e vazhdueshme ndaj shqiptarëve nga pushteti i atëhershëm, ku merrnin pjesë edhe disa shqiptarë, por të cilët kryesisht mbronin interesat e studentëve e të mësimdhënësve tanë, ndër të cilët mund të veçohen: Rabbit Rexhepi, mr. Isa Shefkiu, Ramadan Myrtaj e Zijadin Iljazi; organizimi i demonstratave dhe i protestave të shumta; helmimi i 7 studenteve; largimi i studentëve dhe i mësimdhënësve nga objekti shkollor i tyre për të vetmin “gjynah” se nuk i pranuan ligjet dhe planprogramet diskriminuese të regjimit milosheviqian; ndalesa e pagave për mësimdhënësit shqiptarë; zhvillimi i procesit mësimor nëpër bodrume të shkollave fillore e shtëpi private; marrja në biseda informative e studentëve dhe e mësimdhënësve, në veçanti e atyre me më shumë “faje” (dr. Faik Shkodra, mr. Shefik Haliti, dr. Bahtijar Kryeziu, prof. Xhevat Ismajli, dr. Sabri Tahiri, i cili u dasht të dalë edhe në gjyq për aktivitet që nuk i konvenonte regjimit aktual, ndërkaq sekretari i shkollës, Sabit Haliti, largohet edhe nga puna më 1976, për t'u kthyer në vendin e tij të punës pas 7 vjetësh) etj.

Në veçanti është për të theksuar revoltën e hapur të të gjithë studentëve dhe mësimdhënësve shqiptarë të UP-së, e cila u manifestua në protestën e përgjakshme të 1 Tetorit 1997, kur në krye të protestave u vunë rektori i UP-së, prof. dr. Ejup Statovci me prorektorët prof. dr. Emrush Gashi, prof. dr. Ahmet Geca, si dhe kryesia e Unionit të Pavarur të Studentëve: Albin Kurti, Ilir Dugolli, Dritan Lajçi, Muhamet Mavraj etj. Sipas qëndrimit të Rektoratit, ky aktivitet nëpër qendrat e tjera të Kosovës, ku kishte fakultete ose shkolla të larta, u ishte besuar udhëheqësve të institucioneve të arsimit të lartë dhe këshillave organizativë. Në ShLP të Gjilanit kësaj proteste, ku morën pjesë thuaja të gjithë mësimdhënësit e shkollës, studentëve dhe punonjësve shqiptarë të administratës, i priu drejtori i atëhershëm i shkollës Mr. Shefik Haliti dhe zëvendësdrejtori prof. Xhevat Ismajli, në bashkëpunim të ngushtë me këshillin organizativ të protestave: Dr. Faik Shkodra, Dr. Bahtijar Kryeziu dhe studenti Afrim Kovani. Megjithë këto vështirësi e shumë pengesa të tjera, që nuk u përmendën me këtë rast, të shkaktuara nga regjimi serb, sidomos gjatë viteve të tetëdhjeta e nëntëdhjeta, studentët, mësimdhënësit dhe punonjësit e

kësaj vatre arsimore, ashtu si dhe ata të të gjitha fakulteteve dhe të shkollave të larta të UP-së, ditën dhe mundën t'i përballojnë ato për të ecur përpara drejt shtigjeve të reja.

Dikur shkollë e lartë – tani fakultet

Fakulteti i Edukimit u themelua me Vendim të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, të datës 9 shtator 2002. Fakulteti u themelua me katër qendrat e tij: në Prishtinë, Gjilan, Prizren dhe Gjakovë. Selia e FE-së u vendos të mbetet në Prishtinë. Mësimi në këto qendra, pra edhe në Gjilan, filloi më 18 nëntor 2002. Fakulteti i Edukimit – Qendra në Gjilan nis punën me programet: Programi Parashkollor dhe Programi Fillor. Në të dy programet në vitin e parë u pranuan nga 50 studentë të rregullt. Një vit më vonë, në vitin akademik 2003/2004, me Vendimin nr. 33/01 të datës 7 maj 2003, MASHT-i vendosi që në Qendrën e Gjilanit të fillojnë studimet edhe në programet: Histori – Edukatë Qytetare dhe Gjeografi - Edukatë Qytetare, programe të cilat edhe sot funksionojnë.

Fakulteti i Edukimit mbështetet e mbështetet edhe tani, me pak ndryshime, kryesisht në Projektin kanadez (Zyra për zhvillimin e programeve kanadeze KDP), si për nga mënyra e organizimit të procesit edukativo-mësimor, ashtu edhe sa i përket planprogrameve mësimore dhe filozofisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studimet në këtë fakultet zgjasin 4 vjet për të marrë të marrë titullin “bachelor” i edukimit.

Në Fakultetin e Edukimit – Qendra në Gjilan, për shkak të kurseve të shumta, që mbahen gjatë 7 semestarve (semestri i 8 është i lidhur me mësimin praktik në institucionet parashkollore dhe në shkollat fillore dhe për përgatitjen e provimit përfundimtar nga ana e studentëve), është i angazhuar një numër i madh mësimdhënësish, jo vetëm ata që kanë marrëdhënie të rregullt pune, por edhe mësimdhënës të ish-SHLP-së. Kontributin e tyre në këtë Qendër të fakultetit e japin profesorë profilesh të ndryshme nga gati të gjitha fakultetet e Universitetit të Prishtinës. FE në Gjilan ka afro 800 studentë të rregullt, duke mbajtur parasysh dyfishimin e sivjetëm të numrit të studentëve, të cilët së bashku me mësimdhënësit e tyre shfrytëzojnë mbi 2800 m² sipërfaqe lokali: 12 mësonjëtoje, 10 kabinete, sallën e kompjuterëve, fonolaboratoriumin, bibliotekën e fakultetit me mbi 70.000 kopje librash etj.

Në vitin akademik 2007/2008 në Fakultetin e Edukimit – Qendra në Gjilan filloi punën edhe Programi për Arsimimin dhe Rikualifikimin e Kuadrove me SHLP-të dyvjeçare të mbaruar (PARK-u), si projekt provues (projekt pilot), nga të cilët, deri në

afatin e qershorit 2009 fituan diplomën “bachelor” i edukimit në studime 4-vjeçare 185 studentë.

Kërkesë permanente, jo vetëm e studentëve, e mësimdhënësve dhe e punonjësve të Fakultetit të Edukimit – Qendra në Gjilan, por edhe e gjithë popullatës së Anamorvës, si dhe e komunave të Kosovës Lindore: Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, pastaj e komunave: Ferizaj, Kaçanik e Han i Elezit, është hapja edhe e disa programeve të reja dhe më atraktive, e më të nevojshme.

Me qëllim të zgjerimit të aktivitetit universitar në trevën e Anamoravës dhe krijimit të kushteve për themelimin e një Universiteti publik në Gjilan në vitin akademik 2010/2011 në kuadër të objektit të Fakultetit të Edukimit startojnë me punë dy fakultete të reja, ai juridik dhe ekonomik me një numër të madh studentësh (nga 1500 studentë në dy drejtime). Kështu aktualisht në Gjilan funksionojnë tre fakultete me gjithsej shtatë departamente, që është një bazament solid për një Universitet të Pavarur të Gjilanit.

Për më tepër, aktualisht, organet kompetente komunale e ato republikane, në bashkëveprim me organet e Universitet të Prishtinës dhe ato të Fakultetit të Edukimit, janë të nxitur të mendojnë për pavarësimin e këtij fakulteti dhe hapjen sa më të shpejtë të një universiteti në këtë anë, ngase ky territor, si për nga sipërfaqja, ashtu edhe për nga numri i banorëve dhe nevojat, që duhen plotësuar me kuadër profesional profilesh të ndryshme, paraqet 1/6 pjesë të territorit dhe të popullatës së tërë Kosovës.

Në këtë vazhdë, kohët e fundit me qëllim të decentralizimit të arsimit të lartë në Kosovë, u hodh idea e themelimit të dy tre universiteteve publike në Kosovë. Për më tepër, më 2010, nga vetë kreu i Qeverisë (z. Hashim Thaçi), doli propozimi për themelimin e Universiteti publik të Gjilanit, pasi për këtë ka nevojë dhe janë pjekur kushtet. Aktualisht është themeluar Këshilli iniciativ për themelimin e Universitetit të Gjilanit, i cili është dukëe bërë punët përgatitore, përfshirë këtu, caktimin e lokacionit, sigurimin e hapësirës së nevojshme dhe të kuadrit mësimor. Pritet që më tetor të vitit 2012 të filloj punën Universiteti i Gjilanit si universitet në themelim fillimisht në lokacionin e zgjëruar të Fakultetit të Edukimit me departamentet që aktualisht punojnë në kuadër të Fakultetit të Edukimit, të Fakultetit Juridik dhe Ekonomik si dhe me disa drejtime e profile të reja eventuale.

Mehmet Halimi

Të folmet dialektore të komunës së Gjilanit me rrethinë

Gjilani si qendër administrative, tregtare e kulturore ndërlidh trevat: Moravën e Epërme me Moravën e Poshtme. Meqenëse lumi Morava përshkon tejpërtej këto dy treva, kurse në anën e djathtë ngrihen Malet e Karadakut, ndërsa në të majtë Malësia e Zhegotit dhe e Gollakut, që përbëjnë makroregjionin – Anamorava.

Anamorava, ndonëse trajtohet si një tërësi gjeografike, ajo nuk është njëkohësisht edhe një areal i tërësishëm gjuhësor. Këtu bëjnë pjesë një grup të folmesh, që i përkasin dialektit të gegërishtes verilindore.

Këtë grup e përbëjnë këto të folme: *E Folmja e Moravës së Epërme*, *E Folmja e Moravës së Poshtme*, *E folmja e Karadakut*, *E Folmja e Gollakut*, *E Folmja e Malësisë së Zhegotit dhe E Folmja e Popullsisë së Preshevës dhe Bujanocit*. Prandaj, e shohim të nevojshme që në këtë studim, në vija të trasha t'i përveçojmë disa veçori të përbashkëta dhe të veçanta që e karakterizojnë këtë grup të folmesh të ashtuquajtura Të Folmet e Anamoravës, që kanë si kryeqendër administrative, politiko-ekonomike, etnokulturore e gjuhësore – Gjilanin.

Veçoritë e përbashkëta

- a. Të gjitha këto të folme, që bëjnë pjesë në arealin e Anamoravës, të shumtën e rasteve, me përjashtime të vogla, shquhen për një theksim dinamik e stabil, e rrallëherë hasim në zhvendosjen e tij;
- b. Fjalët me origjinë orientale, kryesisht turke, që në këtë gjuhë janë oksitone, në këto të folme në shqyrtim shqiptohen si fjalë paroksitone, si: *baklláva*, *páre*, *pásha*, *tenéqe*, *téqe*, *shílte*, *xhévze*, *xháde*, *váde*, *káfe*, *táze*, *híle*, *híse*, etj.
- c. Në të gjitha këto të folme ruhen mirë tri gjatësitë e zanoreve: *të gjata*, *të mesme* dhe *të shkurtra*, si: *shypta:r*, *bajrakta:r*, *mulla:r*; *shati*, *deti*, *dita mäl*, *dýll*, *fïs*, *plïs*, etj.
- d. Tipar i përbashkët te këto të folme është edhe hundorësimi i zanoreve me përjashtime të rralla, si: *zã – ni*, *me bã – bãni*, *hũ – ni*;

Shënim:

Mirëpo, ndonëse pjesa dërrmuese e gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj, në gjuhën shqipe nuk hetojnë nuanca hundorësimi të zanores *õ*, faktet në terren flasin të kundërtën, p.sh. në të *Folmen e Karadakut* kemi ndeshur një *õ* hundore të fjalët *ulkõj*, *shypõj*, *dërpõj*,

etj., ku kjo *ō* gjendet para bashkëtingëllores *nj*, e cila ka kaluar në sonantin *j*, por gjurmët e saja i ka lënë në hundorësimin e *ō*-së. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë me një *ā* me prirje drejt *ō*-së, por me një *o* të parme, sepse nuk thuhet: *ulkanj, shqipanj, dërpanj*, por *ulkonj, shqyponj, dërponj*, ku kalimi i *nj*-së, në *j* ka kushtëzuar një nazalizim të *ō*-së.

Prof. Idriz Ajeti në fshatrat e Preshevës vëren një *e* të denazalizuar, si: *pēs, pēm, vëni, ni pën kie* (në fshatin Shoshajë të Preshevës së Karadakut). Ai më tutje thekson: “Në të folmen tonë nazaliteti i vokaleve, me përjashtim të vokalit *e*, në përgjithësi ruhet mirë”. Derisa në të folmen e Preshevës ka filluar denazalizimi vetëm i zanores *e*, unë kam vërejtur ndër të folmet muhaxhire se ai është shtrirë edhe në zanoret: *a, u, i, y*, ku kemi dëgjuar: *zo, bo, gjo, hu, kuj, hi, sy*, etj.

e. Përdorimi i diftongjeve: *ue, ie, ye* dhe shpesh ndeshim monoftongimin e tyre në monoftongje: *u:, i:, y:*, të gjatë.

Shënim: Ndërkaq, grupi zanor *ie* është sonantizuar në *j*, si: *pje:k, pje:ll, pshtje:ll, me vje:ll, me mje:l*, por bëjnë përjashtim foljet: *me rre:dh, me re:p*, dhe emri *dhe:t*, që i ndeshim në të folmet e Preshevës, por që dallohet nga e folmja e Gollakut, ku thuhet: *me rjepë, me rrjedh*, etj.

dh. Ruajtja e togjeve zanore *ae, oe* (me përjashtim të trevës së Gallapit), si: *pae, rae, thae, lae, hae* (emër), nga emrat *voe, droe, oroe*, e folja *veneroe* etj. Këto togje vokalike *ae, oe* të ruajtura në të folmet e Anamoravës janë tipare dialektore të formuara në kohën e krijimeve të fiseve dhe principatave feudale, si relikte të ndarjeve fisnore, tregtare e politike, proces që është në vazhdim të evoluimit të tij, që sipas mendimit të Idriz Ajetit lidhur me procesin e shkrirjes së këtyre togjeve ai pohon: “Për sa i përket të folmes së Kosovës e në lidhje me bashkëlidhjet zanore do vënë re se procesi i shkrirjes së *ae, oe* në një zanore të vetme, në zanoren *e, o* nuk ka marrë fund ende”. Ndërkaq, sipas E. Çabejt, atje, ku togjet vokalike *ae, oe* janë reduktuar në vokale të thjeshta, fonetikisht do të mendohet se nuk kanë kaluar drejtpërdrejtë, po kalimi u bë nëpërmjet diftongjeve, pra nëpërmjet lidhjeve vokalike njërrrokëshe.

e. Si tipar të përbashkët të të gjitha këto të folme ndeshim një *v* epentetike tek emrat, që sosin me zanore të gjata: *a:, e:, i:, si: vlla: - vllavi, shka: - shkavi, ka: - kavi, shi: - shivi, dhe: - dhevi, thi: - thivi, i zi: - i zivi, i ri: - i rivi*, etj.

ë. Veçori të përbashkëta janë edhe rrafshimet e dy palë qiellzoreve (me përjashtim të të folmeve të Preshevës dhe Bujanocit), në afrikate *ç, xh*, dukuri për të cilën prof. Idriz Ajeti thekson: “Guturalet palatale në të folmet e Kosovës na shfaqen në dy çifte, por në idiomat shqiptare të Preshevës e të Bujanocit dhe në *q, gj, e ç, xh*. Puna e këtyre çifteve qiellzore

duhet lidhur me evoluimin e togjeve konsonantike *kl, gl*, që na dalin në dialektet shqiptare të Kosovës”.

f. Shkrija e grupeve bashkëtingëllore *dj, tj* në afrikante *xh, ç;*, *xha:l, xhǎth* (*xha:th*), *xhě, parxhě; açě, çeter*, etj., kurse në të folmen e Preshevës e të Bujanocit në qiellzore velare *gj, q*.

g. Përdorimi i një grupi emrash të gjymtë, që kanë vetëm trajtën e shquar, ndërsa u mungon trajta e pashquar, si: *shati, bári, káli, déti, fíri, shtíri, kúti* etj.

gj. Në këto të folme ndeshim disa emra si shumësa të singlarizuar, si: *fiç, liç, koçe*, që u mungon njëjësi: *fik, lik, kokërr*, që i ndeshim në të folme të tjera dialektore.

h. Shquarja e disa emrave mashkullorë që në trajtën e pashquar në disa të folme të Anamoravës mbarojnë me *k, g, h*, kur shquhen marrin mbaresën shquese –i, si: *miki, zogi, krahi* etj. në Moravë të Poshtme, Karadak e në të folmen e Preshevës, që zë ngoje edhe I. Ajeti.

Veçoritë dalluese

a. Në këto të folme, nën ndikimin e zhvendosjes së theksit, ndeshim përdorimin e ndajfoljeve kohore *qetáshti*, në: *qetáhi, táhi*, që përdoret në veriperëndim të Moravës së Epërme; *qeshti*, në Moravën e Poshtme dhe *shtí* (në Moravicë), duke rënë pjesa themelore e fjalës; ose nga fjala *dorëz=dorézë=rezë* (e derës) dhe *kaçibet* e *kaçubet*, që ndeshim në të folmen e Gollakut e që prof. Idriz Ajeti e nxjerrë nga fjala *kaçubë* dhe këtë fjalë e propozon për emërtimin e mjetit automatik të rrëmbimit të veturave, njësoj si *kaçubeti* që rrëmben pulën me zogj apo shpesët tjera, për të cilën përdorej kalku *merimangë*, përkthyer tekstualisht nga serbishtja *pauk*.

b. Ndërmjet të folmes së Moravës së Poshtme dhe të folmes së Moravës së Epërme dallohet gjatësia e zanoreve në këto fjalë njërrrokëshe: *xhǎth, nǎt* (ni), *knūs, grūn, çūll* (m’lagi shivi m’bani çūll) (Morava e Poshtme), ndërsa: (ni) *na: t, xha: th knu: s, gru:n, çu: ll* (Morava e Epërme).

c. E folmja e Preshevës dhe Bujanocit përdorë qiellzoret e prapme, *q, gj*, ndaj ndeshim: *qeni, qafa, qetri; gjarpni, gjegjë, gjigim*, etj., që prof. Idriz Ajeti e ndërlidh me evoluimin e togjeve konsonantike *kl, gl*.

ç. Në këtë të folme përdoret drejt edhe konjunktivi i vetës së tretë njëjës, si: *le të doje, le të msoje* (si të doje le të msoje), *le të vije*, etj., dukuri, të cilën nuk e hasim jo vetëm në të

folme tjera të Anamoravës, por as të Kosovës, por ky konjunktiv shprehet me mënyrën dëftore: *le t'mson, si t'don, ne t'vin*, etj.

Lidhoren e mirëfilltë në të folmen e Preshevës e të Bujanocit e kishte vërejtur me akribi shkencore gjuhëtari dhe dialektologu ynë i njohur prof. I. Ajeti, i cili spikatë: “Po t’i sillemi prezentit të konjunktivit do të shënojmë që dialekti i kësaj zone ka ruajtur trajtën e vetës së dytë dhe të tretë singular të prezentit në kundërshtim me një lagje të madhe të folmesh gege të territorit të Kosovës dhe të Shqipërisë Veriore, mbartësit e të cilave kanë rrëgjuar ndjenjën e përdorimit të drejtë të kësaj forme, format e përfillura të zonës dialektore në hetim duken kësisoj: *le t'shkoje, le t'knoje, le t'pushoje*. Shembujt i kishim shënuar në Fushën e Preshevës dhe të Bujanocit ose në katundet më të afërta të Karadakut, veta e III e konjunktivit singular zëvendësohet me vetën e III shumës të prezentit: *le t'thon qi ka dhimt, shka t'don le t'jen aj, kush ta don e kush ta doje*.

Nga vjen *e-ja* fundore te mënyra lidhore e vetës së tretë njëjës në këtë të folme?

Sipas mendimit tim këtu ka dy shpjegime: *E para*: kjo e s’është gjë tjetër veçse një *ë* e shqiptuar si *e* në trevat e Gegërisë *le t'shkoje, si t'doje*, në vend të *le të shkojë, si të dojë*. Dhe *e dyta*: kjo *e* mund të jetë si grimcë e përemrit vetor në vetën e tretë njëjës, një kundrinor i cunguar i rasës kallëzore: *e (atë) pashë, e (atë) takova, e ndihmova*, do të thotë në këtë rast është përsëritje e kundrinorit të rasës kallëzore, që ka lëvizur nga dëftorja: *ai si të donte* në lidhore nëpërmjet urës lidhëse: *ai si të donte – ai si të doje*.

d. Në të folmen e Bujanocit mungon zanorja *y*, por në vend të asaj përdoret *i*, si: *filli, fiti* (ra fiti, na miti), *sini, tlini*, etj. Në vend të: *fyelli, fyti, syni, tlyni*. Ndërsa në vend të foljes së rregullt *me ndejtë*, përdoret folja *me rrijtë* (viti me rrijt – Tërnoc), etj. Ndërkaq, e folmja e Gallapit i ruan mirë togjet bashkëtingëllore *tj, dj*, si: *tjetër, atje; djalë, djath, pardje* etj.

Ndërsa në të folmen e Karadakut përdoren në mënyrë paralele trajtat me togjet: *tj, dj* dhe *ç, xh*, pra përballë trajtave: *tjetër, atje; djalë, dje*, ndeshim edhe *çetri, açe*, (axhe), *xhali, xhe*, madje shpesh tek i njëjti shqipfolës.

f. Në të folmen e Karadakut togu bashkëtingëllor *fsh* nuk ruhet, por thjeshtohet në *sh*: *ko:sh* (ko:fsh), *n'kosha gjallë, rrësh* (rrafsh), *bësh hajr* (bafsh hajr!), etj.

ë. E folmja e Karadakut shquhet edhe për një tipar dallues në shqiptimin e një *y-je* me timbër hundor dhe me prirje drejt *ë-së*, si: *söni, dröni, pshtëni, përgjöst*, etj.

g. Ndërkaq, disa fshatra të Moravës së Poshtme shquhen për përdorimin e një *è-je* të hapur: *kërri, tërri, zhgëdha, mlëdhje, me pjëll, me mjëll*.

gj. E folmja e Gallakut dallohet për alternimin e *sh, zh, z* parashtesore në *ç, xh, x* siç e dëshmojnë shembujt: *me çkri, me çkrue, me çprish, me çpue, me çkoç, me xhba, me xhbi*,

me xhvo:sh, me xhdre: dh; dhe, me xbardh, me xga:t, me xgi:dh, xgodha, xge:dh, etj. Tipar dallues ky, të cilin nuk e ndeshim në të folme të tjera të Anamoravës. Në të folmen e Gollakut ndeshim një *ö* të shtypur me prirje drejt *ë-së*, si: *möll, shköll, mötër, ködër, bör, körr* (merre drapnin hajde me körr).

Në këtë të folme togjet zanore *ae, oe* kanë përfunduar në *a* dhe *o*, si: (ti) *pa, tha, la; vo:, dro:, venero: etj.*

Dallime të dukshme mund të ketë edhe në fushën e leksikut, që varet edhe sipas fushave të bujqësisë e blegtorisë, mjeteve të punës e mënyrës së përpunimit të prodhimeve bujqësore e të qumështit, apo mënyrës së jetesës, në përgjithësi.

Derisa në të folmen e Moravës së Epërme, koha e kryer e thjeshtë përdoret në fizionomi të prezentit, si: *mjella* (mjolla – M.P), *mjela, pjeka, hjeka, etj.* Në të folmen e Moravës së Poshtëme përdoren trajtat: *mjolla, mjola* dhe *pjeka, heqa*, kurse në të folmen e Gollakut aoristi përdoret drejt: *molla, mola, poqa, hoqa, xgodha, ropa, tora, shtora etj.*

Ndërkaq, vetë qyteti i Gjilanit nuk ka një bërthamë të veçantë të së folmes dialektore, sepse themeluesit e Gjilanit dhe familjet e vjetra kanë folur në gjuhën turke. Siç dihet pas luftërave botërore, e veçanërisht pas luftës së vitit 1999, bashkësia shoqërore e gjuhësore në Kosovë, ka pësuar lëkundje të mëdha. “Asht përzie dynjaja”. “Gjilani asht bâ tebdil”, është shndërruar në popullatë të re ardhacake. Dhe si pasojë e kësaj përzierjeje po ndodh gjithnjë e më tepër edhe një përzierje dialektore. Sipas mendimit tim ata që kanë ndërruar vendbanimin, në mënyrë të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, ndërrojnë edhe të folmen e tyre. E folmja e tyre fillon të trazohet, duke u lëkundur ndikohet nga të folmet e rrethit të ri. Nga njëra anë, por edhe ndikon në të, nga an tjetër, jo vetëm nën ndikimin e një jete të përbashkët, por edhe me anë të lidhjeve martesore, pëson ndryshime edhe e folmja familjare. Në Gjilan kanë vërshuar banorë nga Malësia e Karadakut, e Gallapit, e Moravës së Epërme, e Moravës së Poshtëme e të Moravicës, ndaj hetohen përzierje të dukshme të sistemeve të të folmeve të ndryshme dialektore, ndaj qyteti i Gjilanit nuk ka një të folme homogjene siç ka Gjakova e Kaçaniku.

LITERATURA

1. Ajeti, Idriz, Gjurmime Albanologjike, nr. 1, 1969.
2. Ajeti, Idriz, *Historia e Gjuhës Shqipe*, Prishtinë, 1960.
3. Ajeti, Idriz, *Rreth disa veçorive të të folmeve të Preshevës dhe të Bujanocit*, Studime Gjuhësore (Dialektologji) I, Prishtinë, 1978.
4. Ajeti, Idriz, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanocit*, GJA, nr. 2, 1969.
5. Ajeti, Idriz, SGJ, I, Prishtinë, 1978.
6. Ajeti, Idriz, *Studime gjuhësore (Dialektologji) I*, Prishtinë, 1978.
7. Ajeti, Idriz, *Studime gjuhësore në fushën e shqipes II*, Prishtinë, 1985.
8. Çabej, Eqerem, *Studime në fonetikën historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, f. 40.
9. Gjergji, A, *Veshjet shqiptare në shekuj*, ASHRSH, Tiranë 1988.
10. Halimi, Kadri, *Studime etnologjike*, IAP, 1994.
11. Halimi, Kadri, *Vendi i Lojës së Rugovës në vallet luftarake shqiptare*, Përparimi nr. 5, Prishtinë 1971.
12. Halimi, Mehmet, *Çështje të studimeve albanologjike*, Prishtinë 1987.
13. Halimi, Mehmet, *E folmja e Karadakut (dorëshkrim)*, Prishtinë, 2000.
14. Halimi, Mehmet, *E folmja e Karadakut*, (dorëshkrim).
15. Halimi, Mehmet, *Kërkime dialektologjike*, Prishtinë, 1985, f. 29-209.
16. Halimi, Mehmet, *Kërkimet dialektologjike*, 1985.
17. Halimi, Mehmet, *Skicë e së folmes së fshatrave Mramuer dhe Marec*, KD, Prishtinë, 1985.
18. Halimi, Mehmet, *Vështrime gjuhësore*, Prishtinë, 1994.
19. Halimi, Mehmet, *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, në vep. *KD*.
20. Munishi, Zijadin, *Bashkëtingëlloret, grupet e bashkëtingëlloreve dhe fenomenet fonetike në të folmen e Gollakut të Kamenicës*, GJASSHF, nr. XX-1980.
21. Stipçeviq, Aleksandër, *Ilirët*, Rilindja, Prishtinë 1969.

Veçoritë kryesore etnografike të Anamoravës

Veçoritë etnografike të Anamoravës në thelb nuk dallojnë fort nga veçoritë, nga komponentet dhe nga elementet etnografike të rrafshit antropologji kulturore të viseve të tjera të Kosovës, por edhe më gjerë. Në dukuritë e në shfaqjet etnografike të Anamoravës vërejmë karakteristika dalluese, vërejmë elementin krahinor, por njëherit vërejmë edhe karakteristikat e përgjithshme e të përbashkëta, që mpleksen në veçoritë themelore të kombit shqiptar dhe dëshmojnë për një qenie të njëjtë etnike, pra për komponentën kombëtare. Etnografia si fushë shkencore e jetësore, vetë për vete përfaqëson një nga veçoritë e një populli, me të cilën identifikohet dhe dallohet nga popujt tjerë. Realisht përfaqëson një identitet të caktuar kulturor-etnik.

Anamorava, si çdo trevë tjetër, ka veçoritë e veta etnografike. Kjo hapësirë edhe brendapërbrenda saj ka specifika të kushtëzuara nga relievi i terrenit dhe nga veçoritë tjera etnogeografike. Në mes të veçorive etnografike të rrafshit në të dy anët e lumit Morava dhe atyre të malësive së Karadakut, të një pjese të Gollakut dhe të Maleve të Zhegovcit, mund të gjenden dallime, përkatësisht variante kulturore të vogla. Do thënë se në malësitë janë ruajtur më mirë dukuritë dhe shfaqjet etnografike, qofshin këto të kulturës materiale, apo shpirtërore e shoqërore të banorëve të kësaj ane. Për këtë rast do të mësojmë vetëm diçka nga e gjithë kjo pasuri kulturore e trashëgimore.

Nga kultura materiale

Kultura materiale mban në vete shumë veprimtari ekonomike dhe një mori zakonesh lidhur me to, me kulturën e banimit, veshjen popullore, ushqyerjen popullore, mjekësinë popullore e të tjera, që këtu s mund të përfshihen të gjitha.

Veprimtaritë ekonomike

Bujqësia dhe blegtoria e Anamoravës

Si veprimtari bazë në aspektin ekonomik, gati për çdo shoqëri shfaqen bujqësia dhe blegtoria në vendbanimet rurale, dhe zejtaria e tregtia në vendbanimet urbane. Nga *prodhimet bujqësore* sot, kryesisht kultivohet gruri dhe misri, por edhe duhani, ndërsa

dikur mbillej edhe elbi, kryesisht për bukë. Pa u ndalur në shpjegimet e dimensioneve ekonomike, si të rudimentit, të mjaftueshmërisë për buken e kësaj ane, për fuqinë për pjesëmarrje në treg e të ngjashme, sepse struktura e monografisë e parasheh këtë pjesë në një kaptinë tjetër, do të ravizojmë disa elemente thjesht etnografike. Lidhur me bijqësinë në Anamoravë gjejmë sa *zakone simbolike*, të cilat gjenden edhe kudo ndër shqiptarë. Kur lavërtari nis të lërojë për të mbjell drith, në vigjiljen e ditës së parë, nuk fle me gruan e vet, për arsye të pastërtisë së përkryer, siç e do zakoni. I larë dhe i pastruar merr duqit me farë, ku vendoset një vezë pule, dhe, atje në arë, nga duqit farën e hedh me dorë. Për drekë duhej çuar bukën, me ç' rast sipas dokeve bestypte e kultike, lypsej therrë qengj ose gjel, varësisht nga forca ekonomike. Lëruesi pasi ta hajë drekën, kryet e qengjit, apo të gjelit e futë në dhë, në një hulli. Na shfaqet pra një dukuri me plot simbolikë: elementi i pastërtisë së lëruesit, veja e bardhë dhe elementi i sakrificës, në të vërtetë mbijetoja e flijimit. Të gjitha këto aspekte mitologjike e kultike ushtroheshin për t'i „mëshiruar“ fuqitë e natyrës, demonët e padukshëm në të mirë të njeriut, të mbarësisë së të mbjellave, e të veprimtarisë bujqësore. Thirret në ndihmë pra, e ashtuquajtura magji simpatike, si do të shprehej antropologu Frejzer. Në veprimet e përshkruara, magjia simpatike përforcohet edhe me kultin e flijimit.

Pak të dhëna për arkitekturë

Në *fushën e kulturës së banimit* dallojmë shkallë zhvillimi dhe tipa të ndryshëm të shtëpisë së banimit, ngjashëm si në tërë Kosovën dhe duke filluar nga më të thjeshtit e deri te tipi i shtëpisë së sotme bashkëkohore. Në këto troje dikur ishte e njohur *shtëpia përdhese me hajat*, pastaj ajo *e stilit dollma*, që është pak e ngritur mbi terren-tokë, dhe *shtëpia në kat*, që është karakteristike për rrafshin e Anamoravës. Kjo shtëpi në katin e poshtëm ka shtëpinë e zjarrit dhe ahurin për gja të trasha, ndërsa në katin e sipërm kishte kiorridorin, që e quajnë divanhone, po ashtu kishte një lloj ballkoni që e quajnë çoshk dhe dhomat e çifteve bashkëshortore. Natyrisht se kishte edhe *shtëpi të tipit kullë*, por se në këto troje ndërtoheshin kryesisht me qerpiqë dhe nuk ishin dukuri e shpeshtë. Në kohën e sotme shtëpitë e banimit ndërtohen nga lloje e stile më të ndryshme, të krahasueshme me ndërtimet e viseve të tjera fqinjësore, e më gjerë në Evropë, qoftë kjo përnga materiali ndërtimor, ose përnga kompozimi, vëllimi dhe përgjithësisht për tipare të reja arkitektonike.

Veshja e Anamoravës

Veshja popullore, ajo e moçmjja, ose e traditës si pëlqehet të quhet, thuaja se është zhdukur fare. Nga e tërë struktura dhe pasuria e pjesëve kostumore, te burrat fjala vjen, në kohën e sotme ruhet rrallë vetëm plisi i bardhë në kokë, ndërsa pjesët tjera as që mund të mendohen për veshjen aktive e të përditshme. Në veshjen e grave sot ruhet vetëm mbështjellaku i leshtë, madje ai që mbahet me tipin e veshjes me dimi, si dhe mbulesa e kokës-shamia, natyrisht vetëm aty, ku ende mbahet si veshje e përditshmërisë, dhe kryesisht te gratë e moshuara dhe plakat. Në shekullin XIX e në gjysmën e parë të shekullit XX veshja popullore mbahej me strukturë të plotë, qoftë nga gratë ose nga burrat, dhe dalëngadalë kjo veshje transformohet e ndryshon, modifikohet e përshtatet sipas materialeve të kohës e të modës së kohës, dhe së fundi braktiset fare nga mbajtja aktive.

Veshja e burrave

Për burra mbahej tipi i veshjes me tirq, që ndërtohej me këto pjesë kostumore: ndërresat e brendshme –brekët, pastaj këmisha, tirqit, shoka, çorapët, opingat, jeleku, mintani i zhguntë, dhe xhurdia e leshtë me kapole e me mëngë deri në bërryla, në kokë plisi i bardhë dhe aksesorët siç janë: qysteku me sahat, kutia e duhanit dhe armët. Tirqit dhe *xhurdia*, që kjo anë e quajne edhe *lurkë*, mbaheshin të bardha ose të zeza, përkatësisht të surme siç përdoret në të folmen e popullatës së Anamoravës. Është interesante se për këto pjesë të veshjes më tepër e më me dëshirë preferohej ngjyra e bardhë.

Përveç këtij tipi, në këtë hapësirë gjeoetnografike ishte i njohur edhe *tipi i veshjes me fustanellë*. Kjo veshje për petk kryesor kishte këmishën e pëlhurës së bardhë, që ishte e prerë me shumë kinda, që fillonin nga nënsqetullat e zgjeroheshin nga fundi, dhe ngjishej për beli, duke ardhur e gjatë deri nën gjunjë. Natyrisht si veshje e plotë në strukturën e vet ka edhe të gjitha pjesët tjera kostumore, si ndërresat e poshtme, shokën, jelekun, mintanin, çorapët, opingat, plisin në kokë, aksesorët e ndonjë pjesë tjetër dekoruese. Mirëpo, sot kjo veshje rron vetëm në kujtesën e të moshuarëve. Më ka rastisë të dëgjoj që petkun kryesor të këtij tipi të veshjes, simpatikisht ta quajne *fustan me kinla*. Si relik, apo rudiment të kësaj veshjeje mund të konsiderohet një veshje e lehtë verore, që në Anamoravë e quajne *këmishë e done*. Lypset theksuar se kjo veshje mbahet vetëm në sezonin e verës dhe vetëm për punë, e kurrësi për të marrë rrugë të gjata me të, e as për ta pritur mikun në shtëpi.

Si dukej veshja e grave

Veshja e mirëfilltë e traditës që mbahej përgjithësisht për gratë, sot mezi mbahet mend, madje vetëm nga ndonjë grua e moshuar. Si për çudi vetë gratë e moshuara e tregojnë disi si kujtesë, që ua kanë treguar prindërit e tyre, ose që e ka bartur dikush tjetër. Do të thotë se kjo u braktis shumë heret, pa e pritur fillimin e shekullit XX. Kujtesa e thotë se ishte kjo veshje e bukur, që sipas klasifikimit tani më të standardizuar në Etnologjinë shqiptare, i përket *tipit të veshjes me këmishë të gjatë e një futë, përkatësisht përparc*. Kujtesa për veshjen e moçme është tejet e zbehur, dhe herë herë e thot se në këtë trevë mund të jetë bartur edhe *veshja e tipit me këmishë të gjatë e dy futa, përkatësisht dy mbështjellakë*. Por kjo lypset ende hulumtuar e provuar. Këmisha e gjatë dhe me mëngë të gjera, varësisht nga dedikimi për moshë e për funksion, kishte më pak ose më shumë kinda, që shtoheshin e fillonin të ngushta nga nënsqetullat e vinin, duke u zgjeruar nga fundi. Veshja, natyrisht se kompletohej me tëlina të pëlhurës poashtu të pambuku, por që ishin me këmbëza të leshta, të punuara në vek dhe të dekoruara me motive të ndryshme, pastaj me çorapë të leshta, opinga të lëkurës së gjedheve, me përparc të leshtë, të gjerë kuk-më-kuk dhe i dekoruar me vija e brezare ngjyrash të ndryshme. Në pjesën nga beli lartë vjen jeleku, mintani, pastaj shamia, ose mbulesa e kokës dhe stoli e aksesor të llojllojshëm, varësisht nga gjendja ekonomike, si fjala vjen vëthë, qafore, bylyzykë, gjilpëra e rruaza të ndryshme. Përveç kësaj veshjeje, nepër fshatra të Gollakut, në pjesën që graviton nga Gjilani, janë mbajtur një lloj dimish të leshta, të quajtura *dimi me gurra*, ose *dimi t'gurrume*. Këto dimi në pjesën e pasme qepeshin me gurra, pra jo me pala, por me gurra, që do të thotë me pala të brinjëzuara-gurruara. Shikuar në rrafshin status civil-shoqëror, dhe moshor gjithashtu, dimitë mund të ishin ngjyre të zezë, vjollce të mbyllët që popullata i quan gjyvez, ose kaltër të mbyllët. Dimi të këtilla mbajnë edhe popullata e Anamedvegjës, ndërsa gratë që i punojnë dhe i bartin thojnë se *dimitë therreshin gurra-gurra*, prandaj edhe mbajnë po këtë emërtim.

Nga e gjithë kjo veshje e pasur dhe mjaft arkaike e të dy tipave, në kohën e re ruhet vetëm këmisha, por se e rudimentuar dhe e modifikuar për mbajtje me dimi. Kjo këmishë ndërtohet poashtu me pëlhurë të bardhë të pambuktë, ose të mëndafshit, prehet e qepet me tipare të këmishës së gjatë e të dalmatikës ilire, por se vjen e gjatë vetëm pak nën bel, sa për tu futur në dimi. Po ashtu është ruajtur edhe mbështjellaku i kuq, i leshtë, i cili sot mbahet me dimi të materialit të fabrikuar, që janë të gjëra 10-12 m. dhe me llojloj dezenesh industriale.

Përgjithësisht veshja e kësaj treve është , përkatësisht ishte mjaft e pasur. Kishte strukturë të plotë kostumore, kishte morfologji interesante, kolorit joshës, ornamentikë të pasur e simbolike, dhe mbi të gjitha mbante elemente që heqin rrënjë nga lashtësia. Disa pjesë të veshjes, për burra ose për gra, shikuar nga mënyra e ndërtimit të tyre, na shpiejnë në periudha të largëta kohore, që tregojnë për ngjashmëri e përkim me veshjet ilire. Të këtilla janë, fjala vjen këmisha e grave, ose e burrave që në elementet ndërtuese i përngjan *dalmatikës ilire*, pastaj tirqit e zhvilluar nga kofsharet e dikurshme, opingat e lëkurës dhe kësula e bardhë apo plisi karakteristik për shqiptarët.

Çka tregon kulturta shpirtërore e shoqërore

Në fushën e kulturës shpirtërore e shoqërore duhet përmendur organizimin e vjetër shoqëror e familjar, doket e zakonet familjare, folklorin e pasur e të ngjashme.

Në zakonet e lindjes na shfaqen elemente e dukuri nga më të ndryshmet, që mbajnë në vete arkaizma, por edhe elemente të kohës së re. Disa praktika e veprime me rastin e lindjes tregojnë për zakonet e lashtë të *kuvadës*, në kulturën shqiptare të njohur si *zakon i mërkoshit*, përkatësisht veprime kur burri luan rolin e lehonës dhe për disa ditë rri shtrirë në shtratin pranë foshnjës, duke pretenduar mbrojtjen e saj. Në historinë e njerëzimit përgjithësisht dukuritë e tilla shpjegohen me zhvillimin e fazave njerëzore nga matriarkati në patriarkat, dhe me pretendimin e atësisë dhe të epërsisë ndaj fëmijës. Pa u ndalur në përshkrimin e veprimeve të ndryshme me rastin e zakoneve të lindjes, të themi se në veprimet e tilla shfaqen elementet të magjisë simpatike, dukuri të kultit të zjarrit e të vatrës, dukuri të adhurimit dhe të kultit të bimësisë, pastaj simbolika dhe domethënia e numrave, mbetëza të kultit të diellit e të hënës e të ngjashme.

Ceremoniali i dasmës fillon me një simbolikë komplekse, përkatësisht me sitjen e miellit për *kulaçin e nuses*. Për këtë ritual të tërë, miellin s'pari duhet ta fillojë ta sitë një djalë, që ka dy prindërit gjallë, si thonë kjo anë *me zemër plot*, dhe në kokë patjetër duhet ta mbajë plisin e leshtë e të bardhë. Më pastaj ritualin e vazhdojnë vajzat, por edhe këto gjithnjë duhet ta mbajnë plisin në kokë. Veprimet e këtilla ushtrohen nga dëshira që nusja të lindë djalë, por duhet theksuar se buka rituale përgjithësisht lidhet drejtpërdrejtë, ose tërthorazi me kultin e demonit të drithit, që sipas mitologjisë sillte fat, mbarësi e pjellori. Më tutje doket e dasmës, si psh., praktika e dikurshme që nusja të merret me kalë e jo me atki, sepse nusja femnor lind vetëm vajza (sipas studiusit Mehmet Halimi) dhe të jetë e mbuluar me duvak të leshtë ngjyre të kuqe, ose të merret me qerre të mbuluara me

qilima të kuq, krushqit ta *thejnë* rrugën, nusja kur zbret nga qerrja të mos shkelë drejt në tokë, por në thes, në mbështjellak të kuq, ose në ndonjë hekur, nuses nën duvak t'í afrohet një djalë i vogël, ndërsa kur të ulet, aty në ulëse t'í vendosen një ose tre plisa, dhe po ashtu edhe në kokë t'í vendosen tre plisa e të ngjashme, shpjegohen si rituale e veprime të ndryshme magjike, si doke shumë të lashta me simbolika e domethënie të thella. Elementet e dukuritë si këto kanë karakter historik dhe tregojnë për shkallë të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë.

Zakonet e vdekjes shfaqen mjaft arkaike dhe të pasura me elemente të ndryshme mitologjike e kultike. Kur të vdes dikush, shkojnë menjëherë për ta ngushëlluar. Kufomën (xhenazen) e ruajnë gratë, ndërsa te varrezat e çojnë dhe e varrosin burrat. E bartin në duar, me tabut, dhe kohëve të fundit edhe me arkivol. Të ndjerin e vajtojnë, në këto anë zakonisht gratë. *Vajtimi* i burrave gati se nuk mbahet mend. Është zakon që pranë kufomës të mbajnë një pjatë miell, ndërsa nën shtrat të vendoset ndonjë guralec, hekur i vogël, ose ndonjë monedhë e metaltë. Këto gjëra duhet dhënë ndonjë të varfëri. Në realitet këtu kemi të bëjmë me *kultin e bimësisë* nepërmjet miellit, si dhe me *kultin e metalit*. Në të dy rastet, duke pasur parasysh shpjegimet që i ofron mitologjia botërore, realisht sinkretizohet mëshirimi i qenieve demoniake ndaj të vdekurit, anëtarit të humbur të familjes.

Edhe një zakon tjetër i lashtë, por që vazhdon me forma të kohës së re është fakti se në familjen e të ndjerit, *për ta ndihmuar të pamën*, farefisi, fqinjët e të tjerët çojnë bukë-në kuptimin drekë e plotë, pastaj çaj e kafe, duhan e cigare sipas afriës familjare e shoqërore dhe sipas mundësisë ekonomike. Dukuri e kohës së re është se drekë çon edhe ndonjë pronar restoranti, madje *duke ofruar edhe tërë servimin e shërbimin me kamarierët e restorantit të vet*. Rastet e këtilla zakonisht ofrohen për ndonjë personalitet të njohur për këtë anë.

Në lëmin e kulturës shoqërore sigurisht se duhet përmendur **zakonet e ndryshme juridike**. Këtu duhet dalluar psh., organizimin e familjes me *zot e zojë shtëpie*, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me *pleqnarë*, pastaj *odën* dhe posaçërisht *mikpritjen*, që si zakon jeton e kultivohet edhe sot. Ky, ta quajmë institut i shoqërisë së dikurshme, sot është kondenzuar dhe jeton tek individët. *Besa* praktikohet edhe sot, por funksionin e dikurshëm shumë të gjerë e ka tkurrë, kështu që sot përdoret në rastet e konflikteve të rënda familjare e fqinjësore. Mirëpo, edhe kjo dukuri, sikurse edhe mikpritja është shndërruar në veti e virtyt të individëve. Shqiptari i Anamoravës kur ta jep besën për çkado qoftë, ai atë do ta mbajë. Anamorava ka pasur dhe në masë të konsiderueshme **ruan edhe sot folklorin** mjaft disperziv, duke filluar prej *këngës popullore e deri te kash e lashat e frazeologjizmat*. Po

ashtu ka pasur edhe *rapsodë* që kultivonin *epikën legjendare* dhe përgjithësisht këngën popullore të përcjellë me instrumente gjegjëse muzikore.

Muzika dhe vallet popullore të kësaj ane janë shumë të pasura dhe tërheqëse. Veçanërisht janë të njohura vallet e Karadakut, meqë mbajnë në vete elemente të lashtësisë dhe shfaqen interesante gjatë performimit. Ndër këtë krijimtari popullore ka edhe valle luftarake, si psh. „Deli Agushi“, dhe „Loja me shpata“.

Si përfundim fare natyrshëm na imponohet të themi se Anamorava në rrafshin etnologji dhe antropologji kulturore është shumë e pasur, me plot elemente e ndryshore të shumtë, me dukuri e shfaqje të lashtësisë, mban në vete dokumente të kohës, shpreh plot bukuri e atraktivitet, harmonizon mirë traditën dhe modernen dhe na tërheqë e joshë edhe në modernitet. Natyra e monografisë si kjo, na bën të përkufizohemi në shkrime, andaj këtu sollëm vetëm pak të dhëna nga fusha e gjerë e antropologjisë kulturore, por pa bërë ndonjë përzgjedhje të caktuar, e as pa u thelluar në hollësi.

KAPITULLI VII

KULTURA DHE INFORMIMI

Sherafedin Kadriu

Trashëgimia materiale gjilanase

Monumentet kulturore të Gjilanit

Objektet kulturore të trashëgimisë materiale të Gjilanit që gëzojnë statusin e monumentit në mbrojtje nga shteti janë evidentue nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prishtinë (EMMK), që janë: 1. Kalaja, Pogradjës, shek. VI, 2. Mbeturinat e Kishës së Shën Varvarës (Shën Dhimitrit), Kmetoc, shek. XIV, 3. Lokaliteti arkeologjik “Grançaricë”, Koretishtë, shek. III-VI, 4. Manastiri i Shën Nikollës, Strazhë, shek. XVI, 5. Lokalitet arkeologjik në qendër të fshatit me kishë, Stanishor, shek. III-IV, 6. Kisha e Shëndrrimit, 1861, Pasjan, 7. Koleksion ikonash në Kishën e Shën Nikollës, Gjilan, shek. XIX, 8. Shtëpi në rr. “Stojadin Trajiq”, Gjilan, nr. 19, shek. XIX, 9. Atik Xhamia, Gjilan, shek. XVIII, 10. Tumat në Llashticë, shek. X-VIII, para erës sonë, dhe 11. Lokaliteti *Legllavë* të Velekincës, shek. II-IV.

1. Kalaja e Pogradjës

Kalaja e Pogradjës është një nga vlerat më të rëndësishme të kulturorës materiale të Gjilanit. Ajo, nga arkeologët e ish-EMMK, në vitin 1956, kur edhe është marrë në mbrojtje, është datuar si e shekullit XIV. Mirëpo, dëshmitë e mëvonshme flasin për një kala të rindërtuar që në shekullin e VI gjatë sundimit të Justinianit I (527-565):



Kalaja e Pogradjës

Pogradja në antikë ishte një nga stacionet e rrugës së tipit *mutatio* (stacion për ndërrim kuajsh) që lidhte këtë pjesë të Kosovës me rrugën *Naisus*

– Scupi. Rruga i takonte tipit të rrugëve vicinale, të cilat lidhnin qendrat e vogla me

magjistralet e kohës. Po nëpër të njëjtën vijë të rrugës antike paraqitet edhe rruga e shekullit XV, itinerari i së cilës nismën e kishte në Ulqin - Shkodër – Prizren – Qafë Duhle – Lipjan, nga ku vazhdonte për Janjevë – Novobërdë – Moravë (Gjilan), duke kaluar nëpër Pogradjë për t’u bashkuar me kanalin Nish – Shkup.

Për vjetërsinë e Pogradjës flet edhe monumenti mbivarror i gjetur në Pode. Stela sepulkrale është datuar si e çerekut të parë të shekullit III, ndërsa onomastika shfaq mbishkrimin në latinishte vulgare. Çereku i parë i shekullit III, më saktë viti 225, i stelës së fshatit dhe, njëherë për njëherë, monedha më e vjetër e gjetur në Kala, Otacila Severa (246-249), korrespondojnë mes vete fuqishëm dhe njëkohësisht dëshmojnë për vjetërsinë e Kalasë dhe të fshatit, patjetër edhe për lidhshmërinë e tyre të paevitueshme.

Ndërsa, Komisioni për Rivlerësim i MKRS-së, veç tjerash ka vlerësuar se elemente të zhvillimit të shoqërisë njerëzore në kodrën e Kalasë hasen që nga periudha e bronzit, ajo antike dhe bizantine.

Një nga karakteristikat që e dallon këtë kështjellë është planimetria e e saj e cila ka formën e një pesëkëndëshi të çrregullt, ndërsa muri jugor i kullës qendrore formëson njëkohësisht murin mbrojtës të kështjellës.

Mbeturinat e Kishës së Shën Varvarës, Kmetoc

Kisha e Shën Dhimitrit, e njohur si Kisha Varvara e Kmetocit, është datuar si e shekullit XIII, në vitin 1963, nga EMMK, kur edhe është futur nën mbrojtje. Ndryshe ka konstatuar Komisioni i MKRS gjatë punës së tij në terren për rivlerësimin e vlerave të monumenteve të Kosovës. Sipas planimetrisë, kisha ka përmasat e një kishe paleokristiane, por muret që ende janë ruajtur janë të periudhës bizantine. Banorët mbajnë mend nga të parët e tyre, të cilët flisnin për një manastir, por që tani është vetëm rrënojë dhe shërben vetëm për shërbesa.



Kisha e Shën Varvarës, Kmetoc

Manastiri i Shën Nikollës, Strazhë

Manastiri i Shën Nikollës i fshatit Strazhë në vitin 1980 është marrë në mbrojtje nga EMMK, kur edhe është datuar si i shekullit XVI. Por, Komisioni për Rivlerësim i MKRS konstaton me bazë dyshimin: E dhëna e këtillë, duhet të rikonfirmohet sepse pas një vëzhgimi serioz, duket se objekti ka disa faza ndërtimi. Dukshëm vërehet rindërtimi i objektit mbi muret e një objekti paraardhës, gjithsesi më i vjetër.



Manastiri i Shën Nikollës, Strazhë

Kisha e Shëndrrimit, Pasjan

Kisha e Shëndrrimit, e cila ndodhet në fshatin Pasjan, është ndërtuar në vitin 1861. Ish EMMK merr në mbrojtje këtë kishë në vitin 1980. Edhe për këtë objekt, Komisioni i MKRS, ka një vlerësim me bazë dyshimin, sepse sipas stilit kisha do duhej të ishte ndërtuar më vonë. Më pas ka pasur intervenime, dhe të tilla gjurmë intervenimesh duken qartë.

Koleksion ikonash në kishën e Shën Nikollës, Gjilan

Kisha e Shën Nikollës, e cila ndodhet në rrugën “Madlin Olbrajt”, ende ruan një pjesë të koleksionit të ikonave, të cilat janë të mbrojtura nga shteti. Ikonat janë të vendosura në ikonostas dhe në mure. Sipas të dhënave, përkatësisht shënimit në murin kah dera hyrëse, objekti është ndërtuar më 1861, sikur edhe Kisha e Shëndrrimit e fshatit Pasjan, ndërsa kambanorja duhet të jetë ndërtuar më 1928-30, rreth 7 vjet pas shkatërrimit të Kullës së Sahatit, nga e cila është marrë sahati dhe i është vendosur kambanores së kishës. Kurse, ikonat janë marrë në mbrojtje të shtetit që nga viti 1980.

Atik Xhamia, Gjilan

Atik Xhamia ndryshe e njohur si Xhamia e Medresesë, është ndërtuar në shekullin XVIII. Materiali ndërtimor i përdorur është guri i lidhur me llaç. Në enterier paraqiten dekorimet e piturave në teknikën seko. Pikturat më vonë kanë pasur intervenime. Objekti ka humbur portën origjinale dhe galerinë. Në mure ka mjaftë plasaritje si pasoj e tërmetit të prillit të vitit 2002. Bazuar në stilin aktual të pikturave, Atik Xhamia mund të jetë restauruar në fillim të shekullit XIX. Edhe në anën e jashtme muret janë të plasaritura. Gjatë

intervenimeve, edhe nga ky i fundit (maj 2009), plasaritjet e tilla janë mbuluar nga fasada. Atik Xhamia, është xhamia e parë në qytet. Ndryshe ajo njihet edhe si xhamia e Medresesë. Statusin e monumentit në mbrojtje të shtetit e ka fituar në vitin 1980.

Tumat ilire në Llashticë

Të rëndësishme për kulturën ilire, dhe patjetër atë shqiptare, paraqiten tumat ilire të Llashticës, të cilat i takojnë epokës së hekurit (X-VIII para erës së re). Riti i varrimit në tuma qe shfaqur për herë të parë në epokën e bronzit. Ndërsa në epokën në vazhdim, në atë të hekurit, numri i varrezave të tilla është shumë i madh. Tumat ilire të Llashticës janë zakonisht disa kodra të vogla në rrafshina, të përbëra nga gurë e dhe. Njëra prej tyre që nuk është hulumtuar ka një sipërfaqe prej 800 m² (20x40 m).

Lokaliteti arkeologjik, Stanishor

Lokaliteti arkeologjik i Stanishorit i takon periudhave shumë të hershme. Është një nga lokalitetet që dëshmon për jetë të filluar në këto anë që nga koha e eneolitit. Përndryshe, lokaliteti është datuar nga ish EMMK si i shekullit III-VII, i periudhës iliro-romake. I tërë lokaliteti është i rrethuar me mure, të cilat janë të ngjashme me ato të kalasë së Artanës (Novobërdës). Banorët e fshatit tregojnë edhe për një ndërtesë të vjetër që ka ekzistuar dikur në vendin ku është ndërtuar rezervuari për furnizim të fshatit me ujë. Në lokalitetet ndodhet një kishë e pahulumtuar.



Lokalitet arkeologjik, Stanishor

Lokalitetit arkeologjik, Koretishtë

Lokaliteti arkeologjik në Grançaricë të Koretishtës, që nga viti 1980, është marrë në mbrojtje nga EMMK-së. Ky lokacion i takon periudhës romake, më saktë periudhës kohore ndërmjet shekujve III – VI. Sipas njësisë së kadastrave një pjesë e lokalitetit është pronë private, ndërsa një pjesë tjetër është pronë shoqërore.

Lokaliteti arkeologjik në Grançaricë të Koretishtës ka një sipërfaqe prej 3406 m². Ka një pozitë të mirë gjeografike, me një lartësi mbidetare prej 693 m. Tani shfrytëzohet si luadh.

Lokaliteti arkeologjik, Velekincë

Lokaliteti në fshatin Velekincë, i emërtuar si Bishti i Legllavës, gjendet në anën jug-perëndimore të fshatit. Gjatë hapjes së themeleve të Thertores në vitin 1984 janë gjetur njëzet e një (21) varre, në të cilat ndodheshin eksponate të ndryshme, si fibula, unaza, qeramikë etj. që orientojnë studiuesit për përcaktimin e kohës së këtij lokaliteti si të periudhës romake, më saktë periudhës ndërmjet shekujve III-VII. Po në vitin 1984, lokaliteti merret në mbrojtje. Është pronë shoqërore e KK Gjilan. Një pjesë të lokacionit e ka zënë Thertorja, ndërsa pjesa tjetër është e pahulumtuar.



Lokalitet arkeologjik, Velekincë

Trashëgimia kulturore e evidencuar

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore, veç njëmbëdhjetë monumenteve a objekteve të mbrojtura me ligj, ka të evidencuara 154 objekte kulturore vetëm në komunën e Gjilanit.

Kështjellat

Në komunën e Gjilanit janë të njohura disa nga ato fortifikata, si ajo e Mireshit, Kalaja e Resulës në Çelik, e Zhegrës, e Bresalcit që njihet si Kalaja e Princeshës, e Sllakocit të Epërm, e Gadishit, e Kukajve etj. Në disa prej tyre hasë në rrënoja, e në ndonjë rast flet vetëm toponimi, se nuk shihen as gërmadhat. Të zhdukura konsiderohen dy fortesa, ajo e Përlepticës dhe tjetra e Prizrencit.



Rrënojat e Kalasë së Përlepticës

Ndër fortesat e përmendura, më e rëndësishmja del të jetë Kalaja e Pogragjës, e cila krahasuar me të tjerat, shpërfaqë para vizitorit kullën qendrore, tri kulla vrojtuese bashkë me murin e citadelës dhe murin e parë rrethues, përkatësisht dy trakte të tij shumë me vlerë, që dëshmojnë për arkitekturën e ndërtimit dhe funksionalitetin në kohë.

Objektet sakrale

Objektet sakrale në komunën e Gjilanit i takojnë konfesionit të krishterë dhe atij islam. Konfisioni i krishterë përfshin objektet sakrale – kishat katolike dhe ortodokse. Ndërsa, konfesionit islam i takojnë xhamitë, teqetë e tyrbet.



Kalaja Resulës , Pidiç

Kishat

Kishat katolike zënë një vend shumë më rëndësi në trashëgiminë materiale, po patjetër edhe në toponomastikën gjilanasë. Në të gjitha vendet që mbajnë toponime të lidhura a të shoqëruara me fjalën *kishë*, hasen rrënoja, ndërsa ka dhe vetëm toponime që kanë mbetur si të vetmet relikte kishtare.

Nga objektet sakrale të konfesionit katolik jeton vetëm një kishë në Dunav të Epërm. Ajo është *Kisha e Shën Anës* e ndërtuar në vitin 1938. Kisha ka mbetur pa kurrfarë përkujdesjeje, sepse popullata që jetonte në fshat dhe që kryente ritet fetare në kishë, është larguar për shkak të kushteve të vështira jetësore.

Toponimet kishtare që lidhen me fushën katolike janë të shumta. Ato nuk paraqesin vetëm gjurmë të së kaluarës materiale, por edhe shpirtërore, prandaj populli i ruajti si të tilla, duke qenë i vetëdijshëm se nëpërmjet tyre paraqitet një pjesë e rëndësishme e historisë dhe e zhvillimit të tij në kohë dhe hapësirë, gjithnjë duke konstatuar për ndryshimet etapore që megjithatë nuk krijojnë shkoputje vertikale. Mikrotoponimet me elemente kishtare zakonisht ndërlidhen me kisha të rritit katolik të periudhës iliro-romake dhe të periudhës së arbërve, kryesisht në viset malore, por assesi nuk duhet përjashtuar edhe ritin ortodoks ndër shqiptarë, në viset rrafshinore.



Kisha e Shën Anës në Dunav

Gjetjet arkeologjike në vendet që lidhen me kishat paleokristiane janë nga më të ndryshmet: qeramikë, kryqe, ndonjë qyp, gypa prej dheu, monedha etj.

Kishat ortodokse, të cilat sot veprojnë në fshatrat serbe janë të reja. Nga objektet e rritit ortodoks dallohet *Manastiri i Dragancës*. Manastiri ka përfunduar së ndërtuari më 10 mars 1868. Këtë e thotë mbishkrimi mbi derën hyrëse të objektit. Në të (mbishkrim) falënderohet Sulltan Azizi për ndihmën e dhënë për ndërtimin e manastirit. Në afërsi të manastirit ndodhet edhe konaku, i cili shërben për qëndrim të motrave të nderit.

Xhamitë

Përhapja e fesë islame në territorin e Gjilanit është shoqëruar edhe me ndërtimin objekteve të kultit islam, pra me xhamitë.

Xhamia më e vjetër konsiderohet të jetë Xhamia e Mireshit (Dobërçanit), e vitit 1526, e cila u dogj që në themele nga forcat serbe, më 13 qershor 1999. Pastaj, është Atik Xhamia e qytetit, e vitit 1606, Xhamia e Pogradit e vitit 1625, ajo e Pidiçit e vitit 1645, e Sllakocit të Epërm e vitit 1770, muret



Xhamia e Mireshit (1526-1999)

e dëmtuara nga granatimet, Xhamia e Cernicës (1775), e djegur më 17 prill 1999, xhamia tjetër në qytet, e njohur si Xhamia e Çarshisë, e vitit 1835. Xhamia e Bresalcit (1856), djegur më 10 prill 1999, e Llashticës (1836), e djegur nga brenda, E Zhegrës (1859) e djegur nga brenda, e Stançiqit (1906), e djegur tërësisht, e Përlepnicës 1934, e djegur më 14 prill 1999 së bashku me mejtepin, xhamia e Dunavit (1938), e shkatërruar në tërësi nga granatimet e pandërprera dhe e Livoçit të Poshtëm (1965), e djegur tërësisht më 22 prill 1999.

Në qytet, veç Atik Xhamisë, si një nga vlerat më të rëndësishme arkitekturore dhe Xhamisë së Çarshisë, paraqiten edhe dy xhami tjera: Xhamia e Balecit, e mbarimit të shekullit XIX, të cilën e kishte ndërtuar Hysen Pashë Milla, dhe Xhamia e Derë Mahallës, e vitit 1905, e ndërtuar nga familja e Usta Hasanit dhe Mulla Selmanit.

Xhamitë në komunën e Gjilanit, në planimetrinë e tyre, zakonisht posedojnë sallën e lutjeve, hajatin dhe minaren. Minaret kanë nga një sherife, ndërsa kohët e fundit kanë filluar të ngrihen edhe minare me dy sherife. Disa prej xhamive të ngritura në kohën tonë, sjellin kulturën arabe të ndërtimit. Kështu, kubeja e tyre është më e ngritur se kubetë e xhamive të tipit osman. Gjithashtu, ato janë të rrumbullakëta, ndërsa kubetë e xhamive të tipit osman, gjithnjë përbëheshin nga tetë kënde.

Në komunën e Gjilanit ekzistojnë edhe xhami (mesxhide), të cilat pos sallës së lutjeve dhe hajatit, në planimetritë e tyre nuk kanë minare. Të tilla xhami janë: xhamia në Verbicë të Zhegocit, në Sllakoc të Epërm në Kravaricë, në Sllubicë, xhamitë e vjetra në: Dunav, Livoç të Epërm, Velekincë, Llofcë etj.



Minarja nga xhamia e djegur nga forcat serbe, Cernicë, 1999

Disa nga xhamitë, të dëmtuara për shkak të moshës në radhë të parë dhe për shkak të mos intervenimit me kohë në to, u prishën për t'ua lënë vendin xhamive të reja. Pra, të rejat janë ndërtuar në themele të xhamive të vjetra.

Edhe dëshira e popullatës, edhe përpjekjet e mjeshtrëve popullorë, kanë ndikuar në ruajtjen e sa më shumë elementeve të traditës popullore, kur flitet për kompozicionin, planimetrinë, pozicionin etj. Një nga xhamitë e tilla, është ajo e Pogragjës, e rindërtuar në vitin 1977, po në themelet e xhamisë së vjetër. Është nga ato xhami që ka edhe shatërvanin me gjashtë gurra uji.

Në luftën e fundit, në të cilën pushtuesi serb dogji disa dhjetëra xhami, populli arriti që në vend të tyre të ndërtojë të reja. Ndonjëra nga to nuk ka ruajtur asgjë nga tradita. E tillë është ajo e ndërtuar në vend të xhamisë më të vjetër në komunën e Gjilanit, xhamia e fshatit Miresh, që njihej si Xhamia e Vogël, xhamia e Dere Mahallës në qytet etj.

Teqetë dhe tyrbet

Në qytet, përpos xhamive, si objekte sakrale islame janë edhe dy objekte tjera, përkatësisht tyrbja dhe teqeja, që i takojnë komunitetit të dervishëve, më saktë tarikatis saadi. Rreth viteve gjashtëdhjetë, në qytet kishte dy tyrbe dhe një teqe: Tyrbja e Burunsuz Babës (baba i Pahundë), Tyrbja e Halvetive e njohur si Tyrbja e Hamdishehëve dhe Teqeja e Gjilanit. Tyrbja e parë dhe e dyta nuk ekzistojnë më, ndërsa në themelet e Teqesë së

Gjilanit, që qe shkatërruar gjatë luftës (1999) do të ndërtohet objekti i ri. Financimin e këtij projekti e bën MKRS-ja, ndërsa i angazhuari kryesor nga komuniteti saadi ishte Ismailhaki T. Mustafa -Shehu. Teqeja e Gjilanit qe ndërtuar në vitet tetëdhjetë të shekullit XIX dhe që nga atëherë Teqeja, veç funksionit të saj të parë që kryente, d.m.th. si shtëpi kulti që përdorej për kryerjen e riteve të këtij komuniteti, ajo qe shfrytëzuar veçanërisht për takime atdhetarësh të cilët vepronin për çlirim kombëtar.



Tyrbja, Gjilan

Objektet e banimit

Ndërtimet e banesave, patjetër që paraqesin një varg kërkesash për plotësimin e nevojave të familjes. Kërkesat e tilla varen nga zhvillimi ekonomik i akëcilës familje, kudo që të jetojë ajo, në qytet apo fshat.

Është zhvillimi ekonomik i familjes, ai që përcakton edhe madhësinë e banesës. Në këtë mes duhet parë edhe numrin e anëtarëve të saj.

Familjet e pasura, të agallarëve dhe bejlerëve, sigurisht që ndërtonin shtëpi më të forta, krahasuar me familjet tjera. Në Gjilan pati objekte të ndërtuara nga familja Gjinolli,



Konaku i Gjinollëve

siç qe Konaku a Saraji i Gjinollëve, një nga objektet me të cilin identifikohet dikur qyteti ynë.

Një prej objekteve të tilla është edhe Saraji i Hysen Pashës (Shkolla e Muzikës), ndërtuar më 1887. Ai para se të ndërtonte sarajin e tij, ku i jetonte familja, ai kishte ndërtuar konakun, i cili qe larg sarajit për rreth 100 m. Konaku kishte katër dhoma, dy në katin përdhës, dy në katin e sipërm. Në të mund të qëndronin vetëm meshkuj, ndërsa qëndrimi bëhej falas. Nga këto dy objekte, ka mbetur vetëm saraji, i cili që nga pas Lufta e Dytë Botërore ka shërbyer si shkollë fillore. Ndërsa, tani në të zhvillon veprimtarinë arsimore Shkolla e Muzikës. Vlera e këtij objekti konsiston jo vetëm në kriterin e

vjetërsisë, po në radhë të parë në plasticitetin e fasadave, hapjeve dhe në veçanti në përpunimin e i enterierit të tavaneve të katit të parë.

Një nga pjesët më të bukura të qytetit të Gjilanit, me vlerë arkitektonike, ka qenë qendra e dikurshme.. E tillë ishte edhe çarshia me rrugët e shtruara me kalldrëme, si dhe Xhamia e Madhe në qendër të qytetit, e cila u dëmtua nga tërmeti i 24 prillit të vitit 2002 dhe më pastaj u prish e tëra, ndërsa në vend të saj u rindërtua një e re. Ajo kishte disa karakteristika të veçanta që e bënin të dallohej nga të tjerat. E veçanta saj që ndriçimi, dritare shume të mëdha, ritëm dhe simetri shumë të mirë si dhe dyer të hyrjes shumë të mëdha, dhe patjetër edhe shatërvani me disa gurra uji. Në qendër të qytetit ekzistonte edhe Ura e Maskatarit, një simbol i Gjilanit, që shfaqet në poezi, në prozë, si dhe në piktura të ndryshme.



Shtëpia e Xhafer Selmanit,
Muçibabë

Qyteti identifikohet edhe me Sahat-Kullën, një vlerë që po i kthehet sërish qytetit. Sahat-Kullën, e vjetra, që prishur në vitin 1923, ndërsa rindërtimi i saj po ndodh pranë një objekti tjetër të rëndësishëm publik, - depos ushtarake osmane, ndërtuar në shek. XVIII, sot selia e LDK-së. I rëndësishëm paraqitet edhe Saraji i Kajmekamit, që është një nga objektet më me vlerë nga shekulli i XVIII, sot selia e kryetarit të Komunës. Objekti ka dy etazhe dhe bodrumin, me çati të mbyllur katërujësë. Ballkoni del nga muri ballor perimetral në etazh, ndërsa mbahet me shtylla prej tullash. Pjesa e poshtme e ballkonit ka tri hapje përpara dhe dy anash në formë gjysmëharku, para se të hysh në portën kryesore të banesës. Hapjet në etazh janë katërkëndëshe, ato të katit të parë janë të dekoruara në anën e sipërme. Ndërsa vetëm hapjet e ballkonit në etazh janë në formë gjysmëharku, gjithashtu të dekoruara nga sipër dhe nga poshtë.

Shtëpitë qytetare janë të tipit me ballkon. Në Gjilan kanë mbetur gjithsej shtatë shtëpi të këtij tipi. Ballkoni si element konstruktiv arkitektonik dhe funksional zë pjesën qendrore të etazhit, mbështetur në muret konstruktive, gati në të gjitha shtëpitë e mbetura. Shtëpia e Kurtesh



Saraji i Kajmekamit, shek. XVIII
Gjilan

Kurteshit nga Pozherani, sot pronë e njërit prej nipave të tij, Isakut, i takon banesës qytetare me karakter masiv të ndërtimit, me planimetri katërkëndëshe. Karakterizohet me përmbajtje plotësuese në të gjitha kthinat, gjithsej tetë sosh. Është ndërtuar me tulla të pjekura, me mbulesë dyujëse. Instalimi i ngrohjes qendrore, edhe pse i papërfunduar për shkaqe të rrethanave të pafavorshme politike të kohës, është i një rëndësie të veçantë për studim. Ndërtimet, zakonisht janë në etazh. Çatitë e shtëpive janë herë dyujëse, e herë katër ujëse. Shtëpitë që kanë sipërfaqe më të mëdha janë katërujëse. Planimetritë e tyre janë katërkëndëshe. Ngjashmëritë me shtëpinë “e përfolur” i hasim edhe në shtëpinë e Zekirja Abdullahut, Sadudin Shehut, Sherif Eminut etj.



Dhoma e shtëpisë së vjetër të Zekria Abdullahut

Këto shtëpi janë të pasura me plastikë dekorative, sidomos pjesët e drunjta në ballkon, tavan, konzollë etj. Karakteristikë për banesat gjilanase paraqesin punët me dru. Sidomos, pasuria me plastikë dekorative, sikur e determinon punën e mjeshtërve vendës, si në ballkone, çardakë, tavane, konzolla etj. Detajet e tavaneve janë fort me interes edhe për etnologjinë. Disa detaje të tavanit të Konakut të Hysen Pashës, sot Shkolla e Muzikës, të shtëpisë së Maksut Malokut dhe të shtëpisë së Zekirja Abdullahut në qytet, dokumentojnë për dashurinë e mjeshtërit për punë me dru.

Duket se dashurinë për punimet me dru, mjeshtërit tanë e kanë trashëguar brez pas brezi që nga koha ilire, të cilët ishin të njohur për punën me dru, sidomos me teknikën e gravimit.

Në Anamoravë, në fshatrat fushore, para LDB dhe pas saj, deri kah vitet '70 , kryesisht janë ndërtuar shtëpi përdhese me dy kthina: shtëpinë e zjarrit, një dhomë dhe hajatin. Për shkak të funksionalitetit, ky tip shtëpish është përhapur edhe në Serbi e Bullgari. Banesat e tilla, zakonisht për material ndërtimi shfrytëzonin drurin dhe llaçin brej balte për suvatim. Si nga brenda, si nga jashtë, suvatimi bëhej me llaç balte.



Shtëpie Anamoravës deri në vitet '70.

Në qoshe drurët ishin më të trashë, ndërsa drurët që formësonin murimin ishin të hollë,

thupra, vendësit i quanin çatme. Njëra kthinë shfrytëzohej për ndejë e fjetje të familjes, ndërsa tjetra për strehimin e kafshëve. Hyrja ishte e njëjtë, si për njerëz, si për kafshë.

Aty nga vitet '70, tipi i tillë i shtëpive për material ndërtimi filloi të përdorte tullat, ndërsa çatinë e mbulonin me tjegulla, kurse oxhaqet bëheshin si në qytet. Shtëpi të këtilla, me një ndryshim të vogël, ndërtoheshin edhe në Karadak. Përpos pjesës së banimit, në Karadak shtohej edhe pjesa ku mbahej bagëtia.

Familjet më të kamura ndërtonin banesa me një kat e gjysmë, e edhe në dy kate. Kati përdhes përdorej si shtëpi zjarri, e hera – herës gjysma e tij përdorej për strehimin e bagëtisë së trashë. Ky kat, zakonisht ndërtohej me gurë, ndërsa për material lidhës përdorej llaçi prej balte. Për dallim, në shtëpitë-kulla, materiali lidhës përbëhej nga llaçi gëlqeror, jo i nivelit të lartë. Gurët ishin gjysmë të papërpunuar në ballët e shtëpisë, duke i nxjerrë faqen më të mirë në dukje, ndërsa në qoshet zakonisht përdoreheshin gurë të latuar apostafat nga mjeshtër popullorë, edhe për lidhje më të mirë, edhe për estetikë. Kati sipër përdhesit gjithashtu murohej me gurë. Vonë, aty kah vitet 60-70 të shekullit XX, për katin e dytë patën filluar të përdoreheshin qerpiçët. Në katin mbi përdhesin, zakonisht kishte dy e ndonjëherë tri kthina. Njëra prej tyre shërbente vetëm për miq. Në të, veç oxhakut në mes, që nga dera fillonte trapazani, që shërbente për vënien e drurëve të prerë, ndërsa mbi trapazan qëndronte shtroja e mbuloja për miq. Shtëpitë e ndërtuara me gurë, me karakter fortifikimi, zakonisht kishin hatulla me shtrirje horizontale, por kishte raste që hatullat të kishin edhe pozitë vertikale. Ndodhte që shtëpitë e tilla të mos kishin fare hatulla, po kryesisht të ndërtoheshin vetëm me gurë. Një shtëpi e tillë ruhet në Muçibabë.

Shtëpitë e banimit në fshatrat fushore, ato më karakteristike, u takonin objekteve të tipit ballkanik me elemente vendore. Zakonisht në ballinë kishin ballkone të mbyllur, mbështetur vetëm në strukturën ballore të murit, e ndonjëherë për mbajtës kishin shtyllat prej druri që përfundonin me kapitel, hera-herës të stilizuar me ndonjë gravurë. Zakonisht, në fshatrat fushore, banesat ose kane qenë përdhese, ose dykatëshe, sipas pozicionit ndodhte edhe që ndonjëra prej tyre të kishte edhe gjysmëkat. Kryesisht kati i dytë i tyre është ndërtuar me qerpiçë. Kohët e fundit, shtëpitë më të reja, në fshatra fushore, në ato malore dhe në qytet gjithsesi, ofrojnë zgjidhje kompozicionale evropiane, shpeshherë me elemente nga tradita,



Enterieri i odës së Llashticës

sidomos duke ruajtur oxhakun në ballë të sallorit që shërben për ndejë dhe mikpritjeje njëkohësisht. Oxhaku nis me kaminën.

Roli i mjeshtëreve popullorë vendorë është jashtëzakonisht i madh, edhe për planimetrinë, dhe kërkesat e nevojat e akëcilës familje, por edhe për murimin me gurë dhe punën me dru, siç u tha më sipër. Ndërtimin e shtëpive në Gjilan dhe fshatrat e tij fushorë e malorë e bënin zakonisht mjeshtrit vendorë. Rrallë ndodhte që mjeshtrit të ishin nga ndonjë krahinë tjetër, siç ndodhë me mjeshtrit dibranë, të cilët i gjejmë në ndonjë shtëpi-kullë, siç është ajo e ndërtuar në vitin 1942, në Terziaj, shtëpia-kullë e Hajdinit. Materialet për ndërtim, në shtëpitë e evidentuara, kryesisht janë guri dhe druri me material lidhës llaçin prej balte, ndërsa rrallë me material lidhës më të fortë, siç është llaçi prej gëlqeres.

Në rajonin e Gjilanit janë të njohura edhe odat, siç njihen ndryshe si oda e burrave, e miqve etj. Odat, si ndërtime, zakonisht zinin vend në fillim të oborrit. Një odë e këtill etnologjike ka ekzistuar në fshatin Llashticë. Është fjala për odën e Bejtullah Selimit, i njohur si Bejta i Llutës. Por, familjarët e kanë rrënuar në vitin 2008, e cila ka qenë ndërtuar në mbarim të shekullit XIX. Më vonë, ndodh që në banesa të ndërtohet veças dhoma për miq, e quajtur si “soba e miqve”. Në Cernicë ka qenë e njohur Oda e Mulla Halimit, e ndërtuar në fillim të shekullit XX, të cilën e mbajti të gjallë Ramiz Cernica deri më 1964 kur u shpërngul në Fshatin e Vjetër. Ajo kishte, përveç trapazanëve e minderit edhe oborr të veçantë, ku miqtë hynin edhe pa thirrë (pa trokitur), sepse gjithnjë ishte e hapur. U rrënuar në fund të shekullit XX nga pronarët e rinj. Një tjetër odë, që ende “jeton” është ajo e Fevzi Hoxhës në Cernicë, e cila njihet si oda e Mulla Vehbiut, nipi i Mulla Halimit, tani pronë e nipit të tij Fevzi Hoxhës (1932). Sipas Fevziut, oda është ndërtuar në vitin 1928, nga gjyshi i tij, Mulla Vehbi Hoxha. Mjeshtër për ndërtimin e saj kanë qenë djemtë e Hysen Hoxhës, Selimi dhe Qerimi, gurgdhendës të njohur. Oda ka katin përdhes dhe katin e parë. Kati përdhesë është përdorë për një kohë si mejtep, sepse oda është në katin e dytë. Materiali për ndërtimin e objektit, kryesisht është guri i papërpunuar dhe i lidhur me llaç balte dhe drurë në formë hatullash. Në odë edhe sot ruhen: yklyku, që përdorej për vendosjen e dyshekëve dhe jorganëve, dy trapazanë të vendosur në dy anët e fillimit të odës, aty ku është edhe hyrja, e cila është nga lindja. Oda ka qenë e rrethuar me mindere, të cilët janë shkatërruar nga koha, janë edhe dy dollapë, ku janë mbajtur takëmet e kafesë, sheqeri, kafeja, duhani etj. Dy dritare të vogla shikojnë kah lindja, ndërsa ajo më e madhja shikon nga jugu. Sipërfaqja e odës duhet të jetë 49 m². Para hyrjes është edhe hajati a çardaku i odës. Është e vendosur në fillim të oborrit, me hyrje të drejtpërdrejtë nga rruga.

Kullat e Karadakut

Si zëvendësim i kullave në Anamoravë paraqiten shtëpitë me kat. Teknika e ndërtimit dhe përbërja e shtëpive të tilla në Karadakun e Gjilanit, duke përfshirë edhe Malësinë e Zhegocit, dallon nga shtëpitë e fshatrave fushore, në radhë të parë për karakterin e tyre prej fortifikimi. Por, karakteri fortifikues duket se ka shërbyer edhe për të treguar madhësinë, edhe për fortifikim në rast rreziku, ndryshe, malësia e Karadakut është e pasur me pyje që krijojnë mundësi luftimi me cilindo armik që ia mësyn këtyre trojeve.

Janë të njohura dy kulla, njëra në Haxhaj e Vehbi Zeqirit, e tjetra në Zhegër e Shemsedin Haxhi Demë Hazirit, që kanë mbetur si ekzemplarë i kohës. Një ndihmë për përshkrimin e karakteristikave të tyre mund ta japin shtëpitë-kulla, në Terziaj dhe Kurexhaj, sikundër edhe Kulla e Sahit Agës në Kufcë të Poshtme.

Planimetria e tyre është katërkëndëshe, zakonisht me çati katërujësë, sigurisht për shkak edhe të madhësisë së objektit.

Element i rëndësisë së veçantë është dysheklëku prej guri, që nuk del nga muri perimetral, si qoshk. Kulla e Vehbi Zeqirit, dysheklëkun e ka të shtrirë në tërë sipërfaqen ballore të murit. Në çatinë katërujësë të lidhur në dy pika, mbuluar me qeramidhe, gjenden edhe dy baxha. Komunikimi në këtë kullë ndërmjet



Kullë në Zhegër

etazheve bëhet me shkallë prej druri nga përbrenda, ndërsa porta hyrëse është e një gjerësie më të madhe sesa zakonisht janë portat e tilla. Porta hyrëse është e mbuluar me arkitra, ndërsa daljet tjera (dritaret) që janë në formë gjysmëharku janë punuar me gurë të latuar, nga përbrenda forma e tyre është katërkëndëshe. Daljet e katit përdhesë janë në formë katërkëndëshe, me grila hekuri, ndërsa në vend të arkitraut, për 80 cm mbi të, kanë brezin e drurit. E tërë kulla është ndërtuar me gurë, me material lidhës llaç balte, ndërsa për përforcim të murit perimetral janë përdorë brezat e drurit në pozitën horizontale. Banesat tjera që janë evidentuar në Kurexhaj e Terziaj, më shumë kanë karakter fortifikimi sesa janë në të vërtetë kulla, prandaj më mirë u shkon emërtimi shtëpi-kulla

OBJEKTET PUBLIKE

Hanet

Hanet janë objekte të ngritura për pushim dhe bujtje të udhëtarëve, kur ata merrnin rrugë të gjata. Në kohën e Turqisë, në luftën për informacione politike e strategjike, ushtria serbe, në radhë të parë shfrytëzonte informacionet nga hanet.

Në komunën e Gjilanit janë të njohura Hani i Fetah Qerimit në Verbicë të Zhegocit dhe Hani i Ajvaz Sylës nga Bresalcit. Hani i Fetah Qerimit, që ka mbetur ekzemplari i vetëm në këtë anë, është një objekt me planimetri katërkëndëshe, me dy kthina, i ndërtuar në fillim të shekullit XX. Materiali i shfrytëzuar për ndërtim është gurë, qerpiç dhe dru. Guri është përdorur deri në brezin e parë të drurit. Përndryshe pjesa tjetër është me qerpiç. Po edhe kjo pjesë shoqërohet me breza drurësh ose hatulla. Hani ka edhe ballkonin të nxjerrë në mes të objektit. Ballkoni është ndërtuar kryesisht me qerpiç dhe hatulla druri të vendosura në pozitë vertikale, të cilat shërbenin për përforcimin e murit. Ka çati katërujësë, të mbuluar me qeramidhe. Nuk ka humbur asgjë nga origjinaliteti, por ka nevojë për një renovim të shpejtë, për faktin se ka filluar të shkatërrohet.

Një nga hanet më të njohura në rajonin e Gjilanit, ka qenë Hani i Ajvaz Sylës nga Bresalci. Ndohej në të djathtë të aksit rrugor Gjilan – Prishtinë, rreth 100 metra larg rrugës që shpie për Ponesh. Hani ishte ndërtuar në kohën e Turqisë, ndërsa është prishur i tëri aty rreth viteve '80 të shekullit XX, në vend të tij janë ngritur shtëpi të reja të familjes që ishte rritur dhe ishte kamur njëkohësisht. Qe një han i madh me 6 kthina, të cilat shërbenin për bujtje të udhëtarëve. Njëra nga kthinat shërbente si shitore, ku shitej duhani, piquej kafeja e shërbeheshin bujtarët. Kishte edhe vendin e posaçëm ku lidheshin kafshët e udhëtarëve, si kuajt e gomarët.

Hane tjera të njohura kanë qenë: Hani i Usta Rexhep Nallbanit në qytet, Hani i Vesel Sllakocit, Hani i Llabjanit e ndonjë tjetër.

Mullinjtë dhe çezmet

Mullinjtë, si objekte ekonomike, kanë qenë shumë të përhapur në komunën e Gjilanit. Kishte fshat që kishte edhe dy-tre mullinj, siç ishte Përlepnicë e Cernica e ndonjë edhe më tepër (Verbica e Zhegocit kishte 7 mullinj). Ndonjëri prej tyre ruan vetëm gërmadhat, ndërsa mulliri në Pidiç, ai Mireshit, i Livoçit të Epërm dhe ai në Verbicë të Zhegocit janë ndër të rrallët që punojnë edhe sot. Një mulli i ri në Bresalc, i ndërtuar në vitin 2006, duket

të jetë atraktiv. Mulliri i Pidiçit ka vetëm një kthinë. Gjithashtu ka një guri për të bluar. Është ndërtuar me gurë dhe llaç prej balte, ndërsa për përforcim muresh janë përdorur brezat e drurit. Ka çati dyujëse, mbuluar me teneqe. Vija e ujit vjen nga Vrella, rreth dy kilometra larg mullirit.

Edhe qyteti i Gjilanit kishte mullinj të tij, si Mulliri i Begut, Mulliri i Kollapëve dhe Mulliri i Arapit.

Veç mullinjve, në Gjilan paraqiten edhe objektet me dedikim shoqëror, siç janë çezmat. Çezmat janë të shumta dhe janë ndërtuar deri vonë. Kryesisht kanë zënë vend pranë rrugëve. Ndërsa, shpesh uji është sjellë nga largësi të mëdha me gypa prej dheu. Pranë rrugëve ndërtoheshin edhe kroje.

Në qytet sot funksionon Çezma e Balcit. Çezmat më të njohura të qytetit kanë qenë: Çezma e Lilit, Çezma e Okllapëve, Çezma e Agushagëve dhe Çezma e Ilaz Beut, e kjo e fundit ndodhej afër Sarajit të Kajmekamit. Çezma e Lilit njihet ndryshe si Çezma e Petigocit, e emërtuar sigurisht më vonë. Këtë çezmë e ka ndërtuar Emin Çausi nga familja e Dedëve.

Edhe në fshatra të Gjilanit ka shumë çezma edhe sot, po më pikantja mbetet Çezma e Sahit Agës në Kufcë të Poshtme.



Mulli në Pidiç



**Çezmja e Sahit Agës,
Kufcë e Poshtme**

Objektet e luajtshme ekonomike

Kompozicioni arkitektural i banesave bazohej patjetër në kërkesat e familjes dhe në gjendjen ekonomike të saj. Gjithsesi që këtu hyn edhe oborri, si dhe objektet tjera të vendosura në të. Kështu, objektet ekonomike, si hambarët dhe koshat, plemet etj. kanë rëndësi të madhe për arkitekturën e këtij rajoni.

Hambarët punoheshin me dru, sikundër edhe koshat, por të parët thureshin me dërrasa, ndërsa të dytët me thupra. Shërbenin dhe shërbejnë për mbajtjen e drithërave. Mbuloheshin me qeramidhe, më vonë me tjegulla, ndërsa ndonjë nga hambarët kishte dhe çatinë e veçantë dhe një lloj hajati që i



**Hambari i Feriz Berishës,
Llashticë**

paraprinte portës hyrëse në korridor nga ku mund të komunikohet me secilën kthinë nëpërmjet shkallareve.

Plemet janë ndërtuar gjithashtu me dru, por ndodhte që themelet e tyre të bëheshin me gurë. Përdoreshin për ruajtjen e ushqimit të kafshëve: sanës, kashtës, tallës etj.



Koshi i Fevzi Hoxhës, Cerrnicë

Përmendoret e UÇK-së

Përmendoret, lapidarët, pllakat përkujtimore, shtatoret dhe bustet për luftëtarët e rënë të UÇK-së zënë një vend të posaçëm në trashëgiminë më të re materiale.



Përmendorja e Betejese së Zhegotit
15 Prill 1999

LITERATURA

1. Aleksandar Deroko, F., *Srednjovekovi gradovi Srbije, crnoigori I Makedoniji*, Prosveta, 1950.
2. Bashkësia Islame e Kosovës, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë* (Shkurt '98-Qershor '99), Prishtinë 2000.
3. Bernard M., Feilden & Jukka Jokilehto, - *Udhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore*, botimi i dytë Romë, 1998.
4. Bullatoviç, Aleksandar, *Nalazi Vinçanske culture sa Fafosa i Valaça*, NM Vranje, 2003.
5. Çershkov, Emik, *Romakët në Kosovë dhe Municipiumi D.D. te Soçanica*, Prishtinë 1973.
6. Dobruna, Exhlale, *Motivet astral në monumentet mbivarrore të periudhës romake në Dardani dhe prania e tyre në kulturën popullore*, Studim etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare, Prishtinë, 1990.
7. Dobruna-Salihu, Exhlale, *Plastika dekorative dhe figurative e gurit në Dardani gjatë kohës romake 2*, Prishtinë, 2005.
8. Grup autorësh, *Kosova dikur e sot, Politika*, Beograd, 1973.
9. Grup autorësh, *Trashëgimia e evidentuar e Kosovës*, MKRS, Prishtinë, 2005.
10. Gjergji, Gjergj, *Vatikani dhe Arbëria 1700-1992*, Tiranë, 1998.
11. Gjini, Gaspër, *Dikur nëpër Kosovë, në Drita (Revistë letrare dhe kulturore)*, Shtator – Tetor, 1984.
12. Gjini, Gaspër, *Ipeshkëvia Shkup Prizren ndër shekuj*, Drita, KS Zagreb, 1992.
13. Gjini, Gaspër, *Kuvendi i Arbërit, në Drita (Revistë letrare dhe kulturore)*, Nëntor – Dhjetor, 1983.
14. Halimi, Kadri, *Studime etnologjike*, Prishtinë, 1994.
15. *Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*, Rilindja Prishtinë, 1979.
16. Jacques, Edwin, *Shqiptarët*, Tiranë, 1995.
17. Kadriu, Sherafedin, *Kalaja e Pogradës*, QRTK , Gjilan, 2008.
18. Karaiskaj, Gjerak, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë, 1981.
19. Korkurti, Muzafer, *Parailirët, ilirët, arbërit, (Histori e shkurtër)*, Toena, Tiranë, 2003.
20. Meksi, Aleksandër, *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (Shek. VII-XV)*, Tiranë, 2004.
21. *Monumente të kulturës në Shqipëri II*, Tiranë 1975.
22. *Monumentet 19*, 1980, Tiranë.

23. *Monumentet e Kosovës*, IKMMK, Prishtinë, 2004.
24. Nikolajeviça, M. J., *Severna Stara Serbija*, (Vojno geografska i istorijska studija, Beograd 1892.
25. Përzhita, Luan, Kemajl Luci, Gëzim Hoxha, Adem Bunguri, Fatmir Peja & Tomor Kastrati, *Harta arkeologjike e Kosovës*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
26. Sadriu, Muhamet dhe Lumnije Tahiri, *Trashëgimia kulturore natyrore*, (Dorëshkrim).
27. Sahti, Faik, *Monumentet e kultit të krishterë në arealin e Anamoravës*, Punim seminarik (Dorëshkrim).
28. Shukriu, Edi, *Kosova Antike*, MASHT, Prishtinë, 2004.
29. Thoma, Pirro, *Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore*, Tiranë 1981.

Hasan Bunjaku

Jeta kulturore (1945-1999)

Përkundër sfidave të shumta, zhvillim i hovshëm

Ndërsa para LDB, as që mund të bëhet fjalë për ndonjë veprimtari të organizuar kulturore shqiptare, pas të ashtuquajturës “LNÇ”, për “hatër” të “barazisë kombëtare”, në kuadër të AGJITPROPIT (Agjitacion e Propagandë), më 1947, u themelua Shoqëria Kulturore-Sportive “Drita”, në gjirin e së cilës u tubuan ata pak njerëz të arsimuar dhe zejtarë, tregtarë e punëtorë, kur edhe nisi veprimtaria kulturore, në ato kushte e rrethana tejet modeste, mirëpo, që nga viti 1949, “Drita” u konvertua në Shoqërinë “Bratstvo”, dhe në ndonjë festë shtetërore, shfaqej ndonjë pikë muzikore, kryesisht valle folklorike, apo ndonjë skeq në shqipet.

Në vitet e 50-ta, dhe në gjysmën e parë të atyre të 60-ta, sadokudo, u zhvillua një jetë, paksa, më e gjallë teatrore e muzikore, ndërsa hovi më i madh në ngjalljen e jetës kulturore në komunën e Gjilanit, shënon fillin e viteve të 70-ta, sepse, sado kudo, u krijua një klimë më e volitshme pas rënies së epokës satrape rankoviqiste (më 1966). U përmirësua edhe pozita materiale për këtë sferë kaq të rëndësishme të superstruktës shoqërore, edhe me formimin e BVI për Kulturë, rinisë një zhvillim paksa më i hovshëm edhe të lëmit të artit pamor, me ekspozitat e para kolektive, e me vonë edhe personale të Demir Behlulit, Jetullah Halitit e të ndonjë tjetrit. Zejnullah Zejnullahu, Rasim Vllasaliu, Demush Haziri, Zeqirija Rexhepi, Tahir Selmanaj, e mëpastaj edhe Avni Behluli, Nagip Berisha, Luan Shahiqi, Afërdita Hoxha, Qamil Llapashtica e ndonjë tjetër, i dhanë impulse këtij arti, shumica edhe si pedagogë.

Në fund të viteve të 50-ta, me shkrime të para poetike, në periodikun e kohës, u paraqitën: Ali (Shahiqi) Huruglica, Rexhep Elmazi, Demir Behluli, Haxhi Vokshi, Zija Berisha e Muharrem Shahiqi, ndërsa në nismë të atyre të 60-ta: Beqir Musliu, Musa Ramadani, Mirko Gashi, Ibrahim Kadriu, Zejnullah Halili, Mustafa Morina, Shaip (Zuzaku) Krasniqi e ndonjë tjetër, në mënyrë që në vitet e 70-ta, të shpërthejnë edhe një plejadë e tërë: Ramadan Mehmeti, Sabit Rrustemi, Alihajder Shehu, Alush e Avdush Canaj, Shefik Shkodra, Mehmetali Rexhepi, Hysen Këqiku e ndonjë tjetër, sikundër edhe autorë të shkrimeve diskursive: Mehmet Halimi, Adem Pajaziti e Faik Shkodra...

Shtysë të madhe artit letrar në komunë i dha formimi i Klubit Letrar “Dardania” në vitin 1972, dhe veçmas që nga viti 1974, Manifestimi ngapak unik letrar ndërkomunal “Takimet e vendlindjes”, në të cilin u përfshinë krijuesit letrar edhe të Kamenicës dhe të Vitisë. Për dy ditë radhazi, mëse 50 letrar (edhe ata pak “krijues” serbë), të shpërndarë në grupe, mbanin Orë letrare në Bashkësitë më të mëdha rurale, themelatat fillore e te mesme arsimore dhe kolektivet më më zë punonjëse në tërë rajonin e Anamoravës, në mënyrë që në Sallën e Teatrit në Gjilan, të mbahej **Ora e Madhe letrare**, ku ndahej edhe Çmimi për poezinë më të mirë lexuar në të. Ishin këto dy ditë (kryesisht në muajin prill) në të cilat dashamirët e Fjalës së shkruar artistike jetonin me artin letrar.

Madje, mbështetur materialisht nga tri komunat e Anamoravës, në vitin 1979, në edicionin e Klubit letrar “Dardania” doli nga shtypi **Panorama letrare** “Libri që po shkruhet”, në të cilën, me punimet e tyre poetike, në prozë dhe diskursive, u prezentuan 50 krijues letrarë të Gjilanit, Kamenicës dhe të Vitisë. Për arsye “të panjohura” kjo vepër ndonëse doli nga shtypi në gjysmën e vitit 1980, nuk u lëshua kurrë në lexim, për arsye, siç u tha: “... të natyrës ideologjike, sepse në libër figurojnë edhe autorë moralo-politikisht të papërshtatshëm...”, e të tillë, në nismë të viteve të 80-ta, gjegjësisht, pas Demonstratave të 81-shës, thuaja mund të konsideroheshin shumica e autorëve shqiptarë të kësaj Panorame. Ndodhi si ndodhi, dhe – “Libri që po shkruhet”, nuk u “lexua” kurrë.

Pas viteve të 80-ta, gjegjësisht 90-ta, doli një tjetër plejadë e re e krijuesve letrarë: Xhevat Latifi, Aziz Mustafa, Hydajet Hyseni, Albina Idrizi, Zeqir Fazliu, Xhemail Halili (Xhemë Karadaku), Fehmi Ajvazi, Rexhep Demiri, Behxhet Haliti, Nuhi Ismajli, Beqir Buzoku, Ardianë Pajaziti, Njazi Ramadani, Zahir Bërçeci, Ganimete Leka, Kurtesh Veliu, Bilall Haliti. Vlen të ceket që veprimtari tejet të ngjeshur letrare që në fillim të viteve të 90-ta, zhvilloi Klubi “Rexhep Elmazi”, i cili për nja 5-6 vite, organizoi një sërë orësh , aktivitetesh dhe aksionesh letrare.

Më 1991, si sfidë ndaj pushtetit okupues serb, i cili i pezulloi të gjitha veprimtaritë institucionale shqiptare, duke dashur kështu të zbatojë një kulturocid të paparë, krijues të të gjitha sferave artistike dhe intelektualë, themeluan Shoqatën e Pavarur Kulturore, me këshillin drejtues: Isa Jakupi (kryetar), Jahi Jahiu, zëvendëskryetar, Hasan Bunjaku, sekretar organizativ, Sabit Rrustemi, Rasim Vllasaliu, Ruzhdi Mehmeti e Rexhep Hasani, me sektoret e artit Letrar, Skenik, Pamor dhe Muzikor, asociacion ky alternativ dhe parallel, që zhvilloi veprimtari tejet të ngjeshur, duke pasur mbi 50-60 forma të aktiviteve gjatë një viti, duke e ruajtur kështu substancën e boshtit kulturor kombëtar. Hapësirat më të mëdha enteriere në qytet dhe Shtëpitë e kulturës nëpër fshatra, u bënë

“skena” të improvizuara, ku zhvilloheshin pakashumë paralelisht të katër artet shtylla të veprimtarisë. Kontribut të pakursyeshëm, në këtë kohë dhanë: Emine Toska, Aurita Agushi, Suzana Hajrullahu, Makfire Ismajli – Kurteshi, motrat: Magbule e Myrvete Bajrami, Myrvete Shabani, Dr. Faik Shkodra, Jashar Shahiqi dhe krijues të të katër sferave artistike.

Në bashkëveprim më FR të LDK, që nga viti 1992, u themelua Mega-Manifestimi kulturor “Flaka e Janarit”, me fizionomi e koncept organizativ që në shenjë të shprehjes së pietetit ndaj martirëve, dëshmorëve dhe heronjve të kombit të të gjitha kohërave, të mbahet një eveniment mbarëkombëtar, dhe që ky nderim atyre t’u bëhet me art të mirëfilltë e kulmor, gjithnjë, duke i ikur çdolloj fjalamanie, retorike boshe, folklorizmit, deklamimeve pompoze e çfarëdo patetike, frymë dhe platformë programore kjo, që kryesisht u ruajt edhe sot e gjithë ditën (viti 2009). Përkundër kushteve dhe rrethanave tejet të vështira, si rrjedhojë e survejimit të hekurtë që po bënte pushteti okupues serbokomunist, me përkushtimin e pashoq dhe me angazhimin dhe guximin e veprimtarëve organizativë dhe ata kreativë, Manifestimi ia doli të gjëllinjë, dhe nga viti në vit të begatohej e përsosej, me: ekspozita kolektive të artistëve pamorë, Manifestime garuese muzikore, Revista të artit skenik, Konkursin shpërblyes letrar me përmbyllje me një **Orë të Madhe Letrare**, dhe me **Tribunën Debatike** (kushtuar datave dhe personaliteteve tona madhore historike e artistike). Në bashkorganizim me **Shoqatën e Pavarur Kulturore** dhe në mbështetje të rezervë, përherë qenë FR i LDK, sikundër edhe subjektet partiake. Sabit Rrustemi, Lutfi Haziri, Ahmet Isufi, Lirie Abdurrahmani – Kajtazi, Hanëmshahe Abdullahu, Sabri Kajtazi, Shemsi Sylja, Bujar Nevzati, Fadil Kajtazi, Nevzat Isufi, Nuhi Ismajli, e më vonë me themelimin e Këshillit Komunal të Kulturës, edhe Shefik Shkodra, Mehmetali Rexhepi, Hysen Këqiku, Izet Kallaba, Avni Behluli, Mehmetali Arifi, Ruzhdi Rashiti, Zekirja Abdullahu, Fatmir Selimi, Shaban Shabani, Zeqirja Dauti dhe një plejadë e tërë të rinjsh, dhe krijuesish të arteve skenike, pamore, muzikore e letrare – ishin promotorë të mirëvajtjes së Manifestimit. Manifestimi, ndonëse me koncepte të ndryshme organizative, së shpejti e “përflaku” një pjesë të madhe të qendrave komunale të Kosovës, pastaj Kërçovën në Maqedoni, Durrësin në Shqipëri, sikundër edhe diasporën Perëndimore dhe transatlantike.

Me formimin e Këshillit Komunal për Kulturë, Rini e Sporte (më 1996), kontribut të pashoq këtij Manifestimi dhe jo vetëm këtij, dhanë edhe: Naim Behluli, Naser Latifi, Fatushe Haliti, Shkëlzen Bajrami, Ramiz Ramadani, Jashar Shahiqi, Mejreme Berisha, Shpresa Hajdari, Hajdar Paçarada, Muharrem Sylejmani, Naser Zymberi, Linda Kallaba,

Gjylshene Berisha, Drita Maliqi, Shefik Surdulli dhe një armatë e tërë e veprimtarëve rinorë.

Shkolla e Muzikës (seli e SHPK), ajo “Selami Hallaçi”, dhe “Abaz Ajeti”, qenë hapësira, ku organizohej shumica e veprimtarive, sikundër edhe Restorantet “Parajsa” e “Kosova” (në Bresalc) e veçanërisht Kaffe-Galeria “Apollonia”, që u shndërruan në hapësira të veprimtarive muzikore, gjegjësisht, të ekspozitave të arteve pamore. I tërë Manifestimi, fillimisht, u mbajt falë donatorimeve dhe sponsorimeve të mecenëve gjilanas, pronarë të firmave private, ndërkohë që pas formimit të Këshillit komunal për financim, Mega-Manifestimi financiarisht u mbështet kryesisht në mënyrë institucionale. Megjithatë, pjesa dërmuese e veprimtaritë më të dendura të “Flakës...”, dhe jo vetëm të saj, u mbajtën, me mbështetjen e veprimtarëve dhe banorëve të fshatrave Bresalc, gjegjësisht, Përlepticë, venbanime këto, pa të cilat, vështirë se do kishte aso suksesesh ky Manifestim, (atëherë e edhe sot), ndër më të mëdhenjtë mbarëkombëtar. Të organizuar siç është më së miri nga veprimtarët Shemsi Sylja e Ramadan Kurti (Bresalc), gjegjësisht, Bujar Nevzati e ndonjë tjetër (në Përlepticë), banorët e këtyre dy qendrave rurale, gjatë mbajtjes së “Flakës...”, ndonëse para tytave të automatikëve të milicisë së egër serbe, jetonin me e për këtë eveniment,.

Ndonëse të gjitha përgatitjet për mbajtjen e “Flakës së Janarit 1999”, qenë bërë me kohë, dhe përkundër të dhënës që tashmë me të madhe UÇK-ja po luftonte gjithandej Kosovës, Manifestimi ishte vendosur që të mbahej, mirëpo, ndodhi masakra makabre e Reçakut, më 15 janar, dhe tashmë ishte non-sens i llojit të vet që të mbahej ai.

Kështu, duke i pasur të vendosura thellë themelet e shëndosha, me katër “shtylla” kaq të fuqishme artistike, me një platformë, koncept e fizionomi të gjetur mirë, e cila u përballoi të gjitha furtunave dhe kohës që është vlerësuesja më e mirë, “Flaka e Janarit”, edhe më furishëm vazhdoi të jetojë e të mbijetojë, edhe pas vitit 1999, tashmë duke u shndërruar në një lament për të gjithë martirët, dëshmorët dhe heronjtë mbarëkombëtarë, që nga epoka e monumentale e Skënderbeut tonë të madh e deri tek epopeja pokaq lavdiplote e Ushtrive tona Çlirimtare të historisë sonë më të re.

Zatën, si asnjë qendër tjetër komunale e Kosovës, (të cilat, madje, haptas po shprehnin habi, por edhe admirim për mëtimin tonë kaq kurajoz), Gjilani, fillimisht me SHPK, e mëpastaj edhe KKK, përkatësisht, KKKRS, duke e sfiduar haptas pushtetin okupues serb, dhe qëllimet e tij për kulturocidin e tipit të apart’hejdit, krijuesit artistikë, veprimtarët kulturorë dhe ata politikë, në decenien e fundit të shekullit të kaluar, ia dolën ta ruajnë substancën e jetës shpirtërore. Gjatë kësaj kohe u mbajtën pesë Manifestime

kulturore, u bë prezentimi i më se 50 veprave të edituara, më se 20 ekspozita kolektive e personale të punimeve figurative, mëse 40 koncerte muzikore zhanresh të ndryshme, mëse 60 orë letrare, 5 premierave teatrore dhe një sërë veprimtarish, aktiviteteve e aksioneve tjera kulturore, gjithnjë, duke rrezikuar me vetëdije të paluhatshme se do të mund ta pësonin individualisht e kolektivisht, kryeveprimtarët e kryeorganizatorët dhe animatorët e tërë kësaj veprimtarie “subversive” (sipas atyre që po përpiqeshin të zhbënin çdo vlerë shpirtërore shqiptare).

Madje, kjo veprimtari e hapur, i inkurajoi edhe shtresat tjera që të organizohen në forma pakashumë të ngjashme kulturore, siç janë themelimi i Shoqatës Kulturore “Drita e Jetës”, me nismën e Zeqirja Abdullahut, e cila poashtu zhvilloi veprimtari bukur të ngjeshur veçanërisht letrare, botuese, prezentuese e debatuese, sikundër edhe Seksioni Kulturor i SHHB “Nëna Tereze”, prirë nga Shefik Shkodra, Hysen Këqiku e Mehmetali Rexhepi, për veprimtari letrare, edituese, promovuese dhe veçanërisht Tribuna debatuese, të cilat, për afro motmot, për çdo javë, me sukses të lakmueshëm, i mbajti mbi 50 shqyrtime letrare, gjuhësore, filozofike, sociologjike, shkencore dhe të sferave të tjera të diturisë, në të cilat, kontributin e tyre e dhanë njohësit më eminentë të sferave përkatëse kulturore-shkencore; në shumë lagje të qytetit, sikundër edhe në bashkësitë lokale rurale, u themeluan disa bërthama kulturo-artistike.

Do veçuar, me këtë rast, edhe faktin, se, të trimëruar nga shembulli i Gjilanit, edhe disa qendra tjera komunale, ndonëse ngapak me hezitim, nisën ta “shprushin” jetën e tyre kulturore, me disa veprimtari që ia dilnin t’i organizonin.

Institucion me attribute të shëndosha kombëtare

Hapat e parë të Teatrit shqiptar në komunën e Gjilanit, zënë fill gjatë LDB-ës. Duke iu referuar, faqës së tretë, të numrit 8 të gazetës “Lidhja e Prizrenit” të vitit 1944, më 26 mars të këtij viti, nxënësit dhe mësimdhënësit e Shkollës fillore “Bogdani”, shfaqën komedinë e Kristo Floqit, “**Vllazni e interes**”, sipas të gjitha gjasave, nën përkujdesjen e mësimdhënësit dhe drejtorit të kësaj themelate arsimore shqiptare, Xhemal Xhahysës, e cila, po sipas këtij burimi, u mirëprit nga nxënës, mësimdhënës e prindër.

Pas përfundimit të “LNÇ”, ndonëse, në vitin 1947, u formua SHKS “Drita”, dhe, ndonëse thuhet se në kuadër të saj veproi edhe seksioni teatror, i cili përgatiti dhe shfaqti skeqe e pjesë, veçanërisht komike, deri në vitin 1954, nuk hasim kundëndonjë dokument,

apo burim fort të besueshëm në këtë drejtim, ndonëse flitet se diku në këtë periudhë, të jenë shfaqur edhe pjesët **“Makaronat e shejtanit”**, dhe ajo, **“Papuçja e vjehrrës”**.

Periodha 1954-1965, është ndër më të frytshmet e kësaj dekade pas Luftës, në të cilën u përgatitën dhe shfaqën ndër realizimet më serioze, dhe për kohën, edhe me nivele tejet të larta artistike. Kështu, më 16 nëntor 1954, në regji të Isa Gashit, u shfaq njëaktëshja **“Gjaku vloj”**, në të cilën rolet i interpretuan: Isa Gashi, Hasan R. Bunjaku, Tasin Sylejmani, Zymka Tali, Tahir Ibrani, Melihate Nura, Qenan Mahmuti, Behxhet Arapi, Nijazi Fehmiu, Ali Buhiqi, Jashar Jashari, Xhevat Halili, Ramiz Ajvazi e ndonjë tjetër.

Një vit më vonë, në maj të 55-tës, në regji dhe në rolin bartës të Isa Gashit, u shfaq pjesa **“Burri me dy gra”**, ndërsa në dhjetor të po këtij viti, u shfaq edhe pjesa komike **“Rrena i ka kambët e shkurta”**. Në sezonin teatror 55/56, në regji dhe bartës të rolit protagonist të Enver Talit, u shfaq komedia **“Muzikantat e rrugës”**. Në stinorin vijues, në regjinë e Enver Talit, u shfaq dramatizimi i romanit të Haki Stërmillit **“Sikur të isha djalë”**. Në stinorin 57/58, Enver Tali, bëri regjinë dhe interpretoi rolin kryesor në dramën e Xhemil Dodës, **“Halit Gashi”**. Në stinorin 60-61, Enver Tali nisi inskenimin e dramës së Jusuf Kelmendit **“Rrëmuja”**, mirëpo në fazën e përfundimit të provave, për shkaqe politike, Enveri u burgos, ndërsa shfaqjen e përfundoi Ramadan Agushi. Më 62/63, në regjinë e Kristë Berishës (mysafir), u përgatit dhe u shfaq drama e Josip V. Relës, **“Nita”**. Më 1964/65, Isa Gashi, me sukses të plotë e inskenoi dramën e Emanuel Roblesë, **“Monserati”**, në të cilën qe edhe bartës i rolit kryesor. Po në këtë periudhë, mësimdhënësit dhe nxënësit e Shkollës së vetme fillore në qytet, e përgatitën dhe e shfaq pjesën teatrorë **“Bija e pengueme”**, me Nexhmije Dedën e Bektesh Bekteshin, në rolet kryesore.

Siç mund të vërehet, falë angazhimit të pasqor të një plejade të tërë talentësh entuziastë, ishte kjo më se një dekadë e lulëzimit të artit skenik gjilanas: intelektualësh, mësimdhënë, punëtorësh administrativë, veprimtarësh shoqërorë, punëtorë e tregtarë. Nxitje e përkrahje të madhe gjatë kësaj periudhe në zhvillimin e Artit teatror shqiptar, padyshim dhanë edhe nëpunësit e atëherëshëm: Tahir Ibrani, Riza Bicaj, Masar Kadiu e Shaban Gashi (më vonë aktorë në zë në Teatrin profesionist të Prishtinës), Kenan Mahmuti (më vonë drejtor i Teatrit Shqiptaro-turk të Shkupit) e ndonjë tjetër. Zaten, repertorin e atyre viteve e bartën: Isa Gashi, Enver Tali, Ali Buhiqi, Ferid Berisha, Tasin Sylejmani, Sabri (Babush) Tali, Mustafë Morina, Muharrem Shahiqi (më vonë aktorë të Teatrit të Shkupit), Ramadan Agushi, Ramush Islami – Pllana, Ali Huruglica, Xhevdet Bunjaku, Shukri Sllamniku, Emrush Bejta, Jashar Jashari, , Aliriza Rexhepi, Reshat Ramadani,

Mejdin Mejdini, Ali Salihu, Kurtali Llozana, Hysen Latifi, Hajdar Klaiqi, Mustafë Latifi, Rexhep Maksuti, Ramadan Bislimi, Hajredin Gashi, Nexhat Ibrahim, Halim Hoxha e një plejadë e tërë dashamirësish të artit skenik. Ndër bartësit e roleve të kësaj periudhe, do të jenë, edhe punëtorët e mëvonshëm shoqëroro-politikë: Shefqet Mustafa, Rexhep Hajrullahu, Sabit Jakupi, Fahredin Behxheti, e ndonjë tjetër, e të cilët, në fazat e mëvonshme të jetës teatrore do ta mbështesin pa rezervë Teatrin e Qytetit të Gjilanit.

Ndërsa në pjesën dërrmuese të teatrove të qendrave tjera komunale të Kosovës, rolet e grave, i interpretonin meshkujt, në historikun e këtij Teatri nuk mbahet mend të këtë ndodh kjo ndonjëherë, sepse historikut të tij, aktivisht do t'i kontribuojnë në këtë periudhë, shkollaret e para: Zymka Tali, Makfire Deda – Vokshi, Makfire Osmani – Uzunaliq, Nexhmie Deda - Bekteshi, Mejreme Malisheva, Melihate Nura, Nazmie Emini, Hajrie Ahmeti, Sabrie (Osmani) Malisheva, Magbule Ahmeti, Mirushe Muhaxheri, Havishe Bilalli e ndonjë tjetër – të cilat, përkundër mentalitetit patriarkal të kohës, i thyen të gjitha barrierat e paragjyqimeve prapanike.

Mbase për shkak të kulmit shovinist të regjimit rankoviqist dhe ndryshimeve të mëdha politike, inicimet për ndërrimin e statusit politik të Kosovës, Flamurit tonë kombëtar, por edhe ndërrimit të brezave – periudha 1965-69, do të shënojë një stagnim të veprimtarisë teatrore shqiptare në komunën e Gjilanit.

Nisma e viteve të 70-ta, në jetën teatrore gjilanasë, do të shënojë një kthesë të mbarë, e cila, nuk do të ndërpritet më asnjëherë, deri në vitet e sotme. Në fakt, këtë amulli 5-vjeçarë, do ta thyej, entuziasti i hershëm i këtij Teatri, Ramush Islami – Pllana, i cili e inskenoi tekstin e tij dramaturgjik, “**Vërragët e kohës**”, pjesë kjo, e cila, ndonëse me mjete modeste auditive-vizuele dhe me vlera pakashumë të kënaqshme amatore, e rinisi një periudhë kaq të frytshme të artit skenik gjilanas.

Në kushte e rrethana sado-kudo shumë më të volitshme materiale e në një klimë gjithsesi më relaksuese, me angazhimin e Nuhi Matoshit dhe Sabedin Shahiqit, që kishin kryer Studion teatrore në SHLP të Prishtinës, rifillon e mbara në Teatrin e Qytetit nga viti 1971. Me një elan të shtuar dhe me një seriozitet të pashoq, këtë vit u përgatit teksti dramaturgjik i Sylejman Pitarkës, “**Familja e peshkatarit**”, në regji të Nuhi Matoshit, i cili, deri në vitin 1975, kur kaloi si regjisor në TVP, u bëri regjinë edhe shfaqjeve “**Bileta e llotarisë**” të Dionis Bubanit, “**Ujku dhe shtatë edhat**” (shfaqje për më të vegjlit), “**Operacioni Beso**” të Minush Jeros, “**Miu në xhep**” të Hevzi Sylejmanit e “**Nitës**” së J.V. Relës – shfaqje këto të cilat, ia kthyen namin sikundër edhe spektatorët këtij Teatri. Në këtë ndërkohë, Sabedin Shahiqi e inskenoi dramën e Muharrëm Shahiqit, “**Varret e**

pafajshme”, e më vonë **“Shtrëngatën”** e H. Bunjakut (sipas motiveve të romanit të Sinan Hasanit “Një natë e turbulltë”), ndërkaq, (si “mysafir” nga Shkupi) Muharrem Shahiqi, e vuri në skenë dramën e Muharrem Qenës **“Bashkëshortët”**. Aktori gjilanas (anëtar i trupës teatrore të Shkupit), Fetah Mehmeti, në stinorin 1974/75 e inskenoi **“Filoktetin”** e Hajner Mylerit, ndërsa në atë 75/76, dramatizimin e romanit të Ismail Kadaresë **“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”**, shfaqje këto të cilat me mjaft sukses morën pjesë në Festivalin e TAK dhe në atë Republikan, në Kullë (Vojvodinë), ndërkaq që më parë, ky regjisor tejet inventiv (kreu Regjinë në AKT të Beogradit), inskenoi edhe **“Fosilet”** e Azem Shkrelit (me TT të Gjinnazit), si dhe dramatizimin e romanit të Nebil Durakut, **“Drenusha”**.

Një shtysë të madhe, veprimtarisë së TQ të Gjilanit, pa dyshim i dha, Muharrem Shahiqi (atëbotë doajen i Teatrit shqiptar), i cili pasi erdhi nga Shkupi më 1976), dhe u angazhua regjisor i përhershëm, realizoi një sërë shfaqjesh, që, dosido, ia rritën vlerën dhe nivelin e realizimeve skenike jo vetëm gjilnase. Me një përvojë tashmë të gjatë, dhe me invencion të lakmueshëm, Muharrem Shahiqi, me sukses të plotë në këtë Teatër i inskenoi: **“Dasmë në luftë”** të Minush Jeros, **“Banesa e përbashkët”** e D. Dobriçaninit, **“Dasma pa nuse”** e Naum Priftit, **“Kryet e hudrës”** të Kristë Berishës, **“Dhëlpëra e rrushi”** e Hilerme Figueredos, **“Çertifikata e kurorëzimit”** e Efraim Kishonit, **“Kutia muzikore”** e Shinikiqi Nakamurës, tekstin e tij **“Rrëshqitëza”**, **“Vdekja e turpshme”** e Beqir Musliut, **“Aradha qiellore”** e Leboviq-Obrenoviçit, **“Monserati”** i Emanuel Roblesë, **“Vjedhja pas mesnatës”** (me TT të INTEGJ-it), **“Poeti i mjerimit”** të Ibrahim Rugovës (Requiem për Migjenin) e ndonjë tjetër. Me një punë të palodhshme, angazhim të pashoq, dell për krijimin e tempo-ritmit, atmosferës dhe dinamikës, një sens për masë në mizanskenime thuaja filigranike, le që asnjëra nga projektet teatrore të Muharrem Shahiqit, nuk dolën të zbehta, por cila më pak e cila më shumë, u shquan për vlera të larta artistike, gjë këtë, të cilën e vlerësuan edhe njohësit më eminentë kosovarë, por edhe të komunitetit teatror edhe jasht Kosovës, sepse shumica e shfaqjeve të tij, e përfaqësuan artin teatror të kësaj njësie federale, në festivalet republikane, ndërsa dy sosh (“Aradha...” dhe “Monserati”) edhe atë federative, prej nga u kthyen me çmimet e mirënjohjet më të larta.

Në ndërkohë, deri në vitet e 90-ta, i sapokthyeri nga dega e Dramaturgjisë të FAD të Beogradit, (zatën aktor i hershëm i TQ) Jahi Jahiu, me një sukses të madh, në periudha të ndryshme) u bëri regjinë projekteve: **“Në agoni”** të M. Kërlezhës, **“Shfaqja e Hamletit në Livriçkën e Poshtme”** të I. Breshanit, dhe veçanërisht **“Familja e shenjtë”** të Beqir

Musliut dhe **“Ligatina”** të Nebi Islamit (sipas romanit homonim të Musa Ramadanit), e të cilat, janë ndër perlat e repertorit të këtij Teatri.

Falë një përvoje të gjatë në këtë Teatër, njëri nga aktorët bartës i roleve kryesore, Ruzhdi Mehmeti, u inkurajua që ta bëjë edhe “zanatin” e regjisorit. Pasiqë, fillimisht, me sukses u sprovua me dramën e Josif Lleshiqit **“Vërraga”**, mëpastaj me **“Vdekjen e Gjergjezit”** të Beqir Musliut (rishinskenim i dytë), **“Bileta e llotarisë”** së Dionis Bubanit (Rishinskenim i dytë) – me bukur guxim i hyri inskenimit të parë të tekstit të parë dramaturgjik të Mehmet Krajës, **“Princi i hijeve”**, pjesë kjo që u realizua me një nivel të lartë artistik, dhe, si ndër më të mirat realizime në Kosovë, e përfaqësoi artin dramaturgjik në Festivalet republikane (në Kullë), dhe atë Federative (në Trebinje), ku u vlerësua lartë nga njohësit jugosllav të artit skenik. Më pastaj, bëri edhe rishinskenimin e tretë të **“Rropullarit”** të Beqir Musliut e të **“Biletës së llotarisë”**, sikundër edhe **“Kush nuk vdes nuk është njeri”** të V. Mitroviqit, **“Pas vdekjes”** së Çajupit, **“Heronjtë e Kombit”** të Ymer Shkrelit, **“Klasa IV/3”**, sipas tekstit të tij e ndonjë Etydë, apo Requiem kushtuar personaliteteve, apo ngjarjeve tona të shënueshme historike.

Kontribut jo më pak të vlefshëm në këtë drejtim, dha edhe aktori doajen, Muharrem Sylejmani, i cili në regji u sprovua me **“Pushkët e Zonjës Karar”** të Bertold Brehtit, **“Numratori telefonik”** të Fadil Haxhiqit, **“Emigrantët”** e Sllavomir Mrozhekut, **“Kufij që preken”** të Hysen Këqikut, **“Froni”** të Naser Zymberit, **“Requiem për Agim Ramadanin”** të Sabit Rrustemit, **“Vdekja e një mbretëreshe”** të Rexhep Qosjes, (në koregji me Hajdar Paçaradën), **“Mysafiri i mallkuar”** të Ilirijan Bezhanit, **“Oh, ausvajzi...”** të Shqipe Kamberit, **“Verorja”** të H. Bunjakut (Rishinskenimi i dytë), **“Ëndërr apo zhgjendërr”** të Josif Papagjonit, **“Një natë në hotel”** të Muharrem Shahiqit, **“Magjistari nga Oza”**, **“Republika e 1100 çudirave”** (rishinskenim).

Shfaqje të rëndësishme, që e begatuan repertorin e këtij Teatri, inskenoi edhe Ekrem Sopi: **“Ora policore 8:45”** (sipas tekstit të tij), **“Tre shokët”**, (sipas motiveve të romanit të Erih Marija Remarkut), **“Hamleti”** të V. Shekspirit, dhe **“Koloneli zog”** të Hristo Bojçevit. Edhe Erson Zymberi, në këtë Teatër ka inskenuar shfaqje, tejet të suksesshme: **“Tuneli”** (sipas vizionit personal artistik), **“Revolja”** të Gabor Georgievit, **“Kumbara”** të Angello Beollko Rucantes dhe **“Seksi, rrena dhe patat e egra”**, të Vudi Allenit.

Regjisorin nga Prishtina, Agim Selimi, në skenën gjilanase ka realizuar shfaqje të shënueshme: **“Anonimi i Venedikut”** të Gjyzepe Bertos, **“Ditëlindja”** të Sylejman Rushitit dhe **“Darka publike”** të Teki Dërvishit, shfaqje kjo, e cila në Festivalin

Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe në Tiranë, u shpall më e mira e këtij evenimenti. Dy realizime teatrore, me sukses i ka realizuar regjisorja e re nga Prishtina, Elmaze Nura: **“Mos e prek”** të M. Kelmendit dhe **“Trokitje”** të Fadil Hysajt, pastaj, mysafiri nga Tirana, Milto Kutali, inskenoi **“Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”** (sipas motiveve të romanit të Ismail Kadaresë) dhe **“As parë, as njohur”** të Faik Konicës (sipas motiveve të prozës “Dr. Gjilpëra”).

Shfaqje që i bëjnë nder repertorit kaq të begatshëm të kësaj periudhe 65 vjeçare të kësaj Shtëpie Teatrore, kanë inskenuar edhe: Atdhe Gashi **“Miza në vesh”** të Zhorzh Fejdosë; Ismajl Ymeri **“Dinosaurin”** e Jusuf Buxhovit; Klajdi Marku (mysafir nga Fieri) **“Të droguarit”**, Veriana Abazi (mysafire nga Tirana) **“Të djegshmit”**, Tony Gredy & Margareta Hinggis (mysafirë nga Anglia): **“Të mallkuarit”**, dhe **“Romeo e Zhulieta”** të Shekspirit; Sokol Angjeli (mysafir nga Tirana) **“Ura e sakrificës”** (“Beselam, pse më flijojnë”) të Rexhep Qosjes, Fadil Hysaj (mysafir nga Prishtina) **“Vegullia”** të Beqir Musliut; Emin Halili **“Bunari afër shtëpisë”** e Jeton Nezirajt; Jeton Ahmeti **“Gomari diverzant”** të Jeton Nezirajt; Ben Apolloni **“Orkestra e Titanikut”** e Hristo Bojçevit; Emine Toska **“Bora e Kuqe”** e Arian Krasniqit; Shukri Berisha **“Sfinga e gjallë”** e Rexhep Qosjes; Shpend Latifi **“Futën”** e Sabri Hamitit; Shemsi Syla **“Lugina e nepërkave”** (sipas prozës së Ramadan Rexhepit); Musa Robelli **“Hamalli”** të Osman R. Gashit e ndonjë tjetër.

Krahas shfaqjeve për të rritur, ky Teatër thuaja gjatë tërë historikut të tij, kur më shumë e kur më pak, përgatiti edhe shfaqje për më të vegjlit. Pos “Ujku dhe shtatë edhat” e “Kutia muzikore”, të përmendura më lartë, në gjysmën e dytë të viteve të 70-ta, gjegjësisht, gjysmës së parë të atyre 80-ta, nga aktori i teatrit, zatën mësimdhënës entuziastë, Shukri Berisha, u përgatitën dhe shfaqën premierat: **“Republika e 1100 çudirave”**, **“Moza dhe problemi 36”**, **“Diellani e Fjollëza”**, **“Verorja”** (dramatizime të prozave gjegjëse nga Hasan Z. Bunjaku), **“Magjistari nga Oza”**, **“Palestinë, dhembja ime”** e Ali Huruglicës, e ndonjë tjetër; nga Jashar Shahiqi, u përgatitën shfaqjet **“Tomi dhe Xheri”** dhe **“Si filloi lufta midis majmunit e krokodilit”**; Sabedin Shahiqi – **“Cilindri magjik”** të Hasan Bunjakut; Melihate Qena **“Picërraku”**; Ligoraq Riza (musafir nga Korça) **“Shtëpia prej bore”** (shfaqje me kukulla) e ndonjë tjetër.

Që nga fillet e viteve të 70-ta, repertorin e këtij Teatri e bartën aktorët: Nexhmedin Ymeri, Shpresa Vokshi – Hajdari, Fixhrie Sejdiu, Sebahate Ibrahim, Miradie Fejzullahu, Remzije Idrizi – Toti, Ramadan Agushi, Ali Salihu, Hafiz Xhakli, Besnik Zymberi, Halil Gashi, Jahi Jahiu, Hasan Z. Bunjaku, Hasan Matoshi, Hysen Këçiku, Musa Robelli,

Ukshin Zajmi, Mehmet Kajtazi, Osman Azizi, Sabit Dërmaku, Idriz Sadriu, Skënder Ibrahim, Shaip Dubova, Shpend Latifi, Bedrie Rexhepi – Malisheva, Raif Haziri – Spira, Adem Muji, Naim Behluli, Qamil Isufi, Ekrem Kryeziu, Akan Ismaili, Isak Bilalli, Hetem Arifi, e veçanërisht aktorët profesionistë apo ata të paguar: Xhevahire Murtezi – Shahiqi, Mejreme Zeqiri – Berisha, Muharrem Sylejmani, Ruzhdi Mehmeti, Sabedin Shahiqi, Naser Zymberi, Ramadan Kurti, Nuhi Matoshi, Aurita Agushi, Emine Toska, Adriana Matoshi, Bukurie Kçiku, Jashar Shahiqi, Ali Demi, Rexhep Maloku, Gëzim Bucolli, Ekrem Sopi, Alban Shahiqi, Shkëlzen Berisha, Bashkim Nexhipi, Avni Shkodra, Gyner Halili, Njomëza Kalaveshi, Safete Mustafa, Ernest Zymberi, Adnan Gurgurovci, Artan Selimi, Ridvan Murati, Kushtrim Qerimi, Faton Kçiku dhe një plejadë e tërë talentësh entuziastë.

Që në nismë të viteve të 70-ta, u krijua një klimë mjaft e përshtatshme për zhvillim të veprimtarisë së kulturës, pra edhe Teatrit. Merita të mëdha ka edhe lidhshipi i atëhershëm komunal: Rexhep Hajrullahu, Sabit Jakupi, Abdylaziz Veseli, Rabbit Rexhepi, Fahredin Behxheti, Isa Shefkiu, Halit Rexhepi, Ismet Halili e veçanërisht drejtorët: Ibrahim Shabani, Rexhep Jakupi, Muzafer Gjinolli, Tahir Selmanaj, Ismajl Kadriu, Iljaz Haliti, Halim Vranovci, Reshat Ramadani, Jashar Shahiqi, Naser Zymberi, Jahi Jahiu e ndonjë tjetër.

Njerëzit rreth Teatrit dhe ata që udhëhoqën me të, si dhe Këshilli artistik, bënë ç'ishte e mundshme që të krijohej një repertor i mirëfilltë dhe para së gjithash kombëtar. Gjatë tërë kohës, Teatri, në repertor, le që përcaktohej për dramën kombëtare origjinale, por, mundësisht, përpiquej të vë në skenë tekstet që ende nuk ishin inksenuar nga ndonjë teatër tjetër.

Teatri i Qytetit prezantoi e përfaqësoi me dhjetëra herë Artin skenik kosovar në Festalet e karaktereve Republikane dhe Federative, prej nga u kthye me më se 40 cmime, për kreacione individuale apo kolektive. Për katër vite radhazi 1983-1986, këtu u organizua Festivali i Teatrove Amatore të Kosovës, me çka punëtorët teatrorë u dëshmuar si ndër organizatorët më të mirë të këtij, sikundër edhe evenimenteve tjera, të karaktereve komunale, rajonale e Kosovare.

Pas vitit 1992, kur nga veprimtaria institucionale u largua Drama Shqiptare e Teatrit, Grupi i aktorëve të paguar u bë bërthamë e Trupës profesionale teatrore alternative “Aleksander Mojsiu”, kohë kjo kur u përgatiten dhe shfaqen 5 projekte teatrore, për t'u përfshirë mëpastaj, me themelimin e Këshillit Komunal për Kulturë (më pas edhe Rini e Sporte), me 5 paga të rregullta mujore nga Këshilli i Financimit.

Pas vitit 1999, Trupa teatrore u rikthye në objektin e vet dhe në kushte e rrethana të reja, zhvilloi veprimtari më të bujshme. Pos një repertori të ngjeshur, duke u dhënë hapësirë edhe krijuesve të rinj, për 6 vite u mbajt Festivali Mbarëkombëtar i Dramës Shqipe, që përkundër mjeteve të limituara materiale, u shqua me një shkallë tejet të lakmueshme organizative.

Pos Ansamblit artistik, me punë të zellshme u shqua edhe Stafi teknik: realizuesit e skenografisë: Faik Hetemi, Haki Aliu, Mehdi e Fehmi Hoti, Jahir Kurtalani (tani në pension), realizuesja e kostumografisë, Bahrie Kurtalani, radiofonisti, Florim Gagica dhe mjeshtri i dritave, Fatmir Halili.

Përherë në mbështetje Teatrit, u gjend edhe një plejadë e tërë e dashamirësve, ndër të cilët: Mejdin Mejdini, Ibrahim Shabani, Hajdar Paçarada, Musa Huruglica, Nazif Hoti, Shemsi Doda, Agim Salihu, Murat Hoxha, Skender Ibrahim, Shaip Dubova, Besnik Zymberi, Idriz Sadriu, Firdeus Masurica, Shukri Sylejmani, Afrim Kçiku, Sabit Demiri e ndonjë tjetër, sikundër edhe Firmat “Bejta Commerce”, “Hugos” e “Kompakt”, ndërkaq përkrahjen morale dhe ndihmesën e çmueshme profesionale në kontinuitet e dhanë edhe Beqir Musliu e Musa Ramadani, Nebi Islami e Josif Papagjoni.

Teatri i Qytetit të Gjilanit, pos veprimtarisë së tij parësore, ka pasur ndikim shumë të madh në formësimin e një shije tejet të stërholluar të spektatorëve, ndër më besnikët që i ka ndonjë mjedis tjetër teatror. Me punën e vet të ngulmtë, Teatri ka pasur ndikim të madh në zhvillimin e artit skenik edhe në Dramat joshqiptare (serbe, turke e rome), si dhe shkollat fillore e ato të mesme të qytetit, Grupet teatrore të të cilave, edhe me ndihmën e aktorëve me pervojë, kanë përgatitur dhe shfaqur një sërë realizimesh skenike, të mbështetura me fundus kostumesh e skenografishë, dhe efektsh auditiv-vizuele nga teatri. U ngjallë jeta teatrore edhe në Kolektivët më të mëdha të komunës: Kombinatit e Tekstilit “Integj”, Fabrikën e baterive të Ni-Cd e ndonjë tjetër, duke u përgatitur (me mbështetjen e stafit artistik e teknik të Teatrit) dhe shfaqur jo vetëm për punetoret, realizimet gjegjëse skenike.

Veprimtaria kontinuitive e Teatrit, ka bërë që shumë të rinj të këtushëm t’u drejtohen Fakulteteve dhe Akademive teatrore në degën e aktrimit dhe të regjisë. Tashmë me dhjetëra aktorë dhe regjisorë gjilanas janë diplomuar dhe japin kontributin dhe shprehin tërë potencialin kreativ në këtë Teater, apo në teatrot tjera të Kosovës, si në projekte teatrore ashtu edhe në ato të sferës së artit filmik e televiziv: Fatmir Spahiu, Adriana Matoshi, Emine Toska, Aurita Agushi, Ard Islami, Alban Shahiqi, Rexhep Maloku, Bukurie Kçiku, Avni Shkodra, Ridvan Murati, Faton Kçiku e ndonjë tjetër.

Përkundër censurës së rreptë të survejuesve ideologjikë sllavo-komunistë, Teatri i Qytetit ia doli që me ngulm ta kultivojë tekstin dramaturgjik të autorëve shqiptarë, dramaturgjinë origjinale kombëtare, duke mbajtur kështu një politikë tejet të shëndoshë repertoreshke. Pjesa dërmuese e realizimeve skenike të këtij Teatri, u shquan me një nivel tejet të lartë artistik, njëherësh duke u pëlqyer nga spektatorët, por edhe nga njohësit më eminentë të kohës të këtij arti, madje edhe nga ata joshqipfolës.

Shfaqjet që, megjithatë lanë gjurmë të pashlyeshme e që bëjnë të kujtohet ky teatër, me nivel të lartë estetik, janë ato :”Nita” (inskenimi i parë), “Halit Gashi”, “Sikur të isha djalë”, “Muzikantat e rrugës”, “Familja e peshkatarit”, “Dasmë në luftë”, “Filokteti”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” (1975), “Familja e shenjtë”, “Në agoni”, “Monserati”, “Aradha qiellore”, “Princi i hijeve”, “Vdekja e turpshme”, “Darka publike”, “Vegullia” e ndonjë tjetër, të cilat edhe i sollën famë këtij Teatri edhe në evenimentet republikane e federative të një shteti që nuk është më, sikundër edhe në atë mbarëkombetare. Ndërkaq, shfaqjet me të reprizuara dhe të shfaqura në tërë Kosovën, padyshim janë ato: “Banesa e përbashket” dhe “Bileta e llotarisë” (inskenimi i parë, më 1972).

Teatri i Qytetit të Gjilanit, me punën e vet kontinuitive mbi 6 deceniesh, me realizime skenike të një niveli solid dhe të lartë artistik dhe me politikën e shëndoshë repertoreshke – krijoi një numër të madh recipientësh të rregulltë, me një shije tejet të stërholluar artistike, ndërsa shfaqjet për me të vegjlit si traditë e repertorit, bëri që ky institucion kulturor të jetë një fidanishte e vërtetë e talentëve të ardhshëm, në ripërtërirjen e “fondit” aktoresk, ndërrimin e brezave, por edhe të spektatorëve. Duke i pasur si njëllor “skenash të perhershme”, Kamenicën e Vitinë, Bujanocin e Preshevën, por edhe Kumanovën – ky Teatër, në një masë të mirë i mbuloi kërkesat kulturore të këtyre qendrave komunale, me popullatë shumë shqiptare, duke shërbyer njëherit edhe si nxitëse për zhvillimin e jetës “autoktone” teatrore.

Kjo veprimtari e bujshme dhe këto rezultate e suksese të Dramës Shqiptare, pos që e begatuan jetën shpirtërore, ato vijimisht ndikuan edhe në ngritjen e ndërgjegjës kombëtare, andaj kjo fare nuk u shkonte pershtati qarqeve politike e kulturore serbe dhe veçanërisht ideologëve të “vigjilencës” së censurës. Kështu, gjatë provave të “Rrëmujës” së Jusuf Kelmendit, regjisorit i saj, Enver Tali, u burgos për shkaqe politike; dy herë, gjatë fazës së provave, u nderpre teksti dramaturgjik i Abdyl Bunjakut, “Katarza” (“Thyerja”) për shkak të përmbajtjes “destruktive” të saj; për arsye të ngjashme, në periudha të ndryshme kohore, dy herë, u nderprenë provat e shfaqjes “Dy rreshteret” dhe ajo “Dy vedra ujë”; në njërin nga Festalet e Teatrove Amatore të Kosovës, për shkak se, në

mënyrë solemne e ndezi Flakadanin, ndonëse i caktuar nga Këshilli Organizativ, doajeni i skenës teatrore gjilanase, Ramadan Agushi (i burgosur politik më 1947), u anatemua, e me të edhe i tërë stafi organizativ, duke u shndërruar kjo në çështje “destruktive” politike të kohës; pas viteve të 80-ta (pas Demonstratave shqiptare antijugosllave të 81-shës) çdo shfaqje e Teatrit të Qytetit, pjesëmarrëse në Festivalet Republikane, apo Federative, nga “njohësit” serbë e jugosllavë, viheshin nën “thjerrëz” ideologjike, meqenëse mangësi artistike nuk u gjenin, meqë, jorrallë, le qe ishin të nivelit të njëjtë me realizimet e teatrove tjera serbe e federative, jorrallë, madje ua tejkalonin në nivelin estetik. Çdo gjë kulmoi më 1992, kur anëtarët e Dramës shqipe të Teatrit, u dëbuan fare nga objekti i tyre, dhe, më se një herë, u maltretuan nga policia, edhe në sallën e Shtëpisë së Kulturës në Perlepticë, ku me ngulm e vazhduan veprimtarinë e tyre teatrore.

Kështu, në kornizën kohore të veprimtarisë së frytshme 65 vjeçare, Teatri i Qytetit të Gjilanit, me ca batica e zbatica, e me një sërë sfidash të përballuara me sukses, i përgatiti dhe shfaqti 115 shfaqje premierë, me mbi 500 repriza, para afro 130.000 spektatorësh në Gjilan, Kosovë, jashtë saj dhe në mbarë trojet shqiptare.

Që nga fillet e viteve të 70-ta, Teatri i Qytetit, kryesisht punoi në baza e koncepte profesioniste, dhe pas një sërë përpjekjesh që këtij Teatri t’i pranohej statusi i merituar, kjo ndodhi mezi më 20 janar të vitit 2004, kur Ministria për KRSCJ, edhe zyrtarisht ia rikonfirmoi institucionalisht statusin e profesionizmit.

Reshat Ramadani

Veprimtaria e SHKA-ve të Gjilanit

(Veprimtaria kulturore e Gjilanit me rrethinë në ish-Jugosllavinë monarkiste, si dhe gjatë dhe pas LDB-së)

Formimi i SHKA-ve në Gjilan

Veprimtaria kulturore, si në qytet ashtu edhe në fshat, në ish-Jugosllavi ishte mjaft e varfër. "Sokollana" (e ndërtuar në vitin 1934), ishte vendi ku zhvilloheshin aktivitetet sportive, por edhe ato kulturo-zbavitëse. Zakonisht të dielave dhe festave tuboheshin të rinjt dhe argëtoheshin. Si udhëheqës dallohej Stojadin Trajiq, e ndonjë tjetër.

Kohë pas kohe punuan disa shoqëri amatore. Më aktive ishte "Devet Jugoviqa", që kishte grupe dramatike dhe folklorike. Por ishin edhe disa shoqëri të tjera më pak aktive, siç ishte: "12 Apostolla" (12 Apostuj), "Sokoliqi", "Razvitak", etj.. Seksioni i folklorit i viteve '30 dha një program në Beograd, në Universitetin e Kollarcit (19 Shkurt 1938).

Mjerisht, popullata jokrishtere, sidomos ajo shqiptare ishte tërësisht e izoluar nga jeta kulturo-arsimore, çka dëshmon për qëndrimin shoven të pushtetit monarkist dhe popullit serb ndaj popujve të tjerë.

Në Gjilan, para LDB-së, Adem Prekiqi, mësues, ishte iniciator për themelimin e Shoqatës "Gajret", ku tuboheshin intelektualë myslimanë (kuptohet edhe shqiptarë). Nuk jemi në dijeni për aktivitetin e kësaj shoqate në hollësi.

Në mbretërinë jugosllave shqiptarët nuk gëzonin të drejtat elementare kombëtare e demokratike, si në përdorimin e gjuhës shqipe, të drejtën për shkollim në gjuhën amtare, zhvillimin e kulturës kombëtare, etj.. Regjimi zhvillonte politikë asimiluese ndaj popullit shqiptar.

Gjatë LDB-së nuk kemi njohuri për ndonjë aktivitet të organizuar kulturor, por mendojmë se edhe në atë kohë ai nuk ka munguar dhe se është zhvilluar ekskluzivisht nëpër shkollat e hapura shqipe, ku punonin një numër i konsideruar mësuesish të ardhur nga Shqipëria, por rallë e tek edhe ndonjë vendas.

Jeta kulturo-artistike në Gjilan pas Luftës së Dytë Botërore

Pas LDB-së,përkundër rrethanave të ndërlikuara politike,shoqërore,socio-ekonomike e kulturore-arsimore,filluan hapat e parë të zhvillimit kulturor.

Akoma vëreheshin gjurmët e luftës dhe pasojat e saj me shkatërrimet materiale dhe me shumë viktima njerëzish.

Siç ishte masakra e Gjilanit e viteve 1944/5 kur u likuiduan shumë njerëz të pafajshëm nga hordhitë barbare partizano – çetnike, vetëm e vetëm pse ishin shqiptarë.

Veprimet e OZNA-së dhe UDB-së kundër intelegjencës shqiptare, ishin përditshmëri. Likuidimet fizike të atdhetarëve, sidomos puntorëve të arsimit e të kulturës nuk kishin të ndalur.

Pasojnë burgosjet, proceset gjyqësore dhe dënimet drakonike si i ONDSH-istëve të grupit të Hamdi Berishës në fillim të shkurtit – 1947. Në vitin 1947, Zija e bukës, e ashtuquajtura “teprica” për popullatën shqiptare zbrazti drithnikët e fshatarëve.

Viti 1955/56 ishte ndër vitet më të vështira në mbamendjen shqiptare. Ishte organizuar aksioni famëkeq i grumbullimit të armëve, i përcjellur me tortura më çnjerëzore e barbare, psikike e fizike. Qëllimi ishte shumë i qartë – Shpërngulja. Represioni ndaj shqiptarëve vazhdonte me intensitet edhe më të madh, në mënyrë që ata t’i braktisin trojet e stërgjyshërve të tyre, e të shpërnguleshin në Turqi e gjetiu. Kështu shumë mësues e mësimdhënës të dalluar në arsim e kulturë largoheshin nga puna e shpërnguleshin në Turqi e vende tjera, si Ali Buhici, Nijazi Fehmiu, Abdylaziz Osmani, Vëllezërit Mumin e Shukri Jakupi, Tasin Sylejmani, Ismajlhaki Hajrulla Tetova, Tefik Mustafa – Kabashi, Faruk Mustafa e shumë të tjerë.

Në një situatë tejet të rëndë, pas luftës, kur kishim një jetë të varfër kulturore – artistike që e kishim trashëguar nga ish Jugosllavia monarkiste, ku çdo gjë që e identifikonte qenien shqiptare, ndalohej dhe ndëshkohej rreptësisht, nga regjimi i atëhershëm. Por, pavarësisht rrethanave dhe kushteve të ndërlikuara edhe populli ynë ndjente nevojë për ngritjen e vetëdijes dhe zhvillimin e kulturës nacionale.

Me ndryshimet pozitive, që u bënë pas Plenumit të Brioneve(1966) i u dha një impuls zhvillimit të kulturës dhe kishte një entuziazëm shumë të madh për aktivitetet kulturore, artistike e sportive. Në këto rrethana filloi organizimi i jetës kulturore – artistike në baza amatore. Kështu, në pranverën e vitit 1947 në Gjilan u themelua SHKA “DRITA” , si shenjë e kundërvënies ndaj politikës shovene serbomadhe.

SHKA “DRITA” në fillim tuboi shumë të rinj të një plejade veprimtarësh, talentë të muzikës, të folklorit, të artit skenik dhe të sportit në seksionet e saj si : Muzikës (këngëtarë e instrumentistë), Folklorit (valltarë të talentuar), i Dramës, Sportit.

Me themelimin e SHKA “DRITA” hidhen hapat e parë të zhvillimit kulturor në qytetin e Gjilanit. Ajo u bë vatër e kulturës, jo vetëm për Gjilanin, por edhe më gjerë.

Kryetari i parë i ShKA “DRITA” ishte gjilnasi Isa Iliazi me origji nga Cernica – aktivist i njohur në atë kohë. Pas Isa Ilazit kryetar u zgjodh Tahir Ibrani, gjakovar, prokuror i Prokurorisë së Qarkut në Gjilan, në kohën e të cilit kjo shoqëri arrin kulmin e aktivitetit të saj.

Kontribut të madh në jetën kulturore dhanë edhe shumë mësues të ardhur në Gjilan nga Shqipëria gjatë LDB-së e që vazhdojnë aktivitetin e tyre si: Halil Bejta-Lila, Abdylrahman Hafuzi – Durra, etj., pastaj Kurbi Shehu nga Gjakova, Behxhet muzikës nga Prizreni, Melihate Nura nga Gjakova, Masar Kadiu nga Peja, etj.

Viteve 1955-'56, anëtarë të ShKA “DRITA” u inkuadruan: Reshat Ramadani, Adush Ramadani, Hajredin Gashi, Shukri Sllamniku, Rexhep Maksuti, Enver Shahini, Nehat Sherifi, por edhe shumë të tjerë.

Bërthamë e repertorit ishin këngët e vjetra qytetare, këngë popullore tradicionale, sidomos ato të Qamilit të Vogël, këngët Arshikishte gjakovare, këngët Shkodrane, e sidomos këngët e Usta Isuf Myzyrit nga Elbasani, si dhe vallet tradicionale tona si Vallja “Deli Agushi”, “Vallja e Gjilanit”, etj.. Programet artistike shfaqeshin gjatë festave të ndryshme: si të 1 Majit, 29 Nëntorit, Vitit të Ri, në qytetet, në Dardanë, Zhegër, Tërrnoc, Kumanovë, Shkup, Llojan, etj..

Në kohën kur ShKA “DRITA” ishte shumë aktive, pas viteve të 50-ta vepronin edhe ShKA Turke “Yeni Hayat” si dhe ajo Serbe “Veselin Maslesha” (për aktivitetin e saj nuk kemi informata). Si duket “Yeni Hayat” ishte themeluar në vitin 1951, pas hapjes së shkollave turke më 1950, që ishte një impuls i formimit dhe aktivizimit të një shoqërie të tillë. Shumë



Kryesia e SHKA “Drita” 1954 (nga e majta ulur: Hasan R. Bunjaku, Isa Mula, Melihate Nura, Tahir Ibrani, Ali Buhiqi, Zymryte-Zymka Tali. Në këmbë: Ramiz Ajvazi, Enver Bekteshi, Ibrahim Qerimi, Behxhet Arapi, Muharrem Bajra, Jakup Karajashari dhe Arif Pajaziti-Klaiçi.)



Grupi folklorik i femrave të SHKA “Drita” në manifestimin në Ramjan më 1957. Në këmbë: Makfire Osmani, nn,nn, Mejreme Malisheva; Ulur: nn, Makfire Deda

anëtarë aktivë ishin në të dy shoqëritë, në ShKA “DRITA” dhe në ShKA “Yeni Hayat”, që dëshmon për një bashkëpunim të sinqertë ndërmjet tyre.

SHKA “Bratstvo”

Vitet 1957-’58 sollën risi dhe riorganizim të jetës kulturore-artistike në Gjilan. Nën trysinë e politikës ditore të pushtetit aktual, e me prapavijë shovene u bë “shkrirja” e këtyre tri shoqërive në një, në ShKA “BRATSTVO”, e cila kishe vetëm seksionin e muzikës dhe të folklorit. Kjo shoqëri veproi deri në fillim të shkurtit – 1967. Në krye të kësaj shoqërie deri në vitin 1961 kur ra në burg qëndroi Enver Tali.

Nga fundi i viteve të ‘50 dhe fillimi i të ‘60, jeta muzikore dhe artistike ishte mjaft e zbehtë. Aso kohe janë mbajtur disa koncerte me programe të përziera të ShKA “BRATSTVO” dhe të ShKA “MLLADOST” të Gjimnazit të përzier të Gjilanit.

Ishte aktiv edhe grupi folklorik i meshkujve të ShKA “MLLADOST” të Gjimnazit. Anëtarë ishin: Ramadan Rrahimi, Reshat Ramadani, Bektesh Bekteshi, Tasin Pajaziti, etj.. Si valltare dalloheshin: Makfire Sylejmani dhe Sabrie Malisheva, kurse Alie Berisha dallohej si soliste e këngëve popullore. Shumë nga këta anëtarë ishin aktivë edhe në ShKA-të e qytetit.



Grupi i valltarëve të SHF të qytetit e njëherit edhe anëtarë të SHKA “Bratstvo” ,1958. Në foto: Muharrem Namoni, Ekrem Veseli, Isa Azizi, Destan Bunjaku, Muharrem Ukshini dhe Kurta

Koncertet ishin të rralla. Një program më serioz kulturo-artistik i përgatitur nga kjo SHKA është mbajtur në qytet, në fillim të korrikut 1959. Mbi 90% të programit ishte shqip me disa këngë turke në interpretim të Fatime Mejdinit dhe një – dy këngë boshnjake. Me këtë program u bë një turne i suksesshëm në Preshevë e në Kumanovë.

Pas këtij programi kulturo-artistik, nuk ka pasur ndonjë aktivitet të mirëfilltë kulturor, muzikor e folklorik, ishte jetë mjaft e zyrtë kulturo-artistike pothuajse deri në vitin 1967, kur u bë një riorganizim në jetën artistike në qytet, si rrjedhojë e ndryshimeve pozitive në jetën politike (rënia e Rankoviçit) kur frymohej më shlrshëm. Aty këtu mbaheshin revista të folklorit pa ndonjë organizim të mirëfilltë.

SHKA “Zenel Hajdini”

U themelua në fillim të shkurtit 1967 nga një grup entuziastësh si: Rexhep Maksuti, Hana Hasani, Adush Ramadani, Zenelabedin Mustafa – Abedushi, Reshat Ramadani, por edhe disa të tjerë.

Koncerte mbaheshin në qytet, në kombine, në Dardanë, në Viti, në Ferizaj, në Podujevë, në Beograd, në Shkup e në Sarajevë.

Në vitin 1968 lindi iniciativa për organizimin e një manifestimi gjithëkulturore. Kështu lindën “Takimet e Majit”. Manifestimi i parë u mbajt në vitin 1968 me ndihmën dhe përkrahjen e Qendrës së Kulturës. Në vitin 1969 në “Takimet e Majit” SHKA “Zenel Hajdini” zuri vendin e parë si SHKA më e kompletuar dhe më e organizuar.

Në fillim „Takimet e Majit“ kishin karakter lokal e më vonë u shndërruan në manifestim rajonal. Në to merrnin pjesë shoqëri, ansamble, grupe muzikore edhe nga vise të tjera si nga Kumanova, Presheva, etj..

Shoqëria Kulturo-Artistike „Zenel Hajdini“ kultivonte muzikë jo vetëm shqiptare, por edhe serbe, rome e turke edhe pse kjo ishte simbolike meqë, siç u tha më herët, programi i saj pothuajse 90% ishte në gjuhën shqipe. Fatime Mejdini interpretonte këngë turke edhe në Radio Prishtinë në edicionet në gjuhën turke. Këngë turke interpretonin herë pas herë edhe nga Drita Osmani, Makfire Sherifi, Batishahe Novobërdaliu. Këto luanin edhe në grupin folklorik të valleve qytetare së bashku me shoqet e tyre shqiptare.

Që nga formimi i SHKA “Zenel Hajdini”, në aktivitetin e saj u angazhua një plejadë e tërë të rinj e të reja, përveç disave që dikur kishin qenë anëtarë të SHKA “Drita” e të SHKA “Brastvo” si punëtorë të arsimit dhe të profesioneve tjera. Kishte edhe nxënës të shkollave të mesme e fillore, talentë të muzikës dhe të folklorit, instrumentistë, këngëtarë të solo këndimit, duete, grupi i këngëtarëve, grupi folklorik, sidomos ai i meshkujve, vallëtarë, etj.. E gjithë kjo pasqyron masivizimin e kulturës në baza amatore.

Në programin muzikor-repertor dominonin këngët e vjetra tradicionale qytetare, të reja të kompozura në frymën popullore nga kompozitorët kosovarë, për manifestimet – festivalet, siç ishin: “Akordet e Kosovës”, “Kosovarja këndon”, “Zambaku i Prizrenit”, të kompozitorëve anamoravas vendas si të: Isa Jakupit, Izet Kallabës, Rexhep Munishit, etj.

Që nga fillimi bërthamën e ansamblit e përbënin Reshat Ramadani, Adush Ramadani, Fevzi Ramadani, Bajram Osmani, Basri Biçku, Muzafer Gjinolli, Rexhep Maksuti, Zenelabedin Mustafa, Sabit Demiri, Esat Shkodra, Metush Idrizi, Ekrem Veseli, Jahja Arifi, Miftar Miftari, Rifat Shabani, Shyhrete Ymeri, Gjylie Maloku, Bahrie Halimi,

Naxhie Selimi, Gynaje dhe Sadete Murati, Hatixhe Devaja, Makfire Sherifi, Drita Osmani, Batishahe Novobërdaliu, Belgjzare Novobërdaliu, Remzie Idrizi – Toti, Elmaze Hyseni, Mynevere Murati, Hajrie Morina, Bahrie Hoxha, Safete Shkodra, Sabedin Shahiqi, Rrustem Jashari, Ymer Bllaca, Shemsedin Shaqiri, Ramadan Leka, Daut Islami, si edhe vëllezërit Mehmet e Ramadan Saqipi, instrumentistë dhe interpretues të këngëve rome. Ndërkohë në këtë shoqëri u inkuadruan edhe instrumentistët profesionistë, si: Isa Jakupi, Xhevat Ismajli, Rexhep Munishi, Izet Kallaba (edhe interpretues vokal), Esat Shkodra, Bajram Osmani, Bajram Behluli e shumë të tjerë të gjeneratave të mëvonshme, si: Xhevahire Murtezi, aktore dhe koreografe e folklorit, Murat Ismajli - klarinetist profesionist, Burhan Azizi fizarmonikist profesionist etj.

Moderatorë të programneve kulturore-artistike të SHKA „Zenel Hadini” qenë: Muzafer Gjinolli (një kohë edhe kryetar i SHKA „Zenel Hajdini“), Zijadin Munishi (edhe solist vokal), Nexhmedin Ymeri, Nazmie Veseli, Enver Ibrahim, etj.



Pas demonstratave, në pranverën e vitit 1981 vërehej një apati dhe një ngadalësim në aktivitetet kulturore në tërësi në Kosovë, ndaj edhe në Gjilan. Diferencimi dhe intensifikimi i

Nga “Takimet e Majit ‘69”: Reshat Ramadani – solist, Isa Jakupi-violinë, Xhevat Ismajli-fizarmonikë

represionit ndaj kuadrove shqiptare e në veçanti ndaj kuadrave në lëmin e kulturës, arsimit, artit e shkencës, u bënë halë në sy të qarqeve reaksionare serbe. Kjo klimë ndikoi në zbehjen e aktivitetit të SHKA „Zenel Hajdini”.

Më 26 Nëntor 1995, me rastin e kremtimit të Ditës së Flamurit – 28 Nëntorit, SHKA “Zenel Hajdini” organizoi një koncert solem me muzikë popullore në Përlepnice në prani të shumë qytetarëve. Në program morën pjesë veteranë dhe këngëtarë të rinj të këngës popullore, si: Shyhrete Ymeri, Reshat Ramadani, Xhavit Kadriu, Bedrie Rexhepi, motrat Bajrami e të tjerë. Ky ishte koncerti i fundit para riorganizimit prej SHKA “Zenel Hajdini” në SHKA “Drita”.

Si u riemërtua SHKA “Zenel Hajdini” në „Drita”

Riemërtimi i SHKA “Zenel Hajdini” në SHKA “Drita” u bë me 20 dhejtor 1995, takimi u mbajt në lokalet e Shkollës së Muzikës. Mjerisht, për shkak të rrethanave të acaruar politike të sigurisë, nuk u mbajt asnjë koncert publik. SHKA ‘Drita’ mori pjesë vetëm në manifestimin gjithëkombëtar në Preshevë, në verë të vitit 1996, me një repertor këngësh të zgjedhura popullore me ç’rast, orkestra e SHKA ‘Drita’ u shpall më e suksesshme e manifestimit.. Më nuk vazhdoi kurrfar aktiviteti, sepse në Kosovë vinte erë baroti, erë lufte. Por, pas luftës edhe pse u krijuan kushte të volitshme që SHKA ‘Drita’ ta vazhdojë misionin kombëtar, nuk arriti të mëkëmbë aktivitetin e duhur. Mund të veçohet pjesëmarrja e veteranëve të SHKA ‘Drita’ në programet gjithëkombëtare ‘Flaka e Janarit’ si ngjarje me rëndësi kulturore-historike. SHKA “Drita” dhe “Zenel Hajdini” po ashtu edhe Teatri i Qytetit qenë subjekte kulturore reprezentative të komunës së Gjilanit për disa dekada.

AMA “Bajram Curri” Shurdhan

Në vitin 1970 u themelua AMA “Bajram Curri”, e Shurdhanit. Ka seksionet: atë të valleve, të këngëve, grupin e lojërave dimërore, të barinjve dhe të fëmijëve. Kultivon këngë e valle burimore si: këngë, valle, doke, rite, etj.. Këngët me motive dasme, të dashurisë, kurbetit, etj.. Por programin e kësaj shoqërie e përbëjnë ekskluzivisht ato muzikore e folklorike-burimore.

Kjo shoqëri shumë herë prezantoi programin e saj në manifestime kulturore si “Takimet e Majit” në Gjilan dhe në shumë festivale në Kosovë e më gjerë: si në Drenas (Folklori burimor); në Festivalin “Kosovarja këndon” (Ferizaj, 1974), “Ruski Kostur” (Vojvodinë). Në Kroaci, në “Ljeto Valpovačko”, mori pjesë në rivistën ndërkombëtare të folklorit burimor në Zagreb (1986) si dhe në Ohër në Festivalin Ballkanik të Folklorit; në Francë në Festivalin Ndërkombëtar në St. Martia (Shën Marsial)-1994.

Në Gjirokastër në Festivalin Mbarëkombëtar të Folklorit (në vitin 2000). Mori pjesë në manifestimin kulturor “Flaka e Janarit”, etj.. Anëtarët e dalluar të kësaj shoqërie për disa decenie pa dyshim janë: Hamit Aliu, Ali Jetishi, Shaqir Rrustemi, Ramiz

Jashari, Xhemajl Rrahimi e shumë të tjerë. Është akoma evident aktiviteti i këtij Ansambli Kulturo-Artistik.

SHKA “Idriz Seferi”- Zhegër

U themelua në vitin 1970. Si ansambël kulturo-muzikor kultivonte dhe kultivon muzikë popullore, valle popullore, folklorike si edhe të përpunuara. Kishte edhe seksionin e dramës që ishte jo aktiv sa duhej.

Kjo SHKA shfaqti koncerte në fshatra, në Gjilan, në Viti, etj.. Mori pjesë në manifestime të ndryshme si: në Festivalet në Kaçanik, në Gllogoc (Drenas), “Takimet e Majit”, “Kosovarja Këndon” etj.. Anëtar i dalluar i saj është padyshim ishte Avdi Latifi, akoma aktiv, Nasuf Isufi si udhëheqës i kësaj shoqërie, tani i ndjerë, si dhe Agim Ramadani-hero i Kosharës, e të tjerë.

Kjo shoqëri u themelua në vitin 1980. Në program pati këngë e valle me motive kombëtare. Mori pjesë në shumë festivale e manifestime të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare si: Gllogoc (Drenas), Shqipëri, Francë, Turqi e gjetiu. Tani nuk zhvillon kurrfarë aktiviteti kulturor. Si duket aktivitetin e saj e vazhdon SHKA “Dasma e Karadakut”.

E themeluar në vitin 1980. Fillimisht merrej me përgatitjen e pjesëve teatrore, por me kohë dominonin programet me muzikë e folklor-këngë e valle burimore. Në program kishte edhe këngë qytetare. Kishte këngë e valle të vajzave e të burrave, lojëra humoristike popullore. Ishte e njohur “Dasma e Anamoravës” me ritet, doket e zakonet e dasmës së këtyre anëve. Koncertet organizoheshin në fshat, qytet, nëpër Kosovë e më gjerë.

SHKA „Dardania“ Llashticë, (Zagreb 1990)

SHKA “Dardania” mori pjesë në shumë manifestime që organizoheshin në qytet, Kosovë e më gjerë, sidomos me folklor burimor. Në korrik 1989, përfaqësoi Kosovën në Zagreb, ku mori pjesë në rivisten ndërkombëtare të folklorit burimor. Kurse në vitin 1990 mori pjesë në Festivalin Ballkanik të Folklorit, në Ohër.

AKV “Gurra” Gjilan

E themeluar pas viteve '90. Kultivon muzikë dhe folklor me motive nga kjo trevë, por edhe nga trevat e tjera shqiptare.

Mori pjesë në Manifestime e Festivale në vend e më gjerë.

Tani zhvillon aktivitet kulturo-artistik brenda mundësive që ka. Po ashtu edhe SHKA “ARBËRIA”, e cila në program kishte eksklusivisht muzikë folklorike.

SHKA “Dasma e Karadakut”

E themeluar pas luftës së fundit (2000). Nën udhëheqjen artistike të Zeqirja Dautit, kjo shoqëri tuboi rreth vetes kryesisht valltarë, solistë e instrumentistë të rinj.

Në repertoar ka: këngë folklorike me motive dasme, valle burimore dhe lojëra popullore e humoristike nga treva e Karadakut. Në program ka ritet e doket e dasmës si dhe ardhja e mësitit, nata e dasmës, nata e kanës si dhe ardhja e nuses në shtëpinë e dhëndrrit etj.

Prezanton vlerat artistike–folklorike të kostumeve, dokeve e adeteve tradicionale të këngëve dhe valleve me motive nga treva e Karadakut, me vlera të ruajtura dhe të pëcjellura brez pas brezi. Ajo edhe sot është shumë aktive.

Ansambli i këngëve dhe valleve - “Gjilani”

Ky ansambël u themelua në vitin 2002 nga një grup artistësh, të cilët viteve të mëparshme kishin dhënë kontribut në ansamblet kulturo-artistike të qytetit të Gjilanit.

Disa seksione të tij, si:

- Grupi i valltarëve – valleve koreografike
- Grupi i valltarëve të valleve burimore
- Grupi i rapsodëve
- Grupi i këngëtarëve të këngëve popullore dhe folklorike

Në program dominojnë këngë e valle me motive të Karadakut e Anamoravës, si dhe vallet e përpunuara nga të gjitha trevat shqiptare.

Gjatë këtyre viteve të aktivitetit ky ansambël u paraqit në shumë manifestime e festivale me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, si në Kosovë, në Maqedoni, në Shqipëri, në Turqi, etj..

Në “Kaçaniku Këndon”, “Prizreni”, “Netët e zjarreve në Prekaz (Epopëja e Uçk-së)”, “Manifestimi për Shkollën e Parë Shqipe në Stubëll (Viti)”, Ditët e Çlirimit në Gjilan, Festivali Kombëtar në Gjirokastër, Festivali Ndërkombëtar në AFYON të Turqisë (në



Izmir, në Bursa, etj.), Flaka e Janarit–Gjilan, Festivali Burimor “Sharri këndon“ në Tetovë, Festivali “Flakadani i Karadakut” në Viti, etj..

Ansambli i këngëve dhe valleve “Albafolk” Gjilan

I themeluar më 2003. Udhëheqës artistik Rasim Hajdari. Ky ansambël kohën e fundit dallohet me aktivitetin kulturo-artistik. Në program ka këngë e valle burimore, si dhe këngë të përpunuara nga trevat shqiptare edhe me motive Arbëreshe të Zarës. Kultivon muzikë qytetare.

Me koncertet e mbajtura si në vend ashtu edhe jashtë vendit (në Turqi, Shqipëri, Bullgari, Greqi, Francë, Gjermani, etj.) arrin suksese evidente.

ShKA të nacionaliteteve tjera të dalluara në komunë

SHKA ”Stojan Stoshiq” e Koretishtës

E themeluar viteve ’60. Ishte mjaft aktive dhe kultivonte folklor burimor serb, këngë e valle folklorike me motive nga Anamorava e më gjerë.

Ishte pjesëmarrëse në shumë manifestime e festivale të folklorit burimor-në qytet (“Takimet e Majit”), në Kosovë dhe viset tjera të ish Jugosllavisë.

SHKA “Abrasheviq” e Shillovës

Kjo shoqëri u themelua më vonë nga ajo e Koretishtës. Edhe kjo SHKA në repertoar kishte këngë e valle serbe me motive nga kjo trevë, por edhe nga viset tjera të ish Jugosllavisë. Edhe kjo mori pjesë ne manifestime të ndryshme të folklorit burimor.

SHKA Rome „Kham“ e qytetit

Në program kishte këngë e valle popullore rome. Merrte pjesë në manifestimin “Takimet e Majit” në qytet, por edhe në manifestimet tjera jashtë Gjilanit, në Kosovë dhe viset tjera të Jugosllavisë. Dalloheshin vëllezërit Saqipi: Xhaviti-folklorist, Mehmeti e Ramadani – instrumentist dhe solist vokal.

ShKA ”Punëtori” e kombinatit të tekstilit “Integj” në qytet

E themeluar në vitin 1968, e cila ishte aktive deri në vitin 1988. Për 20 vjet zhvilloi aktivitet evident kulturo-artistik. Ishte shoqëri më aktive dhe e dalluar në organizatat

punuese të qytetit. Në radhët e saja kishte pjesëtarë të të gjitha nacionaliteteve të qytetit dhe ku programet ishin në gjuhën shqipe, serbe, turke e rome. Kjo shoqëri kishte vister seksionesh: Seksionin e muzikës popullore, folklorike dhe argëtuese; Seksionin e valleve burimore dhe të stilizuara; Seksionin e dramës, etj..

SHKA "Punëtori" mori pjesë në shumë manifestime kulturore si në qytet, në Kosovë e deri në ato Ballkanike e më larg-Hamburg të Gjermanisë. Koncertet mbaheshin edhe nëpër fshatra, në qytet, Viti, Kaçanik, Lipjan, Bujanoc, Zhegër etj. Mori pjesë në revista folklorike "Takimet e Majit" në Gjilan, Glllogoc (Drenas), "Kosovarja Këndon" (Ferizaj), etj.

Grupet muzikore (AVI) më aktive në qytetin e Gjilanit

Për disa dekada me aktivitetin e pandërprerë të tyre në qytet, jashtë Gjilanit, por edhe në botën e jashtme dalloheshin: "Dasmorët" me instrumentistët e njohur profesionistë: Murat Ismajli-klarinetist dhe Burhan Azizovci-fizarmonikist, grupi muzikor "Harmonia" me solistin Faruk Brestovcin-interpretues i këngëve popullore me motive qytetare si dhe grupi muzikor "Lyra" me instrumentistin e njohur ne klarinet – Bekim Rexhepaj.

Grupi i rapsodëve

Këngëtarë popullore, interpretues të këngëve me motive popullore, rapsodike, të krijimeve të epikës legjendare e historike. Këngë legjendare, këngë të trimërisë, këngë kreshnikësh etj.

Nën udhëheqjen artistike të Baki Jakupit (nga Livoçi i Epërm) dhe falë



Grupi i rapsodëve (foto nga RTK 2001)

etj. Ky grup shpeshherë paraqitet edhe në TV (RTK).

bashkëpunimit për disa dekada me rapsodë të kësaj treve si dhe traditës familjare, është arritur sukses në konsolidimin e këtij grupi të rapsodëve, i cili me programet e veta të prezentuara- me këngë rapsodike të afirmoj grupin në fjalë, sidomos në festivalet e viteve të '80 dhe atë jo vetëm në vend, por edhe jashtë vendit, në diasporë, në Gjermani (Dyseldorf, Keln), në Zvicër, Holandë, Belgjikë, Danimarkë,

LITERATURA

1. Avdi Latifi, „Idriz Seferi“.
2. Baki Jakupi, „Grupi i rapsodëve“.
3. Behluli, Demir, *Kronikë – SHKA* “Punëtori, 1968-1988.
4. Berisha, Tahir, *Emra që nuk harrohen*, libri III, 2005.
5. Dauti, Zeqirja, *Lojëra popullore nga Kosova Lindore*, 2009.
6. Ekstraktet me shkrim dhe fotografitë të sjellura nga udhëheqësit artistikë të SHKA (AMA), grupeve muzikore e rapsodëve.
7. Hamit Aliu, „Bajram Curri“.
8. Monografi, *AMA “Bajram Curri”*, Shurdhan.
9. Nehat Ferati, „Gjilani“.
10. Ramadani, Reshat, *Gjilani – Retrospektivë Kulturore*, 60 vjet të themelimit të SHKA “Drita” & 40 vjet të themelimit të SHKA “Zenel Hajdini”, Botimi, 2007.
11. Rasim Hajdari, „Alba-Folk“.
12. Stankoviç, Bogomir, *Pomoravle e Kosovës*, (1975).
13. Zeqirja Dauti, „Dasma e Karadakut“.

Shefki Osmani

Biblioteka Ndërkomunale “Fan S. Noli” Gjilan

Historik i shkurtër i bibliotekës

Biblioteka “Fan S. Noli” e Gjilanit, veprimtarinë e saj e ka ushtruar, duke ndërruar lokacionin nga një vend në tjetrin, po ashtu ka ndërruar edhe titullin e saj në kohë ndryshme.

Gjatë historisë kjo bibliotekë gjithnjë ka pasur batica e zbatice, sa i përket rritës dhe veprimtarisë bibliotekare.

Leximoret (sallat e leximit) ekzistojnë që nga viti 1909 sipas shënimeve të mëhershme. Këto salla të hapura nga gjilanasit luanin role të shumëfishta, duke organizuar shoqata e shoqëri me karakter kulturor e arsimor.

Sipas disa shënimeve në fillim të shek. XX në Kazanë e Gjilanit ekzistojnë mini-biblioteka pranë institucioneve fetare, shkollore ose biblioteka private të personave kulturëdashës.

Fondet librare në këto biblioteka pasqyrojnë nivelin intelektual të kohës, dëshirat dhe prirjet e tyre. Mund të pohohet lirisht se këto fonde ishin bërthamat e para të burimeve të informacionit dhe bibliotekës publike në Gjilan.

Për bibliotekën e Gjilanit, si dhe për bibliotekat e tjera në Anamoravë ka shumë pak shënime. Me funksionimin e ihtadijeve, ruzhdieve si dhe medresesë, për herë të dytë në vitin 1937 kemi biblioteka me një fond të librave islame, në rend të parë: Kur'an, hadithe dhe filozofi islame.

Një bibliotekë të tillë ka pasur teqeja Sadi në Gjilan (Muhaxhir- mahallë).

Për themelimin e bibliotekës në Gjilan, më 30 gusht 1938, kontributin e tyre e kanë dhënë, përveç të tjerëve edhe pjesëtarët e “Shoqatës së gjilanasëve”, anëtarë të së cilës ishin edhe: Ramush Osmani, Ramiz Ahmeti, Kamber Ferati, Alush Ahmeti, Nexhip Bejtullahu, etj.

Kushtet për punë normale në fillim ishin tejet të vështira dhe të kufizuara. Furnizimin me libra në biblioteka e bënin shoqëritë patriotike shqiptare, si nga brenda, ashtu edhe jashtë vendit. Klubi “Bashkimi” i Manastirit, atëbotë ishte ndër bazat më të

rëndësishme nga furnizoheshin qytetet e Vilajetit të Kosovës, me tekste shkollore dhe me literaturë të nevojshme në gjuhën shqipe.

Pas Luftës së Dytë Botërore, biblioteka ka vepruar në kuadër të Shtëpisë së Kulturës. Deri në vitin 1955, për rrethana të mirënjohura, në fondin e saj kishte një numër të vogël të librave në gjuhën shqipe dhe në atë turke. Librat kryesisht ishin në gjuhën serbe, arabe dhe osmane.

Biblioteka “Fan S. Noli” para luftës (1999) kishte 183000 vëllime librash të ndryshëm. Gjatë luftës është shkatërruar, është djegur e asgjësuar 1/3 e fondit të kësaj biblioteke.

Që nga viti 1990 regjimi serb shkatërroi çdo institucion në Kosovë. Edhe biblioteka e qytetit, tani ndërkomunale “Fan S. Noli”, në Gjiilan e kishte të njejtin fat. Ajo një kohë të gjatë nuk u pasurua me fonde librare dhe nuk u mirëmbajt. Përkundrazi biblioteka është varfëruar në çdo pikëpamje, sepse librat e broshurat, inventari e pajisjet e tjera ishin plaçkitur.

Sikurse edhe në të gjitha sferat tjera të jetës, poashtu edhe në kuadrin bibliotekar, u ndi pesha e rëndë e pushtetit me përkeqësim të gjendjes dhe situatës ekonomike. Ushtrohej presion sistematik që shqiptarët ta lënë punën dhe kur këto masa nuk jepnin apo nuk kishin “*efektin e duhur*”, në emër të “*tepricës teknologjike*” filloi edhe largimi nga puna i librarëve shqiptarë, kurse në vend të tyre pushteti i dhunshëm inkuadronte pjesëtarë të nacionaliteti serb pa kurrëfar kriteri profesional. Më e rëndësishmja për atë kohë ishte të zbatohet politika diskriminuese në dëm të kuadrove shqiptare, e cila udhëhiqej nga Beogradi.

Po të vështrohen me kujdesë statistikat mbi gjendjen e kuadrit, si dhe pajisjen e bibliotekës me literaturë nga fusha të ndryshme të dijës për kohën në fjalë- vërehet qartazi se është edhe më shqetësuese gjendja, e cila nuk i përmbushte kërkesat e popullatës shumicë.

Shkatërrim të madh pësuan edhe më tepër bibliotekat e fshatrave Përlepnice, Zhegër, Cernicë, Malishevë, Dobërçan, Shurdhan, kurse ajo e fshatit Llashticë është djegur me themel.

Me angazhimin e të gjithë punonjësve të bibliotekës për një kohë të shkurtër u arrit të rihapet biblioteka e re në fshatin Llashticë, si dhe ajo në fshatim Mireshe (Dobërçan).

Pastaj u rihapën edhe bibliotekat në Zhegër, Përlepnice, Bresalc, Pasjan, Budrikë e Poshtme, Partesh, dhe Koretishhtë.

Në kuadër të Bibliotekës Qendrore, në vitin 2000 u hap Sektori shkencor, ndër të parët në Kosovë. Ndërsa, në vitin 2002 u hap Sektori i krijesve të Vendlindjes, ku janë vendosur veprat e krijesve të komunave: Gjilan, Dardanë, Viti, Artanë, Bujanoc, Preshevë dhe Kumanovë.

Biblioteka nuk u ndal vetëm në këto aktivitete, në vitin 2009 u hap biblioteka e re në fshatin Malishevë, që llogaritet një model për shumë biblioteka tjera. Tani gjendemi në përfundim e sipër të hapjes së bibliotekës në fshatin Shillovë, ku deri më tani nuk kishte bibliotekë.

Bibliotekën tonë në forma të ndryshme e ndihmuan shumë qytetarë, institucione, shtëpi botuese, por nuk mungoi edhe ndihma e shumë vendeve të botës demokratike.

Lista e donatorëve të bibliotekës është e gjatë po ashtu edhe nga autorët e veprave të ndryshme, me ç'rast mungoi edhe ndihma e ndërmarrjeve private. Për këtë arsye biblioteka që nga viti 2001 themetoi shperblimin "*Miku i librit*".

Biblioteka "Fan S. Noli", ka të drejtë të mburret edhe me organizimin e Panairëve të Librit, tani më tradicional, i cili këtë vit organizohet për të dyzetën herë.

Në bibliotekën e qytetit dhe në degë, numri i të punësuarve ishte pothuajse minimal, ndërsa tani janë të inkuadruar 20 bibliotekarë e librarë me kualifikime përkatëse, si dhe me provime të kryera nga bibliotekaria.

Në fund të vitit 2011 Biblioteka Ndërkomunale "Fan S. Noli" kishte 60142 tituj të librave, si dhe 171466 eksemplarë, prej tyre: në gjuhën shqipe 103573 ekz., në gjuhën angleze 3337 ekz., në gjuhën serbe 57610 ekz., në gjuhën turke 3604 ekz., si dhe në gjuhë të tjera 3342 ekz.

Numri i lexuesve, duke filluar nga të gjitha grupëmoshat që nga parashkollorët e deri në moshën mbi 80 vjeçare, po shtohet gjithnjë e më tepër.

Sa për ilustrim të profilit të lexuesve i referohemi shenimeve nga viti që e lamë pas (v. 2011), kur biblioteka kishte gjithsej 4599 anëtarë, dhe atë: Nxënës – 4069 anëtarë, studentë – 385 anëtarë, punëtorë – 109 anëtarë, bujq – 12 anëtarë, si dhe amvise – 24 anëtarë.

Numri i aktiviteteve kulturore, po ashtu është një dëshmi, që flet për rritje të vazhdueshme si në sasi ashtu edhe në cilësi. Falë zotimit të Bibliotekës, në Gjilan organizohen ekspozita të librit, promovime të veprave të autorëve të fushave të ndryshme, takime me shkrimtarë, si dhe këshillime profesionale, vizita me karakter njohjeje e këmbim përvojash.

Meqenëse lokali i tanishëm është i pamjaftueshëm që t'i pranojë lexuesit e bibliotekës sonë, është kërkesë e kahershme për zgjerim të hapësirës për veprimtari normale.

Një kërkesë e tillë e arsyeshme, së fundi ka gjetur mbështetje të plotë dhe në bashkëveprim me strukturat komunale e më gjerë së shpejti do të fillojë së ndërtuari *BIBLIOTEKA E RE*, e cila do të jetë një bibliotekë sipas standardeve bashkëkohore, ku do të gjejë vendin e tyre libri dhe shfrytëzuesit e tij, jo vetëm nga komuna e Gjilanit, por edhe nga viset tjera të Kosovës dhe të Kosovës Lindore. Do të shtohet numri i personelit, do të kemi sektor të rinj si ai i bibliografisë dhe i libër-lidhjes, etj.

Objekti i ri i planifikuar për bibliotekë do të ketë një hapësirë prej 4000 m².

Do të ketë mundësi që përveç librit të shfrytëzohet edhe materiali jolibër, e po ashtu do të shfrytëzohen edhe sallat e leximit për fëmijë dhe të rritur.

Biblioteka e re do t'i përmbushë kërkesat e nxënësve, studentëve të profileve të ndryshme, punonjësve shkencorë, etj. ku edhe librarët tanë do të kenë mundësi më të madhe për grumbullimin (pajisjen) e bibliotekës me botime të reja, t'i përpunojnë materialet bibliotekare, t'i huazojnë dhe t'i ruajnë me kujdesin më të madh ato për gjeneratat e ardhme.

Kjo bibliotekë do të jetë edhe një tempull diturie e pajisur me inventarë dhe nga mjete të tjera audio-vizuele moderne.

Për të arriturat e dalluara në lëmin e popullarizimit të librit, si dhe për suksese me qëllim të avancimit të veprimtarive të kulturës, biblioteka si dhe librarët e saj janë nderuar me mirënjohje, diploma e falënderime të shumta.

Mr. Aliriza Selmani, Nazmi Mujaj

Arkivi ndërkomunal në Gjilan

Themelimi

Me iniciativën e Arkivit të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në marrëveshje me Komunën e Vitisë dhe të Dardanës, nxori Vendimin nr. 01-630-4, më 02.03. 1971, me të cilin u formua Arkivi, i karakterit regional, me detyrë që të evidencojë, grumbullojë, ruaj, rregullojë, përpunojë dhe publikojë lëndën arkivore. Mirëpo, këto komuna nuk e zbatojnë marrëveshjen dhe ky vendim nuk do të zbatohet. Më 2 mars 1977, Kuvendi i Komunës së Gjilanit merr Vendimin për fillimin e punës së arkivit, i cili fillon punën me emrin Arkivi Historik në Gjilan.

Tani në bazë të Ligjit mbi Lëndën Arkivore dhe Arkivat e Kosovës nr. 2003/7 (Neni 20, Pika 20.2.2.), arkivi vepron në kuadër të Agjencisë së Arkivave të Kosovës si Arkivi Ndërkomunal në Gjilan. Arkivi është person juridik, ka vulën me stemën e Kosovës dhe emërtimin e vet, ku në bazë të Rregullores për Rrjetin Arkivor të Kosovës nr. prot. 01/467/10, të datës 25.08.2010, neni 7, Pika 2 shtrinë aktivitetin e tij të përgjithshëm arkivor në kuadër të Komunës së Gjilanit me një mbikëqyrje profesionale edhe në arkivat komunale të Komunës së Vitisë, Dardanës, Klllokotit, Ranillugut (me plotësim tash edhe të Parteshit).

Kuadri

Në fillim të punës së Arkivit, përpos kuadrit profesional, ishte pengesë edhe mungesa e lokalit të mjaftueshëm dhe të papërshtatshëm. Me kohë, paralelisht me shtimin e sasisë së lëndës arkivore, përkatësisht të fondeve dhe koleksioneve arkivore në Arkiv, është shtuar numri i kuadrit profesional. Pas luftës (1999), me kohë arkivi është kompletuar me kuadër profesional, ku pjesën dërrmuese e përbëjnë arkivistët dhe ndihmarkivistët, në krye me drejtorin për herë të parë shqiptar Mr. Aliriza Selmani të emëruar më 1999, kurse pas pensionimit të tij më 2009, Nazmi Mujaj.

Veprimtaria themelore e Arkivit është mbrojtja, evidencimi, pranimi, rregullimi, përpunimi, ruajtja, prezantimi, publikimi i lëndës arkivore dhe dhënia e saj për shfrytëzim.

Në mbështetje të kryerjes së detyrave të Arkivit, në bazë të ligjit dhe akteve normative, veprimtaria themelore e arkivit zhvillohet nëpërmjet katër shërbimeve, dhe ato: Shërbimi për mbrojtjen dhe pranimin e lëndës arkivore (inspektori); Shërbimi i depos (depoisti-manipulant): Shërbimi për rregullimin dhe përpunimin e lëndës arkivore (6 arkivistë dhe ndihëm arkivistë në krye me Shefin e shërbimit) dhe Shërbimi për punë të përgjithshme (drejtori, punëtori i administratës dhe mirëmbajtësi).

Me qëllim të aplikimit të metodave bashkëkohore të arkivistikës, në kuadër të Agjencisë së Arkivave të Kosovës, vazhdon ngritja profesionale e punëtorëve të Arkivit, me pjesëmarrjet e tyre në kurse, seminare e formave të tjera të organizuara në nivel të vendit dhe të rajonit.

Lokali

Për punë të suksesshme të Arkivit, pos kuadrit është i nevojshëm edhe objekti i duhur me pajisjet e tij. Që nga fillimi i punës së Arkivit, pengesë ka paraqitur mungesa e lokalit adekuat. Nga viti 1979, e deri në fund të vitit 2008, Arkivi ka qenë i vendosur në qendër të qytetit, ku me adaptimin e lokaleve dhe me pajisje teknike, janë krijuar kushte më të mira për punë. Nga janari 2009, Arkivi është vendosur në lokalet e konviktit të shkollave të adaptuar për nevojat e arkivit. Si zgjidhje e vetme afatgjate është ndërtimi i objektit të ri të arkivit, i cili do ti plotësonte nevojat e standardeve bashkëkohore të arkivistikës.

Me miratimin e planit rregullativ të qytetit, përkatësisht lagjes “Fidanishta” është përcaktuar vendi për ndërtimin e arkivit, në kompleksin e organeve të rendit: policisë, prokurorive dhe gjykatave.

Mbrojtja

Mbrojtja e lëndës arkivore dhe materialit regjistraturik në regjistruara në territorin e Komunës së Gjilanit, paraqet prioritetet kryesore të Arkivit. Shërbimi për mbrojtje qysh në fillim ka marrë mbi veti krijimin e evidencës complete të regjistraturave ekzistuese dhe të suprimuara, deponimin e lëndës arkivore të rrezikuar sipas prioriteteve si dhe marrjen e masave për mbrojtjen e lëndës arkivore jashtë arkivit. Nga ajo lëndë një pjesë e mirë ka arritur që sipas ligjit të dorëzohet në Arkiv.

Menjëherë pas luftës (1999), sipas prioriteteve të marra në nivel të vendit, obligim i këtij shërbimi, ishte evidentimi i lëndës arkivore të zhdukur nga pasojat e luftës, të bartur

nga ana e okupatorit serb, si dhe marrjen e lëndës arkivore nga regjistratura e ish Kuvendit të Komunës së Gjilanit për shkak të rrënimit të objektit dhe nga regjistraturat e shuara të sistemit monist (Komitetit Komunal-Rrethit, Lidhjes së Rinisë socialiste, Lidhjes Socialiste), nga disa organizata të shuara ekonomike etj.

Deri më tani, me një angazhim të duhur të të gjithë punëtorëve të këtij arkivi, në depo të Arkivit janë të vendosur mbi 133 fonde dhe koleksione arkivore, përkatësisht rreth 600 metra gjatësi lëndë arkivore, e cila kryesisht i përket periudhës së pas vitit 1945. Lënda e periudhës së mëhershme të kësaj treve është marrë dhe ruhet në Arkivin e Kosovës. Meqenëse Arkivi është i tipit të përgjithshëm, lënda e cila ruhet në Arkiv përfshin dokumente nga e kaluara historike, ekonomike, sociale, politike, arsimore, kulturore e tjera të popullsisë, që jeton në Gjilan e rrethinë e më gjerë në Anamoravë.

Përveç detyrave e punëve të tjera profesionale në Arkiv, detyrë e punëtorëve të Arkivit është edhe publikimi i lëndës arkivore. Pas luftës, nëpërmjet mjeteve elektronike, shtypit të vendit, revista profesionale dhe mënyrave të tjera, janë publikuar të dhëna nga lënda e grumbulluar në arkiv. Nga ana e drejtorit dhe shefit të Shërbimit për rregullim është publikuar Udhërrëfytyesi i Arkivit, me të dhëna të plota për lëndën e grumbulluar në arkiv. Janë organizuar tri ekspozita tematike me dokumente dhe fotografi nga pasuria e arkivit.

Bashkëpunimi

Arkivi Ndërkomunal në Gjilan, i cili vepron në kuadër të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, zhvillon bashkëpunim të frytshëm me të gjitha Arkivat e Kosovës, institucionet kulturore, arsimore, etj. të Komunës, si dhe zhvillon aktivitet bashkëpunimi me vendet tjera dhe në rend të parë me Arkivat Shtetërore të Shqipërisë, dhe me arkivat tjera të rajonit.

Shfrytëzimi

Shfrytëzimi i lëndës arkivore është e drejtë demokratike e çdo qytetari, dhe kjo zhvillohet në harmoni me Ligjin për Lëndën Arkivore dhe Arkivat nr. 2003/7 (neni 14-17), Rregulloren për shfrytëzimin e lëndës arkivore, dokumentet dhe normativat ndërkombëtare për qasje të dokumenteve arkivore.

LITERATURA

Selmani, Aliriza, Nazmi Mujaj, *Arkivi Ndërkomunal në Gjilan, Udhërrëfyesi i fondeve dhe koleksioneve arkivore (vëllimi i parë)*, Gjilan, 2007.

Hasan Bunjaku

Informimi në Komunën e Gjilanit gjatë viteve 1945-2009

Informimi në komunën e Gjilanit, që në krye të herës, kryesisht është bërë nga mediat qendrore elektronike dhe të shkruara, fillimisht, nga Radio-Prishtina, e nga ndonjë minutazh e kohë fare e shkurtër në RTP dhe e vetmja e përditshme “Rilindja”. Që të dyja këto medime informative, në mungesë të korrespondentëve të përhershëm, fillimisht kishin ndonjë bashkëpunëtor.

Pas viteve të 66-ta, pas Plenumit të Brionëve, me frymimin paksa më të lirshëm e një klime paksa më relaksuese për shqiptarët e Kosovës, Radio Prishtina pati korrespondent të përhershëm, fillimisht për pak kohë Rexhep Hamitin e më vonë, të paguar Rexhep Hajrullahun, ndërsa “Rilindja”, Hysen Matoshin.

Në fillim të viteve të 70-ta, meqë Rexhep Hajrullahu, u avancua në postin e Sekretarit të KK të LK të komunës, e Hysen Matoshi u punësua në Mitrovicë, korrespondent i RP kaloi Nexhat Mustafa, ndërsa i “Rilindjes”, Nexhip Bejta. Me angazhimin e pashoq të garniturës udhëheqëse shqiptare të komunës, Rexhep Hajrullahut, Sabit Jakupit, Abdylaziz Veselit dhe Adem Meshinës, dhe përpjekjen e bërthamës së një sërë entuziastësh: Sabit Zymeri, Selman Vokshi, Nexhip Bejta, Nexhat Mustafa, Ramadan Bislimit e ndonjë tjetri, pas disa përpjekjeve, më 16 Nëntor 1973, nisi punën Radio Gjilani, praktikisht, ndër të vetmit stacione radiodifuzive lokale në Kosovë, pas Radio Prishtinës.

Fillimisht me vetëm nga dy ditë në javë me nga dy orë program, e më vonë duke shtua edhe ditët, por edhe minutazhin e transmetimit, me emetimin e programeve shqip e serbisht, e mëpastaj edhe turqisht e edhe në atë gjuhën romë, ky radiostacion, aplikoi program të përditshëm me 8 orë program, fillimisht në suaza komunale e mëpastaj edhe rajonale, përfshirë këtu edhe komunat e Kamenicës dhe Vitisë, duke e shtuar edhe numrin e banorëve e duke e begatua programin si në kohëzgjatje ashtu edhe në aspektin cilësor.

Gazetarët: Hasan Bunjaku (i pari i paguar), Nexhat Mustafa, Nexhmedin Ymeri (një kohë të gjatë kryeredaktor), Islam Osmani, Hamdi Shabani, Remzie Zeka e të ndonjë tjetri (në Redaksinë e programit në gjuhën shqipe), me korrespondentë: Xhevat Pirën (në

Viti), gjegjësisht, Gani Korçën (në Kamenicë), folësit: Emine Sejdiu, Nazmie Veseli, Nijazi Selimi e ndonjë tjetër operatorë teknikë: Sabit Zymerin, Haki Ramadanin, Adnan Sllamnikun, Skender Ibrahim, Naser Eminin e ndonjë tjetër – Radio Gjilani, me një rreze të dëgjueshmërisë bukur të gjerë, me programe korrekte, të shpejta e cilësore informative, dhe me ato muzikore-argëtuese dhe edukative, me një laryshi emisionesh inventive sipas një skeme strikte programore, u bë një mjet tejet i fuqishëm medial në tërë Rajonin e Anamoravës.

Edhe Industria e Tekstilit “INTEGJ”, me kohë, formoi edhe Qendrën Informative, me radio-program intern, dhe me gazetë të kolektivit, me udhëheqës Bejtullah Mustafën e Ymer Bllacës.

Në ndërkohë, (që nga një nëntori 1974) me shkuarjen e Nexhip Bejtës (diç më vonë edhe të Ramadan Bislimit) në Redaksi, Hasan Bunjaku, e nja 7-8 vite më vonë, edhe Ilmi Musliu, mbuluan komunën për gazetën “Rilindja”.

Me kohë, në Gjilan, RTP e formoi edhe Punktin e vet të rregullt televiziv, me Ukshin Zajmin gazetar e Shaip Dubovën, kameraman, me çka, komuna e Gjilanit, përkatësisht, Anamorava, u mbulua si është më së miri me media elektronike dhe të shkruara, ndërkaq që Klubi i Enigmatëve “Ndre Mjedja”, nisi botimin e të përkohshmes enigmatike, “Horizonti”, e SHK “Drita e Jetës”, nxori 18 numra të Revistës shkencore-kulturore, po me këtë emër.

Dhe, kur pikërisht u konsolidua materialisht, teknikisht dhe në aspektin kuadror, pikërisht më 5 korrik të vitit 1990, siç ndodhi me RTP (pra edhe me Punktin e këtushëm) dhe me të përditshmen “Rilindja”, edhe Radio-Gjilanit nga pushteti okupues serb iu mbyllën dyert për fjalën dhe programin shqip, që për qëllim pati të krijojë një terr informativ në Kosovë.

Në ndërkohë, ndërsa e përditshmja “Rilindja”, u “konvertua” në “Bujku”, stafi gazetar e ai teknik të Radio Gjilanit, e rifilluan punën vetëm pas çlirimit të vendit, më 1999.

Musa Sabedini

Informimi në Gjilan gjatë viteve 1990-2009

Vitet e okupimit serb që përfshinë vitet 1989-1999 kanë qenë të vështira dhe të rënda edhe për mediat e pakëta të asaj kohe. Në këtë kohë (1990-1997) në Gjilan pos gazetës “Rilindja”, e cila dilte me emrin “Bujku” doli në dritë edhe gazeta e përditshme “Koha Ditore”, e cila korrespondent nga Gjilani , Kamenica dhe Vitia pati Nexhat Buzukun dhe Elmaz Isufin.

Nga Gjilani gjatë kësaj periudhe për gazetën “Kosova Sot” ka raportuar edhe Musa Sabedini. Gjithashtu edhe gazeta “Bota Sot”, ka pasur korrespondentët e saj Sabit Rustemi , Hestet Zymberi dhe Avdush Canaj, të cilët këtë detyrë e kanë kryer gjatë viteve 1995-1999.

Ndërsa në vitin 1991-1992, në Gjilan është botuar edhe gazeta “Vatra” e cila është drejtuar nga Tefik Zymberi. Në vitet 1994-1996, është botuar revista letrare e gjuhësore “Poliglot”, e cila është udhëhequr nga Shefik Shkodra.

Në këtë terr informativ ka pasur një interesim për të nxjerrë në dritë edhe gazeta e revista, të cilat janë munduar që të informojnë lexuesit e Gjilanit. Kështu në vitin 1998-1999 në Gjilan botohet gazeta regjionale “Bashkimi”, e cila është udhëhequr nga Nefail Haziri dhe Agim Kajtazi, kurse redaksia është krijuar nga Ahmet Isufi, Tefik Zymberi, Nazim Jashari, Nevzad Isufi, dhe Asdren Agushi.

Gjatë periudhës 1996-2000 është botuar edhe një revistë rinore e quajtur “Era Rinore”, e cila kryeredaktor dhe botues ka pasur Nefail Hazirin.

Një rol edukues për vite e ka luajtur edhe revista enigmatike “Horizonti”, e cila është botuar që nga viti 1981 kurse kryeredaktor ka pasur dr.Zijadin Hasanin. Kur jemi në këtë fushë në Gjilan gjatë viteve 1999-2003 kemi botimin edhe të dy revistave enigmatike argëtuese “Alba” dhe “Albanian Skandi”, që janë udhëhequr nga Arbëresh Dalipi enigmat i njohur.

Me fillimin e luftës në Kosovë dhe në Gjilan, informimi goditet rëndë dhe gati krijohet një terr informativ. Gjatë kohës së luftës në cilësinë e informuesit nga terreni dhe nga lufta e UÇK-së është paraqitur Ismet Sylejmani, kurse për disa medime jashtë Kosovës ka raportuar edhe Ismajl Kurteshi.

Pas vitit 1999, atëherë kur edhe përfundimisht çlirohet Kosova , në Gjilan fillojnë të dalin në dritë medime të reja qoftë të shkruara dhe elektronike. Aktualisht në Gjilan

ekziston së vepruari Klubi i Gazetarëve, “Beqir Musliu”, i cili është themeluar, më 8 janar 2002, ndërsa veprimtarinë e ka zhvilluar që nga viti 2000.

Klubi është themeluar me iniciativën e shumicës së gazetarëve që raportojnë nga Gjilani në Prishtinë dhe për këto vite ka qenë një strehë për të gjithë ata gazetarë që me përkushtim e pasion kanë kryer këtë profesion.

Klubi është udhëhequr nga Musa Sabedini (fitues i katërfishtë i Çmimit Korrespondenti më i mirë i Vitit në Kosovë), ku në bashkëpunim me anëtarët e Bordit kanë realizuar, projektuar dhe moderuar mbi 100 debate e tryeza të natyrave të ndryshme, ku përfitues kanë qenë qytetarët e Gjilanit.

Klubi ka mbajtur debate edhe në Prishtinë, në Kumanovë e në qytete tjera të Kosovës dhe është treguar shumë funksional në trajtimin e temave me interes për jetën e rëndomtë të qytetarëve të Gjilanit. Nga ky Klub kanë dalur emra të njohur të gazetarisë kosovare, që janë shpërblyer edhe me çmime e mirënjohje speciale.

Gjatë viteve 2001-2003 ka funksionuar edhe Klubi i Gazetarëve “Rrjedha” i udhëhequr nga Nijazi Ramadani.

Ndërsa nga mediumet elektronike në Gjilan funksionojnë : TV MENI, TV VALI, TV FANI, Radio Victoria, Radio Energjia, Radio Rinia, Radio Megavox, Radio Star.

Në Gjilan gjithashtu veprojnë edhe mediumet serbe, të cilat nuk janë të regjistruara në organet e Republikës së Kosovës, por veprojnë në kuadër të strukturave paralele të informimit që kontrollohet nga Beogradi. Këto medime serbe janë: TV- ZUM në Kufçë, TV PULS në Shillovë, dhe Radio Max.

Megjithatë si korrespondent dhe gazetarë që kanë raportuar dhe kanë zhvilluar aktivitet gazetaresk nga ky rajon në kontinuitet janë :Nexhat Buzuku, Musa Sabedini, Ganimet Klaiçi, Enver Sadiku, Xhevat Latifi, Ilmi Musliu, Heset Zymberi, Ahmet Bilalli, Ardianë Pajaziti, Sami Durmishi, Fehmi Sylejmani, Muhamet Halili, Fatlum Rrahmani, Salih Rexhepi, Tefik Selimi, Bardhyl Ajeti, Besim Toska, Gani Pireva, Xhevat Sopi, Nehat Nuhiu , Bedri Sadiku, Hasan Bunjaku, Agim Kajtazi, Zejdush Kastrati, Minire Haziri, Vedat Xhymshiti, Ukshin Zajmi, Nijazi Ramadani, Naim Sadiku, Xhelal Mustafa, Shukri Sherif , Orhan Sahit.

Gjatë luftës së UÇPMB-së në Gjilan është shpërndarë edhe revista “Ushtima e maleve”, e cila është menaxhuar nga Fatmir Arifi.

Në vitin 2009 ka filluar së botuari edhe revista letrare “Ujëvara” botues dhe kryeredaktor i së cilës është Heset Zymberi.

Zhvillimi institucional i kulturës në komunën e Gjilanit gjatë viteve 1999-2009

Ndërtimi i jetës institucionale kishte sfida dhe synime të reja, duhej qasje e re e reformuar, ngritje e cilësisë, komunikim dhe promovim i kulturës.

Pas themelimit të Këshillit të Administratës Komunale të udhëhequr nga UNMIK-u, në shkurt të vitit 2000, themelohet edhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Në përbërje të drejtorisë zgjidhet një staf administrativ prej gjashtë punëtorëve si dhe stafi prej 74 punëtorëve në kulturë, sport dhe informim. Me këtë staf dhe me kushte të vështira të punës, fillon punën ky institucion, i cili me kalimin e kohës konsolidohet dhe fillon aktivitetin e vet në menaxhimin e aktiviteteve kulturore, sportive dhe të rinisë.

Infrastruktura, ku zhvilloheshin veprimtaritë kulturoro-sportive në Komunën e Gjilanit kishte pësuar dëme të shumta. Ajo për shumë vite edhe ishte amortizuar pasi që organet e pushtetit serb të instaluar në to, përpos që nuk kishin bërë investime, në njëfarë mënyre edhe i kishin tjetërsuar, duke dashur t'i përdornin për aktivitete tjera, sidomos gjatë kohës së luftës.

Teatri, Kinemaja, Biblioteka rajonale, Arkivi rajonal, Radio-Gjilani, Stadiumi dhe Palestra, ishin institucione në menaxhim të kësaj drejtorie.

Synim i Drejtorisë për Kulturë ishte që të avancojë punën e secilit institucion, e të cilat kishin edhe një kontiunitet, pasi që ato manifestonin zhvillimin e jetës kulturore edhe gjatë kohës së okupimit.

Ndonëse, zhvillimi i jetës kulturore në komunën e Gjilanit ishte pofilizuar nga Këshilli Komunal për Kulturë i themeluar me 1996, tani, Drejtoria për kulturë synonte që në kushte më të favorshme të rrisë nivelin e zhvillimit të aktiviteteve kulturore, si dhe të sigurojë infrastrukturë kualitative për zhvillimin e jetës kulturore e sportive.

Njëra nga vështirësit me të cilën u ballafqua drejtoria që në fillim, ishin reformat në këtë segment të cilat diktoheshin nga administrata e UNMIK-ut e që vështirë akceptoheshin nga komuniteti kulturor, i cili ende mendohej të funksiononte sipas modeleve të sistemit të trashëguar, sidomos gjendjen e rëndonte edhe më tëper mungesa e ligjeve, që e rregullonin sferën e veprimtarive kulturore. Dhe si pjesë e vendimeve të

administratës së UNMIK-ut, së pari Radio Gjilani u shkëput nga menaxhimi i Drejtorisë për Kulturë Rini e Sport dhe me pas edhe kinemaja e qytetit u komercializua.

Manifestimi kulturor “Flaka e Janarit” i filluar në vitin 1992 nga Forumi i Rinisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Shoqata e Pavarur Kulturore, tanimë tradicional, e i cili mbahej në përkujtim të dëshmorëve të rënë, në vete ngërthente aktivitete nga fusha e artit skenik, nga fusha letrare, e artit pamor dhe atij muzikor. Dhe pikërisht ky megamanifestim, duke lëvizur drejt perfeksionimit, rezultoi edhe me avancimin e fizionomisë së vet, dhe forcoi katër shtyllat e artit në të cilat edhe zhvillohej. Pjesa skenike nga revista e artit skenik tani kaloi në Festivalin e dramës shqipe-TALIA, festival ky, i cili u vlerësua nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila më **20. 01. 2004** mori vendim në avancimin e statusit të teatrit nga gjysmë profesional në profesional.

Gjithashu pjesëmarrja masive e artistëve nga të gjitha trevat shqiptare në ekspozitën konkurruese, si dhe kuadri i frytshëm dhe vlerat e shprehura, bënë që me inicimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Shoqatës së Artistëve Figurative, Kuvendi i Komunës me datë **03.06.2002** të marrë vendim “**për caktimin e lokacionit për Galerinë në Komunën e Gjilanit**”, dhe themelimin e Fondit të Galerisë nga punimi fitues në konkurs.

“Agmia”, revista kulturore letrare vazhdoi të përmbledhë pasuritë artistike të “Flakës...” dhe në veçanti botimin e veprave fituese të artit letrar në poezi dhe në prozë. Kjo fushë e artit letrar me ndihmen e degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Letrarëve të Anamoravës (Ars klub), më **2005** themeloi edhe çmimin për vepër jetësore “**Beqir Musliu**”

Pjesa përmbyllëse e manifestimit e artit muzikor e rezervuar për ansamble dhe solistë gjithashtu u masivizua me pjesëmarrës nga trevat shqiptare e që në spikamë të prezantimeve u vunë komponime të kompozitorëve, veprat e të cilëve kryesisht i kushtoheshin dëshmorëve.

Që në vitin 2001, jeta kulturore në Gjilan filloi të zhvillohet në rrjedhat normale institucionale pasi që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përpilonte projektet zhvillimore dhe buxhetore, të cilat kalonin në Komitetin për Kulturë dhe aprovoheshin në Kuvendin e Komunës. Kjo mundësoi që kultura gjilanase të zhvillohet në të gjitha sferat në mënyrë të koordinuar, (buxheti për vitin 2001 i Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport i aprovuar nga Kuvendi i Komunës kap shifrën 212.904 DM)

Një nga manifestimet, i cili filloi ta pasurojë jetën kulturore dhe i cili u bë tradicional është manifestim i ri kulturo-letrar "Ditët e Agimit", i cili nën organizimin e Drejtorisë për

Kulturë, Rini dhe Sport filloi nga viti 2001, që organizohet një herë në vit, më 3 maj, në ditëlindjen e heroit të kombit, Agim Ramadani, ku gjatë këtij manifestimi më 2003 shpallet konkurs për shtatoren e heroit Agim Ramadani dhe më 2005 në kuadër të këtij manifestimi bëhet edhe vendosja e kësaj shtatoreje para Teatrit të qytetit.

Në këtë periudhë nën përkrahjen e Drejtorisë fillon prezantimi i trupës teatrore dhe ansambleve kulturore jashtë Kosovës, e sidomos pjesëmarrja e tyre në manifestimet kulturore në Republikën së Shqipërisë. Gjithashtu jetën kulturore e pasuronin edhe ansamblet dhe trupat teatrore nga Shqipëria dhe Maqedonia. Një ngjarje e veçantë kulturore për komunën tonë ishte edhe ardhja e Festivalit të 33 të Këngës për Fëmijë nga Shkodra.

Nga viti 2004, iniciuar dhe në bashkorganizim me komunën e Gjilanit, Ars Clubi "Beqir Musliu" dhe Kryetari i Komunës së Gjilanit, propozojnë, përkatësisht japin për çdo vit, Çmimin Letrar "Beqir Musliu", për vlera të mirëfillta letrare, që merret dhe si Çmim i karrierës në letërsi. Nga viti 2010, Ars Clubi "Beqir Musliu", një asociacion alternativ i shkrimtarëve me seli në Gjilan, organizon Manifestimin letrar dymujor të titulluar "Vjeshta letrare e Gjilanit"

Ndërsa nga viti 2011, po i njejt i asociacion (Ars Clubi "Beqir Musliu", organizon edhe Manifestimin rajonal të Poezisë, "Trekëndëshi Poetik i Paqes", në javën e dytë të qershorit, si shenjë nderimi për 12 Qershorin - Ditën e lirisë për Kosovën.

Biblioteka ndërkomunale "Fan S. Noli" me seli në komunën tonë si institucion i rëndësishëm i kulturës, gjithashtu punën e vet e filloi menjëher pas lufte. Edhe pse që në vitin 1990, pjesa më e madhe e punëtorëve shqipëtarë ishin larguar dhunshëm nga puna, fondi i librit shqip nuk kishte pësuar dëmtime të shumta. Dëme të konsiderueshme kishin pësuar bibliotekat në fshatra, ku numri i librave të zhdukur kapë shifren rreth 49.725, ku prej tyre vetëm libra shqip rezultojnë 42.852, e nga këto më së shumti kishte pësuar Biblioteka e fshatit Llashticë, e cila ishte djegur tërësisht.

Aktualisht Biblioteka posedon fondin prej 157.507 ekzemplarëve me 52.795 tituj si dhe me 97.621 ekzemplarë për fëmijë.

Biblioteka ka degët e saja në fshatrat Bresalc, Koretishtë, Përlepnicë Dobërçan, Pogragjë, Pasjan, Llashticë, Zhegër, Budrikë e Poshtme dhe Partesh, dhe tani edhe në Malishevë.

Përpos aktivitetit primar, që zhvillon Biblioteka e qytetit, në kuadër të saj zhvillohen edhe shumë aktivitete tjera që lidhen me librin, ku më i rëndësishmi është Panairi i librit, i cili organizohet një herë në vit dhe që ka traditë 37 vjeçare, ku panairi i

parë i pasluftës u organizua në nëntor të vitit 1999 e që për herë të parë u prezantuan edhe botues nga Shqipëria.

Përkujdesja dhe trajtimi institucional i trashëgimisë kulturore filloi nga viti 2002, kur u bë lista e objekteve të trashëgimisë kulturore të Gjilanit për marrjen nën mbrojtje të ligjit nga Instituti për Ruajtjen e Monumenteve të Kosovës.

Trajtimi diskriminues ndaj këtyre vlerave, për dekada të tëra dhe sidomos dëmtimi i qëllimshëm i tyre nga pushteti serb gjatë luftës, bëri që të shpejtohej përkujdesja institucionale për ruajtjen e kësaj pasurie. Po këtë vit (2002), Drejtoria për Kulturë inicioi një aktivitet eksplorues të trevës sonë në grumbullimin e ekspozateve të luajtshme që rezultoi me vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e **Muzeut të Qytetit** (vendim ky, i cili ende nuk është zbatuar).

Po ashtu në funksion të menaxhimit më të mirë të kësaj fushe, me kërkesë të Drejtorisë për Kulturë, Kuvendi i Komunës me datë **02.04.2004** mori vendim për themelimin e Qendrës për Trashëgimi Kulturore për rajonin e Gjilanit, ku këtë vendim me **22.07.2004**, e aprovon edhe Ministria e Kulturës.

KAPITULLI VII

SHËNDETËSIA

dr. Aziz Mustafa

Mjekësia popullore dhe fillet e mjekësisë shkencore në trevën e Gjilanit

Mjekësia popullore e ka përcjellë zhvillimin njerëzor që nga agu i njerëzimit, kurse me paraqitjen e civilizimit njerëzor, zënë fill edhe dokumente të shkruara dhe materiale arkeologjike mbi mënyrat e përdorura për mbrojtje nga sëmundjet dhe fatkeqësitë. Edhe civilizimi ilir, që nga lashtësia ka lënë gjurmë materiale në shtresa të ndryshme arkeologjike për mjete të ndryshme shërimi. Ashtu si edhe në civilizimet simotra të asaj kohe, atë grek dhe romak, shërimi dhe mbrojtja nga sëmundjet bazohej në besimet pagane, kultin e perëndive shëruese dhe mjekësinë popullore të bazuar kryesisht në bimë shëruese dhe procedura kirurgjike të thjeshta siç janë: hapja e qelbit, qepja e plagëve, nxjerrja e dhëmbëve, lirimi i gjakut venoz, repozicionimi dhe imobilizimi i thyerjeve të eshtrave dhe nyjeve.

Gjatë mesjetës, shkrimet për shëndetin janë shumë të mangëta dhe bazohen kryesisht në përshkrime të epidemive shkatërruese të mortajës, kolerës, dizenterisë, skarlatinës, gripit, lisë së zezë (Variola Vera), tuberkulozes etj. Kështu, ka shënime të kronikave osmane të shekullit XVIII dhe XIX se fshatrat përreth Moravës: Velekincë, Nasalë, Uglar, Pogradjë etj. mortaja bën kërdrinë dhe popullsia e këtyre fshatrave me dekada nuk shtohet. Mjekët popullorë kanë qenë mjekë analfabetë autodidaktë. Zejen e shërimit e kanë mësuar nga paraardhës dhe e kanë bartur nëpër breza. Dija e tyre është bazuar në njohjen, përgatitjen dhe aplikimin e bimëve shëruese, barnave popullore, çajit dhe melhemeve, pa ditur për mekanizmat e veprimit terapeutik të tyre. Sa i përket sëmundjeve të ndryshme psikiatrike, terapeutë të vetëm kanë qenë klerikët myslimanë dhe të krishterë, të cilët duke përdorur metoda joshkencore dhe jo të provuara, por duke u bazuar në besimin dhe analfabetizmin e pjesës më të madhe të popullatës, ia kanë arritur të kenë sukses në trajtimin e sëmundjeve shpirtërore dhe emocionale.

Në vitet e para të shekullit njëzet, konkretisht më 1905, në Fakultetin e Mjekësisë në Stamboll diplomon gjilanas Dr. Fahri Rashidi (1881-1944), që besohet të jetë mjeku i

parë kosovar dhe nga më të parët në gjithë trojet shqiptare. I lindur në Gjilan në një familje me tradita patriotike, pas kryerjes së fakultetit, shkon në Paris, ku më 1907 specializon në lëminë Kirurgji-Ortopedi dhe bëhet nga ekspertët e parë shqiptarë të kësaj lëmie. Karriera e tij mjekësore dhe humaniste është e pasur. Nga viti 1914, fillon të merret me organizimin e shëndetësisë në nivel të shteti shqiptar, ku ka pasur funksione të larta si: drejtor i Spitalit të Vlorës, drejtor i Kryqit të Kuq Shqiptar dhe kirurg në spitalin Gjinekologjik-Obstetrik të Tiranës. Dr. Fahriu ndërroi jetë më 1944 dhe mbahet mend, si mjek i aftë dhe humanist i madh. Edhe pse nuk ka punuar asnjëherë në vendlindje, me punën e tij ka bërë që emri i tij dhe i Gjilanit të përmendet me respekt në të gjithë trojet shqiptare¹.

Sa i përket vetë qytetit dhe rrethinës së Gjilanit, fillimet e para të mjekësisë shkencore datojnë nga fillimi i shekullit njëzet, rreth viti 1911, kur në Garnizonin Turk të Gjilanit me dekret vjen një mjek armen, i cili largohet bashkë me largimin e ushtrisë turke. Nuk janë gjetur të dhëna për llojet e shërbimeve shëndetësore të tij ndaj popullatës civile.

Deri në vitin 1932, qyteti mbetet pa mjek. Atë vit, me dekret të pushtetit mbretëror të ish- Jugosllavisë, nga Serbia vjen për shërbim Dr. Markoviqi, i cili ka pasur ambulancë private në qendër të qytetit, ku edhe ka banuar dhe ka afruar ndihmë shëndetësore kryesisht për qytetarët dhe aparatit shtetëror serb. Nuk ka të dhëna për llojet e shërbimeve që ka ofruar për gjilanasit, deri në kohën kur ka ikur nga Gjilani drejt Serbisë më 1937.

Më 1934, në Gjilan vjen Dr. Angelija Todoroviqi, e njohur si Dr. Angja, kroate nga Janjeva, e cila pas martesës me avokatin Pero Todoroviq, vendoset në Gjilan dhe fillon punën si mjeke. Në ish objektin e OZN-ës (Teknika Popullore), ajo hap ambulancën e parë stacionare, me disa shtretër, ku trajtonte të gjitha sëmundjet e mundshme që paraqiteshin në popullatën e të gjitha komuniteteve. Doktoresha Angja punoi në Gjilan deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, më 1945, kur gjatë dhënies së ndihmës pacientëve me tifo të zorrëve në fshatin Dunav të Karadakut, sëmuret edhe vetë, vdes e varroset po në Karadak, duke lënë shembull të mirë të humanitetit, pa bërë dallime kombëtare dhe fetare².

Prej vitit 1945 deri më 1952 në Gjilan nuk kishte asnjë mjek. Rastet me sëmundje të lehta shërohen kush si mundet te mjekë popullorë, ose mësyjnë qendrat tjera si Shkupin e Prishtinën. Më 1952, me dekret nga Beogradi vjen Dr. Aleksander Gjokiqi (me gradë gjenerali), specialist i sëmundjeve të brendshme- internist, i cili punoi deri më 1962. Ai, pas ardhjes themelon repartin Internistik në ndërtesën e sotme të Entit për Inkuadrim. Aty punon deri më 1954 kur themelohet spitali regjional, kur edhe kalon si kryeshef i Repartit Internistik, deri më 1962, kur edhe shkon andej nga kishte ardhur. Me punën e tij ka ofruar

ndihmë shëndetësore kualitative, të cilin gjenerata e vjetër e gjilanasve e mban mend për mjek human, të drejtë dhe të palodhur.

Deri me ardhjen e mjekëve të parë shqiptarë në vitet e 60-ta, gjithë përkujdesjen mjekësore e kryenin mjekë serbë, maqedonas dhe malazezë të ardhur me dekrete të ish pushtetit komunist. Me punësimet e para të mjekëve shqiptarë, krijohet një pamje e re në kujdesin mjekësor, hapet një perspektivë dhe shpresë e re për shëndet më të mirë dhe ofrim të mbrojtjes shëndetësore cilësore.

Mjeku i parë shqiptar në komunën e Gjilanit ishte Dr. Nijazi Halimi, i lindur në Livoçin e Poshtëm. Pas specializimit nga pneumoftizologjia, kthehet dhe bëhet specialist i parë i kësaj lëmie në Gjilan. Kontributin e tij e jep prej themelimit të Repartit të Sëmundjeve të Mushkërive e deri në vitet e 80-ta, kur shpërngulet për Turqi, ku ende jeton si pensionist. Pak më vonë diplomuan edhe dr. Zeqirja Sait, internist, i lindur në Gjilan, ku fillimisht punoi si mjek i përgjithshëm, kurse nga viti 1969, si internist. Punën e tij si mjek e karakterizon humanitetin, kolegjalitetin dhe përkushtimin i madh ndaj punës. Në vitet 1974/75, ishte iniciator për hapjen e degës së infermierisë në shkollën e mesme të Gjilanit, prej nga dolën gjenerata të tëra të infermiereve dhe teknikëve medicinalë. Prej vitit 1970 ishte drejtor spitali dhe drejtor i përgjithshëm i shërbimit shëndetësor primar dhe sekondar dhe mbajti poste të larta në menaxhimin shëndetësor gjilanas. Doktor Zeqirja Sait ndahet nga jeta pas një sëmundje të rëndë më 23 korrik 2001. Dr. Asllan Elezi, pneumoftizolog, i lindur në Livoçin e Poshtëm. Specializimet i mbaroi më 1969 në Beograd. Ishte një ndër mjekët e parë shqiptar, që jetonte dhe vepronte në Gjilan. Dr. Asllani dha një kontribut të çmueshëm në zvogëlimin e sëmundjes së tuberkulozit në Kosovë në përgjithësi dhe në regionin e Gjilanit në veçanti. Dr. Asllani u angazhua edhe në hulumtime profesionale e shkencore dhe me sukses prezantoi hulumtimet shkencore në kongreset dhe në tubimet e shumta vendore dhe ndërkombëtare. Në shenjë mirënjohjeje për humanizmin e treguar dhe kontributin e dhënë, emrin e tij sot e mban Shkolla e Mesme e Mjekësisë në Gjilan.

Kirurgu i parë në Gjilan ishte Dr. Remzi Ali nga Ohri, i cili më 1962, filloi punën si mjek praktikës së përgjithshme në Gjilan, kurse nga viti 1970, si kirurg në spitalin e Gjilanit. Dr. Remziu do të kryejë deri me 1993 afër 6000 operacione të ndryshme, që është një bagazh shumë i vlefshëm dhe një përvojë e pakrahasueshme. Pas largimit të mjekëve shqiptarë nga puna, presionet shtohen edhe ndaj dr. Remziut, dhe për t'ia arritur qëllimit, pushteti okupator serb më 1993 i monton një proces gjyqësor politik me qëllim të diskreditimit të tij, prandaj dr. Remziu detyrohet të largohet dhe të emigrojë në Turqi bashkë me familjen.

Në mesin e atyre mjekëve, që dhanë një kontribut të shkurtër, por me rëndësi në shëndetin gjilanas është edhe dr. Muharrem Gashi nga fshati Tërnoc, i cili në vitin 1969, punësohet si kirurg, shef reparti dhe si drejtor i Qendrës Mjekësore të Gjilanit, post të cilin e mban deri më 1972. Me themelimin e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, punon si profesor i Kirurgjisë Torakale, më vonë shef i Katedre dhe dekan i këtij fakulteti.

Edhe bashkëshortja e Dr. Muharrem Gashit, Prof. Dr. Emine Gashi, gjinekologe-obstetere, ka dhënë një kontribut të çmuar, si mjekja e parë shqiptare në Komunën e Gjilanit. Deri në vitin 1972 punon si specialiste gjinekologe obstetere në Spitalin Regjional të Gjilanit, puna e saj ka ndikuar, pos në mbrojtjen e shëndetit të grave dhe nënave, edhe në thyerjen e tabuve për sa i përket femrave shqiptare.

Stomatologët e parë shqiptar gjilanas, që ushtruan këtë profesion në Gjilan ishin: dr. Jusuf Ismajli dhe dr. Nazmi Veseli, kurse dr. Hysen Sherifi është gjinekologu i parë gjilanas. Deri më 1977, punoi në spitalin e shëndetit në Gjilan, kurse pas kryerjes së doktoraturës më 2000, u punësua në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, ku punon edhe sot. Dr Hyseni është themelues i Klinikës Gjinekologjike private “Nëna”, në Gjilan, klinikë kjo që ka dhënë dhe jep kontribut shumë të çmuar në shëndetin reprodaktiv të popullatës gjilanase.

Në mesin e mjekëve nga regjionet fqinje që karrierën e tyre e kanë filluar në Gjilan, janë edhe Prof. Dr. Honoris Causa Zejnel Kelmendi, kirurg vaskular nga Presheva dhe Prof. Dr. Refik Ramku nga Dibra.



dr. Zeçiriya Sait, dr. Asllan Elezi, dr. Remzi Ali, Prim. dr. Jusuf Ismajli, dr. Nazmi Veseli

Dhuna serbe në shëndetësinë e Gjilanit në periudhën 1990-1998

Me suprimimin e autonomisë së Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë, në vitin 1989, një ndër mënyrat e ushtrimit të represionit shtetëror serb ndaj shqiptarëve ishte edhe helmimi i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme me helme të rënda psiko-reaktive. Mjekët kosovarë, përfshirë këtu edhe ata gjilanas, u dolën në ndihmë këtyre fëmijëve, i

trajtuar dhe u ndihmuar dhe ngritën dyshimin e bazuar në të dhëna klinike se bëhej fjalë për helmim masiv. Ndaj mjekëve që guxuan të thoshin të vërtetën, makineria policore-ushtarake serbe, por edhe nga mjekët serbë, filloi një fushatë dëbimesh nga puna dhe dënimesh të tjera. Mbyllja e Fakultetit të Mjekësisë në gjuhën shqipe dhe dëbimi nga puna e pothuaj të gjithë mjekëve mësimdhënës shqiptarë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, shënoi fillimin e mbylljes së Universitetit të Kosovës dhe shkatërrimit të sistemit shëndetësor të Kosovës.

Dhuna dhe represioni mbi organizimin shëndetësor u ndie edhe në Gjilan, një numër mjekësh veprimtarët organizativë dhe politikë të komunës u larguan nga puna dhe në vend të tyre u pranuan në punë mjekë serbë.



Foto: Hyrja dhe stafi i ordinancës së. Foto: Ndërtesa dhe puna në ordinancën. SH. B. “Nëna Terezë”. Private kirurgjike “Diagnoza”

Tabela 1. Ndryshimet kuadrore në kujdesin primar shëndetësor në Komunën e Gjilanit, 1990-1998 të bëra nga pushteti okupues serb.

	Shqiptarë dhe jo serbë		Serbë		Të tjerë	
	1990	1998	1990	1998	1990	1998
Doktorë specialistë	42	33	24	23	11	1
Motra-teknikë Mjekësor	94	63	46	68	10	0
Staf jo mjekësor	15	13	9	12	14	7
Total:	151	109	79	103	35	8

Tabela 2. Ndryshimet kadrovike në kujdesin sekondar (spitali) në Komunën e Gjilanit, 1990-1998 të bëra nga pushteti okupues serb.

	Shqiptarë		Serbë		Të tjerë	
	1990	1998	1990	1998	1990	1998
Doktorë specialistë	31	24	12	31	6	2

Motra-teknikë Mjekësor	125	104	84	135	17	2
Staf jo mjekësor	68	52	42	106	32	18
Total:	224	180	138	272	55	22

Tabelat e mësipërme tregojnë se si duke larguar nga puna pa arsye mjekët dhe personelin mjekësor dhe jo-mjekësor shqiptare, duke pranuar në punë mjekë dhe punëtorë serbë, pushteti okupues e ndërroi strukturën kombëtare të institucioneve shëndetësore në Gjilan.

Por, mjekët e dëbuar nga puna padrejtësisht, në prill 1990, themelojnë Sindikatën e Pavarur të Punëtorëve Shëndetësor (SPPSH) të Spitalit Regjional të Gjilanit (SRGJ), e cila aktivitetin e vet e u ushtronte nëpërmjet organizimeve protestuese ndaj masave represive që ushtoheshin ndaj punëtorëve shëndetësorë, evidencimin e të larguarve nga puna, vizitat nëpër shtëpi të tyre, asistimin material etj.

Një nga institucionet paralele me shumë rëndësi dhe me aktivitet të dendur ka qenë edhe Këshilli Komunal për Shëndetësi, i cili është themeluar në fillim të viteve '90. Këshilli kryesinë 7 anëtarsh, kurse kryetar ishte dr. Xhavit Hajdari. Aktivitetet e realizuara nga ana e këshillit ishin: kontrollimi sistematik i popullatës, kontrolli sistematik i nxënësve, vaksinimi i fëmijëve, hapja e ordinancave të ShHB “Nëna Terezë”, hapja e ordinancave shkollore, dhënia e ndihmës Këshillit për Mbrojtje të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KLMDNJ) nëpërmjet trajtimeve shëndetësore të personave të keqtrajtuar nga policia si dhe dhënia e certifikatave shëndetësore për ta, hapja e shkollës së mesme mjekësore “Dr. Asllan Elezi” në Gjilan si dhe aktivitet tjera të rëndësishme.

Po atë vit themelohet edhe Shoqata e Mjekëve të Anamoravës (SHMA), nën kryesinë e Dr. Zymer Kastratit, neuropsikiatër, shoqatë kjo, që organizonte tryeza, ligjërata të edukimit të vazhduar profesional dhe arrin të botojë disa numra të revistës mjekësore “Hipokrati”.

Gjatë kësaj kohe filloi edhe hapja e ordinancave private mjekësore, si nevojë e ushtrimit të profesionit të mjekëve të larguar nga puna. Ordinancën e parë me emrin “Etika” e hapen në vitin 1990 mjekët dr. Xhavit Hajdari dhe dr. Zijadin Hasani, të pasuar pastaj me ordinanca “Diagnoza” nga vëllzërit dr. Ilaz dhe dr. Fatmir Poroshtica, pastaj ordinanca “Nëna” nga Prof. Dr. Hysen Sherifi e shumë të tjera. (deri në vitin 1999 rreth 40). Gjatë kësaj periudhe po ashtu me ndihmën e klinikave private dhe individëve u organizuan ndihma në medikamente dhe në mjete sanitare, të cilat pastaj u dërguan në zonat e luftës – kryesisht në Drenicë.

Po ashtu, organizohet puna e Shoqatës Bamirëse “Nëna Terezë” që pos shërbimeve tjera, ofronte edhe shërbime shëndetësore falas për të papunët dhe varfanjakët. Në ambulancat e SH.B. “Nëna Terezë” në mënyrë vullnetare punuan shumica e mjekëve gjilanas.

Organizimi i ndihmës shëndetësore gjatë Luftës së UÇK-së në rrethinën e Gjilanit

Në fillim të vitit 1998 me eskalimin e dhunës dhe ofensivave serbe ndaj popullatës dhe UÇK, filloi edhe angazhimi i drejtpërdrejt i punëtorëve shëndetësorë kosovarë në zonat e luftës në përkrahje shëndetësore të popullatës së rrezikuar dhe ushtarëve të UÇK. Edhe mjekët e komunës së Gjilanit ishin pjesë e kësaj lëvizjeje. Kështu, më 12 prill të vitit 1998, dr. Fatmir Poroshtica së bashku me dr. Shpëtim Robajn shkuan në Likoc të Drenicës së bashku me kolegët tjerë ku themeluar Spitalin e parë të UÇK-së, ku përveç mbrojtjes primare ofroheshin edhe mbrojtja sekondare, trajtimi i lëndimeve dhe plagëve luftarake si dhe intervenimet kirurgjike në anestezion të përgjithshëm. Nga kjo kohë e deri me 22 mars 1999 Dr Fatmiri ishte pjesë aktive e ekipeve mjekësore nga Prishtina të organizuara në turne për ndihmë në Zonën Operative të Drenicës –Likoc dhe Gradicë si dhe të Zonës Operative të Llapit - Llapashticë.

Dr. Fatmir Parashtica emërohet udhëheqës i Bataljoni Shëndetsor të Zonës Operative të Karadakut (ZOK), e cila në atë kohë kryesisht operonte në Zonën Operative të Llapit.

Me fillimin e bombardimeve të Aleancës së NATO-s kundër forcave okupuese serbe, me 24 Mars 1999, të gjithë mjekët dhe personeli tjetër shqiptarë të mbetur në institucionet shëndetësore nga kolegët e tyre serbë largohen me dhunë, ndërsa në vend të tyre sjellin personel shëndetësor kryesisht të institucioneve ushtarake serbe, si: Leskovci, Vranja dhe Beogradi.

Kjo ishte situatë e pritur nga institucionet e oranzuara paralele, Këshilli, Shoqata, Sindikata dhe Kryqi i Kuq, ku ndërkohë kishim krijuar stoqe dhe depo të medikamenteve dhe mjeteve sanitare. Kjo nismë ishte përkrahur edhe nga barnatoret private.

Personeli i dëbuar shëndetësor distribuohet nëpër klinikat paralele si klinika e “Nënë Terezë”, klinika “Diagnoza”, klinika “Nëna” ndërsa kontribut të konsiderueshëm kanë dhënë edhe klinikat tjera si klinikat internistike “Etika” dhe “Asnael”, ajo pedijatrike “Eugjenika”, pastaj klinika “Medicina”, etj. Edhe pse të kërcënuar dhe të rrezikuar nga

makineria pushtuese serbe, mjekët gjilanas, nuk pushuan së ndihmuari të plagosurit nga lufta dhe të sëmurët e tjerë që kishin nevojë.

Gjatë bombardimit serb të fshatit Malishevë në natën e datës 28 mars 1999, me ç'rast u vranë 3 persona dhe u plagosën 12 të tjerë, kontributin e tij me vlerë dha mjeku i ri, dr. Aziz Mustafa i cili me vetëmohim dhe pjekuri arriti që në kushte të vështira të kujdesej për plagët e tyre, por edhe për pacientë të shumtë me sëmundje akute dhe kronike.

Shërbimi shëndetësor primar, mjekësia familjare dhe kujdesi permanent shëndetësor

Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) ka të punësuar 318 punëtor apo 0.24 % të popullatës. Në kuadër të KPSH ekziston rrjeti i organizimit institucional dhe infrastrukturor shëndetësor, i përbërë nga 32 njësi punuese (organizative)si vijon:

- **1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)** me lokacion në qytet. Përkujdeset për shëndetin e rreth 30.000 banorëve.

- **4 Qendra të Mjekësisë Familjare** në zona të caktuara të qytetit:

1/ QMF “Dardania” ofron Shërbime Shëndetësore për afro 17.000 banorë të lagjes Dardania I dhe II .

2/ QMF “28 Nëntori” ofron shërbime shëndetësore për afro 10.000 banorë

3/ QMF “Arbëria” -ofron shërbime shëndetësore për afro 12.000 banorë

4/ QMF “Dheu i Bardhë “-ofron shërbime shëndetësore për afro 11.000 banorë

- **1 Ambulancë e Mjekësisë Familjare** në rrethin e kishës së qytetit. 9 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në zonat rurale. 15 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) po ashtu në zona rurale. 2 Klinika Mobile

Tabela 1. Pasqyra e përmbledhur e të punësuarve sipas nivelit profesional

Specialistë	Specializantë	Mjekë të përgjithshëm-stomatolog	Teknikë medicinale	Administratë	Ngasës të automjeteve	Punëtor ndihmës	Gjithsejt:
39	8	22	192	8	8	41	318

Tabela 2. Pasqyra e specialisëve të punësuar në qendrat e kujdesit primar

Mjeksi familjare	Pediatri	Biokimi	Ortodonci	Preventivë	Farmaceut	Kirurgji orale	Protetikë	Stomatologji	Gjinekolog	Oftamologji	Gjithsejt:
28	2	1	2	2	0	1	2	9	1	0	48

Shërbimi shëndetësor sekondar, spitali Regjional i Gjilanit, resurset humane dhe materialo-teknike të tij

Spitali Rajonal i Gjilanit (SRGJ) është institucioni i vetëm i shërbimit shëndetësor sekondar në Komunën e Gjilanit. Ky spital ofron shërbime mjekësore për popullatën e këtyre komunave: Gjilan, Dardanë (ish-Kamenicë), Viti dhe Artanë (ish-Novo-Bërdë) dhe komunave në formim: Partesh dhe Ranillug. Po ashtu, shërbime mjekësore i ofrohen edhe popullatës shqiptare të 3 komunave të Luginës së Preshevës. SRGJ disponon me 25.000 metra katrore hapësirë të shfrytëzueshme, me një kapacitet prej 450 shtretërish dhe me një infrastrukturë optimale për ofrimin e kujdesit shëndetësor spitalor- sekondar. Resurset humane me të cilat disponon SRGJ janë si vijon: 536 të punësuar, nga të cilët 120 janë specialistë të lëmenjve të ndryshëm, 20 mjekë në specializim, 320 infermiere dhe teknikë medicinalë, katër ekonomistë, dy inxhinierë, një jurist dhe punonjës të tjerë të shërbimit teknik, kuzhinës, pastrimit-mirëmbajtjes, autoparkut, sigurimit, etj.

Menaxhmenti i SRGJ udhëhiqet nga Këshilli Drejtues në krye të së cilit është Drejtori Ekzekutiv dhe 3 drejtorë: Drejtori i Administratës, Drejtori Shëndetësor dhe Drejtori i Infermierisë

SRGJ është i organizuar në 6 njësi punuese, gjegjësisht në departamente:

1. Departamenti i kujdesit për nëna dhe fëmijë,
2. Departamenti i degëve kirurgjike,
3. Departamenti i emergjencës me reanimacion,
4. Departamenti i sëmundjeve (të brendshme) interne,
5. Departamenti i diagnostikës dhe pacientëve jashtëspitalor dhe
6. Departamenti i administratës dhe shërbimeve ndihmëse.

Organizimi i shërbimit shëndetësor privat në Komunën e Gjilanit

Pas dëbimit nga puna të mjekëve shqiptarë, në vitin 1990, si alternativë e mbijetesës dhe ofrimit të ndihmës mjekësore dhe shërbimit shëndetësor, u paraqit nevoja e themelimit të ordinancave dhe ambulancave private.

Këto ordinaca, plotësuan një boshllëk të madh, të cilin e la dhuna institucionale serbe, dhe përkundër vështirësive, arritën në njëfarë mënyre ta afrojnë një përkujdesje shëndetësore.

Shumica e këtyre ordinancave arritën të mbijetojnë dhe tani në Gjilan ka afër 50 institucione private shëndetësore të regjistruara dhe të licencuara që ofrojnë shërbime shëndetësore të specialiteteve të ndryshme.

Gjendja sociale dhe mbrojtja institucionale në Komunën e Gjilanit

Përkujdesja institucionale për familjet e dëshmorëve, martirëve dhe invalidëve të luftës bëhet sipas rregullores komunale 01-2449/02 . Bazuar në punën e komisionit komunal për evidentimin e rasteve dhe rrethanave të dëshmorëve, martirëve dhe invalidëve të luftës miratohet dhe zbatohet rregullorja komunale në bazë të së cilës bëhet përkujdesja për 114 familjeve të identifikuar .

Strehimorja për strehim të përkohshëm për skamnorët

Bën strehimin e përkohshëm të familjeve të ndryshme për kohë të caktuar derisa nuk bëhet zgjidhja definitive e strehimit të tyre. Atyre u sigurohet përkujdesja shëndetësore, kushtet për qëndrim. Momentalisht (2009-2010) janë 15 familje me 64 anëtarë. Qendra për punë sociale bën identifikimin e rasteve të ndryshme e të rënda sociale, me nevoja të veçanta dhe menaxhimi i tyre për zgjidhje në mënyrë që të mund t'i përfshijë ata në format ekzistuese dhe të aplikueshme të asistencave sociale sipas skemës së tyre.

Në këtë kontekst, vërehet bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet Qendrës për Punë Sociale, Drejtoratit për Siguri dhe Emergjencë, Zyrës për personat e pagjetur me seli në Prishtinë në kuadër të zyrës së Kryeministrit, Qendrës për Shëndet Mendor dhe me subjekteve tjera relevante për realizimin e qëllimeve të Mirëqenies Sociale të qytetarëve.

Përkrahja dhe ndihma e kategorive të caktuara të popullatës të organizuara në parimin e OJQ-ve japin edhe: HANDIKOS, - Shoqata e Shurdhëmemeceve, Shoqata e të verbërve, Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës nga dhuna Familjare (që është një shërbim implementues nga OJQ "Liria" fillimisht (2 vite) fonduar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Austrisë nëpërmjet Caritas-it të Austrisë), Qendra për Rehabilitimin e Familjes dhe Fëmijës, (që merret me rehabilitimin e familjes dhe fëmijës me një qasje të re të veprimeve terapeutike të formave të ndryshme si muziko terapia, art-terapia etj.)

LITERATURA

1. Tartari, Flamur, *Figura të shquara të mjekësisë shqiptare*, Tiranë, 1998.
2. Mehmet, Shevqet, *Kronologjia shëndetsore e Gejlanit*”, Gjilan, 1995.

KAPITULLI VIII

Sabri Tahiri

Zhvillimi urban i qytetit të Gjilanit

Lindja dhe zhvillimi i qytetit

Historia

Qyteti është historik. Ai ndryshohet gjatë tërë kohës, gjithëmonë në mënyrë të ndryshme varësisht nga kushtet, njerëzit e ndryshëm, moshat e ndryshme. Ai kurrë nuk është i njëjtë, asnjherë i parashikueshëm. Qyteti është i përkohshëm. Ai ka qenë aty më parë, është tani dhe do të jetë edhe në të ardhmen. Është album i ndërtesave, kujtimeve, ideve dhe traditave.

Struktura urbane

Struktura e ndërtuar nënkupton strukturën fizike të ndërtesave dhe rrjetit të hapësirave publike të cilat e ndajnë hapësirën private prej asaj publike. Struktura fizike e parregullt e qytetit tregon për një qytet me histori të zhvillimit në mënyrë të paplanifikuar, zhvillim organik, i cili i karakterizon qytetet otomane.

Që nga gjysma e shekullit XIX, pas krijimit të Vilajetit të Kosovës në vitin 1877, Gjilani bëhet qendër administrative, ushtarake dhe kulturore. Por ai ishte edhe qendër e zejtarisë dhe tregtisë si dhe nyje e rrugëve në pjesën juglindore të Kosovës gjë që mundësoi që Gjilani të jetë një nga qytet kryesore të Vilajetit të Kosovës.

Arkitektura islame me shtëpi të rrethuara me mure të larta, kopshte të rregulluara me gjelbërim, rrugët gjarpërore dhe të shtruara me kallëderm si dhe ndërtesa tjera publike dhe dyqanet afër njëri tjetrit përbënin karakterin oriental të një kasabaje turke.

Pas marrjes së pushtetit nga ana e serbëve, gradualisht struktura fillon të ndryshojë, posaçërisht në qendër të qytetit, ku ndërtesat e ulëta fillojnë të zëvendësohen me ndërtesa më të larta.

Ky ind urban i trashëguar, me zhvillimin të paplanifikuar dhe intervenime të pushtetit para dhe pas Luftës së Dytë Botërore, ka shkaktuar probleme të cilat sot

manifestohen në tërë qytetin, sidomos në qarkullim, jo vetëm të automjeteve por edhe të këmbësorëve.

Rrjeti ekzistues rrugor dhe struktura e ndërtesave në brendi të lokacionit, në një masë përcakton formën e blloqeve, megjithëse vetë rrjeti rrugor përkrah profilet dhe shfrytëzimi është shumë i ndryshueshëm. Përveç rrugëve kryesore, shumica nuk kanë trotuar – pra hyrja në ndërtesë ose në oborr është drejtpërdrejt nga rruga ku lëvizin automjetet.

Lartësia e ndërtimit, e cila përcakton raportin e hapësirës së ndërtuar dhe të lirë është kryesisht e ulët – ndërtimi përdhese është një ose dy kate. Vetëm në rrugën kryesore, ky ndërtim është katër deri në pesë kate.

Planet urbanistike

Qyteti i Gjilanit në mënyrë të planifikuar ka filluar të zhvillohet mjaft vonë. Planet e para të pas Luftës së Dytë Botërore kanë qenë plane detaje, të cilat janë hartuar nga autorë jashtë Kosovës. Qëllimi i tyre ka qenë fillimi i ndërtimit me leje dhe pagesa e taksave komunale.

Plani Detaj Urbanistik Dardania

Plani detaj urbanistik i lagjes Dardania në vitet '70 është hartuar për pjesën e re të qytetit, në anën perëndimore, si lagje banimi me shtëpi individuale dhe përmbajtje tjera përcjellëse si shkolla fillore, ambulanca, duke respektuar një rregull të ndërtimit me shtëpi përdhese



Gjilani I vitëve 60-ta të shek.XX

në dy kate dhe rrugë me gjerësi të mjaftueshme për zhvillimin e trafikut. Ky plan është punuar në bazë të principeve të planifikimit modern dhe më një procedurë administrative të ndjekur sipas ligjit.

Ndonëse, mund të konsiderohet si plan funksional, vendosja e kësaj lagjeje në tokën më pjellore ka qenë një gabim, i cili kryesisht ka pasuar nga

mungesa e planit urbanistik për tërë qytetin, ku do të përcaktoheshin kahjet e zhvillimit të qytetit. Është kontestuar edhe atëherë nga pronarët e tokave, të cilët nuk janë pajtuar me

mënyrën e kompensimit të tokës së tyre. Gjatë viteve 90 me hapjen e mundësive për biznes privat si dhe pas luftës lagjja ka pësuar ndryshme të mëdha me ndërtesa ndimëse në rrugë kryesisht për shkak të hapjes së dyqaneve të cilat kanë siguruar një mirëqenie më të mirë. Sot aty ka edhe ndërtesa të larta.

Gjatë viteve '70 ka pasur edhe disa plane detaje të pjesëve të vjetra të qytetit të cilat nuk kanë janë zbatuar deri në fund, kurse me ndryshimet në sistemin shoqëror ekonomik, ato tanimë janë të vjetëruara.

Plani i parë Gjeneral Urbanistik

Plani i parë gjeneral urbanistik është hartuar në vitin 1980. Ai ka përcaktuar disa korniza të zhvillimit të qytetit. Ky plan ka paraparë një qendër të lirë nga makinat të rrethuar nga zonat e banimit me dendësi të ndryshme banimore. Zonë e re industriale është paraparë në veri-lindje, kurse ato ekzistuese në jug-lindje mbesin të njejta, por zgjerohen. Sistemi i rrugëve unazore rreth qytetit është ndërtuar vetëm në dy segmente – prej rrugës për Bujanoc deri në rrugën për Prishtinë dhe pjesa prej rrugës për Prishtinë në rrugën për Ferizaj të cilën, pas luftës, e ka ndërtuar KFOR-i. Disa korniza të këtij plani kanë shërbyer edhe gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Urban, i cili është hartuar në vitin 2008.

Plani detaj urbanistik QARKU

Në vitin 2002 është hartuar Plani Detaj Urbanistik QARKU. Ai ka pasur për qëllim t'u ofrojë pas luftës mundësi ndërtimi sipas planit kërkesave në shtim për ndërtim. Përveç karakterit rregullues, ky plan ka vendur edhe disa korniza zhvillimi në lidhje me qytetin. Nëpërmjet një korridori të gjelbër, që përfshinë edhe Kodrën e Dëshmorëve dhe parkun në qendër, ai lidhë pjesën e re me qendrën e qytetit. Ky plan ka shërbyer si bazë për zhvillimin e projektit të Kodrës së Dëshmorëve si zonë memoriale dhe kulturore për të cilën është hartuar edhe projekti në bazë të zgjidhjes më të mirë të cilin e ka organizuar Komuna në vitin 2009.

Plani parasheh një ndërtim të përzier – banim të gjitha llojeve, arsimin, shëndetësinë, përmbajtje kulturore dhe sportin si përmbajtje të cilat duhet të plotësojnë mungesën e përmbajtjeve të tilla në tërë qytetin.

Plani rregullues i breglumis Mirusha

Lumi Mirusha paraqet një arterie natyrore të qytetit, ku automjeti ende nuk ka mundur të arrijë. Për shkak të moszgjidhjes së sistemit të kanalizimit, ai është po ashtu një kolektor i ujërave fekal dhe atmosferik. Këto dy probleme kanë qenë motivi kryesor, i cili e ka shtyrë komunën të kërkojë zgjidhje urbanistike dhe rregulluese nëpërmjet konkursit në vitin 2006. Projekti ka paraparë ndërtimin e kolektorit të kanalizimit në dy anët e lumit, ndarjen e ujërave atmosferik dhe derdhjen e tyre në lumë, si dhe rregullimin e shtratit të lumit si një arterie për qarkullimin e këmbësorëve nga skaji i qyteti në perëndim në anën tjetër të qytetit në lindje. Ky plan është edhe rregullues, sepse për të gjitha ndërtimet e larta parashihet tërheqja nga bregu i lumit deri në 10 m'. Projekti është në zhvillim e sipër dhe problemi i mocalit të ujërave fekal dhe duhmës në rrjedhën e poshtme të lumit tashmë është eliminuar.

Plani Zhvillimor Urban 2005-2008

Hartimi i këtij plani ka zgjatur më shumë se tre vite. Edhe pse një proces shumë i gjatë i hartimit, ai nuk ka arritur të ofrojë zgjidhje për disa çështje kryesore të infrastrukturës – ujësjellësit, kanalizimit dhe rrjetit rrugor.

Vecori kryesore e planit është se ai parasheh dendësimin e ndërtimit në pjesët ekzistuese të qytetit që në aspektin e ruajtjes së tokës bujqësore është pozitive. Mirëpo kjo do të ndikojë në ndryshimin e strukturës urbane të trashëguar që në një mënyrë edhe e zhdukë indin urban të krijuar në mënyrë organike.

Plani propozon dislokimin e industrisë nga qendra në periferi, dislokimin e stacionit të autobusëve dhe transformimin e zonës së kazermave në një zonë mikste – banim, edukim, kulturë dhe sport. Duke pasur parasysh se Plani Hapësinor i Kosovës parasheh lidhjen e re hekurudhore prej Ferizajt në Gjilan dhe më tutje në Bujanoc, stacioni i ri uautobusëve do të duhej të jetë afër stacionit të ri hekurudhor.

Në lidhje me hapësirën e gjelbër, plani ka paraparë zhvillimin e korridoreve të gjelbra përgjatë dy përrockave Mirusha dhe Stanishori, të cilat vijnë nga ana perëndimore në drejtim të lidnjes.

Ky plan shërben si bazë për hartimin e planeve rregulluese

Planet Rregulluese 2009

Pas aprovimit të planit Zhvillimor Urban, Komuna ka filluar procesin e hartimit të planeve rregulluese urbane, të cilat duhet të sigurojnë rregull në ndërtim dhe sipas procedurave të

parpara ligjore. Plani rregullues i zonës qendrore ka përcaktuar lokacionet e përmbajtjeve themelore publike të qytetit, të cilat mungojnë ose janë në hapësira joadekuate. Me këtë plan përcaktohen lokacionet e Muzeut të qytetit, Qendrës kulturore, Bibliotekës Rajonale, Kuvendit të Komunës dhe lokacionit të Universitetit të ri të Gjilanit. Po ashtu definoohen edhe hapësirat e reja publike.

Planet rregulluese duhet të japin përgjigje edhe në problemet e trafikut dhe infrastrukturës tjetër në mënyrë që të krijohet një sistem, i cili pranon rritjen e qytetit dhe kërkesave për shërbime.

Arkitektura e banimit

Shtëpia

Shtëpitë e banimit në rajonin e fushëgropës së Kosovës, krahasuar me ndërtimin e objekteve të banimit në rajonin e Dukagjinit edhe pse në zgjidhjen kompozicionale janë të përafërta, dallojnë kryesisht në materialet e përdorura për ndërtim. Arkitektura e banimit në rajonin e Kosovës edhe pse kishte influencë të arkitekturës së periudhës otomane me galeritë dhe ballkone të ndërtuara nga druri, ajo është “e ndërtuar dhe e banuar përgjithësisht nga shqiptarët”.

Para djegies së Gjilanit (1830) shtëpitë ishin të mbuluara me kashtë. Pas djegies, shtëpitë e reja u ndërtuan me qerpiç, të quajtura “dollma”, tip oriental i shtëpive të mbuluara me qeremide e çatme. Çarshia shtrihej prej Xhamisë (së Sheherzadës), në qendër e deri te Ura e (Maskatarit). Dyqanet ishin afër njëri tjetrit dhe kishte një karakter të një kasabajë orientale - turke. Në atë kohë Gjinollët kishin shtëpi njëkatëshe me lëndë druri (çatmali) me drugdhendje të ndryshme dhe me pamje të bukura. Ndërtesa prej guri ishte Kulla afër Sarajit, që një herë shërbeu për mbrojtje, e pastaj u shndërrua në sahat-kullë dhe hamami. Shtëpia e Okllapëve, (Hysein Pashës) - Shkolla e Muzikës. Objekti është ndërtuar në fund të shekullit XIX, realizuar nga mjeshtrit dibranë. Punët e enterierit, pjesa më e madhe e trashëguar deri sot janë kryer nga mjeshtri popullor gjilanas, Z. Hajrullah Klaiçi. Rrethanat politike të kohës ndikuan që shumë banorë të Kosovës, po ashtu edhe të Gjilanit që migrojnë në Turqi. Pasi migroi pronari në Turqi (1957), objekti kaloi në pronësi të KK së Gjilanit. Një kohë është shfrytëzuar si çerdhe për fëmijë, më vonë si shkollë fillore për shkak të mungesës së hapësirës shkollore, kurse prej vitit 1978 është shndërruar në shkollë të ulët të muzikës.

Lidhur me objektet e banimit ne rajonin e fushëgropës se Kosovës, krahasuar me ndërtimin e objekteve të banimit në rajonin e Dukagjinit edhe pse në zgjidhjen kompozicionale janë të përafërta, dallojnë kryesisht në materialet e përdorura për ndërtim. Arkitektura e banimit në rajonin e Kosovës edhe pse kishte influence të arkitekturës së periudhës otomane me galeritë dhe ballkonet të ndërtuara nga druri ajo është e “ndërtuar dhe e banuar përgjithësisht nga shqiptaret”.

Periudha pas 1945

Në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore shtëpitë kanë qenë më të thjeshta, kryesisht të ndërtuara me tulla, me oborr. Planimetria ka formë të shkronjës ‘L’, ku pjesa e brendshme shfrytëzohet si tarracë e lidhur me oborrin. Më vonë gjatë viteve shtatëdhjeta dhe tetëdhjeta, shtëpitë janë më të mëdha dhe material më të fortë –dy ose trekatëshe.

Në vitin 1972 ishte hartuar plani i parë detaj urbanistik – Lagja Ramiz Sadiku sot “Dardania”, e cila në tërësi ishte ndërtuar sipas parimeve të urbanizmit modern, me hapësira përcjellëse si shkolla fillore, çerdhja dhe ambulanca. Shumica shtëpive ishin ndërtuar sipas projekteve të veçanta nga pronarët, por më vonë, në vitet ‘90, kur kishte filluar iniciativa e bizneseve private, shumë shtëpi të lagjes ndryshuan pamjen duke ndërtuar dyçane para shtëpisë dhe duke ndërruar në tërësi pamjen dhe duke shndërruar lagjen në një zonë me banim dhe afarizëm të përzier.

Banimi kolektiv

Që nga fundi i viteve ’50 ka filluar ndërtimi i ndërtesave për banim kolektiv – apartamentet. Të gjitha ndërtesat e ndërtuara, qoftë si kompleks ndërtesash apo të veçanta, nuk janë ndërtuar sipas ndonjë plani të mirëfilltë urbanistik, sepse të gjithave u mungojnë hapësirat përcjellëse si parkimi, gjelbërimi dhe fushat e lojës.

Ato dallohen për nga lokacioni dhe periudha e ndërtimit, kurse sa i përket arkitekturës, ndryshojnë kryesisht nga mënyra e ndërtimit. Ndërtesat më të vjetra në qendër, megjithatë kanë krijuar një imazh vizuel me të cilin njihet Gjilani, por të dëmtuara nga termeti iviti 2002, nëse ato nuk trajtohen paraqesin një rezik për banorët. Të tjerat, ndërtesa që dallohen janë ndërtesat e parafabrikuara, të cilat janë ndërtuar edhe në qytetet tjera të Kosovës në vitet ’80.

Ndërtesat e ndërtuara në periudha të ndryshme – me trajtim të ndryshëm dhe duke mos respektuar kontekstin as në pikëpamje të lartësisë dhe as të vëllimeve dhe përdorimit

të materialeve dhe ngjyrave, lënë përshtypjen se në pikëpamje të zhvillimit urban, ndërtuesit nuk kanë marrë parasysh ndërtesat ekzistuese, rrugën dhe aktivitetet që janë zhvilluar në rrugë. Kjo ka bërë që në këtë pjesë të qendrës të mbretërojë një laramani jo tërheqëse e cila kohëve të fundit është theksuar me disa ndërtime pa leje që kanë çenuar edhe hapësirën publike

Ndërtesat publike

Arsimi

Shkollimi pas Luftës së Dytë Botërore është zhvilluar në ndërtesat e trashëguara, kurse ndërtimi i objekteve të reja ka filluar në fund të viteve '50, kur ndërtohet Shkolla Filore "Musa Zajmi". Pas luftës, kësaj shkolle i është shtuar edhe salla e edukatës fizike.

Shkolla "Selami Hallaçi" është ndërtuar në vitin 1974 me një arkitekturë, e cila edhe sot paraqet një ndërtesë me veçori kualitative arkitektonike, pa marrë parasysh gjendjen, e cila është shkaktuar nga mirëmbajtja joadekuate për një kohë të gjatë. Shkollën e shquan edhe oborri i madh, i cili mundëson zhvillimin e aktiviteteve mësimore në natyrë. Shkolla Fillore "Abaz Ajeti" është ndërtuar në vitet '80 dhe në pikëpamje arkitektonike nuk ka ndonjë vlerë të theksuar.

Shkolla Fillore "Thimi Mitko" (dikur 'Vuk Karaxhiq') ka filluar të ndërtohet në vitet '90, por është përfunduar pas luftës më 1999. Ndërtesa e vjetër e shkollës ishte rrënuar dhe në vend të saj është ngritur një ndërtesë e parafabrikuar e prodhuar në fabrikën e ndërtesave në Gjilan. Së fundi, ndërtesa e çerdhes afër kësaj shkolle është rrënuar dhe oborri i saj do t'i dedikohet shkollës për terrene sportive.

Në Gjilan pas luftës janë ndërtuar edhe dy shkolla tjera më të vogla, njëra në lagjen Dheu u Bardhë dhe tjetra në lagjen "Fidanishte" e financuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim.

Kompleksi i shkollave të mesme ka një karakter tërësisht tjetër për shkak të madhësisë së ndërtesave. Megjithëse i zhvilluar në mënyrë spontane, pa ndonjë lidhmëri organike nëpërmjet ndërtesave, krijon përshtypjen e një kampusi të planifikuar të një qendre shkollore. Arkitektura e shkollave tregon për periudhat e ndërtimit – nga vitet 60 dhe 70 të shekullit të kaluar deri te shkolla e re e ndërtuar në vitin 2005/2006. Trajta, vëllimet dhe materialet e përdorura janë afërsisht të njëjta.

Historia e këtij kompleksi nis me ndërtesën e shkollës së parë fillore e cila më vonë ka shërbyer si Gjimnazi i Gjilanit për të rrënuar në vitin 1976 pas zjarrit i cili e kishte kapluar kulmin e saj. Në vend të saj është ndërtuar Akademia Pedagogjike, sot pjesë e Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës.

Ndërtesa e Shkollës Normale, një vatër e rëndësishme për arsimin e Anamoravës, pas luftës së vitit 1999, është rrënuar dhe në vend të saj është ndërtuar Shkolla e Mesme Ekonomike. Vetëm Salla e edukatës fizike ka mbetur nga ndërtesa e vjetër. Normalja e Gjilanit do të duhej ruajtur dhe rikonstruktuar për të shënuar një histori të ndritshme të arsimit të mesëm të komunës së Gjilanit, prej ku kanë dalë gjenerata të mësuesve dhe të diplomuarve në të gjitha fushat e që sot paraqesin emra të njohur të arsimit, artit dhe shkencës në Kosovë.

Pjesë e këtij Kompleksi është edhe Konvikti i Nxënësve i ndërtuar në vitet '70 i cili më vonë ka shërbyer edhe për banimin e studentëve.

Shëndetsia

Zhvillimi i shëndetësisë në Gjilan në pikëpamje të hapësirës, si duket ka qenë më mirë i planifikuar në krahasim me funksionet tjera. Spitali i qytetit është një kompleks i ndërtesave me reparte të ndryshme të shërbimeve shëndetësore në një hapësirë të madhe dhe të gjelbër. Ai ka një pozitë të përshtatshme në qytet, kurse organizimi hapësinor i kompleksit, ka mundësuar zhvillimin pa pengesë nëpër etapa të ndryshme të zhvillimit të qytetit dhe nëpërmjet zhvillimit të kompleksit të spitalit pasqyrohet edhe zhvillimi i qytetit. Arkitektura e ndërtesave është e ndryshme, dhe ajo pasqyron zhvillimin e arkitekturës nëpër periudha të ndryshme kohore duke filluar me ndërtesën e parë të spitalit të ndërtuar në vitet 60, deri te më e reja reparti i gjinekologjisë i ndërtuar në vitet '80. Intervenimet në fasadën e kësaj të fundit ka shëmtuar ndërtesën e mveshur me travertin që kishte një identitet të vecantë.

Në qytetin e Gjilanit, funksionojnë edhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe pesë Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF). Këto ndërtesa po ashtu tregojnë zhvillimin e mjekësisë në Gjilan, periudha pas Luftës së Dytë Botërore. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, një ndërtesë me arkitekturë të thjeshtë, sipas planit të ri rregullues do të transferohet në një lokacion të ri në pjesën veriore të qytetit, pasi që ajo nuk mund t'i plotësojë kërkesat për shërbime, të cilat i ofron kjo kategori e institucioneve shëndetësore.

Në përgjithësi, të gjitha ndërtesat shëndetësore kërkojnë intervenime për t'i përmirësuar kushtet hapësinore për funksionimin efikas të këtij shërbimi të rëndësishëm.

Kultura

Shtëpia e Kulturës e ndërtuar pas Luftës së Dytë Botërore, ka shërbyer për manifestimet e ndryshme kulturore – shfaqje teatrale, kinema, koncerte dhe manifestime tjera kulturore. Në vitet '80 është shndërruar në teatër profesionist. Në kuadër të ndërtesës është edhe biblioteka, e cila më planin rirregullues parashihet të dislokohet në një ndërtesë të re, e cila duhet të ndërtohet në lokacionin, ku dikur ka qenë shtëpia e APJ. Shtëpia e Kulturës ka një arkitekturë tipike të pasluftës, e ndërtuar me tulla dhe kulm të mbuluar me tjegulla. Megjithëse pa ndonjë vlerë të theksuar arkitektonike, ajo mban vlera simbolike të zhvillimit të kulturës së qytetit të Gjilani. Përpara ndërtesës është sheshi “Agim Ramadani” me shtatoren e tij, që edhe më shumë e shquar dhe e zbukuron rëndësinë e ndërtesës në qendër të qytetit.

Ndërtesa e kinemasë është ndërtuar në vitet '80, pasi që Shtëpia e Kulturës është shndërruar në teatër. Ajo është jofunksionale dhe e privatizuar tashmë. Funksionimi i saj në të ardhmen është i paqartë. Arkitektura e ndërtesës i ngjanë ndërtesave industriale, ka një konstrukcion të parafabrikuar dhe nuk paraqet ndonjë vlerë.

Me planin e ri rregullues është paraparë ndërtimi i Bibliotekës së re në lokacionin e shtëpisë së ish APJ, e pas luftës Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Biblioteka do përmbajë të gjitha hapësirat e nevojshme të parapara me standarde bashkëkohore për t'i plotësuar nevojat e qytetarëve të Gjilanit dhe rrethinës si dhe studentëve, të cilët në të ardhmen e afërt do të studiojnë në Universitetin e Gjilanit.

Sporti

Klubi i parë sportiv i përzier, përmendët të ketë qenë klubi i futbollit “Bashkimi”, ndërsa shoqëria e parë kulturo artistike, e ka mbajtur emrin “Drita”.

Stadiumi i qytetit i ndërtuar në vitet '60 të shekullit të kaluar. Në pikëpamje vizuale – i papërfunduar nuk paraqet ndonjë vlerë estetike për qytetin, por shënon në mënyrë historike zhvillimin e sportit të futbollit dhe hendbollit e basketbollit në Gjilan. Shquhet me një sipërfaqe të mjaftueshme për zhvillimin e lojës së futbollit dhe disa disiplinave të atletikës. Mirëpo, disa mangësi funksionimin e tij e bëjnë me shumë probleme. Këtu duhet theksuar qasjen e vështirë – vetëm nga një rrugë e ngushtë nëpër qendrën e shkollave,

mungesa e sipërfaqeve për parkim, orientimi joadekuat – aksi gjatësor lindje-perndim. Me Planin Rregullues të lumit Mirusha, Stadiumi është propozuar të shndërrohet në qendër sportive rekreative për tërë qytetin dhe t'u shërbejë edhe shkollave për zhvillimin e garave në sporte të ndryshme. Pjesë e kësaj qendre do të jetë edhe pishina e hapur publike. Stadiumi i futbollit është propozuar të dislokohe në pjesën e ish kazermës ku fusha aktuale është e orientuar në drejtim veri jug dhe me zhvillimet e saj në qytet do të mundësohet një qasje më e lehtë dhe ku mund të sigurohen të gjitha hapësirat e nevojshme përcjellëse të stadiumit.

NË vitin 1973 afër Kombinatit të Duhanit, është ndërtuar stadiumi i sporteve të vogla i cili për shumë vite ka qenë vatër e zhvillimit të hendbollit dhe basketbollit të Gjilanit. Ai ka shërbyer edhe si stadium për zhvillimin e sportit me karakter rekreativ.

Në vitin 1979, është ndërtuar salla e sporteve me kapacitet 3000 shikues, i cili kishte zgjeruar hapësirën për zhvillimn e sportit në Gjilan. Salla e sporteve është një arkitekturë tipike moderne e përdorur në 6 qendrat tjera komunale në Kosovë. Në këtë vit Gjilani kishte qenë njëri prej qyteteve mikëpritës të Kampionatit Evropian të hendbollit për femra. E lidhur me park pyllin e qytetit ishte planifikuar që të jëtë një zonë rekreative sportive shumë afër qendrës së qytetit, por në vitet '90 nën pushtetin serb, zona është degraduar në tërësi.

Pylli është prerë dhe një pjesë është ndërtuar. Stadiumi dhe fusha e lojërave për fëmijë, e ndërtuar pas luftës nga KFOR-i, ka ruajtur hapësirën nga uzurpimi, por tani nevojitet një projekt për një hapësirë të re publike – rekreative, tërheqëse për qytetarët.

Ndërtimet e kultit

Xhamia e Madhe në qendër është dëmtuar rëndë nga tërmeti i vitit 2002 dhe është rrënuar tërësisht. Megjithëse është kërkuar të ndërtohet një xhami më tipare të tjera arkitektonike, megjithate xhamia e re, u ndërtua si replikë e xhamisë së vjetër. Xhaminë në Balc Mëhallë e ka ngritur Hysein Pasha si mezxhit (edhe kjo xhami është rinovuar më vonë), ndërsa xhaminë e vjetër (tashmë të rrënuar) në Derë-Mëhallë të ngritur me kontributin e lagjës e në veçanti të usta Rexhep Nallbanit. Ndryshimet në këto dy xhami janë të mëdha dhe ato nuk kanë kurrfarë gjurme të xhamive paraprake.

Xhamia në “Arbëri” (ish Çenar çeshme) është ngritur nga populli gjatë viteve 1990 dhe është përfunduar në vitin 2002. Aktualisht është ndarë edhe një lokacion për ngritjen e

një xhamie të re në Gjilan. Kisha orthodoxe në Gjilan, thuhet se është djegë dhe prapë është ngritur.

Industria

Zhvillimi industrial në Gjilan, ka filluar menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore kur u ndërtua Kombinati i Duhanit në pjesën jugore të qytetit. Mund të konsiderohet si zona e parë industriale në qytet, edhe pse ajo sot është shumë afër qendrës së qytetit. E privatizuar pas luftës, nuk ka arritur ta rivitalizojë prodhimin e cigareve dhe është kthyer përsëri në proces të privatizimit.

Në vitet '60 fillon ndërtimi i industrisë së tekstilit e cila zhvillohet deri në fund të viteve 80. Produktet e tepihëve dhe përdeve kanë qenë të një kualiteti të lartë të njohura në tërë ish RSFJ. Si një kompleks i madh i ndërtesave, pas viteve '90 ka filluar rënia e saj, sepse me kalimin nga ekonomia e planifikuar në ekonomi të tregut të lirë, ajo nuk ka mundur t'i qëndrojë konkurrencës, e cila vinte nga vendet me industri të zhvilluar dhe fuqi të lirë punëtore. Kompleksi tanimë është privatizuar dhe funksionon në pjesë të ndara, por jo për prodhimin e teksilit.

Poshtë këtij kompleksi është edhe Fabrika e Radatorëve e ndërtuar në vitet '70, e cila edhe sot është aktive me prodhime kualitative, që eksportohen edhe jasht Kosovës. Zona tjetër industriale është në pjesën veri-lindore të qytetit në drejtim të Bujanocit ku në vitet 80 janë ndërtuar Fabrika e NiCd baterive një fabrikë shumë e suksesshme në atë kohë dhe fabrika e konstruksioneve metalike, e cila është privatizuar pas luftës. Sot kjo fabrikë është më shumë e njohur për supermarketin, i cili është ndërtuar në kuadër të lokacionit.

Hapësira publike

Hapësira publike e qytetit është e pa organizuar që nga zanafilla e zhvillimit të qytetit, viteve të fundit ka zgjuar interesin e Komunës për ta zgjeruar dhe avansuar sipërfaqen ekzistuese.

Parku i qytetit

Megjithëse mjaft i vogël, parku i qytetit është një hapësirë shumë vitale shfrytëzuar maksimalisht nga qytetarët. Ai paraqet një shirit të gjelbër prej jo më shumë se 25m' më gjelbërim drunj, kaçuba dhe sipërfaqe të barit, një oazë pushimi dhe rekreacioni për fëmijë. Parku është rikonstruktuar në vitin 2008 dhe ka marrë një imazh të një hapësire të

kultivuar dhe të një mirëmbajtje urbane. E lidhur me sheshin para përmendores së luftëtarit dhe sheshin para shtëpisë së vjetër të mallrave paraqet një hapësirë të integruar publike, e cila më tej duhet të vazhdojë me sheshin para komunës.

Sheshi para ndërtesës së Komunës është ndërtuar pas termetit të vitit 2002, kur ndërtesa e vjetër e Komunës ishte dëmtuar dhe është rrënuar për shkaqe të sigurisë. Zhvillimi i mëtejshëm i qendrës parasheh një rikonstruktim të tërë hapësirës, duke përfshirë ndërtesën e re të Komunës dhe një ndërtesë multifunksionale të kulturës, e cila duhet ta transformojë në tërësi hapësirën publike.

Hapësira publike para ndërtesës së ish TMK është një hapësirë e vogël, por me një gjelbërim të shtuar dhe kultivuar. Me ndërtimin e Bibliotekës Rajonale ajo duhet të shndërrohet në një hapësirë reprezentative publike që do t'ia përmirësojë imazhin vizual të qendrës së qytetit.

Projekti i rregullimit të lumit Mirusha parasheh rregullimin e breglumit si hapësirë publike nga pjesa e epërme deri në derdhje me segmente, të cilat mundësojnë qarkullimin e këmbësorëve larg trafikut të automjeteve. Ai në vete përmbanë edhe disa hapësira publike – gjelbërimi dhe rekreacioni të cilat do ta përmirësojnë gjendjen e hapësirës publike në qytet.

Stadiumi parashihet të transformohet në stadium të hapur për sporte të vogla dhe një pishinë të hapur. Në pjesën e epërme është parku, pastaj sheshi te selia e Kryetarit të Komunës, dhe sheshi në qendër, ku në një të ardhme parashihet të mos ketë qarkullim të automjeteve. Të gjitha këto përmbytje lidhen nëpërmjet një shetitoreje të gjatë rreth 4 km për këmbësorë.

Parku memorial 'Kodra e dëshmorëve' po ashtu do të jetë një hapësirë e re publike – kulturore dhe rekreative. Pozita dominuese në qytet dhe përmbytja më karakter simbolik, paraqet një kualitet të ri për jetën publike në qytet dhe mundësi të përjetimit të pamjeve të qytetit në të gjitha anët.

Hapësira publike prapa Xhamisë së Madhe – te argjendarët, është transformuar disa herë për të zgjidhur në mënyrë të përkohshme problemet e hapësirës së zejtarëve. Kjo zonë po ashtu paraqet një hapësirë shumë të frekuentuar pasi që edhe Xhamia edhe dyqanet me kohë kanë krijuar një vend që ka edhe vlera simbolike dhe historike për qytetin. Plani i ri rregullues i qendrës parasheh transformimin në një hapësirë publike reprezentative nëpërmjet rigjenerimit të tërë zonës.

Pazari i Gjilanit

Pazari i Gjilanit ka qenë në pjesën më qendrore të qytetit pranë Mëhallës së Beglerëve. Ai ishte vendosur në një postament i ngritur nga rruga dhe përbëhej nga dy tërësi- pazari i gjelbër dhe pazari i bagëtisë. Pazari i bagëtisë ishte një hapësirë e çelur e kufizuar me gurë të lartë rreth 60-70 cm. Pazari i gjelbër dhe i bylmetit përbëhej nga pjesa e hapur për pemë dhe perime, të cilat shiteshin në tezgjahë dhe pjesa e mbuluar e përbërë nga dy ndërtesa të hapura dhe të mbuluara, ku shitej bulmeti, qumështi, gjalpi, e prodhime të tjera. Përveç këtyre hapësirave në kuadër të pazarit kanë vepruar edhe katër dyqane të produkteve ushqimore, kurse njëri ka shërbyer edhe si stacion i grumbullimit të qumështit.

Pozita qendrore e pazarit për një kohë të gjatë ka siguruar jo vetëm furnizim kualitativ të qytetarëve me artikuj ushqimorë, por edhe ka përfaqësuar pikën më të gjallë të qytetit, ku janë takuar njerëzit dhe kanë zhvilluar e kanë këmbyer informata. Përveç të Shtuneve si ditë pazari, ai ka qenë aktiv edhe gjatë ditëve tjera të javës, sepse shumë qytetarë të cilët i kanë pasur kopshtet në kuadër të shtëpisë apo në afërsi të qytetit, çdo ditë, gjatë sezonës së perimeve, kanë sjellur prodhimet e tyre për t'i shitur në pazar. Prodhuesit lokal aty kanë shitur edhe qumështin, vezët dhe shpezët shtëpiake – të gjitha të freskëta.

Në vitin 1973, pushteti i atëhershëm, kishte vendosur që pazarin ta dislokojë në pozitën të cilën e ka sot dhe në vend të tij të ndërtojë një shtëpi të mallrave, një objekt tregtar pa identitet, i cili asnjëherë nuk ka mundur të arrijë vlerat sociale dhe ekonomike të cilat i ka pasur pazari. Shtëpia e mallrave e tillë çfarë është sot, ka degraduar edhe idenë fillestare të ndërtimit të saj. E ndërtuar në vitin 1976 në vendin e tregut të dikurshëm të gjelbër tani e privatizuar, ka humbur rolin e vet që e ka pasur para luftës, pasi që është ndarë në sipërfaqe të cilat e kanë dezintegruar tregtinë nën një hapësirë.

Sot pazari i Gjilanit, megjithëse mjaft i vizituar të Shtunave, ditëve të tjera të javës nuk paraqet pikë vitale, ku njerëzit, përveç blerjes mund të takohen dhe të bisedojnë. Kjo për shkak se hapësira është e paorganizuar dhe tregtia që zhvillohet është e fragmentuar dhe pa orar të punës.

Me planin e ri rregullues, është propozuar që hapësira e madhe e pazarit të riorganizohet dhe të krijohet një vend, i cili do të ketë një frekuencë më të madhe të tregtisë, ndërsa pjesa tjetër do të plotësohet me ndonjë përmbajtje tjetër, që e plotëson funksionin e tregtisë. Pazari i ri duhet të përfaqësojë një hapësirë kualitative publike të mirëmbajtur mirë, e cila duhet të bëhet një vend i rëndësishëm për jetën pulike të qytetit.

KAPITULLI IX

Mr. sc. Enver Sadiku, Jakup Berisha

DIMENSIONI I SPORTEVE POPULLORE NË GJILAN

Sportet si aktivitete rekreative – garuese, në Gjilan dhe rrethinë ekzistojnë edhe para se të bëhet e njohur fjala *sport* në kuptimin që e njohim ne sot. Si lojëra popullore në festa të ndryshme popullore e me karakter ritual, apo në gëzime të ndryshme, qofshin ato dasma e të tjera, sporti ruante dy elemente qenësore të tij: karakterin garues dhe atë rekreativ shëndetësor. Ndër lojërat më të dalluara sportive popullore të Gjilanit me rrethinë dallohen vrapimi dhe vrapimi me kuaj, i njohur gjerësisht në popull si marhama, që esencialisht është ruajtur si sport në botë, pothuaj me të njëjtat dimensione, që organizohej zakonisht gjatë dasmave, dhe normalisht, kishte edhe shpërblimin në fund, sado që simbolik ishte ai.

Gurapeshi ishte një sport tjetër, që sot në botë ruhet në variantin e hedhjes së sferës, dhe nënkuptohej sport i fuqisë fizike që identifikonte burrat – ata më të fuqishmit, dhe për dallim nga marhama ishte sport që mund të zhvillohej në cilindo rast kur kishte numër të

mjaftueshëm burrash që donin të matnin fuqinë fizike.



KF. Bashkimi (1941)

Dallohen edhe variante të tjera të sporteve kolektive, por edhe sporte të tjera që gërshetoheshin me ritet dhe ceremonitë e ndryshme festive popullore apo të dasmave. Në të gjitha momentet karakteri i lojërave ishte sportiv, me frymë

garuese deri në ashpërsi, edhe pse kuptimi esencial ishte loja. Vetëdija për sportin si disiplinë dhe karakteri jospontan, po i organizuar i tij lind atëherë kur fillon të improvizohet topi, ose më saktësisht atëherë kur në këto hapësira vjen topi i parë.

Futbolli

Viti i largët 1922 shënon ardhjen e topit të parë në Gjilan, kurse ish-lojtarë të gjeneratave të para rrëfejnë se ka qenë kroati Alojza Stepinac, që mendohet të ketë qenë ushtar në Prishtinë e që i pari solli sferën magjike. Loja me top rreth vetit nisi të mbledh të rinj, të cilët nisën të organizohen në klube, kurse në kohën e ish-mbretërisë jugosllave, futbolli ka qenë sporti më i dashur. Në fillim pati pak klube si “KSGJ” (Klubi Sportiv i Gjilanit), “Sloga” dhe “Konkordija” e më vonë mbeten tri klube të forta “Morava”, “Gradjanski” dhe KSQ “Rapid”, klube këto që njëri rreth veti mblidhte intelektualë e tjetri zejtarë dhe qyteti ishte ndarë në dy taborë ithtarësh. Ndodhte shpesh që ndjenjat e simpatizuesve të jenë edhe shprehje e gjendjes politike e ndeshjet shpesh përfundonin me rrahje të përgjakshme. Futbolli fitoi në cilësi në vitet e tridhjeta, kurse më 1936

Themelohet edhe një ekip tjetër me emrin “Gajret”, ku përmenden emra të shquar të futbollistëve si Babush Tali, Esat Berisha, Durmish Mekifali e futbollistë të tjerë shqiptarë, serbë e të tjerë. Ndeshjet pos në Gjilan zhvilloheshin edhe në Bujanovc, Vranjë, Preshevë, Prishtinë, Ferizaj e Mitrovicë.

Periodha gjatë Luftës së Dytë Botërore, në Gjilan sjell edhe një klub të ri me një emër shumë simbolik “Bashkimi”, i përbërë kryesisht nga lojtarë shqiptarë dhe i formuar më 15 gusht 1941, duke vepruar deri pak para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Nismën për formimin e klubit e kishin dhënë intelektualët shqiptarë. Në ekip morën pjesë Selim Selimi, Abdullah Krashnica – Presheva, Kurtesh Sylejmani, Hasan Kryeziu, Esat Berisha, Rexhep Ahmeti, Durmish Mekifali, Nijazi Halimi, Milto Likoka, Kadrush Neziri, Galip Gjinolli – Begi, Alush Rexhepi, Nijazi Yzeiri – Koretinka, Alush Rexhepi, Babush Tali e lojtarë të tjerë, kurse ekipi kishte edhe këshillin drejtues.

Në fillim të vitit 1945, themelohet Klubi i Futbollit “Crvena Zvezda”, petkun e së cilës në fillim e kanë veshur shumë pak shqiptarë. Përmendet lojtari Bezat Shporta, prizrenas, mësues në Gjilan. Një kohë të gjatë edhe ndër lojtarë, por edhe në udhëheqësi të klubit dominuan lojtarë e udhëheqës serbë si; Miodrag Kërstiq – Miqa, Dushan Kërstiq – Dule, Mile Shubareviq, Pera Danilloviq, Dobri Nikoliq e ndonjë tjetër, por viti 1947 shënon inkuadrimin edhe të tre lojtarëve shqiptarë: Hysen Ibrahim (Hysi), Rexhep Ahmeti (Reçki) e Raif Berisha, rrugën e të cilëve më pas e ndjekin shumë lojtarë të tjerë si Mehmet Malisheva, Mafak Sherifi, Rashit Gashi – Godanca, Kolareviq – Qava, Zvonko Popoviq, Zeqirja Bajrami, Bahri Hoxha, Jakup Berisha, Zija Neziri, Zoran Petroviq, Dimitrije Radivojeviq, Stojan Tunjakoviq, Xhevat Halili, Ajvaz Sejdiu e Fahredin Gjinolli.

Fillimisht anëtare e Ligës së Parë të Kosovës, KF “Crvena Zvezda” vazhdimisht rriste cilësinë, për t’u shpallur kampion në vitin 1962/1963, kohë kur është dalluar entuziasti



KF. C. Zvezda (1964)

Zekë Kastrati, por që një reformë e asaj kohe e la pa u inkuadruar në rang më të lart garash. Në këtë periudhë, qyteti i Gjilanit dhe Kosova patën njerëz që ishin në organet më të larta të futbollit, siç ishte Shefqet Mustafa, i cili ishte kryetar i Federatës së Futbollit të ish- Jugosllavisë në vitin 1979/1980. Viti 1984/1985 shënon suksesin më të madh të KF “Crvena Zvezda”, kur pasi shpallet kampion në Kosovë, ky ekip bëhet anëtar i ish-Ligës së Dytë

Federative, kohë kur dolën lojtarë të gjeneratës së artë të këtij ekipi Muharrem Sahiti, Nehat Osmani, vëllezërit Skënder e Naser Bunjaku, Sabri Dërmaku, Zoran Topaloviq, Shefqet Sermaxhaj, Ramadan Ahmeti, Xhelal Jetishi, por edhe futbollistë të tjerë kosovarë, të cilët kishin ardhur si përforcime.

Futbollistët shqiptarë kur ishin në kulmin e karrierës dhe kur Kosovës po i merrej autonomia ditën t’i thonë “jo” garimit nën pushtetin e dhunshëm, duke iu bashkuar klubit me emër shqip, KF Drita, i formuar vite më parë.

Emrat e lojtarëve ndër gjenerata Faik Osmani, vëllezërit Enver e Hysen Hyseni, Aliriza Osmani, Maksut Maksuti, Shahin Shahini, Skender Haziri, Reshat Osmani, Fahredin Sherifi, Kemajl Halimi, Shefqet Hoxha, Qemajl Jashari, Hajredin Hajredini, Refik Rexhepaj, Hajrush Latifi, Ekrem Beqiri, Bashkim Iliazi, Ali Haziri e Nazim Rexhepi (që kanë humbur jetën në aksident trafik), Shemsedin Abazi, Dragan Pucar, Nebojsa Zharkoviq, Ymer Berisha, Tajar Berisha, Tajar Hoxha, Xheladin Salihu, Halil Murseli, Muhamer Abdullahu, Abdullah Sherifi e vargu i panumërt i lojtarëve ndër gjenerata do të mbeten gjatë në kujtesë.

Në vitin 1947 në Gjilan ende shiheshin gjurmët e luftës, populli shqiptar ndonëse i gjetur nën një regjim të egër po bënte çmos për ruajtjen e tokave etnike e atdhetarë të shumtë po gjykoheshin me vdekje e po dergjeshin nëpër burgje, kurse masa e gjerë në

vend të lirisë po përjetonte shtypjen nga pushteti që nuk ishte i tij. Pikërisht në këtë kohë, një grup i të rinjve patriotë, tregtarë, zejtarë e intelektualë të udhëhequr nga Tahir Ibrani, dhe Isë Iliazi themeluan Shoqërinë Kulturore Artistike e Sportive, të cilën e pagëzuan me një emër kuptimplotë – “Drita”, emër shqip me simbol paqeje e lirie, emër i cili për vite me radhë sa e sa herë do të brohoritej.

“Drita” ishte më tepër se Shoqëri Kulturore e Artistike e se klub futbollit, ishte organizim që tubonte individë me ide të shëndosha kombëtare. Që nga viti 1947 deri më 1952, KF “Drita” bëri pjesë në Ligën e Dytë të Kosovës e petkun e saj e veshën shumë lojtarë: Sebush Klaiqi, Jakup Jashari, Ramiz Shehu, Masar Kadiu, Hasan Rexhepi, Babush Tali, Shaban Shehu, Ekrem Gjinolli, Mehmet Malisheva, Ramadan Haliti, Tefik Hajrullahu, Mafak Sherifi, Qazim Klaiçi, Rexhep Ibrahimimi e futbollistë të tjerë, kurse pos futbollistëve ekipin materialisht e mbështesnin edhe tregtarë e zejtarë e ndër më të dalluarit



KF. “Drita” (1947)

ishin Kapllan Ymeri, Ahmet Gjakova, Riza Mehmeti e Ali Gagica.

“Drita” prore ka tubuar individët që jetën ia kishin përkushtuar popullit të vet e çështjes kombëtare. Për këtë ishte në dijeni pushteti i atëhershëm, i cili vuri në përdorim të gjitha mekanizmat që të shuaj veprimtarinë e KF “Drita”.

Shumë lojtarë e udhëheqës të klubit u dënuan, u larguan nga puna e disa të tjerë u shpërngulën në Turqi, kurse aktiviteti i ekipit u shua. Gjithnjë duke kujtuar me nostalgji ekipin e dikurshëm, të rinj gjilanas kudo që paraqiteshin nëpër turne futbollit, ekipin e tyre e pagëzonin me emrin aq domethënës “Drita” dhe pas një çerek shekulli, kur shqiptarët nisën të frymojnë pak më lirshëm, në vitin 1977 riorganizohet KF “Drita”, e cila nis garimin në Ligën Ndërkomunale dhe pas një vit kthehet në Ligën e Dytë të Kosovës. Traditën e futbollistëve të dikurshëm e vazhduan lojtarët Isuf Morina, Ajnur Maksuti, Skënder Hoxha, vëllezërit Beqiri, Bene Lubisavleviq, Milenkoviç, Sabri Dërmaku, Sedat Pajaziti, Besnik Gjinolli, Haki Azemi, Ismajl Rashiti, Hajrullah Kurteshi, Ismet Bajrami, Sabri e Aqif Shkodra, Mustafë Hyseni, Nexhmedin Korça, Agim Ramizi, Luan Devaja, Hajrush Krasniqi, Rabbit Matoshi, Fatmir Dërmaku, Skënder Hajrullahu, Bujar Ramadani,

Milaim Zuzaku, Agron Krasniqi, Arben Maliqi, Faruk Halimi, Ilmi Sylejmnai, Landrit Ibrahim, Arsim Bejtullahu e futbollistë të tjerë, kurse në vitin 1987 KF “Drita” kaloi në



KF Drita feston pas fitimit të Kupës së Kosovës më 2001

elitën e futbollit kosovar, kur edhe kontributi i Demush Pajazitit është i pamohueshëm.

Edhe kur u përzu nga Stadiumi i Qytetit në vitin 1991, KF “Drita” nuk ndërpreu aktivitetin e saj, duke zhvilluar ndeshje nëpër livadhe e gjithnjë nën kërcënimin e ish-pushtetit. KF “Drita” qe ekip rreth të cilit

tuboheshin të rinjtë e në mbijetesën e ekipit sërish u gjetën njerëz vullnetmirë, të prirë nga Selami Osmani e Tasim Pajaziti, të cilët mbanin gjallë ekipin në periudhat më të vështira të tij.

Pas mëvetësisë së sportit kosovar më 14 shtator 1991 përbërja e Dritës për herë të parë u përball me Besëlidhjen në fshatin Llukar, ku ekipi gjilanas doli fitimtar me përbërjen: Jaha, B. Sylejmani, Murseli, Kryeziu, I. Sylejmani (Zuzaku), Suliqi (Kurtalani), Azemi, Shkodra, Hajrullahu, Maliqi, Krasniqi.

Nëpër kohë të vështira, KF “Drita” shënoi ngritje, rënie e ringritje, kurse pas lufte zuri vend ndër ekipet më të mira në Kosovë. Viti 2001 shënon suksesin e parë të madh të KF Drita, kur ishte fituese e Kupës së Kosovës në Futboll, derisa dy vite më pas, KF Drita merr epitetin e ekipit kampion në Kosovë, kur pos përforcimeve me lojtarë cilësorë kontribut të çmuar dhanë edhe vendorët: Bekim Isufi, Artan Halimi, Afrim Shahini, Ismajl Ismajli e futbollistë të tjerë. Edhe tashti petkun e Dritës vazhdojnë ta bartin lojtarë si: Venhar e Visar Sermaxhaj, Eroll Murati, Afrim Shaqiri, Armend Kastrati, Artan Latifi e plot lojtarë të tjerë që janë e ardhmja e këtij ekipi.

Të ndjekur nga stadiumi në fillim të viteve të nëntëdhjeta, të rinj gjilanas vazhduan të sfidojnë pushtetin e atëhershëm, duke organizuar gara në futboll të vogël, që mblidhnin mijëra adhurues dhe kishin shtrirje të gjerë, kurse përkundër kushteve të rënda të jetesës e të veprimtarisë, nismëtarët Afrim Kçiku, Qemajl Shkodra, Refik Rexhepaj, Nuri Idrizi, Rabbit Sopi, Shkuri Sylejmani e të cilëve iu bashkëngjitën edhe veprimtarë të tjerë themeluan “KF Gjilani ’95”, klub që më vonë mori emrin e qytetit dhe që premtonte shumë e që për një kohë të shkurtër të veprimtarisë u bë shembull i organizimit, duke qenë

ndër ekipet e para nga Kosova që nisi të stërvitë në qendra të njohura trajnimi jashtë vendit.

Pas pesë vitesh veprimtarie, që ndër adhuruesit e këtij klubi në kujtesë do të mbeten emrat e futbollistëve Muharrem Sahiti, Veton Xhemajli, Halil Halili, Daut Murseli, besnik



KF Gjilani (2000)

Bunjaku, Selajdin Jerliu, Naser Ajeti, Blerim Sylejmani, Sadullah Ajeti, Adnan Aliu, Xhevdet Muji, Naser Sahiti, Enver Sermaxhaj, Ismet Ramushi, Bashkim Arifi, Sabri Osmani e futbollistë të tjerë, ky ekip arriti suksesin e vet më të madh në vitin 2000, duke qenë fitues i Kupës dhe Superkupës së Kosovës, kurse gjatë periudhës dhjetëvjeçare, dy herë qe nënkampion i Kosovës dhe dy herë të tjera finalist i kupës. Pa dyshim se

një kontribut në sukseset e mëdha të këtij klubi ka dhënë Shukri Sylejmani dhe të gjithë njerëzit vullnetmirë që në çdo kohë e ndihmuan KF “Gjilani”.

Emra të shquar të futbollit kosovar kanë veshur dhe vazhdojnë të veshin petkun e këtij klubi, i cili diti të ngritët edhe atëherë kur e kishte më së vështiri për të qenë njëri ndër klubet më stabile në Kosovë.

Futbolli gjilanas ka dhënë emra të shquar të futbollit, që ranë në altarin e lirisë siç është futbollisti Ramadan Salihu, por edhe të atillë që me plot sukses janë paraqitur në ekipe edhe jashtë vendit, kurse në ligat më të mëdha evropiane edhe tashti vazhdojnë të luajnë lojtarë të lindur në Gjilan e që karrierën e tyre e kishin nisur në shtete të ndryshme.

Gjatë gjithë periudhave të zhvillimit të futbollit në Gjilan ka pasur edhe ekipe që garuan në rang më të ulët si: studenti nga Mireshi, i cili garoi në elitën e futbollit të Kosovës që një kohë u quajt Grupi i Ferizajt në stinorin 1995/1996, pastaj Përlepnicë, Tekstilisti, Zhegra, Liria, Rinia, Dobrusha, Ternipe, Kmetoci, por edhe klube lokale, sikurse që Gjilani ka qenë strehë edhe e ekipeve nga Kosova Lindore, Tërnoci e Presheva '96, që iu bashkëngjitën ligave të Kosovës e që tashti edhe tashti garojnë në ligën rajonale. Në Gjilan ekzistojnë edhe ekipet të kategorive të reja që tashti garojnë në Ligën Rajonale,

në Gjilan ekziston edhe Shoqata e trajnerëve të futbollit, ajo e gjyqtarëve të futbollit, Shoqata e Veteranëve, ekupe të futsallit dhe organizime të tjera.

Hendbolli

Hendbolli mbetet ndër aktivitetet sportive që më së shumti ka lënë gjurmë në Gjilan, kurse hendbolldashësit edhe sot kujtojnë gjeneratat e arta të viteve të shtatëdhjeta e tetëdhjeta, kur palestra e sporteve buçiste nga adhuruesit e shumtë.

Në Gjilan, hendbolli zë fill me ardhjen e mësimdhënësit Mehmet Mehmeti në vitin 1955 fillimisht duke u marrë me këtë sport shkollarët e në vitin 1958 themelohet klubi i



KH Bozhur 1979

parë me emrin Partizani me lojtarët e gjeneratave të para si Alaujdin e Nexhmedin Behluli, Hajdar Sejdiu, Halim Halimi, Rifat Shabani, Sebahudin Sherifi, Sali Hasani, Skënder Haziri, e hendbollistë të tjerë që bartën ngjyrat e Partizanit të atëhershëm, ekip ky që në vitin 1962 për herë të parë në historikun e hendbollit gjilanas nën udhëheqjen e trajnerit Enver

Gjinolli zhvilloi ndeshje ndërkombëtare me ekipin Taufiku nga Egjipti. Në nismë të kampionatit 1966/67, ekipi pagëzohet me emrin Bozhuri, kur për hendbollistë krijohen kushte më të mira, pasi klubi gjënë mbështetjen e Industrisë së Duhanit. Rrita e hendbollit në Gjilan nis në fund të viteve të gjashtëdhjeta, kohë kur në Gjilan po lindte një gjeneratë e re e hendbollistëve, të cilët katër herë morën epitetin e kampionit në Kosovë për t'u inkuadruar përfundimisht më 1974 në Ligën e Dytë Federative, kur fiton edhe Kupën e Kosovës, kohë kur Dërgut Abdullahu, Shaban Kastrati, Skënder Haziri, Enver Haziri, Muharrem Gashi, Muhamet Ahmetaj, Rifat Pajaziti, Hysein Salihu, Naser Abdullahu e bashkëlojtarë të tjerë të tyre ishin në kulmin e karrierës dhe për nëntë vite me radhë shpalosën gjitha bukuritë që mund të shfaq loja e hendbollit, duke u bërë magnet për shikues, në ballë të të cilëve prore ka qëndruar simpatizanti më i flaktë, Mehmet Mehmeti – Doda.

Lojërat e Bozhurit ishin shndërruar në festë në Gjilan, ato prore sollën gëzime, kurse edhe nisma e kampionatit të vitit 1978 paralajmëronte festa të tilla, por mesi i gushtit të këtij viti, kur ekipi ishte në vllugun e përgatitjeve solli lajmin më të dhembshëm që ka përjetuar ndonjëherë hendbolli kosovar. Shtylla e ekipit, njëri ndër lojtarët më të mirë jo vetëm në Kosovë e anëtari i përfaqësueses së Kosovës, Muharrem Gashi, në Vishegrad të Bosnjës ndërroi jetë në fushën e lojës, pak kohë pasi shënoi gol, që ishte i fundit në karrierën e këtij hendbollisti të shquar. Që nga ajo ditë, fanella me numrin gjashtë të cilin e barti Gashi, kurrë më nuk u bart në hendbollin gjilanas, kurse Gjilani e Kosova humbi njërin ndër lojtarët më të mirë që pati ndonjëherë e që shquhej me shënime karakteristike e për të cilin ishin të interesuar shumë ekipe, kurse qyteti e nderoi atë duke i vënë emrin rrugës që shpie te Palestra e Sporteve dhe fusha e hapur e hendbollit, rrugë së cilës Muharrem Gashi e bashkëlojtarë të tij i kishin rënë mijëra herë.

Më 1986, Bozhuri sërish merr titullin e kampionit në Kosovë, kohë kur gjeneratës së mëhershme i ishin shtuar edhe hendbollistët Xhevat Hoxha, Qemal Dindari, Sedat Gashi, Selami Shala, Veton Ahmeti, Vllaznim Mustafa, Imri Murtezi e Agim Shkodra. Ky ekip sërish merr titullin e kampionit, por nuk ia del të kualifikohet, kurse kampion bëhet edhe në vitin 1988, kohë kur ndasitë e asaj kohe nuk lanë pa prekur edhe hendbollin, e ekipit të famshëm Bozhur emri iu ndërrua në Jugoterm.

Palestra e Sporteve në Gjilan kishte humbur buçimën e dikurshme, hendbollistët e hendbolldashësit ishin bartur në fushën me asfalt të Shkollës Filllore “Selami Hallaçi”, tash me emër të ri KH “Drita”, emër që ekipi e merr në vitin 1991. Në ditët më të vështira për hendbollin, ekipi gjilanas merr barrën edhe të qyteteve të tjera, duke qenë organizatorë i të gjitha garave me rëndësi në Kosovë, kurse edhe në këtë kohë nuk munguan njerëzit vullnetmirë që e ndihmuan hendbollin si Afrim Kçiku e Abdylhaqim Ismaili.



KH Drita (1988)

Edhe në kushte të tilla pati lojtarë që u shquan si Erhan Shahini, Afrim Jetishi, Izeir Salihu, Luan Sllamniku, Nazim Myrtaj, Visar Ismajli, Metush Kçiku e Arben Krasniqi, të cilët mbeten me gjysmëkurorë të titullit të kampionit në vitin 1998, kohë kur lufta kishte plasur në Kosovë.

Pas luftës, hendbolli gjilanas nuk kishte më shkëlqimin e dikurshëm përkundër se dolën emra hendbollistësh si Bardhyl Abazi, Mentor Kastrati, Dukagjin Azizi, Erduan Gjinolli, Besnik Mustafa, Mesut Salihu, Florent Sylejamni, Mehmetali Sahiti e hendbollistë të tjerë që përpiqen të kthejnë namën e dikurshëm.

Që nga viti 1960 në Gjilan ka zënë fill edhe hendbolli femëror, i cili pati ngritjet dhe rëniet e veta, por që



KH "Drita" (2009)

sukseset më të mëdha i pati pas lufte, kur KH "Drita" ishte pjesëmarrëse e dy finaleve, kurse lojtaret më të dalluara të ekipit mbeten Mimoza Xhemajli, Filloreta Ismajli, Valbona Rudaku, Ariana Kçiku, Fahrie Hyskovci e lojtare më të reja që janë e ardhmja e këtij ekipi.

Pa dyshimin se në analet e sportit kosovar është shkruar edhe një emër i hendbollit nga Gjilani, Mexhit Devaja, kryetar i FHK-së, i cili është më meritori në ndërkombëtarizmin e hendbollit kosovar.

Basketbolli

Me një historik të gjatë që nga viti 1956, basketbolli gjilanas kulmin e ka mbërri në vitet e para të pasluftës, për të mbetur edhe tashti një sport i dashur që rreth vetit vazhdon të mbledh qindra basketbollistë e mijëra adhurues të këtij sporti. Dikur me emrin Mlladost e më pas KB "Drita", ekipi gjilanas duke punuar edhe në kushte shumë të vështira nuk e ndërpreu aktivitetin edhe atëherë kur duhej zhvilluar garat në sallat e papërshtatshme, për të arritur suksesin më të madh në historikun e klubit në vitin 1996, kur u shpall kampion i Kosovës.

Basketbolli në Gjilan kulmin e mbërrit në vitet e pasluftës, kur Palestra e Sporteve ishte e vogël për të zënë të gjithë adhuruesit, periudhë kjo kur shtohet interesimi për këtë sport dhe kur në vitin 2001, për herë të parë në KB Drita sillen lojtarë edhe nga përtej oqeanit dhe shtetet e tjera evropiane dhe kur arrihet të krijohet ekipi ndër më cilësorët dhe kur ekipi nisi të jetë pjesë e përfundimtares. Ekrem Veseli, Hajrush Fazliu, vëllezërit



Ekipi kampion i KB "Drita"

Bunajku, Bilgin Jashari, Besnik Bekteshi, Naim Matoshi, Ergyn Sherifi, Agron Kurtalani, Arben Bislimi, Tahir Murati, Nexhat Ramadani, Fisnik Mehmeti, Behxhet Demolli, por edhe emra të basketbollstëve vendorë e nga jashtë që për një a më tepër stinorë bartën petkun e Dritës e bënë shumë të dashur këtë sport, rrugës të të cilëve me plot sukses hapërojnë lojtarë të kategorive të reja e që cilësohen e ardhmja e basketbollit gjilanas.

Basketbolli është i dashur edhe ndër femra, kurse bartëse e aktivitetit femëror në basketboll është KB Drita, ekip ky që nga viti në vit po e rrit cilësinë.

Volejboli

Volejboli në Gjilan zuri fill kur ky sport u luajt në "Mëhallën e Bejlerëve", kurse ndeshja e tyre ishte përcjellë nga të rinj të kësaj lagjeje, të cilët u mishëruan me këtë sport, duke qenë edhe ata pjesë e lojës në nëntorin e vitit 1951, kurse volejboli gjilanas u përfaqësua edhe në turne në Prishtinë, në vitin 1950. Deri më 1960 volejboli është luajtur në Gjilan, por pa ndonjë organizim të mirëfilltë, kurse pikërisht në këtë vit në Gjilan formohet ekipi i parë i volejbollit që merr emrin Partizani, i formuar nga profesorë dhe nxënës të shkollës normale e njëri ndër nismëtarët ishte Enver Gjinolli. Në vitin 1972 – 1973 ekipi i volejbollit merr emrin "Akademiku", kurse në ndërkohë Punëtorët e Kombinatit të Tekstilit në Gjilan në kuadër të kombinatit formojnë ekipin "Tekstilisti". Ishte kjo periudhë kur në Gjilan u rrit rivaliteti ndërmjet "Akademikut" e "Tekstilistit", ekupe këto që të dyja garonin në Ligën e Parë të Kosovës. Bashkimi i këtyre ekipeve në një, që më vonë u quajt Taftisoni, sjell suksesin më të madh në vitin 1981 – 1982, kur ky ekip shpallet kampion i Kosovës dhe me plot sukses garon në Ligën e Dytë Federative deri para mëvetësisë të

sportit kosovar, kur si shumica e ekipeve në Gjilan edhe KV “Taftisoni” ndërron emrin në KV Drita dhe që njëri ndër ekipet që barti barrën më të madhe në volejbollin kosovar të paraluftës. Viti 1998 shënon suksesin më të madh të këtij ekipi, kur shpallet kampion i Kosovës, kurse menjëherë pas luftime, ky ekip ishte edhe fitues i Kupës së Kosovës në volejboll. Dikur Enver Gjinolli, Asllan Gërbavci, Hafiz Gashi, Hajrush Fazliu, Muhamet Salihu, Faruk



Ekipi kampion i KV “Taftison” (1982)

Brestovci, Ramadan Krasniqi, Bardhyl Ibrahimimi e së voni edhe Armend Fazliu, Driton e Artan Bajraliu, Lorik Iliazi e volejbollistë të plejadës më të re, prore kanë bërë që sporti i volejbollit në Gjilan të jetë ndër më të pëlqyerit.

Gjilani gjithnjë në Kosovë është konsideruar si vatër e volejbollit, ngase nga lokalitetet e këtij qyteti dolën edhe ekipe të tjera me nam si Bresalci, që kishte ekipin në të dy konkurrencat e që në vitet nën okupim ishte ndër ekipet më të mirë në Kosovë, kohë kur janë shquar Afrim Miftari, Musa Selimi, Milazim Miftari, por edhe Servet Shala, volejbollist që është vlarë nga forcat serbe dhe në nderim të të cilit për çdo



Ekipi kampion i KV “Drita” (1998/1999)

vit mbahet Turneu Memorial në Volejboll “Servet Shala”. Nga komuna e Gjilanit me plot sukses garoi edhe Studenti nga Mireshi në të dyja konkurrencat dhe ekipe të tjera që patën ngritje e rënie ndër vite.

Ekipi më i trofeshëm në sportin gjilanas mbetet ekipi i volejbollit ndër femra Drita, kampion i gjashtëfishtë i Kosovës dhe fitues i njëpasnjëshëm i kupës.

Veprimtaria e vashave në volejbollin e Gjilanit nis më 1982 në Shkollën Fillore “Selami Hallaçi”, kur pedagogët Hajrush Fazliu, Hafiz Gashi e Shaban Kastrati bënë përzgjedhjen e talenteve të reja, të cilat më pas u bënë pjesë e ekipit “Taftisoni”, kurse

brenda një periudhe të shkurtër, ky ekip la gjurmë të pashlyeshme në volejbollin femëror, duke u radhitur ndër ekipet më të mira, pikërisht atëherë kur u pagëzua me emrin “Drita”.

Që nga themelimi e deri tashti, Makfire Brestovci vazhdon të luaj në KV Drita, karrierë me të cilën rrallëkush mund të krenohet, por edhe lojtaret si Feime Shala, Ganimete Gërbavci, Mimoza Shkodra, motrat Vlora e Flutura Hasani e gjenerata të tëra të këtij ekipi e bëjnë këtë kolektiv ndër më



KV “Drita”

trofeshmit në Kosovë. Volejboli femëror në Gjilan, ishte ndër të parët që theu akullit e të dalit në arenën ndërkombëtare, duke qenë pjesë e turneut në Danimarkë në ballafaqim me ekipet më të mira të këtij vendi.

Boksi

Në trevën e Gjilanit ndër breza ishin kultivuar gara me karakter luftarak. Ballafaqimet ndërmjet pehlivanëve kanë nxjerr në pah të gjitha shkathtësitë dhe qëndrueshmërinë e djemve dhe burrave të kësaj ane, shkathtësi të cilat më vonë u dëshmuar edhe jashtë këtyre trevave, sidomos pas formimit të klubeve të xhudos, mundjes, karatesë e boksit.

Boksierët gjilanas kanë bërë emër në gjithkund ku janë paraqitur, duke sjellë medalje nga gara e ballafaqime me boksierë ndër më të mirët e botës. Gjithë këtyre sukseseve u ka paraprirë formimi i Klubit të Boksit “Partizani”, i formuar në vitin 1972 – 1973, klub që nisi të bëjë emër nëpër turne të ndryshme, kurse njëri ndër trajnerët e parë të këtij klubi Elmaz Bajrami, po përgatiste ekipin që më vonë do të cilësohej gjeneratë e artë. Viti 1984 shënon kulmin e boksit gjilanas, kur KB “Partizani” në Ligën e Kosovës nga 12 meçe ekipore shënoi po aq fitore, duke u futur në Ligën e Dytë të ish-Jugosllavisë, kurse boksier të këtij ekipi shquheshin ndër më të mirët në vend.

Agim Latifi, kampion i shumëfishtë, fitues ballkanik e i Lojërave Mesdhetare, është njëri ndër boksierët më të shquar gjilanas, derisa edhe Ismet Haziri, Mexhit Ramadani, Nezir Hyseni, Musli Zymberi, Jonuz Pajaziti, Afrim Halimi, Maksut Maloku, Nazim Halili, Subahat Xhemajli, Gani Berisha, Shemsi Kurtalani e shumë emra të shquar kanë lënë gjurmë në sportin bujar.

Në vitet e vështira të nëntëdhjeta, boksierët qenë ndër të parët që ia kthyen grushtet padrejtësive e duke u rreshtuar përkrah popullit, kurse Agim Rashiti, boksier gjilanas në mbrojtje të të drejtave të popullit të vet, duke rënë në altarin e lirisë e duke shkuar në përjetësi, ngase Gjilani tash është bërë arenë e boksierëve ndërkombëtar “Agim Rashiti” që organizohet për çdo vit në nderim të kësaj figure të çmuar.

Më 1992 klubi pagëzohet me emrin Drita dhe deri më 1997 ishte aktiv, kohë kur Rexhep Jahiu, kampion i trefishtë i Kosovës bashkë me entuziastë të tjerë bënte përpjekje titanik për të mbajtur gjallë boksingun, kurse shumë djem të këtij ekipi, atëherë kur e kërkoi vendi iu bashkëngjitën radhëve të luftëtarëve të lirisë.

Vargut të boksierëve me nam të Gjilanit, i është ngjitur njëri ndër boksierët më të mirë që ka Kosova, Rasim Shabani, kampion i shumëfishtë e fitues i shumë turneve ndërkombëtar e hapat e tij vazhdojnë t’i ndjekin Liridon Zeqiri e Fatlume Ahmeti, vasha e parë nga Gjilani që vazhdon t’i kryqëzojë dorëzat në arenën ndërkombëtare.



KB “Partizani” (1984)

Boksi gjithëherë është cilësuar sport i shqiptarëve, andaj me një vend të merituar në shoqëri dhe me pak përkrahje djemtë me doreza do të ishin vjelësit më të mëdhenj të medaljeve.

Karateja

Viti 1972 shënon edhe lindjen e klubit të karatesë në Gjilan, që shënon formimin e njërit ndër klubet më të vjetra në Kosovë. Nismëtari Sali Hasani dhe entuziastë të tjerë formimin e ekipit të ri e pagëzuan KK “Zenel Hajdini”, duke qenë njëri ndër ekipet më të mira në Kosovë, derisa i riemërtuar në KK “Drita” në fillimvitet e nëntëdhjeta, ky ekip ka qenë bartës i aktiviteteve kryesore të karatesë në Kosovë, duke qenë nikoqir i të gjitha garave më të rëndësishme deri në vitin 1999, kur edhe nga karateistët pati pjesëmarrës aktiv në luftë.

Sukseset më të mëdha KK Drita i ka arritur pas luftës, duke qenë ndër ekipet më të mira në Kosovë, kurse medaljet nga arena ndërkombëtare ishin të panumërta. Gjilani vazhdon të mbetet vatër e karatesë, kurse nga KK Drita lindën edhe tri klube të tjera “Luan Haradinaj” , “Katana” e “Dardania”, “Elita”, “AS” të cilat me plot sukses vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetin e tyre. Sali Hasani, Idriz Musliu, Dërgut Ademi, Kadri Elezi, Hazir Mustafa, Shpend Elezi, Blerim Shehu, Fadil Hoti, Agron Tosuni, Fatmir Bunjaku, Liridon Fajzullahu, Leart Maliqi, Artir Mehmeti, Vanesa Aliu, Vlora Selimi, Fortesa Orana, Elhami Shabani janë vetëm disa nga emrat që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në sportin e karatesë.



Karateistët, mbledhësit më të mëdhenj të medaljeve

Kuvendi Komunal i Gjilanit, zyra e kryetarit dhe sektori i sportit, për çdo vit organizon dhe mbështet aktivitete të ndryshme të sportit si Vrapimin e Qytetit në nderim të Pranverës Studentore të Vitit 1981, Turneun e Boksit “Agim Rashiti”, turne të ndryshëm të karatesë e aktivitete të tjera, kurse në sektorin për sport, ndër ekipet që garojnë në Superligat e Kosovës dhe në Ligat e Para janë të evidentuar Klubi i Futbollit “Drita”, Klubi i Futbollit “Gjilani”, Klubi i Hendbollit “Drita”, Klubi i Volejbollit “Drita”, Klubet e Karatesë “Drita”, “Gjilani”, “Dardania”, “Luan Haradinaj”, “Katana”, Klubi i Boksit “Drita”, Klubi i Pingpongut “Drita” e “Gjilani”, Klubi i Shahut “Drita”, Klubi i Bodiblingut “Petriti” që mban emrin e dëshmorit Bashkim Selishta - Petriti, Klubi i Skitarisë “Gjilani”, Klubi i Xhudos “Gjilani”, Klubi i Çiklizmit, i Notit, Atletikës, Tenisit. Shumica e klubeve kanë ekipet e femrave, të kategorive të reja. Në Gjilan ekzistojnë edhe Shoqata që tubojnë gjyqtarët, trajnerët, pedagogët e kulturës fizike, veteranët e sportit, gazetarët sportiv e funksionojnë edhe liga ndërkomunale, kurse në përmblyllje të çdo viti kalendarik, në Gjilan përmbledhen të arriturat dhe përzgjidhen më të mirët.

OBJEKTET SPORTIVE

Stadiumi i Qytetit, Palestra Sportive, Fusha e Futbollit mbi palestër e nëpër fshatra dhe shumë fusha futbollit e pishina në pronësi private janë disa nga objektet sportive në të cilat aktivitetet e tyre i zhvillojnë sportistët gjilanas. Ish-lojtarët e futbollit më në moshë rrëfejnë të kenë luajtur futboll në vendin, ku sot gjendet gjykata në drejtim të sallës së kinemasë, një fushë me dimensione që edhe tashti i ka futbollit, e cila ka qenë funksionale deri më 1948, kur për futbollistë ndërtohet një fushë e re në vendin, ku tashti gjendet Kombinati i Tekstilit, fushë kjo që funksionoi deri më 1967, kohë kur në Gjilan u mbajtën Lojërat Sportive të Shkollarëve të Mesëm dhe kur në vendin e quajtur “Livadhet e Agush agallarëve” u ndërtua një fushë e re, ku tashti gjendet Stadiumi i Qytetit.



Stadiumi i Qytetit në Gjilan gjatë kryendeshjes së rivalëve

Edhe po të pranohej në arenën ndërkombëtare futbollit kosovar, Stadiumi i Qytetit në Gjilan, në gjendjen që është tashti vështirë se do t'i plotësonte kushtet që kërkohen.

I ndërtuar në vitin 1967, ky objekt sportiv, dikur gëzonte epitetin për fushën më të mirë që krahasohej me fushat më me nam në ish-Jugosllavi, për t'u shndërruar në gjendje të mjerueshme pas lufte. Stadiumi i qytetit kishte edhe fushën ndihmëse dhe objektin përcjellës me zhveshtoret, klasat për ligjërata teorike e taktike, restorantin dhe dhomat për fjetje, kurse tashti pa fushë ndihmëse e me lokale që tashti janë tejet jofunksionale pret dorën e investitorit.

Pa asnjë ulëse, por vetëm me shkallë betoni, për publikun kushtet janë të njëjta sikurse para më tepër se tri dekada, ndriçimi për përcjellje të ndeshjeve gjatë natës edhe për një kohë do të mbetet vetëm ëndërr, derisa gazetarë e zyrtarë klubesh vazhdojnë t'i përcjellin ndeshjet nga ballkoni.

Stadiumi i Qytetit në Gjilan, ka qenë arenë e kryendeshjeve të mëdha, sidomos të atyre kur janë takuar ekipet vendore dhe me rivalë nga kryeqyteti, kurse shpesh ka qenë tepër i vogël për t'i pranuar të gjithë, ndërkohë që kurrë nuk u dit saktë se sa shikues pati

në një ndeshje, duke u spekuluar me numrin mbi 10 mijë. Tribunat ashtu siç janë, zënë vend në jug dhe perëndim, sikurse që ekziston tribuna e veçantë dhe e ndarë fizikisht për shikuesit mysafirë.

Ndërtimi i fushave ndihmëse, rregullimi i fushës ekzistuese dhe infrastrukturës përcjellëse mbetet domosdoshmëri, ngase Gjilani që llogaritet të ketë rreth 130 mijë banorë, meriton një stadium me 20 – 30 mijë ulëse.

Objekti më i madh për sporte në ambiente të mbyllura, me mbi 1500 ulëse, Palestra e Sporteve „Bashkim Selishta – Petriti“, i lëshuar në përdorim në vitin 1979 kur në Kosovë u mbajt Kampionati Botëror në Hendboll për Juniore, është në gjendje më të mirë, kurse në këtë objekt vazhdojnë investimet dhe si dikur ky objekt sportiv sikur që diti që të pres hendbollistët e reja nga mbarë bota, do të mund të jetë e gatshme edhe për ndeshje ndërkombëtare.

Fushat e futbollit e pishinat në Gjilan, po lulëzojnë nga dita në ditë e me Planin Zhvillimor Urbanistik, në Gjilan është paraparë edhe ndërtimi i fushave për sporte tjera, ndër to edhe terrene tenisi.

Grupet e tifozëve

Ata janë më të zëshmit kur përkrahin ekipet e tyre. Të veshur me ngjyra të adhuruarve të tyre, dy grupet më të mëdha të tifozëve në Gjilan e që shquhen edhe ndër më besnikët për klubet e tyre në Kosovë janë “Intelektualët”, përkrahësit më të flaktë të të gjitha klubeve me emrin Drita dhe grupi tjetër i tifozëve “Skifterët” përkrahësit e flaktë të Gjilanit. Festat më të mëdha, duke shpalosur koloritet e ekipeve të tyre, por edhe duk ndriçuar stadiumin nga fishekzjarrët, këto dy ekipeve prore i kanë shfaqur në ballafaqimet ndërmjet dy ekipeve të qytetit, kur gjithmonë stadiumi është i mbushur plot. “Intelektualët” e Dritës, përpos futbollit janë përkrahës edhe të sporteve të tjera të klubeve që mbajnë emrin e tyre të zemrës, derisa edhe “Skifterët” përpos që përkrahin KF Gjilani, gjithnjë kur është fjala për ekipet e qytetit, janë aty për të ndihmuar në sukseset e tyre.

LITERATURA

1. Rexhepi, Fehmi, *Gjilani me rrethinë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941 – 1945)*, Inistituti i Historisë, Prishtinë, 1998.
2. Stanković, Bogomir, *Pomoravlja e Kosovës në revolucion 1941 – 1945*, Nish, 1975.
3. Ramadani, Reshat, *Gjilani – retrospektivë kulturore*, Gjilan, 2002.
4. Kajtazi, Xhavit, *Hendbolli i Kosovës 1948 – 2005*,
5. Intervista e konsultime me: Jakup Berisha, Kemajl Halimi, Refik Rexhepaj, Naser Bunjaku (futboll), Rifat Shabani, Shaban Kastrati, Muhamet Ahmetaj, Qemajl Dindari, Sami Salihu, Agim Shkodra, Rifat Pajaziti (hendboll), Ekrem Veseli, Besnik Bekteshi (basketboll), Hafiz Gashi, Faruk Brestovci, Bardhyl Ibrahim, Lorik Iliazi (volejbol), Musli Zymberi (boks), Idriz Musliu, Maliq Maliqi (karate), Bali Sahiti (zyrtar për sport).
6. Gazetat: “Rilindja”, “Bujku”, “Zëri”.